

Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave

Raport për vitin 2010-2011

I. Rezyme

Gjykimet për krimet luftës

Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar.

Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve, të të akuzuarve dhe të të dënuarve para ligjit. Në procedurat për krimet e luftës, në nivel të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos, zbatohet Ligji Penal i RSFJ-së, kurse Ligji Penal i BdheH zbatohet në Gjykatën e BdheH. Për shkak të kundërshtimit të Republika Srpska, e cila i referohet Marrëveshjes së Dejtonit, nuk ka Gjykatë Supreme në BdheH, arsye kjo për të cilën procedura ankimore është në kompetenca të Gjykatës së BdheH, e cila gjykimet i kryen në procedurën e shkallës së parë.

Bartja e kompetencave për gjykim për krimet e luftës në gjykata më të ulëta shkon ngadalë. Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011, në tërësi janë bartur 83 lëndë në gjykatat me kompetenca vendore. Prej tyre, në tërësi 52 lëndë janë caktuar në gjykatat në FBdheH, 27 në gjykatat në RS, dhe një lëndë në Gjykatën Themelore në distriktin e Brçkos në BdheH. Obligimet e reja të gjykatave kantonale dhe të qarkut e kërkojnë mbështetjen përkatëse teknike, profesionale dhe financiare, në mënyrë që gjykimet të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe pa shkelje të së drejtës në gjykimin fer dhe të drejtë.

Instituti i pranimit të fajit, me pjesëmarrjen e shoqatave të viktimave në sjelljen e vendimeve mbi përmbarrimin në rastin konkret, dëshmohet si një instrument përkatës i drejtësisë penale në raport me rrjedhën e madhe të kohës nga kryerja e krimeve të luftës, vjetërsia e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe me nevojën e viktimave për të përjetuar pendimin publik dhe kërkimfaljen e kryerësve.

Gjykimet janë më intensivet në Gjykatën e BdheH, i cila që nga themelimi e deri në fund të vitit 2011 me vendime të plotfuqishme ka dënuar 88 persona dhe ka përfunduar gjithsejtë 78 raste për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të zakoneve ndërkombëtare të luftës.

Mbyllja e negociatave mbi kapitullin 23, mbi drejtësinë dhe të drejtat themelore ka sjellë, me anë të sinergjisë së kritikës së institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave të të drejtave të njeriut si dhe rekomandimit të Komisionit Evropian, deri te përmirësimi i kuadrit juridik në të cilin kryhet procesimi i krimeve të luftës në Republikën e Kroacisë. Me ndryshimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë është futur kompetenca ekskluzive e gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb, si dhe mundësia e shfrytëzimit të provave të mbledhura nga GJPNJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë.

Në vitin 2011 është bërë progres në procesimin e krimeve të luftës. Trysnia e Amnesty International dhe e organizatave vendore për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2011 ka kontribuar që Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) të ngrit aktakuzë kundër Tomisllav Merçepit, këshilltarit të luftës në MPB-në e Republikës së Kroacisë, dhe Vlladimir Milankoviçit, komandantit të njërive aktive dhe rezervë në formacion të DP në Sisak gjatë vitit 1991 dhe 1992. Megjithëkëtë, pos këtyre disa shembujve edhe më tutje nuk ka hetime kundër eprorëve politik dhe ushtarak në rastin e veprave penale kundër pjesëtarëve të grupit të pakicave kombëtare. Me gjithë ekzistimin e informatave dhe provave publikisht të qasshme, të shfrytëzuara në procedurat penale të përfunduara, ende nuk ka filluar procedura kundër Vlladimir Sheksit, në kohën e luftës kryetar i Shtabit të Krizës për Sllavoninë Lindore, i cili, siç pohohet, është i përfshirë në krimet e kryera në Osijek në vitin 1991.

Në rastet e viktimave të dhunimit/dhunës seksuale, gjykatat, as edhe në një rast, nuk i kanë zbatuar masat e mbrojtjes së identitetit të viktimës – të dëshmuarit përmes hapësirës tjetër me anë të video linkut, ndryshimit të

personit dhe të zërit, përdorimin e pseudonimit etj. Viktimat, vetëm në disa lëndë gjatë të dëshmuarit në seancat kryesore gjyqësore, janë përjashtuar nga publiku.

Arsyetimet, të cilat i përcjellin dënimet e ulëta me burgosje, dhe aktgjykimet me të cilat të akuzuarit lirohen nga akuzat, e zbulojnë anshmërinë e gjyqtarëve ndaj pjesëtarëve të policisë dhe të ushtrisë së Kroacisë. Gjyqtarja e Gjykatës së Qarkut në Sisak, Snjezhana Mrkoc, me rastin e arsyetimit të aktgjykimit me të cilin të akuzuarit lirohen nga akuzat lidhur me katër pjesëtarë të UK, në muajin nëntor të vitit 2010, ka thënë: „Më vjen jashtëzakonisht shumë keq që duhet t'i dënoj pjesëtarët e ushtrisë së Kroacisë për vepra penale, të cilat jemi mësuar t'i bëjë ana e kundërt, posaçërisht tash kur i ndezim qirinjtë për Vukovarin.“

Shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë të Hagës për gjeneralët Ante Gotovina dhe Mlladen Markaç e kanë përcjellë komente paushalleske politike, ngritja e të gjykuarve në piedestalin e heronjve kombëtar, organizimi i protestave të përkrahjes anë e kënd Kroacisë, injorimi i gjetjeve faktike dhe i vuajtjeve e padrejtësisë, të cilat janë bërë ndaj viktimave.

Legjislacioni i Republikës së Serbisë nuk është në harmoni me standardet të cilat i ka vendosur GJPNJ në pikëpamje të përgjegjësisë komanduese. Në legjislacionin penal të Serbisë nuk ka institucion të përgjegjësisë komanduese. Nuk ka as vullnet politik që të gjykohej gjeneralët. Edhe pse GJPNJ me aktgjykimin e saj të shkallës së parë e ka gjykuar pothuajse gjithë kreun e dikurshëm shtetëror të Republikës së Serbisë, kjo nuk ka sjellë deri tek fillimi i procedurave penale kundër oficerëve të lartë të ushtrisë dhe të MPB-së, në zonat e përgjegjësisë së të cilëve ka pasur krime masive të luftës.

Hetimet, të cilat i përgatit dhe i fillon Prokuroria për Krimet e Luftës e Republikës së Serbisë (PKL) zgjasin shumë dhe në një numër relevant të rasteve nuk rezultojnë me aktakuzë. Në lidhje me krimet masive, të kryera në BNK të Dubravës në Kosovë, PKL ka filluar të veprojë në vitin 2008, por deri në fund të vitit 2011 nuk i ka hapur hetimet. Në lidhje me akuzat penale të FDH-së kundër komandantit të togut të Dhjetë Diversant të Ushtrisë së Republika Srpska, Millorad Pelemishit, të muajit gusht të vitit 2010, PKL publikisht ka njoftuar për fillimin e procedurës penale, por kjo nuk ka ndodhur deri në fund të vitit 2011.

PKL gjatë vitit 2011 i ka gjykuar gjithsejtë nëntë persona. Prej tyre, vetëm njëra aktakuzë, (kundër tre të akuzuarve) përbënë një procedurë të re, kurse aktakuzat kundër gjashtë të tjerëve kanë dalë nga dy procedura të mëhershme të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd.

Në lëndët e krimeve të luftës, të kryera në Kosovë, PKL shpesh ngrit aktakuza në bazë të hetimeve pjesërisht të zhvilluara, siç është lënda e Suharekës dhe e Qyshkut.

Është praktikë e PKL që të ndryshojë aktakuzat para sjelljes së aktgjykimit, duke e zvogëluar përgjegjësinë e të akuzuarve në pozita komanduese, siç është rasti në lëndën *Zvornik II* [i akuzuari Popoviq dhe Grujiq]. Edhe në vitin 2011, lëndë të bartura ka pasur më shumë se procedura të reja, si para Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, ashtu edhe para Gjykatës së Apelit në Beograd.

Si edhe në vitin 2010, Gjykata e Apelit në Beograd, edhe në vitin 2011 ka vazhduar të konfirmoj dënimet e ulëta me burgosje të gjykatës së shkallës së parë. Shembulli më negativ është lënda *Zvornik II*, në të cilën i akuzuari Branko Popoviq është dënuar me 15 vite burgosje, kurse i akuzuari Branko Grujiq me dënim me burgosje në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh. Duke pasur parasysh se ata të dy, në kohën e kryerjes së krimeve, si bartës të pushtetit civil dhe ushtarakë në komunën e Zvornikut, sipas natyrës së funksioneve të tyre kanë qenë më të përgjegjshmit, se kanë qenë pjesëmarrës aktiv në realizimin ose, madje, organizator të planit mbi dëbimin e po-pullatës civile nga territori i komunës së Zvornikut, lartësia e dënimit, e cila iu është shqiptuar, është skajshmërisht joproporcionale.

Mbrojtja e dëshmitarëve insajderë shkakton brengosje të madhe, posaçërisht kur kihat parasysh raporti mbi veprime të paligjshme në procesimin e krimeve të luftës, të cilin FDH ua ka dërguar institucioneve shtetërore në

nëntor të vitit 2010 si dhe reagimet e PKL lidhur me pjesë të caktuara nga ai raport.¹ FDH vë në pah se Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve funksionon si grup për trysni, i cili e ka për detyrë të parandalojë pjesëtarët e ushtrisë dhe të policisë për të dëshmuar mbi krimet e luftës. Posaçërisht brengosin pjesët e pohimeve të dëshmitarëve insajderë se PKL i ka dekurajuar që të dëshmojnë kundër gjeneralit të akuzuar të policisë, si dhe pohimet e PKL se dëshmitarët insajderë fabrikojnë gënjeshtër mbi atë institucion.

Ligji Penal i Kosovës i përgjigjet më shumë kërkesave të së drejtës ndërkombëtare se sa Ligji Penal i RSFJ-së. Ligji Penal i Kosovës përfshin dhunimet dhe përgjegjësinë komanduese të komandantit ushtarak ose të personit, i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak dhe i cili mundet, në rrethana të caktuara, për të qenë përgjegjës për veprimet e të gjithëve nën kontrollin e tij efektiv, ndryshe nga Ligji Penal i RSFJ-së, i cili e njeh vetëm përgjegjësinë penale për urdhërim dhe kryerje të krimeve të luftës.

Në gjykatat në Kosovë për trajtim presin më shumë se 200.000 lëndë të mbetura. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në muajin nëntor të vitit 2010, e ka miratuar Strategjinë Kombëtare për uljen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, por zbatimi i kësaj strategjie ende nuk ka dhënë rezultate të dukshme. Problemet, siç janë trysnitë politike, mungesa dhe joprofesionalizmi i prokurorëve dhe i gjykatësve vendor, edhe më tutje janë aktuale.

Në vitin 2010, EULEX-i, i cili është përgjegjës për gjykimet për krime të luftës, ka qenë i angazhuar më shumë në lëndët e krimit të organizuar, të korrupsionit, të keqpërdorimit të pozitës zyrtare si dhe në procedurat sipas ndihmës së jashtëzakonshme juridike, kurse më pak në gjykimet për krime të luftës. Në vitin 2011, ka pasur më shumë hetime të përfunduara, të cilat kanë rezultuar me konfirmimin e aktakuzave, me aktgjykime të shkallës së parë dhe të plotfuqishme. Është e rëndësishme që prokurorët vendor kanë qenë të angazhuar në dy lëndë të krimeve të luftës. Në lëndën *Prokurori kundër Sllobodan Martinoviçit dhe të tjerëve*, prokurori vendor e ka marrë lëndën në fazën e seancës gjyqësore kryesore, kurse në lëndën *Prokurori kundër Zoran Koliçit*, prokurori vendor i ka udhëhequr hetimet.

Mbrojtja e dëshmitarëve është problemi më i madh në procesimin e krimeve të luftës në Kosovë. Në muajin korrik të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili parasheh themelimin e Komisionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili vendos për fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e programit të mbrojtjes. Shqetësim të madh shkakton dispozita, e cila parasheh “regjim special për dëshmitarët e mbrojtur në burgje dhe në shtëpi ndëshkuese korrektuese”.

EULEX-i, kurse para tij UNMIK-u, proceson dhe hulumton rrëmbimet e shqiptarëve në Kosovë nga ana e UÇK-së, për shkak të dyshimit se kanë bashkëpunuar me pushtetin serb, por ende nuk merret me trajtimin e rrëmbimit të serbëve, romëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë. Në muajin qershor të vitit 2011, EULEX-i ka themeluar Grupin Special Operativ Hulimtues, me seli në Bruksel, i cili ka për detyrë të zbatojë hetimet mbi zhdukjet në Kosovë, bartjen e personave të rrëmbyer në Shqipëri dhe nxjerrjen e organeve njerëzore. Kjo është një shans që për fatin e serbëve, romëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë të zhdukur të flitet në kontekstin e përgjegjësisë penale, por edhe të nevojës humanitare dhe njerëzore për hulumtimin e solidaritetit dhe të bashkëndjesisë me të gjitha viktimat. Me ndryshimin e Ligjit Penal në Mal të Zi, të miratuar në vitin 2003, përgjegjësia komanduese është paraparë si vepër e veçantë penale. Deri në fund të vitit 2011 nuk ka pasur të akuzuar sipas përgjegjësisë komanduese.

Karakteristike për katër procedura penale për krime të luftës është se të akuzuarit janë kryerës të drejtpërdrejtë të veprave penale. Prokuroria iu ka propozuar të akuzuarve, kurse gjykata e ka caktuar paraburgimin, vetëm pas ngritjes së aktakuzës, gjë që ka sjellë deri te ajo që pothuajse gjysma e të akuzuarve për deportime, si edhe rasti i të akuzuarit të parë *Kalugjerski Laz* dhe njëri prej të akuzuarve në rastin *Morina*, janë gjykuar në mungesë.

Gjykata e Lartë në Podgoricë ka sjellë në datën 29 mars të vitit 2011 aktgjykimin me të cilin lirohen të gjithë,

1 „Vërejtje ndaj raporteve të Fondit për të Drejtën Humanitare”, Prokuroria për Krime të Luftës e Republikës së Serbisë, 14.11.2011. http://www.tuzilastvorz.org/html_trz/VESTI_SAOPSTENJA_2011/S_2011_11_14_LAT.pdf.

dhjetë të akuzuarit në lëndën *Deportimi i refugjatëve*, me arsyetimin se “të akuzuarit, me veprimet e tyre të paligjshme, të cilat janë vërtetuar se i kanë kryer, nuk kanë kryer krime të luftës sepse nuk iu kanë takuar formacioneve të armatosura, nuk kanë qenë në shërbim të ndonjëres prej palëve në konflikt.” Në lëndën *Bukovica*, aktgjykimi është shfuqizuar në muajin qershor të vitit 2011 dhe lënda është kthyer në gjykim të përsëritur. Aktgjykimi tjetër, me të cilin lirohen të akuzuarit, në këtë lëndë është sjellë në fillim të muajit tetor të vitit 2011. Të dyja aktgjykimet kanë shkaktuar kritikë të ashpër të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut.

Në Maqedoni nuk ka gjykime për krime të luftës. Ligji mbi Amnistinë është miratuar në vitin 2002, me çka është mundësuar amnistia e të gjithë pjesëtarëve shqiptarë të formacioneve të armatosura për të cilët ka pasur dyshime se kanë kryer krime të luftës, me përfundim në datën 6 shtator të vitit 2001. Sipas këtij Ligji, amnistia nuk ka pasur të bëjë me të akuzuarit kundër të cilëve është ngritur procedurë para GJPNJ. Me nismën e partive politike shqiptare (Partia Demokratike e Shqiptarëve – PDSH, Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI), në datën 19 korrik të vitit 2011 është iniciuar procedura e votimit në Parlamentin e Maqedonisë për mbështetjen e shumicës për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë. Të njëjtën ditë, nisma është miratuar me 63 vota për kurse 29 kundër, me çka është hequr dorë nga drejtësia penale për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni.²

Interpretimi autentik i Ligjit mbi Amnistinë ka mundësuar që amnistia të zbatohet edhe në personat e dyshuar në lëndët të cilat GJPNJ ia ka kthyer Maqedonisë për procedurë.

Krimet ndaj shqiptarëve ende nuk janë procesuar. Lënda *Humnera* ndodhet me vite në Prokurorinë Themelore Publike dhe sipas Ligjit mbi Amnistinë do të mbyllet. Në zonën e Humnerës, midis Këçevës dhe Dibrës, është gjetur varreza me mbetje mortore të personave të cilët janë zhdukur gjatë konfliktit të vitit 2001: Radoslav Ginov, shtetas bullgar, dhe tre shqiptarë nga Maqedonia - Islam Veliu, Hajredin Halimi dhe Ibrahim Veliu. Prokuroria nuk ka ngritur aktakuzë. Të dyshuarit për vrasje të këtyre viktimave janë pjesëtarë të paemëruar të organeve të rregullta të sigurimit.

6 |

Në Slloveni nuk ekzistojnë gjykatat dhe prokuroria të cilat në mënyrë të veçantë janë kompetente për krimet e luftës, kurse nuk ekziston as edhe shërbimi i veçantë për mbështetje të dëshmitarëve.

Në rrjedhë e sipër janë dhjetë procedura për krime të luftës kundër popullatës civile dhe shkeljes së Konventave të Gjenevës. Procedurat zgjasin pothuajse 20 vite, në mungesë të të akuzuarve. Rasti më i njohur është procedura penale para gjykatës në Murska Sobota, kundër oficerit të ish APJ-së, kolonelit Berislav Popovit dhe gjeneralit Vllada Trifunoviq, shtetas të Republikës së Serbisë. Të dyja aktakuzat në muajin prill të vitit 2008 janë bashkuar dhe shkruirë në një. Prokuroria në Murska Sobota i ka akuzuar Trifunoviqin dhe Popovin sipas bazës së përgjegjësisë komanduese për krime të luftës ndaj civilëve me rastin e intervenimit të APJ-së në Slloveni në vitin 1991.³

Në procedurë e sipër janë 15 hetime kundër pjesëtarëve të APJ-së, të cilat kanë filluar menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Slloveni.

Gjykatat në Slloveni i kanë sjellë pesë aktgjykime, me të cilat të akuzuarit lirohen nga akuzat. Aktgjykimi i fundit është sjellë në vitin 1999. Katër aktgjykimet, me të cilat lirohen të akuzuarit nga përgjegjësia penale, i janë shqiptuar pjesëtarëve të ish APJ-së, të kombësisë jo-sllovene, dhe një oficeri të APJ-së, të kombësisë sllovene, “për shkak të shërbimit në ushtrinë e huaj”.

Aktakuzat në fuqi dhe lëndët hetimore kërkojnë rishqyrtim serioz profesional, sepse i takojnë kohës e cila e ka karakterizuar edhe qasjen politike ndaj pjesëtarëve të ish APJ-së, dhe jo vetëm atë juridike. Midis të tjerash, këtë

2 Konflikti i armatosur në Maqedoni ka zgjatur nga muaji janar deri në muajin nëntor të vitit 2001.

3 “Gjenerali Trifunoviq: Nuk do të shkoj në gjykim”, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, 14 korrik i vitit 2010. http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_zaradni_zlocin_usloveniji/2099828.html.

e dëshmon edhe shembulli i aktgjykimit me të cilin lirohet nga përgjegjësia penale vozitësi i APJ-së, i cili ka qenë i akuzuar se e ka rrezikuar sigurinë sepse nën ndikimin e alkoolit „ka vozitur me shpejtësi të madhe në drejtim të fëmijëve“.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal në procesimin e krimeve të luftës, deri në fund të vitit 2011 janë nënshkruar disa marrëveshje bilaterale midis prokurorive të BdheH, Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Këto marrëveshje në mënyrë të rëndësishme i kanë kontribuar këmbimit të informacioneve dhe dëgjimit të dëshmitarëve jashtë kufijve të shtetit, sepse iu mundësojnë prokurorive që t'i dërgojnë kërkesat e tyre dhe që t'i pranojnë ato, pa shfrytëzimin e kanaleve diplomatike.

Marrëveshja mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës, të cilën Kroacia dhe Serbia e kanë nënshkruar në vitin 2006, është treguar si një instrument i mirë në shmangien e problemeve në procesimin e krimeve të luftës, të grumbulluara gjatë viteve të pasluftës, në të cilat në Kroaci kryesisht janë gjykuar kryerësit e kombësisë serbe, derisa në Serbi nuk ka pasur gjykime për krimet e luftës.

BdheH dhe Kroacia, në muajin shkurt të vitit 2010, kanë nënshkruar Marrëveshjen e ndryshuar mbi përmbartimin reciprok të vendimeve gjyqësore në çështjet penale, të cilët parandalojnë ikjen e personave të gjykuar nga njëri shtet në tjetrin. Rezultat i kësaj Marrëveshjeje është se i dënuari i arratisur Branimir Gllavash sot e vuan dënimin në burgun e Zenicës.

Është pozitive se organet e gjyqësorit të Serbisë dhe të Kroacisë kanë vazhduar t'i këmbëjnë provat dhe lëndët gjyqësore përkundër kushteve të përkeqësuar, të shkaktuara nga burgosja e shtetasit kroat Tihomir Purd në BdheH sipas fletarrestimit të Republikës së Serbisë, me refuzimin e PKL të Republikës së Serbisë që gjyqësorit kroat t'ia dorëzojë aktakuzën dhe provat kundër shtetasit kroat Veljko Mariq, me shpalljen e aktakuzës së Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së kundër Vlladimir Sheksit dhe edhe 33 shtetasve të Kroacisë si dhe me sjelljen e Ligjit mbi Pavlefshmerinë, të cilin Parlamenti kroat e ka miratuar në datën 21 nëntor të vitit 2011.

Nënshkrimi i Protokolleve midis BdheH dhe Serbisë mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të krimeve të luftës, me të cilët, midis të tjerash, është arritur marrëveshja e investimit të përpjekjeve të përbashkëta në parandalimin e hetimeve paralele, e caktuar për datën 30 nëntor të vitit 2011 në Bruksel, është anuluar para vet nënshkrimit. Misioni i OSBE-së konsideron se „zhvillimi i procedurave nga ana e pushtetit serb në lëndët me krime të luftës, të cilat kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur në BdheH, edhe pse legjitime sipas të drejtës ndërkombëtare, ka qenë arsye e rritjes së tensioneve midis BdheH dhe Serbisë“. Përmirësimi i marrëdhënieve midis prokurorive të BdheH dhe Serbisë varet nga tërheqja e PKL të Republikës së Serbisë prej keqpërdorimit të institucionit të juridiksionit universal.

Në muajin tetor të vitit 2010, Serbia dhe Mali i Zi kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi Ekstradimin, e cila parasheh ekstradimin për veprat penale kundër njerëzimit dhe të mirave të tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë edhe krimet e luftës, që deri në fund të vitit 2011 nuk është zbatuar në raport me të akuzuarin e parë në lëndën *Kalugjerski Laz*, Predrag Strugarin.

Edhe pse ekziston një nevojë e madhe për bashkëpunim të fuqishëm me institucionet kosovare, për shkak të vrasjes së 13.500 njerëzve gjatë konflikteve të armatosura në vitin 1998 dhe 1999 dhe menjëherë pas përfundimit të luftës, gjyqësori i Republikës së Serbisë bashkëpunon ekskluzivisht me Njësinë e EULEX-it për hetimin e krimeve të luftës.

Reformat institucionale

Në shumicën e shteteve post-jugosllave ekzistojnë dispozita ligjore të cilat e pengojnë personin e dënuar për çfarëdo vepre penale me dënime me burg mbi minimumin e caktuar për të kryer detyrën e deputetit, ku janë të përfshirë edhe personat të cilët janë të dënuar për krime të luftës.

Në BdheH, në periudhën e viteve 2002-2004 janë kryer reformat e policisë (certifikimi) dhe të gjyqësorit (riemërimi), e, megjithëkëtë, proceset e verifikimit (vetting) nuk kanë qenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, sepse personat, të cilët kanë qenë të përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës ose në shkelje e tjera të të drejtave të njeriut edhe më tutje kryejnë funksione në organet shtetërore. Korniza ekzistuese në fuqi e ndalon emërimin si dhe të drejtat aktive dhe pasive zgjedhore personave, kundër të cilëve ekziston aktakuza e konfirmuar në lëndët e krimeve të luftës si dhe personave të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit. Megjithëkëtë, me ligj nuk janë përfshirë personat të cilat e kanë vuajtur dënimin me burg për krimet e kryera të luftës. Në Kosovë, korniza normative nuk e precizon nëse personi i cili është në vuajtje të dënimit me burg për krime të luftës ose këtë dënim e ka vuajtur mund të jetë kandidat në zgjedhje, derisa të dyshuarit për krime të luftës mund të kandidohen në zgjedhje. Në praktikë, ka raste kur marrin funksione të shquara publike.

Në Serbi, edhe më tutje nuk zbatohet Ligji mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut (Ligji mbi lustracionin) i vitit 2003, por është paraqitur projekt-ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut, afati i vlefshmërisë së të cilit do të vazhdohej për 20 vite. Ky projekt-ligj edhe më tutje është në procedurë të Kuvendit. Në Mal të Zi dhe në Kroaci edhe më tutje nuk ka kërkesë për lustracionin.

Sllovenia e ka zbatuar reformën e institucioneve qysh në mesin e viteve nëntëdhjetë, kur një nga kriteret për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, përkatësisht për mbajtjen në shërbimin e pjesëtarëve të policisë ka qenë edhe mospërfshirja e personave në shkeljen e të drejtave të njeriut, përkatësisht në krime të luftës. Në mënyrë plotësuese është pamundësuar rizgjedhja e gjykatësve, të cilët kanë sjellë aktgjykime, me të cilat janë shkelur të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit 2011, me Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi përcaktimin e kushteve plotësuese për ushtrimin e funksionit publik, Komisioni për verifikimin e fakteve në Maqedoni e ka zgjeruar kontrollimin mbi bashkëpunimin me shërbimet e fshehta edhe te priftërinjtë, gazetarët, aktivistët e organizatave joqeveritare, avokatët dhe shkencëtarët. Nga fundi i këtij viti është filluar procedura para Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitave mbi zgjerimin e hetimeve. Profesori universitar dhe aktivisti, që një kohë të gjatë ka punuar për të drejtat e njeriut në Maqedoni, Vladimir Milçin është shpallur bashkëpunëtor i shërbimit të fshehtë komunist, gjë që ka shkaktuar pyetjen lidhur me pavarësinë e punës së këtij Komisioni në lidhje me trysnitë politike.

Në vendet e rajonit edhe më tutje është e pranishme përkrahja e fuqishme politike dhe publike për të akuzuarit për krime të luftës, lavdërimi i rolit të tyre gjatë konflikteve të armatosura dhe theksimi i vuajtjeve të viktimave të popullit vetjak. Qëndrimi i këtillë ka dominuar në Kroaci pas shqiptimit të aktgjykimit jo të plotfuqishëm gjeneralëve kroat në muajin prill të vitit 2011, derisa përfaqësuesit politik të Serbëve dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës edhe më tutje i kanë theksuar vuajtjet e popullit të vet, duke ngulur këmbë në balancën midis viktimave, posaçërisht në lidhje me gjenocidin në Srebrenicë. Deputetët serb më së shumti kanë pasur vërejtje ndaj punës së institucioneve të BdheH, të cilat merren me krimet e luftës, duke ua përshkruar anshmërinë dhe kriteret e ndryshme në varësi nga përkatësia etnike. Kuvendi i Serbisë, në vitin 2010 e ka miratuar Deklaratën mbi dënimin e krimeve në Srebrenicë, me çka është bërë një hapë i rëndësishëm në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, por teksti i deklaratës dhe miratimi i saj kanë hasur në kritika, posaçërisht në BdheH. Përfaqësuesit e shoqatave të viktimave të Srebrenicës e kanë kritikuar deklaratën, sepse është shmangur shprehja e qartë e fjalës „gjenocid“, derisa përfaqësuesit e organizatave të luftëtarëve nga Republika Srpska miratimin e Deklaratës e kanë interpretuar si imponim të fajit kolektiv ndaj popullit serb.

Temat në lidhje me krimet e luftës shumë rrallë janë përfaqësuar në media, derisa në shumicën e vendeve post-jugosllave ende është i pranishëm „patriotizmi gazetaresk“, përkatësisht mbizotërimi i ideologjisë nacionaliste. Në Serbi është shtruar çështja e përgjegjësisë penale të gazetarëve për shkak të nxitjes së krimeve të luftës gjatë konflikteve të armatosura në vitet nëntëdhjetë, kurse kërkesë të ngjashme kanë bërë edhe organizatat për të drejtat e njeriut në Mal të Zi. Tablonë e mediave në vitin 2011 në Kroaci e ka karakterizuar reagimi i mediave ndaj aktgjykimit jo të plotfuqishëm ndaj gjeneralëve, në të cilin ka mbizotëruar qëndrimi mbi padrejtësinë dhe „dënimet drakonike“, pa aspak hapësirë të dhënë për viktimat.

Vërtetimi i fakteve dhe tregimi i së vërtetës

Gjatë viteve 2010-2011, në rajon nuk është paraqitur asnjë nismë zyrtare e rëndësishme për formimin e komisionit shtetëror (kombëtar) të së vërtetës.

Në BdheH në këtë periudhë, Grupi i ekspertëve për përpilimin e strategjisë së drejtësisë tranzicionale në BdheH e ka zhvilluar procesin konsultativ, ku është debatuar mbi modelin dhe propozimet për krijimin e një trupi jashtëgjyqësor për vërtetimin e fakteve dhe tregimin e së vërtetës në nivelin nacional. Përkundër aktgjykimeve gjyqësore të shumta, një pjesë e qytetarëve të BdheH edhe më tutje konsideron se faktet relevante mbi konfliktin e armatosur ende nuk janë vërtetuar. Pas Marrëveshje së Paqes të Dejtonit, në BdheH është realizuar një numër i madh i nismave në fushën e vërtetimit të fakteve dhe të tregimit të së vërtetës, kryesisht brenda shoqërisë civile, por këto nisma kryesisht kanë qenë ndërmjet vete të pa bashkërenditura dhe të fokusuar para së gjithash në qendrat urbane.

Pas procesit shumëvjeçar intensiv konsultativ në kuadër të procesit KOMRA, në muajin mars të vitit 2011, është miratuar Propozim Statuti i KOMRA-s, që së bashku me më shumë se gjysmë milioni nënshkrime të qytetarëve të mbledhura anë e kënd rajonit i është dhënë kryetarëve të shteteve të krijuara në territorin e ish-Jugosllavisë. Gjatë vitit 2011, procesi KOMRA ka hyrë në fazën e institucionalizimit, përkatësisht të bartjes nga niveli civil në nivelin politik.

Qendra shtetërore kroate memoriale-dokumentuese e luftës Atdhetare ka vazhduar me mbledhjen e fakteve mbi ngjarjet nga konfliktet e armatosura në Kroaci, duke e zgjeruar veprimtarinë e saj edhe në konfliktin e armatosur në BdheH. Në Kosovë, në vitin 2011, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është themeluar Instituti shtetëror për Hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë me qëllim të koordinimit, të përcjelljes dhe hulumtimit të krimeve të luftës. Në Serbi, në Kroaci dhe në Kosovë, organizatat për të drejtat e njeriut, që punojnë në dokumentimin e krimeve të luftës (Fondi për të Drejtën Humanitare, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe Documenta) kanë vazhduar të punojnë në vërtetimin e regjistrimit gjithëpërfshirës të humbjeve njerëzore në konfliktet e armatosura të viteve nëntëdhjetë. Në Slloveni, me hulumtimin dhe vërtetimin e fakteve mbi “personat e fshirë” është marrë Instituti për Paqe në Lubjanë.

Koordinimi rajonal i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur në hapësirën e ish-Jugosllavisë ka filluar në vitin 2011 nën patronatin e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), me qëllim të ndërlidhjes së shoqatave dhe të fuqizimit të trysnisë në qeveritë e rajonit e me qëllim të zgjidhjes më efikase të fatit të personave të zhdukur në konfliktet e armatosura. Deri në fund të vitit 2011, sipas të dhënave të KNPZH-së, fati i rreth 13.500 njerëzve, të cilët janë zhdukur gjatë konflikteve të armatosura nga viti 1991 deri në vitin 2001 në hapësirën e ish-Jugosllavisë ende nuk është zgjidhur. Aktivitetet në gjetjen dhe në identifikimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur i kanë kryer komisionet shtetërore për personat e zhdukur në Kroaci, Serbi dhe Mal të Zi, përkatësisht Instituti për personat e zhdukur në BdheH. Në Kosovë, me zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur merren Komisioni qeveritar për Personat e Zhdukur, Zyra për Mjekësi Ligjore brenda Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës dhe Departamenti për mjekësinë forenzike i EULEX-it.

Në përmbajtjen e numrit më të madh të teksteve shkollore, të shfrytëzuara në vitin shkollor 2010-2011 në shkollat fillore dhe të mesme në BdheH, Kroaci, Serbi, Kosovë, Mal të Zi dhe Slloveni hetohet anshmëria etnike. Përgjegjësia dhe faji për krimet e luftës ose shpërbërjen e Jugosllavisë kryesisht i përshkruhen palës tjetër, derisa heshtet roli i palës vetanake në krime. Asnjë tekst shkollor, i cili shfrytëzohet në shkollat fillore dhe në të mesmen Maqedoni nuk ka përmbajtje të përfaqësuar të cilat flasin mbi konfliktin e vitit 2001.

Reparacionet

Ligjet që rregullojnë statusin dhe të drejtat e viktimave civile të luftës, në shumicën e shteteve post-jugosllave kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me periudhën e mëparshme, dhe ende janë evidente mangësi të shum-

ta në fushën e drejtësisë tranzicionale. Në shumicën e shteteve, të drejtën për reparacione administrative ende e kanë vetëm civilët dhe ushtarët që kanë pësuar lëndim trupor, kurse pasojat e keqtrajtimit duhet t' i dëshmojnë me prova për t' i fituar këto të drejta. Viktimat që nuk i plotësojnë këto kërkesa, ose që nuk kanë dëmtime fizike si pasojë e keqtrajtimit gjatë konflikteve të armatosura, në shumicën e shteteve post-jugosllave nuk kanë statusin e viktimave civile të luftës. Përjashtim është BeH, ku ligji parashikon që viktimat e dhunimit dhe të keqtrajtimit seksual kanë të drejtë për kompensim, pa kushtin e dëshmimit me prova të dëmtimit trupor.

Në periudhën e kaluar, personat të cilët kanë qenë të burgosur në kampe, gjithashtu në shumicën e shteteve është dashur të provojnë lëndimin trupor, dhe me përjashtim të Kroacisë, vetë qëndrimi në kamp nuk ka qenë i mjaftueshëm për të fituar të drejtën për kompensim. Sa i përket personave që kanë qenë të ndaluar në kampe, mund të pritët përparim në Kosovë, ku nga fundi i vitit 2011 është miratuar Ligji që rregullon statusin, të drejtat dhe përfitimet e viktimave civile dhe ushtarake të luftës. Me këtë ligj është parashikuar që për njohjen e statusit të të burgosurit civil dhe luftarak mjafton qëndrimi në kamp.

Kosova ka bërë përparim përkitazi me masat e reparacionit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë konflikteve të armatosura, por në lidhje me to. Atje në vitin 2010 është nxjerrë Ligji i cili rregullon statusin ligjor, të drejtat dhe përfitimet e kësaj kategorie, numerikisht të madhe, të viktimave.

Në të gjitha shtetet post-jugosllave edhe më tej janë në fuqi dispozitat diskriminuese të cilat rregullojnë statusin, të drejtat dhe përfitimet e viktimave të luftës, porse të cilat janë të pavolitshme për civilët në krahasim me luftëtarët përkitazi me kushtet për njohjen e statusit të invalidit të luftës, me lartësinë e kompensimeve dhe me vëllimin e përfitimeve.

Pavarësisht nga numri i madh i kërkesë padive për kompensimin e dëmit që janë ngritur në gjykatat e të gjithë rajonit, edhe më tej, një numër fare i vogël i viktimave arrin që në rrugë gjyqësore të realizojë kompensimin e dëmit, i cili u është shkaktuar gjatë konflikteve të armatosura. Në këtë ndikon, si kohëzgjatja e madhe e procedurës, interpretimi i dispozitave ligjore që rregullojnë parashkrimin e kërkesave të tyre në dëm të viktimave, aplikimi i një standardi jashtëzakonisht të lartë të dëshmimit, trajtimi joadekuat i viktimave dhe shpallja e gjykatave jokompetente. Prandaj, viktimat gjithnjë e më shumë kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre para institucioneve ndërkombëtare. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vitin 2010, ka nxjerrë një aktgjykim të shkallës së parë lidhur me rastin e dhjetë qytetarëve "të fshirë" të Sllovenisë, ku është konstatuar se Sllovenia në këtë rast ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mundur kështu krijimin e hapësirës për të rregulluar në të ardhmen statusin e këtyre personave në Slloveni.

Ashtu si në periudhën e mëparshme, në pothuajse të gjitha vendet post-jugosllave po ngrihen memoriale ekskluzivisht për të përkujtuar viktimat-pjesëtarë të kombit shumicë. Vetëm në Mal të Zi është ngritur një monument përkujtimor kushtuar të gjithë viktimave civile që kanë pësuar në konfliktet e armatosura gjatë viteve 1991-2001. Një numër i vogël i këtyre monumenteve të ngritura në rajon është rezultat i iniciativave private ose i përpjekjeve nga ana e vetë familjeve të viktimave, pa ndonjë pjesëmarrje të qeverisë dhe shpesh herë edhe pa leje të domosdoshme. Në disa raste, autoritetet kanë ndaluar apo larguar përmendoret e këtilla.

II. Gjykimet për krimet luftës para gjykatave vendore

1. Rezume

Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar.

Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në **Bosnjë dhe Hercegovinë** seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve dhe të të dënuarve para ligjit. Në procedurat për krimet e luftës, në nivel të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos, zbatohet Ligji Penal i RSFJ-së, kurse Ligji Penal i B dhe H zbatohet në Gjykatën e B dhe H. Për shkak të kundërshtimit të Republika Srpska, e cila i referohet Marrëveshjes së Dejtonit, nuk ka Gjykatë Supreme në B dhe H, arsye kjo për të cilën procedura ankimore është në kompetenca të Gjykatës së B dhe H, e cila gjykimet i kryen në procedurën e shkallës së parë.

Bartja e kompetencave për gjykim për krimet e luftës në gjykata më të ulëta shkon ngadalë. Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011, në tërësi janë bartur 83 lëndë në gjykata me kompetenca vendore. Prej tyre, në tërësi 52 lëndë janë caktuar në gjykata në FB dhe H, 27 në gjykata në RS, dhe një lëndë në Gjykatën Themelore në distriktin e Brçkos në B dhe H. Obligimet e reja të gjykatave kantonale dhe të qarkut e kërkojnë mbështetjen përkatëse teknike, profesionale dhe financiare, në mënyrë që gjykimet të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe pa shkelje të së drejtës në gjykimin fer dhe të drejtë.

Instituti i pranimit të fajit, me pjesëmarrjen e shoqatave të viktimave në sjelljen e vendimeve mbi përmbartimin në rastin konkret, dëshkohet si një instrument përkatës i drejtësisë penale në raport me rrjedhën e madhe të kohës nga kryerja e krimeve të luftës, vjetërsia e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe me nevojën e viktimave për të përjetuar pendimin publik dhe kërkimfaljen e kryerësve.

Gjykimet janë më intensivet në Gjykatën e B dhe H, i cili që nga themelimi e deri në fund të vitit 2011 me vendime të plotfuqishme ka dënuar 88 persona dhe ka përfunduar gjithsejtë 78 raste për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të zakoneve ndërkombëtare të luftës.

Mbyllja e negociatave mbi kapitullin 23, mbi drejtësinë dhe të drejtat themelore ka sjellë, me anë të sinergjisë së kritikës së institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave të të drejtave të njeriut si dhe rekomandimit të Komisionit Evropian, deri te përmirësimi i kuadrit juridik në të cilin kryhet procesimi i krimeve të luftës në Republikën e **Kroacisë**. Me ndryshimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë është futur kompetenca ekskluzive e gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb, si dhe mundësia e shfrytëzimit të provave të mbledhura nga GJNPJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë.

14

Në vitin 2011 është bërë progres në procesimin e krimeve të luftës. Trysnia e Amnesty International dhe e organizatave vendore për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2011 ka kontribuar që Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) të ngrit aktakuzë kundër Tomislav Merçepit, këshilltarit të luftës në MPB-në e Republikës së Kroacisë, dhe Vlladimir Milankoviqit, komandantit të njësisë aktive dhe rezervë në formacion të DP në Sisak gjatë vitit 1991 dhe 1992. Megjithatë, pos këtyre disa shembujve edhe më tutje nuk ka hetime kundër eprorëve politik dhe ushtarak në rastin e veprave penale kundër pjesëtarëve të grupit të pakicave kombëtare. Me gjithë ekzistimin e informatave dhe provave publikisht të qasshme, të shfrytëzuara në procedurat penale të përfunduara, ende nuk ka filluar procedura kundër Vlladimir Sheksit, në kohën e luftës kryetar i Shtabit të Krizës për Sllavinë Lindore, i cili, siç pohohet, është i përfshirë në krimet e kryera në Osijek në vitin 1991.

Në rastet e viktimave të dhunimit/dhunës seksuale, gjykata, as edhe në një rast, nuk i kanë zbatuar masat e mbrojtjes së identitetit të viktimës – të dëshmuarit përmes hapësirës tjetër me anë të video linkut, ndryshimit të personit dhe të zërit, përdorimin e pseudonimit etj. Viktimat, vetëm në disa lëndë gjatë të dëshmuarit në seancat kryesore gjyqësore, janë përjashtuar nga publiku.

Arsyetimet, të cilat i përcjellin dënimet e ulëta me burgosje, dhe aktgjykimet me të cilat të akuzuarit lirohen nga akuzat, e zbulojnë anshmërinë e gjyqtarëve ndaj pjesëtarëve të policisë dhe të ushtrisë së Kroacisë. Gjyqtarja e Gjykatës së Qarkut në Sisak, Snjezhana Mrkoc, me rastin e arsyetimit të aktgjykimit me të cilin të akuzuarit lirohen nga akuzat lidhur me katër pjesëtarë të UK, në muajin nëntor të vitit 2010, ka thënë: „Më vjen jashtëzakonisht shumë keq që duhet t'i dënoj pjesëtarët e ushtrisë së Kroacisë për vepra penale, të cilat jemi mësuar t'i bëjë ana e kundërt, posaçërisht tash kur i ndezim qirinjtë për Vukovarin.“

Shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë të Hagës për gjeneralët Ante Gotovina dhe Mlladen Markaç e kanë përcjellë komente paushalleske politike, ngritja e të gjykuarve në piedestalin e heronjve kombëtar, organizimi i protestave të përkrahjes anë e kënd Kroacisë, injorimi i gjetjeve faktike dhe i vuajtjeve e padrejtësisë, të cilat janë bërë ndaj viktimave.

Legjislacioni i Republikës së **Serbisë** nuk është në harmoni me standardet të cilat i ka vendosur GJNPJ në pikë-pamje të përgjegjesisë komanduese. Në legjislacionin penal të Serbisë nuk ka institucion të përgjegjesisë komanduese. Nuk ka as vullnet politik që të gjykohe gjeneralët. Edhe pse GJNPJ me aktgjykimin e saj të shkallës së parë e ka gjykuar pothuajse gjithë kreun e dikurshëm shtetëror të Republikës së Serbisë, kjo nuk ka sjellë deri tek fillimi i procedurave penale kundër oficerëve të lartë të ushtrisë dhe të MPB-së, në zonat e përgjegjesisë së të cilëve ka pasur krime masive të luftës.

Hetimet, të cilat i përgatit dhe i fillon Prokuroria për Krimet e Luftës e Republikës së Serbisë (PKL) zgjasin shumë dhe në një numër relevant të rasteve nuk rezultojnë me aktakuzë. Në lidhje me krimet masive, të kryera në BNK të Dubravës në Kosovë, PKL ka filluar të veprojë në vitin 2008, por deri në fund të vitit 2011 nuk i ka hapur hetimet. Në lidhje me akuzat penale të FDH-së kundër komandantit të togut të Dhjetë Diversant të Ushtrisë së Republika Srpska, Millorad Pelemishit, të muajit gusht të vitit 2010, PKL publikisht ka njoftuar për fillimin e procedurës penale, por kjo nuk ka ndodhur deri në fund të vitit 2011.

PKL gjatë vitit 2011 i ka gjykuar gjithsejtë nëntë persona. Prej tyre, vetëm njëra aktakuzë, (kundër tre të akuzuarve) përbënë një procedurë të re, kurse aktakuzat kundër gjashtë të tjerëve kanë dalë nga dy procedura të mëhershme të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd.

Në lëndët e krimeve të luftës, të kryera në Kosovë, PKL shpesh ngrit aktakuza në bazë të hetimeve pjesërisht të zhvilluara, siç është lënda e Suharekës dhe e Qyshkut.

Është praktikë e PKL që të ndryshojë aktakuzat para sjelljes së aktgjykimit, duke e zvogëluar përgjegjësinë e të akuzuarve në pozita komanduese, siç është rasti në lëndën *Zvornik II* [i akuzuari Popović dhe Grujić]. Edhe në vitin 2011, lëndë të bartura ka pasur më shumë se procedura të reja, si para Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, ashtu edhe para Gjykatës së Apelit në Beograd.

Si edhe në vitin 2010, Gjykata e Apelit në Beograd, edhe në vitin 2011 ka vazhduar të konfirmojë dënimet e ulëta me burgosje të gjykatës së shkallës së parë. Shembulli më negativ është lënda *Zvornik II*, në të cilën i akuzuari Branko Popović është dënuar me 15 vite burgosje, kurse i akuzuari Branko Grujić me dënim me burgosje në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh. Duke pasur parasysh se ata të dy, në kohën e kryerjes së krimeve, si bartës të pushtetit civil dhe ushtarakë në komunën e Zvornikut, sipas natyrës së funksioneve të tyre kanë qenë më të përgjegjshmit, se kanë qenë pjesëmarrës aktiv në realizimin ose, madje, organizator të planit mbi dëbimin e popullatës civile nga territori i komunës së Zvornikut, lartësia e dënimit, e cila iu është shqiptuar, është skajshmërisht joproporcionale.

Mbrojtja e dëshmitarëve insajderë shkakton brengosje të madhe, posaçërisht kur kihet parasysh raporti mbi veprime të paligjshme në procesimin e krimeve të luftës, të cilin FDH ua ka dërguar institucioneve shtetërore në nëntor të vitit 2010 si dhe reagimet e PKL lidhur me pjesë të caktuara nga ai raport.⁴ FDH vë në pah se Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve funksionon si grup për trysni, i cili e ka për detyrë të parandalojë pjesëtarët e ushtrisë dhe të policisë për të dëshmuar mbi krimet e luftës. Posaçërisht brengosin pjesët e pohimeve të dëshmitarëve insajderë se PKL i ka dekurajuar që të dëshmojnë kundër gjeneralit të akuzuar të policisë, si dhe pohimet e PKL se dëshmitarët insajderë fabrikojnë gënjeshtër mbi atë institucion.

4 „Vërejtje ndaj raporteve të Fondit për të Drejtën Humanitare”, Prokuroria për Krime të Luftës e Republikës së Serbisë, 14.11.2011. http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/VESTI_SAOPSTENJA_2011/S_2011_11_14_LAT.pdf.

Ligji Penal i **Kosovës** i përgjigjet më shumë kërkesave të së drejtës ndërkombëtare se sa Ligji Penal i RSFJ-së. Ligji Penal i Kosovës përfshin dhunimet dhe përgjegjësinë komanduese të komandantit ushtarak ose të personit, i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak dhe i cili mundet, në rrethana të caktuara, për të qenë përgjegjës për veprimet e të gjithëve nën kontrollin e tij efektiv, ndryshe nga Ligji Penal i RSFJ-së, i cili e njeh vetëm përgjegjësinë penale për urdhërim dhe kryerje të krimeve të luftës.

Në gjykatat në Kosovë për trajtim presin më shumë se 200.000 lëndë të mbetura. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në muajin nëntor të vitit 2010, e ka miratuar Strategjinë Kombëtare për uljen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, por zbatimi i kësaj strategjie ende nuk ka dhënë rezultate të dukshme. Problemet, siç janë trysnitë politike, mungesa dhe joprofesionalizmi i prokurorëve dhe i gjykatësve vendor, edhe më tutje janë aktuale.

Në vitin 2010, EULEX-i, i cili është përgjegjës për gjykimet për krime të luftës, ka qenë i angazhuar më shumë në lëndët e krimin të organizuar, të korrupsionit, të keqpërdorimit të pozitës zyrtare si dhe në procedurat sipas ndihmës së jashtëzakonshme juridike, kurse më pak në gjykimet për krime të luftës. Në vitin 2011, ka pasur më shumë hetime të përfunduara, të cilat kanë rezultuar me konfirmimin e aktakuzave, me aktgjykime të shkallës së parë dhe të plotfuqishme. Është e rëndësishme që prokurorët vendor kanë qenë të angazhuar në dy lëndë të krimeve të luftës. Në lëndën *Prokurori kundër Slobodan Martinoviçit dhe të tjerëve*, prokurori vendor e ka marrë lëndën në fazën e seancës gjyqësore kryesore, kurse në lëndën *Prokurori kundër Zoran Koliçit*, prokurori vendor i ka udhëhequr hetimet.

Mbrojtja e dëshmitarëve është problemi më i madh në procesimin e krimeve të luftës në Kosovë. Në muajin korrik të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili parasheh themelimin e Komisionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili vendos për fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e programit të mbrojtjes. Shqetësim të madh shkakton dispozita, e cila parasheh “regjim special për dëshmitarët e mbrojtur në burgje dhe në shtëpi ndëshkuese korrektuese”.

EULEX-i, kurse para tij UNMIK-u, proceson dhe hulumton rrëmbimet e shqiptarëve në Kosovë nga ana e UÇK-së, për shkak të dyshimit se kanë bashkëpunuar me pushtetin serb, por ende nuk merret me trajtimin e rrëmbimit të serbëve, romëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë. Në muajin qershor të vitit 2011, EULEX-i ka themeluar Grupin Special Operativ Hulumtues, me seli në Bruksel, i cili ka për detyrë të zbatojë hetimet mbi zhdukjet në Kosovë, bartjen e personave të rrëmbyer në Shqipëri dhe nxjerrjen e organeve njerëzore. Kjo është një shans që për fatin e serbëve, romëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë të zhdukur të flitet në kontekstin e përgjegjësisë penale, por edhe të nevojës humanitare dhe njerëzore për hulumtimin e solidaritetit dhe të bashkëndjesisë me të gjitha viktimat.

Me ndryshimin e Ligjit Penal në **Mal të Zi**, të miratuar në vitin 2003, përgjegjësia komanduese është paraparë si vepër e veçantë penale. Deri në fund të vitit 2011 nuk ka pasur të akuzuar sipas përgjegjësisë komanduese.

Karakteristike për katër procedura penale për krime të luftës është se të akuzuarit janë kryerës të drejtpërdrejtë të veprave penale. Prokuroria iu ka propozuar të akuzuarve, kurse gjykata e ka caktuar paraburgimin, vetëm pas ngritjes së aktakuzës, gjë që ka sjellë deri te ajo që pothuajse gjysma e të akuzuarve për deportime, si edhe rasti i të akuzuarit të parë *Kalugjerski Laz* dhe njëri prej të akuzuarve në rastin *Morina*, janë gjykuar në mungesë.

Gjykata e Lartë në Podgoricë ka sjellë në datën 29 mars të vitit 2011 aktgjykimin me të cilin lirohen të gjithë, dhjetë të akuzuarit në lëndën *Deportimi i refugjatëve*, me arsyetimin se “të akuzuarit, me veprimet e tyre të paligjshme, të cilat janë vërtetuar se i kanë kryer, nuk kanë kryer krime të luftës sepse nuk iu kanë takuar formacioneve të armatosura, nuk kanë qenë në shërbim të ndonjëres prej palëve në konflikt.” Në lëndën *Bukovica*, aktgjykimi është shfuqizuar në muajin qershor të vitit 2011 dhe lënda është kthyer në gjykim të përsëritur. Aktgjykimi tjetër, me të cilin lirohen të akuzuarit, në këtë lëndë është sjellë në fillim të muajit tetor të vitit 2011. Të dyja aktgjykimet kanë shkaktuar kritikë të ashpër të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut.

Në **Maqedoni** nuk ka gjykime për krime të luftës. Ligji mbi Amnistinë është miratuar në vitin 2002, me çka është mundësuar amnistia e të gjithë pjesëtarëve shqiptarë të formacioneve të armatosura për të cilët ka pasur dyshime se kanë kryer krime të luftës, me përfundim në datën 6 shtator të vitit 2001. Sipas këtij Ligji, amnistia nuk ka pasur të bëjë me të akuzuarit kundër të cilëve është ngritur procedurë para GJNPJ. Me nismën e partive politike shqiptare (Partia Demokratike e Shqiptarëve – PDSH, Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI), në datën 19 korrik të vitit 2011 është iniciuar procedura e votimit në Parlamentin e Maqedonisë për mbështetjen e shumicës për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë. Të njëjtën ditë, nisma është miratuar me 63 vota për kurse 29 kundër, me çka është hequr dorë nga drejtësia penale për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni.⁵

Interpretimi autentik i Ligjit mbi Amnistinë ka mundësuar që amnistia të zbatohet edhe në personat e dyshuar në lëndët të cilat GJNPJ ia ka kthyer Maqedonisë për procedurë.

Krimet ndaj shqiptarëve ende nuk janë procesuar. Lënda *Humnera* ndodhet me vite në Prokurorinë Themelore Publike dhe sipas Ligjit mbi Amnistinë do të mbyllet. Në zonën e Humnerës, midis Kiçevës dhe Dibrës, është gjetur varreza me mbetje mortore të personave të cilët janë zhdukur gjatë konfliktit të vitit 2001: Radoslav Ginov, shtetas bullgar, dhe tre shqiptarë nga Maqedonia - Islam Veliu, Hajredin Halimi dhe Ibrahim Veliu. Prokuroria nuk ka ngritur aktakuzë. Të dyshuarit për vrasje të këtyre viktimave janë pjesëtarë të paemëruar të organeve të rregullta të sigurimit.

Në **Sllloveni** nuk ekzistojnë gjykatat dhe prokuroria të cilat në mënyrë të veçantë janë kompetente për krimet e luftës, kurse nuk ekziston as edhe shërbimi i veçantë për mbështetje të dëshmitarëve.

Në rrjedhë e sipër janë dhjetë procedura për krime të luftës kundër popullatës civile dhe shkeljes së Konventave të Gjenevës. Procedurat zgjasin pothuajse 20 vite, në mungesë të të akuzuarve. Rasti më i njohur është procedura penale para gjykatës në Murska Sobota, kundër oficerit të ish APJ-së, kolonelit Berisllav Popovit dhe gjeneralit Vllada Trifunoviq, shtetas të Republikës së Serbisë. Të dyja aktakuzat në muajin prill të vitit 2008 janë bashkuar dhe shkrirë në një. Prokuroria në Murska Sobota i ka akuzuar Trifunoviqin dhe Popovin sipas bazës së përgjegjësisë komanduese për krime të luftës ndaj civilëve me rastin e intervenimit të APJ-së në Sllloveni në vitin 1991.⁶

Në procedurë e sipër janë 15 hetime kundër pjesëtarëve të APJ-së, të cilat kanë filluar menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Sllloveni.

Gjykatat në Sllloveni i kanë sjellë pesë aktgjykime, me të cilat të akuzuarit lirohen nga akuzat. Aktgjykimi i fundit është sjellë në vitin 1999. Katër aktgjykimet, me të cilat lirohen të akuzuarit nga përgjegjësia penale, i janë shqiptuar pjesëtarëve të ish APJ-së, të kombësisë jo-slllovene, dhe një oficeri të APJ-së, të kombësisë slllovene, “për shkak të shërbimit në ushtrinë e huaj”.

Aktakuzat në fuqi dhe lëndët hetimore kërkojnë rishqyrtim serioz profesional, sepse i takojnë kohës e cila e ka karakterizuar edhe qasjen politike ndaj pjesëtarëve të ish APJ-së, dhe jo vetëm atë juridike. Midis të tjerash, këtë e dëshmon edhe shembulli i aktgjykimit me të cilin lirohet nga përgjegjësia penale vozitësi i APJ-së, i cili ka qenë i akuzuar se e ka rrezikuar sigurinë sepse nën ndikimin e alkoolit „ka vozitur me shpejtësi të madhe në drejtim të fëmijëve “.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal në procesimin e krimeve të luftës, deri në fund të vitit 2011 janë nënshkruar disa marrëveshje bilaterale midis prokurorive të B dhe H, Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Këto marrëveshje në mënyrë të rëndësishme i kanë kontribuar këmbimit të informacioneve dhe dëgjimit të dëshmitarëve jashtë

5 Konflikti i armatosur në Maqedoni ka zgjatur nga muaji janar deri në muajin nëntor të vitit 2001.

6 “Gjenerali Trifunoviq: Nuk do të shkoj në gjykim”, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, 14 korrik i vitit 2010. http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_zaradni_zlocin_usloveniji/2099828.html.

kufijve të shtetit, sepse iu mundësojnë prokurorive që t'i dërgojnë kërkesat e tyre dhe që t'i pranojnë ato, pa shfrytëzimin e kanaleve diplomatike.

Marrëveshja mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës, të cilën Kroacia dhe Serbia e kanë nënshkruar në vitin 2006, është treguar si një instrument i mirë në shmangien e problemeve në procesimin e krimeve të luftës, të grumbulluara gjatë viteve të pasluftës, në të cilat në Kroaci kryesisht janë gjykuar kryerësit e kombësisë serbe, derisa në Serbi nuk ka pasur gjykime për krimet e luftës.

BdheH dhe Kroacia, në muajin shkurt të vitit 2010, kanë nënshkruar Marrëveshjen e ndryshuar mbi përmbarimin reciprok të vendimeve gjyqësore në çështjet penale, të cilët parandalojnë ikjen e personave të gjykuar nga njëri shtet në tjetrin. Rezultat i kësaj Marrëveshjeje është se i dënuari i arratisur Branimir Gllavash sot e vuan dënimin në burgun e Zenicës.

Është pozitive se organet e gjyqësorit të Serbisë dhe të Kroacisë kanë vazhduar t'i këmbëjnë provat dhe lëndët gjyqësore përkundër kushteve të përkeqësuar, të shkaktuara nga burgosa e shtetasit kroat Tihomir Purd në BdheH sipas fletarrestimit të Republikës së Serbisë, me refuzimin e PKL të Republikës së Serbisë që gjyqësorit kroat t'ia dorëzojë aktakuzën dhe provat kundër shtetasit kroat Veljko Mariq, me shpalljen e aktakuzës së Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së kundër Vlladimir Sheksit dhe edhe 33 shtetasve të Kroacisë si dhe me sjelljen e Ligjit mbi Pavlefshmërinë, të cilin Parlamenti kroat e ka miratuar në datën 21 nëntor të vitit 2011.

Nënshkrimi i Protokolleve midis BdheH dhe Serbisë mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të krimeve të luftës, me të cilët, midis të tjerash, është arritur marrëveshja e investimit të përpjekjeve të përbashkëta në parandalimin e hetimeve paralele, e caktuar për datën 30 nëntor të vitit 2011 në Bruksel, është anuluar para vet nënshkrimit. Misioni i OSBE-së konsideron se „zhvillimi i procedurave nga ana e pushtetit serb në lëndët me krime të luftës, të cilat kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur në BdheH, edhe pse legjitime sipas të drejtës ndërkombëtare, ka qenë arsye e rritjes së tensioneve midis BdheH dhe Serbisë“. Përmirësimi i marrëdhënieve midis prokurorive të BdheH dhe Serbisë varet nga tërheqja e PKL të Republikës së Serbisë prej keqpërdorimit të institucionit të juridiksionit universal.

Në muajin tetor të vitit 2010, Serbia dhe Mali i Zi kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi Ekstradimin, e cila parasheh ekstradimin për veprat penale kundër njerëzimit dhe të mirave të tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë edhe krimet e luftës, që deri në fund të vitit 2011 nuk është zbatuar në raport me të akuzuarin e parë në lëndën *Kalugjerski Laz*, Predrag Strugarin.

Edhe pse ekziston një nevojë e madhe për bashkëpunim të fuqishëm me institucionet kosovare, për shkak të vrasjes së 13.500 njerëzve gjatë konflikteve të armatosura në vitin 1998 dhe 1999 dhe menjëherë pas përfundimit të luftës, gjyqësori i Republikës së Serbisë bashkëpunon ekskluzivisht me Njësinë e EULEX-it për hetimin e krimeve të luftës.

2. Bosnja e Hercegovina

Në procesimin e krimeve të luftës zbatohen dy ligje penale – Ligji Penal i RSFJ-së i vitit 1976 dhe Ligji Penal i BdheH i vitit 2003. Gjykata e BdheH e zbaton Ligjin Penal të BdheH⁷, kurse gjykatat kantonale dhe ato të qarkut si edhe Gjykata Themelore në distriktin e Brçkos, zbatojnë Ligjin Penal të RSFJ-së, i cili në lëndët për krimet e luftës po ashtu zbatohet në Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe në Kosovë. Sipas interpretimit të Gjykatës së BdheH⁸, gjykatat vendore kanë të drejtë vet të vendosin sipas cilit ligj do t'i procesojnë krimet luftës. Parimi themelor është që personi i akuzuar të gjykohe në bazë të ligjit i cili ka qenë në fuqi në kohën kur janë kryer krimet, por ky parim mund të mos përfillet nëse ekziston rreziku që i dyshuari/i akuzuari t'i shmanget gjykimit për krime të luftës. Në

7 Gjykata e BdheH në dy raste ka gjykuar sipas Ligjit penal të RSFJ-së.

8 “Një krim i luftës, dy ligje“, faqja e internetit *IWPR*, 16 shkurt i vitit 2012, <http://iwpr.net/sr/report-news/bosna-i-hercegovina-jedan-ratni-zlo%C4%8D-dva-zakona>.

këto raste do të zbatohet ligji më i ri penal.⁹ Sipas Ligjit Penal të RSFJ-së, dënimi maksimal me burgosje është 15 vite kurse ai minimal është pesë vite. Ligji Penal i BdheH parasheh dënimin maksimal në lartësi prej 45 vitesh, kurse atë minimal në lartësi prej 10 vitesh.

2.1. Kapacitetet

Seksioni i veçantë për krime të Luftës i Gjykatës së BdheH (Seksioni I) është themeluar në datën 6 janar të vitit 2005, si nismë e përbashkët e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian në BdheH dhe GJPNJ me qëllim të procesimit të kryerësve të rangut të mesëm dhe të ulët në hierarkinë dhe përgjegjësinë ushtarake. Me themelimin e Departamentit I, dhe me një varg ndryshimesh të cilat kanë pasuar, Gjykata e BdheH ka marrë një pjesë të kompetencave të gjykatave kantonale dhe të atyre të qarkut në procesimin e krimeve të luftës.

Nga fundi i vitit 2011, në Seksionin I, krahas 9 gjyqtarëve vendor, kanë qenë të angazhuar edhe 4 gjyqtarë ndërkombëtar.¹⁰ Në Departamentin e Apelit të Gjykatës së BdheH janë aktiv 14 gjyqtarë, të cilët, pos në krimet e luftës, veprojnë edhe në lëndët e tjera. Me gjyqtarët e Seksionit I dhe të Departamentit të Apelit, drejtpërdrejt bashkëpunojnë 26 këshilltar juridik dhe bashkëpunëtor profesional. Në divizionet e tjera, të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi ofrojnë mbështetjen për procesimin e krimeve të luftës (Seksioni i administratës gjyqësore) punojnë 27 të punësuar.¹¹ Në nivel të BdheH është internacionalizuar edhe funksioni i prokurorit dhe, së këndejmi, pranë Seksionit I, nga gjithsejtë 19, deri në fund të vitit 2011, kanë qenë të angazhuar edhe 4 prokurorë ndërkombëtar. Prokurorëve dhe gjyqtarëve të huaj, pranë Seksionit për Krime të Luftës, iu ka skaduar afati në fund të vitit 2009, por ai iu është zgjatur edhe për tri vite të tjera.

Sipas kompetencave për udhëheqjen e procedurës, ekzistojnë dy grupe të lëndëve të krimeve të luftës. Grupi i parë i përfshin lëndët e krimeve të luftës të cilat janë pranuar për t'u punuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP) të BdheH. Për procesimin e këtij grupit të parë është kompetent Gjykata e BdheH: në shkallën e parë vendimin e sjellë Seksioni I i Departamentit Penal të Gjykatës së BdheH, kurse në shkallën e dytë Seksioni I i Departamentit të Apelit të Gjykatës së BdheH. Grupi i dytë përfshin lëndët e krimeve të luftës, të cilat janë pranuar për t'u punuar në gjykata dhe në prokurori në entitetet dhe në Distriktin e Brçkos para hyrjes në fuqi të LPP të BdheH, e në të cilat aktakuza nuk ka qenë në fuqi, përkatësisht nuk ka qenë e konfirmuar. Këto gjykata dhe prokuroritë janë të obliguara për të përfunduar këto lëndë, duke pasur parasysh faktin se Gjykata e BdheH ka të drejtë, sipas nenit 449 të LPP të BdheH për të marrë përsipër secilën prej këtyre lëndëve.

Ekzistojnë dy entitete të Gjykatave Supreme (Gjykata Supreme e FbdheH dhe Gjykata Supreme e RS), Gjykata Shtetërore e BdheH, e cila nuk i ka kompetencat e gjykatës supreme, Gjykata e Apelit e Distriktit të Brçkos e BdheH, dhjetë gjykata kantonale si dhe gjashtë gjykata të qarkut në dy njësi të ndryshme shtetërore-juridike.¹² Para të gjitha gjykatave, prej 20 gjykatave të cekura, zhvillohen gjykime për krime të luftës, në shkallë të ndryshme.¹³ Rasti i njëjtë është edhe me prokuroritë: katër prokurori të nivelit të lartë (të entiteteve, distrikteve dhe kombëtare), 15 prokurori të rangut të mesëm (të nivelit të qarkut/të nivelit

9 Sipas deklaratës së ndihmësit të ministrit të drejtësisë të BdheH, Niko Grubjesiqit dhënë gazetarit të IWPR-së: „Një person, i cili është dënuar për krime të luftës në Gjykatën e BdheH e ka ngritur ankesën në gjykatën e Strazburgut. Ai person pohon se të drejtat e tij të njeriut janë rrezikuar, sepse është gjykuar në bazë të ligjit të ri penal.“ *Po aty*.

10 Regjistri i gjyqtarëve të gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, 27 janar i vitit 2012, faqja e internetit e Gjykatës së BdheH, <http://www.sudbih.gov.ba/?opcija=bio&jezik=b>.

11 Informacion i marrë nga Gjykata e BdheH, 27 janar i vitit 2012.

12 Në BdheH punojnë edhe dy gjykata Kushtetuese, tri ministri të drejtësisë dhe një komision gjyqësor, i cili i ka kompetencat e ministrisë.

13 Për procesimin e grupit të dytë të lëndëve të krimeve të luftës, në Federatën e BdheH janë kompetente gjithsejtë 11 gjykata (10 gjykata kantonale si gjykata të shkallës së parë dhe Gjykata Supreme e Federatës së BdheH si gjykatë e shkallës së dytë), në Republika Srpska gjithsejtë gjashtë gjykata (5 gjykata të qarkut si gjykata të shkallës së parë dhe Gjykata Supreme e RS si gjykatë e shkallës së dytë), dhe në Distriktin e Brçkos të BdheH gjithsejtë 2 gjykata (Gjykata Themelore e Distriktit të Brçkos si gjykatë e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit e Distriktit të Brçkos të BdheH si gjykatë e shkallës së dytë).

kantonal) si edhe një prokurori speciale dhe tetë departamente të prokurorisë. Të gjitha, të 28-tat kanë kompetenca për të zhvilluar hetime dhe për të ndjekur penalisht veprat penale të krimeve të luftës.

2.2. Bartja e përgjegjësive në gjykata të nivelit më të ulët

Menjëherë pas themelimit të Gjykatës së BdheH është supozuar se kjo gjykatë nuk do të ketë mundësi t'i marrë të gjitha rastet, të cilat, sipas aktit të themelimit, i takojnë. Çështja e bartjes së kompetencave për procesimin e krimeve të luftës në gjykata më të ulëta, së këndejmi, deri më sot është një nga problemet qendrore në procesimin e krimeve të luftës në BdheH.

Krahas kësaj, procesimi i krimeve të luftës është i ngarkuar edhe nga mungesa e të dhënave mbi lëndët e pazgjidhura. Për shembull, në muajin prill të vitit 2010, Prokuroria e BdheH ka raportuar mbi ekzistimin e 1.381 lëndëve të krimeve të luftës në fazën e hetimeve që kanë të bëjnë me 8.249 persona të dyshuar, të cilët kanë qenë në punë të 17 prokurorive, që është numër pakrahasueshëm më i vogël nga vlerësimi i organeve të njëjta të vitit 2007, që ka lëvizur nga 13.000 deri në 17.000 kryerës. Sipas interpretimit të misionit të OSBE-së, shkak i dallimit të madh mund të jenë lëndët të udhëhequra në mënyrë paralele në prokurori të ndryshme dhe koordinimi i pamjaftueshëm midis prokurorive në këmbimin e të dhënave.¹⁴

Vendimin mbi bartjen e procedurave në gjykatat tjera (me kompetenca lokale), Gjykata e BdheH e sjellë mbi bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 27a të Kodit mbi Procedurën Penale të BdheH, më saktë sipas peshës së veprës penale, cilësisë së kryerësit si dhe rrethanave të tjera të lidhura me vlerësimin e kompleksitetit të lëndës. Të njëjtat kriterë janë të përcaktuara dhe në hollësi të përpunuara në Strategjinë shtetërore për punë në lëndët e krimeve të luftës, të miratuar në vitin 2008.¹⁵ Me Strategji janë të përkufizuara afatet kohore, kapacitetet, kriteret dhe mekanizmat e udhëheqjes me lëndët, barazimi i praktikës gjyqësore, çështjet e bashkëpunimit rajonal, mbrojtja dhe përkrahja e viktimave dhe e dëshmitarëve, si dhe aspektet financiare dhe mbikëqyrja e zbatimit të Strategjisë. Në nivel të Gjykatës dhe të Prokurorisë së BdheH është paraparë krijimi i evidencave qendrore të të dhënave mbi të gjitha lëndët e krimeve të luftës në BdheH. Është përcaktuar që më të përgjegjshmit për krime të luftës në mënyrë prioritare do të procesohen para Gjykatës së BdheH. Po ashtu, është paraparë edhe harmonizimi i praktikës gjyqësore me qëllim që të sigurohet siguria juridike dhe barazia e qytetarëve para ligjit.¹⁶ Strategjia e thekson nevojën e procesimit të lëndëve më të komplikuar dhe më prioritare në një afat prej shtatë vitesh si dhe procesimin e lëndëve të tjera të krimeve të luftës në një periudhë prej 15 vitesh. Me qëllim që të lehtësohet bartja e lëndëve në gjykata të tjera, Dhoma e Popujve të Asamblesë Parlamentare të BdheH, në muajin shtator të vitit 2010 i ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet e LPP të BdheH. Megjithatë, ka mendime profesionale se plani i përcaktuar, sidoqoftë, është tejet ambicioz.¹⁷

Në periudhën prej vitit 2006 e deri në fund të vitit 2011, me vendim të Gjykatës së BdheH janë përcjellë gjithsejtë 83 lëndë në gjykatat me kompetenca lokale. Prej tyre, 52 lëndë janë përcaktuar në gjykatat e BdheH, 27 në gjykatat në RS dhe një lëndë në Gjykatën Themelore të Distriktit të Brçkos të BdheH.¹⁸ Misioni i OSBE-së vlerëson se sistemi i gjyqësorit në BdheH ende nuk e ka mundur bartjen efikase të lëndëve më pak komplekse në nivelet më të ulëta sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe se numri i lëndëve të bartura është i pamjaftueshëm.¹⁹

Strategjia shtetërore e parasheh që gjykimet për krime të luftës të zhvillohen në të gjitha nivelet dhe që, së këndejmi, të zbatohet i njëjti ligj – Ligji Penal i BdheH. Si një nga mënyrat e barazimit të praktikave gjyqësore në gjithë territorin e BdheH, OSBE-ja ka rekomanduar krijimin e Gjykatës Supreme të BdheH. Për këtë nuk ekziston një

14 Arritja e drejtësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë: procesimi i lëndëve të krimeve të luftës nga viti 2005 deri në vitin 2010. OSBE BdheH, 2011, f. 24-25.

15 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f.7.

16 Raporti i dytë periodik i Bosnjës dhe Hercegovinës mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike, Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët, tetor, 2010.

17 Intervistë me Branko Mitroviqin, prokuror i Prokurorisë Qarkut të Banjallukës, 20 dhjetor i vitit 2011.

18 Informacion i marrë nga Gjykata e BdheH, 27 janar i vitit 2012.

19 Informacion i marrë nga Misioni i OSBE-së, 27 janar i vitit 2012.

bazë eksplicite kushtetuese, gjë në të cilën referohen autoritetet e Republika Srpska, por nuk ekziston as ndalesa eksplicite kushtetuese, gjë që e theksojnë edhe autoritetet e FdheH. Megjithëkëtë, të gjithë kërkojnë që të gjenet një zgjidhje që Gjykata e DdheH të mos sjellë aktgjykime të shkallës së parë e që, pastaj, të vendos edhe në procedurat e shkallës së dytë.

Këshilli i lartë prokuroria dhe gjyqësori në DdheH, në muajin nëntor të vitit 2011, kanë propozuar themelimin e Gjykatës së Apelit të DdheH, por kësaj i kundërvihet Republika Srpska. Për RS është i pranueshëm themelimi i një Paneli të Apelit pranë Gjykatës së DdheH, që do të ishte kompetent për veprat penale të Ligjit Penal të DdheH, por jo edhe të entiteteve.²⁰

2.3. Federata e DdheH

Numri i tërësishëm i prokurorëve për krime të luftës në Federatën e DdheH është 12. Nga gjithsejtë 10 prokurori kantonale, vetëm 5 prej tyre i kanë departamentet e specializuara për lëndët e krimeve të luftës, të cilat janë të themeluara pas miratimit të Strategjisë shtetërore për procesimin e krimeve të luftës. Vetëm 4 prokurori kanë prokurorë, të cilët punojnë ekskluzivisht në lëndët e krimeve të luftës.²¹ Shpërndarja më efikase e kuadrit prokurorial në masë të madhe varet edhe nga Ligji mbi Prokurorinë e FdheH, i cili ende është në procedurë. Me të do të vendosej një kornizë ligjore për të gjitha gjykatat, dhjetë prej tyre kantonale, kurse një federale. Me Projektin e ligjit të përmendur është paraparë punësimi i këshilltarëve si dhe i ndihmësve të prokurorëve, të cilët do të rrisnin kapacitetet dhe efikasitetin e prokurorive të entiteteve.²²

2.4. Republika Srpska DdheH

Në Republika Srpska, gjykimet për krimet e luftës zhvillohen para pesë gjykatave të qarkut (Banja Lluca, Doboji, Bijeljina, Sarajeva Lindore dhe Trebinja) dhe para Gjykatës Supreme të RS. Gjykata Supreme e RS vendos mbi ndihmën ligjore kundër vendimeve të gjykatave të qarkut dhe sjellë aktgjykime të plotfuqishme.²³ Strukturën prokuroriale e përbëjnë Prokuroria e RS, pesë prokurori të qarkut dhe, në kuadër të Prokurorisë së Qarkut të Banja Llukës, Prokuroria Speciale për Krime të Luftës.

Në gjashtë gjykata, 21 gjykatës punojnë në lëndët e krimeve të luftës. Në të gjitha prokuroritë, me hetimet dhe me ndjekjen penale merren 12 prokurorë. Në MPB-në e RS, me hulumtimin e krimeve të luftës merret Departamenti për hulumtimin e krimeve të luftës, por numri i të punësuarve, në pajtim me Rregulloren mbi mbrojtjen e të dhënave të fshehta të MPB-së së RS, konsiderohet fshehtësi.²⁴ Në Prokurorinë Speciale për krime të luftës në Banja Llukë është formuar ekipi prej 11 hulumtuesve nga radhët e pjesëtarëve të Qendrës për siguri publike të Banja Llukës.²⁵ Prokurorisë shpesh i arrijnë akuza penale kundër kryerësit N.N. edhe për vrasje të rënda, për të cilat vetëm hetimet tregojnë nëse janë në pyetje krime të luftës.²⁶

Në procesimin e krimeve të luftës zbatohet Ligji Penal dhe LPP i RSFJ-së, i cili ka qenë në fuqi edhe në kohën e konfliktit të armatosur.²⁷

20 "PLGJP propozon themelimin e Gjykatës së Apelit të DdheH", faqja e internetit *Glas Srpske*, 9 nëntor i vitit 2011, http://www.glassrpske.com/novosti/vijesti_dana/VSTS-predlaze-osnivanje-apelacionog-suda-BiH/lat/66019.html.

21 Informacion mbi numrin e prokurorëve i marrë nga Paneli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Bosnjës dhe Hercegovinës, 6 janar i vitit 2012.

22 Informacion i marrë nga Misioni i OSBE-së, 27 janar i vitit 2012.

23 Ligji mbi gjykatat, neni 28, *Gazeta Zyrtare e Republika Srpska*, nr. 111/04, nr. 109/05, nr. 37/06, nr. 119/08, nr. 58/09, nr. 116/09.

24 Informacion i marrë nga Mirna Shoja, zyrtare për marrëdhëniet me publikun e MPB-së së Republika Srpska, 13 janar i vitit 2012.

25 Intervistë me Branko Mitroviqin, prokurorin e Prokurorisë së Qarkut të Banja Llukës, 20 dhjetor i vitit 2011.

26 Sipas fjalëve të prokurorit Mitroviq, ka pasur shembuj kur akuza e parë penale ka pasur të bëjë me vrasje të rënda dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, por vepra e mëvonshme është modifikuar në krime të luftës. *Po aty*.

27 Gjykatat në Republika Srpska e zbatojnë Ligjin Penal dhe Ligjin mbi Procedurën Penale të RSFJ-së, i cili nuk lejon pranimin e procesverbalit nga hetimet si dëshmi, të cilën e mundëson ligji mbi Procedurën Penale, të cilin e zbaton Gjykata e DdheH. „Banja Lluca: Trashëgimia e kohëve në të cilat kemi jetuar“, faqja e internetit e *BIRN-it*, 27 dhjetor i vitit 2007, <http://www.bim.ba/bh/95/10/7151/>.

2.5. Distrikti i Brçkos i BdeH

Në distriktin e Brçkos të BdeH për krime të luftës gjykimet bëhet para Gjykatës Themelore dhe të Apelit të Distriktit të Brçkos të BdeH. Zbatohet Ligji Penal i SFRJ.

2.5.1. Statistika

Nga fillimi i vitit 2011 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2011, numri i tërësishëm i lëndëve në gjykatat e BdeH ka qenë 115²⁸: prej tyre në Gjykatën e BdeH 64, në Federatën e BdeH 22, në Republika Srpska 21, dhe në Distriktin e Brçkos 8.²⁹

Gjatë vitit 2010 ka pasur gjithsejtë 108 lëndë në të gjitha gjykatat e BdeH. Gjykimet për krimet e luftës kanë qenë në numrin më të madh në Gjykatën e BdeH, ku në tërësi kanë qenë 47. Gjykata Supreme e FBdeH i ka pasur në tërësi 14 lëndë, kurse Gjykata Supreme e RS gjithsejtë 7 lëndë. Gjykatat kantonale i kanë pasur 22 lëndë, të qarkut 12, kurse Gjykata Themelore e Distriktit të Brçkos 2 lëndë.³⁰ Në vitin 2011 janë iniciuar gjithsejtë 52 procedura, prej të cilave 27 në Gjykatën e BdeH, 8 në gjykatat e qarkut në RS, 13 në FBdeH dhe 4 në Gjykatën e Distriktit të Brçkos. Janë përfunduar 33 lëndë, prej të cilave 19 në Gjykatën e BdeH, 4 në gjykatat e qarkut, 10 në gjykatat kantonale dhe asnjë në Distriktin e Brçkos të BdeH.³¹

Në vitin 2010 janë iniciuar gjithsejtë 39 procedura të lidhura me veprat e krimeve të luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare. Prej tyre, në Gjykatën e BdeH janë iniciuar 26 procedura, në gjykatat e Republika Srpska gjashtë, në FBdeH pesë dhe në distriktin e Brçkos të BdeH dy. Janë të përfunduara gjithsejtë 23 lëndë, prej tyre në Gjykatën e BdeH 13, në gjykatat në RS katër, në FBdeH pesë dhe në distriktin e Brçkos të BdeH një.³²

Para Gjykatës Themelore të distriktit të Brçkos në BdeH në vitin 2010 janë zhvilluar katër gjykime për krime të luftës, kurse në vitin 2011 shtatë gjykime. Gjykata e Apelit e distriktit të Brçkos të BdeH e ka pasur një lëndë të krimeve të luftës në vitin 2010 dhe një person është gjykuar me një vendim të plotfuqishëm. Në vitin 2011 nuk ka pasur lëndë të krimeve të luftës para këtyre gjykatave.³³

Kur është fjala për hetimet, gjatë vitit 2010, Prokuroria e BdeH ka zhvilluar 365 hetime për krime të luftës, prokuroritë kantonale 320, prokuroritë e qarkut 437 dhe Prokuroria e Distriktit të Brçkos 28.³⁴ Qendra për hulumtime të krimeve të luftës e Agjencisë Shtetërore për Hulumtim dhe Mbrojtje (ASHHM - State Investigation and Protection Agency SIPA) në vitin 2010 ka vepruar sipas 480 Urdhëresave të Prokurorisë së BdeH, prej të cilave gjashtë urdhëresa të prokurorisë së entiteteve, kurse janë përfunduar 197 hetime. SIPA në nëntë muajt e parë të vitit 2011 ka vepruar sipas 317 urdhëresave të Prokurorisë së BdeH, prej të cilave 5 urdhëresa të prokurorisë së entiteteve, kurse janë përfunduar 211. Në periudhën prej vitit 2006 e deri në vitin 2011, SIPA i ka privuar nga liria gjithsejtë 137 persona të dyshuar për krime të luftës.³⁵

28 Paneli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Bosnjës dhe Hercegovinës, i vetmi organ kompetent për mbledhjen dhe përpunimin e të gjitha të dhënave statistikore në lidhje me punën e të gjitha Gjykatave dhe Prokurorive në Bosnjë dhe Hercegovinë, ka refuzuar të lëshojë të dhënat statistikore për këtë raport, me arsyetimin se nuk i posedon këto të dhëna.

29 Informacion i marrë nga Misioni i OSBE-së i datës 27 janar të vitit 2012.

30 Informacion i marrë nga Paneli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i BdeH, 6 janar i vitit 2011.

31 Informacion i marrë nga Misioni OSBE-së, 27 janar i vitit 2012.

32 Rastet e përfunduara të krimeve të luftës të viteve 2004-2010, faqja e internetit e OSBE-së, BdeH, <http://www.oscebih.org/Default.aspx?id=70&lang=BS>.

33 Komunikim me email me Amela Perezoviqin, zyrtare e Gjykatës së Apelit të Distriktit të Brçkos të BdeH, 15 dhjetor i vitit 2011.

34 Raport vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial për vitin 2010, tabela 16, f. 267.

35 Informacion i marrë nga SIPA, në datën 6 janar të vitit 2012.

Prokuroria në BdhëH në vitin 2010 ka ngritur 26 aktakuza për krime të luftës kundër 42 personave³⁶, kurse në vitin 2011 5 aktakuza kundër 40 personave.³⁷

Prokuroria e Gjykatës Themelore të Distriktit të Brçkos në vitin 2010 ka ngritur tri aktakuza kundër shtatë personave, kurse në vitin 2011 tri aktakuza kundër pesë personave.³⁸

2.6. Performanca e Gjykatës së BdhëH

Gjykata e BdhëH që nga themelimi i saj e deri në fund të vitit 2011 me aktgjykime të plotfuqishme i ka dënuar 88 persona dhe i ka përfunduar gjithsejtë 78 lëndë për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocidit dhe shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare të luftës. Gjykata në BdhëH, nga fillimi i punës së saj ka shqiptuar gjithsejtë 91 aktgjykime të shkallës së parë kundër 133 personave të akuzuar, duke përfshirë 23 aktgjykime në bazë të marrëveshjes mbi pranimin e fajit kundër 23 personave.³⁹ Nga numri i përgjithshëm i personave të dënuar, gjykata e BdhëH gjashtë persona i ka liruar me kusht: Dushan Fushtarit,⁴⁰ Mitra Rasheviqin, Vasa Todoroviqin, Momçillo Grubanin, Ljubiçica Pashkon dhe Ivica Vrdoljakun, derisa Abduladhim Maktouf është gjykuar me dënim të plotfuqishëm me 5 vite dhe e ka vuajtur dënimin.⁴¹

Gjatë vitit 2010, Gjykata e BdhëH ka pranuar për t'i punuar 106 lëndë të reja në fazën e PPP-procedurës paraprake penale (faza e procedurës paraprake, hetimet), përkatësisht 12 lëndë të reja në fazën e PDP (faza e dëgjimit paraprak, aktakuza e ngritur). Me aktgjykime të plotfuqishme i ka dënuar 16 persona. Para Seksionit I janë shqiptuar 13 aktgjykime të shkallës së parë, duke përfshirë pesë në bazë të marrëveshjes mbi pranimin e fajit, kurse Departamenti i Apelit për krime të luftës ka sjellë 10 aktgjykime, të cilat janë bërë të plotfuqishme.⁴²

Me përfundim në datën 26 dhjetor të vitit 2011, Gjykata e BdhëH ka pasur 117 lëndë në fazën e hetimeve dhe 11 lëndë të reja me aktakuza të ngritura. Në fund të vitit 2011, në fazën e përgatitjeve për seancën gjyqësore kryesore dhe në seancën gjyqësore kryesore janë gjendur 25 lëndë, kurse 9 në procedurën ankimore. Me dënime të plotfuqishme janë dënuar 15 persona. Para Seksionit I janë shqiptuar 18 aktgjykime të shkallës së parë. Departamenti i Apelit ka sjellë 13 aktgjykime të plotfuqishme.⁴³ Gjatë vitit 2011 është arritur numri më i lartë i marrëveshjeve mbi pranimin e fajit që nga fillimi i punës së Departamentit për Krime të Luftës, të cilat Gjykata e BdhëH i ka pranuar dhe i ka shqiptuar 70 vite burgosje duke i dënuar 7 persona.⁴⁴ Marrëveshjet mbi pranimin e fajit janë një nga institucionet kyçe në kuadër të procedurës penale në BdhëH.⁴⁵

Për 33 persona të dënuar janë shqiptuar gjithsejtë 436 vite burgosje. Dënimi më i madh i është shqiptuar Mi-

36 Zyra e Regjistrave të Gjykatës së BdhëH dhe Prokurorisë së BdhëH, Raport vjetor për vitin 2010, f. 37.

37 „Gjykata shtetërore në vitin 2011: 31 aktgjykime për krime të luftës“, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, 8 janar i vitit 2011. http://www.slobodnaevropa.org/content/drzavni_sud_u_2011_33_presude_za_ratne_zlocine/24444988.html.

38 Faqe e internetit, Prokuroria e Distriktit të Brçkos të BdhëH, <http://jt-brckodistriktbih.pravosudje.ba/>.

39 Informacion i marrë nga Gjykata e BdhëH, 27 janar i vitit 2012.

40 Lirimi me kusht i Dushan Fushtarit, i cili i është dorëzuar Hagës dhe i ka pranuar krimet ndaj boshnjakëve dhe kroatëve të kryera në Keraterm ka zgjatur deri në datën 29 mars të vitit 2011, kur ka skaduar aktgjykimi i shqiptuar i dënimit me burgosje. Në paraburgimin e GJNPJ është gjendur nga viti 2002 deri në vitin 2006. Koha e kaluar në njësinë e paraburgimit të GJNPJ i është llogaritur në dënimin, të cilin e ka shqiptuar Gjykata e BdhëH.

41 Informacion i marrë nga Gjykata e BdhëH, 4 dhe 25 janar i vitit 2012.

42 Informacion i marrë nga Gjykata e BdhëH, 4 janar i vitit 2012.

43 Informacion i marrë nga Gjykata e BdhëH, 4 janar i vitit 2012.

44 „Gjykata Shtetërore në vitin 2011: 31 aktgjykime për krime të luftës“, faqja e internetit *Radios Evropa e Lirë*, 8 janar i vitit 2011. http://www.slobodnaevropa.org/content/drzavni_sud_u_2011_33_presude_za_ratne_zlocine/24444988.html.

45 Si pjesë e reformës së gjithmbarshme të sistemit penal-juridik, ky institut i bazuar në të drejtën zakonore anglosaksone, iu mundëson prokurorëve dhe të dyshuarve, përkatësisht të akuzuarve të negociojnë për llojin dhe gjatësinë e sanksioneve penalo-juridike, me kushtin që i dyshuari, përkatësisht i akuzuari të pranojë se ka kryer veprë penale dhe se pranon të heq dorë nga disa të drejta themelore siç është e drejta në diskutimin publik para gjykatës, në sigurimin e procedurës publike gjyqësore dhe e drejta në ankesë. Rastet, në këtë mënyrë zgjidhen pakrahasueshëm më shpejtë, sepse nuk rezulton deri tek vet procedura gjyqësore. Megjithatë, problemet, të cilat i theksojnë viktimat janë se, nga ana e tyre, të dënuarit dënohen me dënime më të ulëta dhe, së këndejmi, nga pikëpamja e tyre, drejtësia nuk është e kënaqur.

llorad Trbiquit - 30 vite burgosje për shkak të krimit në Srebrenicë. Dënimi më i ulët i plotfuqishëm i shqiptuar i është shqiptuar ndihmësit të komandantit për siguri në batalionin *Hamza* pranë korpusit të pestë të Armatës së Republikës së BdeH, Shefik Aliqit, i cili është dënuar me 10 vite burgosje.⁴⁶

2.7. Ekstradimet nga BdeH dhe në BdeH

Ekstradimi i të dyshuarve nga BdeH dhe në BdeH kryesisht funksionon në bazë të fletarrestimeve ndërkombëtare. Gjatë vitit 2010 dhe 2011, shtetet jashtë rajonit të ish-Jugosllavisë i kanë ekstraduar në institucionet gjyqësore të BdeH një numër të madh të të dyshuarve për krime të luftës.

Ministria e Drejtësisë e SHBA-ve ia ka dorëzuar ministrisë së BdeH në datën 12 janar të vitit 2010 Edina Xhekun dhe Rasem Handanoviçin në bazë të fletarrestimit ndërkombëtar të organeve të gjyqësorit të BdeH.⁴⁷ Edina Xheku dyshohet nga Prokuroria e BdeH se si pjesëtar i njësisë speciale *Zulfikar*, e cila ka vepruar pranë shtabit qendror të Armatës së BdeH, ka marrë pjesë në sulmin në Trusinë në muajin prill të vitit 1993, kur janë vrarë 18 civil kroat dhe katër pjesëtarë të burgosur të Këshillit Kroat të Mbrojtjes (KKM).⁴⁸

Rasem Handanoviçi, i quajtur Zolja, pjesëtarit të së njëjtës njësi, nga Prokuroria e BdeH po ashtu dyshohet për pjesëmarrje në fshatin Trusinë, në datën 16 prill të vitit 1993, kur janë vrarë 18 civilë dhe katër të persona të zënë rob, dhe janë plagosur një numër i madh i personave, në mesin e të cilëve ka pasur edhe dy fëmijë. Rasem Handanoviçi është i dyshuar se personalisht ka marrë pjesë në pushkatimin e tre të burgosurve dhe tre civilëve.⁴⁹

Marko Boshkiq, ish pjesëtar i Detashmentit të dhjetë diversant të Ushtrisë së RS, i dyshuar për veprë penale të gjenocidit në Srebrenicë në muajin korrik të vitit 1995, është ekstraduar në BdeH në datën 24 prill të vitit 2010 nga SHBA-ja, ku e vuante dënimin me burgosje për shkak të veprës penale të mashtrimit të imigracionit. Në datën 19 korrik të vitit 2010, në Sarajevë, me Prokurorinë e BdeH e ka nënshkruar Marrëveshjen mbi pranimin e fajit, të cilin e kanë përkrahur edhe shoqatat e viktimave. Është dënuar në datën 27 korrik të vitit 2010 me dhjetë vite të burgosjes për krime kundër njerëzimit.

Në bazë të fletarrestimit ndërkombëtar, të lëshuar nga Prokuroria e BdeH, Spanja, në datën 26 gusht të vitit 2010, ka ekstraduar Veselin Vllahoviçin të quajtur Batko. Prokuroria e BdeH e ngarkon Veselin Vllahoviçin se nga muaji maj deri në muajin gusht të vitit 1992, në zonën e Grbavicës, Vracit dhe Kovaçiqit, në komunën e Sarajevës, ka vrarë dhe ka marrë pjesë në vrasjen e më shumë se 30 personave, si edhe se, vetëm ose në grup me persona të tjerë të armatosur, ka keqtrajtuar, ka rrahur dhe ua ka marrë paratë dhe gjëra të tjera me vlerë qytetarëve të kombësisë kroate dhe boshnjake. Gjykimi për të akuzuarin Vllahoviç ka vazhduar në vitin 2012.

Shtetasja kroate Azra Bashiq, e cila në muajin mars të vitit 2011 është burgosur në SHBA në bazë të fletarrestimit ndërkombëtar të organeve të gjyqësorit të BdeH të vitit 2006, ende nuk i është ekstraduar institucioneve të gjyqësorit të këtij shteti. Bashiqi dyshohet për torturë dhe vrasje të të burgosurve serb në kampin e Derventit nga muaji prill deri në muajin qershor të vitit 1992, kur ka qenë komandante e Brigadës 108 të Rijekës të Ushtrisë së Republikës së Kroacisë. Gjykata federale amerikane, në bazë të dokumentacionit të cilin e ka dorëzuar Ministria e Drejtësisë e BdeH, e ka miratuar ekstradimin. Prokuroria e BdeH pas analizës së provave, lëndën e ka bartur në kompetenca të Gjykatës së Qarkut në Dobo.

Avokati i të akuzuarës Azra Bashiq, Patrick Nash, megjithëkëtë, konsideron se nuk ka marrëveshje midis BdeH

46 „Gjykata Shtetërore në vitin 2011: 31 aktgjykime për krimet e luftës“, faqja e internetit e *Radios Evropa e Lirë*, 8 janar i vitit 2011. http://www.slobodnaevropa.org/content/drzavni_sud_u_2011_33_presude_za_ratne_zlocine/24444988.html.

47 *Po aty*.

48 „BdeH: Të dyshuarit për krime të luftës të ekstraduar nga SHBA-ja“, faqja e internetit e portalit *Dnevno*, 20 dhjetor i vitit 2011. http://www.dnevno.hr/vijesti/regija/bih_osumnjiceni_za_ratni_zlocin_izrucen_iz_sada/498431.html.

49 „Rasema Handanoviçi e ekstraduar gjyqësorit të BdeH“, faqja e internetit të *BIRN*, 27 dhjetor i vitit 2011. <http://www.bim.ba/bh/302/10/34130/>.

dhe SHBA-ve, e cila e mundëson ekstradimin, posaçërisht për arsye se Bashiqi është shtetase e natyralizuar amerikane, kurse gjykatësi i gjykatës federale amerikane konsideron se marrëveshjet ekzistuese e mundësojnë kthimin e Bashiqit në Evropë.⁵⁰

2.8. Gjykimet për dhunën seksuale në luftë

Deri në fund të vitit 2011 në Gjykatën e BdeH⁵¹ janë zhvilluar rreth 20 procedura me elemente të dhunës seksuale, në të cilat rreth 100 gra viktime kanë dëshmuar. Komiteti kundër torturës i KB-së konsideron se „dhunimi nuk është përkufizuar si një krim i veçantë dhe, së këndejmi, përkufizimi i dhunës seksuale të luftës në BdeH nuk është në përputhje përkufizimet ndërkombëtare, arsye kjo përse aktakuzat sipas këtyre neneve lehtë mund të refuzohen, kurse të akuzuarit të mbesin të padënuar.“⁵² Në Ligjin Penal të BdeH, vetëm dy nene e cekin dhunimin si krim të luftës kundër njerëzimit (neni 172) dhe si krim të luftës kundër popullatës civile (neni 173). Në vitin 2010 krimet e luftës të dhunimit ceken në nëntë aktgjykime të Gjykatës së BdeH, prej të cilave tri i kanë liruar të akuzuarit nga akuzat (Miomir Saviq, Krsto Saviq dhe Ferid Hoxhiq), kurse gjatë me të cilat të akuzuarit dënohen.⁵³ Nga fundi i vitit 2011, nga gjithsejtë 27 aktgjykime të sjella para Seksionit I, në shtatë prej tyre të akuzuarit janë dënuar.⁵⁴

Midis veprimeve para Gjykatës së BdeH, të cilat e kanë „karakterizuar“ vitin 2011, gjithsesi se është Albina Terziq⁵⁵, gruaja e parë e cila, midis veprave të tjera penale, është e akuzuar edhe për dhunë seksuale të luftës. Të akuzuarën Albina Terziq, Prokuroria e ngarkon se në periudhën prej muajit maj të vitit 1992 e deri në mesin e këtij viti, si pjesëtare e Policisë Ushtarake të Këshillit Kroat të Mbrojtjes (KKM), vet ose me pjesëtarë/tare të tjerë të KKM-së, ka marrë pjesë në sjelljen çnjerëzore ndaj popullatës civile. Ajo i ka rrahur, i ka torturuar fizikisht dhe psikikisht, ka organizuar „dasma të kampit“ dhe i ka detyruar të burgosurit ta dhunojnë një të burgosur me invaliditet mental, duke kryer, kështu, shumë forma të dhunës seksuale edhe ndaj të burgosurve e edhe ndaj të burgosurës. Gjykimi ka filluar në datën 4 tetor të vitit 2011.

2.9. Gjykimet për krime në kampin *Silos*, në shkollën fillore dhe kazermën *Krupa*

Prokuroria e BdeH ka ngritur në datën 30 dhjetor të vitit 2012 aktakuzën kundër tetë personave, të cilët i ngarkon se nga muaji maj i vitit 1992 e deri në fund të muajit janar të vitit 1996 kanë marrë pjesë në ndërmarrjen e bashkuar kriminale në kuadër të së cilës me anë të planifikimit, urdhërimit, nxitjes dhe përkrahjes e ndihmës kanë kryer veprë penale të krimeve të luftës kundër civilëve dhe krime të luftës kundër të burgosurve të luftës të kombësisë serbe dhe kroate në objektet e *Silos*it në Tarçin, në shkollën fillore 9 maji në Pazariq si dhe në depon e kazermës *Krupa* në Zovik.⁵⁶ I akuzuari Mustafa Gjelijloviq në kohën e ngjarjeve ka qenë kryetar i Kuvendit Komunal Haxhiq. I akuzuari Fadil Çoviq ka qenë shef i Stacionit të Sigurisë Publike të Haxhiq, kurse Mirsad

50 „Azra Bashiq kërkon gjykim në SHBA“, faqja e internetit e B92, 9 korrik i vitit 2011. http://www.b92.co.rs/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=07&dd=09&nav_category=64&nav_id=524340.

51 Organizatat e viktimave të mbijetuara të dhunës seksuale ngulin këmbë që të gjitha rastet e dhunës seksuale të luftës duhet të jenë të procesuara në Gjykatën e BdeH, duke qenë se viktimat nuk kanë besim në gjykatat e nivelit më të ulët nga arsye të ndryshme, kurse më së shpeshti janë në pyetje problemet e mbrojtjes joadekuate të dëshmitarëve.

52 Komiteti Kundër Torturës (CAT), observacione përmbyllëse (CAT/C/SR.978). në raportin e kombinuar 2-5 të BdeH CAT/C/BEH/2-5 (neni. 1 dhe 4), <http://sim.law.uu.nl/SIM/CaseLaw/uncom.nsf/804bb175b68baaf7c125667f004cb333/3fa9a2542602ec44c12578730046b79e?OpenDocument>.

53 Bastah Predrag – me aktgjykim të shkallës së parë është dënuar me 18 vite, Marko Radiq – 25 vite, Qerim Novaliqi – shtatë vite, Miodrag Nikaçević – 10 vite, Ante Kovaç – 13 vite dhe Krsto Saviq i dënuar me 17 vite burgosje.

54 Novica Tripkoviç – me aktgjykimin e shkallës së parë i dënuar me tetë vite burgosje, Sasha Bariçanin – 18 vite, Sllavko Laloviç – pesë vite, Velibor Bogdanoviç – gjashtë vite (në arrati), Qerim Novaliqi – me aktgjykim të shkallës së dytë i dënuar me tetë vite e gjashtë muaj, Miodrag Markoviç – shtatë vite, Bastah Predrag – me aktgjykim të shkallës së dytë i dënuar me 22 vite dhe një aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga aktakuza (Darko Doliq), deri sa janë në rrjedh e sipër shtatë procese (Veselin Vlahoviç, Albina Terziq, Oliver Krsmanoviç (*Fija e flokut të zanës- Vilina vlas*), Jasko Gazdiq (*Shtëpia për dhunim*), Zheljko Jukiq, Damir Lipovac, Vlatko Jarak).

55 Më shumë për lëndën shih në faqen e internetit të Gjykatës së BdeH <http://www.sudbih.gov.ba>.

56 Lënda S1 1 P 007914 KRI – Mustafë Xheliloviç dhe të tjerët, në dispozicion në faqen e internetit të Gjykatës së BdeH, <http://www.sudbih.gov.ba/?opcija=predmeti&id=683&jezik=b>.

Shabiq polic në të njëjtin stacion. Nezir Kaziqi ka qenë komandant i Brigadës së nëntë bregore të Armatës së Bosnjës e Hercegovinës, Beqir Hujiqi administrator i kampit *Silos*, Halid Çoviqi dhe Sherif Meshanoviqi zëvendës të tij, kurse Nermin Kalembër roje në kampin *Silos*.⁵⁷

Prokurori Marjan Pogaçnik i ngarkon të akuzuarit se e kanë përbërë një “zinxhirë” të roleve reciprokisht të lidhura, qëllim i të cilit ka qenë burgosja sistematike e popullatës serbe dhe kroate nga Pazariqi, Haxhiqi dhe Tarçina, burgosja e tyre në vendin e paraburgimit në kampin *Silos*, si dhe në objektet për paraburgosje në hapësirat e shkollës fillore *9 maj* në Pazariq, dhe në kamp në depot e kazermës *Krupa*.

Sipas aktakuzës, në kampin *Silos*, në kohëzgjatje të ndryshme prej një e deri në 1334 ditë, në mënyrë të kundërligjshme janë mbyllur së paku 500 civilë të kombësisë serbe dhe së paku 90 persona të kombësisë kroate. Në shkollën fillore *9 maji* në Pazariq, e cila po ashtu ka qenë një kamp i organizuar, kanë qenë të ngjuar e pakta 140 persona të kombësisë serbe, kurse në depot e kazermës *Krupa* në Zovik së paku 150 persona të kombësisë serbe dhe së paku 30 persona të kombësisë kroate. Civilët e paraburgosur i janë shtruar sjelljes çnjerëzore, shkaktimit të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha dhe lëndimeve të integritetit trupor ose shëndetit, uzurpimit të së drejtës në gjykim të drejtë si dhe detyrimit në punë të detyrueshme.⁵⁸ Si pasojë e veprimeve të cekura, shumë persona kanë pësuar me vdekje.⁵⁹

Të akuzuarit janë në paraburgim nga data 23 nëntor e vitit 2011. Prokurori publikisht e ka tërhequr vërejtjen se ushtrohet ndikim në dëshmitarët e prokurorisë.⁶⁰ Seanca gjyqësore kryesore nuk ka filluar deri në fund të vitit 2011.⁶¹

2.10. Gjykimi i pjesëtarëve të Detashmentit të Dhjetë Diversant të Ushtrisë së RS

Gjykimi i komandantit të detashmentit të Togut të Parë të Bjelinjes të Detashmentit të Dhjetë Diversant të Shtabit Kryesor të URS Franc Kosit, dhe pjesëtarëve të atij Detashmenti Stanko Kojiqit, Vlastimir Golijanit dhe Zoran Goronjit, ka filluar në datën 8.09.2010, me deklarinimin për fajësinë para Gjykatës së BdheH.⁶² Golijani është i vetmi i cili e ka pranuar fajin. Aktakuza e Prokurorisë së BdheH i ngarkon për vepër penale të gjenocidit. Të akuzuarit ngarkohen se kanë marrë pjesë në pushkatimin e mbi 800 burrave dhe djemve boshnjak nga Srebrenica, të cilët në grupe janë sjellë në fermën Branjevo. I akuzuari Kos dhe të akuzuarit e tjerë, si bashkëkryerës, “kanë kryer vrasjen e burrave të kombësisë boshnjake dhe iu kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe shpirtërore, me qëllim të zhdukjes së plotë ose të pjesshme të grupit kombëtar, etnik dhe fetar të boshnjakëve”. I akuzuari Kos ka qenë komandant i Togut të parë të Detashmentit të Dhjetë Diversant, kurse Kojiqi, Golijani dhe Goronja pjesëtarë të të njëjtit Detashment. Të gjithë së bashku i kanë pushkatuar të burgosurit, prej të cilëve disa kanë qenë me duar dhe sy të lidhur.⁶³ Këtë e ka vërtetuar edhe vet i akuzuari i parë Kos. Ka thënë se “të gjithë të akuzuarit kanë marrë pjesë në pushkatimin në Branjevë”.⁶⁴ I akuzuari i dytë Stanko Kojiq është i vetmi, i cili ka pohuar se “nuk e ka vrarë askënd”. Ai, “vërtetimin” e të burgosurve të pushkatuar, të cilin e ka kryer Kosi, e ka karakterizuar si “akt human”, sepse “njerëzit kanë klithur pasi që në ta është shtënë nga mitralozi”.⁶⁵

57 “Të burgosur tetë të dyshuar për krime në Tarçin”, faqja e internetit e *BIRN*, 22 nëntor i vitit 2011. <http://www.bim.ba/bh/297/10/33848/>.

58 “Rasti ‘Silos’: aktakuza e ngritur për krime të luftës”, faqja e internetit e *Oslobodenje*, 30 dhjetor 2011. <http://www.oslobodenje.ba/vijesti/bih/sud-bih-potvrdena-optuznica-za-zlocine-u-silosu>.

59 “Tetë të burgosur për shkak të torturave në kampin Silos”, faqja e internetit e *Nezavisne novine*, 22 nëntor i vitit 2011. <http://www.nezavisne.com/novosti/hronika/Osam-uhapsenih-zbog-mucenja-u-logoru-Silos-116097.html>.

60 “Është kërkuar zgjatja e paraburgimit të tetë të dyshuarve”, faqja e internetit e *BIRN*, 20 dhjetor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/301/10/34079/>.

61 Gjykata e BdheH e ka konfirmuar aktakuzën e Prokurorisë të datës 2 janar të vitit 2012.

62 Lënda S1 1 P 003372 10 PRI - Kos Franc dhe të tjerët, në dispozicion në faqen e internetit të Gjykatës së BdheH, <http://www.sudbih.gov.ba/index.php?opcija=predmeti&id=316&jezik=b>.

63 “Kos dhe të tjerët: Plumbi pas qafe”, faqja e internetit e *BIRN*, 2 shtator i vitit 2011. <http://www.bim.ba/bh/285/10/33232/?tpl=30>.

64 “Kos dhe të tjerët: Forca madhore në Branjevë”, faqja e internetit e *BIRN*, 22 nëntor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/297/10/33857/>.

65 “Kos dhe të tjerët: Vrasja si akt human”, faqja e internetit e *BIRN*, 09 dhjetor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/299/10/33994/>.

Gjykimin në vitin 2011 e ka karakterizuar dëshmia e dëshmitarit të mbrojtur të Prokurorisë Z-1, i cili ka vërtetuar se pjesëtarët e Detashmentit të Dhjetë Diversant kanë qenë në dijeni për planin e vrasjes së boshnjakëve në Branjevë. Z-1 po ashtu ka qenë anëtarë i të njëjtit Detachment. Z-1 ka sjellë të dhënën se “pjesëtarët e Detashmentit të tij urdhrin për vrasjen e civilëve në fermën ushtarake, Branjevë (komuna e Zvornikut) e ka marrë nga Millorad Pelemisha”.⁶⁶ “Pelemish ka vetëm thënë - kush shkon në atë aksion dhe nuk ka kërkuar vullnetar. [...] I kemi vrarë me një plumb pas qafe, kurse disa më vonë i kanë vërtetuar vrasjet. Policët ushtarak kanë ardhur me autobusë me të burgosurit. Ata na kanë thënë se e kemi kryer punën tonë, sepse nuk ka më autobusë;”, ka thënë Z1.⁶⁷

Të njëjtat pohime i ka sjellë edhe dëshmitari i mbrojtjes së të akuzuarit të parë Kos, Velibor Popoviqi, po ashtu pjesëtar i Detashmentit të Dhjetë Diversant. Popoviqi ka thënë se pjesëtarët e këtij detachmenti “nuk kanë ditur se ku shkojnë dhe as që e kanë pasur mundësinë për të refuzuar çfarëdo urdhri”, dhe se “të gjitha urdhrat kanë ardhur nga Misha Pelemishi”, dhe se asnjë pjesëtar i detachmentit “nuk i ka rënë në mend ta refuzojë urdhrin e tij dhe as që ka ekzistuar mundësia për këtë”.⁶⁸

Në gjykim kanë dëshmuar shumë ish pjesëtarë të Detashmentit të Dhjetë Diversant⁶⁹ Zijad Zhihiq, po ashtu, ka dëshmuar se pjesëtarët e Detashmentit të Dhjetë Diversant të URS “është dashur të kryejnë secilin urdhër, sepse, në të kundërtën, do t’i kishin vrarë”. I akuzuari i parë Kos ka thënë se “kurrë nuk e ka fshehur se ka marrë pjesë në pushkatimet e boshnjakëve në Fermën ushtarake në Branjevë në muajin korrik të vitit 1995, por se nuk ka marrë pjesë në zhdukjen e popullatës boshnjake, por se ka vetëm ka punuar sipas urdhrave”.⁷⁰ Mbrojtja e ka mohuar se veprat e përshkruara në aktakuzë mund të karakterizohen si gjenocid dhe në udhëheqjen e procedurës (gjatë vitit 2011) ka qenë e fokusuar në paraqitjen e provave të cilat tregojnë se Kosi dhe të tjerët nuk kanë mundur për t’i refuzuar urdhrat dhe se nuk kanë ditur për planin e kryerjes së gjenocidit si edhe për qëllimin e pushkatimit, në të cilin kanë marrë pjesë.⁷¹

Franc Kos, shtetas sloven, ka qenë pjesëtar i ushtrisë kroate, pastaj i Armatës së BdeH, kurse në Ushtrinë e RS është rekrutuar nga kampi *Batkoviq* në Bijeljine. Drazhen Erdemoviq, pjesëtar i parë i Detashmentit të Dhjetë Diversant i cili është gjykuar nga GJNPJ dhe i cili e ka pranuar fajin, e ka identifikuar Kosin si një nga komandantët dhe ekzekutuesit.⁷² Kos me vite ka qenë në arrati dhe është fshehur pas emrit të rrejtshëm në Bijeljine. Është burgosur sipas fletarrestimit ndërkombëtar në kufi të Kroacisë e të Serbisë dhe iu është dorëzuar autoriteteve të BdeH. Të gjithë të akuzuarit e tjerë janë gjendur në BdeH në momentin e burgosjes. Gjykimi nuk ka përfunduar deri në fund të vitit 2011.⁷³

66 “Kos dhe të tjerët: Të ndërgjegjshëm për krimin, faqja e internetit e *BIRN*, 23 gusht i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/284/10/33184>.

67 “Kos dhe të tjerët: Plumbi pas qafe”, faqja e internetit e *BIRN*, 2 shtator i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/285/10/33232/?tpl=30>.

68 “Kos dhe të tjerët: Ushtarët e rrahur dhe nervoz”, faqja e internetit e *BIRN*, 27 shtator i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/289/10/33434/>.

69 “Kos dhe të tjerët: Ballafaqimi i dëshmitarëve”, faqja e internetit e *BIRN*, 23 dhjetor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/301/10/34110/>.

70 “Kos dhe të tjerët: Pushkatimi sipas urdhrat”, faqja e internetit e *BIRN*, 8 nëntor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/295/10/33770/>.

71 “Kos dhe të tjerët: Forca madhore në Branjevë”, faqja e internetit e *BIRN*, 22 nëntor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/297/10/33857/>.

72 Pos Erdemoviqit, vetëm edhe një pjesëtar i Detashmentit të Dhjetë Diversant, Marko Boshkiq, është gjykuar në mënyrë të plotfuqishme me dhjetë vite burgosje (19 korrik i vitit 2010), për pjesëmarrje në ekzekutimet në Srebrenicë. Boshkiqi po ashtu ka pranuar fajin, dhe e ka lidhur marrëveshjen mbi pranimin e fajit me të cilën është obliguar se do të dëshmojë në proceset para Gjykatës së BdeH dhe GJNPJ. Boshkiqi është ekstraduar nga SHBA-ja në datën 28 prill të vitit 2010.

73 FDH i ka paraqitur PKL të Republikës së Serbisë në datën 11 gusht të vitit 2010 akuzat penale kundër shumë pjesëtarëve të Detashmentit të Dhjetë Diversant për shkak të pjesëmarrjes në gjenocid të kryer në Srebrenicë. Midis personave të përfshirë me këtë akuzë penale janë Milorad Pelemishi, Petar Salapura, Radoslav Jankoviqi, Milo Petroviqi, Radoslav Kremenoviqi, Franc Kos, Dragan Peqanac, Brano Gojkoviqi, Vlastimir Golijan, Aleksandar Cvetkoviqi, Stanko Savanoviqi dhe Zoran Obrenoviqi, prej të cilëve, sipas njohurive të FDH-së, e pakta gjashtë persona gjenden në Serbi. FDH në muajin shtator të vitit 2011 ka publikuar dosjen mbi Detashmentin e Dhjetë Diversant në të cilin sjellen faktet mbi pjesëmarrjen e këtyre personave në gjenocid në Srebrenicë. Deri në fund të vitit 2011, Prokuroria e Serbisë ende nuk ka ngritur aktakuzë kundër komandantit Millorad Pelemishit dhe pjesëtarëve të tjerë të Detashmentit të Dhjetë Diversant.

2.11. Rasti i Vullnetares⁷⁴

Prokuroria e BdeH udhëheq hetimet mbi Rrugën e Vullnetarëve nga viti 2006. Në tri vitet e fundit, hetimet i ka udhëhequr prokurori ndërkombëtar Jude Romano. Hetimet janë intensifikuar pasi që gjykata britanike e ka refuzuar kërkesën e Republikës së Serbisë për ekstradimin e ish anëtarit të Presidencës së BeH, Ejup Ganiqit, në datën 27 korrik të vitit 2010, kundër të cilit, si edhe kundër Stjepan Kljujiqit, po ashtu ish anëtarit të Presidencës së BdeH, pastaj gjeneralit Jovan Divjakut, dhe edhe 16 shtetasve të BdeH, Prokuroria e Republikës së Serbisë në vitin 2008 ka filluar hetimet për shkak të dyshimeve se në datën 2 dhe 3 maj të vitit 1992 në Rrugën e Vullnetarëve në Sarajevë kanë kryer krime të luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve, për vrasje dhe plagosje të kundërligjshme të armikut [pjesëtarëve të APJ-së] dhe kanë përdorur mjete të palejuara të luftës. Deri në fund të vitit 2011, Prokuroria e BdeH nuk i ka kryer hetimet.⁷⁵ Prokuroria e Republikës së Serbisë po ashtu deri në fund të vitit 2011 nuk i ka kryer hetimet.

Prokuroria e GJPNJ në vitin 2003 e ka sjellë vendimin se nuk ka mjaft prova se Ejup Ganiqi të jetë i akuzuar – dhe këtë vendim ia kanë përcjellë zyrës së prokurorit shtetëror të BdeH. “Vlerësimi ynë nuk mund të merret si mendim përfundimtar mbi këtë rast, sepse ai nuk është vendim i plotfuqishëm i bazuar mbi të gjitha faktet”, ka thënë përfaqësuesi i Prokurorisë në Hagë⁷⁶.

BdeH, Serbia dhe Kroacia, në vitin 1996, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Romës, përkatësisht “Rregullat e rrugës”, të cilat kanë qenë në fuqi deri në vitin 2004 dhe iu ka urdhëruar që para ngritjes së procedurave për krime të luftës nga Prokuroria e GJPNJ ta kërkojnë mendimin mbi provat e mbledhura.

Republika Srpska, në muajin korrik të vitit 2002, Prokurorisë së GJPNJ ia ka dërguar evidencat e veta mbi vrasjet në rrugën e Vullnetarëve dhe e ka kërkuar arsyeshmërinë e ngritjes së aktakuzave, duke përfshirë edhe ato kundër Ejup Ganiqit. Një vit më vonë, GJPNJ e ka informuar RS se nuk ka prova të mjaftueshme që Ganiqi të akuzohet për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Pos në rastin e Rrugës së Vullnetarëve, Serbia dhe BdeH, deri në fund të vitit 2011, kanë zhvilluar hetime paralele edhe në rastin *Kolona e Tuzllës*.

3. Kroacia

Në procesimin e krimeve të luftës në Kroaci zbatohen Ligji penal i RSFJ-së i vitit 1976 dhe Ligji Themelor Penal i Republikës së Kroacisë i vitit 1993. Me miratimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve të Ligjit Themelor Penal të vitit 2004 është krijuar baza juridike për zbatimin e parimit të përgjegjësisë komanduese. Me ndryshimet e Ligjit mbi Zbatimin e Statutit të GJPNJ-së, të cilat kanë hyrë në fuqi në qershor të vitit 2011, është mundësuar shfrytëzimi i provave të mbledhura nga ana e organeve të GJPNJ-së në procedurat penale për krime të luftës, në të cilat gjykatat do vlerësojnë sipas Ligjit mbi Procedurën Penale. Ndryshimet e cekura do të mundësojnë shfrytëzimin e provave të GJPNJ në të gjitha procedurat penale të cilat kanë filluar pasi që ndryshimet kanë hyrë në fuqi,

74 Burimet serbe, duke përfshirë edhe PKL të Republikës së Serbisë, pohojnë se në datën 2 dhe 3 maj të vitit 1992 janë vrarë 42, plagosur 73, kurse janë burgosur 215 ushtar të APJ-së. Prokuroria e BdeH, si dhe burimet e pavarura, cekin se me rastin e tërheqjes së kolonës së APJ-së, në datën 3 maj të vitit 1992, janë vrarë shtatë persona, kurse janë plagosur 14 persona.

75 Në datën 17 janar të vitit 2012, Prokuroria e BdeH ka sjellë vendimin mbi ndërprerjen e hetimeve kundër 14 të dyshuarve në bazë të 352 deklaratave dhe 412 provave materiale. Me hetime është vërtetuar se gjatë sulmit në Rrugën e Vullnetarëve në datën 3 maj të vitit 1992 janë vrarë shtatë persona dhe janë plagosur 14, pasi që janë paaftësuar për luftë. Megjithatë, siç e cek Prokuroria e BdeH, „hetimet vazhdojnë për shkak të ekzistimit të dyshimeve të bazuara se është kryer vepër penale e krimeve të luftës, sepse në viktimat është hapur zjarr pasi që janë paaftësuar për luftë ose derisa janë ndodhur në automjetin e ambulancës”. Më tutje është cekur se vazhdojnë hetimet mbi marrjen e një pjese të ushtarëve të burgosur nga kolona e APJ-së në hapësirat e sallës së fizkulturës, Burgut Qendror dhe shtabit të Mbrojtjes Territoriale, ku, siç tregohet, janë abuzuar dhe keqtrajtuar. “Nuk ka aktakuzë për atë të Vullnetarëve”, faqja e internetit *Novi magazin*, 17 janar i vitit 2012, <http://www.novimagazin.rs/svet/nema-optuznice-za-dobrovoljacku>.

76 “Serbia i vazhdon hetimet mbi Vullnetaren”, faqja e internetit *Tanjug*, 18 janar i vitit 2012, <http://www.tanjug.rs/novosti/30432/srbija-nastavlja-istragu-o-dobrovolja%C4%8Dkoj.htm>.

përkatësisht për lëndët të cilat kanë qenë në fazën e diskutimit para hyrjes së tyre në fuqi.

Ligji mbi Pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve gjyqësore të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë është sjellë në datën 21 tetor të vitit 2011 menjëherë para shpërbërjes së parlamentit kroat.⁷⁷ Sjellja e këtij ligji është argumentuar me atë se me të dëshirohet të ndalet kapja e organeve gjyqësore të Republikës së Serbisë në territorin e RK. Ligji është shkruar dhe miratuar me procedurë të shpejtuar si reaksion ndaj aktakuzës së Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së kundër 44 qytetarëve të Kroacisë, të cilën Prokuroria për krime të luftës e Republikës së Serbisë ia ka përcjellë Prokurorisë Shtetërore të Republikës së Kroacisë. Aktakuza ka përfshirë përfaqësues të institucioneve shtetërore në pozicionime të larta si dhe anëtarët e Bashkësisë Demokratike Kroate (BDK), Vladimir Sheksin, nënkryetar i Parlamentit kroat, Ivan Vekiqin, ish ministrin e punëve të brendshme të RK, Branimir Glavashin (në vuajtjen e dënimit me burgosje në BdheH), Tomislav Merçepin, ish sekretar i mbrojtjes popullore në komunën e Vukovarit dhe këshilltar i ministrit të punëve të brendshme të RK gjatë viteve 1990 dhe 1991) dhe edhe 40 veteranëve kroat të luftës për vepra penale të krimeve të luftës dhe gjenocidit.

Kryetari i Republikës së Kroacisë, Ivo Josipoviç, në datën 27 dhjetor të vitit 2011 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese të RK për vlerësimin e kushtetutshmërisë me arsyetimin se Ligji i miratuar shkel të drejtën kushtetuese në mbrojtjen e veteranëve kroat në procedurat e mundshme penale për krime të luftës dhe se i ekspozon para pasigurisë juridike⁷⁸ „dhe se, së këndejmi, nuk i kontribuon parimit se secili krim duhet të jetë i dënuar“.⁷⁹ Po ashtu është problematik edhe fakti se si ligj organik nuk është votuar me shumicën e caktuar me ligj⁸⁰ dhe se „me të kundër Kushtetutës i janë dhënë autorizime ministrit të Drejtësisë për të vendosur nëse dëshiron ose jo për të kaluar ndonjëherë prej veprimeve nga kompetencat e gjykatave të rregullta“.⁸¹ Qeveria e re kroate, e cila është formuar në datën 24 dhjetor të vitit 2011, ka njoftuar për heqjen e këtij ligji me procedurë të shpejtuar.

3.1. Kapaciteti

Në vitin 2010, MPB-ja dhe Prokuroria Shtetërore (PSHRK) e kanë sjellë listën e krimeve me prioritet në të cilat kryerësit ende nuk janë zbuluar. 127 janë përcaktuar me prioritet, prej tyre 8 në nivel kombëtar, kurse të tjerat në nivel rajonal. MPB-ja ka formuar 20 ekipe hetuese, kurse PSHRK i ka obliguar 15 zëvendës të prokurorëve shtetëror për procesimin e prioriteteve kombëtare, kurse 34 zëvendës të prokurorëve shtetëror për prioritetet rajonale.

Në muajin shkurt të vitit 2011, PSHRK dhe MPB-ja e Republikës së Kroacisë kanë sjellë Strategjinë për hulumtimin dhe procesimin e krimeve të luftës të kryera në periudhën prej vitit 1991 deri në vitin 1995.

Në muajin maj të vitit 2011, në fazën e fundit të mbylljes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian,⁸² Parlamenti Kroat i ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Zbatimin e Statutit të GJPNJ (J), i cili përkufizon shfrytëzimin e provave të GJPNJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë, të cilat kanë filluar

77 Ligji mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të drejtësisë të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, *Narodne novine Republike Hrvatske* 124/11.

78 Kryetari Josipoviç i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit mbi pavlefshmërinë në Kushtetutën e RK, kumtesë, faqja e internetit e Kryetarit të Republikës së Kroacisë, 27 dhjetor i vitit 2012, <http://www.predsjednik.hr/27122012>.

79 Përgjigje e Kryetarit Josipoviç në letrën e Amnesty International dhe Nismës së të Rinjve për të drejtat e njeriut, e datës 27 tetor të vitit 2011.

80 Kryetari Josipoviç i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit mbi pavlefshmërinë në Kushtetutën e RK, kumtesë, faqja e internetit e Kryetarit të Republikës së Kroacisë, 27 dhjetor i vitit 2012, <http://www.predsjednik.hr/27122012>.

81 *Po aty*.

82 Kapitulli 23 në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian ka të bëjë me drejtësinë dhe të drejtat themelore, në kuadër të të cilave më e rëndësishmja është krijimi i gjyqësorit të pavarur dhe efikas. Në kuadër të kësaj faze të negociatave, Komisioni Evropian i ka urdhëruar Kroacisë formimin e gjykatave të specializuara për krimet e luftës, kurse Kroacia e ka kryer këtë detyrë me themelimin e departamentit për krime të luftës pranë gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb.

pasi që ndryshimet kanë hyrë në fuqi.⁸³ Me anë të ndryshimeve janë rregulluar autorizimet ekskluzive të gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb [departamentet e specializuara për krime të luftës], në të gjitha procedurat e reja penale të krimeve të luftës, me çka është siguruar se procedurat e reja nuk do të fillojnë para gjykatave të vogla. Departamentet e specializuara kanë 16 gjyqtarë hetues dhe 38 gjyqtarë të këshillave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore.⁸⁴ Gjykimet zhvillohen edhe në gjykatat e qarkut, nëse kanë qenë në fazën paraprake para miratimit të ndryshimeve të ligjit.⁸⁵

Të njëjtët gjyqtarë, të cilët gjykojnë në departamentet për krime të luftës, po ashtu gjykojnë edhe për vepra të tjera penale⁸⁶. Për vëllimin e tyre të rritur të punës nuk janë siguruar mjete financiare të posaçme, dhe nuk janë angazhuar as këshilltarë të posaçëm, të cilët do t'i ndihmonin në përgatitjen dhe udhëheqjen e procedurës.

Një numër i caktuar i prokurorëve shtetëror, të angazhuar në divizionet e specializuara për krime të luftës, kanë kaluar nëpër një trajnim special për ndjekjen e veprave penale të krimeve të luftës. Kryeprokurori shtetëror Mladen Bajić, në bazë të „ndarjes vjetore të punëve“ e ka caktuar zëvendësen Jasmina Dolmagiqin kompetente për ndjekjen e krimeve të luftës.

Gjykata Supreme e Republikës së Kroacisë (GJSRK), në propozimin e arsyetuar të Kryeprokurorit shtetëror, mund të miratojë një delegacion për udhëheqjen e procedurave në njërin prej katër gjykatave të specializuara. Në vitin 2010 janë transferuar nëntë lëndë penale, kurse në vitin 2011 tridhjetë lëndë.⁸⁷

Shoqatat për të drejtat e njeriut e vënë në pah problemin e hetimeve dhe të gjykimeve në mjediset e vogla. Sipas mendimit të tyre, primare është bartja e tyre nga PSHQ (Prokuroritë Shtetërore të Qarkut) dhe gjykatat në mjediset më të vogla në njërin prej katër gjykatave të specializuara, të cilat kanë kapacitete më të mëdha profesionale, mundësi teknike dhe janë më pak të ekspozuara ndaj trysnive të institucioneve lokale. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci (Nisma e të Rinjve) sjellë shembullin e hetimeve të vrasjeve të civilëve serb në Sisak, të cilat as pas 19 vitesh nga kryerja e krimeve nuk kanë rezultuar me aktakuza. Me propozim të Kryeprokurorit Shtetëror, Mladen Bajić, GJSRK rastin e ka bartur në PSHQ në Osijek, gjë që, siç vlerëson Nisma e të Rinjve, mund të jetë shembull i një praktike të re në shmangien e trysnive politike në institucionet e hetuesisë. Nga ana tjetër, Kryeprokurori i Shtetit Mladen Bajić konsideron se aktgjykimet duhet të ndodhin në mjedisin lokal, sepse kjo, pastaj, ia dërgon mesazhin tërë bashkësisë. Megjithatë, Zoran Pusić, kryetar i Këshillit Qytetar për të Drejtat e Njeriut (KQDNJ), konsideron se është e mundshme të sigurohet mbrojtja e pjesëmarrësve të procesit vetëm në një numër të vogël të rasteve.⁸⁸

3.2. Qasja ndaj të dhënave mbi procesimin e krimeve të luftës

Shoqatat joqeveritare vlerësojnë se në vitin 2011 është arritur përparim në qasjen ndaj të dhënave mbi procedi-

83 Ligji mbi Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe ndjekjen për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të luftës, (*Gazeta popullore e Republikës së Kroacisë- Narodne novine Republike Hrvatske*, nr. 55/2011. Në qershor të vitit 2011, pasi që ndryshimet kanë hyrë në fuqi, Gjykata e Qarkut në Osijek, në procedurën e përsëritur kundër Damir Kufnerit dhe të tjerëve, ka refuzuar për t'i shfrytëzuar deklaratat e dëshmitarëve, të cilat i kanë marrë prokurorët e Prokurorisë së GJPNJ. Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjykimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

84 Shoqatat joqeveritare dhe organizatat tregojnë për mungesën e sjelljes së një strategjie implementuese, e cila do ta përcillte themelimin e departamenteve të specializuara për krime të luftës.

85 Pas miratimit të ndryshimeve të ligjit, në gjykatat e rregullta të qarkut janë aktivizuar së paku tetë procedura, prej të cilave numri më i madh në Gjykatën e Qarkut në Vukovar. Është fjala për aktakuza, të cilat në më pak se një vit janë ndarë nga proceset e tjera ose në mënyrë plotësuase janë ndryshuar ose për përtëritje të procedurës.

86 Kryetari i Seksionit për krime të luftës në Gjykatën e Qarkut në Osijek Zvonko Vekić kryen, në të njëjtën kohë, edhe funksionet e kryetarit të Seksionit Penal të shkallës së parë dhe të gjykatësit të Seksionit për lëndët e Zyrës për luftimin e korrupsionit dhe të krimin të organizuar (ZLKKO).

87 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjykimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

88 Intervistë me Zoran Pusićin, Komiteti Qytetar për të Drejtat e Njeriut, 17 janar i vitit 2012.

min e krimeve të luftës. Prokuroria Shtetërore e RK i publikon të dhënat statistikore nga Baza e të dhënave të krimeve të luftës mbi numrin e personave në kundër të cilëve është nisur procedura penale, numrit të të akuzuarve, numrit të personave në raport me të cilët kanë përfunduar procedurat si dhe mbi numrin e personave të procesuar sipas përkatësisë së palëve në konflikt. Por, shoqatat joqeveritare, të cilat i përcjellin gjykimet për krimet e luftës, konsiderojnë se të dhënat e cekura nuk janë të mjaftueshme në mënyrë që të mund të përcillet përparimi në procesimin e krimeve të luftës.

3.3. Statistika

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2011, PSHRK ka evidencuar 490 krime të luftës, në të cilat me vdekje kanë pësuar 5.987 persona. Prej tyre, 393 krime i kanë kryer pjesëtarët e ish APJ-së ose formacionet e të ashtuquajturës MAS e Krajinës, 86 pjesëtarë të ushtrisë dhe policisë kroate, dy pjesëtarë të të ashtuquajturës Mbrojtjes popullore të Krajinës Autonome Bosnja Perëndimore dhe shtatë pjesëtarë të njësive të pidentifikuara.⁸⁹ Nga 316 krime me kryerës të njohur, 103 janë zgjedhur. Procedurat penale janë iniciuar kundër 3.432 personave, prej të cilave 104 pjesëtarë të njësive kroate. Në raport me 2.998 kryerës të dyshuar, procedura ka filluar në mungesë të tyre. Me aktgjyqime jo të plotfuqishme janë liruar 704 persona ose është ndërprerë procedura ose është rikualifikuar aktakuza, kurse me dënime jo të plotfuqishme janë dënuar 554 persona.⁹⁰

Gjatë vitit 2011, hetimet kundër 370 kryerësve të pandehur kanë qenë në punë e sipër. Rreth 540 raste kanë qenë në fazën paraprake, në të cilën kryerësit e pandehur nuk kanë qenë të identifikuar.⁹¹

Sipas të dhënave të shoqatave joqeveritare,⁹² gjatë vitit 2011 janë akuzuar 29 persona – 18 pjesëtarë të njësive kroate dhe 11 pjesëtarë të njësive serbe. Pothuajse të gjithë të akuzuarit pjesëtarë të njësive serbe janë të paqashtëm për organet e drejtësisë së RK. Në vazhdim kanë qenë 28 procedura të shkallës së parë, në 10 gjykata të qarkut, në të cilat janë akuzuar 65 persona. Në Gjykatën e Qarkut në Split, edhe pse është fjala për një gjykatë të specializuar, nuk ka pasur gjyqime. Edhe pse janë caktuar, shqyrtimet nuk janë mbajtur në 11 lëndë penale, kryesisht për shkak të mungesës së të akuzuarve, në lidhje me të cilët nuk janë sjellë vendime mbi gjykimet në mungesë. Gjykatat e qarkut kanë sjellë aktgjyqime të shkallës së parë në 17 lëndë penale kundër 36 të akuzuarve. Në gjashtë procedura penale, 14 persona janë gjykuar me aktgjyqime të plotfuqishme kundër popullatës civile.⁹³ Prej tyre, nëntë persona janë pjesëtarë të njësive kroate, katër janë pjesëtarë të njësive serbe, kurse një është pjesëtarë i të ashtuquajturës Krajinës Autonome të Bosnjës Perëndimore. Këto janë lëndë me numër relativisht të vogël (12) të viktimave. GJSRK, në vitin 2011 ka sjellë aktgjykimet në lidhje me 23 të akuzuar: i ka shfuqizuar aktgjykimet ndëshkuese të shkallës së parë kundër katër pjesëtarëve të njësive kroate dhe pesë pjesëtarë të njësive serbe i ka kthyer në shqyrtim të përsëritur; në lidhje me gjashtë të akuzuar (tre pjesëtarë të njësive kroate dhe tre pjesëtarë të njësive serbe), e ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin lirohen të akuzuarit nga përgjegjësia penale; në lidhje me dy pjesëtarë të njësive kroate dhe një pjesëtar të njësive serbe, ajo e ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë, me të cilin dënohen të akuzuarit, kurse në lidhje me dy të akuzuar e ka ulur dënimin me burg, ndërsa në lidhje me një të akuzuar e ka konfirmuar aktgjykimin refuzues të shkallës së parë⁹⁴.

PSHRK, në vitin 2010 ka pranuar 58 akuza penale të lidhura me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe vepra të tjera penale, të cilat përbëjnë shkelle të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të luftës. Meqë kishin

89 Raport mbi përmeshjen e obligimeve nga Kapitulli 23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Qeveria e RK, 12 janar i vitit 2011.

90 Për të gjykuarit me aktgjyqime të plotfuqishme nuk ka të dhëna të sakta. Informacioni i marrë nga PSHRK me kërkesë të YIHR (NRRK) sipas Ligjit mbi të drejtën në qasje ndaj informacioneve, 2 nëntor i vitit 2011.

91 Faqja e internetit e PSHRK, <http://www.dorh.hr>.

92 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjyqimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

93 Pos në lëndën kundër Branimir Gllavashit dhe bashkëpunëtorëve të tij, ku dënimi është konfirmuar dhe modifikuar, përkatësisht zvogëluar.

94 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjyqimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

mbetur nga viti i kaluar të pazgjidhura 44 akuza, në tërësi në punë kanë qenë 102 akuza.⁹⁵ Sipas burimit të njëjtë, në vitin 2010 është ngritur aktakuza kundër 71 personave.⁹⁶ Të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS)⁹⁷ tregojnë se në vitin 2010 janë paraqitur gjithsejtë 120 persona për vepra penale të krimeve të luftës (108 për krime të luftës kundër popullatës), 14 persona për krime kundër njerëzimit dhe 10 persona për gjenocid. Sipas të dhënave të ESHS, në vitin 2010 gjithsejtë janë dënuar 12 persona për shkak të veprave penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, kurse një person është gjykuar për shkak të vrasjes dhe të plagosjes së paligjshme të armikut. Për të njëjtën periudhë, OSBE-ja ka evidencuar 60 të akuzuar, prej tyre 42 pjesëtarë të kombësisë serbe (38 të akuzuar në mungesë) dhe 18 të kombësisë kroate (një në mungesë).⁹⁸

Sipas evidencës së shoqatave joqeveritare, në vitin 2010, gjykatat e qarkut kanë sjellë 15 aktgjykime të shkallës së parë, prej të cilave 11 me të cilat personat e akuzuar dënohen. Në tetë lëndë, 11 të akuzuar janë pjesëtarë të njësisë serbe; në tri lëndë, katër të akuzuar kanë qenë pjesëtarë të njësisë kroate; ka një aktgjykim, me të cilin lirohet nga përgjegjësia penale një pjesëtarë i njësisë serbe.

3.4. Gjykimet në mungesë

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kroacisë, në muajin korrik të vitit 2010 ia ka dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë regjistrin e 1.543 personave kundër të cilëve në Kroaci është iniciuar procedura për shkak të krimeve të kryera të luftës. Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e personave të gjykuar në mungesë. Organizatat lokale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut pajtohen se shumica prej 554 të gjykuarve me aktgjykime të plotfuqishme janë pikërisht të gjykuar në mungesë.

Sipas të dhënave të PSHRK, prokuroritë shtetërore kanë kërkuar përtëritjen e procedurave në lidhje me 94 persona të gjykuar, pjesëtarë të njësisë serbe. GJSRK pozitivisht ka vlerësuar kërkesat e prokurorive shtetërore dhe në procedurat e përtëritura, me ndryshimin e aktakuzave dhe zbatimin e ligjit mbi amnistinë, janë pezulluar procedurat në lidhje me 69 të gjykuar me aktgjykime të plotfuqishme.⁹⁹ Kërkesat për përtëritjen e procedurës nga ana e të gjykuarve janë të rralla. PSHRK e cek se derti në fund të vitit 2011, 22 persona të dënuarve kanë kërkuar përtëritjen e procedurës.

Shoqatat joqeveritare e vënë në pah se revidimin e procedurave në numrin më të madh të rasteve e kanë bërë të njëjtat prokurori të qarkut, të cilat e kanë ngritur aktakuzën duke mos i respektuar standardet e objektivitetit dhe të paanësisë.¹⁰⁰

3.5. Kohëzgjatja e gjatë e procedurave

Disa procedura penale zgjasin 10 e më shumë vite. Procedura kundër Muhajl Hrastovit për krime të luftës në Urën e Koranës¹⁰¹ zhvillohet prej vitit 1992. GJSRK dy herë e ka shfuqizuar aktgjykimin ndëshkues të gjykatës së Qarkut në Karlovc, e pastaj, pas aktgjykimit të tretë ndëshkues e ka zhvilluar vet seancën dhe e ka dënuar Hrastovin me 8 vite burgosje. Gjykata Kushtetuese në vitin 2010 e ka shfuqizuar aktgjykimin ndëshkues dhe e ka kthyer lëndën në Gjykatën Supreme në gjykim të përsëritur. Deri në fund të vitit 2011, shqyrtimi nuk ka filluar.

95 Raport i PSHRK për vitin 2010, faqja e internetit e PSHRK, <http://www.dorh.hr/IzvjesceORadu>.

96 *Po aty*.

97 Informacion i marrë nga Enti Shtetëror për Statistika, 13 dhjetor i vitit 2011.

98 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, të cilët i kanë përcjellë 22 gjykime, kanë evidencuar 55 të akuzuar.

99 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjykimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

100 Intervistë me Zoran Pusiçin, Komiteti Qytetar për të Drejtat e Njeriut, 17 janar i vitit 2012.

101 Hrastov është akuzuar se si pjesëtar i policisë speciale të RK në Urën e Koranës ka vrarë 13, kurse i ka plagosur dy pjesëtarë të burgosur të APJ-së.

Në nëntor të vitit 2011, GJSRK, për herë të katërt e ka shfuqizuar aktgjykimin ndëshkues të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut për të akuzuarin Petar Mamula. Procedura kundër të akuzuarit Enes Viteshkiqit, pjesëtarë i njësisë kroate, për likuidimin e 18 civilëve serb në Paulin Dvor zgjat që nga viti 2002. Gjykata Supreme dy herë e ka shfuqizuar aktgjykimin ndëshkues të të Gjykatës së Qarkut në Osijek.

Nga vitet 90-të zhvillohet procedura në mungesë kundër të akuzuarit Radosllav Çubrilit për vrasjen e gjashtë civilëve kroat.

3.6. Anshmëria e gjykatave

Organizatat joqeveritare e vënë në pah anshmërinë e gjykatave në rastet e gjykimeve të ish pjesëtarëve të forcave kroate. Në Gjykatën e Qarkut në Karlovc në procedurën kundër Mihajl Hrastovit për vrasje të 13 pjesëtarëve të ish APJ-së (rasti i Urës së Koranës), pjesëtarët e shoqatave të luftëtarëve zëshëm e kanë komentuar procedurën, duke i fyer viktimat dhe dëshmitarët.¹⁰² Automobilit të prokurores shtetërore të qarkut i janë shpuar gomat, kurse i është dërguar porosia që të ketë kujdes „sepse ka fëmijë“.¹⁰³

Në procedurat kundër ish pjesëtarëve të forcave kroate, anshmëria e Gjykatës së Qarkut në Sisak është e dukshme nëpërmjet zbatimit të rrethanave lehtësuese ndaj pjesëtarëve të akuzuar të Ushtrisë Kroate si dhe në tretmanin e dëshmitarëve. Serbët janë konsideruar dëshmitarë të pasigurt me rastin e dëshmisë në dobi të serbëve të akuzuar, kurse kroatët, të cilët kanë dëshmuar në dobi të kryerësve, si dëshmitarë të sigurt. Gjykatësja e Gjykatës së Qarkut në Sisak, Snjezhana Mrkoc, ka deklaruar me rastin e arsytimit të aktgjykimit, në muajin nëntor të vitit 2010, me të cilën është hedhur aktakuza lidhur me katër të pjesëtarë të UK: „Më vjen jashtëzakonisht shumë keq që duhet t'i gjykojë pjesëtarët e Ushtrisë kroate për vepra penale, të cilat jemi mësuar t'i bëjë ana e kundërt, posaçërisht tash kur nderim qirin për Vukovarin.“¹⁰⁴

Nisma e të rinjve e cek se GJSRK disa herë, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me burgosje, ka marrë parasysh faktin se të akuzuarit kanë qenë të shpërblyer me medalje¹⁰⁵ ose se kanë pasur „entuziazëm patriotik“.¹⁰⁶

3.7. (Mos)Procesimi i krimeve të forcave kroate

Në vitin 2011 është arritur përparim në procesimin e krimeve të luftës. Në qershor të vitit 2011 ka filluar një hetim kundër tre personave për krime lufte në Sisak, ndër të cilët edhe ndaj Gjuro Brodaracit, Kryeshef i Drejtorisë së Policisë në vitin 1991. Brodarac ka vdekur në korrik të vitit 2011 në paraburgim. Në dhjetor të vitit 2011 PSHQ në Osijek ka ngritur aktakuzën kundër Vlladimir Millankoviqit, komandant i forcave të policisë në zonën e gjerë të Sisakut dhe të Banovinës dhe kundër zëvendëshefit të Drejtorisë së policisë në Sisak, Drago Boshnjakut, pjesëtar i njësisë speciale “Vukovi” të Drejtorisë së policisë në Sisak. Ata janë akuzuar për hyrje të dhunshme në shtëpi dhe banesa, si dhe për keqtrajtim të paligjshëm të një numri të civilëve serbë me ç’rast janë vrarë 24 prej tyre.¹⁰⁷

Në fillim të qershorit të vitit 2011 është ngritur aktakuzë kundër Tomislav Merçepit, komandantit të formacionit rezervë të MPB, të vendosur në Pakračka Polanë dhe në Panairin e madh të Zagrebit, për shkak se personalisht kishte urdhëruar privime të paligjshme nga liria, torturime dhe vrasje të civilëve dhe se, ndonëse e kishte ditur

102 Intervistë me Zoran Pusiçin, Komiteti Qytetar për të Drejtat e Njeriut, 17 janar i vitit 2012.

103 *Po aty*.

104 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Osijek, Documenta dhe GOLJP, Zagreb, kumtesë për publik me rastin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Sisak për krim në Novska, 25 nëntor i vitit 2011, http://www.centar-za-mir.hr/index.php?page=article_news&article_id=594&lang=hr.

105 Aktgjykim, me të cilin është konfirmuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Osijek, i shqiptuar për Tomislav Dilberin dhe Fred Margushin. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Kroacisë, *Kundër imunitetit të pushtetit: procesimi i krimeve të luftës në Kroaci*, mars, 2011.

106 Aktgjykim për Mirko Norac dhe Rrahim Ademin, Gjykata Supreme e Republikës së Kroacisë, nr. I Pp 1008/08-13.

107 Sipas burime zyrtare policore bëhej fjalë për vrasjen e rreth 40 civilëve, ndërsa burime të tjera, ndër të cilat Bashkësia e serbëve në Kroaci, flasin për 600 civilë serb të vrarë në Sisak nga ana e njësisë policore, ushtarake dhe paramilitare të Republikës së Kroacisë. Nisma e të rinjve për të drejta të njeriut, Kroacia, *Kundër imunitetit të pushtetit: procesimi i krimeve të luftës në Kroaci*, Mars 2011.

se vartësit e tij janë duke kryer krime, nuk kishte parandaluar veprimet e tilla joligjore. Kështu, vartësit e tij në rajonin e Kutinës, Pakracit dhe të Zagrebit i kanë privuar nga liria 52 persona, prej të cilëve 43 i kanë vrarë.

Nisma e të Rinjve vë në pah se si krime të shumta kundër civilëve serbë mbeten të pandëshkuara. Në raportin e lartpërmendur *Kundër imunitetit të pushtetit*, kjo Nismë thekson vrasjet dhe shkatërrimin e pasurisë së serbëve në Vukovar në vitin 1991¹⁰⁸, dhe se familjarët e viktimave, të cilët kishin parashtruar kërkesë, janë refuzuar për arsye se nuk ekziston aktgjykim të plotfuqishëm, dhe u janë arkëtuar shpenzimet gjyqësore. Nisma thekson edhe evakuimin e 26 fshatrave serbe në Komunën e Pozhegës në tetor të vitit 1991, me ç'rast forcat kroate kanë vrarë disa dhjetëra civilë dhe kishin shkatërruar disa qindra objekte banimi dhe ekonomike.

Gjate aksionit ushtarako-policor “Vetëtima” (“*Blesak*”), më 1 dhe 2 maj të vitit 1995, është çliruar një pjesë e territorit të okupuar të RK, porse aksioni ka pasur për pasojë edhe shpërnguljen e popullatës serbe. Sipas të dhënave nga Këshilli kroat i Helsinkit për të drejta të njeriut, pjesëtarët e forcave kroate, gjatë dhe menjëherë pas këtij aksioni, kanë vrarë 83 civilë serb.

Operacioni ushtarako-policor “Stuhia” (“*Oluja*”) ka filluar më datën 4 gusht të vitit 1995, kurse zyrtarisht ka përfunduar në datën 7 gusht të vitit 1995. Sipas të dhënave nga Këshilli Kroat i Helsinkit, gjatë operacionit dhe pesë ditë pas tij, e kanë humbur jetën të paktën 677 persona.¹⁰⁹ Për dallim nga të dhënat e KKH, evidenca e PSHRK-së përmban të dhëna për 214 persona të vrarë, nga të cilët 167 kishin pësuar si viktime të krimeve të luftës, kurse 47 si viktime të veprës penale të vrasjes. Për shkak të vrasjes së 21 personave, janë procesuar 33 persona, nga të cilat 14 edhe janë dënuar.¹¹⁰ Nuk ka asnjë aktgjykim të plotfuqishëm për krime lufte gjatë dhe pas aksioneve/operacioneve ushtarako-policore *Bljesak* dhe *Oluja*.

3.8. Mosprocesimi i komandantëve ushtarak dhe civil të profilit të lartë

Deri në fund të vitit 2011, nuk është zhvilluar në Kroaci asnjë hetim i shpejtë, i pavarur dhe i paanshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për t’u identifikuar personat të cilët kanë pasur përgjegjësi komanduese duke përfshirë edhe ata që do të mund të akuzoheshin për krime lufte. Procesimin e personave, të cilët kanë pasur përgjegjësi komanduese në kohën e kryerjes së krimeve të luftës, po e pengon legjislacioni joadekuat dhe mungesa e vullnetit politik.¹¹¹ Përkundër ekzistimit të informatave dhe të dëshmimeve me qasje publike, të shfrytëzuara gjatë procedurave ndëshkimore të përfunduara, AI paralajmëron se edhe sot e kësaj dite nuk është ngritur procedurë kundër Vlladimir Sheksit, i cili në kohën e luftës ishte kryetar i Shtabit të Krizës për Slavoninë Lindore, dhe i cili thuhet të jetë përfshirë në krime në Osijek në vitin 1991.¹¹²

Nisma e të Rinjve vë në pah edhe persona të tjerë në pozita të larta të cilët ende gëzojnë mbrojtje nga përgjegjësia penale. Kjo Nismë, në raportin e vet thekson emrin e Ivan Vekiçit, i cili gjatë vitit 1991 ishte ministër i punëve të brendshme, me pëlqimin e të cilit Tomislav Merçepi kishte themeluar formacionin rezervë të MPB-së. Pastaj ajo (Nisma e të Rinjve) përmend gjeneralin e luftës Karl Gornishek, i cili kishte dhënë urdhër për evakuimin e fshatrave të Pozhegës, gjë që kishte rezultuar me vrasjen e dhjetëra civilëve serb. Institucionet hetimore deri tani nuk e kanë shqyrtuar përgjegjësinë e mjekut Darko Milinoviçit, i cili është i përfshirë në krimet ndaj civilëve serb në Gospiq. Edhe përkundër faktit që GjLRL ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin Mirko Norac është dënuar për krime

108 Në dhjetor të vitit 2010, janë hapur hetimet kundër Tomislav Merçepit, ish-këshilltarit të ministrit të Punëve të Brendshme dhe komandanti i Njësisë speciale policore, e cila quhej në mënyrë të popullarizuar „Merçepovci“, për vrasje dhe zhdukje të serbëve në territorin e Zagrebit dhe Pakračka Polanës. Kundër Merçepit është ngritur aktakuzë në qershor të vitit 2011.

109 Këshilli kroat i Helsinkit për të drejta të njeriut, *Raporti: Operacioni ushtarak “Oluja” dhe pas kësaj*, Zagreb, më 8. Prill 1999.

110 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documente dhe Këshilli qytetar për të drejta të njeriut *Monitorimi i gjykimeve për krime të luftës -raporti për vitin 2011*. Të dhënat i kanë prezantuar përfaqësueset e DORH-së në Tribunën publike për krimet e paprocesuara gjatë dhe pas aksionit ushtarako-policor *Oluja*, 28. Prill 2011.

111 Informimi i KE për shqetësimin për shkak të mosndëshkimit për krime të luftës në Kroaci [Briefing to the European Commission on the ongoing over impunity for war crimes in Croatia], Amnesty International, October 2011.

112 Informimi i KE për shqetësimin për shkak të mosndëshkimit për krime të luftës në Kroaci [Briefing to the European Commission on the ongoing over impunity for war crimes in Croatia], Amnesty International, October 2011.

luftë të kryera gjatë dhe menjëherë pas aksionit të zhvilluar në vitin 1993 në Medaçki Xhep, jo larg Gospiqit, kurse Rrahim Ademi është liruar në bazë të fakteve të përcaktuara lidhur me zingjirin komandues paralel, të cilin e përbënin Davor Domazet, Zhelko Sačić dhe gjenerali i ndjerë Janko Bobetko, ende nuk është ngritur procedurë kundër Domazetit dhe Sačićit. Mate Laushiç, i cili gjatë luftës e ka ushtruar detyrën e Kryeshefit të Drejtorisë së Policisë, është i përfshirë në krime të luftës në burgjet ushtarake, *Lora* dhe *Kuline*, si dhe në krimet e kryera nga pjesëtarët e Policisë ushtarake pas *Olujes*.

Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Komiteti Qytetar për të Drejtat e Njeriut gjithashtu vlerësojnë se ka munguar ndjekja penale ndaj personave me përgjegjësi politike dhe ushtarake, sidomos në rastin e veprave penale kundër pjesëtarëve të grupit të pakicës nacionale. Këto shoqata joqeveritare theksojnë se si në lëndët kundër Rrahim Ademit dhe Mirko Noracit, pastaj kundër të akuzuarit Branimir Gllavashit është kombinuar baza ligjore nga neni 28 i KPPRK me elementet e përgjegjësisë së komanduesve ushtarakë për veprime të vartësve të vet, të përkufizuara me të drejtën ndërkombëtare, gjë që paraqet fillim të një praktike të re në krahasim me konceptin e përgjegjësisë komanduese.¹¹³

3.9. Viktimat e dhunës seksuale

AI e thekson papërshtatshmërinë e kornizës ligjore, arsye kjo përse dhuna seksuale nuk procesohet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën e gjykatave ndërkombëtare. Problemin kryesor e sheh në aplikimin e Ligjit themelor penal të vitit 1993, i cili parasheh që përdorimi i forcës duhet të dëshmohej si element i përdhunimit, gjë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare ekzistuese. Një praktikë e këtillë, sipas AI, kontribuon në mosndëshkimin për krime luftime të dhunës seksuale. AI tërheq vërejtjen se sipas standardeve të GJPNJ, viktimat e dhunës seksuale nuk duhet të dëshmojnë se i është kundërvënë në mënyrë aktive sulmuesit.

Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut kanë analizuar 17 lëndë, në të cilat janë akuzuar 28 persona, prej të cilëve vetëm një numër i vogël janë akuzuar vetëm për dhunim. Nga lëndët e analizuar, 27 janë viktimat e dhunimit/dhunës seksuale. Shoqatat e sipërpërmendura kanë vërejtur se si gjykatat në asnjë rast nuk i kanë aplikuar masat mbrojtëse të identitetit të viktimës – dëshmimi nga lokali tjetër përmes video linkut, ndryshimi i fytyrës dhe i zërit, përdorimi i pseudonimit etj. E vetmja gjë që është bërë është ajo që në disa lëndë, gjatë dëshmimit të viktimës, publiku është larguar nga seanca kryesore.¹¹⁴

3.10. Lirimi me kusht nga vuajtja e dënimit me burgosje

Shoqatat joqeveritare nuk kanë arritur të mbledhin të dhëna për numrin e të dënuarve për krime luftime e të liruar me kusht nga vuajtja e dënimit me burgosje, sepse Drejtoria për sistem të burgjeve e Ministrisë së Drejtësisë këto të dhëna i trajton si informata konfidenciale.¹¹⁵

3.11. Aktgjykimi i plotfuqishëm ndaj Branimir Gllavashit

Ndaj Branimir Gllavashit, i cili gjatë kohës së luftës ishte sekretar i mbrojtjes popullore dhe komandant i mbrojtjes së Osijekut, Kolegji i Apelit i Gjykatës së BdhëH, më 14 dhjetor të vitit 2010 nxori aktgjykim të plotfuqishëm, me të cilin i është konfirmuar dënimi me burgosje prej tetë vitesh të cilin tashmë ia kishte shqiptuar Gjykata e Qarkut – në Zagreb.¹¹⁶

113 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli qytetar për të drejta të njeriut, *Monitorimi i gjykimeve për krime të luftës - raporti për vitin 2011*.

114 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli qytetar për të drejta të njeriut, *Monitorimi i gjykimeve për krime të luftës - raporti për vitin 2011*.

115 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli qytetar për të drejta të njeriut, *Monitorimi i gjykimeve për krime të luftës - raporti për vitin 2011*.

116 Branimir Gllavashit është gjeneral luftime në pension, një nga themeluesit e HDZ-së, deputet në vazhdimësi i HDZ-së dhe i Lidhjes demokratike kroate për Slavoni dhe Baranjë (HDSSB) në të gjitha legjislaturat e deritashme të Kuvendit, dhe prefekt i Zhupanisë së Osijekut – Baranjës në dy mandate.

Sipas pikës një të aktakuzës në lëndën *Garazha*, Gllavash është dënuar për shkak të mosparandalimit të torturimit dhe të vrasjes së Çedomir Vučkovićit dhe të mosparandalimit të torturimit ndaj Nikolla Vasiqit. Në lëndën *Selote-ja* është gjykuar për shkak të urdhrin për arrest, kryerjes së torturimit dhe vrasjes së shtatë civilëve të kombësisë serbe, trupat e të cilëve janë hedhur në lumin Sava.

3.12. Procedura të reja penale

3.12.1. Aktakuza kundër Tomisllav Merçepit

Tomisllav Merçep, ish- deputet i Parlamentit, sekretar i mbrojtjes popullore në komunën e Vukovarit dhe këshilltar i ministrit të Punëve të Brendshme të Kroacisë gjatë viteve 1990 dhe 1991, është arrestuar në datën 10 dhjetor të vitit 2010, vetëm dy ditë pasi Amnesty International në raportin e vet kishte shfaqur shqetësimin për faktin se Vlladimir Sheks, Ivan Domazet Loshko dhe Tomisllav Merçep nuk janë procesuar për krime të luftës.¹¹⁷

Aktakuza është ngritur në datën 9 qershor të vitit 2011.¹¹⁸ Ajo e ngarkon atë se ai personalisht ka urdhëruar privime të kundërligjshme nga liria, torturime dhe vrasje të civilëve dhe, po ashtu, edhe pse e kishte ditur se vartësit e tij janë duke vepruar në mënyrë të paligjshme, ai këto veprime nuk i kishte parandaluar. Janë përfshirë vetëm krimet në rajonin e Kutinës, Pakracit dhe të Zagrebit, ku vartësit e tij në mënyrë të paligjshme kishin privuar nga liria 52 persona, prej të cilëve 43 i kishin vrarë, ndërsa tre persona evidentohen si të zhdukur. Gjithashtu, kjo njësi ka marrë pjesë në vrasjen e anëtarëve të familjes Zec.¹¹⁹

3.12.2. Aktakuza kundër Brodarcit, Millankovićit dhe Boshnjakut

Gjuro Brodarac¹²⁰, zyrtar i lartë i HDZ(BDK)-së, gjeneral në pension i Ushtrisë Kroate (UK)¹²¹, është paraburgosur në datën 20 qershor të vitit 2011 dhe është nxjerrë para gjyqarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Osijek me dyshimin se bashkë me Vlladimir Millankovićin dhe me Drago Boshnjakun¹²², gjatë viteve 1991 dhe 1992, në rajonin e Sisakut me rrethinë, në mënyrë të paligjshme ka burgosur dhe torturuar 69 civilë të kombësisë serbe, prej të cilëve 31 persona kanë vdekur.

Ndërkohë, në datën 13 korrik të vitit 2011, Gjuro Brodarac vdes nga pasojat e sepsës. PSHQ në Osijek ka ngritur më 16 dhjetor të vitit 2011 aktakuzë kundër Millankovićit dhe Boshnjakut për veprën penale të krimeve të luftës kundër civilëve dhe për krime të luftës kundër të burgosurve të luftës. Millanković akuzohet se ai e dinte, por nuk kishte parandaluar e as ndëshkuar pjesëtarët e njëjse vartëse për hyrje të paligjshme në banesa, arrestime dhe ndalime të paligjshme, si dhe për keqtrajtim të civilëve dhe për likuidimin e të paktën 24 personave. Aktakuza pohon se disa keqtrajtme të civilëve personalisht i ka urdhëruar dhe ka marrë pjesë në to. Drago Boshnjak në aktakuzë ngarkohet se ai ka organizuar dhe udhëhequr një grup të anëtarëve të „Vukovi“(Ujqit), i cili në mënyrë të paligjshme ka arrestuar, keqtrajtuar dhe ka kryer tetë vrasje. Numri i përgjithshëm i viktimave është reduktuar nga 31 viktima, sa figuronin në kërkesën për hetim nga qershori i vitit 2011, në 24 sish.

117 Informimi i KE për shqetësimin për shkak të mosndëshkimit për krime të luftës Kroaci [Briefing to the European Commission on the ongoing over impunity for war crimes in Croatia], Amnesty International, October 2011.

118 Gjykimi i Tomisllav Merçepit ka filluar në datën 10 shkurt të vitit 2012, në Gjykatën e Zhupanisë në Zagreb.

119 Vrasja e familjes Zec është kryer në dhjetor të vitit 1991, kurse kryerësit, të cilët jo shumë gjatë pas kësaj janë arrestuar, janë lëshuar në liri për shkak të gabimit procedural me rastin e marrjes së deklaratave nga kryerësit (deklaratat nuk i kishin dhënë në prani të avokatëve).

120 Gjuro Brodarac, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë kryeshef i Drejtorisë së policisë (DP) në Sisak, kryeshef i Shtabit komandues të zonës së Banisë-Kordunit dhe anëtar i Shtabit rajonal të krizave për Sisak dhe Bani, ka komanduar të gjitha njësitë aktive dhe rezervë në formacionin e DP-së në Sisak, të Mbrojtjes popullore dhe të formacionit mbrojtës të Njësisë së gardës popullore.

121 Ka ushtruar funksionin e deputetit të kuvendit, të prefektit të Zhupanisë së Sisakut-Moslavaçës, të kryetarit të Federatës Kroate të Futbollit dhe të këshilltarit qeveritar për deminin në Qeverinë e Ivo Sanaderit.

122 Vladimir Milanković ka qenë komandant i të gjitha njëjse aktive dhe rezervë në formacionin e DP në Sisak gjatë viteve 1991 dhe 1992, kurse Drago Boshnjak ka qenë pjesëtar i formacionit rezervë të DP në Sisak „Vukovi“(Ujqit).

3.12.3. Aktakuza kundër Aleksandar Vasileviqit dhe Miroslav Zhivanoviqit

Në muajin prill të vitit 2011, Prokuroria Shtetërore e Qarkut të Osijekut ka ngritur aktakuzë kundër Aleksandar Vasileviqit, kryeshefit të dikurshëm të Drejtorisë së Sigurimit të Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore, dhe kundër Miroslav Zhivanoviqit, nënkolonel i ish- APJ-së, për krime ndaj civilëve kroat dhe ndaj robërve në kampe në territorin e Republikës së Serbisë. Autoritetet e drejtësisë të Republikës së Kroacisë nuk kanë qasje ndaj këtyre të akuzuarve.

3.13. Aktgjykimi i shkallës së parë i Hagës ndaj gjeneralëve Gotovina dhe Markaç

GJPNJ në datën 15 prill të vitit 2011 ka nxjerrë Vendimin e shkallës së parë ndaj dy gjeneralëve kroat, Ante Gotovina dhe Mladen Markaç, me të cilin i ka shpallur persona me përgjegjësi komanduese për krime kundër njerëzimit në konfliktet e armatosura në Kroaci. GJPNJ ka konstatuar përgjegjësinë e gjeneralëve për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale gjatë dhe pas operacionit *Oluja*, i cili kishte për qëllim që me forcë dhe përgjithmonë të zhvendoste popullatën serbe nga rajoni i Krajinës së Kroacisë. Menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit, përfaqësuesit e autoriteteve kroate në paraqitjet dhe në deklaratat e tyre publike kanë refuzuar të pranojnë gjetjet e Gjykatës së Hagës, duke mohuar krimet e bëra nga ana e Forcave të Armatosura të Kroacisë.¹²³ Kryeministrja e Qeverisë, Jadranka Kosor, në mesin e përfaqësuesve të lartë të Qeverisë, publikisht ka deklaruar se aktgjykimi është i papranueshëm dhe se Kroacia duhet të krenohet me të gjithë ata që kanë marrë pjesë në operacion dhe kanë kontribuar për fitoren e Kroacisë¹²⁴. Kryetari i Partisë Social-demokrate (PSD), Zoran Milanoviç këtë aktgjykim e ka vlerësuar si politik.¹²⁵

Shpallja e aktgjykimit është shoqëruar nga komentime paushalle politike, ngritje e të gjykuarve në piedestalin e heronjve nacional, organizime të protestave mbështetëse anë e kënd Kroacisë, injorim të gjetjeve faktike dhe të viktimizeve, siç e kanë vlerësuar këtë Qendra për Paqe, Jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut, Dokumente dhe Këshilli Qytetar për të Drejta të Njeriut.¹²⁶

4. Serbia

Ligji për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore në procedurën për krime të luftës e ka vërtetuar kompetencën e më tepër organeve shtetërore në zbulimin dhe procesimin e kryerësve të krimeve të luftës.¹²⁷ Në bazë të këtij ligji, në datën 1 korrik të vitit 2003 është themeluar Prokuroria për Krime të Luftës e Republikës së Serbisë (PKL) pastaj, Shërbimi për Zbulimin e Krimeve të Luftës, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shërbimi për Ndihmë dhe Mbështetje për të Dëmtuarit dhe Dëshmitarët, në kuadër të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Qarkut në Beograd /të Gjykatës së Lartë në Beograd (i cili kryen punët administrative –teknike lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të të dëmtuarve), dhe Njësia e Posaçme e Paraburgimit, në kuadër të Burgut të Qarkut në Beograd.

Ky ligj aplikohet për të zbuluar dhe ndjekur penalisht kryerësit e veprave penale kundër njerëzimit dhe të së drejtës ndërkombëtare (kreu XVI i Ligjit themelor penal) dhe të veprave penale, të parapara me nenin 5 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Në nenin 3 të Ligjit është precizuar që organet shtetërore

123 "Presidenti Josipoviç dhe Kryeministrja Kosor të shokuar me aktgjykimin ", faqja e internetit *Večernji list*, 15 prill i vitit 2011, <http://vecernji.hr/vijesti/predsjednik-josipovic-premierka-kosor-sokirani-presudama-clanak> - 276870.

124 „Aktgjykimi i papranueshëm“, faqja e internetit *Tportal*, 15 prill i vitit 2011, <http://www.tportal.hr/vijesti/hrvatska/122662/aktgjykim> Aktgjykimi i papranueshëm.

125 „Aktgjykimi është politik“, faqja e internetit *Dalmacija News*, 15 prill i vitit 2011. <http://dalmacijanews.com/vijesti/Milanovic-aktakuza> - <http://dalmacijanews.com/vijesti/Milanovic-optuznica-protiv-Gotovine-politicka-inkriminacija>.

126 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Këshilli Qytetar për të Drejta të Njeriut –*Monitorimi i gjykit për krime të luftës – raporti për vitin 2011*.

127 Ligji për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore në procedurën për krime të luftës „*Službeni glasnik Republike Srbije*“(Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë) Nr. 67/2003, 135/2004, 61/2005, 101/2007 dhe 104/2009.

të Republikës së Serbisë janë kompetente për zhvillimin e procedurës për veprat penale të sipërpërmendura, të kryera në territorin e ish RSFJ-së, “pavarësisht nga shtetësia e kryerësit apo e viktimës”.¹²⁸ Ekzistojnë mendime se Republika e Serbisë po keqpërdor institutin e kompetencave universale në mënyrë që me aktakuza dhe gjykime ndaj shtetasve të huaj [shtetasve të shteteve trashëgimtare të RSFJ-së] të korrigojë “të vërtetën e Hagës”.

Sikurse në Kroaci, në Mal të Zi dhe në Kosovë, organet gjyqësore të Republikës së Serbisë aplikojnë Ligjin Penal të RSFJ-së.¹²⁹

Kodi penal i Republikës së Serbisë përcakton dënimin me burgim (6 muaj) dhe gjobën për çdo person „i cili deri sa zgjatë procedura para gjykatës, para nxjerrjes së vendimit gjyqësor të plotfuqishëm, me qëllim të cenimit të supozimit të pafajësisë ose të pavarësisë së gjykatës, jep deklarata në mjetet e informimit publik.”¹³⁰

Ligji për Procedurën Kontestimore i Republikës së Serbisë ua kufizon qasjen ndaj drejtësisë individëve, organizatave, autoriteteve të pavarura, asociacioneve dhe mediave. Me nenet 499 dhe 500, ligjvënësi kërcënon me gjoba të larta secilin person që do të donte të shprehte qëndrimin kritik për çështjet publike.¹³¹

Për të proceduar në lëndët e veprave penale, të cilat i parashikon ligji, kompetent është Departamenti për Krime të Luftës i Gjykatës së Lartë në Beograd, në shkallë të parë, kurse në shkallë të dytë, Gjykata e Apelit në Beograd.

4.1. Kapacitetet¹³²

Prokurorin për krime të luftës e emëron Kuvendi i Republikës së Serbisë dhe mandati i tij është gjashtë vjet. Që nga themelimi i PKL në këtë funksion është Vladimir Vukçevići. Zëvendësprokurorët i zgjedh vetë Prokurori, në periudhë prej katër vjetësh. Prokurori për krime të luftës ka tetë zëvendës prokurorë.¹³³

Departamenti për Krime të Luftës ka dy kolegje gjyqësore, të cilat gjykojnë në shkallë të parë, në përbërje prej tre anëtarësh. Gjithsej shtatë gjykatës për krime të luftës gjykojnë në procedurën e shkallës së parë¹³⁴. Gjykata e Apelit në Beograd ka kolegjin për krime të luftës të cilin e përbëjnë tre gjykatës. Nëse procedura në shkallë të parë është zhvilluar para Gjykatës së Lartë jashtë Beogradit, në atë rast procedura në shkallë të dytë zhvillohet para Gjykatës së Apelit me kompetencë territoriale.

128 *Po aty*.

129 Nga data 15 janar e vitit 2012 implementohen dispozitat e Kodit të ri për procedurën penale të Republikës së Serbisë, me të cilat në lëndët e krimeve të luftës është aplikuar hetimi prokurorial dhe instituti i pranimit të fajësisë. Me Kodin e ri vendoset monopoli i avokatit në përfaqësimin e interesave të viktimave dhe heqet e drejta e tyre që për vete të zgjedhin përfaqësuesin, i cili nuk është avokat. Me këtë, në lëndët e krimeve të luftës, ekspertëve për të drejta të njeriut /mbrojtësve të të drejtave të njeriut iu është pamundësuar për të përfaqësuar viktimat e krimeve të luftës, përveç nëse nuk janë avokat. Kodi i procedurës penale, *Službeni glasnik Republike Srbije*, (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë) Nr. 72/2011.

130 Kodi penal i Republikës së Serbisë, neni.336a, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 72/2009.

131 Ligji për procedurën kontestimore, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 72/201, është duke u implementuar nga data 1. 02. 2012.

132 Njëpërmjet projektit „Drejtësia dhe krimet e luftës“, të cilin gjatë viteve 2010-2011 e ka implementuar OSBE-ODIHR bashkë me misionin e OSBE-së në Serbi dhe të cilin e financon BE-ja, gjatë periudhës prej më shumë se një viti janë punësuar 12 bashkëpunëtorë (në pozitë të juristëve, analistëve dhe të bashkëpunëtorëve) në Prokurorinë për krime të luftës, nga të cilët pas përfundimit të projektit në tetor të vitit 2011, gjashtë prej tyre kanë vazhduar të punojnë në këtë institucion. Janë të punësuar edhe tetë bashkëpunëtorë profesional (juristë) në departamentet për krime të luftës të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit në Beograd, prej të cilëve, pas përfundimit të projektit, pesë prej tyre kanë mbetur në marrëdhënie të përhershme pune. Gjatë periudhës së viteve 2010 dhe 2011, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Sundimin e Ligjit i Misionit të OSBE-së në Serbi, njëpërmjet punës së Sektorit për Krime të Luftës, dhe projekti i sipërpërmendur i OSBE/ODIHR kanë organizuar vizita studimore-pune për 13 gjykatës për krime të luftës (nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit) në Tribunalin e Hagës, si dhe trajnime, të zhvilluara disa herë - në Beograd dhe në Hagë, nga lëmi i të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe i të drejtës penale ndërkombëtare dhe i praktikës e i përvojave të punës së GJPNJ për 15 bashkëpunëtorë profesional nga Prokuroria dhe nga Departamenti për Krime të Luftës.

Komunikimi me email me Ivan Jovanovićin, shef i Sektorit për krime të luftës i OSBE-së në Beogradu, 21 dhjetor i vitit 2012.

133 Komunikimi me email me PKL, i datës 23 dhjetor të vitit 2011.

134 Informacion i marrë nga Gjykata e Lartë në Beograd, i datës 10 shkurt të vitit 2012.

Në një numër më të vogël, gjykimet për krime të luftës mbahen edhe para gjykatave me kompetencë të përgjithshme. Këto gjykime kanë filluar para formimit të PKL në të ashtuquajturat gjykata të zhvendosura nga Kosova, të cilat mbanim emërtimet e gjykatave në Kosovë, nën kompetencat e UNMIK-ut. Në ato gjykata kanë qenë të punësuar prokurorët dhe gjykatësit, të cilët para muajit qershor të vitit 1999 kanë punuar në organet e drejtësisë në Kosovë. Pas heqjes së këtyre gjykatave, lëndët e krimeve të luftës iu janë transferuar gjykatave të larta në Nish, në Krlevë, në Pozharevc dhe në Prokuplje.

4.2. Statistika

Që nga themelimi i Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë aktgjykime të plotfuqishme për 23 lëndë kundër 54 personave dhe aktgjykime të shkallës së parë për pesë lëndë kundër 17 personave. Janë ngritur gjithsej 145 aktakuza, kurse hetimet janë duke u zhvilluar edhe për 100 persona.¹³⁵

Në vitin 2010, PKL ka ngritur nëntë aktakuza kundër 32 personave, dhe në vitin 2011 – nëntë aktakuza kundër 55 personave.¹³⁶ Nga këto, aktakuza kundër tre personave në lëndën *Bijelina* është hapur procedurë e re, ndërsa aktakuzat kundër gjashtë të akuzuarve kanë dalë nga dy lëndë të cilat janë duke u zhvilluar para kolegjeve gjyqësore të Departamentit për krime të luftës.¹³⁷

Hetimet zgjasin shumë. Në lidhje me krimet masive të kryera në BKN të Dubravës në Kosovë, PKL ka filluar të veprojë në vitin 2008, por deri në fund të vitit 2011 nuk ka hapur ndonjë hetim. Në lëndët e krimeve të luftës të kryera në Kosovë, PKL shpesh ngre aktakuza në bazë të hetimeve të kryera pjesërisht, si në rastin e një aktakuze për krime luftime në Suharekë, e cila është ngritur për krimet e kryera në datën 26 mars të vitit 1999, edhe pse të njëjtat njësi të policisë serbe në këtë qytet, edhe në datën 22 dhe 25 mars të vitit 1999 kishin vrarë civilët shqiptarë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për hetimin e krimeve të luftës në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, të kryera në datën 14 maj të vitit 1999. PKL, në vitin 2010 ka ngritur aktakuzë për krime të luftës të kryera në fshatin Qyshk, duke paralajmëruar zgjerimin e hetimeve, gjë që nuk ka ndodhur deri në fund të vitit 2011. Praktikë e PKL është që të ndryshojë aktakuzën në prag të nxjerrjes së aktgjykimit, duke zvogëluar përgjegjësinë e të akuzuarve në pozita komanduese, si në rastin e të akuzuarit, komandantit të Detashmentit 37 të NJPP të MPB të Serbisë Radoslav Mitroviq dhe të të akuzuarit Branko Grujiq, kryetarit të dikurshëm të Komunës së Zvornikut.

Departamenti për Krime të Luftës i Gjykatës së Lartë në Beograd (në tekstin e mëtejme Departamenti për Krime të Luftës), në vitin 2010 ka nxjerrë nëntë aktgjykime të shkallës së parë, me të cilat 13 të akuzuar janë dënuar dhe një është liruar nga përgjegjësia penale. Gjykata e Apelit në Beograd ka nxjerrë shtatë aktgjykime, me të cilat 21 të akuzuar janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme, tre janë liruar nga akuzat kurse në lidhje me pesë të akuzuar ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer për rigjykim. Në rastin Tuzlanska kolona, Gjykata e Apelit në Beograd ka hapur shqyrtimin dhe, pas dëgjimit të dëshmitarëve të mbrojtjes, lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim para një kolegji të ri. Në rastin e Suharekës, Gjykata e Apelit ka konfirmuar aktgjykimin dhe dënimin me burgosje prej 20 vjetësh për të akuzuarin Repanoviç, ish-komandantin e stacionit policor të Suharekës në Kosovë.

Në vitin 2010, shumica e rasteve para kolegjeve gjyqësore të Departamentit për Krime të Luftës kanë të bëjnë me krime të luftës kundër civilëve kroat në konfliktet e armatosura në Kroaci, të cilat Ministria e Drejtësisë ia ka ceduar Prokurorisë për Krime të Luftës të Republikës së Serbisë, për shkak se të dyshuarit nuk janë në dispozicion për organet policore dhe gjyqësore të Republikës së Kroacisë [janë me qëndrim në Serbi].¹³⁸ Një lëndë, Ministria e

135 Komunikim me email me PKL i datës 23 dhjetor të vitit 2011. Të gjitha të dhënat janë vërtetuar në shumë intervista me zëvendësprokurorin për krime të luftës, Bruno Vekariqin gjatë muajit marsit të vitit 2012.

136 Komunikim me email me PKL i datës 23 dhjetor i vitit 2011.

137 Lëndët *Skoçiq* dhe *Qyshk*.

138 Lëndët janë dërguar në bazë të Marrëveshjes mbi ndjekjen e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës, të nënshkruar midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kroacisë, 2006.

Drejtësisë e BdhëH ia ka ceduar Prokurorisë për Krime të Luftës, kurse një procedurë tjetër, gjithashtu për krime të luftës në Bosnje, e ka filluar në bazë të një marrëveshjeje të Prokurorisë për krime të luftës dhe Gjykatës Supreme të Republika Srpskës, e cila kishte nxjerrë aktgjykimin ndaj të akuzuarit (i cili është me qëndrim në Serbi) në mungesë. Gjashtë lëndë, të marra nga Republika e Kroacisë, kanë përfunduar në vitin 2010, si edhe dy lëndë nga BdhëH. Bëhet fjalë për lëndët me më pak viktime.

Në vitin 2011, para Departamentit për Krime të Luftës janë zhvilluar 13 procedura. Në gjashtë lëndë janë nxjerrë aktgjykimet me të cilat janë dënuar 17 të akuzuar dhe dy janë liruar nga përgjegjësia penale, kurse shtatë procedura të tjera janë në zhvillim e sipër. Gjykata e Apelit në Beograd, në vitin 2011 ka marrë një 11 vendim lidhur me ankesat e paraqitura kundër aktgjykimeve të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, me të cilat janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme 12 akuzuar, kurse ndaj 15 të akuzuarve i ka anuluar aktgjykimet e shkallës së parë dhe lëndët i ka kthyer për gjykim të përsëritur.

Gjatë vitit 2011, nga gjithsej 20 procedura para Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd dhe Gjykatës së Apelit në Beograd, Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) shtatë lëndë ia ka ceduar PKL të Republikës së Serbisë¹³⁹, kurse dy organeve të drejtësisë të Republika Srpska- BdhëH.¹⁴⁰

Në vitin 2010 dhe 2011, për krime të luftës dhe për vepra penale të motivuara etnikisht, e të kryera gjatë konflikteve të armatosura në Kosovë, janë zhvilluar gjykimet edhe para gjykatave me kompetenca të përgjithshme në Nish, Pozharevc, Kralevec dhe në Sremska Mitrovicë. Për procedurat para këtyre gjykatave është karakteristike se zgjasin mbi 10 vjet, se gjykatësit anojnë nga të pandehurit, se paraqitjet joadekuate të mbrojtësve kalojnë pa u dënuar, se zhvillohen pa prezencën e viktimave të mbijetuara dhe të të dëmtuarve, dhe pa praninë e publikut¹⁴¹.

4.3. Dënimet e ulëta

Sikurse edhe në vitin 2010, Gjykata e Apelit në Beograd, edhe në vitin 2011 i ka konfirmuar dënimet e ulëta me burgim të cilat i kishte shqiptuar Departamenti për Krime të Luftës i Gjykatës së Lartë në Beograd.¹⁴²

317

Shembulli më negativ është lënda Zvorniku II, në të cilën i akuzuari Branko Popoviq është dënuar me burgim prej 15 vjetësh, ndërsa i akuzuari Branko Grujiq me burgim prej 6 vjetësh. Duke pasur parasysh se këta të dy, në kohën e krimit, si përfaqësues të autoriteteve civile dhe ushtarake në komunën e Zvornikut, për nga natyra e funksioneve të tyre kishin përgjegjësinë më të madhe, se kanë qenë pjesëmarrës aktiv në zbatimin e planit, madje edhe organizatorë të dëbimit të popullsisë myslimane nga territori i komunës së Zvornikut, se kjo është vetëm një nga 5 procedurat e ngritura dhe të zhvilluara për krime të luftës të kryera në Zvornik dhe se krimet e kryera që janë lëndë e procedurave të mbetura janë pasojë e rrethanave dhe e kushteve të krijuara nga aktivitetet e të dënuarve Grujiq dhe Popoviq –lartësia e dënimeve, që iu janë shqiptuar, është tejet joadekuate.¹⁴³

4.4. Gjykimet në proces për krime të luftës

4.4.1. Rasti Lovas

Gjykimet ndaj përfaqësuesve të pushtetit serb në fshatin Lovas, në Republikën e Kroacisë, në periudhën tetor – nëntor të vitit 1991, Luban Devetakut, Milan Devçiqit, Milan Radojçiqit dhe Zheljko Kërnjajiqit, ndaj oficerëve të ish-APJ-së, Miodrag Dimitrijeviqit, Darko Periqit, Radovan Vlajkoviqit dhe Radosav Josipoviqit, si dhe ndaj

139 Lëndët *Stara Gradishka*, *Vukovar*, *Lički Osik*, *Tenja*, *Medak*, *Banski Kovačevac* dhe *Beli Manastir*.

140 Lëndët *Bijelina* dhe *Prijedor*.

141 Për këto gjykime nuk ka informacion publik.

142 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gjykimet për krime të luftës dhe për vepra penale etnikisht të motivuara në Serbi në vitin 2010*. – *Raport*, f. 7.

143 Përveç procedurës së lartpërmendur, në formë të plotëfuqishme ka përfunduar procedura në lëndën *Zvornik I*, kurse në zhvillim e sipër janë procedurat në lëndët *Zvornik III* dhe *IV*, si dhe në lëndën *Skoçiq*.

pjesëtarëve të Njësisë vullnetare „*Dušan Silni*“ (*Dushani i fuqishëm*), Sasha Stojanoviçit, Dragan Baçiqit, Jovan Dimitrijeviçit, Zoran Kosijerit, Petronije Stevanoviçit dhe Aleksandar Nikolaidisit për krime të luftës ndaj civilëve kroat, ku janë vrarë 69 kroat, banorë të atij fshati, ka filluar në datën 17 prill të vitit 2008, para kolegjit gjyqësor, të cilin e kryeson gjykatësja Olivera Angjelkoviç¹⁴⁴.

Deri në fund të vitit 2011 janë mbajtur gjithsej 167 ditë gjykimi. Gjykata ka marrë në pyetje 192 dëshmitarë, në mesin e të cilëve 32 të dëmtuar nëpërmjet lidhjes video-konferencore nga gjykatat e qarkut në Kroaci, dhe shtatë oficerë të ish APJ-së, të cilët në kohën e krimeve të luftës mbanin pozita komanduese, dhe që dinin për ngjarjet, por nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar krimet e as për të ndëshkuar kryerësit. Pesë dëshmitarë i ka propozuar FDH, përfaqësuesit e të cilëve i kanë përfaqësuar të dëmtuarit. Gjykimin rregullisht e kanë përcjellë shtatë anëtarë të familjeve të të dëmtuarve, të organizuar nga FDH. Është fjala për gjykimin e parë ndaj oficerëve të ish APJ-së. Me aktakuzë nuk janë përfshirë oficerë të rangut të lartë të lartë të ish-APJ-së, për përgjegjësinë e të cilëve padyshim flasin provat e administruara gjatë procedurës së provave.

4.4.2. Rasti *Skoçiq*

Në bazë të kallëzimit penal që e ka paraqitur FDH¹⁴⁵, PKL, në datën 30 prill të vitit 2010 ka ngritur aktakuzë kundër Simo Bogdanoviçit, Damir Bogdanoviçit, Zoran Stojanoviçit, Tomisllav Gavriçit, Gjorgje Sheviçit dhe Zoran Aliqit, pjesëtarë të Njësisë vullnetare „*Simini četnici*“ (Çetnikët e Simës) për shkak të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 paragrafi 1 LP të RFJ-së, në bashkëkryerje në lidhje me nenin 22 KP të RFJ-së.

Të akuzuarit ngarkohen për shkak se nën komandën e të akuzuarit Simo Bogdanoviç, në datën 12 korrik të vitit 1992 në fshatin *Skoçiq*, komuna e *Zvornikut* në *BdheH*, në një shtëpi të zbrazët kishin mbledhur 27 romë, në mesin e të cilëve kishte fëmijë, gra dhe meshkuj të rritur, të cilëve ua kanë marrë të gjitha gjërat e vlefshme, e më pas i kanë rrahur me duar, me shqelma, me kondakët e pushkëve dhe me objekte të tjera, një mashkull e kanë vrarë, disa i kanë urdhëruar të zhvishen dhe të bëjnë seks oral me njëri-tjetrin, edhe pse ata ishin kushëri të afërt dhe të largët, tri vajza, dy prej të cilëve ishin të mitura, i kanë dhunuar disa herë, dhe pastaj të gjithë me kamion i kanë dërguar në fshatin fqinj *Maleshiq*. Në *Maleshiq* i kanë ndarë tri vajza, të cilat në vijim i kanë shfrytëzuar seksualisht dhe i kanë detyruar të punojnë si skllave pune. Të tjerët i kanë dërguar deri te shpella në lagjen *Hamziq* dhe pas kësaj i kanë nxjerrë një nga një nga automjeti dhe i kanë vrarë me armë zjarri dhe duke përdorur thika, kurse kufomat i kanë hedhur në greminë. Në këtë vend ata i kanë vrarë 22 persona, përfshirë një grua në shtatzëni të dukshme dhe kanë plagosur të dëmtuarin *Zija Ribiqin*, i lindur më 16.02. 1984, i cili është i vetmi i mbijetuar, edhe pse ata e kanë qëlluar dhe therë me thikë, dhe pastaj e kanë hedhur në greminë.

Për të njëjtin krim, Prokuroria për krime të luftës, në datën 23 shkurt të vitit 2011 ka ngritur aktakuzë kundër Zoran Aliqit, dhe kështu procedura kundër tij është bashkuar me procedurën kundër të akuzuarit Simo Bogdanoviç dhe të tjerëve. Nga fundi i vitit, në datën 22 dhjetor të vitit 2011, Prokuroria për Krime të Luftës, për të njëjtën veprë penale ka akuzuar Zoran Gjurgjeviçin dhe Dragan Gjekiçin, gjithashtu pjesëtarë të grupit vullnetar „*Simini četnici*“.¹⁴⁶

Si edhe në lëndët e tjera, edhe në këtë procedurë dëshmitarët e nacionalitetit serb nuk dinë asgjë për vrasjen e fqinjëve. Një dëshmitar ka refuzuar kategorikisht çdo mundësi që kurrë ndonjë herë ndonjë fqinji mysliman t'i ketë thënë se “çetnikët kanë vrarë romë”, i cili në seancën kryesore gjyqësore ka përshkruar në detaje disa situata në të cilat ata kanë folur në lidhje me krimin kundër romëve.

144 Prokuroria për Krime të Luftës e Republikës së Serbisë ka ngritur aktakuzën në datën 28 nëntor të vitit 2007.

145 FDH, në vitin 2008 ka paraqitur në PKL kallëzim penal kundër Simo Bogdanoviçit dhe të tjerëve për shkak të veprës penale të krimit të luftës kundër popullatës civile, të cilit i ka bashkëngjitur edhe deklaratën e të vetmit të mbijetuar – të të dëmtuarit *Zija Ribiq*.

146 Kundër Zoran Gjurgjeviçit para të së njëjtës gjykatë, sipas aktakuzës së PKL, të datës 5 qershor të vitit 2011 në lëndën *Bijelina*, është duke u zhvilluar procedura për shkak të veprës penale të krimit të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, paragrafi 1 i LP të RFJ lidhur me nenin 22 të LP të RFJ.

Tri dëshmitare të mbrojtura kanë dëshmuar nga dhoma të tjera dhe me pseudonime. Përvojat e tyre janë të dhimbshme edhe për shkak se atyre kurrë askush nuk iu ka ofruar përkrahje profesionale e as përkrahje në lidhje me gjykimin. Një viktimë ka pasur përvojë të keqe edhe me shërbimin gjyqësor për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në hotel, ku ajo ka qëndruar si dëshmitare e mbrojtur, nuk ka pasur drekë, sepse shërbimi gjyqësor e kishte rezervuar dhomën vetëm me mëngjes.

4.4.3. Rasti i Qyshkut

Me aktakuzën e PKL të datës 10 shtator të vitit 2010 të akuzuarve iu është vënë në barrë se gjatë kohës së konflikteve të armatosura midis forcave të RFJ – UJ/MPB-së së RS, nga njëra anë, dhe koalicionit të forcave të NATO-s dhe pjesëtarëve të UÇK-së, nga ana tjetër, me qëllim të dëbimit të popullatës shqiptare, vendosjes së kontrollit të plotë mbi tërë territorin e Kosovës dhe krijimit të zonës etnikisht të pastër, kanë urdhëruar dhe në datën 14 maj të vitit 1999 kanë kryer sulm të armatosur ndaj popullatës civile të fshatit Qyshk. Me atë rast kanë kryer vrasje individuale dhe grupe, kanë zbatuar masa të frikësimit dhe të terrorit, me djegien dhe me shkatërrimin e shtëpive, objekteve përcjellëse dhe të automjeteve. Nga jeta janë privuar gjithsejtë 44 civil dhe janë shkatërruar më shumë se 40 shtëpi familjare dhe më shumë se 40 objekte përcjellëse, 3 kamionë, 5 automjete të udhëtarëve dhe 3 traktorë. E kanë përvetësuar pronën e civilëve shqiptar duke ua marrë paratë atyre (gjithsejtë më shumë se 125.000 DM), stolitë dhe gjërat e tjera me vlerë në vlerë të pavërtetuar dhe ua kanë marrë edhe shumë automjete të udhëtarëve si dhe dy kamionë, pa nevojë të arsyetuar ushtarake. E kanë kryer edhe shpërnguljen e popullatës civile të mbijetuar me qëllim që ajo të shpërngulet në Republikën e Shqipërisë, duke dëbuar, në këtë mënyrë, nga fshati Qyshk më shumë se 400 gra, fëmijë e pleq. Për këto vepra janë akuzuar Toplica Milladinoviçi, komandant i MTU 177 Pejë, i ndjeri Nebojsa Miniç, komandant i togut të parë 177 i MTU, i quajtur *Shakali*, si dhe pjesëtarët e kësaj njësie, Sreqko Popoviçi, Sllavisha Kastratoviçi, Zvonimir Cvetkoviçi, Boban Bogiqeviçi, Ranko Momiçi, Zoran Obradoviçi, Miloško Nikoliçi, Sinisha Mishiçi, Sinisha Dungjer dhe Predrag Vukoviçi, si dhe pjesëtarët e formacionit rezervë dhe aktiv të policisë, midis të cilëve edhe Vidoje Koriqanini dhe Radoslav Brnoviçi, të cilët vullnetarisht i janë bashkëngjitur njësisë *Çakallët (Šakali)*.

PKL ka hequr dorë nga ndjekja penale e Sasha Xhudoviçit, pjesëtarit të grupit operativ-ndjekës (GON), dhe Vidoje e Zoran Jashoviçit, banor i Qyshkut, i kombësisë serbe, dhe gjykata, në datën 2 shtator të vitit 2011 lidhur me ta, me vendim, e ka ndërprerë procedurën.

Gjatë procedurës së provave, tek dëshmitarët nga radhët e MPB-së së Serbisë dhe të UJ posaçërisht ka rënë në sy „kujtesa afatshkurtër“, frika dhe dëshira që të shmanget çfarëdo mundësie e përfshirjes personale dhe të përgjegjësisë eventuale për krimet e kryera. Kjo posaçërisht ka qenë e dukshme tek dëshmitari Borissllav Vllahoviçi, ish kryeshefit të SPB-së së Pejës, Miliçko Jankoviçi, ish komandantit të batalionit të blinduar të brigadës së motorizuar 125 të UJ dhe Dushko Antiçi, ish komandantit të Departamentit Ushtarak të Pejës.

Dëshmitari më i rëndësishëm dhe më i bindshëm është padyshim dëshmitari i mbrojtur PS - Zoran Rashkoviçi. Në fillim të dëshmisë së tij gjashtë ditore, në dhjetor të vitit 2011, Zoran Rashkoviçi ka kërkuar që të dëshmohej pa masa të mbrojtjes, me emër dhe mbiemër të plotë me arsyetimin se dëshiron t'i shoh të akuzuarit në sy dhe t'iu thotë të gjithëve se çka mendon për ta dhe krimet të cilat i kanë kryer. Dëshmitari në mënyrë të gjallë ka shpjeguar se në datën 14 maj të vitit 1999, komandanti i njësisë, i ndjeri Nebojsa Miniç, e ka urdhëruar lëvizjen me fjalët që të shkojnë për "gjueti në gjermanët". Dëshmitari posaçërisht e ka theksuar se në atë moment në fshatin Qyshk nuk ka pasur "terroristë" dhe as që dikush ka shtënë në ta. Gratë, fëmijët dhe pleqtë janë mbledhur në qendër të fshatit dhe, sipas fjalëve të dëshmitarit, „ka filluar beteja“. Në momentin kur kanë arritur në fshat, ai e ka parë se si i akuzuari Sokiç i ka vrarë dy shqiptarë, të cilët janë nisur drejt tyre dhe i kanë pyetur „a keni nevojë për diçka“. Pak më vonë e ka parë të akuzuarin Popoviç se si i pushkaton tre shqiptarë para një shtëpie, kurse i ka parë edhe 25 burra të cilët qëndronin në rresht në skajin tjetër të fshatit dhe pas kësaj i ka dëgjuar të shtënat. Dëshmitari e ka parë të akuzuarin Momiç, Nikoliç dhe Magja Vukoviçin se si i fusin 15 shqiptarë në një shtëpi, kur nga e njëjta janë dëgjuar rafalet. Pasi që pjesëtarët e njësisë *Çakejtë* ua kanë marrë paratë dhe gjërat e tjera me vlerë, civilët shqiptarë kanë qenë të detyruar të paketojnë gjërat nëpër traktorë dhe automjete të tjera e ta braktisin fshatin. Nga

fshati Qyshk *Çakejtë* janë drejtuar në fshatin Pavlan, ku, në hyrje të vet fshatit, e takojnë një shqiptar, në të cilin, i akuzuari Popoviç, duke i thënë fjalët „Për Serbinë“, ka shtënë në kokë.

Në të njëjtin fshat, i akuzuari Momiç e dhunon dhe vret një shqiptare, për të cilën dëshmitari pandeh se ka qenë shtatzënë. Pas 40 minutash e lëshojnë fshatin Pavlan dhe arrijnë në fshatin Zahaq, ku prapë ndahen në më shumë grupe, hyjnë nëpër shtëpi, plaçkitin, vrasin, i djegin shtëpitë dhe e dëbojnë popullatën në të cilën hasin¹⁴⁷. Duke reaguar në dëshminë e tij, i akuzuari Mishiq e ka quajtur dëshmitarin „Vuk Branković“. Dëshmitari i është përgjigjur se gjithmonë do të jetë tradhtar i një serbi të tillë.

Seancën gjyqësore kryesore të vitit 2011 e kanë karakterizuar veprimet joprofesionale të mbrojtësve, të cilët, në të gjitha mënyrat, kundër ligjit dhe kodeksit profesional të etikës së avokatit, janë përpjekur për të kundërshtar të drejtën e të autorizuarve të plotfuqishëm të të dëmtuarve për të marrë pjesë në procedurë.¹⁴⁸

Kryetarja e trupit gjykues, gjykatësja Snezhana Garotiq-Nikoliç me një udhëheqje të mirë dhe të sigurt, e ka parandaluar pengimin e procedurës.

Për të njëjtën ngjarje, prokuroria suedeze, në datën 11 shtator të vitit 2011, e ka ngritur aktakuzën kundër Miliç Martinoviçit, pjesëtarit të Grupit Operativ-Ndjekës të Njësisë të Posaçme të Policisë (GONNJPP) të MPB-së së Republikës së Serbisë, me të cilat ka komanduar Goran Radosavljeviç i quajtur Guri, për krime kundër njerëzimit. Në seancën kryesore gjyqësore, para Gjykatës së Qarkut në Stokholm, kanë dëshmuar zëvendësi i prokurorit për krime të luftës i Republikës së Serbisë, Dragoljub Stankoviç, me ftesë të mbrojtjes së të akuzuarit Martinoviç, dhe Natasha Kandiç, në cilësinë e ekspertes për të drejtat e njeriut, me ftesë të Prokurorisë.

4.5. Përgjegjësia komanduese

FDH ka pasur vërejtje serioze lidhur me lartësinë dënimeve të personave të dënuar me aktgjykime të plotfuqishme në lëndën *Zvornik II*,¹⁴⁹ duke vënë në pah se gjykata është dashur të ketë parasysh pozicionet e të akuzuarve, Branko Grujiçit, ish kryetarit të komunës së Zvornikut (BdheH) dhe Branko Popoviçit, ish komandantit të MT të komunës së Zvornikut, para së gjithash, sepse në atë komunë, nën kontrollin e tyre kanë ndodhur krimet,¹⁵⁰ pesha e të cilave i përgjigjet krimeve kundër njerëzimit, të cilat nuk i sanksionon Ligji Penal i SFRJ/RFJ, të cilin e zbatojnë organet gjyqësore në Serbi.

Në raportin e vet mbi gjykimet për krime të luftës në vitin 2011, FDH e thekson dënimin me burgosje në kohëzgjatje prej 15 vitesh për të gjykuarin Branko Popoviçin, kurse për të gjykuarin Branko Grujiçin dënimi me burgosje në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh kurrësi nuk mund të vlerësohet si vendim i cili është në përputhje me peshën e krimit të kryer, sepse gjykata është dashur ta ketë parasysh institutin e përgjegjësisë komanduese, edhe pse nuk ka mundur ta zbatojë. Veprimet e të akuzuarve, të cilat përbëjnë vrasje, torturime, sjellje çnjerëzore, lën-

147 Krimet e kryera në Pavlan dhe Zahaq nuk janë përfshirë në aktakuzë. FDH ka ngritur akuzë për krime të luftës në fshatrat e përmendura, si dhe kërkesën për zgjerimin e hetimeve, por deri në fund të vitit 2011, PKL nuk i ka filluar hetimet.

148 Në emër të FDH-së, të autorizuar të plotfuqishëm të të dëmtuarve kanë qenë Natasha Kandiç, avokati Mustafë Radoniç dhe Sllavica Jovanoviç. Ashtu siç e thekson FDH në raportin e vet mbi gjykimet për krime të luftës në vitin 2011: „Edhe pse për këtë nuk kanë pasur bazëshmëri ligjore, kanë insistuar që të autorizuarve të plotfuqishëm t’iu pamundësohet përfaqësimi i mëtejme i të dëmtuarve. Duke bërë pyetje lidhur me profesionalizmin e tyre, janë përpjekur për ta nënvlerësuar punën e tyre, kanë kërkuar që t’iu kufizohet e drejta e shkrimit të pyetjeve, dhe madje edhe ka pasur fjalë të pahijshme, duke u shërbyer me gjuhën vulgare dhe me fyerje. Sjellja e këtyllë e mbrojtësve ka nxitur të autorizuarin e plotë të të dëmtuarve, avokatin Mustafë Radoniç, të thotë se si ai ndjen armiqësi nga ana e kolegëve të tij. Po ashtu, kanë qenë të dukshme edhe përpjekjet e mbrojtësve të caktuar që me futjen e politikës në këtë procedurë, ta zhvendosin fokusin e vëmendjes nga krimet e rënda dhe ta shndërrojnë gjykatoren në një poligon për mbrojtjen e interesave kombëtare“. Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Serbi në vitin 2010 – Raport*, f. 101-102.

149 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Serbi në vitin 2010 – Raport*, f. 10.

150 Gjykata e Apelit në Beograd ka shpallur në datën 3 tetor të vitit 2010 aktgjykimin e plotfuqishëm për të akuzuarit Branko Grujiçin dhe Branko Popoviçin për marrjen e pengjeve, vrasjen e më shumë se 700 myslimanëve dhe deportimin e 1.800 myslimanëve. *Po aty*.

dime të integritetit trupor, shpërngulje të dhunshme, marrje të pengjeve, privim nga e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, plaçkitje të pronës së popullatës¹⁵¹, në rrethanat e cekura dhe në mënyrën e vërtetuar përbëjnë dëbim si forma më e rëndë e krimit kundër njerëzimit, që, fatkeqësisht, nuk është i paraparë me ligjin vendor penal.

5. Kosova

Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës ka miratuar katër ligje, të cilat përmbajnë masa për përforcimin e pavarësisë së gjykatave: Ligjin mbi Gjykatat, Ligjin mbi Prokurorin Shtetëror, Ligjin mbi Këshillin Juridik të Kosovës dhe Ligjin mbi Këshillin Prokurorial. Zbatimi i plotë i këtyre ligjeve është paraparë për vitin 2013. Në vitin 2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Personat e Zhdukur.

Ligji Penal i RSFJ-së i vitit 1976 (LPJ) zbatohet në lëndët e krimeve të luftës. Nga muaji prill i vitit 2004, kur si rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/26 ka hyrë në fuqi, zbatohet Ligji mbi Procedurën Penale i Kosovës (LPPK), të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në muajin nëntor të vitit 2008. Sipas dispozitave të këtij ligji, në rastet e aktakuzave të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohet Ligji mbi Procedurën Penale i RSFJ-së (LPPJ), pos që ligji kosovar zbatohet në lidhje me mjetet e ndihmës së jashtëzakonshme juridike¹⁵².

5.1. Kapacitetet

Gjykimet për krime të luftës në Kosovë në procedurën e shkallës së parë zhvillohen në pesë gjykata të qarkut,¹⁵³ kurse Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente në procedurat e shkallës së dytë. Trupat gjykues për krime të luftës janë të përziera, dhe i përbëjnë dy gjykatës ndërkombëtar dhe një gjykatës vendor. Me trupin gjykues gjithnjë kryeson gjykatësi ndërkombëtar. Përjashtim është Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në të cilën të gjithë anëtarët e trupit gjykues janë ekskluzivisht gjyqtarë ndërkombëtar.¹⁵⁴

Hulumtimi i krimeve të luftës është në kompetenca të Njësisë për Hulumtime të Krimeve të Luftës të EULEX-it (NJHKL), e cila numëron 8 hetues ndërkombëtarë. NJHKL ka ndihmuar në krijimin e Njësisë për Krime të Luftës në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila numëron 9 hetues lokal. Përgjegjësia për hulumtimin e krimeve të luftës, në bashkëpunim me NJHKL, dhe për ndjekje penale të krimeve të luftës qëndron në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK¹⁵⁵), me të cilën udhëheq Ministria e Drejtësisë e Kosovës dhe EULEX-i, në krye me prokurorin e EULEX-it. PSRK është zyrë e specializuar e prokurorisë në kuadër të Zyrës së Prokurorit Shtetëror të Kosovës. Vetëm dy prokurorë ndërkombëtarë merren ekskluzivisht me krime të luftës.¹⁵⁶ Në vitin 2011, dy prokurorë vendor kanë filluar të punojnë në rastet e krimeve të luftës.

Në bazë të Ligjit mbi Jurisdikcionin,¹⁵⁷ gjykatësit e EULEX-it kanë kompetenca primare (ekskluzive) dhe sekondare

151 Mbi rolin e të dënuarve më së miri flet dëshmitari Millorad Davidoviç, komandant i brigadës Federative të SPB-së Federative të RFJ-së, duke shpjeguar se politika e partisë së PSD, kryetari së cilës në komunën e Zvornikut ka qenë Branko Grujiç, ka qenë që myslimanët „në mënyrë të organizuar, me plan dhe në mënyrë sistematike të shpërngulen nga hapësira e Republika Srpska“, si dhe që „alfa dhe omega“ e të gjitha ngjarjeve në Zvornik ka qenë Branko Popoviç. *Po aty*.

152 Amnesty International, në raportet e veta, e thekson se Ligji Penal i Kosovës më shumë i përgjigjet kërkesave të së drejtës ndërkombëtare se sa Ligji Penal i RSFJ-së. Ligji kosovar përfshin edhe dhunimin dhe përgjegjësinë komanduese të komandantit ushtarak ose të personit i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak, i cili mundet, në rrethana të caktuara, të jetë përgjegjës për veprimet e të gjithëve nën kontrollin e tij efektiv, me ndryshim nga Ligji Penal i RSFJ-së, i cili e njeh vetëm përgjegjësinë penale për urdhërim dhe kryerje të krimeve të luftës.

153 Ato janë pesë: Gjykata e Qarkut në Gjilan, Gjykata e Qarkut në Prizren, Gjykata e Qarkut në Pejë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykata e Qarkut në Mitrovicë.

154 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Serbi në vitin 2010 – Raport*, Prishtinë, 2011, f. 51.

155 PSRK është themeluar me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Kosovës, nr. 03/L-052, i cili është miratuar në muajin mars të vitit 2008.

156 Misioni i OSBE-së, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitetet, *Gjykimet kosovare për krime të luftës: Vlerësim pas 10 vitesh 1999-2009*, maj 2010, f.14.

157 Ligji nr. 03/L-053 mbi jurisdikcionin, seleksionimin dhe ndarjen e lëndëve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i miratuar në datën 13 mars të vitit 2008, <http://www.eulex-kosovo.eu/training/?id=139>.

(ndihmëse) ndaj veprave penale të cilat i hetojnë ose i ndjekin penalisht gjykatat komunale dhe ato të qarkut.¹⁵⁸

Në gjykata, në procedurë presin më shumë se 200.000 raste të mbetura. Më e ngarkuara është Gjykata e Qarkut në Mitrovicë me mbi 10.000 lëndë të pazgjidhura.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në nëntor të vitit 2010 e ka miratuar Strategjinë Kombëtare mbi zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura si pjesë e planit strategjik për përparimin e gjyqësorit në periudhën e viteve 2007-2012. Zbatimi i Strategjisë ende nuk ka dhënë rezultate të dukshme dhe problemet, siç janë trysnitë politike, mungesa dhe joprofessionalizmi i prokurorëve dhe gjyqtarëve vendore edhe më tutje janë aktual.¹⁵⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e vlerësojnë zbatimin e Strategjisë si të suksesshëm, por një shikim në statistikat tregon se numri i lëndëve të pazgjidhura nuk po zvogëlohet, por po rritet.¹⁶⁰

5.2. Statistika

EULEX-i ka pranuar nga administrata e UNMIK-ut 1.187 raste të krimeve të luftës, të cilat, pas kontrollimit, janë reduktuar në rreth 750. Sipas vlerësimit të FDH, në bazë të bisedave me prokurorët e EULEX-it, PSRK gjatë vitit 2010 dhe 2011 ka filluar disa dhjetëra hetime preliminare dhe dhjetëra zyrtare¹⁶¹. Sipas të dhënave të EULEX-it, gjykatësit ndërkombëtarë, në procedurën e shkallës së parë dhe të dytë, kanë sjellë 10 aktgjykime në vitin 2009, katër në vitin 2010,¹⁶² dhe në vitin 2011 tri të shkallës së parë dhe dy aktgjykime të plotfuqishme.¹⁶³ Në muajin qershor të vitit 2011, PSRK ka shpallur 27 lëndë të përfunduara me aktgjykime të plotfuqishme, katër procedura janë në vazhdim e sipër dhe pesë janë në procedurën ankimore.¹⁶⁴

Në vitin 2010 dhe 2011të gjitha aktakuzat i kanë përfaqësuar prokurorët ndërkombëtarë. Disa përjashtime ka pasur në lëndët e gjykimeve të përsëritura, në të cilat, sipas vendimit të PSRK aktakuzën e kanë përfaqësuar prokurorët lokal.¹⁶⁵ Është fjala për lëndët *Prokurori kundër Slobodan Martinoviçit dhe të tjerëve* dhe *Prokurori kundër Zoran Koliçit*.

Në vitin 2010, EULEX-i ka qenë më shumë i angazhuar në lëndët e krimit të organizuar, korrupsionit, keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe në veprimet lidhur me ndihmën juridike të jashtëzakonshme e më pak në gjykimet për krimet e luftës.

Në muajin nëntor të vitit 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka dënuar ish pjesëtarin e formacionit rezervë të MPB-së së Serbisë, Vukmir Cvetkoviçin me shtatë vite burgosje për shkak të pjesëmarrjes në shpërnguljen e popullatës

158 Ligji nr.03/L-053 mbi juridiksionin, seleksionimin dhe ndarjen e lëndëve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEKS-it në Kosovë, i miratuar në datën 13 mars të vitit 2008, <http://www.eulex-kosovo.eu/training/?id=139>.

159 Mossuksesi i Gjykatave, Faqja e internetit të së përditshmes *Kosova Sot*, 18 qershor i vitit 2011, http://www.kosova-sot.info/te_tjera/kronika_e_zeze/deshtojne-gjykatat.

160 Raport statistikor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, statistikat e gjykatave të rregullta, http://kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-I-PERGJITHSHEM--TREM-III-2011-SERBISHT_Final_5424.pdf.

161 Në vitin 2010, FDH ia ka dorëzuar NJHKL-së dokumentacionin e vet mbi krime të luftës në BNK të Dubravës në Kosovë, në bazë të të cilit NJHKL i ka kontaktuar dëshmitarët dhe të mbijetuarit në shërbim të mbështetjes së veprimeve paraprake të Prokurorisë për krime të luftës, intervistë me Natasha Kandiçin, drejtoreshën ekzekutive të FDH-së, 15 dhjetor i vitit 2011.

162 Raport vjetor mbi aktivitetet juridike të gjykatësve të EULEX-it (*Annual Report On The Judicial Activities Of EULEX Judges*), 2010. <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual-report2010/Judges%20Annual%20Report%202010.pdf>.

163 Sipas evidencave të Gjykatës së Qarkut në Pejë, lënda e Veselin Beshoviçit po ashtu ka përfunduar më mënyrë të plotfuqishme, me heqjen dorë të prokurorit ndërkombëtar nga ndjekja penale, me deklaratën e datës 5.07.2005 në fazën e përgatitjes së gjykimit të përsëritur. Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Serbi në vitin 2010 – Raport*, Prishtinë, 2011.

164 Numri i aktgjykimeve të shpallura nga ana e gjykatave komunale dhe të qarkut dhe i Gjykatës supreme lidhur me veprat penale. Raport vjetor mbi aktivitetet juridike të gjyqtarëve të EULEX-it (*Annual Report On The Judicial Activities Of EULEX Judges*), 2010. godine, <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual-report2010/Judges%20Annual%20Report%202010.pdf>.

165 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Kosovë në vitin 2010 – Raport*, Prishtinë, 2011.

shqiptare civile nga Klina, duke iu urdhëruar njerëzve që ta lëshojnë qytetin dhe duke djegur së paku dy shtëpi shqiptare në muajin mars të vitit 1999¹⁶⁶.

Procedura kundër Idriz Gashit, pjesëtar i UÇK-së, për shkak të vrasjes së shqiptares Sanije Balaj, në datën 12.08.1998, për shkak të dyshimit se bashkëpunonte me pushtetin serb, ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm në muajin nëntor të vitit 2010. Gjykata Supreme e Kosovës e ka konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, me të cilin Gashi është gjykuar me dënim me burgosje prej 14 vitesh.

Në muajin tetor të vitit 2010, para gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka filluar procedura penale kundër Sabit Gecit dhe Rrezak Aliut, pjesëtarëve të UÇK-së, të cilët kanë pasur pozita të rëndësishme gjatë luftës, për shkak të keqtrajtimit të shqiptarëve të Kosovës në dy kampe në Shqipërinë veriore. Për shkak të mbrojtjes së dëshmitarëve, konfirmimi i aktakuzës, në dy seanca të gjykatës, ka qenë i mbyllur për publikun. Edhe pse neni 330 i LPPK parasheh mundësinë e pranisë së ekspertëve publik në seancat e mbyllura për publikun, as përfaqësuesit të FDH-së Kosovë, të vetmes organizatë joqeveritare e cila përcjellë gjykimet, nuk i është dhënë leja e EULEX-it për të përcjellë seancat.

Problemi i mbrojtjes së dëshmitarëve është aktualizuar në lëndën *Gjergj Luli dhe të tjerët*, para Gjykatës komunale në Pejë. Bekim, Engjëll, Prenk dhe Gjergj Luli janë dënuar me kusht me pesë muaj burgosje për dhënie të deklaratave të rrejshme në gjykimin e Gjeloš Krasniqit, për burgosjen e paligjshme të shqiptarit Pashk Luli, baba i Gjergj Lulit, në datën 24 mars të vitit 1999, të cilit prej aso kohe i ka humbur çdo gjurmë. Gjykatësi ndërkombëtar Malcolm Sammons në arsyetim e aktgjykimit, si rrethanë lehtësuese në lidhje me Gjergj Lulin ka cekur se gjykata ka fituar përshtypjen se i akuzuari Gjergj ka hequr dorë nga deklaratat e mëhershme,¹⁶⁷ në mënyrë që familjen e tij dhe vetveten ta mbrojë nga hakmarrja e Gjeloš Krasniqit.

Në vitin 2011 ka pasur disa hetime të përfunduara, të cilat kanë rezultuar me konfirmimin e aktakuzave, të aktgjytimeve të shkallës së parë dhe të plotfuqishme.¹⁶⁸ Prokurorët vendor kanë qenë të angazhuar në dy lëndë të krimeve të luftës. Në lëndën *Prokurori kundër Slobodan Martinoviçit dhe të tjerëve*, prokurori vendor e ka marrë lëndën në fazën e seancës kryesore gjyqësore, kurse në lëndën *Prokurori kundër Zoran Koliçit*, prokurori vendor i ka udhëhequr hetimet¹⁶⁹.

43

Gjykata Supreme e Kosovës, në përbërje të përzier të trupit gjykues, me të cilin ka kryesuar gjykatësi ndërkombëtar Charles Louis Smith III, ka konfirmuar në datën 14 korrik të vitit 2011 aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, me të cilin është dënuar Gjeloš Krasniqi me shtatë vite të burgosjes për shkak se në datën 24 mars të vitit 1999, në fshatin Doblbarë në Kosovë, e ka marrë si peng Pashk Lulin, të cilit prej aso kohe i ka humbur çdo gjurmë.

5.3. Gjykimet për krime të luftës në vazhdim

5.3.1. *Rasti Sabit Geçi*

Në muajin korrik të vitit 2011, Sabit Geci dhe edhe tre pjesëtarë të UÇK-së para Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë janë gjykuar me dënime me burg prej shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet për shkak të keqtrajtimit të shqiptarëve

166 Gjykata Supreme e Kosovës në datën 16 gusht të vitit 2011 e ka konfirmuar vendimin mbi lartësinë e dënimit, me faktin se e ka modifikuar veprën penale. Në vend se për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 i LP të RSFJ-së (LPJ), në lidhje me nenin 22 të LP të SFRJ-së, Gjykata Supreme të akuzuarit ia ka vënë në barrë krimet e luftës kundër popullatës civile në përputhje me nenin 142 paragrafi 1 i LP të RSFJ-së (RFJ), me nenin 3 të Konventave të Gjenevës dhe me nenet 1 dhe 17 të Protokollit të Dytë Plotësues të Konventave të Gjenevës.

167 I akuzuari Gjergj Luli në disa deklarata të dhëna policisë dhe prokurorëve të GJNPJ dhe UNMIK-ut ka pohuar se në datën 24.03.1999, nga oborri i axhës së tij Prenkës, babanë e tij e ka marrë Gjeloš Krasniqi me një grup të pjesëtarëve të uniformizuar të UÇK-së.

168 Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, *Gjykimet për krime të luftës dhe veprat penale etnikisht të motivuara në Kosovë në vitin 2010 – Raport*, Prishtinë, 2011.

169 *Po aty*.

të Kosovës në kampet e UÇK-së në Kukës dhe Cahan, në Shqipërinë veriore.¹⁷⁰ Në këtë procedurë, prokurori ndërkombëtar Maurizio Salustro e ka shfrytëzuar të drejtën e prokurorit, në pajtim me nenin 322 të LPPK, për të vazhduar me mbledhjen dhe propozimin e provave dhe të dëshmitarëve të ri edhe pas ngritjes së aktakuzës. Trupi gjykues, me të cilin ka kryesuar gjykatësi ndërkombëtar Joanthan Welfor Caroll, që në fillim të procedurës ka konfirmuar kompetencat e tij për veprat penale të cilat kanë ndodhur në territorin e vendit tjetër, duke iu referuar nenit 105 të LP të RSFJ-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në nenin 135 të LPK, i cili parasheh që LPK të zbatohet ndaj shtetasve të Kosovës të cilët kryejnë vepra penale në kundërshtim me Konventat e Gjenevës. Në këtë procedurë, 20 dëshmitarë kanë pasur statusin e dëshmitarëve të mbrojtur. Gjatë gjykimit, numri më i madh i dëshmitarëve me familjet e tyre kanë qenë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre në lokacione të fshehta brenda Kosovës.

5.3.2. *Rasti Kleçka*

Në muajin gusht të vitit 2011, para trupit gjykues në përbërje të përzier të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka filluar seanca gjyqësore kryesore kundër nëntë të akuzuarve për krime të luftës kundër popullatës civile të të burgosurve të luftës. Rasti është i njohur në publikun e gjerë si rasti Kleçka ose rasti Limaj dhe të tjerët. Me aktakuzë është përfshirë edhe Fatmir Limaj, ish ministër i infrastrukturës dhe funksionar i lartë politik i partisë në pushtet, Partisë Demokratike të Kosovës. Limaj ndodhet në arrest shtëpiak nga data 22 shtator e vitit 2011. Më herët, Limaj ka qenë i liruar në procesin në GJPNJ, ku është gjykuar për krime të kryera në vitin 1998. Të akuzuarit ngarkohen për krime të luftës kundër popullatës civile dhe krime të luftës kundër të burgosurve të luftës, sipas disa pikave dhe atë se në cilësinë e pjesëtarit ose të komandantit të UÇK-së në qendrën e paraburgimit në Kleçkë kanë marrë pjesë në rrahjen dhe në vrasjen e të burgosurve, midis të cilëve edhe pjesëtarit të MPB-së së Serbisë Nebojsa Gjuriqit dhe civilëve Veljko Markoviqi, Arben Avdyli, Bojan Cvtekoqi, Zharko Filipoviqit, Zhivota Todoroviqit dhe të paraburgosurve të tjerë, me identitet të pavërtetuar. Pas leximit të aktakuzës, mbrojtja e të akuzuarve ka paraqitur një numër të madh të vërejtjeve lidhur me sjelljen e prokurorit, posaçërisht duke e kundërshtuar pranueshmërinë e deklaratave dhe të ditarit të dëshmitarit anonim X, i cili është dëshmitari kryesor në procedurë. Ai ka mbajtur ditar të hollësishëm mbi ngjarjet në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, ku ka punuar si roje e burgut. Trupi i dëshmitarit X, në datën 28.09.2011, është gjetur në parkun e Duisburgut, në Gjermani. Aso kohe publiku ka kuptuar se është fjala për shqiptarin e Kosovës Agim Zogaj. Hetimet policore kanë treguar se Zogaj kishte kryer vetëvrasje. Ai e ka lënë një letër në të cilën ka akuzuar EULEX-in për torturë psikike. Fillimi i seancës gjyqësore kryesore është shtyrë për datën 30 janar të vitit 2012, kur trupi gjykues, me të cilin kryeson gjykatësi ndërkombëtar Jonathan Welford-Carroll, do të shqyrtojë pranueshmërinë e deklaratave dhe të ditarit të dëshmitarit X.

5.4. Procesimi i rrëmbimit të serbëve, romëve dhe pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike

Me qindra serb, romë dhe pjesëtarë të pakicave të tjera etnike janë kidnapuar nga pjesëtarë të UÇK-së gjatë kohës së luftës dhe menjëherë pas saj në Kosovë në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1998 e deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2000. Është hetuar vetëm një numër i vogël i rasteve. UNMIK-u, më vonë EULEX-i, kanë procesuar dhe vazhdojnë të hetojnë rastet e rrëmbimit të shqiptarëve të Kosovës nga ana e UÇK-së për shkak të dyshimit se kanë bashkëpunuar me pushteti serb, por ende nuk merren me rastet e rrëmbimit të serbëve, romëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë. Procesimi i rrëmbimeve është në përgjegjësi të prokurorive të qarkut, fakt të cilit, me të drejtë, i kundërvihet shumë organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut Amnesty International. Kjo organizatë konsideron se PSRK duhet të hulumtojë rastet e rrëmbimeve post-konfliktuale, për të cilat mendon se përmbajnë karakteristika të krimit kundër njerëzimit. AI përfundon se kualifikimi i rrëmbimeve si krim i zakonshëm i kontribuon kulturës së mbajtjes së mosndëshkimit në Kosovë. Kjo organizatë i thekson tri arsye, të cilat fuqishëm i kundërvihen angazhimit që procesimi i rrëmbimeve dhe i zhdukjeve të lidhura me luftën të jetë në kompetenca të PSRK: formimi i Ekipit Hetues Special të EULEX-it për transferim post-konfliktual të serbëve të kidnapuar në Shqipëri; Baza e të dhënave e KNKK të të zhdukurve në luftë dhe në lidhje me luftën, që përm-

ban informacione mbi personat e zhdukur deri në fund të vitit 2000 dhe Ligji mbi personat e zhdukur, të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në vitin 2011 dhe i cili e thekson të drejtën e familjeve për të ditur për fatin e të zhdukurve në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1998 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, në lidhje me luftën në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999.

Një pakënaqësi e madhe midis familjeve të viktimave serbe ka shkaktuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 26 prill të vitit 2011 mbi lirimin e Besim Berishës nga përgjegjësia penale për vdekjen e Momçillo Milenkoviçit dhe zhdukjen e djalit të tij Svetomirit në datën 2 gusht të vitit 1999 në Prishtinë. Besim Berisha, në muajin nëntor të vitit 1999 ka qenë i akuzuar për vepër penale të vrasjes nga neni 30 paragrafi 2 pika 2 e LPK dhe KZK dhe ndalim të paligjshëm sipas nenit 63, paragrafi 4, në lidhje me nenin 1 të Ligjit Penal të Serbisë.¹⁷¹ Gjykimi ka filluar në datën 20 mars të vitit 2000, ka zgjatur një ditë dhe të njëjtën ditë gjykatësi vendor e ka sjellë aktgjykimin me të cilin i akuzuari lirohet nga aktakuza. Në bazë të ankesës së prokurorit, Gjykata Supreme e Kosovës e ka shfuqizuar aktgjykimin dhe lëndën e ka kthyer në gjykim të përsëritur. Për shkak të mungesës së Berishës, gjykimi i ri ka filluar në datën 28 korrik të vitit 2009. Gjykata nuk ka pasur sukses në vërtetimin e shkakut të vdekjes së Momçillo Milenkoviçit, i cili ka vdekur pas shkuarjes së sulmuesve nga shtëpia e tyre, dhe lidhur me atë se çfarë ka ndodhur me Svetomir Momçilloviçin, i cili në prani të sulmuesve ka kërcyer nga dritarja e shtëpisë, para së cilës kanë bërë roje dy persona nga grupi i sulmuesve. Për këtë arsye, prokurori e ka ndryshuar aktakuzën në atë mënyrë që të akuzuarit ia ka vënë në barrë veprën penale të ekspozimit ndaj rrezikut, që parasheh dënimin e personit i cili personin tjetër e lë pa ndihmë në rrethana të rrezikshme për jetën. I akuzuari është dënuar me gjashtë vite burgosje, por Gjykata Supreme e ka shfuqizuar aktgjykimin dhe të akuzuarin e ka liruar me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka provuar në masë të mjaftueshme lidhshmërinë e Besim Berishës me veprën penale, për të cilën është dënuar.

5.5. Hetimet e akuzave mbi tregtimin me organe njerëzore (raport i Dick Martit)

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE), në datën 25 janar të vitit 2011 e ka miratuar Raportin e raportuesit Dick Marti, në të cilin kryeministri kosovar Hashim Thaçi vihet në lidhje me rrëmbimet, torturat dhe vrasjet e civilëve serb dhe shqiptarë të transferuar në kampet e ndalimit në Shqipëri. Sipas atij Raporti, në një kamp janë vlarë të burgosurit dhe atyre iu janë nxjerrë organet me qëllim të shitjes. Ky Raport për herë të parë i ka filluar hetimet e rrëmbimeve dhe të zhdukjes së serbëve në kontekst të krimeve ndërkombëtare. Në muajin qershor të vitit 2011, EULEX-i e ka njoftuar se e ka themeluar Grupin special hulumtues operativ, të vendosur në Bruksel, për të zhvilluar hetimet mbi zhdukjet në Kosovë, transferimin e personave të kidnapuar në Shqipëri dhe nxjerrje të organeve njerëzore. Në muajin gusht të vitit 2011, EULEX-i e ka emëruar John Clint Williamsin për prokuror udhëheqës të Grupit special hulumtues operativ. Në muajin tetor të vitit 2011, shefi i Misionit të EULEX-it, Javier Bout De Marnhac e ka nënshkruar marrëveshjen mbi bashkëpunimin me ministrin e policisë së Shqipërisë, Bujar Nishani, që mundëson hetimin mbi kampet e pandehura të burgosjes në Shqipëri.

6. Mali i Zi

Kodi Penal (KP) i Malit të Zi është plotësuar në vitin 2003 me veprat penale të krimit kundër njerëzimit (neni 427) dhe të mosmarrjes së masave për parandalimin e kryerjes së veprave kundër njerëzimit, si dhe vlerave të tjera të mbrojtura sipas ligjit ndërkombëtar (neni 440). Me këtë pjesën e fundit, është paraparë përgjegjësia komanduese si vepër e veçantë penale.¹⁷²

Në gusht të vitit 2010 ka filluar zbatimi i pjesshëm i Kodit të ri të Procedurës Penale, siç janë nenet dhe dispozitat

171 Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, faqja e internetit e Misionit të EULEX-it, <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/DCPrishtina/Besim-Berisha2/Judgment%20Besim%20Berisha%20aka%20Burim%20Dibrani%20Serbian.pdf>.

172 Mbi bazën e përgjegjësive komanduese, për shkak të mosparandalimit dhe/ose mosdëshkimit për krimet e kryera askush deri më sot nuk është gjykuar në Mal të Zi.

lidhur me hetimet e prokurorisë dhe institutin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, kurse që nga shtatori i vitit 2011 Kodi zbatohet plotësisht.¹⁷³

6.1. Kapacitetet

Në vitin 2008, në Prokurorinë Supreme Shtetërore është aftësuar Departamenti për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit dhe krimeve të luftës, me të cilin udhëheq Prokurori Special. Në gjykatat e larta në Podgoricë dhe Bijelo Polje, po ashtu që nga viti 2008, ekzistojnë Departamente të specializuara gjyqësore për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit dhe krimeve të luftës, nëpër të cilat punojnë gjithsejtë tetë gjyqtarë të specializuar dhe tre gjyqtarë hetues. Edhe Prokurori Special e edhe zëvendësit e tyre, si dhe gjyqtarët në Departamentet e specializuara, janë të stimuluar me shtesa të posaçme mbi bazën e pagave të tyre mujore. Në procedurën e shkallës së dytë, kompetente është Gjykata e Apelit në Podgoricë, ndërkaq Gjykata Supreme e Malit të Zi vendos në shkallën e tretë si dhe mbi masat e jashtëzakonshme juridike.

Drejtoria e policisë nuk ka departament të veçantë për zbulimin e krimeve të luftës, kurse në Seksionin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është sistemuar vendi i punës së komisarit të lartë policor, aktivitetet e të cilit, në mes të tjerash, janë të drejtuara edhe në zbulimin e krimeve të rënda kundër jetës dhe trupit.¹⁷⁴

6.2. Gjykimet për krimet e luftës

Gjatë viteve 2010 – 2011 kanë qenë në vazhdim katër gjykime për krime lufte: kundër të burgosurve të luftës dhe civilëve në kampin *Morinj*; kundër popullatës civile – refugjatëve nga Bosnja dhe Hercegovina (*rasti i Deportimit të refugjatëve*); kundër popullatës civile në zonën e Bukovicës (*rasti Bukovica*), si dhe kundër popullatës civile, refugjatëve nga Kosova (*rasti Kalugjerski Laz*). Janë sjellë tri aktgjykime të shkallës së parë, një nga të cilat ka qenë ndëshkuese - rasti *Morinj*, dhe dy të tjera me të cilat të gjithë të akuzuarit lirohen nga përgjegjësia penale në lëndët *Bukovica* dhe *Deportimi i refugjatëve*.

Në datën 25 nëntor të vitit 2011, Gjykata e Apelit ka shfuqizuar aktgjykimin e shkallës së parë në *rastin Morinj* dhe lëndën e ka kthyer në gjykim të përsëritur, i cili nuk ka përfunduar deri në fund të vitit 2011.

Po ashtu, edhe në rastin *Bukovica* është shfuqizuar aktgjykimi në qershor të vitit 2011 dhe lënda është kthyer në gjykim të përsëritur. Aktgjykimi i dytë – me të cilin të akuzuarit lirohen nga përgjegjësia penale, lidhur me këtë lëndë është sjellë në fillim të tetorit të vitit 2011.

Karakteristikë e të gjitha lëndëve është se të akuzuarit janë kryerës të drejtpërdrejtë të veprave penale.

Në të gjitha procedurat për krime të luftës, prokuroria ka propozuar caktimin e paraburgimit vetëm pas ngritjes së aktakuzës, pas përfundimit të hetimeve. Kjo ka bërë që pothuajse gjysma e të akuzuarve për deportim, si dhe i akuzuari i parë në *rastin Kalugjerski Laz*¹⁷⁵, si dhe një nga të akuzuarit në *rastin Morinj*, janë gjykuar në mungesë.

6.2.1. Rasti Bukovica

Prokuroria Supreme Shtetërore ka ngritur në datën 21 prill të vitit 2010 aktakuzën kundër pesë pjesëtarëve të formacionit rezervë të APJ-së (Radmilo Gjokoviçiq, Radisha Gjokoviçiq, Sllobodan Cvetkoviçiq, Gjorgje Gogiçiq, Millorad Brkoviçiq) dhe dy pjesëtarëve të formacionit rezervë të policisë (Sllavisha Svrkotës dhe Radoman

173 Organizata joqeveritare Akcioni për të drejtat e njeriut konsideron se Vendimi për hetime prokuroriale mund të sjellë tek aplikimi i pabarabartë i ligjit, sepse gjykatësi vetë vendos se a bëhet fjalë për vepër penale të krimit të organizuar, të korrupsionit, terrorizmit, krimeve të luftës ose është fjala për ndonjë vepër penale, që nuk i takon asnjërës nga këto kategori. Akcioni për të drejtat e njeriut, *Të drejtat e njeriut në Mal të Zi 2010 – 2011*, Podgoricë 2011, fq.198.

174 Komunikim me e-mail me drejtorin e Drejtorisë së Policisë të Malit të Zi Bozhidar Vuksanoviç, i datës 17 janar të vitit 2012.

175 Predrag Strugar është gjykuar në mungesë.

Shubariqit) për shkak të veprës penale të krimeve kundër njerëzimit. Ata janë të akuzuar se, në kohën e konfliktit të armatosur ndërkombëtar në BdeH gjatë viteve 1992–1995, si pjesëtarë të batalionit kufitar të Ushtrisë së Jugosllavisë në Pljevlje dhe MPB-së – Qendra e Sigurimit në Pljevlje, duke i shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare, në zonën e bashkësisë lokale Bukovica, komuna e Pljevljes, kanë vepruar në mënyrë johumane ndaj popullatës civile të kombësisë boshnjake-myslimane, kur edhe ka ardhur deri te shpërngulja e një pjese të popullatës nga ajo zonë.¹⁷⁶ Gjykimi ka filluar në datën 28 qershor të vitit 2010 para Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje.¹⁷⁷ Në seancën gjyqësore kryesore ka dëshmuar drejtori i Drejtorisë së policisë së Malit të Zi, Veselin Veljoviç, i cili në kohën e cila përfshihet në aktakuzë ka qenë komandant i stacionit të policisë në Pljevlje dhe sipas disa dëshmimeve ka udhëhequr bastisjet e shtëpive në Bukovicë. Ai ka pohuar se gjatë ngjarjeve të luftës në rajonin e Bukovicës nuk janë kryer krime të luftës dhe se gjithçka është kryer sipas rregullave zyrtare. Ka thënë se i njëjti policët e akuzuar, Svrkotën dhe Shubariqin dhe se gjatë gjithë kohës së ngjarjeve në atë zonë nuk ka marrë asnjë vërejtje ndaj punës së tij. Trupi gjykues i Gjykatës së Lartë ka sjellë në datën 31 dhjetor të vitit 2010 aktgjykimin me të cilin të akuzuarit i ka liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale të krimeve të luftës kundër njerëzimit sepse, „nuk është provuar se të akuzuarit me vetiniciativë kanë shkuar në Bukovicë për shkak të frikësimit, torturës dhe sjelljes çnjerëzore ndaj popullatës së atjeshme të kombësisë boshnjako-myslimane, por se, në kuadër të autorizimeve të tyre ligjore, si pjesëtarë të policisë kanë vepruar me qëllim të sigurimit të rendit dhe të qetësisë, përkatësisht se si pjesëtarë të Ushtrisë së Jugosllavisë kanë vepruar me qëllim të sigurimit të kufirit e me qëllim që zhvillimet e luftës nga Bosnja dhe Republika Srpska të mos zgjerohen në zonën e Pljevljes”.¹⁷⁸ Gjykata e Apelit, në datën 29 qershor të vitit 2011e ka shfuqizuar aktgjykimin dhe lëndën e ka kthyer në gjykim të përsëritur.¹⁷⁹ Gjykata e Lartë në Bijelo Polje, në datën 3 tetor të vitit 2011 përsëri ka sjellë aktgjykim, me të cilin të akuzuarit lirohen nga përgjegjësia penale.¹⁸⁰ Me rastin e aktgjykimit të këtillë, avokati dhe kryetari i Komitetit të Juristëve Malazias për të Drejtat e Njeriut, Veli Muriqi ka deklaruar se „nuk janë të akuzuarit njerëzit më përgjegjës për pasojat të cilat kanë rezultuar në atë rast [...] sepse ka qenë fjala për spastrim etnik. Është karakteristike se në atë zonë nuk ka pasur zhvillime të luftës. Kjo hapësirë ka qenë nën kontrollin e policisë malaziasë dhe të Ushtrisë së Jugosllavisë.”¹⁸¹

6.2.2. Rasti i deportimit të refugjatëve

Prokuroria Shtetërore Supreme e Malit të Zi, Departamenti për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit dhe krimeve të luftës, në muajin janar të vitit 2009 ka ngritur aktakuzë kundër nëntë ish dhe pjesëtarëve të tashëm të MPB-së së Malit të Zi: Boshko Bojoviçit – ndihmës i ministrit të punëve të brendshme të RMZ për Shërbimin e Sigurisë Shtetërore (SHSSH); Milisav Markoviçit – ndihmësit të ministrit të punëve të brendshme të RMZ për Shërbimin për Sigurinë Publike; Radoje Radunoviçit, kryeshefit të Sektorit për punë të SHSSH në Herceg Novi; Dushko Bakraçit – punëtorit operativ të Sektorit për punë të SHSSH në Herceg Novi; Bozhidar Stojoviçit – udhëheqësit të Sektorit për punët e SHSSH në Ulqin; Millorad Ivanoviçit – kryeshefit të Qendrës së Sigurisë së Herceg Novit; Milorad Shlivçaninit – komandantit të stacionit të milicisë në Herceg Novi; Branko Bujiçit – kryeshef i Qendrës për Siguri në Tivar dhe Sreten Glenxhës – kryeshef i Departamentit të sigurisë në Ulqin¹⁸². Ata ngarkohen se në muajin maj të vitit 1992, në Podgoricë, Herceg Novi, Tivar dhe Ulqin, kanë kryer shpërnguljen e paligjshme të popullatës civile – shtetas të BdeH, të përkatësisë myslimane dhe serbe, të cilët kanë pasur statusin e refugjatit. Të akuzuarit ngarkohen se kanë kryer krime të luftës kundër popullatës civile, në atë mënyrë që i kanë privuar nga liria 79 persona, shtetas të BdeH dhe ua kanë dorëzuar punëtorëve të SPB-së të Sokolcit, SPB dhe SHKP të Foçës dhe SPB-së së Srebrenicës, duke kryer urdhrin e ministrit të Punëve të Brend-

176 Komunikatë e Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, 22 prill të vitit 2010.

177 Komunikatë e Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, 30 qershor të vitit 2010.

178 Komunikatë e Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, 31 dhjetor të vitit 2010.

179 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Malit të Zi, *Raporti i II tremujor mbi gjendje e të drejtave të njeriut*, f. 5.

180 Komunikatë e Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, 3 tetor të vitit 2011.

181 „Muriqi: Rasti Bukovica edhe një humbje e drejtësisë malaziasë”, faqja e internetit e *Portalit Analitika*, 4 tetor të vitit 2011.

182 Në kohën e deportimit, Kryetari i Republikës së Malit të Zi ka qenë Momir Bulatoviç, kryeministër Milo Gjukanoviç, zëvendëskryeministër për politika të brendshme, drejtpërdrejtë përgjegjës për kontrollin e punës së MPB-së ka qenë Zoran Zhizhiq, kurse zëvendës i ministrit të punëve të brendshme i të ndjerit Pavle Bullatoviç, Nikola Pejakoviç.

shme të RMZ, tash i ndjeri Pavle Bulatoviç, që të veprohet sipas kërkesave të MPB-së së Republikës së Serbisë (në atë kohë, emërtimi zyrtar ka qenë Srpska Republika BdeH), dhe që personat të cilët vijnë nga territori i BdeH në Mal të Zi të privohen nga liria dhe të kthehen në BdeH.

Gjykimi ka filluar në datën 26 nëntor të vitit 2009 në Gjykatën e Lartë në Podgoricë, para gjykatësit Milenko Zhizhiqit dhe dy anëtarëve të jurisë. Në mungesë është gjykuar Dushko Bakraçi, Boshko Bojoviç, Millorad Ivanoviç, Milisav Markoviç dhe Radoje Radunoviç, të cilët kanë qenë në arrati në Serbi. Në gjykim kanë dëshmuar një numër i madh i dëshmitarëve, midis të cilëve edhe personat e dëmtuar të mbijetuar, të afërmit e atyre që kanë pësuar dhe pjesëtarë të MPB-së të Malit të Zi. Ka dëshmuar edhe Momir Bullatoviç.¹⁸³

Të akuzuarit janë mbrojtur me atë se vetëm kanë kryer urdhrat, duke vepruar sipas urdhrave nga telegrami nr. 14–101 i datës 23 maj të vitit 1992, me të cilin është kërkuar që të veprohet në përputhje me kërkesat e MPB-së së Republika Srpska që të gjithë personat nga hapësira e BdeH, të moshës prej 18 deri në 65, të ndalohen dhe të merren me qëllim të kthimit në BdeH.

Me rastin e dëshmisë, Bullatoviç, në datën 12 nëntor të vitit 2010, ka deklaruar se deportimi nuk ka qenë aksion i posaçëm, por një veprim i rregullt i policisë. Ia ka dorëzuar gjykatës me dhjetëra dokumente, midis të cilave edhe origjinalin e depushes, me të cilën urdhërohet që të burgosen 161 persona nga BdeH, për të cilët ka ekzistuar e dhëna se mund të jenë terrorist potencial. Ai ka thënë se “dorëzimi i refugjatëve ka qenë gabim shtetëror dhe jo individual” dhe ka pohuar se policia dhe kryeprokurori i shtetit Shushoviç, “në atë kohë janë kontaktuar non-stop”.

Gjykata e Lartë në Podgoricë ka sjellë në datën 29 mars të vitit 2011 aktgjykimin, me të cilin lirohen nga përgjegjësia penale të gjithë të nëntë të akuzuarit, me arsyetimin se, “të akuzuarit me veprimet e tyre të paligjshme, të cilat është vërtetuar se i kanë kryer, nuk kanë kryer krime të luftës, sepse nuk iu kanë takuar formacioneve ushtarake dhe as që kanë qenë në shërbim të ndonjëres prej palëve në konflikt.”¹⁸⁴ Aksioni për të Drejtat e Njeriut (HRA) ka vlerësuar se aktgjykimi është kontradiktor, “kurse kualifikimi tij juridik konfuz dhe i pambështetur në burime ose në interpretimet relevante të së drejtës ndërkombëtare.”¹⁸⁵ Po ashtu, Aksioni për të Drejtat e Njeriut e konsideron të dyshimtë atë se, “në këtë rast janë kryer krime të luftës kundër popullatës civile në lidhje me konfliktin e armatosur në BdeH.”¹⁸⁶ Prokuroria shtetërore ka depozituar në datën 15 qershor të vitit 2011 ankesën ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Lartë në Podgoricë,¹⁸⁷ kurse për momentin kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit të Malit të Zi.

Me rastin e aktgjykimit, me të cilin të akuzuarit lirohen nga përgjegjësia penale, kanë pasuar një numër i madh i kritikave publike të përfaqësuesve të partive të caktuara politike dhe të organizatave joqeveritare. Aksioni për të Drejtat e Njeriut, në raportin e vet mbi gjykimet e luftës konsideron se aktgjykimi është kontradiktor, kurse kualifikimi i tij juridik konfuz dhe i pabazuar në burime ose në interpretime relevante të së drejtës ndërkombëtare.¹⁸⁸

183 Gjykatësi ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për të dëshmuar Milo Gjukanoviç, Zoran Zhizhiq, në atë kohë zëvendëskryeministër i Malit të Zi përgjegjës për politikën e brendshme, dhe Vladimir Shushoviç në funksion të kryeprokurorit shtetëror, si dhe Svetozar Maroviç e Milica Pejanoviç – Gjurishiq, të cilët në kohën e deportimit kanë qenë anëtarë të Presidencës së Malit të Zi, në krye të së cilës ka qenë Momir Bullatoviç. Aksioni për të drejtat e njeriut, *Gjykimet për krimet e luftës*, Podgoricë, 2011.

184 Paraqitje e vendimit të Gjykatës, http://sudovi.me/odluka_prikaz.php?id=623.

185 Aksioni për të Drejtat e Njeriut, *Të drejtat e njeriut në Mal të Zi 2010-2011*, Podgoricë 2011, f. 566.

186 *Po aty*, f. 568.

187 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, *Raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut për tremujorin e tretë 2011*, f. 6.

188 Siç ceket në raportin e Aksionit për të Drejtat e Njeriut: „Për hir të shembullit, qëndrimi në faqen 72, ku gjykata vërtetoi se në BdeH ka qenë fjala për konfliktin e armatosur midis pjesëtarëve të popujve të cilët kanë jetuar në territorin e saj të serbëve, kroatëve dhe myslimanëve, arsye kjo për të cilën ky konflikt nuk e ka karakterin e konfliktit ndërkombëtar të armatosur, është në kundërshtim me atë qëndrimin në faqe 90: *Për periudhën pas 19 majit të vitit 1992, kur forcat e RFJ-së janë tërhequr si të tilla nga territori i BdeH, forcat e armatosura të Republika Srpska kanë vepruar nën kontrollin e plotë dhe në llogari të RFJ, fakte këto të cilat janë vërtetuar edhe me aktgjykimet e Gjykatës Ndërkombëtare, fakte këto nga të cilat rrjedh se edhe RFJ ka qenë në konflikt të armatosur me forcat qeveritare të BdeH, kurse kjo në kundërshtim me qëndrimin e mbrojtjes*. Përndryshe, nëse forcat e armatosura të RS „kanë vepruar nën kontrollin e përgjithshëm dhe në llogari të RFJ, konflikti në BdeH me vet këtë ka qenë ndërkombëtar, edhe pse gjykata në fund e ka përfunduar të kundërtën.” Aksioni për të Drejtat e Njeriut, *Gjykimi i krimeve të luftës në Mal të Zi*, Podgoricë 2011.

6.2.3. Rasti Kalugjerski Laz

Në fillim të muajit mars të vitit 2007 janë hapur hetimet kundër oficerit aktiv të Ushtrisë së Jugosllavisë Predrag Strugarit nga Beogradi, me banim në Podgoricë dhe dhjetë pjesëtarëve të formacionit rezervë të Korpusit të Podgoricës të UJ nga zona e komunës Berane. Me kërkesën për zhvillim të hetimeve kanë qenë të përfshirë katër persona, të cilët nuk kanë pasur kurrfarë lidhjesh me krimin, dhe, së këndejmi, më vonë prokurori edhe ka hequr dorë nga ndjekja penale në lidhje me ta.

Në territorin Kalugjerski Laz dhe në fshatrat përreth, ku nuk ka pasur konflikte, pjesëtarët e UJ kanë vrarë 21 civilë të kombësisë shqiptare, të cilët forcat MPB-së së Serbisë/UJ-së i kishin dëbuar nga Kosova. Gjashtë persona janë vrarë në Kalugjerski Laz, kurse të tjerët në lokacionet e tjera të komunës së Rozhajes. Katër viktimat të këtij krimi prokurori nuk i ka futur në mesin e viktimave, sipas aktakuzës, mbi bazën e së cilës është në vazhdim e sipër gjykimi para Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje. Të akuzuarit Predrag Strugarit, djali të gjeneralit Pavle Strugar, i cili është dënuar në Tribunalin e Hagës për shkak të rrethimit të Dubrovnikut, krimi në Kalugjerski Laz i vihet në barrë sipas përgjegjësisë komanduese, sepse në atë kohë ka qenë i vetmi oficer aktiv i UJ, kurse shtatë pjesëtarët e tjerë të formacionit rezervë të Korpusit të Podgoricës të ish AJ ngarkohen si kryerës. Territori, në të cilin kanë ndodhur krimet, ka qenë në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Dytë të UJ, në krye të së cilës ka qenë Millorad Obradoviqi. Ashtu siç e thekson Aksioni për të Drejtat e Njeriut, përgjegjësia komanduese përmes tij ka shkuar drejt komandantit të Korpusit të Podgoricës, Sava Obradoviqit, e deri te vet komandanti i dyshuar i batalionit, Predrag Strugari. Millorad Obradoviqi dhe Sava Obradoviqi në hetime përmenden vetëm si dëshmitar, edhe pse kanë qenë epror të Strugarit. Gjykata e Lartë në Bijelo Polje pohon se nuk është në gjendje për të ditur adresat e këtyre dy oficerëve të lartë të UJ për arsye se vendbanimi i tyre është në Republikën e Serbisë.

Gjykimi ka filluar në datën 19 mars të vitit 2009. Në seancat e deritashme janë dëgjuar rreth 100 dëshmitarë. Të gjithë kanë pohuar se të akuzuarit nuk i kanë parë dhe se pothuajse nuk dinë asgjë. Këshilli jashtëgjyqësor i Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje ua ka hequr në datën 1 gusht të vitit 2011 paraburgimin të akuzuarve Barjaktaroviqi, Labudoviqi, Novakoviqi, Bojoviqi dhe Gjurashkoviqi, sepse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është sjellë në afat prej tri vitesh nga koha e caktimit të paraburgimit.

I akuzuari Predrag Strugar, në datën 30 tetor të vitit 2010 është burgosur në Serbi, sipas fletarrestimit ndërkom-bëtar të Interpolit të Podgoricës, në përputhje me Marrëveshjen midis Serbisë dhe Malit të Zi mbi ekstradimin e shtetasve të vet. Ai është dëgjuar dhe është lëshuar në liri.¹⁸⁹

Përfaqësuesi i familjeve të viktimave Veli Muriqi konsideron se hetimet kanë qenë sipërfaqësore, se së paku katër të dyshuar, rastësisht janë emëruar, edhe pse është ditur se ata nuk kanë lidhje me krimin. Ai ka vënë në pah se hulumtimi ka zgjatur jashtëzakonisht shumë, me anë të ngadalësimit nga autoritetet e Serbisë, prej të cilave janë kërkuar një numër i provave, dhe se „mbrojtja e të akuzuarve ka pasur sukses që disa herë gënjeshtrenë e përsëritur ta kthejnë në tezën themelore - se, siç pretendohet, viktimat janë rrahur në Kosovë dhe se janë sjellë në vendin e krimit”.¹⁹⁰ Deri në fund të vitit 2011, procedura e provave ende ka qenë në vazhdim.

189 Gjykata e Lartë në Beograd, në datën 24 janar të vitit 2011, ka sjellë vendimin që Strugari të ekstradohet në Mal të Zi, por Gjykata e Apelit në Beograd e ka shfuqizuar vendimin. Në procedurën e përsëritur, Gjykata e Lartë në Beograd, në datën 25 tetor të vitit 2011 ka sjellë aktgjykimin se nuk ka prova për ekstradim. “Gjykata e Lartë ia ka refuzuar ekstradimin e të akuzuarit për krime të luftës Malit të Zi”, faqja e internetit *Blic*, 3 nëntor i vitit 2011, <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/287401/Visi-sud-odbio-izrucenje-Crnmoj-Gori-optuzenog-za-ratne-zlocine>.

190 Komunikim me email me avokatin e familjeve të viktimave, Veli Muriqin, në datën 12 dhjetor të vitit 2011.

6.2.4. Rasti i Morinjit¹⁹¹

Në datën 15 gusht të vitit 2008 është ngritur aktakuza kundër gjashtë ish pjesëtarëve të formacionit rezervë të APJ-së: Mlladen Govedaricës, kryeshefit të shërbimit të sigurimit të Komandës së bazës së prapavijës detare dhe hetuese, Zlatko Tarleas, hetuesit, Ivo Gojniqit, oficerit rezervë përgjegjës për punët administrative dhe intendante, Shpira Luciçit, polic ushtarak, Ivo Menzalinit, kuzhinier dhe Bora Gligiqit, gardian. Të akuzuarit ngarkohen se nga data 3 tetor e 1991 e deri në datën 18 gusht të vitit 1992, në kohën e konfliktit të armatosur në Republikën e Kroacisë, në „qendrën për pranimin e të burgosurve” kanë urdhëruar dhe kanë kryer torturë, sjellje çnjerëzore, lëndime të integritetit trupor ndaj gjashtë personave të sjellë nga zona e Dubrovnikut. Pas ngritjes së aktakuzës, të akuzuarve iu është caktuar paraburgimi, pos Ivo Menzalinit, i cili ka qenë në arrati dhe i cili është dënuar në mungesë¹⁹².

Gjykimi ka filluar në datën 12 mars të vitit 2010 para Gjykatës së Lartë në Podgoricë. Aktgjykimi është shqiptuar në datën 15 maj të vitit 2010. Gjykata i ka shpallur fajtor dhe i ka dënuar për vepra penale krime të luftës kundër të burgosurve të luftës, Mlladen Govedaricën, me dy vite burgosje, Zlatko Tarleas me një vit e gjysmë, Ivo Gojniqin me dy vite e gjysmë, Shpira Luciçin me tri vite e gjysmë, Bora Gligiqin me tri vite, kurse Ivo Menzalinin me katër vite burgosje. Të akuzuarve iu është hequr paraburgimi. Menzalinit, i cili ka qenë në arrati, gjykata ia ka caktuar paraburgimin, i cili llogaritet nga dita kur më vonë të burgoset. Aktgjykimi në Dubrovnik është pritur me pezëm, sepse të akuzuarit janë dënuar me dënime të ulëta, „thujse janë dënuar për farë kundërvajtje të komunikacionit e jo për krime të kryera në mbrojtjen e RSFJ-së“. Të dëmtuarit e kanë përjetuar aktgjykimin si një tallje të turpshme me të burgosurit e luftës dhe me civilët, të cilët gjashtë ish pjesëtarë të APJ-së përditë i kanë rrahur, keqtrajtuar dhe përlulur.¹⁹³

Gjykata e Apelit, nga fundi i muajit nëntor të vitit 2010 e ka shfuqizuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në gjykim të përsëritur. Gjykata e Apelit ka konfirmuar se aktgjykimi është bazuar në kopjet e pavërtetuara të procesverbalit me deklarata të dëshmitarëve të dhëna në hetuesi para gjykatave të çarkut në Kroaci si dhe në kopjet e pavërtetuara të dokumentacionit mjekësor të të dëmtuarve dhe, së këndejmi, është urdhëruar që të gjitha këto dokumente të përjashtohen nga materialet e lëndës në procedurën e përsëritur.

Gjykata e shkallës së parë i ka dënuar të akuzuarit për krime të luftës kundër të burgosurve të luftës dhe jo edhe për krime të luftës kundër popullatës civile, siç është kërkuar me aktakuzë, sepse ka konsideruar se vendimtare është se të akuzuarit të gjithë të dëmtuarit i kanë konsideruar të burgosur të luftës. Prokurori shtetëror nuk është ankuar kundër një vendimi të tillë gjyqësor dhe në gjykimin e përsëritur dënimi është bërë vetëm për krime kundër të burgosurve të luftës. Gjykimi i përsëritur ka filluar në datën 12 prill të vitit 2011. Në fjalën përfundimtare, në datën 11 nëntor të vitit 2011, zëvendësja e prokurorit special, Lidija Vukçević, e ka ndryshuar aktakuzën në atë mënyrë që Mlladen Govedarica, Bora Gligiqi, Shpiro Luciçi dhe Ivo Menzalin janë akuzuar se kanë kryer krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëveprim me veprën penale „krim i luftës kundër të burgosurve të

191 Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) ia ka dorëzuar prokurorit shtetëror të Gjykatës Supreme të Malit të Zi materialin provues kundër dhjetë shtetasve të Malit të Zi, të dyshuar se kanë kryer krime të luftës kundër civilëve dhe të burgosurve të luftës në Morinj në periudhën prej datës 3 tetor të vitit 1991 deri në datën 2 korrik të vitit 1992. Aksioni për të drejtat e Njeriut, *Gjykimet për krime të luftës në Mal të Zi*, Podgoricë, 2011.

192 „Si epror ushtarak, pra, përgjegjës për qendrën e grumbullimit në Morinj në APJ, në atë periudhë janë cekur: komandanti i Marinës së luftës së APJ, admiral Mile Kandiç; komandantët e sektorit 9 ushtarak të marinës (S9 UM) koloneli i marinës Krsto Gjuroviç (është vrarë në datën 5 tetor të vitit 1991) dhe trashëgimtari i tij vice admiral Miodrag Jokiç; kryeshefi i shtabit 9 ushtarak të marinës (S9 UM), koloneli i marinës Millan Zec; komandanti i grupit 2 operativ, gjenerali nënkoloneli Pavle Strugari; kryeshefat e Drejtorisë së Sigurisë së Sekretariatit Federativ për mbrojtjen popullore – gjeneralët Marko Negovanoviç, Aleksandar Vasiljeviç dhe Nedeljko Boshkoviç; si udhëheqës i grupit special të kundërzbulimit për hetime në Morinje është cekur oficeri i sigurisë ushtarake Mirsad Krluç. Prokuroria e Lartë Shtetërore, Ranka Çarapiç, ka komunikuar se prokuroria nuk ka pasur prova kundër personave që kanë qenë në strukturat komanduese. Zeci, Jokiç dhe Strugari janë akuzuar, kurse Jokiç dhe Strugari edhe janë dënuar për krime të luftës të kryera gjatë rrethimit të Dubrovnikut para Tribunalit të Hagës, por kjo aktakuzë nuk i ka përfshirë edhe ngjarjet në Morinj”. Aksioni për të drejtat e njeriut, *Gjykimet për krimet e luftës në Mal të Zi*, Podgoricë 2011.

193 Aksioni për të drejtat e njeriut, *Gjykimet për krimet e luftës në Mal të Zi*, Podgoricë 2011.

luftës". Mbrojtësit e të akuzuarve kanë kërkuar përjashtimin e zëvendësës së prokurorit special, Vukçevićit, duke pohuar se ajo nuk ka pasur të drejtë për ta ndryshuar aktakuzën, sepse në vendimin e Gjykatës së Apelit është cekur se në procesin e përsëritur nuk do të gjykohen për krime kundër popullatës civile, për arsye se prokurori nuk është ankuar në atë pjesë të aktgjykimit të shkallës së parë. Deri në fund të vitit 2011 aktgjykimi nuk është bërë i plotfuqishëm.

7. Maqedonia

Maqedonia, në vitin 1996, e ka miratuar Kodin Penal, i cili ka të bëjë edhe me krimet e luftës.

7.1. Kapacitetet

Për procesimin e krimeve të luftës¹⁹⁴ kompetent është Departamenti Special Gjyqësor për veprat e krimit të organizuar dhe të korrupsionit në kuadër të Gjykatës Themelore 1 të Shkupit.¹⁹⁵ Për vendimet e shkallës së dytë kompetente janë Gjykata Supreme dhe e Apelit e Maqedonisë. Gjykata Themelore 1 e Shkupit është kompetente edhe për procedurat lidhur me veprat të cilat janë në kompetenca të GJPNJ.¹⁹⁶ Gjykata Themelore 1 e Shkupit është e përgatitur në mënyrë speciale dhe disponon me gjykatoren, e cila i plotëson standardet më të larta teknike. Për lëndët e krimeve të luftës, të krimit të organizuar dhe të korrupsionit përgjegjës janë 11 gjyqtarë dhe 24 shërbyes civil.¹⁹⁷ Nuk ka të punësuar në gjyqësorin, të cilët janë ekskluzivisht kompetent për krime të luftës.

Juridiksionin për hulumtime dhe ndjekje penale të krimeve të luftës e ka Departamenti Special për përcjelljen dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale pranë Prokurorisë Themelore Publike, që është përgjegjëse edhe për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Prokuroria e ka selinë në Shkup dhe është kompetente për tërë Maqedoninë.¹⁹⁸ Në lidhje lëndët me aktakuza për krime të luftës kanë vepruar gjithsejtë 11 prokurorë, në të njëjtën kohë edhe në lëndët e krimit të organizuar dhe korrupsionit.¹⁹⁹

7.2. Statistika

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit në datën 13 gusht të vitit 2001, me të cilin zyrtarisht përfundon konflikti i armatosur, gjatë vitit 2002 kanë filluar dy procedura për krime të luftës.²⁰⁰ Në të gjitha ato procedura, Prokuroria i ka ngarkuar pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK).

Lënda *Punëtorët e ndërtimitarisë* ka të bëjë me kidnapimin e pesë punëtorëve të ndërmarrjes *Mavrovo* të datës 7 gusht të vitit 2001, të cilët pjesëtarët e UÇK-së i kanë keqtrajtuar dhe i kanë torturuar tetë orë. Lënda *Lipkovska brana (Diga e Lipkovës)* ka të bëjë me ndaljen katër dhjetë ditëshe të ujit të pijshëm për qytetin e Kumanovës, mbylljen e ventilin të ujësjellësit të Kumanovës tek Liqeni i Lipkovës, që në atë periudhë ka qenë nën kontrollin e UÇK.

Lënda *Neproshteni (Neprošteno)* po ashtu është rast i kidnapimit, i 12 civilëve në muajin korrik të vitit 2001, të cilët pjesëtarët e UÇK-së i kanë rrëmbyer nga disa lokacione në zonën e Tetovës.

194 Krimet e luftës në Maqedoni procedohen sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, të miratuar në vitin 1996.

195 Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi gjykatat, neni 2, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.35/2008.

196 Ligji mbi bashkëpunimin e Republikës së Maqedonisë dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale të ish Jugosllavisë (GJPNJ), neni 26, paragrafi 2, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.73/2007.

197 Të dhëna zyrtare të Gjykatës Themelore 1 Shkup, http://oskopje1.mk/cms/FCKEditor_Upload/File/WVr/osn.html.

198 Prokuroria publike e Maqedonisë është konceptuar si më poshtë: Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Prokuroria e Lartë Publike, Prokuroria Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe Gjykata Themelore Publike. Ligji mbi Prokurorinë Publike, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.150, 12.12.2007, neni 15, paragrafi 2.

199 Informacion i marrë nga Prokuroria Themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, 28 dhjetor i vitit 2011.

200 Fondi për të Drejtën Humanitare, BIRN dhe Documenta, *Drejhtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f.17.

Në lëndën *Kreu i UÇK-së (Vodstvo na ONA)* është zbatuar parimi i përgjegjesisë komanduese dhe, me aktakuzë të bashkuar, e cila i ka përfshirë 10-20 persona, është akuzuar i gjithë kreu i UÇK-së për më shumë krime të luftës.²⁰¹

Në muajin shtator të vitit 2002, prokuroria e GJPNJ ka marrë kompetencat për udhëheqjen e të gjitha, të katër lëndëve.

Pos lëndëve të marra gjatë vitit 2004, Prokuroria e GJPNJ ka hapur hetimet kundër ish ministrit të policisë Ljube Boshkovskit dhe ish pjesëtarit të MPB-së Johan Tarçulovskit, për krime të luftës të kryera në fshatin Ljuboten, në muajin gusht të vitit 2001.²⁰² Me këtë rast, në muajin janar të vitit 2005, ish kryeministri Vllado Buçkovski ka deklaruar se "historia e vonshme maqedonase do të shtrembërohet nëse GJPNJ i fillon hetimet vetëm për një lëndë".²⁰³ Ali Ahmeti, kryetar i partisë shqiptare Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) ka deklaruar se do të ishte mirë që GJPNJ t'i përfundojë ato lëndë, por ka theksuar se pikërisht vetëm një rast "i meriton hetimet", dhe atë lënda nga Mavrova, derisa tri të tjerat hyjnë nën Ligjin mbi Amnistinë.²⁰⁴

Pas tri vitesh, GJPNJ i ka pezulluar hetimet dhe në muajin shkurt të vitit 2008 të gjitha lëndët prapë ia ka kthyer gjyqësorit maqedonas për procedurë. Ish Kryeprokurorja Karla Del Ponte ka shpjeguar se Tribunali nuk ka pasur zgjedhje tjetër, duke qenë se Këshilli i Sigurimit i KB-ve ka kërkuar që të gjitha procedurat hetimore të jenë të përfunduara deri në fund të vitit 2007.²⁰⁵

Lëndët e kthyer më parë janë përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase, kurse pastaj Ministria e Drejtësisë ia ka dorëzuar të gjitha, të katër lëndët, Prokurorisë (qershor/korrik 2008).²⁰⁶ Prokuroria Publike Themelore, pas procedurës së kryer të tërheqjes së lëndës, ia ka përcjellë materialin departamentit hetues të Gjykatës Themelore 1 të Shkupit.

Gjykata Themelore 1 e Shkupit pohon se nga Prokuroria themelore i janë dorëzuar vetëm tri lëndë (*Punëtorët e ndërtimtarisë, Diga e Lipkovës dhe Neproshteno*) dhe e kurrë nuk iu është dorëzuar lënda *Kreu i UÇK-së*.²⁰⁷ Nga ana tjetër, Prokuroria pohon se lënda *Kreu i UÇK-së* gjendet në fazën e hetimeve, në Gjykatën Themelore 1 të Shkupit.²⁰⁸ Prokuroria e ka ngritur aktakuzën vetëm në lëndën *Punëtorët e ndërtimtarisë*. Dy lëndët e tjera kanë mbetur në fazën e hetimeve, derisa lënda *Kreu i UÇK-së* „ka humbur“ në rrugën midis prokurorisë dhe organeve të hetuesisë. Në fund, të gjitha, të katër lëndët janë vënë *ad acta* me amnistinë e të akuzuarve në muajin korrik të vitit 2011.

Krimet ndaj shqiptarëve ende nuk janë procesuar. Lënda *Humnera (Jama)* ndodhet me vite në Prokurorinë Themelore Publike dhe sipas Ligjit mbi Amnistinë do të jetë e mbyllur.²⁰⁹ Në fushën e Humnerës (midis Kiçevës dhe Dibres) është gjetur varreza me katër trupa të personave të cilat janë zhdukur gjatë konfliktit të vitit 2001: Radoslav Ginov, shtetas bullgar, dhe tre shqiptar nga Maqedonia - Islam Veliu, Hajredin Halimi dhe Ibrahim Veliu. Prokuroria nuk ka ngritur aktakuzë. Të dyshuarit për vrasjen e këtyre personave janë pjesëtarë të pae-mëruar të organeve të rregullta të sigurisë.

201 Lënda *Vejce* – vrasja e pjesëtarëve të forcave maqedonase të sigurisë; lënda *Brionet* – minimi i hotelit së bashku me dy roje të lidhura, dhe lënda *Çelopek* – vrasja e dy civilëve.

202 Prokurori i GJPNJ kundër Boshkovskit dhe Tarçulovskit, faqja e internetit e GJPNJ, http://www.icty.org/case/boskoski_tarculovski/4.

203 Grupi Ndërkombëtarë i Krizave, *Raport për Evropën nr. 41 – Makedonija: tetaravenje kon Evropu*, f. 3.

204 *Po aty*.

205 "Хашкиот трибунал ги врати четирите случаи во Македонија", internet stranica *SE Times*, <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/mk/features/setimes/features/2005/04/27/feature-02>.

206 Intervistë me Bisera Lazarovin, bashkëpunëtoren profesionale në Prokurorinë Publike të Maqedonisë, 23 dhjetor i vitit 2011.

207 Bisedë telefonike me Vladimir Tufegjjiqin, zëdhënësin dhe gjyqtarin hetues të Departamentit për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Gjykata themelore 1 Shkup, 23 dhjetor i vitit 2011.

208 „Каде залута предметот со водството на ОНА?“, internet stranica *Dnevnik*, 15.septembar 2011. <http://www.utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=05E04FE092AE6B4C934690E20E0F752D>.

209 „По хашките случаи, ќе се закопа и „Јама“?“, faqja e internetit *Dnevnik* 29 korrik i vitit 2011., <http://www.dnevnik.com.mk/?ItemID=F46D93FB5374CB448DC5E8085CA87B71>.

7.3. Amnistia për krime të luftës

Me nismën e partive politike shqiptare (Partia Demokratike Shqiptare PDSH – dhe Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI), në datën 19 korrik të vitit 2011 ka filluar procedura e votimit në Parlamentin e Maqedonisë për përkrahjen e shumicës për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë. Të njëjtën ditë, nisma është miratuar me 63 vota *për* dhe 29 *kundër*, me çka është hequr dorë nga drejtësia penale për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni.²¹⁰

Ligji mbi Amnistinë është miratuar në vitin 2002, shtatë muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, me çka është mundësuar amnistomi i të gjithë pjesëtarëve shqiptarë të formacioneve të armatosura, për të cilët ka pasur dyshime se kanë kryer krime të luftës, me përfundim në datën 26 shtator të vitit 2001.²¹¹ Sipas këtij Ligji, amnistia nuk i ka përfshirë të akuzuarit kundër të cilëve ka filluar procedura para GJPNJ. PDSH në vitin 2009 ia ka parashtruar kërkesën Qeverisë së Maqedonisë për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë, por në atë moment Qeveria nuk e ka pranuar atë propozim.²¹² Të njëjtën kërkesë e ka parashtruar BDI dhe kërkesa ka marrë përgjigje pozitive, së pari nga Qeveria e, pastaj, edhe në Parlament.

Interpretimi autentik i Ligjit mbi Amnistinë ka mundësuar që amnistia të zbatohet edhe në të dyshuarit në lëndë, të cilat GJPNJ ia ka kthyer Maqedonisë për procedurë.

Amnesty International e ka gjykuar ashpër zbatimin e tillë të Ligjit mbi Amnistinë si shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare. E drejta e viktimave në drejtësi nuk guxon të jetë subjekt i negociatave politike dhe të afërmit e të gjithë personave të zhdukur duhet të dinë se çfarë ka qenë fati i më të afërmit të tyre.²¹³

Në mesin e atyre të cilët janë liruar nga përgjegjësia penale në bazë të interpretimit autentik të Ligjit mbi Amnistinë ka edhe funksionar të lartë politik. Ali Ahmeti, kryetar i BDI-së, partisë politike e cila e ka filluar nismën për zbatimin e amnistisë edhe ndaj kryerësve të krimeve në të ashtuquajturat lëndët e Hagës, ka qenë në mesin e të akuzuarve në lëndën *Kreu i UÇK-së*. BDI-ja participon në pushtet nga viti 2008. Ahmeti ka qenë lider politik i UÇK-së. Funksionar i lartë i të njëjtës parti është edhe Sadula Duraku, i cili në një mandat të qeverisë e ka kryer edhe funksionin e ministrit të bujqësisë. Duraku ka qenë në mesin e të akuzuarve në lëndën *Diga e Lipkovës* dhe deputet i parlamentit në momentin kur është miratuar interpretimi autentik i Ligjit mbi Amnistinë. Sot është kryetar bashkie i Lipkovës.

Është amnistuar edhe Daut Rexhepi, i akuzuari për krime të përfshira në lëndën *Neproshteno*, i cili është politikan aktiv.

8. Sllovenia

Krimet e luftës në Slloveni gjykohen sipas Ligjit penal të RSFJ-së.

8.1. Kapacitetet

Në Slloveni, pas pavarësimit të saj, janë hequr gjykatat ushtarake, dhe të gjitha gjykimet për krime të luftës janë transferuar në kompetencë të gjykatave të rregullta, nga të cilat, në 11 gjykata të qarkut (Okrojna sodišča), në 4 gjykata të larta (višja sodišča), dhe një në Gjykatën Supreme (Vrhovno sodišče). Gjykimet për krime të luftës, në shkallë të parë, janë duke u zhvilluar në gjykatat e qarkut, kurse në shkallë të dytë, në Gjykatën e Lartë kompetente. Në Slloveni nuk ekzistojnë gjykata dhe prokurori të cilët janë kompetente për krime të luftës, dhe nuk ka

210 Stenografske beleške četvrte sednice Sobraie na R Makedonije, 19 korrik i vitit 2011, f. 53..

211 Ligji mbi Amnistinë, neni 1 *Fletorja zyrtare e R. të Maqedonisë* (Službeni glasnik R.Makedonije), nr.18/2002.

212 Shënime stenografike të seancës së katërt të Kuvendit të Maqedonisë (Sobranie na R.Makedonije), 19 korrik i vitit 2011, f.3.

213 Amnesty International, "Macedonia: Time to deliver justice to the victims of war crimes", PR 1 shtator 2011, <http://www.amnesty.org/en/for-media/press-releases/macedonia-time-deliver-justice-victims-war-crimes-2011-09-01>.

shërbime të posaçme mbështetëse për dëshmitarët. Me një fjalë, nuk ka shërbime të posaçme për mbrojtjen e dëshmitarëve, zhvendosjen e tyre apo ndryshimin e identitetit.

8.2. Statistika

Pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Slloveni,²¹⁴ për shkak të shkeljeve të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare dhe të dispozitave të vendit, pranë organeve kompetente janë paraqitur 104 kallëzime penale²¹⁵. Prej tyre, 70 kallëzime janë kundër pjesëtarëve të APJ-së, kurse një kundër pjesëtarëve të Mbrojtjes Territoriale (MT). Vetëm 10 kallëzime penale janë shndërruar në aktakuza. Janë nxjerrë pesë aktgjykime të plotfuqishme, prej të cilave katër janë hedhur poshtë. Gjykatat, në 46 raste kanë refuzuar kërkesën e Prokurorisë për ngritjen e procedurës penale.

8.3. Gjykimet në proces për krime të luftës

Para gjykatës në Murska Subotë, është duke u zhvilluar procedura kundër oficerit të ish APJ-së, kolonelit Berislav Popov dhe gjeneralit Vllado Trifunoviq për shkak të veprimit të njësisë së blinduar – të mekanizuar të brigadës 32 të Korpusit të Varazhdinit, e cila kishte për detyrë të sigurojë dhe mbikëqyrë vendkalimin kufitar i cili veprim me aktakuzë është cilësuar si krim i luftës kundër popullatës civile.²¹⁶ Aktakuzat individuale, në prill të vitit 2008 janë bashkuar në një aktakuzë të përbashkët. Prokuroria në Murska Subotë e ka akuzuar Trifunoviqin dhe Popovin mbi bazën e përgjegjësisë komanduese për krime të luftës ndaj popullatës civile me rastin e intervenimit të APJ-së në Slloveni në vitin 1991.²¹⁷ Që të dy të akuzuarit janë duke u gjykuar në mungesë.

Të dy oficerët e ish APJ-së, në Kroaci janë dënuar në formë të plotfuqishme me nga 15 vjet burgim. Në Serbi, Gjykata Supreme ka anuluar aktgjykimin me të cilin Popovi dhe Trifunoviqi kanë qenë të dënuar „për shkak të rrënimit të fuqisë ushtarake dhe mbrojtëse të vendit“ për ç’arsye kanë kaluar në burg 547 ditë (Trifunoviqi), përkatësisht 446 ditë (Popovi).²¹⁸ Në ndërkohë, në bazë të vendimit të Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë, Popovit dhe Trifunoviqit iu janë paguar dëmshpërblimet në para për paraburgim të paligjshëm.

8.3.1. Lënda Radovanoviq²¹⁹

Më datën 27 qershor të vitit 1991, batalioni 1 i brigadës së blinduar 1 të Korpusit 14 të APJ-së kishte zënë pjesën jugore të aeroportit Brnik afër Lubjanës. Pjesëtarët e FARS kanë mbetur në pjesën veriore të aeroportit. Ditën e

214 Konflikti i armatosur në territorin e Sllovenisë ka filluar pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Sllovenisë në datën 25 qershor të vitit 1991 dhe ka zgjatur 10 ditë, nga data 27 qershor e vitit 1991 deri në datën 7 korrik të vitit 1991. Konflikti ka shpërthyer ndërmjet forcave të APJ-së dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Sllovenisë (FARS) të cilat përbëheshin nga njësitë e policisë dhe të Mbrojtjes Territoriale (MT). Konflikti ka përfunduar me Marrëveshjen e Brionëve, me të cilën është arritur „moratorium“ për të gjitha vendimet e njëanshme. Kryesia e RSFJ-së, në datën 18 korrik të vitit 1991 ka pranuar vendimin që APJ, bashkë me pajisjet dhe armatimin të tërhiqet nga territori i Sllovenisë. Ushtarët e fundit të APJ-së e kanë lëshuar Slloveninë në datën 25 dhe 26 tetor të vitit 1991. Në atë konflikt ka pasur 76 viktima - 8 në anën e Sllovenisë (4 policë dhe 4 pjesëtar të mbrojtjes territoriale), 45 në anën e APJ-së, janë vrarë edhe 12 shtetas të huaj dhe 10 civilë sllovenë.

215 Të dhënat janë siguruar në bazë nenit 181 të Ligjit për Prokurorinë Shtetërore të RS-së, nga të dhënat e disa prokurorive shtetërore të qarkut (PSHQ) të RS-së me ndërmjetësimin e Zyrës së Prokurorisë Shtetërore të Përgjithshme të Republikës së Sllovenisë dhe të Sekretarit të përgjithshëm të Gjykatës Supreme të Sllovenisë, të verifikuara me ndihmën e të dhënave të shpallura publikisht në medie dhe Aplikimit të Zyrës Statistikore të Sllovenisë në: http://pxweb.stat.si/pxweb/Database/Dem_soc/Dem_soc.asp#13.

216 Që të dy të akuzuarit janë shtetas të Republikës së Serbisë.

217 “Gjenerali Trifunoviq: Nuk do të shkojë në gjykim”, faqja e interneti *Radio Evropa e Lirë*, në datën 14 korrik të vitit 2010, http://www.slobodnaevropa.org/content/general_Trifunoviq_i_akuzuar_për_krim_tëluftë_në_slloveni/2099828.html.

218 Koloneli në pension Berislav Popov dhe gjenerali Vlladimir Trifunoviq janë dënuar në Kroaci me aktgjykim të plotfuqishëm me nga 15 vjet burgim. Ministria e Drejtësisë e Serbisë, në maj të vitit 2011, me oficerët Trifunoviq, Popov dhe Sreten Radushki ka nënshkruar marrëveshje për dëmshpërblim për shkak të qëndrimit në burg, i cili së shpejti edhe u është paguar, kurse disa organizata joqeveritare kanë ndërmarrë nismën për rehabilitim e tyre.

219 Shenja e shkresës: Ppl 66/98, PSHQ në Kranj; Përmbledhje dokumentesh – krimet e luftës në luftën e qershorit të vitit 1991: viti 1992. (9 shkresa) shenja: Ppl 62/92.

nesërme, dy gazetarë-fotoreporterë, shtetas të Austrisë, për të dytën herë me automjetin e tyre të terrenit kanë hyrë në pistën e aeroportit përkatësisht në hapësirën e sheshtë. Afër tyre ndodhej vetëm edhe një gazetar, si dhe zjarrfikësit. Ndaj automjetit është hapur zjarr nga drejtimi i njësisë së APJ-së. Automobili i ngarkuar me bidonë benzine është djegur kurse gazetarët-fotoreporterët kanë mbetur të vrarë. Prokuroria sllovene ka kërkuar që kundër komandantit të njësisë, majorit të APJ-së të fillohen hetimet për shkak të „mënyrës së palejueshme të luftës“ dhe të urdhrat për hapje të zjarrit. Gjykata, në datën 24 qershor të vitit 1992 ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin lirohet nga përgjegjësia penali oficeri i akuzuar i APJ-së, pasi që është konstatuar se i akuzuari ka urdhëruar të hapet zjarr vetëm „në shenjë të paralajmërimit“. Aktgjykimi nuk është i plotfuqishëm.

8.3.2. Lënda Grujoviç²²⁰

Depon e karburanteve te Pushqava në afërsi të Mokronogut e ruante kapiteni i APJ-së bashkë me dy togerë. Kapiteni kishte dashur të kalonte në MT Sllovene, kurse familja e njërit prej dy togerëve jetonte në Mokronog, andaj edhe ai dëshironte të dorëzohej. Por Grujoviç, togeri tjetër i APJ-së kishte refuzuar për ta dorëzuar depon. Kishte Pasuar konflikti i armatosur ndërmjet kapitenit dhe togerit Grujoviç. Kapiteni ishte lënduar, por kishte arritur për të ikur, ndërsa togeri Grujoviç kishte organizuar mbrojtjen e karburanteve dhe kanosej se depon do ta hedhë në ajër në rast se MT tenton ta marrë. Në datën 15 korrik të vitit 1993, gjykata ka filluar hetimet për shkak të krimit të luftës kundër popullatës civile. Në datën 28 tetor të vitit 1994 kundër Grujoviçit është ngritur aktakuza. Nga mesi i vitit 2007, gjykata ka ripërtërirë fletarrestimin ndërkombëtar ndaj të akuzuarit Grujoviç.

8.4. Hetimet e papërfunduara

Në Slloveni janë në zhvillim e sipër 15 hetime për krime të luftës.

Rasti Çeshça vas/ fshati Çeshçe ka të bëjë me vrasjen e një civili më në datën 5 korrik të vitit 1991, në të cilin ka shtënë shoferi i panjohur i automobilin, pranë depos së APJ-së. Policia edhe sot e kësaj dite është duke kërkuar kryerësin.

Ende është duke u zhvilluar hetimet edhe në rastin *Medvedjek*. Forcat e FARS-së kanë ndaluar njësinë e artilerisë të mbrojtjes kundërajrore të regjimentit 306 të mbrojtjes së lehtë kundërajrore të APJ-së, dhe pas kësaj nga avioni i APJ-së është kryer sulmi ndaj barrikadave dhe njerëzve të FARS-së, me ç'rast kanë humbur jetën 8 civilë, në mesin e të cilëve kanë qenë pesë shtetas bullgarë dhe është plagosur një numër i madh i personave ushtarak dhe civilë. Prokuroria Sllovene, në datën 29 janar të vitit 1992 i ka paraqitur kërkesë gjykatës për zhvillimin e hetimeve për shkak të krimit të luftës kundër popullatës civile. Bullgaria, në maj të vitit 1992 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Sllovenisë me pyetjen „a janë thirrur në përgjegjësi personat fajtorë për kryerjen e veprës së dënueshme“²²¹. Prokuroria Sllovene është përgjigjur se „personat përgjegjës për sulm ndaj civilëve nuk janë zbuluar dhe po ashtu as kryerësit e drejtpërdrejtë, për ç'arsye nuk është zhvilluar as procedura penale“²²².

Hetimet nuk kanë përfunduar as në rastin e sulmit nga avioni me raketa, të cilat e kanë goditur ndërtesën e ndërmarrjes AR Holding. Prokuroria në vitin 1999 ende ishte në fazën e mbledhjes së të dhënave për kryerësin.

Për shkak të sulmit nga avioni kundër barrikadave pranë kazermës në Murska Subotë në datën 28 qershor të vitit 1991, me ç'rast është vrarë një ushtar i APJ-së kurse një tjetër është plagosur, Prokuroria Sllovene është duke kërkuar kryerësit për shkak të „krimit të luftës kundër popullatës civile“.

Në rastin *Gibina* policia është duke gjurmuar pas kryerësve nga radhët e APJ-së për shkak të „hapjes së zjarrit pa zgjedhur objektivin“.

220 Shenja e shkresës: Pp 629/91, PSHQ në Novo-Mesto.

221 Pom 5/2006, 7.03.2006.

222 ppn 328/91-JF/vj, 27.03.2006.

Në rastin *Lutomer* policia ende është duke gjurmuar pas pilotëve të APJ-së, të cilët kanë sulmuar barrikadën e FARS-së në qytetin Lutomer.

Në rastin Boç, aviacioni i APJ-së, në datën 2 korrik të vitit 1991 gabimisht ka kryer sulmin nga avioni ndaj pirtgut të telekomunikimit në malin Boç, të cilin e siguronte njësia e APJ-së. Asnjë raketë nuk e ka goditur objektivin. Pas saj, pjesëtarët e FARS-së, me minahedhës të kalibrit 82 mm kanë sulmuar pirtgun, kurse ushtarëve të APJ-së iu është kumtuar se përsëri është duke i sulmuar aviacioni i APJ-së. Si rrjedhojë, ushtarët e a APJ-së iu janë dorëzuar FARS-së. Prokuroria Sllovene, në datën 19 gusht të vitit 1991 ka kërkuar hetim kundër oficerit të APJ-së, i cili ka kërkuar bombardimin e pjesëtarëve të FARS-së, sepse këtë e ka bërë „ në kundërshtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare“ dhe krahas kësaj ka shkaktuar dëme të mëdha.

Në rastin Shentil, policia është duke gjurmuar pas oficerit të APJ-së, i cili ka urdhëruar hapjen e zjarrit nga topat, për ç'arsye janë shkatërruar lokalet e policisë, të doganës, të objekteve të firmës Kompas dhe të pompës së benzinës, të cilën gjë Prokuroria e ka cilësuar si krim të luftës.

Hetimet janë duke u zhvilluar edhe në rastin Zaçeviq, kundër kapitenit të APJ-së, për arsye se si ndihmës komandant i batalionit të blinduar „ka urdhëruar shkatërrimin e pasurisë në përmasa të mëdha“ dhe kështu ka shkatërruar një shtëpi në Shtrihovc. Të ngjashme janë edhe rastet Saviq, Duqan Shentil, Sredishçe mbi Dravë, rasti Mashanoviq, si dhe hetimet në lëndën Juriq e Llukiq dhe Vujoviq.

8.5. Lëndët e përfunduara në formë të plotfuqishme

8.5.1. Lënda *Arsimi dhe të tjerët*.²²³

Punëtor i ndërmarrjes *Elektro Maribor*, i njësisë afariste në Ptuj, sipas instruksioneve të eprorëve, në datën 24 maj të vitit 1991, për të dytën herë ia ka ndërprerë rrymën elektrike kazermës së APJ-së. Kur e ka mbyllur trafostacionin, e ka goditur në këmbë një plumb të cilin e ka shkreh roja nga kazerma e APJ-së. Prokuroria Sllovene kallëzimin ia ka ceduar Gjykatës Ushtarake në Zagreb, sepse në atë kohë ka qenë në fuqi „ Moratoriumi“ lidhur me pavarësimin e Sllovenisë. Gjykata Ushtarake në Zagreb ka konkluduar se kjo nuk ka pasur të bëjë me akt të kundërligjshëm. Më vonë, prokuroria në Ptuj, megjithatë, ka ngritur aktakuzë për vepër penale të shkaktimit të plagëve të rënda trupore. Gjykata e Lartë në Maribor, në datën 14 qershor të vitit 1994, ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin i akuzuari lirohet nga përgjegjësia penale.

8.5.2. Lënda *Koder*.²²⁴

Majori i APJ-së (me prejardhje sllovene), i cili në prag të konfliktit në Slloveni ka shërbyer si pilot-mësues i fluturimeve në aeroportin ushtarak të Pullës në Kroaci, në vitin 2001 ka punuar në Podgoricë si shtetas i RFJ. Aty është transferuar qysh në kohën e konfliktit në Slloveni. Prokuroria Sllovene, në datën 8 dhjetor të vitit 1994 ka ngritur hetimet për shkak të „shërbimit në ushtri të huaj“ dhe për atë se „nuk iu është përgjigjur thirrjes së Kryetarit të Sllovenisë (në vitin 1991) për të dalë nga ajo ushtri“. Prokuroria Sllovene ka ngritur aktakuzë, por Gjykata e Qarkut në Nova-Goricë, në datën 17 dhjetor të vitit 2001 ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin i akuzuari lirohet nga përgjegjësia penale.

8.5.3. Lënda *Veliqi*.²²⁵

Në fshatin Crni Vërh mbi Idri ka qenë e vendosur depoja e municionit dhe e pajisjeve të Mbrojtjes Territoriale

223 Shenja e shkresës: I PP 710/91, PSHQ në Ptuj.

224 Shenja e shkresës: Pp 188/94, PSHQ në Nova-Goricë.

225 Shenja e shkresës: PP 79/92), PSHQ në Nova-Goricë.

të Komunave të Bregdetit Verior. Këtë depo e siguronte togu i pjesëtarëve të APJ-së. Pjesëtarët e MT Sllovene, në datën 25 qershor të vitit 1991, nga kjo depo kanë larguar një pjesë të pajisjeve. Pasi që edhe një grup civilësh tentonte të merrte depon, komandanti i rojës bashkë me njësinë e vet (me ushtarët e APJ-së), të ndarë në dy grupe, ka braktisur depon. Depon, në të njëjtën natë e ka shkatërruar një shpërthim i fuqishëm. Me këtë rast kanë pësuar 178 shtëpi të Crni Vërhit. Prokuroria Sllovene ka kërkuar hetime kundër togerit të APJ-së me akuzë se ka minuar depon dhe ka vepruar me urdhër për të detonuar depon në rast se „dëgjohen të shtëna“. Në datën 29 prill të vitit 1992 gjykata ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin i akuzuari lirohet nga përgjegjësia penale me arsyetimin se „qëllimi i të akuzuarit ka qenë që vetëm të parandalojë që mjetet e padëmtuara luftarake të bien në duar të palës së kundërt“. Aktgjykimi është i plotfuqishëm

8.5.4. Lënda Shtrihovec I²²⁶

Çeta e tankeve e APJ-së nga kazerma *Franc Rozman Stane* në Maribor ka depërtuar në drejtim të vendkalimit kufitar Shentil në kufirin me Austrinë, më 27 qershor të vitit 1991; këtë e ka ndaluar barrikada e FARS-së në Shtrihovec. FARS, ka sulmuar kolonën e APJ-së në momentin kur ajo tentonte të shpërthej barrikadën. Kolonës së tankeve të APJ-së i ka ardhur në ndihmë aviacioni i APJ-së. Gjatë sulmit janë vrarë katër shoferë të kamionëve civil (të cilët kanë qenë të ndalur në kolonë), ndërsa janë lënduar disa civilë dhe pjesëtarë të FARS-së. Ekspertët slloven të kriminalistikës kanë kryer hetimet dhe kanë konstatuar identitetin e dy pilotëve ushtarak të APJ-së. Policia sllovene, në saje të fletarrestimit, njërin prej tyre e ka arrestuar në datën 3 shtator të vitit 1998 në vendkalimin kufitar slloven. Nga fundi i vitit 1998 prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër kolonelit të APJ-së për shkak të „përdorimit të mjeteve të palejueshme luftarake“ dhe të shkeljes së zakoneve të luftës. Në datën 17 shkurt të vitit 1999, gjykata ka nxjerrë aktgjykim, me të cilin i akuzuari lirohet nga përgjegjësia penale, sepse nuk ka pasur prova se piloti i arrestuar i APJ-së ka fluturuar afër mbi Shtrihovec në tipin e sipërpërmendur të avionit dhe se atje ka zhvilluar operacione luftarake.

Gjykata e ka hedhur poshtë aktakuzën e prokurorisë sllovene edhe në rastin Kolenoviq. Shoferi i kombibusit të APJ-së është akuzuar në mënyrë të pabazuar se ka rrezikuar sigurinë, sepse nën ndikimin e alkoolit „ka vozitur me shpejtësi të madhe në drejtim të fëmijëve“.²²⁷

9. Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët

9.1. Bosnja dhe Hercegovina

9.1.1. Mbrojtja e dëshmitarëve

BdheH ka dy ligje të cilat rregullojnë mbrojtjen e dëshmitarëve: Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar dhe të dëshmitarëve të kërcënuar²²⁸, i miratuar në vitin 2003 dhe me kompetencë për tërë territorin e BdheH, dhe Ligjin për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve në BdheH,²²⁹ me të cilin përcaktohen masat konkrete mbrojtëse, por i cili vlen vetëm në nivel nacional.²³⁰ Agjencia Shtetërore për Kërkime dhe Mbrojtje (SIPA), e cila zbaton Programin e mbrojtjes, është kompetente për mbrojtjen e dëshmitarëve ekskluzivisht në procedurat para

226 Shenja e shkresës: I PP 1472/98, PSHQ në Maribor.

227 Shenja e shkresës: PP 137/91, PSHQ në Kopër.

228 Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar dhe të dëshmitarëve në kërcënim *Gazeta Zyrtare e BdheH* 21/03, 61/04, 55/05.

229 Ligji për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve në BdheH, *Gazeta Zyrtare e BdheH* Nr. 29/04. http://www.sudbih.gov.ba/files/docs/zakoni/ba/zakon_o_programu_zastite_svjedoka_29_04_-_bos.pdf.

230 Kundër Propozim ligjit i cili parashikonte zgjerimin e juridiksionit të Programit për mbrojtje edhe në entitete votuan përfaqësuesit e Republika Srpska.

Gjykatës Shtetërore të BdheH. Seksioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (SMD)²³¹i SIPA-s ka kompetencë ekskluzive në zbatimin e Ligjit për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve në BdheH, pastaj ofron formë përkatëse të mbështetjes dhe të mbrojtjes specialiste për dëshmitarët e mbrojtur para gjykatës së BdheH. Nga nëntori i vitit 2004 deri në fund të vitit 2011, SMD ka ofruar mbrojtje dhe mbështetje për 560 persona me status të dëshmitarit të mbrojtur, ku nga kjo në 95 për qind të rasteve mbrojtja ka pasur të bëjë me dëshmitarët në procedurat për krime të luftës. Në vitin 2010, SMD është kujdesur për mbrojtjen e 49 dëshmitarëve të mbrojtur, kurse në vitin 2011 për 102 dëshmitarë të mbrojtur në lëndët për krime të luftës.²³²

Në BdheH është konstatuar një numër jashtëzakonisht i madh i rasteve në të cilat dëshmitarët në procedurat e krimeve të luftës kërcënohen dhe jo rrallë ndaj tyre përdoren metoda të frikësimit.²³³ Milojka Antiq, e cila ka qenë e burgosur në kamp në fshatin Çelebiq ku ka qenë e ekspozuar dhunimit, ka dëshmuar para GJPNJ-së kundër disa kryerësve.²³⁴Një prej tyre, Hazim Deliq, i cili ka vuajtur dënimin me burgim, e ka thirrur Milojkën Antiqin në datën 6 janar të vitit 2009 dhe i është kërcënuar se do të „përjetojë edhe më keq nga ajo që kishte përjetuar në vitin 1992“. Që nga atëherë, ajo jeton nën frikë të vazhdueshme. Ajo ka raportuar në polici për atë që i kishte ndodhur në Vishegrad. Deri në muajin tetor të vitit 2011 nuk ka marrë njoftim nga policia për hetimet që janë ndërmarrë dhe nuk e din nëse janë ndërmarrë çfarëdo hapash. Deliqi asnjëherë nuk është marrë në pyetje.²³⁵

OSBE, në raportin e vet për praktikën e mbrojtjes dhe të mbështetjes për dëshmitarët në lëndët e krimeve të luftës në BdheH ka cekur se lëshimet në sigurimin e të njëjtëve qëndrojnë në mospunë në aspektin e sigurimit të mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve për ç’arsye viktimat dëshmitarë gjithnjë e më pak dëshirojnë të bashkëpunojnë në procedurat penale dhe gjithnjë e më pak besojnë se gjykimet mund të sjellin realizimin e së drejtës.²³⁶Efikasiteti i mbrojtjes së dëshmitarëve jo rrallë komprometohet në mungesë të koordinimit. Dëshmitarët, të cilëve iu janë caktuar pseudonimet, në mënyrë që të mbrohet identiteti i tyre, janë ankuar se po i marrin thirrjet nga gjykatat nëpërmjet postës së rregullt në ç’mënyrë masat për mbrojtjen e tyre zvogëlohen në mënyrë drastike. Bashkësia lokale mund të arrijë lehtë deri te të dhënat se ata janë ftuar për të dëshmuar.²³⁷Akuzuesit ose ata që i përfaqësojnë publikisht zbulojnë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur.²³⁸ Deri në fund të vitit 2011 është ngritur vetëm një aktakuzë për zbulimin e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur para organeve shtetërore në BdheH.²³⁹

231 Sektori për mbrojtjen e dëshmitarëve është nënshkruar i Marrëveshjes për bashkëpunim dhe mirëkuptim në lëmin e mbrojtjes së dëshmitarëve me Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë dhe me Maqedoninë. Për veprim operativ në territorin e BdheH, ky sektor ka vendosur bashkëpunim mjaft të mirë me Sektorin për mbështetjen e dëshmitarëve të Gjykatës së BdheH, ku mbi bazën e kontakteve të përditshme ose javore këmbëhen informacione përkatëse, realizohen koordinime përkatëse në fushën e mbështetjes reciproke dhe të formave të caktuara të ndihmës për këtë Sektor.

232 Informacion i marrë nga SIPA; i datës 06 janar të vitit 2012.

233 Doc. 12440 rev Committee on Legal Affairs and Human Rights Report: The protection of witnesses as a cornerstone for justice and reconciliation in the Balkans Rapporteur: Mr Jean-Charles GARDETTO, Monaco, Group of the European People’s Party, 12 January 2011.

234 *Prokurori kundër Muçiqit dhe të tjerëve* (IT-96-21), aktgjykimi i GJNPJ, më 16 nëntor 1998.

235 Marrë nga: Written information for the follow-up to the concluding observations of the Committee against torture on Bosnia and Herzegovina’s combined second to fifth periodic reports (CAT/C/BIH/CO/2-5). Submitted by TRIAL and 19 war victim organizations of Bosnia and Herzegovina (par. 75.) http://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/followup/ngos/TRIAL_1_BosniaHerzegovina45.pdf

236 OSCE Misioni në BdheH, *Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët në lëndët e krimeve të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë: Pengesat dhe rekomandimet një vit pas miratimit të Strategjisë shtetërore të punës në lëndët e krimeve të luftës*, janar 2010, f. 8.

237 Doc. 12440 rev Committee on Legal Affairs and Human Rights Report: The protection of witnesses as a cornerstone for justice and reconciliation in the Balkans Rapporteur: Mr Jean-Charles GARDETTO, Monaco, Group of the European People’s Party, 12 January 2011. Par. 52.

238 Marrë nga: Written information for the follow-up to the concluding observations of the Committee against torture on Bosnia and Herzegovina’s combined second to fifth periodic reports (CAT/C/BIH/CO/2-5). Submitted by TRIAL and 19 war victim organizations of Bosnia and Herzegovina (par. 76.), http://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/followup/ngos/TRIAL_1_BosniaHerzegovina45.pdf

239 “Gjykata Shtetërore në vitin 2011: 31 aktgjykime për krime të luftës”, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, më 08 janar 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/gjykata_shtetërore_në_vitin_2011_33_aktgjykime_për_krime_të_luftës_/24444988.html.

Në entitete nuk ekziston korniza adekuate ligjore dhe as nuk janë themeluar shërbimet e specializuara policore dhe shërbimet e tjera për zbatimin e masave të mbrojtjes dhe të mbështetjes për dëshmitarët që i cakton gjykata, ashtu siç është bërë kjo në nivelin shtetëror të BdheH.²⁴⁰

9.1.2. Mbështetja për dëshmitarët dhe viktimat

Edhe pse me ligj është parashikuar mbështetja për dëshmitarët viktime, pranë të gjitha gjykatave dhe prokurorive, vetëm Gjykata e BdheH ka Departamentin për mbështetje për dëshmitarët në lëndët e krimeve të luftës. Departamenti ka gjithsej 7 të punësuar, nga të cilët 4 janë psikologë, 1 punëtor social dhe 2 asistentë administrativë²⁴¹ Sipas deklaratës së Alma Taso–Delković, ky departament është specifik në krahasim me shërbimet e tjera në rajon dhe është i orientuar nga ofrimi i mbështetjes psikologjike.²⁴² Theksi është vënë në mbështetjen profesionale dhe në qasjen individuale ndaj secilit dëshmitar, sepse bëhet fjalë për punën me njerëzit që kanë përvoja jashtëzakonisht të rënda.

Departamenti për mbështetjen e dëshmitarëve i Gjykatës së BdheH, nga muaji maj i vitit 2005, kur ka filluar nga puna e deri në datën 31.12.2011, iu ka ofruar mbështetje 4.305 dëshmitarëve në lëndët e Seksionit I.²⁴³

Gjatë viteve 2010 dhe 2011 janë themeluar edhe tri departamente: Departamenti për mbështetjen e dëshmitarëve i Gjykatës Kantonale në Sarajevë dhe i Prokurorisë Kantonale në Sarajevë, dhe Departamenti i Gjykatës së Qarkut dhe i Prokurorisë së Qarkut në Banjallukë. Departamenti për mbështetjen e dëshmitarëve i Gjykatës së B dhe H ka rol bashkërendues kur është fjala për punën e departamenteve të sapoformuara, kurse planifikohet të vazhdohet me hapjen e departamenteve të reja.²⁴⁴

Për shkak të reagimeve të mundshme psikologjike, me rastin e dëshmimit në lëndët e krimeve të luftës, e me pëlqimin e kolegjit gjyqësor, psikologut të DMD, i lejohet të jetë i pranishëm në Gjykatore bashkë me dëshmitarin në mënyrë që të mund të reagojë me kohë. Roli i psikologut në gjykatore është të paralajmëroje gjykatësin në rast se dëshmitari tregon reaksione psikologjike për shkak të të cilave nevojitet të bëhet pauzë.²⁴⁵ Në praktikë, viktimat, shpeshherë, gjatë dëshmisë, janë të ballafaquara me ndërhyrje nga ana e të akuzuarve. Hasna Çusto, ish e burgosur në kampin e Kalinovikut, është sulmuar verbalisht derisa jepte dëshmi para Gjykatës së BdheH, në rastin *Milan Periq dhe të tjerët*. Kur ka hyrë në gjykatore, është sulmuar verbalisht dhe është ofenduar nga i akuzuari kryesor. Derisa Çusto është lutur të lëshojë gjykatoren, pa pasur mundësi të mbrohet, Periqi nuk ka marrë kurrfarë vërejtje. Ky rast Çustos i ka shkakuar trauma serioze psikologjike dhe ajo më nuk dëshiron të dëshmojë para gjykatave, sepse nuk u beson institucioneve. Shoqata “E Vërteta - Kalinovik 92” këtë rast ua ka paraqitur autoriteteve, mirëpo asnjëherë nuk ka marrë kurrfarë përgjigje të rëndësishme.²⁴⁶

Viktimat e dhunimeve të luftës dhe të dhunës seksuale nuk janë të motivuara për të dëshmuar publikisht, „për shkak të frikës ose të mosbesimit ndaj sistemit ligjor dhe ndaj sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve/eve“.²⁴⁷ Hulumtimi të cilin e ka kryer Amnesty International ka treguar se shumica e viktimave do të ishte e gatshme të dëshmonte për

240 Strategjia shtetërore e punës në lëndët e krimeve të luftës, dhjetor 2008, f. 29.

241 Informacion i marrë nga Departamenti për mbrojtjen e dëshmitarëve i Gjykatës së BdheH, i datës 5 janar të vitit 2012.

242 Komunikim me emali me Alma Tason – Delković, udhëheqësen e Departamentit për mbrojtjen e dëshmitarëve të Gjykatës së B dhe H, i datës 12 dhe 13 janar të vitit 2012.

243 *Po aty*.

244 Informacion i marrë nga Departamenti për mbrojtjen e dëshmitarëve i Gjykatës së BdheH, më 5 janar 2012. godine.

245 UNDP, *Vlerësimi i nevojave në fushën e mbështetjes për dëshmitarët /viktimat në Bdhe H*, janar 2010, f. 31-32.

246 Marrë nga: Written information for the follow-up to the concluding observations of the Committee against torture on Bosnia and Herzegovina's combined second to fifth periodic reports (CAT/C/BIH/CO/2-5). Submitted by TRIAL and 19 war victim organizations of Bosnia and Herzegovina (par. 74.), http://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/followup/ngos/TRIAL_1_BosniaHerzegovina45.pdf

247 Intervistë me Jasmina Çausheviqin, vëzhguese e gjykimit në kuadër të projektit të ACIPS-it “Aplikimi i përcjelljes së gjykimit, sensitiv në pikëpamje gjinore, të rasteve të dhunës seksuale të luftës në Gjykatën e BdheH”.

përvojën e vet, sado traumatike, sikur sistemi i mbështetjes ndaj viktimave të ishte më i ndjeshëm ndaj nevojave të tyre.²⁴⁸

9.2. Kroacia

9.2.1. Mbrojtja e dëshmitarëve

Zbulimi i identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur ose të rrezikuar penalisht sanksionohet në Kroaci.²⁴⁹ Me Ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve (të miratuar në vitin 2004) janë formuar Njësia për Mbrojtje (e cila është në përbërje të Drejtorisë së Policisë së Ministrisë së punëve të brendshme) dhe është përgjegjëse për zbatimin e Programit të Mbrojtjes si edhe Komisioni, që është përgjegjës për sjelljen e vendimit për inkuadrimin dhe ndërprerjen e Programit të Mbrojtjes, si dhe punëve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj. Në përbërje të Komisionit janë Përfaqësuesit e Gjykatës Supreme të Republikës së Kroacisë, PSHRK, të sistemit të burgjeve, ministrisë përgjegjëse për punët e gjyqësorit /drejtësisë, të Drejtorisë së Policisë si dhe udhëheqësi i Njesisë për Mbrojtje.²⁵⁰ Sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve në Republikën e Kroacisë prapëseprapë ka mangësi të rëndësishme. Një nga problemet e nxehta është çështja e mbrojtjes së identitetit të viktimave dhe të dëshmitarëve në fazën paraprake atë hetimore.

Në vitin 2011, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut i ka dorëzuar PSHRK shumë deklarata të anëtarëve të familjeve të viktimave të krimeve të luftës kundër popullatës civile të kryera në Vukovar në verën e vitit 1991 nga ana e forcave të sigurisë kroate. Në këto deklarata, personat i kanë shprehur njohuritë e tyre mbi vrasjet dhe zhdukjet e përdhunshme të anëtarëve të familjeve të tyre; mbi rrethanat e zhdukjes dhe, nëse kanë pasur farë njohurish, mbi kryerësit. Nga njëra prej këtyre deklaratave ka rezultuar se si Shefi i Shtabit të Krizës për Sllavoninë Lindore dhe Baranjen, kurse nënkryetar i tashëm i Parlamentit kroat, Vladimir Sheks, ka ditur për vrasjet dhe rrëmbimet e civilëve të kombësisë serbe në zonën e Vukovarit. Sheksi, dy ditë pas dorëzimit të këtij dokumentacioni PSHRK, i ka dhënë deklaratë hetuesve dhe e ka marrë në shikim gjithë dokumentacionin e dorëzuar. Pastaj, në një emision informativ të Radio-televizionit kroat e ka thënë emrin dhe mbiemrin e njërit prej personave, i cili Nismës ia ka dhënë deklaratën.

Nga kjo shihet se janë të mangët mekanizmat e mbrojtjes së dëshmitarëve (ose të personave të cilët kanë njohuri për krimet) në fazën paraprake dhe hetimore. Mekanizmat janë të mangët edhe për faktin se mbrojtjen e parashohin vetëm në fazën e gjyqimit, ku dëshmitarët, varësisht nga rreziku, mund të pranojnë nivele të ndryshme të mbrojtjes. Kjo është një rrethanë, e cila në masë të madhe ua vështirëson dëshmitarëve dhënien e deklaratave mbi krimet e luftës. Në rrethanat kur të dyshuarit ose të akuzuarit i jepen në shikim identitetet e dëshmitarëve para gjyqimit, mbrojtja e identitetit të dëshmitarit gjatë gjyqimit nuk ka kuptim, sepse identiteti i tyre atëherë tashmë është i njohur. Kështu, i akuzuari Branimir Gllavash ua ka treguar gazetarëve emrat dhe mbiemrat e dëshmitarëve të mbrojtur.

9.2.2. Mbështetja për dëshmitarët

Shoqatat joqeveritare, të cilat i përcjellin gjykimet për krimet e luftës konsiderojnë se viktimat dhe dëshmitarët në procedura me vite kanë qenë të lënë anash dhe, së këndejmi, rezultat i kësaj sot është mosinteresimi për të dëshmuar dhe refuzimi që në të të merret pjesë.²⁵¹ Ato konstatojnë se rrjeti i përkrahjes është i përparuar, por se është e nevojshme të zgjerohet vëllimi i përkrahjes.²⁵²

248 Amnesty International, *E drejta e kujt? Gratë e Bosnjës dhe Hercegovinës ende presin*, shtator 2009, f.39.

249 Ligji penal, neni 305, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, 110/97, 27/98, 50/00, 129/00, 11/03, 190/03, 105/04, 84/05, 71/06, 110/07, 152/08, 57/11.

250 Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, 163/03, 18/11.

251 Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Documenta dhe Komiteti Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjyqimeve për krime të luftës – raport për vitin 2011*.

252 *Po aty*.

Mbështetja e viktimave dhe e dëshmitarëve hyn në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe me të udhëheq Drejtoria për lirim me kusht dhe mbështetjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, kurse ekzistojnë departamente edhe pranë gjykatave të qarkut²⁵³. Brenda Drejtorisë së cekur është themeluar Sektori për Mbështetjen e Viktimave dhe Dëshmitarëve (SMVD), në kuadër të të cilit janë të formuara dy departamente: Seksioni për organizimin e mbështetjes për viktimat dhe dëshmitarët dhe Seksioni për zhvillimin dhe koordinimin e sistemit të mbështetje për viktimat dhe dëshmitarët.

Seksioni për organizimin e mbështetje së viktimave dhe të dëshmitarëve e organizon ndihmën psikosociale, e ofron informimin juridik mbi të drejtat e viktimave dhe të dëshmitarëve, si dhe ndërmjetëson në sigurimin e mbrojtjes shëndetësore kur kjo është e nevojshme. Po ashtu, Seksioni ofron përkrahjen logjistike në organizimin e udhëtimit dhe të qëndrimit të personelit. Seksioni për zhvillimin dhe koordinimin e sistemit të përkrahjes për viktimat dhe dëshmitarët merr pjesë në përpunimin e dokumenteve strategjike për mbrojtjen dhe për përparimin e të drejtave të viktimave dhe të dëshmitarëve dhe e përcjellë zbatimin e tyre në fushën e drejtësisë, merr pjesë në përpunimin e rregullave dhe në dhënien e mendimit lidhur me rregullat nga fusha e mbështetjes së viktimave dhe dëshmitarëve, përpunon rekomandimet për barazimin e praktikës së sjelljes me viktimat dhe me dëshmitarët, i grumbullon të dhënat, i punon raportet dhe analizat mbi sistemin e mbështetjes së viktimave dhe të dëshmitarëve, si dhe kryen punët profesionale dhe administrative për Komisionin qeveritar për monitorimin dhe përparimin e sistemit të mbështetjes për viktimat dhe dëshmitarët. Seksioni e koordinon punën dhe e kryen monitorimin mbi punën e departamentit për organizimin dhe dhënien e përkrahjes për dëshmitarët dhe viktimat në gjykata, e organizon dhe e zbaton edukimin dhe mbikëqyrjen psikologjike të të punësuarve në departamente dhe të vullnetarëve.

Pranë gjykatave të qarkut janë të themeluar Departamentet për organizimin dhe për dhënien e mbështetjes për dëshmitarët dhe viktimat.²⁵⁴ Detyrat e këtyre Departamenteve janë dhënia e mbështetjes emocionale dhe e informatave praktike dëshmitarëve dhe viktimave, që dëshmojnë në gjykatat e cekura në fazën e hetimeve dhe të shqyrtimit kryesor.²⁵⁵ Përkrahja është e siguruar edhe për personat të cilët shkojnë në përcjellje të dëshmitarëve dhe të viktimave. Pranë secilit departament janë të punësuar nga dy zyrtarë, të cilët, me ndihmën e vullnetarëve, i ofrojnë përkrahje dëshmitarëve edhe në gjykatat për kundërvajtje edhe në ato komunale.

61

Në kuadër të shërbimit për mbështetje për dëshmitarët pranë gjykatave të qarkut janë të angazhuar edhe 180 vullnetar; janë të punësuar psikologët dhe punëtorët social si dhe truprojat. Shërbimi e ka buxhetin në vlerë prej 300.000 eurosh. Janë të punësuar 20 njerëz, kurse është planifikuar rritja e numrit të të punësuarve në vitin 2012, me faktin që do të angazhohen psikologët dhe punëtorët social dhe jo administrata.

9.3. Serbia

9.3.1. Mbrojtja e dëshmitarëve

Mbrojtja e dëshmitarëve në Serbi është e rregulluar që nga viti 2005 me Ligjin mbi Programin e Mbrojtjes së Pjesëmarrësve në Procedurën Penale (“).²⁵⁶ Ligji ka të bëjë me të gjithë pjesëmarrësit në procedurën penale, të cilët i ekspozohen rrezikut për jetë, shëndet, liri ose pronë. Për sigurimin e mbrojtjes së personave të cekur janë të domosdoshme, sipas ligjit, Njësia për mbrojtje, e cila është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Komisioni për zbatimin e programit të mbrojtjes, të cilin e përbëjnë tre anëtarë, nga tri institucione, – Gjykata Supreme e Serbisë (që është edhe Kryetari i Komisionit), Prokuroria Republikane dhe MPB-ja (udhëheqësi i Njësisë).

253 Të dhënat për mbështetjen për viktimat dhe dëshmitarët i kemi marrë në dokumentin e dërguar nga Drejtoria për Probacion dhe të drejta të viktimave dhe të dëshmitarëve pranë MD.

254 Në Gjykatat e Qarkut në Zagreb, Zarë, Osijek, Sisak, Split, Rijekë dhe Vukovar.

255 Mbështetjen e ofrojnë për dëshmitarët e të gjitha veprave penale, duke i përfshirë edhe lëndët e krimeve të luftës.

256 Me Ligjin mbi programin e mbrojtjes së pjesëmarrësve në procedurën penale, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 85/05.

Njësia e MPB-së së Serbisë për mbrojtjen e dëshmitarëve (në tekstin e mëtejshëm Njësia] bashkëpunon me njësitë policore për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kroaci dhe B dhe H, dhe me Njësien e EULEX-it për hetime të krimeve të luftës. Nuk ka vërejtje lidhur me sjelljen e Njësies ndaj të dëmtuarve. FDH e vë në spikamë se marrëdhënia e Njësive dhe e PKL ndaj dëshmitarëve të mbrojtur, kryesisht dëshmitarëve insajderë, është plotësisht ndryshe. Të dhënat, deri tek të cilat ka ardhur FDH-ja tregojnë se në vitin 2010, dëshmitari i mbrojtur në lëndën *Podujevë II* e ka lëshuar programin e mbrojtjes për shkak të maltretimit dhe masave të çorientimit, të cilat ndaj tij i ka zbatuar Njësia. Një dëshmitar të mbrojtur nga lëndë *Detashmenti 37 i NJPP*, Njësia në muajin korrik të vitit 2010 e ka përjashtuar nga programi i mbrojtjes në atë mënyrë që pjesëtarët e asaj Njësie kanë shkuar në banesën e tij, të cilin e shfrytëzon në kuadër të programit të mbrojtjes, ia kanë kumtuar se i është hequr mbrojtja dhe menjëherë pas kësaj e kanë kthyer me familjen e tij në vendbanimin e mëhershëm.²⁵⁷ Mbi atë dëshmitarë, në faqen e tij të Internetit, PKL thotë²⁵⁸ se ai dëshmitar ka ushtruar trysni në prokurorin që ta punësoj në Prokurori dhe që t'ia paguajë mëditjet, kurse pastaj "ka filluar të shfaq pakënaqësinë e tij me nisjen e akuzave të rrejshme". Mbi dëshmitarin e dytë, PKL thotë se ai „gjithë kohën e ka shantazhuar prokurorin në procedurë, sepse nuk ka dashur të dëshmojë derisa prokurori nuk i ofron punësimin e serishëm në MPB [...] për këtë arsye, dëshmitari nuk i është përgjigjur disa thirrjeve të gjykatësit hetues gjatë hetimeve për të dëshmuar, dhe në fund as që ka dashur edhe të dëshmojë.“²⁵⁹ Dëshmitari i tretë i mbrojtur, nga e njëjta lëndë, i ka drejtuar 6 akuza në organet më të larta shtetërore të RS për shkak të keqtrajtimit nga PKL dhe Njësia. Në muajin korrik të vitit 2011, në një gjendje të rëndë psikike, ai e ka lëshuar programin e mbrojtjes.²⁶⁰

Pozita dramatike e dëshmitarëve-insajder tregohet edhe në lëndën *Qyshku*. Në shqyrtimin kryesor, në muajin dhjetor të vitit 2011, dëshmitari i mbrojtur Zoran Rashkoviç, ish pjesëtar i Detashmentit ushtarako-territorial 177 të AJ-së e ka kërkuar mbrojtjen nga trupi gjykues, duke vënë në pah se anëtarët e familjes së tij i janë ekspozuar trysnive dhe keqtrajtimit nga ana e policisë, dhe se nga PKL nuk ka marrë kurrfarë ndihme, pos përkrahjes verbale.

Pas shpalljes së raportit të raportuesit special të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Jean-Charles Gardett²⁶¹, në të cilin transmetohen kritika shumë të ashpra në llogari të organeve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarëve, PKL ka organizuar analizën e gjendjes dhe në bazë të kësaj e ka përgatitur shënimin intern, në të cilin përfundon "se janë hetuar dobësi në funksionimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve", por shprehet edhe pakënaqësia për shkak të shpalljes së dëshmitarëve në media, „të cilët kanë shprehur akuza në llogari të Njësies dhe Prokurorisë, që kanë sjellë deri te pamja negative mbi punën e Prokurorisë në publik.“²⁶²

Masa e cila disa herë është paralajmëruar nga Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria, dhe e cila do të duhet të sillte përmirësimin në këtë fushë, është ndryshimi i kompetencave ndaj mbrojtjes së dëshmitarëve që nga MPB-ja do të duhej të kalonin në kompetenca të Ministrisë së Drejtësisë. Një rekomandim i njëkohshëm është cekur si "nevojë urgjente" edhe në Raportin e Gardettit.

Në vitin 2010, në programin e mbrojtjes kanë qenë pesë dëshmitarë të krimeve të luftës, dhe shtatë persona të afërt me ta. Në vitin 2011, kanë qenë gjithsejtë pesë dëshmitarë dhe tetë persona të afërt me ta, derisa për momentin katër janë në programin e mbrojtjes si dhe pesë prej të afërmeve të tyre. Që nga themelimi i Njësies për mbrojtje, në programin e mbrojtjes kanë qenë gjithsejtë tetë njerëz dhe 18 persona nga familja e tyre e ngushtë.²⁶³

257 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Paligjësitë e procedimit të krimeve të luftës në Republikën e Serbisë*, muaji shtator i vitit 2011.

258 PKL e RS, Vërejtje ndaj raporteve të FDH-së, 14 nëntor i vitit 2011, faqja e internetit të PKL - http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/VESTI_SAOPSTENJA_2011/S_2011_11_14_CIR.pdf.

259 Është fjala për dëshmitarin e mbrojtur K-79, i cili ka dëshmuar në dy gjykime para Tribunalit të Hagës: në lëndën nr. IT-02-54, *Prokurori kundër Slobodan Millosheviqit*, dhe në lëndën nr. IT-05-87/1, *Prokurori kundër Vllastimir Gjorgjeviqit*. Në aktgjykimin për V. Gjorgjeviqin, Trupi gjykues i referohet dëshmive të këtij dëshmitari, të cilat i vlerëson si shumë të sigurta. Në deklaratën e FDH-së, ky dëshmitar pohon se prokurori Stankoviç e ka dekurajuar për të dëshmuar.

260 Dëshmitari, në ndërkohë, ka fituar azilin politik në një shtet në Evropë.

261 Jean Charles Gardetto, Report to the Council of Europe's Parliamentary Assembly on Witness Protection and Support at the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia..report 12440 rev, publikuar në datën 12 janar të vitit 2011.

262 Informacion i marrë nga Prokuroria për krime të luftës, nëntor i vitit 2011.

263 Të dhëna të përfunduara në vitin 2011. *Po aty*.

9.3.2. Përkrahja për dëshmitarët

Pranë Gjykatës së Lartë në Beograd, në Departamentin për krime të Luftës, është formuar Shërbimi për ndihmë dhe mbështetje për të dëmtuarit dhe dëshmitarët (Shërbimi i gjykatës), dhe atë në bazë të dispozitave të nenit 11 të Ligjit mbi organizimin e kompetencave të organeve shtetërore në procedurë për krime të luftës ("Gazeta Zyrtare e RS" 67/2003, 135/2004, 61/2005, 101/2007 dhe 104/2009). Edhe pse është formuar dhe punon prej vitit 2006, Shërbimi i gjykatës nuk ka ekzistuar në sistematizimin e vendeve të punës krejt deri në hyrjen në fuqi të Ligjit mbi rregullimin/organizimin e gjykatave, të datës 1 janar të vitit 2010. Shërbimi i gjykatës nuk ka një rregullore të punës, pos një rregulloreje interne, në të cilën janë të përcaktuara rregullat themelore të procedurës. Më tutje, ai nuk e ka as buxhetin e vet dhe kërkimi i mjeteve bëhet nëpërmjet Gjykatës së Lartë, në kompetencën e së cilës është. Shërbimi nuk ka psikolog të punësuar, kurse tri nëpunëset e punësuar (njëra është juriste) kanë kaluar nëpër trajnime për punë me dëshmitarët, duke përfshirë edhe trajnimin në GJPNJ në organizim të OSBE-së.

Shërbimi i gjykatës ka kompetenca për veprim që nga ardhja e dëshmitarit në ndërtesën e Gjykatës së Lartë në Beograd e deri te largimi i dëshmitarit nga ndërtesa e gjykatës, pas dëshmisë së përfunduar. Shërbimi i gjykatës i ofron dëshmitarit informacione, të cilat kanë të bëjnë me procedurën e sjelljes (ku duhet të qëndrojë dëshmitari derisa dëshmon, cila është radha e procedurave), dhe e udhëzon lidhur me të drejtën se mund të kërkojë të ulet, të kërkojë ujë, ta ndërpres dëshminë. Para shkuarjes në gjykatë, shërbimi kontakton me dëshmitarin (nga Serbia) dhe e informon mbi procedurën, bënë pyetje lidhur me nevojat e dëshmitarit, prej atyre të posaçme e deri te nevojat logjistike në lidhje me udhëtimin, mungesën në vendin e punës dhe ngjashëm. Ardhja e dëshmitarit nga Kosova për herë të parë është organizuar në bashkëpunim me EULEX-in në procedurën për krime në fshatin Qyshk, që ka filluar në muajin dhjetor të vitit 2010. Para kësaj, logjistikën komplete për numrin e madh të dëshmitarëve të dëmtuar në proceset për krimet e luftës nga vendet e rajonit e ka organizuar Fondi për të Drejtën Humanitare. Në rastin e dëshmitarëve të mbrojtur, Njësia i sjellë "deri te dera", kurse Shërbimi i gjykatës "e pranon" brenda ndërtesës dhe prapë "ia dorëzon" Njesisë pasi që dëshmia të ketë përfunduar.

Që nga formimi i tij në muajin qershor të vitit 2006 e deri në datën 21.12.2011, Shërbimi është angazhuar në 154 lëndë dhe e ka ofruar mbështetjen për 1.888 dëshmitarë, prej të cilëve 566 të dëmtuar.

63

Në vitin 2010, është ofruar mbështetja për 348 dëshmitarë (prej tyre 117 persona të dëmtuar), në 49 lëndë. Me përfundim në datën 21.12.2011, Shërbimi ka punuar me 447 dëshmitarë (199 dëshmitarë janë persona të dëmtuar), dhe ka qenë i angazhuar në 57 lëndë.²⁶⁴ Shërbimi e ofron përkrahjen për dëshmitarët në procedura hetimore, në procedura të kërkesave, në veprimet paraprake, dhe dëshmitarëve në shqyrtimin kryesor.

9.4. Kosova

9.4.1. Mbrojtja e dëshmitarëve

EULEX-i e ka Njësinë për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe programin e mbrojtjes, i cili, sipas gjetjeve të Raportuesit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Jean-Charles Gardetto, funksionon dobët për shkak të mungesës së mjeteve financiare, si dhe mosnjohjes së Kosovës, gjë që e zvogëlon numrin e shteteve të gatshme për të pranuar dëshmitarët nga Kosova, familjes tradicionalisht të madhe të dëshmitarëve të cilët dukshëm i rrisin shpenzimet e rivendosjes etj.²⁶⁵ Raportuesi Gardetto në raport ka vënë në spikamë se rivendosja e dëshmitarëve dhe e familjeve të tyre nga Kosova është e vetmja masë efektive e mbrojtjes së tyre.

Në muajin korrik të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili para-

²⁶⁴ Komunikim me email me Slavica Pekoviçin, bashkëpunëtore për mbështetje për dëshmitarët e Gjykatës së Lartë në Beograd, i datës 21 dhjetor të vitit 2011.

²⁶⁵ Jean Charles Gardetto, Report to the Council of Europe's Parliamentary Assembly on Witness Protection and Support at the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia..report 12440 rev, publikuar në datën 12. janar të vitit 2011, par.155.

sheh themelimin e Komisionit për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili vendos për fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e programit të mbrojtjes. Ligji e parasheh mbrojtjen fizike, ndryshimin e vendbanimit, ndryshimin e identitetit, duke përfshirë edhe operacionin plastik, ndihmën financiare etj. Amnesty International ka shprehur brengosjen për shkak të kësaj dispozita, e cila parasheh “regjim special për dëshmitarët e mbrojtur në burgjet dhe në shtëpitë ndëshkuese përmirësuese”.

Një problem, shumë serioz, i cili i përcjell gjykimet për krime të luftës në Kosovë ka të bëjë me dëshmitarët në proceset, në të cilat ndjehen të pasigurt dhe të cilët shpesh kanë hequr dorë nga paraqitja në gjykim ose i kanë ndryshuar deklaratat e dhëna më herët.²⁶⁶ Kjo ka të bëjë edhe me dëshmitarët e mbrojtur, qoftë në proceset nga gjykimet kosovare ose para GJPNJ, mbrojtja e të cilëve edhe më tutje përbënë një nga problemet e mëdha për EULEX-in, në mandatin e të cilit është kjo punë. Raportuesi special i Këshillit të Evropës Jean-Charles Gardetto në Raportin e tij mbi Ballkanin thotë se vështirësitë me mbrojtjen e dëshmitarëve janë “posaçërisht akute në Kosovë, ku janë vrarë dëshmitarët”.²⁶⁷

Shefi i misionit të EULEX-it, Xavier Bout de Marnhac, në një letër të hapur për mediat kosovare pas vetëvrasjes së Agim Zogajt, dëshmitarit të mbrojtur në rastin e krimeve të luftës të kryera në fshatin Kleçka, që zhvillohet kundër Fatmir Limajt në Kosovë, ka porositur se “situata në Kosovë nuk është në nivelin e kënaqshëm”, se “duhet (që) të përmirësohet” gjendja në këtë fushë, “por kjo kërkon kohë”.²⁶⁸

Hollësitë mbi Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, të cilin e zbaton EULEX-i, janë konfidenciale dhe nuk ka qenë e mundur të merren kurrfarë informacionesh mbi to.²⁶⁹ De Marnhac ka thënë në letrën e tij dërguar mediave se në punën e programit marrin pjesë “oficer me përvojë jashtëzakonisht të madhe” dhe se ai është për EULEX-in “shumë i ndjeshëm dhe i rëndësishëm”. Si probleme kyçe në procesimin e krimeve të luftës, EULEX-i e veçon sigurimin e dëshmitarëve për procese, të cilat në mungesë të të gjitha provave të tjera tash janë kyç për përparimin e mëtejme në këtë fushë. Dëshmitarët rrallë pranojnë për të dëshmuar, posaçërisht kundër kryerësve të cilët i takojnë të njëjtës anë në konflikt.²⁷⁰

Më në fund është krijuar edhe bashkëpunimi midis Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe Prokurorisë për Krime të Luftës të Republikës së Serbisë. Atë e vlerëson EULEX- si të “mirë”, por është fakt se ai bashkëpunim deri tash është realizuar vetëm në lëndën *Qyshku*, e cila zhvillohet në Beograd. EULEX-i e ka organizuar ardhjen e të dëmtuarve për të dhënë deklaratat e tyre në hetime e pastaj edhe në shqyrtimin kryesor. Ka pasur takime të rregullta të punës me prokurorët serb në tri vitet e fundit me qëllim të këmbimit të informatave.²⁷¹

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në datën 29 korrik të vitit 2011 Ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili do të hyjë në fuqi një vit pas miratimit të tij. Në diskutimin publik mbi Ligjin është paralajmëruar se programi nuk do të fillojë para përfundimit të vitit 2014 “për shkak të shpenzimeve të mëdha”, sepse për zbatimin e tij janë të nevojshme shtatë milion euro në vit.²⁷²

266 Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, *Gjykimet për krime të luftës për vepra penale etnikisht dhe politikisht të motivuara në Kosovë në vitin 2010*, Prishtinë, 2011, faqe 52.

267 Jean-Charles Gardetto, report 12440 rev, publikuar në datën 12 janar të vitit 2011.

268 Letër e hapur e Xavijer Bout de Marnjakut, Shefit të Misionit të EULEX-it, drejtuar mediave kosovare në datën 1 dhjetor të vitit 2011., <http://www.eulex-kosovo.eu/images/news/2011/november/open-letter.pdf>.

269 Intervistë me Anne Blanksma, zëdhënëse e EULEX-it në Prishtinë, e datës 05 janar të vitit 2012,

270 *Po aty*.

271 *Po aty*.

272 “Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve në vitin 2014”, faqja e internetit e gazetës *Koha Ditore*, 2 korrik i vitit 2011, <http://www.koha.net/?page=1,13,60874>.

9.5. Mali i Zi

9.5.1. Mbrojtja e dëshmitarëve

Dëshmitarëve mbrojtjen ua ofron Njësia për Mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të Sektorit të Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë së Malit të Zi, e cila sipas rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës i ka gjashtë të punësuar.²⁷³ Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve në Mal të Zi është miratuar në vitin 2004, kurse dispozitat mbi mbrojtjen e dëshmitarëve janë të pranishme edhe në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin mbi Policinë dhe Ligjin mbi Agjencinë për Sigurinë Kombëtare. Zbatohet në veprat penale të krimeve të luftës dhe të krimit të organizuar. Sipas përmbajtjes dhe mënyrës sesi e formon sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve, pothuajse është identik me Ligjin mbi Mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili është në fuqi në Serbi.

Mbrojtja e dëshmitarëve ose e të afërmeve me dëshmitarët sigurohet me anë të zbatimit të Programit të Mbrojtjes së dëshmitarëve. Mbi zbatimin e tij vendos Komisioni, anëtarë të të cilit janë gjykatës të Gjykatës Supreme të Malit të Zi, zëvendësi i kryeprokurorit të shtetit dhe udhëheqësi i Njësies për Mbrojtje.²⁷⁴ Dëshmitarët e kanë mundësinë për të dhënë deklarata me anë të ndryshimit të zërit dhe të pamjes, kurse edhe mund të zbatohen masat e përjashtimit të publikut dhe të dhënies së deklaratës nën pseudonim. Po ashtu, dëshmitarët mund të japin deklaratë me anë të videos dhe lidhjes konferencore nga ndërtesa e gjykatës, ku ndodhen në vendin më të afërm të vendbanimit të tyre.²⁷⁵ Ekzistimi i këtij sistemi të mbrojtjes në Mal të Zi është i rëndësishëm edhe për shkak të bashkëpunimit rajonal në procesimin e krimeve të luftës.

Komisioni, në fund të vitit 2010 ka sjellë vendimin mbi programin e mbrojtjes për Slobodan Pejoviqin, ish inspektorin e policisë nga Herceg Novi, dëshmitarin e aktakuzës në lëndën *Deportimi i refugjatëve*. Pejoviqit i është ofruar zhvendosja jashtë vendbanimit të tij, gjë të cilën ai e ka refuzuar, por e ka pranuar mbikëqyrjen e përforcuar të shtëpisë familjare.²⁷⁶ Raportuesi i Këshillit të Evropës Jean-Charles Gardetto në raportin e tij mbi mbrojtjen e dëshmitarëve e ka ftuar qeverinë malaziasë që në mënyrë të themeltë të hetojë të gjitha sulmet në Slobodan Pejoviqin.²⁷⁷

OSBE, në raportin e saj „Projekti i përcjelljes së gjykimeve (qershor 2009 – gusht 2010)” ka rekomanduar që në Mal të Zi të shfrytëzohet video linku, posaçërisht kur dëshmitarët janë të vendosur jashtë territorit të Malit të Zi.²⁷⁸

9.5.2. Mbështetja për dëshmitarët

Të dyja Gjykatat e Larta, në Bijelo Polje dhe në Podgoricë, para të cilave gjykohen krimet e luftës, i kanë departamentet për mbështetje të dëshmitarëve, kurse në secilën gjykatë është i punësuar nga një person.²⁷⁹ Në Gjykatën e Lartë në Bijelo Polje në shërbimin për mbështetje të dëshmitarëve punon një person, që me profesion është jurist dhe mbështetja për dëshmitarët nuk është e vetmja punë të cilën e kryen ai. Nuk ekziston një rregullore mbi punën e departamentit për përkrahjen e dëshmitarëve, kurse nuk ka evidenca të sakta se sa dëshmitarë e kanë kërkuar ndihmën në gjykime. Ka një vlerësim se është fjala për rreth 20 dëshmitarë. Shërbimi nuk ka psikologë, kurse në sallën e gjykimeve të pranishëm janë mjeku për ofrimin e ndihmës së shpejtë dhe pjesëtarët e policisë.

273 Komunikim me email me përfaqësuesin e Drejtorisë së Policisë së Malit të Zi, qasje në datën 17 janar të vitit 2012.

274 Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, *Gazeta zyrtare e Malit të Zi* 65/04.

275 Informator për dëshmitarët/të dëmtuarit, faqja e internetit të gjykatave të Malit të Zi, <http://sudovi.me/osba/sluzba-za-podrsku/>.

276 Aksioni për të drejtat e njeriut, *Të drejtat e njeriut në Mal të Zi në vitin 2010-2011*, Podgoricë, 2011, f. 216.

277 Jean Charles Gardetto, Report to the Council of Europe's Parliamentary Assembly on Witness Protection and Support at the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia. report 12440 rev, publikuar në datën 12 janar të vitit 2011.

278 Projekti i përcjelljes së gjykimeve (qershor 2009 – gusht 2010); Misioni i OSBE-së në Mal të Zi, Podgoricë, 2011; <http://www.osce.org/me/montenegro/81979>.

279 Intervistë me Andrija Bullatoviqin, Shërbimi për mbështetjen e dëshmitarëve, Gjykata e Lartë në Bijelo Polje e datës 13 janar të vitit 2012.

Personi i punësuar në shërbimin për mbështetje për dëshmitarët gjatë gjithë kohës është me dëshmitarët gjatë pranisë së tyre në Gjykatë, kurse dëshmitarët e marrin edhe broshurën me informacione mbi të dëshmuarit. Personi i punësuar kontakton me mjekët, policinë dhe policinë kufitare dhe e organizon transportin deri te Gjykata, për arsye se ka mjaft dëshmitarë nga Kosova dhe nga Bosnja e Hercegovine.²⁸⁰

Misioni i OSBE-së në Mal të Zi e konsideron të mirë praktikën e mbështetjes së dëshmitarëve të dëmtuar në lëndët e krimeve të luftës dhe e rekomandon edhe më tutje zbatimin e kësaj praktike, siç është krijimi dhe shpërndarja e broshurave informative për dëshmitarët e dëmtuar në të gjitha rastet relevante.²⁸¹

9.6. Maqedonia

Mbrojtja e dëshmitarëve është e rregulluar me Ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve (2005). Me këtë Ligj rregullohen procedura dhe masat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe ofrimi i mbështetjes për dëshmitarët, kurse zbatohet për procedurat në të gjitha llojet e veprave penale tek të cilat ekziston baza reale për rrezikshmëri të personit në procedurë.

Me ligj është i themeluar Paneli për Mbrojtjen e dëshmitarëve, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e Gjykatës Supreme, të Prokurorisë Publike dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtori i Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve të Ministrisë së Drejtësisë dhe udhëheqësi i Departamentit për mbrojtjen e dëshmitarit (Departamenti).²⁸² Një nga masat e mundshme të mbrojtjes të parapara me ligj është edhe ndryshimi i identitetit.²⁸³

Në lidhje me krimet e luftës, katër persona kanë qenë dëshmitarë potencial në lëndën *Punëtorët e ndërtimitarëve*, por ky rast është mbyllur me aktin e amnistisë.²⁸⁴

10. Bashkëpunimi rajonal në procesimin e krimeve të luftës

Deri në fund të vitit 2011, janë nënshkruar disa marrëveshje bilaterale midis prokurorisë së BdheH, Kroacisë, Serbisë²⁸⁵ dhe Malit të Zi, të cilat kanë të bëjnë me lëndët e krimeve të luftës. Këto marrëveshje në mënyrë të rëndësishme i kanë kontribuar zgjidhjes efikase të kërkesave për këmbimin e informacioneve dhe dëgjimin e dëshmitarëve jashtë kufijve të shtetit,²⁸⁶ sepse ua mundësojnë prokurorive që të drejtojnë dhe të përgjigjen në kërkesat, pa përdorimin e kanaleve diplomatike.²⁸⁷

Bashkëpunimi i Kroacisë dhe i Serbisë, para së gjithash, i ka kontribuar rritjes së numrit të gjykimeve në Serbi për krime të luftës ndaj kroatëve dhe zvogëlimit të numrit të gjykimeve në mungesë, në Kroaci. Marrëveshja mbi bashkëpunimin mbi ndjekjen e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës, të cilën të dyja shtetet e kanë nënshkruar në vitin 2006, është dëshmuar si një instrument i mirë në shmangien e problemeve në procesimin e krimeve të luftës, të grumbulluara gjatë viteve të pasluftës, në të cilat në Kroaci kryesisht janë gjykuar kryerësit e kombësisë serbe, deri sa në Serbi nuk ka pasur gjykime për krime të luftës.

280 *Po aty*.

281 Projekti i përcjelljes së gjykimeve (qershor 2009 – gusht 2010); Misioni i OSBE-së në Mal të Zi, Podgoricë, 2011.

282 Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 6, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 38/2005.

283 *Po aty*, neni 10.

284 *Po aty*.

285 Memorandum mbi pajtimin për realizimin dhe përparimin e bashkëpunimit në luftën kundër të gjitha formave të krimit të rëndë e lidhur midis Prokurorisë publike republikane dhe Prokurorisë për krime të luftës të Republikës së Serbisë dhe Prokurorisë së Bosnjës e Hercegovinës e nënshkruar në datën 1 korrik të vitit 2005. Teksti i marrëveshjes është në dispozicion në faqen e internetit të PKL, http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/saradnja_cir.htm.

286 Komunikim me email me zëdhënësen e Misionit të OSBE-së në BdheH, Aida Beshliqin Deliqin, në datën 3 shkurt të vitit 2012.

287 *Po aty*.

BdheH dhe Kroacia në muajin shkurt të vitit 2010 e kanë nënshkruar Marrëveshjen e ndryshuar mbi përmbarimin e vendimeve gjyqësore në çështjet penale, që parandalojnë ikjen e personave të dënuar nga njëri shtet në tjetrin. Marrëveshja ia ka mundësuar Kroacisë për ta filluar procedurën që i dënuari Branimir Gllavash ta vuajë dënimin në BdheH.²⁸⁸ Gllavashi e vuan dënimin në burgun e Zenicës.

Në vitin 2011, organet e gjyqësorit të Serbisë dhe të Kroacisë kanë vazhduar t'i këmbëjnë provat dhe lëndët gjyqësore në kushte të përkeqësuar, të shkaktuara nga burgosja e shtetasit kroat Tihomir Purda në BdheH sipas fletarrestimit të Republikës së Serbisë në bazë të pranimit vetakuzues se i ka vrarë serbët, të dhënë gjatë burgosjes në Serbi, me refuzimin e PKL të Republikës së Serbisë që gjyqësorit kroat t'ia lëshoj aktakuzën dhe provat kundër shtetasit kroat Veljko Mariqit, me shpalljen e aktakuzës së Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së kundër Vlladimir Sheksit dhe 33 shtetasve kroat si dhe me miratimin e Ligjit mbi pavlefshmërinë, të cilin Parlamenti Kroat e ka miratuar në datën 21 nëntor të vitit 2011.

MPB-ja e BdheH, në datën 5 janar të vitit 2011, në kalimin kufitar Orashje, në drejtim të Republikës së Kroacisë, e ka burgosur shtetasin kroat Tihomir Purdën, për të cilin Ministria e Drejtësisë së Republikës së Serbisë e kishte lëshuar fletarrestimin për shkak të krimeve të luftës, të cilat i ka pranuar në një deklaratë të dhënë organeve ushtarake të ish APJ-së gjatë ndalimit në kamp në Serbi. I akuzuari Purda është dëgjuar në datën 21 shkurt të vitit 2011 në Prokurorinë e BdheH në Sarajevë, në prani të zëvendësprokurorit për krime të luftës të RS dhe gjykatësit hetues të Departamentit për krime të luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd. PKL e RS e ka fajësuar Purdën për vrasje të disa viktimave NN, që në opinionin profesional ka krijuar përshtypjen se është fjala për një çështje politike dhe jo të drejtësisë. PKL, në datën 3 mars të vitit 2011, ka sjellë vendimin mbi heqjen dorë nga ndjekja penale e Purdës dhe edhe për dy të akuzuar të tjerë veteran kroat të luftës në mungesë të provave, gjë që në opinionin profesional është vlerësuar si zgjidhje juridike e kënaqshme e problemit, i cili mund të përsëritet nëse PKL nuk e bënë qasjen tejet të kujdesshme ndaj aktakuzave, deklaratave të të ndaluarve dhe provave të tjera në arkivin e Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së.

Republika e Serbisë nuk e ka respektuar Marrëveshjen mbi bashkëpunimin mbi ndjekjen e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës, të nënshkruar me Kroacinë në vitin 2006 as në rastin e shtetasit kroat Veljko Mariqit. Ai është gjykuar në Serbi për vrasje të Petar Slijepçeviqit, gjatë ndjekjes së serbëve nga fshati në komunën e Pozhegës në muajin tetot të vitit 1991²⁸⁹. Prokuroria Shtetërore e RK i është drejtuar PKL të RS me kërkesë për transferimin e provave kundër të akuzuarit Mariq, por PKL e ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se është në proces e sipër hetimi i ri kundër të akuzuarit Mariq.

PKL e RS në datën 10 gusht të vitit 2011 ia ka dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kroacisë aktakuzën e Prokurorisë Ushtarake të ish APJ-së kundër 44 pjesëtarëve kroat të forcave të armatosura për shkak të veprës penale të gjenocidit dhe krimeve të luftës të kryera në zonën e Vukovarit në vitin 1991. Me aktakuzë, midis të tjerëve, janë të akuzuar edhe ish kryetari i Shtabit të Krizës së RK në Sllavoni dhe Baranje, Vlladimir Sheksi²⁹⁰, ministri i punëve të brendshme i luftës i Kroacisë Ivan Veqiq, Shefi i Shtabit të Krizës të Osijekut, Branimir Glavash dhe ndihmësi i ministrit i punëve të brendshme i luftës të Kroacisë Tomisllav Merçepi. Në datën 14 shtator të vitit 2011, ministri kroat i drejtësisë ia ka përcjellë aktakuzën Gjykatës së Qarkut në Osijek.

Qeveria e Republikës së Kroacisë menjëherë pas dorëzimit të aktakuzës kundër *Sheksit dhe të tjerëve*, dhe pas aktgjykimit të shkallës së parë të Veljko Mariqit, ia ka dërguar Parlamentit për miratim Propozimin për Ligjin mbi Pavlefshmërinë, të cilin Parlamenti Kroat e ka miratuar në datën 21 nëntor të vitit 2011. Me anë të ligjit janë shpallur të pavlefshme aktet juridike të organeve gjyqësore të ish APJ-së, RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, me të cilat janë dyshuar, akuzuar dhe/ose dënuar shtetasit e RK për vepra penale kundër vlerave të mbrojtura me

288 Faqja e internetit të Gjykatës së BdheH, <http://www.sudbih.gov.ba/index.php?id=1787&jezik=b>.

289 Veljko Mariqi është gjykuar në procedurën e shkallës së parë në datën 31 tetor të vitit 2011 me 12 vite burgosje.

290 Në muajin tetor të vitit 2011, në kohën kur aktakuza kundër 44 shtetasve të Kroacisë është zbardhur, Sheksi ka qenë duke e kryer detyrën e nënkryetarit të partisë në pushtet të asaj kohe BKD-së (HDZ) dhe Parlamentit kroat.

të drejtën ndërkombëtare e të cilat janë kryer në territorin e RK. Me këtë janë paraparë edhe përjashtimet nga pavlefshmëria – “pavlefshmëria nuk ka të bëjë me aktet, për të cilat organet gjyqësore të Republikës së Kroacisë vërtetojnë se i përmbushin standardet juridike nga legjislacioni penal i Republikës së Kroacisë”. Sipas nenit 3 të Ligjit, „Organet gjyqësore të Republikës së Kroacisë nuk do të veprojnë në lidhje me kërkesat e organeve gjyqësore të Republikës së Serbisë për ndihmën ligjore në procedurat penale nëse veprimi sipas kërkesave të tilla është në kundërshtim me rendin e Republikës së Kroacisë dhe e dëmton sovranitetin dhe sigurinë e saj. Vendimin mbi veprimin lidhur me kërkesat e tilla e sjellë Ministri i Drejtësisë i Republikës së Kroacisë.”²⁹¹

Kryetari i Republikës së Kroacisë, Ivo Josipović, Kryeprokurori Shtetëror i Republikës së Kroacisë, Mladen Bajić, politikanët e opozitës dhe organizatat joqeveritare kanë vlerësuar se Ligji mbi Pavlefshmërinë i rrezikon shtetasit e RK të cilët, eventualisht, janë të akuzuar në mënyrë të pabazë në Republikën e Serbisë, sepse ato aktakuza ekzistojnë pavarësisht nga ajo se nuk janë të pranuar në sistemin juridik kroat. Prapëseprapë, nuk duhet të neglizhohet fakti se PKL, me mosrespektimin e Marrëveshjes mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të krimeve të luftës dhe me qëndrimin se është kompetente për procesimin e krimeve të kryera ndaj të gjitha viktimave serbe, ka vënë në pikëpyetje bashkëpunimin me PSHRK, posaçërisht në këmbimin e provave në lëndët, në të cilat të akuzuarit janë të paqasshëm për organet e gjyqësorit të Kroacisë ose të Serbisë.

Marrëdhëniet midis Serbisë dhe BdheH në mënyrë të dukshme janë përkeqësuar lidhur me rastin e Ejup Ganiqit, ish anëtarit të Presidencës së BdheH, për të cilin, me kërkesë të MPB-së së Serbisë, Interpoli ka lëshuar fletarrestimin ndërkombëtar. Ai është burgosur në aeroportin e Londrës, në datën 1 mars të vitit 2010. Gjykata britanike në Vestminster, në datën 27 korrik të vitit 2010 ka sjellë aktgjykimin mbi procedurën për ekstradimin e Ejup Ganiqit, duke konstatuar se qysh “ditën e parë të këtij dëgjimi, ekzistojnë *prima facie* (në shikim të parë) prova mbi keqpërdorimin e procesit”. Në pikën 38 të aktgjykimit, gjykata konstaton se „nëse Qeveria e Serbisë vërtet ka qenë e gatshme të heq dorë nga procedura e ekstradimit si këmbim për bashkëpunimin bosanas, kjo është e mjaftueshme që të konstatohet keqpërdorimi i procesit në këtë gjykatë”. Në pikën 39 të aktgjykimit „gjykata përfundon se është fjala për keqpërdorimin e procesit për ekstradimin sepse, sipas përfundimit të gjykatës, motivi për ndjekjen e Ejup Ganiqit është i bazuar në politikën, racën ose fenë”.²⁹²

Policia austriake, në datën 3 mars të vitit 2011 në Vjenë ka burgosur gjeneralin e pensionuar të Armatës së BdheH Jovan Divjakun, në bazë të fletarrestimit të cilin për te e ka lëshuar Republika e Serbisë në vitin 2009, duke e akuzuar se ka marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës në Rugën e Vullnetarëve në Sarajevë, me rastin e tërheqjes së kolonës së APJ-së në muajin maj të vitit 1992. Gjykata austriake, në datën 9 korrik të vitit 2011 e ka refuzuar kërkesën e Republikës së Serbisë për ekstradim, me arsyetimin se „në Beograd nuk mund të pres gjykim të ndershëm”.

Nënshkrimi i Protokollit midis BdheH dhe Serbisë mbi bashkëpunimin në ndjekjen e kryerësve të krimeve të luftës, me të cilin, midis të tjerash, është arritur pajtimi i investimit të përpjekjeve të përbashkëta për pengimin e hetimeve paralele, i caktuar për datën 30 nëntor të vitit 2011 në Bruksel, është anuluar para nënshkrimit.²⁹³ Kundër nënshkrimit të Protokollit është deklaruar edhe kryetarja e Gjykatës së BdheH, Medzhida Kreso: “Protokolli nuk do të sillte asgjë të re në lidhje me problemin, që kemi me prokurorinë serbe e ky është bartja e pakusht e të gjitha hetimeve kundër shtetasve tanë për vepra të krimeve të luftës të kryera në territorin e BdheH, të cilat

291 Ligji mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve gjyqësore të ish APJ-së, RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë* 124/11; Kryetari i RK Ivo Josipović, në pajtim me autorizimet e tij, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e RK vlerësimin lidhur me kushtetutshmërinë e këtij ligji. Të njëjtën, në muajin mars të vitit 2012, e ka bërë edhe Qeveria e re e RK. Gjykata kushtetuese e RK ende nuk e ka sjellë vendimin lidhur me këto kërkesa.

292 Snezhana Čongradin, “Falsifikatet dhe shantazhet”, faqja e internetit e portalit Peshqanik, 8 gusht të vitit 2010, <http://peshqanik.net/2010/08/falsifikati-i-ucene/>.

293 „Komshiqi e bllokon nënshkrimin e marrëveshjes”, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, 30 nëntor të vitit 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/komsic_blokirao_sporazum_sa_srbijom_o_ratnim_zlocinima/24407425.html.

janë hapur në bazë të aktakuzës së ish APJ-së ose më vonë janë dorëzuar nga shoqata të ndryshme nga BdheH.²⁹⁴

Misioni i OSBE-së konsideron se „zhvillimi i procedurave nga ana e qeverisë serbe në lëndët e krimeve të luftës, që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur në BdeH, edhe pse legjitime, sipas të drejtës ndërkombëtare, ka qenë arsye e ngritjes së tensioneve midis BdeH e Serbisë. Tensionet e tilla padyshim se paraqesin rrezik që hapat, për bashkëpunim në nivel të punës, siç janë këmbimi i provave dhe dëgjimi i dëshmitarëve, do të shkojnë mbrapa“, konsideron OSBE-ja.

Në muajin tetor të vitit 2010, Serbia dhe Mali i Zi e kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi ekstradimin, e cila parashihet ekstradimin për vepra penale kundër njerëzimit dhe të mirave të tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë edhe krimet e luftës. Në pajtim me Marrëveshjen, pjesëtarët e MPB-së së Serbisë, në datën 30 tetor të vitit 2010 e kanë sjellë para gjykatësit hetues të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, Predrag Strugarin, të akuzuar në lëndën *Kalugjerski Laz* me qëllim të përcaktimit të paraburgimit deri në vendimin për ekstradim. Megjithëkëtë, gjykatësi hetues ka refuzuar për t'ia përcaktuar paraburgimin, duke konstatuar se nga dokumentacioni i dorëzuar gjykatës nuk rezulton dyshimi i bazuar se ka kryer veprë penale. Deri në fund të vitit 2011, Predrag Strugari, nënkolonel i Ushtrisë së Jugosllavisë, e cila e ka kryer krimin në Kalugjerski Laz, nuk i është ekstraduar Malit të Zi.

Me rastin e marrëveshjes së ekstradimit të shtetasve të vet, të nënshkruar në datën 1 tetor të vitit 2010, që nuk i përfshijnë krimet e luftës, organizatat kroate dhe malazise për të drejtat e njeriut e kanë shprehur brengosjen e tyre për shkak të karakterit të kufizuar të Marrëveshjes mbi ekstradimin midis Malit të Zi dhe Kroacisë, që nuk mundëson ekstradimin e shtetasve të vet të akuzuar për krime të luftës.

PKL e RS nuk bashkëpunon me gjykatat kosovare dhe me prokurorët dhe gjyqtarët lokal. Ka bashkëpunim të mirë me Njësinë e EULEX-it për hulumtime të krimeve të luftës. Hulumtuesit e kësaj njësie, me ndihmën e FDH-së dhe politikanit kosovar, Agim Çekut, kanë organizuar pjesëmarrjen e 15 viktimave shqiptare në procedurën para trupit gjykues të Departamentit për krime të luftës në Beograd për vrasjen e 44 shqiptarëve dhe dëbimin e shqiptarëve nga fshati Qyshk në datën 14 maj të vitit 1999. Në gjysmën e dytë të vitit 2011, viktimat shqiptare kanë qenë më pak të gatshme për të udhëtuar në Serbi gjë që, në masë të madhe, është pasojë e mosbesimit të përforcuar të opinionit kosovar në institucionet shtetërore të RS, të krijuar për shkak të mosplotësimit të marrëveshjes në negociatat Beograd – Prishtinë dhe burgosjeve të shpeshta arbitrare të shqiptarëve me rastin e kalimit të tyre në Serbi.

69

III. Reformat institucionale

1. Rezyme

Në shumicën e shteteve post-jugosllave ekzistojnë dispozita ligjore të cilat e pengojnë personin e dënuar për çfarëdo veprë penale me dënime me burg mbi minimumin e caktuar për të kryer detyrën e deputetit, ku janë të përfshirë edhe personat të cilët janë të dënuar për krime të luftës.

Në BdeH, në periudhën e viteve 2002-2004 janë kryer reformat e policisë (certifikimi) dhe të gjyqësorit (riemërimi), e, megjithëkëtë, proceset e verifikimit (vetting) nuk kanë qenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, sepse personat, të cilët kanë qenë të përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës ose në shkelje të tjera të të drejtave të njeriut edhe më tutje kryejnë funksione në organet shtetërore. Korniza ekzistuese në fuqi e ndalon emërimin si dhe të drejtat aktive dhe pasive zgjedhore personave, kundër të cilëve ekziston aktakuza e konfirmuar në lëndët e krimeve të luftës si dhe personave të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit. Megjithëkëtë, me ligj nuk janë përfshirë personat të cilat e kanë vuajtur dënimin me burg për krimet e kryera të luftës. Në Kosovë, korniza normative nuk e precizon

294 Milica Jovanović, Ngadalësimi i procesit për krime të luftës, faqja e internetit *E-novine*, <http://www.e-novine.com/feed/srbija/srbija-tema/63636-Usporavanje-procesa-ratne-zloine.txt>.

nëse personi i cili është në vuajtje të dënimit me burg për krime të luftës ose këtë dënim e ka vuajtur mund të jetë kandidat në zgjedhje, derisa të dyshuarit për krime të luftës mund të kandidohen në zgjedhje. Në praktikë, ka raste kur marrin funksione të shquara publike.

Në Serbi, edhe më tutje nuk zbatohet Ligji mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut (Ligji mbi lustracionin) i vitit 2003, por është paraqitur projekt-ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut, afati i vlefshmërisë së të cilit do të vazhdohej për 20 vite. Ky projekt-ligj edhe më tutje është në procedurë të Kuvendit. Në Mal të Zi dhe në Kroaci edhe më tutje nuk ka kërkesë për lustracionin.

Slllovenia e ka zbatuar reformën e institucioneve qysh në mesin e viteve nëntëdhjetë, kur një nga kriteret për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, përkatësisht për mbajtjen në shërbimin e pjesëtarëve të policisë ka qenë edhe mospërfshirja e personave në shkeljen e të drejtave të njeriut, përkatësisht në krime të luftës. Në mënyrë plotësuese është pamundësuar rizgjedhja e gjykatësve, të cilët kanë sjellë aktgjykime, me të cilat janë shkelur të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit 2011, Me Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi përcaktimin e kushteve plotësuese për ushtrimin e funksionit publik, Komisioni për verifikimin e fakteve në Maqedoni e ka zgjeruar kontrollimin mbi bashkëpunimin me shërbimet e fshehta edhe te priftërinjtë, gazetarët, aktivistët e organizatave joqeveritare, avokatët dhe shkencëtarët. Nga fundi i këtij viti është filluar procedura para Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitave mbi zgjerimin e hetimeve. Profesori universitar dhe aktivisti, që një kohë të gjatë ka punuar për të drejtat e njeriut në Maqedoni, Vladimir Milçin është shpallur bashkëpunëtor i shërbimit të fshehtë komunist, gjë që ka shkaktuar pyetjen lidhur me pavarësinë e punës së këtij Komisioni në lidhje me trysnitë politike.

Në vendet e rajonit edhe më tutje është e pranishme përkrahja e fuqishme politike dhe publike për të akuzuarit për krime të luftës, lavdërimi i rolit të tyre gjatë konflikteve të armatosura dhe theksimi i vuajtjeve të viktimave të popullit vetjak. Qëndrimi i këtillë ka dominuar në Kroaci pas shqiptimit të aktgjykimit jo të plotfuqishëm gjeneralëve kroat në muajin prill të vitit 2011, derisa përfaqësuesit politik të Serbëve dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës edhe më tutje i kanë theksuar vuajtjet e popullit të vet, duke ngulur këmbë në balancën midis viktimave, posaçërisht në lidhje me gjenocidin në Srebrenicë. Deputetët serb më së shumti kanë pasur vërejtje ndaj punës së institucioneve të BdheH, të cilat merren me krimet e luftës, duke ua përshkruar anshmërinë dhe kriteret e ndryshme në varësi nga përkatësia etnike. Kuvendi i Serbisë, në vitin 2010 e ka miratuar Deklaratën mbi dënimin e krimeve në Srebrenicë, me çka është bërë një hapë i rëndësishëm në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, por teksti i deklaratës dhe miratimi i saj kanë hasur në kritika, posaçërisht në BdheH. Përfaqësuesit e shoqatave të viktimave të Srebrenicës e kanë kritikuar deklaratën, sepse është shmangur shprehja e qartë e fjalës „gjenocid“, derisa përfaqësuesit e organizatave të luftëtarëve nga Republika Srpska miratimin e Deklaratës e kanë interpretuar si imponim të fajit kolektiv ndaj popullit serb.

Temat në lidhje me krimet e luftës shumë rrallë janë përfaqësuar në media, derisa në shumicën e vendeve post-jugosllave ende është i pranishëm „patriotizmi gazetaresk“, përkatësisht mbizotërimi i ideologjisë nacionaliste. Në Serbi është shtruar çështja e përgjegjësisë penale të gazetarëve për shkak të nxitjes së krimeve të luftës gjatë konflikteve të armatosura në vitet nëntëdhjetë, kurse kërkesë të ngjashme kanë bërë edhe organizatat për të drejtat e njeriut në Mal të Zi. Tablonë e mediave në vitin 2011 në Kroaci e ka karakterizuar reagimi i mediave ndaj aktgjykimit jo të plotfuqishëm ndaj gjeneralëve, në të cilin ka mbizotëruar qëndrimi mbi padrejtësinë dhe „dënimet drakonike“, pa aspak hapësirë të dhënë për viktimat.

2. Lustracioni

2.1. Bosnja e Hercegovina

Vetëm Bosnja dhe Hercegovina, nga të gjitha shtetet post-jugosllave ka ndërmarrë hapa konkret drejt përpunimit

të një strategjie të gjithmbarshme shtetërore të drejtësisë tranzicionale. Me përkrahjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PZHKB), Ministria e Drejtësisë e BdheH dhe ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët e BdheH, në fund të vitit 2011 e kanë çuar në fund strategjinë e drejtësisë tranzicionale. Me Vendim të Këshillit të Ministrave të BdheH, në muajin janar të vitit 2010, është formuar grupi i punës i ekspertëve për përpunimin e Strategjisë, si trup koordinues me detyrën për të zbatuar procesin e konsultimit me të gjitha subjektet e interesuara të shoqërisë civile dhe institucionet lokale.²⁹⁵ Grupin punues e kanë përbërë 15 anëtarë, prej të cilëve 10 përfaqësues të institucioneve qeveritare, dhe pesë përfaqësues të shoqërisë civile (tri organizata të shoqërisë civile dhe dy profesionist të pavarur). Strategjia përfshin mekanizmat jashtëgjyqësor të drejtësisë tranzicionale: vërtetimi i fakteve dhe tregimi i së vërtetës, reparacionet dhe memorialët dhe reformat institucionale. Procesimi penal i njerëzve përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe krime të luftës nuk është përfshirë, duke qenë se këtë fushë të drejtësisë tranzicionale e shtjellon Strategjia Shtetërore për punë në lëndët e krimeve të luftës, e miratuar në muajin dhjetor të vitit 2008.²⁹⁶

Në BdheH edhe më tutje funksionojnë disa organe, detyrë e të cilave është parandalimi i personave të cilët kanë qenë të përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës ose shkelje të tjera të të drejtave të njeriut për të kryer funksione në organet shtetërore, përkatësisht në agjencitë.

Kontrollin e sigurisë së zyrtarëve policorë, të nëpunësve shtetëror dhe të të punësuarve, me rastin e pranimit të tyre në marrëdhënie pune e kryen SIPA, në bazë të nenit 33, paragrafi (2) i Ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.²⁹⁷ Gjatë vitit 2010 Sektori për kontrollin e sigurisë i SIPA-s ka pranuar 101 kërkesa për verifikim të gjithsejtë 6.788 zyrtarëve policor, të nëpunësve shtetëror dhe të të punësuarve. Në periudhën e cekur, SIPA ka përgatitur 73 raporte mbi kontrollet e kryera për gjithsejtë 2.013 persona, prej të cilëve për 93 persona janë konstatuar fakte të caktuara të cilat parashtruesi i kërkesës për verifikim do të mund t'i trajtonte si pengesa sigurie. Gjatë vitit 2011, Sektori për kontroll të sigurisë ka pranuar 78 kërkesa për verifikim të gjithsejtë 2.461 zyrtarëve policor, nëpunësve shtetëror dhe punonjësve. Në periudhën e cekur janë përgatitur 49 raporte mbi verifikimet e kryera për gjithsejtë 2.083 persona. Tek qindra persona janë konstatuar fakte të caktuara të cilat parashtruesi i kërkesës për verifikim me rastin e vlerësimit eventualisht mund t'i trajtonte si pengesa të sigurisë.²⁹⁸

Sipas Ligjit Zgjedhor të BdheH (neni 1.6), "Asnjë person, i cili është *në vuajtje* të dënimit të shqiptuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë si dhe asnjë person i cili është *nën aktakuzë* të Gjykatës, e që nuk i është nënshtruar urdhrin që të paraqitet para Gjykatës, nuk mund të regjistrohet në Regjistrin Qendror Zgjedhor dhe as që mund të jetë kandidat (nocioni i kandidatit në kuptimin e këtij ligji ka të bëjë me personat e të dyja gjinive), dhe as që do të ketë fare funksion të emërimit, zgjedhor ose publik në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës."²⁹⁹

Po ashtu, sipas Ligjit të Këshillit të Ministrave të BdheH, SIPA verifikon veprimet e luftës të kandidatëve për kryesues të Këshillit të Ministrave të BdheH, përkatësisht për ministrat dhe zëvendësministrat në Këshillin e Ministrave.³⁰⁰ Pas marrjes së informacionit (negativ) mbi veprimet e luftës nga SIPA, Presidenca e BdheH e ka të drejtën e lirisë së veprimit për të vazhduar me emërimin e kryesuesit të Këshillit të Ministrave ose që këtë të mos e bëjë.³⁰¹ Po ashtu, kryesuesi i Këshillit të Ministrave i BdheH të njëjtën procedurë e zbaton në procesin e emërimit të ministrave dhe të zëvendësministrave.³⁰² Parlamenti i BdheH mund të refuzojë për të vërtetuar emërimin e

295 Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët e BdheH dhe Ministria e Drejtësisë, Strategjia e Drejtësisë tranzicionale në Bosnjë e Hercegovinë, 2012-2016 (Tekst pune),f. 9.

296 *Po aty*, f.6.

297 Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, *Gazeta zyrtare e BdheH*, nr. 54/05 dhe nr.12/09.

298 Informacion i marrë nga Zhejko Kujunxhija, zëdhënës i SIPA-s, i datës 13 janar të vitit 2012.

299 Ligji zgjedhor i Bosnjës dhe Hercegovinës, *Gazeta zyrtare e BdheH*, nr. 23/01, ndryshimet dhe plotësimet e fundit nr. 37/08, neni 1.6 dhe neni 1.7.

300 Ligji zgjedhor i Bosnjës dhe Hercegovinës, *Gazeta zyrtare e BdheH*, nr. 23/01, ndryshimet dhe plotësimet e fundit nr. 37/08, neni 10(d), paragrafi 3, në lidhje me nenin 10(d), paragrafi 1, pika a(4).

301 *Po aty*, neni 10(e).

302 *Po aty*.

kandidatëve, midis të tjerash, edhe në bazë të të dhënave mbi aktivitetet e tij/saj në periudhën e konfliktit të armatosur.³⁰³

Megjithëkëtë, në praktikë SIPA nuk i verifikon veprimet e luftës të kandidatëve për deputet në parlamentin shtetëror. Kështu, Shemsudin Mehmedović, një nga nënkryetarët e Partisë së Aksionit Demokratik (PDA), është deputet shumëvjeçar në parlamentin e BdheH, edhe pse kundër tij në vitin 2005, MPB-ja e RS ka ngritur kallëzim penal për krime kundër njerëzimit në Teshnje, ku, në kohën e luftës, ka qenë komandant i stacionit policor. Lënda, nga Prokuroria e Qarkut në Doboj, me urdhër të Gjykatës së BdheH, është bartur në Prokurorinë e BdheH.³⁰⁴ Në vendin e kryeshefit të Departamentit për krim të organizuar të Agjencisë Informative të Sigurisë së BdheH (AIS) deri në fund të vitit 2011 ka qenë Muhidin Bashiçi, edhe pse Prokuroria e BdheH ka ngritur aktakuzë,³⁰⁵ kurse Gjykata e Bosnjës dhe e Hercegovinës e ka konfirmuar në datën 7 dhjetor të vitit 2011, aktakuzën e cila ngarkon për vepër penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile.³⁰⁶

Gjykata Themelore e Distriktit të Brçkos e BdheH e ka konfirmuar në datën 28 nëntor të vitit 2011 aktakuzën kundër Asmir Tatareviqit dhe Armin Omaziqit, për krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës.³⁰⁷ I akuzuari Asmir Tatareviqi edhe më tutje është i punësuar në Qeverinë e Distriktit të Brçkos, në Repartin për siguri publike, në vendin e shefit të ekipit të deminimit.³⁰⁸ Ermin Xhingjiqi, shef i Repartit për Siguri Publike në Qeverinë e Distriktit të Brçkos ka deklaruar se „nuk ka baza për pezullimin e Tatareviqit“. Xhingjiqi i referohet Ligjit mbi shërbimin shtetëror të Distriktit të Brçkos ku në nenin 104 përkufizohet baza për largimin nga shërbimi: në rast se aktakuza konfirmohet për vepër penale të kryer gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nëse është iniciuar veprim disiplinor dhe nëse është caktuar paraburgimi në procedurën hetimore.³⁰⁹ Xhingjiqi e thekson se i ka bërë konsultimet me juristin dhe me zyrën e Përfaqësuesit të Lartë të BdheH dhe i është dhënë informata se nuk ka bazë për pezullimin e Tatareviqit.³¹⁰

Në listat zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në BdheH, të cilat janë mbajtur në muajin tetor të vitit 2010, janë gjendur nëntë të dyshuar për krime të luftës.³¹¹

Simo Zariqi, i cili është dënua në vitin 2003 për krime kundër njerëzimit nga GJPNJ,³¹² është zgjedhur në muajin shkurt të vitit 2010 për zëvendës të kryeshefit të komunës së Shamacit, ku janë kryer krime të luftës, për të cilat është dënua.³¹³ Zariqi, edhe në përfundim të vitit 2011, edhe më tutje është gjendur në atë funksion.

303 *Po aty*, neni 10(g) dhe neni 10(h).

304 Nuk ka të dhëna mbi fatin e lëndës.

305 Aktakuzë e ngritur kundër Muhidin Bashiçit dhe Mirsad Shijkës, komunikatë e Prokurorisë së BdheH, faqja e internetit e Prokurorisë së BdheH, 2 dhjetor i vitit 2011, <http://www.tuzilastvobih.gov.ba/?id=1269&jezik=b>.

306 Në aktakuzë ceket se në datën 25 janar të vitit 1994, i akuzuari Muhidin Bashiç, si kryeshef i Repartit të Luftës të Shërbimit të Sigurimit Olovo dhe i akuzuari Mirsad Shijaku, si polic ushtarak, pjesëtar i brigadës së lehtë 122 të Armatës së BdheH, së bashku me dy pjesëtarë të pidentifikuar të Armatës së BdheH, e ka detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale personin femër, e cila ka qenë në vizitë të personit të burgosur në burgun e Vareshit. Shih: Vijesti, faqja e internetit e Gjykatës së BdheH, 8 dhjetor i vitit 2011, <http://www.sudbih.gov.ba/?id=2289&jezik=b>.

307 „Tatareviqi dhe Omaziqi: Mohimi i fajit“, faqe e internetit e *BIRN*, 11 janar i vitit 2012, <http://www.bim.ba/bh/303/10/34204/>.

308 Intervistë me telefon me Slavica Pavloviqin, zëdhënësen e Qeverisë së Distriktit të Brçkos të BdheH, e datës 25 janar të vitit 2012.

309 Ligji mbi shërbimin shtetëror në organet e administratës së Distriktit të Brçkos të BdheH, *Gazeta zyrtare Distriktit të Brçkos të BdheH*, nr. 28/06 dhe 29/06, 19/07, 2/08, 9/08, 44/08, 25/09, dhe 26/09.

310 Intervistë me telefon me Ermin Xhingjiqin, shef i Repartit për sigurinë publike, Qeveria e Distriktit të Brçko e BdheH, e datës 25 janar të vitit 2012.

311 „Viktimat sërish bëhen viktime“, Justice report, faqja e internetit e *BIRN*, 30 shtator i vitit 2010, <http://www.bim.ba/bh/238/10/30780/>.

312 Aktgjykim në lëndën kundër Bllagoje Simiqit, Mirosllav Tadiçit dhe Sime Zariçit, komunikatë për publik e GJPNJ, 17 tetor i vitit 2003, faqja e internetit e GJPNJ, http://www.icty.org/x/cases/simic/tjug/bcs/031017bcs_summary.pdf.

313 „Pjesa e mirë e BdheH: krimineli i dënua i luftës, Simo Zariçi zgjedhet për zëvendës të kryeshefit të Komunës Shamac“, faqja e internetit *24sata.info*, 7 shkurt i vitit 2010, <http://www.24sata.info/vijesti/politika/25846-Bolji-dio-BiH-Osudjeni-ratni-zlocinac-Simo-Zaric-izabran-zamjenika-nacelnika-Opstine-Samac.html#ixzz1pB8BQmsn>.

2.2. Serbia

Si edhe në vitet e mëparshme, qeveria nuk e ka zbatuar Ligjin mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut, të cilin Kuvendi i Serbisë e ka miratuar në muajin qershor të vitit 2003. Lidhja e Social Demokratëve të Vojvodinës (LSV), në datën 10 nëntor të vitit 2010 ka propozuar Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e përgjegjësisë për shkeljen e të drejtave të njeriut.³¹⁴ Me këtë propozim është paraparë ndryshimi, me të cilin afati i vlefshmërisë së këtij ligji do të zgjatej për 20 vite, në vend të atyre të tashme 10.³¹⁵ Ligji mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut është miratuar në vitin 2003, me qëllim të heqjes së pengesave dhe barrierave të mundshme në ndërtimin e shoqërisë demokratike në Serbi në procesin e demokratizimit, pas ndryshimeve në skenën politike të Serbisë të realizuara në datën 5 tetor të vitit 2000.

Propozuesi, në arsyetimin e tij, ka theksuar se është e domosdoshme që menjëherë të merren masa organizative, financiare, kadrovike dhe të tjera për zbatimin e Ligjit, dhe të fillohet procedura e zgjedhjes së një përbërjeje të re të Komisionit.

Në arsyetimin e bartësit, përfaqësuesit të LSV-së, është cekur mosekzistimi i vullnetit për zbatimin e Ligjit mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut ka krijuar dyshime lidhur me rendin juridik të shtetit dhe kompetencën e institucioneve të tij si dhe në gatishmërinë e tij për të përmbushur obligimet e veta nga marrëveshjet ndërkombëtare, konventat dhe aktet e tjera të së drejtës ndërkombëtare.

2.3. Kosova

Në vitin 2011, në Kuvendin e Kosovës është zhvilluar debati mbi imunitetin e deputetëve në rastin e krimeve për vepra penale të rënda dhe, së këndejmi, edhe për krime të luftës. Debati ka pasuar pasi që misioni i EULEX-it i është drejtuar me letër Kuvendit të Kosovës për qartësim të procedurës për marrjen e imunitetit të deputetëve, kundër të cilëve zhvillohen hetime ose kundër të cilëve është ngritur aktakuza për vepra penale. Debati ka përfunduar pa qëndrime të miratuara. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi konsideron se Kuvendi nuk duhet të deklarohet për imunitetin, sepse „kjo problematikë është e rregulluar me Kushtetutë, kurse Kuvendi nuk mund të interpretojë Kushtetutën“.³¹⁶ Pas përfundimit të debatit, Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese qartësimin e kushteve të cilat janë të nevojshme të plotësohen për heqjen e imunitetit, duke përfshirë këtu edhe kryetarin, kryeministrin, anëtarët e kabinetit dhe deputetët. Gjykata Kushtetuese, në datën 20 shtator të vitit 2011 ka sjellë vendimin në të cilin thuhet se deputetët nuk kanë imunitet nga ndjekja penale. Dy ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në datën 22 shtator të vitit 2011, EULEX-i e ka burgosur Fatmir Limajn, deputetin dhe nënkryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për shkak të dyshimeve se ka kryer krime të luftës në kampin e fshatit Kleçkë në vitin 1999³¹⁷

Ligji mbi zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë nuk e precizon nëse personi, i cili është në vuajtje të dënimit me burgosje për krime të luftës ose e ka vuajtur atë dënim mund të jetë kandidat në zgjedhje. Personi i cili nuk është dënuar, por dyshohet (ose është dyshuar) për krime të luftës mund të kandidohet në zgjedhje.

2.4. Mali i Zi

Edhe pse në vitin 2007 Partia Liberale opozitare ka propozuar miratimin e Ligjit mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave, ligji kurrë nuk është gjendur në rendin e ditës të kuvendit. Kryetari i Partisë Liberale, Andrija Popoviqi ka deklaruar në konferencën „Lufta për paqe, njëzet vite më vonë“, të mbajtur në datën 2 dhjetor të vitit 2011 në Podgoricë, se futja e lustracionit në Mal të Zi, „nuk qëndron në dëshirën për kurrfarë ndjekjesh, sa në dëshirën që

314 Propozim i Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë, ligjet në procedurë.

315 *Po aty*, neni 7.

316 “Qeveria e Kosovës e kërkon interpretimin e kushteve për heqjen e imunitetit”, faqja e internetit *Blic*, 20 korrik i vitit 2011, <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/267181/Vlada-Kosova-trazi-tumacenje-uslova-za-oduzimanje-imunitet>.

317 GJNPJ e ka liruar Fatmir Limajn nga përgjegjësia penale për krime të tjera të luftës.

të hiqet përgjegjësia kolektive ose abstrakte për atë që është bërë”³¹⁸

Në mënyrë të ngjashme, idenë mbi lustrimin e ka mbështetur edhe anëtari i Lëvizjes opozitare për Ndryshime, Branko Raduloviqi, i cili ka deklaruar se lustracioni dhe përgjegjësia penale për krime në të kaluarën janë të nevojshme me qëllim “që të arrihet deri te themelet e forta, mbi të cilat mund të ndërtohet shtëpia morale malaziasë”³¹⁹

2.5. Maqedonia

Me ndryshimet dhe me plotësimet e Ligjit mbi përcaktimin e kushteve plotësuese për ushtrimin e funksioneve publike të vitit 2011 është futur obligimi edhe për priftërinjtë, gazetarët, aktivistët e organizatave joqeveritare, avokatët dhe shkencëtarët që Komisionit për verifikimin e fakteve t’ia dorëzojnë deklaratat mbi bashkëpunimin me shërbimin e sigurimit, në afat prej datës 1 dhjetor të vitit 2011 deri në datën 31 janar të vitit 2012.³²⁰ Në ndërkohë, para Gjykatës Kushtetuese, është ngritur procedura për hulumtimin e dispozitave të reja kushtetuese, e cila, deri në fund të vitit 2011, nuk ka sjellë vendim.

Komisionit, që nga themelimi i tij nga mesi i muajit korrik të vitit 2011, i janë dorëzuar gjithsejtë 11.009 deklarata.³²¹ Bartësit e funksioneve publike kanë dorëzuar 3.602 deklarata, personat që kanë qenë në funksione publike (dhe ende janë gjallë) 5.113 deklarata, kurse kandidatët për funksione publike 2.294 deklarata.³²² Deri në fund të vitit 2011, Komisioni ka verifikuar rreth 6.000 deklarata, kurse për rreth 40 persona ka vërtetuar se kanë bashkëpunuar me shërbimet e sigurimit.³²³ Autorizimet e Komisionit pushojnë në atë moment kur ai e vërteton nëse personi, i cili e ka paraqitur deklaratën, ka bashkëpunuar e ose jo me shërbimet e sigurimit. Pas kësaj, organet gjyqësore janë kompetente për aktgjykime, përkatësisht për të vërtetuar apo për të mos vërtetuar atë bashkëpunim me organet e sigurimit, për të përcaktuar sanksionet si dhe për të vendosur lidhur me atë nëse ata persona kanë apo nuk kanë të drejtë për të kryer funksione publike.³²⁴

Dy partitë më të mëdha shqiptare, - Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe - Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI), në vitin 2010 kanë hyrë në konfrontim të hapur politik kur është burgosur Hysen Musliu, ish pjesëtar i sigurimit të shtetit. Musliu, i cili është me prirje nga PDSH-ja, është akuzuar për krijimin e dosjes për pjesëtarët e BDI-së (partisë në pushtet), për të cilën Komisioni ka konstatuar se është falsifikim.³²⁵ Kontradiktat e kanë përcjellë edhe rastin e Vlladimir Milçinit, profesorit universitar dhe drejtorit të Fondacionit për shoqëri të hapur. Gjatë vendosjes lidhur me rastin e tij, tre anëtarë të Komisionit (me prirje nga partitë opozitare) e kanë lëshuar mbledhjen me arsyetimin se “një bisedë informative nuk është provë mjaftueshëm e fortë që dikush të shpallet si kodosh”. Milçini ka depozituar vërejtjet e tij ndaj vendimit të Komisionit që ai ta shpallë bashkëpunëtor të shërbimit, në të cilat ai ka deklaruar se nuk ka qenë bashkëpunëtor i shërbimit të fshehtë, por viktimë e tij.³²⁶

318 „Diskutim i kryetarit të PMZ Andrija Popoviç në Konferencën ‘Luftë për paqe, njëzet vite më vonë’ 2. 12. 2011. në Podgoricë”, faqja e internetit e Partisë Liberale të Malit të Zi, 3 dhjetor i vitit 2011; http://www.lpcg.org/detail.php?module=2&news_id=1150.

319 „Mund ta zëvendësojmë PDS”, faqja e internetit *Monitor*, 10 shtator i vitit 2010, http://www.monitor.co.me/index.php?option=com_content&view=article&id=1985:moemo-smijeniti-dps&catid=1386:broj-1038&Itemid=2397.

320 Komunikatë e Komisionit për verifikimin e fakteve, e datës 10 nëntor të vitit 2011, <http://www.kvf.org.mk/mk/soopstenija.html>.

321 Deri në fund të vitit 2009, Komisionit i janë dorëzuar 250 deklarata të funksionarëve (Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f.24), që do të thotë se në vitin 2010 dhe 2011, Komisioni ka përpunuar më shumë se 10.700.

322 Raport i Komisionit për verifikimin e fakteve, 15 janar i vitit 2011 - 15 korrik i vitit 2011, f.17.

323 Intervistë me Agim Mehmetin, zëvendësin e kryetarit të Komisionit për verifikimin e fakteve, e datës 22 dhjetor i vitit 2011.

324 *Po aty*.

325 „Нова рунда во ‘лустрациската војна’ ДУИ – ДПА”, faqja e internetit e Radio Evropa e Lirë, 23 nëntor i vitit 2010, <http://www.makdenes.org/content/article/2228635.html>.

326 “Комисија за лустрација: Милчин бил соработник на тајните служби”, faqja e internetit *Dnevnik*, 4 gusht i vitit 2011, <http://www.dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=0BFB6DA05A0AA94094DF461E82B8481C>.

2.6. Sllovenia

Në Slloveni disa herë janë dorëzuar propozimet për t'u zbatuar lustracioni, e megjithëqë asnjë prej propozimeve nuk e ka fituar asnjëherë shumicën në parlament.³²⁷ Dispozita e vetme e lustracionit është i ashtuquajtura „Amendamenti Puçnikov“. Ky amendament në nenin 8 të Ligjit mbi gjyqtarët, i cili është miratuar në vitin 1994, përcakton se gjyqtarët të cilët kanë gjykuar ose kanë marrë pjesë në procedura gjyqësore ose hetimore e që kanë rezultuar me aktgjykime me të cilat janë shkelur të drejtat e njeriut, nuk i përmbushin kushtet për rizgjedhje. Edhe pse është dorëzuar kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij amendamenti, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë ka sjellë vendimin se është kontestuar dispozita në pajtim me kushtetutën.³²⁸

Reformat e gjithmbarshme të policisë dhe të gjyqësorit janë kryer në gjysmën e parë të viteve nëntëdhjetë, kur edhe një nga kriteret për emërimin e ushtruesve të detyrave të gjyqësorit përkatësisht vazhdimin në shërbim të pjesëtarëve të policisë ka qenë edhe mospërfshirja e personit konkret në shkeljen e të drejtave të njeriut, përkatësisht në krimet e luftës.³²⁹ Legjislacioni slloven për punë në organet shtetërore e përcakton që personi të mos jetë i dënuar, si dhe kushtin që personi të mos ndodhet në procedurë penale.³³⁰

3. Mbështetja për të dënuarit dhe për të dyshuarit për krime të luftës

3.1. Bosnja dhe Hercegovina

Nga nëntori i vitit 2011, në Sarajevë, me urdhrin e Prokurorisë së BdheH, janë arrestuar tetë persona,³³¹ të dyshuar për krime të luftës në kampin *Silos* në Tarčin, pastaj në objektet për burgosje në lokalet e Shkollës Filllore „9 Maji“ në Pazariç, si dhe në depot e kazermës Krupa.

Kuvendi i Kantonit të Sarajevës, lidhur me arrestimin e tyre ka reaguar në seancën e datës 29 nëntor të vitit 2011 duke gjykuar „njëzëri“ „mënyrën dhe procedurën e arrestimit të pjesëtarëve të dyshuar të Armatës së BdheH sikur të ishte fjala për kriminelët që fshihen dhe u shmangen ligjeve të BdheH“. Me nismën e përfaqësuesit të PAD Eldar Çomor, Kuvendi i ka dhënë mbështetje të plotë Ministrisë për çështje të luftëtarëve të Kantonit të Sarajevës, që në përputhje me autorizimet ligjore dhe me të gjitha mundësitë e tjera, „e në kuadër të mjeteve të parashikuara për bashkëfinancimin e ndihmës juridike për mbrojtësit e BdheH në buxhetin e KS-së, t'u ofrohen të burgosurve të gjitha llojet e ndihmës“. Kanë reaguar disa personalitete publike të hidhëruar për shkak të ndarjes së mjeteve financiare për të dyshuarit për krime të luftës. Ata kanë theksuar se „me një veprim të këtyllë kontribuohet në relativizimin e përgjithshëm të ngjarjeve nga vitet e 90-ta, në atë mënyrë që secili i mbron kriminelët „e vet“ dhe se veprat penale dhe krimet e luftës disi mbeten të papërfillura“³³², dhe se „nuk dëshirojnë të financojnë mbrojtjen e të dyshuarve për krime të luftës“³³³.

Rasim Deliqi, ish- komandant i Armatës së BdheH, të cilin GJPNJ e ka gjykuar me tri vjet burgim në vitin 2008, ka vdekur më 16 prill të vitit 2010 para përfundimit të procedurës ankimore. Me rastin e vdekjes së tij, në

327 Ideja e zbatimit të lustracionit në Slloveni nuk ka pasur të bëjë me pengimin e punës së personave të cilët janë përgjegjës për shkeljen masive të të drejtave të njeriut (p.sh., në rastin e „personave të fshirë“), si edhe me shkeljet e tjera të mëdha të të drejtave të njeriut. Kryetari i Demokristianëve (DKS) Alojz Peterle dhe kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD) Janez Jansha kanë dhënë, për shembull, në datën 5 nëntor të vitit 1997 në procedurën parlamentare Propozimin e Rezolutës mbi veprimin kundërligjor të regjimit totalitar komunist dhe Propozimin e Ligjit mbi korrigjimin e pasojave të regjimit totalitar komunist. Të dy propozimet kanë dështuar. Më shumë mbi këtë shih në faqen e internetit të agjencisë sllovene të lajmeve, <http://www.sta.si/vest.php?s=s&id=307610>.

328 Gjykata kushtetuese e Sllovenisë, Vendim, nr.U-I-83/94, 14 korrik i vitit 1994.

329 Më shumë mbi lustracionin në Slloveni shih në: Andrazh Zidar, *Lustracioni*, (Nova Revija, Lubjanë, 1996).

330 Ligji mbi nëpunësit shtetëror, Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr.56/2002, neni 88.

331 Të dyshuar janë Mustafa Gjelijloviq, Fadil Çoviq, Mirsad Shabiq, Nezir Kaziq, Beqir Hujiq, Halid Çoviq, Sherif Meshanoviq dhe Nermin Kalember.

332 „Sarajeva e privuar shpirtërisht dhe moralisht, Justice report, faqja e internetit BIRN, <http://www.bim.ba/bh/301/10/34092/?tpid=47>.

333 „Nuk dua të financoj të dyshuarit për krime të luftës“, faqja e internetit *Radio Sarajevo*, 30 nëntor 2012, <http://www.radiosarajevo.ba/novost/68728/ne-zelim-finansirati-odbranu-osumnjicnih-za-ratne-zlocine>.

Kryesinë e BdheH është mbajtur seanca komemorative. Anëtari i Kryesisë së BdheH Bakir Izetvegoviqi, Ministri i mbrojtjes i BdheH Selmo Cikotiqi, zëvendëskryesuesi i Dhomës së Kombeve të Kuvendit Parlamentar të BdheH Sylejman Tihqi si dhe një varg zyrtarësh të tjerë dhe përfaqësuesish të organizatave të luftëtarëve, në përvjetorin e vdekjes së Deliqit kanë vënë kurora mbi varrin e tij, në kuadrin e komemoracionit që është organizuar me atë rast.³³⁴

Me rastin e miratimit të Deklaratës për gjykimin e krimeve në Srebrenicë, në Kuvendin e Serbisë, nga fundi i marsit të vitit 2010, kanë reaguuar përfaqësuesit e partive politike, të shoqatave të viktimave dhe të shoqatave të luftëtarëve, të cilët kanë kritikuar miratimin e kësaj Deklarate. Përfaqësuesit politik të Republika Srpska kanë theksuar se Serbia me këtë akt i ka vënë Republikës Srpska “barrën e fajit kolektiv dhe ia ka futur thikën në shpinë”.³³⁵ Miratimi, i pritur i Deklaratës për Srebrenicën, indinjatën më të madhe e ka shkaktuar te shoqatat e viktimave të luftës. Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve në Kampe i RS Branislav Dukiqi deklaratën e ka quajtur veprim dyfytës. “Serbia me miratimin e Deklaratës për Srebrenicën ka treguar edhe njëherë dyfytërsinë ndaj vëllezërve andej Drinës duke kërkuar nga ata që të pranojnë atë në të cilën nuk kanë marrë pjesë, duke ia vënë kështu lakun në fyt RS-së.”³³⁶ Mendim ndryshe për këtë ngjarje ka pasur kryetari i Partisë së Progresit Demokratik (PPD) Mladen Ivaniqi, i cili në muajin prill të vitit 2010 ka deklaruar se gjithmonë është angazhuar “që të miratohet një deklaratë e përgjithshme, në të cilën pjesa kryesore dhe më e madhe do t’i kushtohej Srebrenicës, krimit më të madh që ka ndodhur në luftën e kaluar”.³³⁷

Reagimet e publikut në Republika Srpska ndaj arrestimit të Ratko Mladiqit në maj të vitit 2011 kanë qenë më të zëshme se sa ato me rastin e arrestimit të Radovan Karaxhiqit.³³⁸ Të ashpra kanë qenë sidomos reagimet e përfaqësuesve të organizatave të luftëtarëve. Kryetari i Kryesisë së Organizatës së Luftëtarëve “Luftëtari i Ilixhës” Goran Shehovac ka theksuar se arrestimi i gjeneralit Mladiq paraqet “akt të turpshëm të Serbisë amë dhe të kryetarit të saj Boris Tadiq”.³³⁹ Kryetari i organizatës së familjeve të të burgosurve, të luftëtarëve të rënë dhe të civilëve të zhdukur të RS, Nedelko Mitroviq ka shprehur dëshirim të madh me rastin e arrestimit të gjeneralit Ratko Mladiq.³⁴⁰ Njëkohësisht, kryetari i Shoqatës së të Burgosurve në Kampe i RS Branislav Dukiq ka shtruar pyetjen se a është e mundur që Serbia të jetë vënë në anën e atyre që kanë shkaktuar shpërbërjen e ish Jugosllavisë dhe të arrestojë ata të cilët janë vënë në mbrojtje të popullit serb: “Në emër të 50 mijë të burgosurve serb në kampe, o Boris (Tadiq) dhe oj Serbi, le të jetë kjo në nderin tuaj, porse gjeneratat tona këtë nuk do t’ua falin kurrë”.³⁴¹

Në periudhën e viteve 2010 – 2011, kryepolitikantët në Republika Srpska kanë kontestuar më fuqishëm se më parë gjenocidin në Srebrenicë. Për vetë Kryeministrin e RS Milorad Dodik, Srebrenica është provokuar me veprimin e forcave myslimane para vitit 1995: “Srebrenica është hakmarrje për pësimin e serbëve në fshatin Kravice në vitin 1993.”³⁴² Përveç kësaj, është theksuar se pranimi i gjenocidit ka për pasojë edhe etiketimin e serbëve si “popull gjenocidal” dhe të RS si krijesë gjenocidale.³⁴³ Lidhur me këtë posaçërisht ka folur edhe kryetari i PDS-së,

334 „U shënuar përvjetori i parë i vdekjes së gjeneralit Rasim Deliq“, faqja e internetit *Vijesti*, më 19 prill 2011, <http://beta.vijesti.ba/vijesti/svijet/37815-obiljezana-prva-godisnjica-smrti-general-rasima-delica.html>.

335 Sërxfan Puhalo, Nebojsa Petroviq, Neda Perishiq, Gatishmëria për pajtim në Bosnje e Hercegovinë (Fridrich Ebert Stiftung, Sarajevë, viti 2010), f. 103.

336 „Dëshmi e gjenocidit të Sërpskës dhe të të gjithë serbëve: Deklarata për Srebrenicën si thikë pas shpine dhe lak në fyt“, faqja e internetit *24sata.info*, më 1 prill 2010, <http://www.24sata.info/vijesti/dogadjaji/29539-Dokaz-genocidnosti-Srpske-svih-Srba-Deklaracija-Srebrenici-ka-noz-ledja-omca-oko-vrata.html#ixzz1fbWACe9z>.

337 Nagja Dikliq, “Do ta përkrahja Rezolutën për Srebrenicën” *BH Dani (Ditët e B dheH)*, më 3 prill 2010, (intervistë me Mladen Ivaniqin, kryetar i PDP-së).

338 Intervistë me Tanja Topiqin, analiste politike, Fridrich Ebert Stiftung Banjallukë, më 17 nëntor 2011.

339 “Protesta në mbarë RS-në”, faqja e internetit *B92*, më 27 maj 2011, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=05&dd=27&nav_category=167&nav_id=515005.

340 „Reagimet ndaj arrestimit të Mladiqit- të ndara“, faqja e internetit *Deutsche Welle*, më 26 maj 2011, <http://www.dw.de/dw/article/0,,15109532,00.html>.

341 *Po aty*.

342 “Do ta mbështesja rezolutën mbi Srebrenicën”, *BH Dani*, 3 prill i vitit 2010, (intervistë me Mladen Ivaniqin, nënkryetarin e PPD-së).

343 Intervistë me Tanja Topiqin, analiste politike, Fridrich Ebert Stiftung Banjallukë, e datës 17 nëntor të vitit 2011.

Mladen Bosiq: “Nuk do të lejojmë që Republika Srpska një ditë të shpallet krijesë gjenocidale dhe kriminale dhe që fëmijët tanë të turpërohen me ata të cilët e kanë krijuar Republikën Srpska”.³⁴⁴

3.2. Kroacia

Shqiptimi i aktgjykimit jo të plotfuqishëm ndaj gjeneralëve Kroat Mladen Markaç dhe Ante Gotovina në prill të vitit 2011 nga ana e GJNPJ-së në masë të madhe ka radikalizuar publikun kroat gjatë vitit 2011.

Për Kryetarin e Kroacisë dr. Ivo Josipović dhe për kryeministren e atëhershme të Kroacisë Jadranka Kosor konstatimet nga aktgjykimi për ndërmarrje të bashkuar kriminale janë të papranueshme, kurse kryetari Josipović ka theksuar se Kroacia respekton dhe do t'i respektoj heronjtë e vet.³⁴⁵ Kryeministri aktual i Kroacisë Zoran Milanović, me rastin e shqiptimit të aktgjykimit, njëherazi kryetar i PSD-së, ka deklaruar se “nuk e pranon ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se asnjëherë nuk do ta pranojë”.³⁴⁶ Politikanët e tjerë në pushtet dhe të opozitës kanë reaguar në mënyrë të ngjashme ndaj këtij aktgjykimi jo të plotfuqishëm nga të cilët ata që kanë pasur orientime nacionaliste e kanë problematizuar vetë bashkëpunimin me GJNPJ-në. Krahas kësaj, janë dëgjuar komente se si aktgjykimi është rezultat i tendencës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale në Hagë për të barazuar agresorin dhe viktimën, përkatësisht humbësin dhe fituesin e luftës.

4. Debatet parlamentare

4.1. Bosnja dhe Hercegovina

Gjatë vitit 2010 në Dhomën e Përfaqësuesve të Kuvendit Parlamentar (KDHP të B dhe H) janë zhvilluar disa debate lidhur me qëndrimin ndaj konflikteve të armatosura gjatë viteve të 90-ta dhe ndaj krimeve të luftës. Është diskutuar për gjenocidin në Srebrenicë dhe për krimet në Sarajevë, për Propozim ligjin për ndalimin e mohimit, të minimizimit, të justifikimit dhe të miratimit të holokaustit, të gjenocidit dhe të krimeve kundër njerëzimit. Tema e konflikteve të armatosura ka qenë pjesë e debatit lidhur me Propozim ligjin për regjistrimin e popullsisë në B dhe H në vitin 2011.

Diskutimi për propozim ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive shtëpiake dhe të banesave në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2011 është karakterizuar me mospajtime themelore ndërmjet palës serbe dhe asaj boshnjake. Përfaqësuesit e partive serbe, gjatë diskutimit kanë insistuar për deklarimin e përcaktimit etnik, kombëtar dhe fetar, ndërsa përfaqësuesit e partive boshnjake janë angazhuar që të mos ketë detyrim ligjor për t'u përgjigjur në këso lloj pyetjesh. Një polemikë e ashpër, mbi baza etnike, është zhvilluar lidhur me kthimin e refugjatëve në vendbanimet e tyre të para luftës për të cilën gjë posaçërisht kanë insistuar deputetët boshnjakë, duke kërkuar që regjistrimi të bëhet vetëm pas përfundimit të procesit të kthimit. Kjo çështje ka hapur debatin lidhur me përgjegjësinë për krimet e kryera gjatë luftës në B dhe H. Duke kundërshtuar këtë propozim ligji, Remzija Kadriq, (Partia për B dhe H, kandidat për Dhomën e Përfaqësuesve të KP të B dhe H nga RS) ka theksuar se “me këtë ligj tentohet të legalizohet spastrimi etnik”,³⁴⁷ kurse një qëndrim të këfillë e ka mbështetur edhe kolegu i tij partiak, Sadik Bahtiq (Partia për B dhe H).³⁴⁸

344 Sër Khan Puhalo, Nebojsa Petroviq, Neda Perishiq, Gatishmëria për pajtim në Bosnje e Hercegovinë (Fridrich Ebert Stiftung, Sarajevë, viti 2010), f. 101.

345 Milan Peh, “Josipović: Është papranueshme teza për ndërmarrje të përbashkët kriminale”, faqja e internetit e *Jutarnji list*, publikuar në datën 15 prill 2011, <http://www.jutarnji.hr/presuda-gotovini--predsjednik-josipovic-sokiran-odlukom-haskog-suda/939183/>.

346 “Millanović: Gotovina dhe Markaç kanë paguar borxhin e huaj”, faqja e internetit *Index*, publikuar në datën 15 prill të vitit 2011, <http://www.index.hr/vijesti/clanak/milanovic-gotovina-i-markac-su-platili-tudji-dug/547341.aspx>.

347 Transkripti nga mbledhja e 70-të e Dhomës së Përfaqësuesve të Kuvendit Parlamentar, i datës 21 janar të vitit 2010, f.27.

348 Transkripti nga mbledhja e 79-të e Dhomës së Përfaqësuesve të Kuvendit Parlamentar të B dhe H, mbajtur në datën 16 qershor të vitit 2010, f.53.

Mospajtime ka pasur edhe rreth numrit të të kthyerve në entitete, edhe përkundër të dhënave ekzistuese zyrtare për numrin e të kthyerve nga minoritetet në territorin e Federatës së BdheH dhe të Republika Srpska, që i ka në dispozicion Ministria për të Drejta të Njeriut dhe për Refugjatë e BdeH.³⁴⁹ Sllavko Joviçiqi, përfaqësues i KP të BdeH nga RS (Lidhja e Socialdemokratëve të Pavarur – LSDP) ka deklaruar se është krenar nga se në Prijedor janë kthyer 25.000, kurse në Foçë 5.000 boshnjakë, ndërsa në Janjë afër Bijelinës janë kthyer 96% e popullsisë boshnjake. “Më thuani një vend në Federatën e BdeH ku janë kthyer 20 serb. Jo, ata edhe sot po shpërngulen nga Sarajeva. Të shohim sa serb sot jetojnë në territorin e BdeH”, theksoi Joviçiqi.³⁵⁰ Kjo deklaratë e tij ka shkaktuar kundërshtime nga ana e deputetëve boshnjakë.

Përkundër mospajtimeve, propozimi i ligjit, pa asnjë amendament të miratuar, gjatë leximit të dytë është miratuar dhe dërguar për shqyrtim në Dhomën e Kombeve. Në mbledhjen e Dhomës së Kombeve, të mbajtur në korrik të vitit 2011 njëzëri është vendosur që të vazhdohet faza e punës në amendamente në këtë ligj deri në fund të vitit 2011.³⁵¹

Deputetët serb dhe boshnjakë nuk janë pajtuar as me rastin e shqyrtimit të Propozim Rezolutës për rëndësinë e gjykimit të gjenocidit në Srebrenicë dhe të krimeve të luftës në BdeH, për ndërtimin e paqes së përhershme të cilën e ka propozuar Klubi i deputetëve të Partisë Socialdemokrate (PSD), kurse e ka mbështetur Komisioni i përbashkët i të dy dhomave për të drejtat e njeriut në mars të vitit 2010. Sipas fjalës hyrëse të Denis Beçiroviqit (Partia Socialdemokrate – PSD), Rezoluta përbënë tentim që në thelb të gjykohen të gjitha krimet e luftës dhe të tregohet respekt ndaj të gjitha viktimave të krimeve të luftës.³⁵² Me rezolutë, përveç tjerash, janë ftuar të gjitha organet kompetente shtetërore që qartazi ta gjykojnë dhe nëpërmjet sistemit të vet juridik të sanksionojnë çdo tentim për të relativizuar gjenocidin në Srebrenicë dhe krimet e luftës të kryera në BdeH. Është kërkuar që edhe Kuvendi Parlamentar i BdeH në mënyrë të paluhatshme të mbështesë edhe tekstin e Rezolutës për Srebrenicën, ashtu siç e kishte miratuar Parlamenti Evropian në janar të vitit 2009. Propozimin e kanë refuzuar deputetët nga radhët e serbëve të Bosnjës.³⁵³ Bakir Izetbegoviçiq (PAD) ka mbështetur Rezolutën dhe gjithashtu ka theksuar se përsëritja e tërë procesit është punë e kotë dhe e panevojshme dhe posaçërisht e dhimbshme për boshnjakët sepse “është e qartë se kjo çështje për fat të keq ende nuk është pjekur për të kaluar.”³⁵⁴

Duke pranuar paraprakisht përmasat e tragjedisë së Srebrenicës, Slavko Joviçiq (LSDP) ka vazhduar të insistonte për nevojën që në mënyrë të njëjtë të pranohen edhe krimet e kryera ndaj popullit serb në rajonin e Srebrenicës: “mos vallë dikush pret nga unë që tani unë të mbështesë këtë? Të paktën dikush të kishte thënë se janë vrrarë pesë serb të pafajshëm në rajonin e Srebrenicës dhe të Bratuncit. Këtë kurrë askush nuk e ka thënë.” Duke reaguuar ndaj deklaratës së Joviçiqit, Azra Haxhiahmetoviçiq (Partia për BdeH) ka thënë se secila palë i ka viktimat e veta, kështu që numërimi selektiv i viktimave nuk mund të shlyejë faktin se është kryer gjenocid.³⁵⁵

Në vazhdim të fjalimit të vet, Joviçiq (LSDP) ka theksuar se e kupton që në Rezolutë gjykohet pësimi i të gjithëve, porse kur përmendet Srebrenica viktimat e tjera lihen në hije, sepse “me të përmendur Srebrenicën të gjitha tekstet e tjera kanë rënë në ujë.”³⁵⁶ Ai ka konkluduar se nuk mund të fitohet mbështetja nga përfaqësuesit e LSDP “për arsye se një situatë e këtillë është edhe te populli serb edhe në RS dhe se nuk është koha për këtë rezolutë.”³⁵⁷ Në prill të vitit 2010, Dhoma e Përfaqësuesve e Kuvendit parlamentar të BdeH nuk e ka miratuar propozimin e

349 Informacion për kthimin e pakicave, Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë e Bosnjës dhe Hercegovinës, <http://www.mhrr.gov.ba/PDF/Izbjeglice/INFORMACIJA%20O%20POVRATKU%20DO%202010.pdf>.

350 Transkripti nga mbledhja e 70-të e Dhomës së Përfaqësuesve të KP të B dheH, mbajtur në datën 21 janar të vitit 2010, f. 30.

351 Ligji është miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve e Kuvendit Parlamentar të BdeH, më 03 shkurt 2012. Ligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive shtëpiake dhe të banesave në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 2013, (*Gazeta Zyrtare e B e H*), Nr.10/12.

352 Transkripti nga mbledhja e 74-të e Dhomës së Deputetëve të Kuvendit parlamentar të B dhe H, mbajtur në datën 24 mars të vitit 2010, f.76.

353 *Po aty*, f.76.

354 *Po aty*, f. 81.

355 Transkripti nga mbledhja e 74-të e Dhomës së Deputetëve të Kuvendit parlamentar të BdeH, mbajtur në datën 24 mars të vitit 2011, f. 82.

356 Transkripti nga mbledhja e 74-të e Dhomës së Deputetëve të Kuvendit parlamentar të BdeH, mbajtur në datën 24 mars të vitit 2010, f. 79.

357 Transkripti nga mbledhja e 74-të e Dhomës së Deputetëve të Kuvendit Parlamentar të BdeH, mbajtur në datën 24 mars të vitit 2010 f. 85.

rezolutës për rëndësinë e gjykimit të gjenocidit në Srebrenicë dhe të krimeve të luftës në BdheH për ndërtimin e paqes së përhershme dhe kështu kjo rezolutë më nuk është kthyer në procedurë parlamentare.

Gjatë vitit 2011 është diskutuar për Propozimin e ligjit për ndalimin e mohimit, minimizimit, justifikimit ose të miratimit të Holokaustit, të gjenocidit dhe të krimeve kundër njerëzimit. Në Kuvendin parlamentar të BdheH tashmë ka pasur debate në tema të ngjashme.³⁵⁸ Propozuesit nga Partia për BdheH, Beriz Belkiq dhe Azra Haxhi-ahmetoviq kanë insistuar për të debatuar edhe përkundër mendimit negativ të Komisionit të përbashkët të të dy dhomave për të drejtat e njeriut.³⁵⁹ Kundërshtarët e miratimit të ligjit, para së gjithash, nga radhët e partive serbe, (LSDP dhe PDS) kanë theksuar se në BdheH ekzistojnë disa të vërteta të luftës, duke potencuar se ky ligj paraqet përpjekje për manipulim politik me ngjarjet nga konfliktet e armatosura. Deputetja Dushanka Majkiq (LSDP) ka shprehur shqetësimin e saj për qëllimin e vërtetë që fshihet pas këtij ligji, përkatësisht qëllimin e propozuesit. Deputetja Majkiq u ka bërë një vështrim pretendimeve për pësimin e serbeve në Sarajevë në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 1995 dhe hetimeve që nuk janë zhvilluar kurrë dhe ka shtruar pyetjen përse autoritetet në Sarajevë ende refuzojnë të formojnë komisionin për hetimin e krimeve ndaj serbeve.³⁶⁰ Duke reaguar ndaj propozimit të këtij ligji, Slavko Joviçiq (LSDP) i ka bërë thirrje palës boshnjake që të pushojë së insistuari për nxjerrjen e këtij ligji, sepse përfaqësuesit serb këtë kurrë nuk do ta pranojnë.³⁶¹

Idhëtarët e nxjerrjes së këtij ligji, si argument kanë theksuar nevojën e parandalimit të manipulimit me viktimat për qëllime të politikës ditore, por edhe obligimin e harmonizimit të ligjeve vendore me obligimet e marra ndërkombëtare. Duke u përpjekur për të arsyetuar shkaqet e propozuesit, Beris Belkiq ka theksuar se ligji në thelb bazohet në një parim që ka të bëjë me pyetjen rreth asaj nëse krimet janë të pranueshme apo jo. Në fund të debatit për këtë propozim kryesuesi i Dhomës së Përfaqësuesve Denis Beçiroviq (SDP) theksoi nevojën e posaçme për nxjerrjen e një ligji të këtillë: “ky ligj u duhet viktimave, të gjitha viktimave, pavarësisht se a janë ato serbe, kroate, boshnjake, hebreje ose cilat do të tjera”³⁶²

4.1.1. Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës

7/9

Në mbledhjen e tretë të rregullt të mbajtur më 14 korrik të vitit 2011, Dhoma e Përfaqësuesve e Parlamentit të Federatës së BdheH në Sarajevë, në bazë të propozimit të kryesuesit të kësaj dhome, Denis Zvizdiq, njëzëri ka miratuar Rezolutën e Parlamentit Evropian për Srebrenicën. Njëkohësisht ka përshëndetur arrestimin e Ratko Mladiçit të akuzuar, përveç të tjerash edhe për gjenocid të kryer në muajin korrik të vitit 1995 në Srebrenicë, dhe kështu me 70 vota “pro” dhe me dy vota të abstenuara është dhënë rekomandimi që Kuvendi Parlamentar i BdheH dhe Kuvendi Popullor i Republika Srpska gjithashtu të miratojnë rezolutën për Srebrenicën në tekstin e saj buri-mor.³⁶³ I njëjti tekst është miratuar edhe në Dhomën e Kombeve të Federatës së BdheH më 18 korrik të vitit 2011. Anëtarët e Klubit të Serbëve në Dhomën Federale të Kombeve, Pegja Kojoviq (Partija Jonë) dhe Mirjana Maliq (PSDP e BdheH) janë deklaruar pozitivisht. Kojoviqi ka kërkuar që krahas rezolutës të votohet konkluzioni sipas të cilit Dhoma e Kombeve do të insistonte për nxjerrjen e Ligjit në Federatën e BdheH, në të cilin do të përcaktohej

358 Gjatë vitit 2010, disa herë në mbledhjet e Dhomës së Përfaqësuesve të Kuvendit Parlamentar të BdheH, janë diskutuar propozimet për inkrimimin e mohimit të holokaustit dhe të gjenocidit. Në mbledhje e 70-të të Dhomës së përfaqësuesve, mbajtur në datën 21 janar të vitit 2010 është votuar për Raportin e Komisionit të Kolegjiumit për propozim konkluzionin të Klubit të Deputetëve të SDA-së nga mbledhja e 69 e kësaj Dhome, të mbajtur më 30 dhjetor të vitit 2009. Në këtë Konkluzion, nga Këshilli i Ministrave kërkohet që të dërgojë në procedurë parlamentare propozimin e aktvendimit ligjor me të cilin, pa mëdyshje, si vepër penale sanksionohet çdo mohim, minimizim ose miratim i krimit të holokaustit, i gjenocidit ose i krimeve të tjera kundër njerëzimit. Kjo nismë nuk ka marrë përkrahjen e nevojshme. Në rrethin e dytë të votimit, me 23 vota „pro“ (nga Federata e BdheH 21, nga Republika Srpska dy), 11 vota „kundër“ dhe pa vota „të abstenuara“, kjo Dhomë nuk ka miratuar Konkluzionin e Klubit të Deputetëve të SDA-së.

359 Mendim pozitiv lidhur me harmonizimin e Propozimit me Kushtetutën dhe me sistemin juridik të BdheH kanë dhënë Drejtorja për Integritet Evropian dhe Këshilli kushtetues-juridik i Kuvendit Parlamentar të BdheH.

360 Audio regjistrim i mbledhjes së 15-të të Kuvendit parlamentar të BdheH, mbajtur në datën 15 dhjetor të vitit 2011.

361 *Po aty.*

362 *Po aty.*

363 Faqja zyrtare e Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, më 14 korrik 2011. http://www.parlamentfb.dhe.h.gov.ba/predstavnicki_dom/hr/page.php?id=106

përgjegjësia penale për secilin që mohon se në BdheH gjatë luftës së kaluar ka pasur gjenocid. Drago Puzigaça, gjithashtu anëtar i Klubit të serbëve nuk ka qenë i pranishëm në mbledhje, por në pyetjen e gazetarit se si do të votonte lidhur me rezolutën, ai është përgjigjur se do të votonte në favor të kësaj rezolute.³⁶⁴

Dhoma e përfaqësuesve të Parlamentit të Federatës së BdheH, në mbledhjen e gjashtë të rregullt të datës 28 shtator të vitit 2011 në formë të projektit ka mbështetur, herën e dytë, plotësimet e *Ligjit penal me të cilin aplikohet dënimi për mohimin e gjenocidit, të Holokaustit, të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit*. Jasmin Duvnjak (PAD), në emër të propozuesit kërkoi edhe plotësimin e ligjit me të cilin parashikohet dënimi me burgim për ata që mohojnë këto krime. Dhoma e Kombeve e Parlamentit të Federatës së BdheH, në mbledhjen e datës 10 nëntor të vitit 2011 ka miratuar Projektligjin për plotësimet e Ligjit penal të FDbheH, me të cilin është parashikuar ndëshkimi i mohimit të gjenocidit ose të krimeve të tjera të luftës, me dënim burgimi prej tre muaj deri në tri vjet.³⁶⁵

4.1.2. *Kuvendi Popullor i Republika Srpska*

Për krimet e luftës të kryera gjatë luftës në BdheH, deputetët e Kuvendit Popullor të Republika Srpska kanë debatuar me rastin e prezantimit të raportit për kërkimin e personave të zhdukur dhe për hetimin dhe procesimin e krimeve të luftës. Në debatin e datës 31 maj dhe të 1 qershorit të vitit 2010 deputetët serb duke kritikuar punën e institucioneve shtetërore të BdheH, kanë theksuar se nuk ekziston vullneti politik për hetimin dhe procesimin e krimeve të kryera ndaj Serbëve. Kështu, Bosislav Bojiq (PDS) ka rikujtuar se Këshilli i Ministrave në datën 25 maj të vitit 2006 ka miratuar propozimin e Parlamentit dhe ka themeluar Komisionin për Sarajevën, por ai në thelb asnjëherë nuk ka filluar të funksionojë dhe as nuk është shuar zyrtarisht.³⁶⁶ Kostadin Vasiq (PDS) gjithashtu ka pyetur pse nuk është jetësuar komisioni i përbashkët për Sarajevën, ashtu siç ishte rasti me komisionin për Srebrenicën dhe ka konkluduar: “Shihet qartë se këtu gjithçka po punohet në dëm të serbëve. Mund të them lirisht se Gjykata, Prokuroria e BdheH po gjykon dhe akuzon, në bazë të urrejtjes ndaj serbëve dhe jo sipas argumenteve dhe provave që ekzistojnë.”³⁶⁷

Deputetët boshnjak gjithashtu kanë pasur kundërshtime, por ndaj punës së institucioneve në Republika Srpska, posaçërisht të ekipit operativ të Republika Srpska për kërkimin e personave të zhdukur. Është theksuar se nuk ka trajtim të njëjtë për personat e zhdukur nga ana e institucioneve të pushtetit të RS. Kështu Mirsad Duratović (Partia për BdheH) ka kontestuar të dhënat nga Raporti për kërkimin e personave të zhdukur, për hetimin dhe procesimin e krimeve të luftës duke thënë: “Nuk është e saktë, sipas të dhënave, se nga fundi i vitit 1995 në RS janë evidentuar 5280 persona të zhdukur. Në atë kohë nga territori i RS kanë qenë të evidentuar diku rreth 22.000 persona të zhdukur. Është e qartë se raporti operon ekskluzivisht me personat e zhdukur të nacionalitetit serb, ndërsa qytetarët e zhdukur të RS të nacionalitetit jo serb janë lënë jashtë këtij raporti.”³⁶⁸ Me të është pajtuar edhe Muharrem Murselović (Partia për BdheH) i cili ka theksuar se në RS janë zhdukur gjithsejtë 21.729 civil dhe ka shtuar: “Në Prijedor, prej nga jam unë, janë vrarë 120 fëmijë, janë vrarë 388 gra, këto janë të dhëna mjaft të besueshme dhe unë do të dëshiroja, ashtu sikurse edhe të gjithë ne këtu, që të paktën sa i përket boshnjakëve ky raport për kërkimin e të zhdukurve të përfshinte të gjithë qytetarët, edhe ata që jetojnë në RS e edhe ata që kanë jetuar në këto hapësira, dhe i cili sot quhet entitet.”³⁶⁹ Në kundërshtim me këtë, deputeti Nenad Kesiq (LSDP) ka pohuar se evidentimi i numrit të të zhdukurve është i vështirë, sepse familjet e serbeve të zhdukur, të zhdukurit e vet i kanë raportuar në RS, kurse familjet boshnjake këtë e kanë bërë në organet federale.³⁷⁰

364 Parlamenti Federal ka miratuar Rezolutën për Srebrenicën, në datën 8 korrik të vitit 2011. <http://www.radiosarajevo.ba/novost/58871/Burek%20i%20dimije>

365 Faqja zyrtare e Parlamentit të Federatës së Bosnje e Hercegovinës, në datën 10 nëntor të vitit 2011. http://www.parlamentfb.dje.ba/dom_naroda/bos/parlament/info/saopcenja.html

366 Transkripti nga mbledhja e 37-të e Kuvendit Popullor të Republika Srpska, mbajtur në datën 31 maj të vitit 2010, f. 119.

367 *Po aty*, f. 102.

368 *Po aty*, f. 106.

369 *Po aty*, f. 110.

370 *Po aty*, f. 114.

Në mars të vitit 2011, pushteti në Republika Srpska, rastin e arrestimit të gjeneralit Jovan Divjak, në bazë të fletarrestimit të Prokurorisë për krimet e luftës të Republikës së Serbisë e ka shfrytëzuar edhe njëherë për të ngritur çështjet lidhur me punën e institucioneve të drejtësisë të BdheH. Një mbledhje e posaçme e kuvendit është mbajtur në datën 13 prill të vitit 2011 dhe në rend dite ka pasur vetëm një pikë – Puna e Prokurorisë dhe e Gjykatës së BdheH. Kryeministri Milorad Dodik ka prezantuar raportin për hetimin dhe procesimin e krimeve të luftës dhe për kërkimin e personave të zhdukur, i cili është përgatitur me kërkesën e Qeverisë së Republika Srpska. Dodik në ekspozenë hyrës ka thënë se vet themelimi i Gjykatës së BdheH është kundërkushtetues dhe se nuk ka arsye të ekzistojë Prokuroria dhe Gjykata e BdheH. Përveç kësaj, Dodik ka thënë se Prokuroria “ka për qëllim të krijojë të vërtetën gjyqësore për serbët si kriminel, e cila do të shfrytëzohej si fakt në strategjitë politike të boshnjakëve”.³⁷¹ Ai gjithashtu ka shprehur qëndrimin se që të dy institucionet janë duke punuar në dobi të interesave politike të boshnjakëve. “Nuk ka boshnjak të akuzuar në bazë të përgjegjësisë komanduese, nuk ka të dyshuar për ndërmarrje të organizuar kriminale dhe për sulme sistematike. Kualifikimet e këtilla juridike janë të rezervuara vetëm për serbët!”³⁷²

Slobodan Popović (PDS) ka theksuar se nuk ka nevojë të debatohet për këtë çështje duke thënë: “Raporti i Prokurorisë dhe i Gjykatës së BdheH për vitin 2009 është miratuar në Parlamentin Shtetëror dhe unë tani pyes se a ka në atë Parlament Shtetëror përfaqësues të Republika Srpska të cilët i kanë dhënë këtij raporti legalitet dhe legjitimitet. Nëse e gjithë kjo është miratuar, atëherë shtrohet pyetja për çfarë ne këtu po flasim.”³⁷³ Ramiz Salkiqi (PDA) ka theksuar se as në bashkësinë boshnjake nuk janë “edhe aq të kënaqur”, sepse “në vend se të procesohet për ata që kanë kryer krimet e gjenocidit në zonën e mbrojtur të KB, Gjykata në Bijelinë ka procesuar gjashtë boshnjakë të cilët pas gjashtë muajve kanë kaluar nëpër mal dhe i janë dorëzuar bazës së SFOR-it në Memiq”.³⁷⁴

Kuvendi Popullor i Republika Srpska, pas debatit, me anë të votave ka përkrahur nismën e Dodikut, që për shkak të qëndrimit të këtyre të Gjykatës dhe të Prokurorisë së BdheH të mbahet referendum në RS, në të cilin qytetarët do të deklaroheshin për ligjet e imponuara (nga të cilët njëri është Ligji për gjykatën e BdheH) dhe për shkeljen e Konventës për të drejtat e njeriut nga ana e Përfaqësuesit të lartë të BdheH. Në konkluzionet që kanë shoqëruar vendimin e Kuvendit është theksuar se puna e Gjykatës dhe Prokurorisë së BdheH, me një qasje selektive në kërkimin dhe procesimin e krimeve të luftës, i ka shkaktuar dëm popullit serb me tendencë të qartë politike që për serbët të krijojë pasqyrë negative për ngjarjet e luftës në BdheH.³⁷⁵ Me konkluzione gjithashtu hedhen poshtë përpjekjet për themelimin e Gjykatës Supreme të BdheH dhe insistohet për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial, pastaj për themelimin e autoriteteve të ndara për të dy entitetet.³⁷⁶ Pas ndërhyrjes së Catherine Ashton, përfaqësueses së lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Dodiku paralajmëroi se do të kërkojë nga kuvendi tërheqjen e vendimit për referendumin dhe në bazë të premtimit të BE-së bashkë me institucionet e drejtësisë së BdheH do të fillojë “dialogu struktural” për reformën e drejtësisë në BdheH. Në mbledhjet e mbajtura nga fundi i majit dhe nga fillimi i qershorit të vitit 2011, Kuvendi Popullor i RS, pas diskutimit ka miratuar Propozim vendimin për shfuqizimin e Vendimit për shpalljen e referendumit në këtë Republikë.

4.2 Kroacia

Në Parlamentin kroat, gjatë vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011 të rralla kanë qenë debatet me temën e marrëdhënies ndaj ngjarjeve nga periudha e konfliktit të armatosur në Kroaci nga viti 1991 e deri në vitin 1995. Porositë në këtë drejtim në debatet parlamentare janë paraqitur gjatë sjelljes së Ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara të organeve gjyqësore të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë.³⁷⁷

371 Transkripti nga mbledhja e 4-të e veçantë e Kuvendit Popullor të Republika Srpska, i datës 13 prill të vitit 2011, f. 16.

372 Transkript nga mbledhja e 4-të e veçantë e Kuvendit Popullor të Republika Srpska, i datës 13 prill të vitit 2011, f. 17.

373 *Po aty*, f. 60.

374 *Po aty*, f. 64.

375 Kuvendi i RS-së ka përkrahur referendimin për Gjykatën dhe Prokurorinë e BdheH, faqja e internetit Radio Evropa e Lirë, më 14 prill 2011. http://www.slobodnaevropa.org/content/republika_srpska_ce_odrzati_referendum/3556606.html.

376 *Po aty*.

377 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011.

Ky Ligj është propozuar nga Qeveria, por përbënë nismë të Bashkësisë Demokratike Kroate (HDZ), kurse është i njohur edhe si “Ligji i Sheksit”. Nënkryetari i parlamentit dhe HDZ-së, Vlladimir Sheksi, i cili e ka zhvilluar fushatën për votimin e ligjit, është një nga të akuzuarit në aktakuzën të cilën e ka aktivizuar Prokuroria për Krime të Luftës e Serbisë. Krahas Sheksit, janë akuzuar edhe Ivan Vekiçi, Branimir Glavashi dhe Tomislav Merçepi dhe edhe 40 persona të tjerë, se kanë kryer vepra penale të krimeve të luftës dhe të gjenocidit. Debati parlamentar rreth Ligjit e ka radikalizuar fushatën zgjedhore, e cila ishte në vazhdim e sipër. Në debatin mbi Ligjin, partitë opozitare kanë marrë pjesë vetëm në fillim, pos Lidhjes Demokratike Kroate të Sllavonisë dhe Baranjes (LDKSB), që ka marrë pjesë në gjithë debatin, pos në votimin e Ligjit.

Ministri i Administratës, Davorin Mlakar, me rastin e paraqitjes së Ligjit ka theksuar se „Republika e Serbisë, me legjislacionin e saj intern e ka zgjeruar juridiksionin e Republikës së Serbisë në zonat e Republikës së Kroacisë sovrane e të pavarur“, dhe se kjo është arsyeja e miratimit të këtij akti juridik. Ai ka theksuar se me këtë Ligj, RK nuk e sjellë në pyetje zbatimin e ligjit Kushtetues mbi bashkëpunimin e RK me gjykatën ndërkombëtare penale në Hagë dhe përmbushjen e obligimeve që dalin prej tij, por se vetëm është fjala që organet e gjyqësorit të RK të mbrojnë dispozitat e veta.³⁷⁸

Përfaqësuesi i BDK -së (HDZ) dhe nënkryetari i Parlamentit Vlladimir Sheksi ka theksuar se akuzat kundër tij, ish ministrit të punëve të brendshme, Ivan Vekiçit, ndihmësministrit të Ivan Vekiçit, Tomisllav Merçepit, dhe sekretarit të mbrojtjes në Osijek, Branimir Gllavashit, janë ngritur me qëllim që të barazohet fajësia në kuptimin operativ midis forcave kroate dhe atyre serbe/serbiane.³⁷⁹ Për disa përfaqësues të HDZ-së, siç është Andrija Hebrangu, aktakuza e Prokurorisë serbiane për krime të luftës përfaqëson fazën e dytë të agresionit serb në RK.³⁸⁰

Përfaqësuesi i LDKSB, Dinko Buriçi ka theksuar se ky ligj nuk do të ofrojë efikasitet në sigurimin e mbrojtjes për veteranët kroat nga ndjekja e organeve të gjyqësorit të RS. Ai ka pohuar se qysh me Ligjin mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale është mundësuar që shteteve të tjera t’iu ekstradohen shtetasit e vet, pa marrë parasysh nëse janë edhe në territorin e RK, dhe eventualisht kanë kryer vepra penale. „Me aktakuzat kundër veteranëve kroat, të cilat vijnë nga Serbia, vendit të agresionit ndaj Kroacisë, vërtet duhet dhënë fund, por rreziku po aq i madh e, shpesh, edhe më i madh për Luftën atdhetare dhe veteranët e luftës vjen nga organet dhe institucionet e gjyqësorit. Në këtë pikëpamje posaçërisht dallohen PSHRK dhe gjykatat kroate“. Ai ka vlerësuar si të “turpshëm” gjykimin e gjeneralëve Mirko Norcit dhe Rrahim Ademit, ku Prokuroria shtetërore e Qarkut në Zagreb për dëshmitarë të aktakuzës ka propozuar Sava Shtrbcin. Është përqendruar edhe në vdekjen e Gjuro Brodarcit në paraburgim, 80 për qind e aktakuzës së të cilit është bazuar në të dhënat e Veritasit.³⁸¹

Shumë përfaqësues të opozitës kanë ardhur në përfundim se miratimi i këtij ligji është një lojë e llojit të vet dhe se nuk do të sjellë mbrojtjen efikase të qytetarëve kroat kur e lëshojnë RK, por se vetëm do të sjellë përkeqësimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe bashkëpunimin e dobësuar dhe të vështirësuar midis PSHRK dhe Prokurorisë për Krime të Luftës të RS. Kështu, përfaqësuesi i Partisë së Pavarur Demokratike Serbe (PPDS), Milorad Pupovac ka theksuar se ky ligj është i panevojshëm, sepse edhe ashtu disa prej këtyre aktakuzave/ndjekjeve janë të pavlefshme, sepse sipas Marrëveshjes së vitit 2006 midis PSHRK dhe Prokurorisë së Serbisë nuk do të procedohet ajo për të cilën nuk ka prova valide, siç ka ndodhur në rastin Purda dhe Bosanasi.³⁸²

378 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011. f. 1-2.

379 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011. f. 28.

380 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011. f. 33-34.

381 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011, f. 2-4.

382 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011. F.10-11.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Partisë së të Drejtave të Kroacisë (PDK), Daniel Srb, ka thënë se Propozim Ligjin do ta mbështesë „për arsye se në te e shoh shpresën se do të arrihet deri te ndryshimi i një bashkëpunimi politik midis organeve të RK dhe RS, e të cilat posaçërisht i shfrytëzon RS me qëllim që t'i realizojë interesat e saj kombëtare, pra edhe me bazën e shfrytëzimit të këtyre aktakuzave“.³⁸³

Ligji është votuar pa pjesëmarrjen e partive opozitare, në atë mënyrë që kuorumi në Parlament mezi është realizuar.³⁸⁴ Është votuar me 72 vota „për“ dhe 5 vota „abstenim“.

4.3. Serbia

Mbi propozimin e deklaratës mbi dënimin e krimeve të kryera në Srebrenicë në Kuvendin e Republikës së Serbisë është debatuar me procedurë të përshpejtuar në datën 30 mars të vitit 2010. Deputetja Nada Kolunxhija në emër të propozuesit (Koalicioni „Për Serbinë Evropiane - PSE ka arsyetuar se deklarata është përpiluar duke u nisur nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin e padisë së BdheH për gjenocid të kryer në Srebrenicë, si dhe nga fakti se Serbia është anëtare e barabartë e Kombeve të Bashkuara dhe nënshkruese e konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, me çka është e obliguar t'i respektojë ato akte. „Duke dënuar krimin e tmerrshëm në Srebrenicë ndaj popullatës boshnjake, duke iu shprehur nderime viktimave të pafajshme, duke shprehur bashkëndjesinë më të thellë me familjet e tyre, ne sot e marrim përgjegjësinë që nga gjeneratat e ardhshme të heqim barrën e rëndë të cilën na e kanë lënë individët“, ka thënë Kolunxhija.³⁸⁵

Deputetët opozitar nga partitë nacionaliste kanë shprehur një varg të tërë të kritikave në llogari të propozuesit të deklaratës, por edhe të shteteve në rajon dhe popujve, posaçërisht atij boshnjak. Është kritikuar procedura e përshpejtuar, pastaj përmbajtja e deklaratës që ekskluzivisht ka pasur të bëjë me viktimat srebrenicase dhe jo edhe me viktimat e krimeve të tjera dhe viktimat e popullit serb. Një numër i madh i deputetëve ka shprehur mendimin se deklarata është pjesë e marrëveshjes me bashkësinë ndërkombëtare dhe se qëllimi i saj themelor është që ta dobësojë pozitën e Republika Srpska. „Teksti i propozuar është i tillë që ndan viktimat e luftës qytetare në hapësirën e ish Jugosllavisë dhe i grind popujt, për arsye se ky tekst me asnjë fjalë nuk i gjykon krimet ndaj popullit serb, i cili në ato luftëra më së shumti ka pësuar e edhe për arsye se me përmbajtjen e saj edhe me momentin në të cilin miratohet, deklarata e këtillë është në kundërshtim edhe me interesat e serbëve, të popullit serb dhe të Republika Srpska“, ka thënë deputeti i Partisë Demokratike të Serbisë (PDS) Jovan Palaliq.

Qëndrime të ngjashme kanë shprehur përmes deputetëve të vet edhe Serbia e Re dhe Partia Radikale Serbe (partia e Vojislav Shesheljit, të akuzuarit para GJNPJ).

Deputeti i Partisë Liberale Demokratike (PLD) Çedomir Jovanoviqi ka thënë se Serbia ka një qëndrim hipokrit ndaj popullit serb në BdheH, „sepse e ka shtyrë në luftë e pastaj edhe e ka flijuar kur ka vendosur për të ikur nga përgjegjësia e vet“, si dhe se „është manipulimi më i paturpshëm dhe gënjeshtër“ se me këtë të fyhen edhe viktimat serbe..³⁸⁶

Deputeti i Partisë Socialiste të Serbisë (PSS) Branko Ruzhiq ka arsyetuar se kërkesë e grupit parlamentar të PSS –Serbia Unike ka qenë që teksti i deklaratës “të mos përmbajë përkufizime juridike të nivelit të krimit“, dhe se është e nevojshme „të mblidhen forcat“ që të arrihet „një konsensus sa më i gjerë në politikën e gjithmbarshme të dënimit të krimit, i cili ka ndodhur në Srebrenicë e, natyrisht, edhe kundër pjesëtarëve të popullit serb“.³⁸⁷

383 Fonogram i debatit mbi Propozimin përfundimtar të ligjit mbi pavlefshmërinë e akteve të caktuara juridike të organeve të ish APJ-së, ish RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, procedurë urgjente, leximi i parë dhe i dytë, P. Z. Nr. 889, mbajtur në datën 6 dhe 21 tetor të vitit 2011.

384 Kuorumi minimal për votim të ligjit është 76 deputet, të pranishëm 77.

385 Sesion i dytë dhe e tretë i seancës së rregullt të Kuvendit të Republikës së Serbisë, 25 dhe 30 mars i vitit 2010; ISSN 0582-6926, Kuvendi i Serbisë, Beograd 2011, f. 102-103.

386 *Po aty*, f. 118-123.

387 *Po aty*, f.124.

Lideri i partisë më të fortë opozitare, Partia Përparimtare Serbe (PPS) Tomislav Nikoliqi e ka paraqitur tekstin e deklaratës, të cilin e ka përgatitur kjo parti. „Në emër të PPS, në mënyrën më të ashpër dënojmë të gjitha krimet të kryera në luftën qytetare në territorin e ish-Jugosllavisë, si krimet ndaj popullit serb, ashtu edhe krimet të cilat pjesëtarët e popullit serb i kanë kryer ndaj pjesëtarëve të popujve të tjerë, e posaçërisht krimin i cili është kryer ndaj myslimanëve të Srebrenicës në muajin korrik të vitit 1995, i cekur në aktgjykimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë“, ka thënë Nikoliqi.³⁸⁸ Kjo parti, megjithëkëtë, nuk e ka përkrahur dokumentin e propozuar të koalicionit qeverisës dhe deputetët e saj e kanë lëshuar sallën e Kuvendit para votimit.

Deputeti Esad Xhuxheviqi, përfaqësues i pakicës boshnjake, ka propozuar që Kuvendi të votojë në datën 11 korrik në ditën e kujtimit të viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, që është pjesë e obligimit, i cili rezultoi nga Rezoluta e Këshillit të Evropës mbi gjenocidin në Srebrenicë, por një grup i madh i deputetëve vrullshëm dhe negativisht ka reaguar ndaj fjalës së tij.³⁸⁹

Deklarata mbi Srebrenicën është votuar me shumicën minimale, me 127 vota për (prej 250 deputetëve të kuvendit), në datën 31 mars të vitit 2010. Në Deklaratë “në mënyrën më të ashpër dënohet krimi i kryer ndaj popullatës boshnjake në Srebrenicë në mënyrën e vërtetuar me aktgjykim të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë“, me çka është shmangur shprehja e fjalës „gjenocid“ në vet tekstin e Deklaratës. Krahas kësaj, është shprehur ngushëllimi dhe kërkimfalja për familjet e viktimave për atë se nuk është bërë gjithçka për të parandaluar këtë tragjedi.³⁹⁰ Në Deklaratë ftohen të gjitha ish palët e konfrontuara në Bosnjë e Hercegovinë dhe në shtetet e tjera të ish Jugosllavisë që ta vazhdojnë procesin e pajtimit dhe të përforcimit të kushteve për jetë të përbashkët të bazuar në barazinë e kombeve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe të lirisë të njeriut dhe të pakicave, që krimet e kryera kurrë më të mos përsëriten. Po ashtu, shprehet edhe e pritja se edhe organet më të larta të shteteve të tjera nga territori i ish-Jugosllavisë në këtë mënyrë do të dënojnë krimet e kryera ndaj pjesëtarëve të popullit serb, si dhe se do të kërkojnë falje e do t’iu shprehin ngushëllime familjeve të viktimave serbe.³⁹¹

84

Debati mbi projekt-deklaratën e Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë mbi dënimin e krimeve të kryera ndaj pjesëtarëve të popullit serb dhe qytetarëve të Serbisë është zhvilluar në datën 14 tetor të vitit 2010. Propozimin e ka paraqitur grupi prej 123 deputetëve të popullit, kurse në emër të propozuesit deklaratën e ka arsyetuar shefja e grupit parlamentar PSE Nada Kolunxhija, duke thënë se dy deklaratat janë rezultat i vendosmërisë së Kuvendit të Serbisë që “në një mënyrë të përcaktuar kundruall të kaluarës dhe ngjarjeve tragjike të viteve 1990-të që në mënyrë adekuate të barazojë të gjitha viktimat e luftërave në hapësirën e ish Jugosllavisë dhe që t’ua jep përkrahjen institucionale të gjitha institucioneve përgjegjëse që kryerësit e këtyre krimeve t’i nxjerrin para drejtësisë“.³⁹²

Slobodan Samarxhiqi (PDS) e ka akuzuar koalicionin në pushtet se Deklarata mbi Srebrenicën për ta „ka qenë e nevojshme për përdorim të jashtëm, kurse deklarata mbi serbët për nevojat e brendshme“, si dhe që me përmbytjen e deklaratës krijohet „seleksioni i disa llojeve të viktimave“, prej të cilave të rangut të ulët janë viktimat serbe, kurse edhe më të ulët viktimat e bombardimit të NATO-s, sepse në deklaratë nuk përdoret termi “krim” për intervenimin e NATO-s.³⁹³

Partia më e madhe opozitare PPS, ka pasur më së shumti vërejtje lidhur me atë se në propozimin e deklaratës mungon kualifikimi “krim” me rastin e të cekurit të bombardimeve të NATO-s. Tomislav Nikoliqi e ka akuzuar

388 *Po aty*, f.128.

389 *Po aty* f. 111.

390 Teksti i Deklaratës mbi Srebrenicën, faqja e internetit Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, <http://www.parlament.gov.rs/narodna-skupstina-.872.html>.

391 Teksti i Deklaratës mbi Srebrenicën, faqja e internetit Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, <http://www.parlament.gov.rs/narodna-skupstina-.872.html>.

392 Sesioni i dytë dhe i tretë i seancës së rregullt të Kuvendit të Republikës së Serbisë, 14 dhe 19 tetor 2010; ISSN 0582-6926, Kuvendi i Serbisë, Beograd 2011, faqe 12.

393 *Po aty*, faqe 19-21.

shumicën në pushtet se me këtë deklaratë vetëm po e blen opinionin publik, kurse nuk është sinqerisht e interesuar për krimet e kryera ndaj serbëve. “Pas Deklaratës mbi dënimin e krimeve në Srebrenicë, asnjë deklaratë tjetër më nuk e meriton vëmendjen”, ka përfunduar Nikoliqi.³⁹⁴

Deputeti i Partisë Radikale Serbe (PRS) Aleksandar Martinoviçi ka thënë se kjo deklaratë „duhet të përfaqësojë makinën e larjes politike, në të cilën duhet të lahet ndërgjegjja e atyre deputetëve të popullit të cilët kanë votuar para disa muajve për atë se në Srebrenicë ka ndodhur diçka që nuk ka ndodhur “. ³⁹⁵

Përfaqësuesi i PLD-së, Zoran Ostojiçi ka përkujtuar se kjo parti ka propozuar se në vend të dy deklaratave të miratohet Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi gjenocidin në Srebrenicë, ku dënohen të gjitha krimet, kurse theksohet njëri, sepse është krim i gjenocidit.³⁹⁶

Deklarata është miratuar me votat e 133 deputetëve të koalicionit në pushtet dhe të deputetëve të PLD-së, kurse deputetët e partive opozitare e kanë lëshuar sallën e kuvendit para votimit. Me Deklaratë në mënyrën më të ashpër janë dënuar krimet ndaj pjesëtarëve të popullit serb dhe qytetarëve të Serbisë gjatë konfliktit të armatosur në ish-Jugosllavi dhe janë ftuar parlamentet, para së gjithash të vendeve nga hapësira e ish Jugosllavisë, për të dënuar këto krime dhe që t’ua japin përkrahjen e plotë organeve të tyre shtetërore dhe organeve të bashkësisë ndërkombëtare në procesimin e kryerësve si dhe që, duke vlerësuar njësoj vlerën e çdo jete njerëzore, të shprehin respektin ndaj viktimave serbe.³⁹⁷

4.4 Kosova

Me rastin e gjykimit pjesërisht të përsëritur të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Ibrahimit, në Kuvendin e Kosovës është mbajtur në fund të muajit maj të vitit 2011 seanca jashtëzakonshme plenare.³⁹⁸ Kërkesën për seancë të jashtëzakonshme e ka paparaqitur Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me përkrahjen e 40 deputetëve të partive të ndryshme politike. Në seancë janë miratuar rekomandimet e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të cilat përmbajnë kërkesën e GJPNJ që gjykimi për Haradinajn dhe të tjerët të jetë „i qartë, fer dhe i shpejtë “, dhe të institucioneve shtetërore që urgjentisht të sigurojnë mbështetjen juridike dhe materiale për të akuzuarit në këtë proces.

Në tekstin e rekomandimeve të miratuara, “duke besuar në pafajësinë e zotëri Haradinajt dhe të shokëve të tij, si dhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Tribunali proces të qartë, fer dhe të shpejtë kundër ish kryeministrit të Kosovës, zotëri Haradinajt dhe shokëve të tij, në mënyrë që zotëri Haradinaj dhe shokët e tij të kthehen sa më shpejt në Kosovë”.³⁹⁹

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi ka qenë i pranishëm në këtë seancë dhe me atë rast ka deklaruar se Qeveria e Kosovës dhe ai personalisht janë të gatshëm për të ofruar ndihmë, dhe se kanë pritur që të krijohen rrethanat e nevojshme që të ofrohet mbështetja juridike dhe ligjore, të cilën e mundësojnë ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosova. Kryeministri ka theksuar se Qeveria beson në pafajësinë e plotë të të akuzuarve dhe se beson se procesi kundër Haradinajt do të jenë fer dhe transparent.⁴⁰⁰

394 *Po aty*, faqe 28-30.

395 *Po aty*, faqe 38.

396 *Po aty*, faqe 49.

397 Tekst i Deklaratës mbi dënimin e krimeve të kryera ndaj pjesëtarëve të popullit serb dhe qytetarëve të Serbisë, faqja e internetit e Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, <http://www.parlament.gov.rs/narodna-skupstina-.872.html>.

398 Ramush Haradinaj është burgosur në datën 20 korrik të vitit 2010 dhe është transferuar në paraburgim në GJNPJ në Hagë, kur Paneli i Apelit i Tribunalit e ka hedhur aktgjykimin me të cilin lirohet nga përgjegjësia penale dhe e ka urdhëruar përsëritjen e procedurës sipas disa pikave të aktakuzës.

399 Republika e Kosovës – Kuvendi, “Rekomandime”, 31 maj i vitit 2011, faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2011_05_31_Preporuke.pdf.

400 Transkript i seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur në datën 31 maj të vitit 2011. Transkripti është marrë me kërkesë nga Kuvendi i Kosovës, 27 janar i vitit 2012.

Gjatë debatit, deputetët e partive opozitare kanë shprehur dyshimin në atë se qeveria kosovare ofron mbështetje për të akuzuarit në atë proces, dhe është thënë se “me ndryshim nga Serbia, Kosova nuk i ka paraqitur prova të mjaftueshme Tribunalit të Hagës me të cilin do të provohej se lufta e UÇK-së a qenë e drejtë”.⁴⁰¹ “Sikur të kishte pasur angazhime serioze në mbrojtjen e vlerave tona të luftës, sot nuk do të ballafaqoheshim me këto sfida, dhe UNMIK-u ose EULEX-i nuk do të burgosnin çlirimtarët tanë”, ka thënë Rexhep Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje!⁴⁰² E vetmja parti politike serbe në përbërjen e tashme të kuvendit, Partia e Pavarur Liberale (PPL), nuk ka marrë pjesë në debat dhe as që kanë votuar deputetët e kësaj partie rekomandimet.⁴⁰³

4.5. Mali i Zi

Gjatë vitit 2010, Kuvendi i Malit të Zi ka debatuar për ballafaqimin me konfliktet e luftës të viteve nëntëdhjetë me rastin e diskutimit të Raportit mbi punën e Gjykatave të vitit 2009 dhe miratimin e propozimit mbi vërtetimin e Konventës Evropiane mbi pandryshueshmërinë e vjetërimit të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, në datën 14 tetor të vitit 2010.⁴⁰⁴

Me rastin e debatit mbi Raportin për punën e gjykatave për vitin 2009 në muajin qershor të vitit 2010, përfaqësuesi me orientim proserb i Partisë Popullore Socialiste opozitare (PPS) Aleksandar Damjanoviçi ka deklaruar se tek gjykimi në lëndët për krimet e luftës dëshiron të shohë „autonominë e plotë dhe pavarësinë e gjykatave” dhe gjykata të cilat janë imune ndaj të gjitha trysnive. Deportimin e refugjatëve boshnjak nga Mali i Zi gjatë konfliktit të armatosur në BdeH e ka quajtur „të ashtuquajturin”, kurse ka porositur se nuk „dëshiron të shohë aktgjykimet gjyqësore për ato të ashtuquajturat krime në funksion të raporteve të ardhshme të do farë komisioneve nga bota e jashtme, që në bazë të aktgjykimeve të tilla dhe aktgjykimeve të pritura do të japin vlerësime të këtilla ose të atilla”.⁴⁰⁵ Ish Ministri i Drejtësisë Mirash Radoviçi ka theksuar se Mali i Zi, “si shoqëri demokratike dhe shtet i përgjegjshëm” është përpjekur që rastet e shkeljes së normave, të cilat i parashihet e drejta humanitare dhe ajo e luftës, e të cilat datojnë nga periudha e konflikteve të luftës në ish-Jugosllavi, të jenë në mënyrë cilësore të proceduara qoftë para gjykatave tona, qoftë para gjykatës së Hagës, me të cilën Mali i Zi bashkëpunon në mënyrë intensive dhe të ngushtë që nga themeli i saj”. Radoviçi ka thënë edhe se institucionet e Malit të Zi e kanë dhënë kontributin e tyre të plotë drejt asaj që „asnjë rast të mos i lihet harresës dhe as arsyetimit si dhe që asnjë kryerës të mos mbetet jashtë fushëveprimit të drejtësisë dhe që asnjë viktimë të mos mbetet pa përkushtim dhe satisfaksion jo vetëm të natyrës morale”.⁴⁰⁶

Me rastin e debatit mbi Projektligjin mbi vërtetimin e Konventës Evropiane për pandryshueshmërinë e vjetërimit të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës janë shtruar çështjet e theksimit të krimit ndaj vetëm një populli si edhe me rastin e debatit mbi pranimin e rezolutës së Parlamentit Evropian mbi Srebrenicën. Deputeti Ervin Spahiç (PSD) ka përkrahur miratimin e këtij Ligji, duke porositur se ai është „parandalim dhe garanci se krimet e luftës nuk do të kalojnë të padënuara, prej cilësdo anë të vijnë ato”.⁴⁰⁷

Sllaven Radunoviç nga Demokracia e Re Serbe (NOVA) ka akuzuar Spahiçin se po iu referohet vetëm „krimeve

401 “Kuvendi kërkon nga Haga shpejtimin e gjykimit të Haradinajt”, faqja e internetit e Radio Evropa e Lirë, 31 maj i vitit 2011. http://www.slobodnaevropa.org/content/skupstina_trazi_od_haga_ubrzanje_procesa_haradnaju/24211131.html.

402 *Po aty*.

403 Në përbërje të re të Parlamentit, të konstituuar pas zgjedhjeve të dhjetorit të vitit 2010, Partia Demokratike e Kosovës e Hashim Thaçit me 34 deputetë e ka shumicën, Lëvizja Vetëvendosje! 12 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës 27 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i ka 11 mandate, kurse Partia Liberale serbe tetë mandate.

404 Transkripti i sesionit të 2-të të seancës së 2-të të rregullt, të datës 14 tetor të vitit 2010, f.75. pjesa e 2-të. http://www.skupstina.me/cms/site_data/SKUPSTINA_CRNE_GORE/AUTORIZOVANI%20FONOGRAFSKI%20ZAPISI%20SA%20SJEDNICA/2-1%20DIO.pdf.

405 Transkripti i sesionit të 8-të të seancës së 1-rë të rregullt, i datës 15 qershor të vitit 2010, f. 187; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=664>.

406 Transkripti i sesionit të 9-të të veçantë të seancës së 1-rë të rregullt të datës 16 qershor të vitit 2010, f. 87; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=663>.

407 Transkripti i sesionit të 2 –të të seancës së 2-të të rregullt të datës 13 tetor të vitit 2010, f. 58-59; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=754>.

ndaj një populli”, „Përse atëherë nuk e keni përmendur Bratuncin? Po flitet për mosvjetrimin”, ka thënë Radunoviçi. E ka pyetur përse nuk i ka përmendur krimet ustashe në Jasenovc, ku ka pasur të vdekur, „shumë më shumë se sa në Srebrenicë”.⁴⁰⁸

Predrag Bulatoviçi (PSP) e ka shtruar pyetjen nëse në institucionet shtetërore ekzistojnë dokumente, të cilat kanë të bëjnë me të ashtuquajturin aksion të deportimit të myslimanëve gjatë muajit maj të vitit 1992, dhe disa prej këtyre dokumenteve a e kanë shenjë publike dhe se a i është drejtuar dikush Prokurorisë ose gjykatës deri tash me kërkesën për dorëzimin e këtyre dokumenteve. Sipas fjalëve të tij, nuk përjashtohet se është e mundur se dikush nga individët ka ndonjë dokument, të cilin Qeveria nuk e ka, dhe i cili është relevant, kurse i ka shenjat përkatëse të konfidencialitetit.⁴⁰⁹ Nënkrjetari i Qeverisë, Svetozar Maroviçi ka vërtetuar se dokumente të caktuara ekzistojnë dhe se disa prej tyre e kanë shenjë e konfidencialitetit, si dhe se ka pasur disa kërkesa nga organet e gjyqësorit, në të cilat është përgjigjur Qeveria.⁴¹⁰ Predrag Bulatoviçi lidhur me këtë ka thënë se publiku i Malit të Zi duhet ta di se Kuvendi e ka hequr shenjë e konfidencialitetit në lidhje me këtë rast. Gjykimi për deportimin ka të bëjë edhe me Malin e Zi, e jo vetëm me të akuzuarit, sepse, mendon ai, është „fjala për funksionarët e lartë policor, prej të cilëve disa deri në vitin 2004 kanë qenë, madje, në funksione të rëndësishme shtetërore, parlamentare, federale”.⁴¹¹

Gjatë vitit 2011, në Kuvendin e Malit të Zi, prapë, më së shumti fjalë mbi krimet e luftës ka pasur pas paraqitjes së raporteve vjetore mbi punën e gjykatave dhe të prokurorive, kurse në debate, krahas deputetëve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e gjyqësorit. Disa deputetë të veçantë të opozitës e kanë kritikuar punën e gjykatave dhe të prokurorive, kurse ka mundur të dëgjohet edhe gjykimi i ngritjes së përmendores për viktimat civile serbe të luftës në ish Jugosllavi në parkun podgoricas Pobrezhje. Deputetët dhe ministrat nga radhët e Partisë Demokratike Socialiste (PDS) në pushtet e kanë theksuar rolin pozitiv të Malit të Zi në ngjarjet e luftës dhe në procesin e ballafaqimit me të kaluarën.

Me rastin e debatit mbi Raportin e Prokurorit Suprem Shtetëror të Malit të Zi mbi punën e prokurorisë publike për vitin 2010, Suljo Mustafiçi (Partia Boshnjake) është interesuar për angazhimin e Prokurorisë në mbledhjen e provave për fillimin e procedurave gjyqësore në rastin e krimeve të luftës. Ka qenë fjala për aktgjykimet me të cilat lirohen nga përgjegjësia penale të akuzuarit në rastin e deportimit të refugjatëve boshnjak në Gjykatën e Lartë në Podgoricë. Mustafiçi ka theksuar se këto aktgjykime, me të cilat lirohen nga përgjegjësia të akuzuarit, „në mënyrë serioze i sjellin në pyetje rezultatet e punës dhe të kredibilitetit të Prokurorisë sonë”. Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, në bazë të provave të Prokurorisë, e sheh si një epilog, „të një procesi farsik”, gjatë të cilit nuk janë mbledhur mjaft dëshmi. Sipas fjalëve të tij, Prokuroria nuk i ka mbledhur në mënyrë të mirë provat mbi deportimin, të cilat i ka karakterizuar si „gjueti në njerëz dhe dërgim në humbëtitir” dhe ka theksuar se është e nevojshme të trajtohet edhe çështja e përgjegjësive komanduese dhe politike.⁴¹²

Gjatë diskutimit mbi Raportin Vjetor për punën e gjykatave gjatë vitit 2010, Ervin Spahiçi (PDS) ka theksuar se vendimet gjyqësore në çështjen e deportimit të myslimanëve, „vërtet janë të bazuara mbi të pavërteta, mbi pasaktësi, madje edhe gënjeshtër”.⁴¹³

Çështja e hetimeve mbi rrëmbimin e udhëtarit nga treni në linjën Beograd – Tivar në vitin 1993 në stacionin e Shtërpçës prapë është hapur gjatë vitit 2011. Koça Pavlloviçi nga Lëvizja për Ndryshme (LPN) ka shtruar çështjen nëse policia malaziasë dhe Prokuroria e kanë vënë pikën në hulumtimin e krimit në Shtërpçe dhe nëse përmën-

408 *Po aty*, f. 60.

409 Transkript i sesionit të 3-të të të seancës së 2-të rregullt të datës 27 tetor të vitit 2010, f. 23-24; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=784>.

410 *Po aty*, f. 24-25.

411 *Po aty*, f. 25-26.

412 Transkript i sesionit të 9-të të seancës së 1-rë të rregullt të datës 23 qershor të vitit 2011, f. 14; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=1110>.

413 *Po aty*, f. 67.

dorja, të cilën kryeministri Lukshiq e ka zbuluar në datën 11 korrik të vitit 2011 në parkun në Pobrezhje në Podgoricë, në të njëjtën kohë është edhe përmendore për ata që para 20 vitesh janë rrëmbyer në Shtërpce.⁴¹⁴ Pavloviqi ka theksuar se klubit parlamentar të Lëvizjes për Ndryshime i është drejtuar komiteti malazias i juristëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili deputetët e LPN-së i ka informuar mbi përpjekjen afatgjatë të familjeve të të kidnapuarve në Shtërpce që diku të ndërtohet ndonjë memorial. „Ata nuk janë të kënaqur me këtë përmendoren e përbashkët në Pobrezhje”, ka thënë Pavloviqi dhe ka shtuar se, „përmendorja e cila flet për krimin duhet që në vete të ketë të shkruar emrin e krimit, për cilin krim aty është fjala”. Ai ka shprehur mendimin që përmendorja në Pobrezhje, „të bëhet antipërmendore, sepse përmendorja duhet t’ua dëshmojë fëmijëve tanë atë se krimi nuk është diçka që ia vlen, e nuk ia vlen nëse kriminelët njihen qartazi dhe dënohen.”⁴¹⁵

Obrad Stanishiqi nga PDS e ka kritikuar ashpër qëndrimin e Pavloviqit duke deklaruar se me këtë, „ka fyer jo vetëm ata, për të cilët është ngritur përmendorja, por edhe familjet e tyre dhe qytetarët e Malit të Zi.”⁴¹⁶

4.6. Maqedonia

Dy partitë politike më të mëdha maqedonase, Vnatrešna makedonska revolucionerna organizacija - Demokratska partija za makedonsko nacionalno edinstvo (VMRO-DPMNE) i Socijaldemokratski sojuz na Makedonija (SDSM), kanë pasur qëndrime skajshmërisht kundërshtuese lidhur me vendimin e kuvendit maqedonas mbi “interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë “. VMRO-DPMNE fuqishëm e ka përkrahur procesin e amnistisë së lëndëve të cilat sipas rregullës 11 bis të Statutit të GJNPJ-së janë të caktuara për gjyqësorin vendas, duke e konsideruar parakusht pozitiv për procesin e pajtimit në Maqedoni.⁴¹⁷ SDSM, duke qenë parti opozitare, i është kundërvënë atij duke konsideruar se amnistia është plotësisht e papranueshme dhe se me këtë kryerësit marrin shpërblim në vend se dënimet.⁴¹⁸

Vetëm disa orë para se të jetë miratuar propozimi ligjor, i cili do të mundësojë zbatimin e gjerë të amnistisë, një nga deputetët e SDSM-së, Andrej Petrov ka deklaruar se kjo është rrezikim i shtetit të së drejtës në Maqedoni, dhe se kjo do të lë gjurmë të pashlyeshme në historinë maqedonase.⁴¹⁹

Debatet parlamentare mbi krimet e luftës të kryera në Maqedoni janë intensifikuar pas miratimit të Ligjit mbi Amnistinë në muajin korrik të vitit 2011, dhe përfaqësuesit e opozitës në to e kanë kritikuar amnistinë e krimeve të luftës.

Deputetët e SDSM-së, Vesna Bendevska dhe Marjanço Nikolov i kanë shprehur qëndrimet se është në pyetje marrëveshja politike midis Nikolae Gruevskit (kryeministër i Maqedonisë dhe lider i VMRO-DPMNE) dhe Ali Ahmetit (lider i Bashkimit Demokratik për Integrim - [BDI], partisë udhëheqëse shqiptare)⁴²⁰, derisa Nikollovi ka shkruar një hap më larg dhe ka thënë se me këtë marrëveshje janë të suspenduara institucionet e Republikës së Maqedonisë, kurse politika dhe pushteti janë vënë para gjyqësorit⁴²¹. Jani Makraduli, po ashtu nga SDSM-ja, e ka akuzuar Qeverinë se me mendimin e saj pozitiv mbi amnistinë (të cilës i ka paraprirë votimi në parlament) e kanë shkelur të drejtën dhe i kanë amnistuar ata të cilët janë përgjegjës për kidnapimin dhe vrasjes e qytetarëve maqedonas në vitin 2001.⁴²²

414 Transkripti i sesionit të 12-të të veçantë të seancës së 1-rë të rregullt të datës 26 korrik të vitit 2011 f. 41; <http://www.skupstina.me/index.php?strana=sjednice&tipS=0&sjednicaid=1160>

415 *Po aty*, f. 42.

416 *Po aty*, f. 43.

417 Të shikohet kapitulli i parë i këtij Raporti, ku është arsyetuar procesi i amnistisë dhe i specifikave të të ashtuquajturave lëndë të Hagës.

418 Intervistë me Daneta Taleski, analist politik, në datën 27 dhjetor të vitit 2011.

419 Shënime stenografike të sesionit të 4 të Kuvendit të R. të Maqedonisë, të datës 19 korrik të vitit 2011, f. 9.

420 Shënime stenografike të sesionit të 8 të Kuvendit të R. të Maqedonisë, të datës 29 korrik të vitit 2011, f. 8.

421 Shënime stenografike të sesionit të 12 të Kuvendit të R. të Maqedonisë, të datës 15 tetor të vitit 2011, f.30.

422 Shënime stenografike të sesionit të 15 të Kuvendit të R. të Maqedonisë, të datës 25 nëntor të vitit 2011, f. 2.

Deputetët shqiptar, posaçërisht nga BDI-ja, partneri i koalicionit me VMRO-DPMNE-në në pushtet, kanë qenë aktiv në përpjekjet për të arsyetuar se përse ka qenë e domosdoshme amnistia e rasteve të hedhura gjyqësorit maqedonas nga GJNPJ. Suzana Saliu (BDI) madje ka pohuar se “Gjykata e Hagës e ka kryer punën e saj, ka vlerësuar se në dosjet të cilat ua kemi dërguar nuk ka elemente për ndjekje për vepra të rënda kundër njerëzimit dhe ka sjellë vendimin, i cili është i njohur në opinionin publik vendor dhe ndërkombëtar.”⁴²³

4.7. Sllovenia

Në vitin 2010 dhe 2011 në parlamentin slloven nuk janë zhvilluar debate posaçërisht të kushtuara ngjarjeve nga periudha e konfliktit të armatosur në Slloveni.

Në vend të kësaj, tema mbi të cilën parlamenti slloven në të kaluarën ka diskutuar shpesh ka qenë qëndrimi ndaj „personave të fshirë“. Në fund të vitit 2008, pasi që është publikuar informacioni se kryetari i komisionit për politikë të jashtme i parlamentit slloven Ivo Vajgl në Beograd ka deklaruar se „personat e fshirë“ do të marrin dokumentet dhe do të kompensohen, në atë kohë Partia Demokratike opozitare Sllovene (PDS) deklarimin e Vajglit e ka quajtur një përpjekje „për rritjen e numrit të votuesve të së majtës tranzitore, në dëm të tatimpaguesve“. Kjo ka qenë shkas për një seancë të re të jashtëzakonshme parlamentare, gjatë të cilës partitë politike opozitare prapë ashpër e kanë sulmuar çfarëdo përmirësimi të padrejtësisë të bërë kategorisë së „personave të fshirë“.⁴²⁴

Deputetët e partive të krahut të djathtë në krye me Partinë Demokratike Sllovene (PDS), i janë kundërvënë edhe të dhënës së re mbi numrin e personave të fshirë, të cilin e ka pohuar Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2009. Deputetët e këtyre partive kanë qenë të bindur se numri i vërtetë i personave të fshirë është, madje, më i vogël se sa ai prej 18.305 personave, ose e pakta rreth këtij numri, në vend të të dhënës së re mbi 25.671 persona. Në vitin 2011 këto parti kanë përsëritur argumente të ngjashme dhe e kanë thirrur në përgjegjësi ministren e punëve të brendshme, Katarinu Kresal për shkak të gjoja numrit gabimisht të vërtetuar dhe të rritur të “personave të fshirë”. Megjithatë, komisioni parlamentar, i cili është marrë me çështjen e personave të fshirë, me shumicë votash të anëtarëve të koalicionit qeverisës, ka pohuar rritjen e numrit të personave të fshirë.

Krahas kësaj, shpesh ka qenë temë edhe çështja e kompensimit të “personave të fshirë”, posaçërisht në dritën e të pritmes së aktgjykimit para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili është zhvilluar në rastin e disa qytetarëve “persona të fshirë” kundër Sllovenisë. Kështu, për shembull, Marijan Pojbiç (PDS) ka bërë vërejtje ndaj deputetëve të koalicionit në pushtet se „në këtë mandat ia kanë dalë që në afatin e dytë ta ngarkojnë shtetin slloven me kompensimet për personat e fshirë“, derisa deputeti i Partisë Nacionaliste Sllovene (PNS) Sreçko Priatelj ka protestuar që parlamenti në përgjithësi të merret me „personat e fshirë, ciganët dhe homoseksualët“.⁴²⁵

5. Mediat dhe raportimi mbi krimet e luftës

5.1. Bosnja dhe Hercegovina

Kur janë në pyetje temat në lidhje me krimet e luftës në media ende është e pranishme “gazetaria patriotike”, përkatësisht dominimi i ideologjisë nacionaliste.⁴²⁶ Mënyra e tillë e punës së mediave nuk ka ndryshuar që nga koha e konfliktit të luftës.

Ekzistojnë dallime drastike në raportimin në varësi nga selia e shtëpisë mediale. Në Analizën e raportimit të

423 Shënime stenografike të sesionit të 4 të Kuvendit të R. të Maqedonisë, të datës 19 korrik të vitit 2011f. 11.

424 Kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Sllovenisë, faqja e internetit e Partisë Demokratike të Sllovenisë: www.sds.si/media/sklic.izredne.seje.dz-vajglova.izjava.doc.

425 Manjnetogram i seancës 14 të parlamentit slloven, i datës 2 mars të vitit 2010, faqja e internetit e kuvendit slloven: <http://www.dz-rs.si/wps/portal/Home/deloDZ/seje/evidenca?mandat=V&type=mag&uid=D76129EBCBD177D8C12576DA0032162B>.

426 „Mediat dhe ideologjitë kombëtare: Analizë e raportimit mbi gjykimet për krimet e luftës, Qendra e mediave“, Sarajevë, 2011, http://www.media.ba/mcsonline/files/shared/MEDIJI_I_NACIONALNE_IDEOLOGIJE_-_za_web__2_.pdf, f. 10.

mediave mbi gjykimet për krime të luftës: *Mediat dhe ideologjitë nacionale* në botim të Qendrës së mediave (Mediacentra) të Sarajevës të vitit 2011, është analizuar raportimi i mediave në BdheH mbi burgosjen e Radovan Karaxhiqit në muajin korrik të vitit 2008. Mbi burgosjen e Karaxhiqit më së shumti kanë raportuar mediat nga Sarajeva, të cilat në përqindje kanë pasur numrin më të madh të artikujve, më së shumti njoftime në faqen e parë dhe përqindje të lartë të teksteve me fotografi, derisa në mediat e shtypura nga Banja Luka të gjithë këta tregues kanë qenë dukshëm më të ulët se sa në ato sarajevase. Në mediat kroate të Mostarit, kjo temë ka qenë më së paku e përfaqësuar. Po ashtu, dallimet në raportimin e mjeteve përputhen edhe me dallimet në qëndrimet etnonacionale të elitave politike në BdheH. Gazetat sarajevase kanë theksuar rolin e Karaxhiqit në krimet e luftës, kurse gazetetat banjallukase këtë e kanë bërë më rrallë. Gazeta ditore nga Mostari, krahas një numri të vogël të interpretimeve negative, ka pasur kryesisht qëndrim neutral.

Publikimi i „Gatishmëria për pajtim në BdheH” po ashtu është marrë me raportimin e mediave mbi rastin Karaxhiq, ku analizohet se sa vëmendje i kanë kushtuar mediat fillimit të gjyimit të Karaxhiqit dhe ku vihet në spikamë qasja e ndryshme dhe mënyra e raportimit në varësi nga selia e mediave në BdheH, përkatësisht në varësi nga ajo se cilës pjesë të publikut në BdheH i drejtohet.⁴²⁷ Sipas gjetjeve të tyre, në mediat sarajevase ka prirë gazetarja e gazetës Dnevni Avaz, Almasa Haxhiq, autorja e 14 publikimeve në lidhje me gjykimin e Karaxhiqit, të cilin më së shpeshti e ka quajtur ’të eturin për gjak të Paljes’.⁴²⁸ Në gazetën ditore mostarase nuk janë botuar komente, por raportime me rastin e fjalës hyrëse të Prokurorisë GJPNJ dhe të hetimit të dëshmitarëve. Press-i banjallukas, nga ana tjetër, i është shmangur të cekurit të krimeve për të cilat ngarkohet Karaxhiqi. Për këtë është shkruar vetëm në një prej tri njoftimeve.⁴²⁹

Kur është fjala për raportimin e luftës dhe rolin negativ të cilin gjatë konflikteve të luftës e kanë luajtur mediat, në BdheH nuk ka pasur sanksione të institucionalizuara. Për nxitje të luftës në nivel të BdheH nuk janë ngritur aktakuza për shtëpi të veçanta të mediave dhe as për gazetarë.

5.2. Kroacia

Gazetaria hulumtuese në temën e krimeve të luftës në Kroaci është e prapambetur dhe të rralla janë rastet kur botohen tekste serioze në këtë temë.⁴³⁰ Heshjta mediale kryesisht ndërpritet në rastin e arrestimit, paraburgimit ose gjykimet.⁴³¹ Pas teksteve të rralla në të cilat transmetohen fakte mbi krimet e luftës, kërcënimet, të cilat iu bëhen gazetarëve, janë shumë të shpeshta, e posaçërisht kur janë në pyetje temat të cilat i ndërldhin politikanët me krimet e luftës.⁴³²

Në muajin korrik të vitit 2011 të *Aktuales* është botuar lajmi se gjenerali i arrestuar Milladen Kruljac ka pranuar se zëvendësi i kryeshefit të Shtabit Qendror të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, Sllavko Bariq në vitin 2010 ka kërkuar ndihmë për likuidimin e gazetarit Drago Hedl. Drago Hedl këtë informatë e ka kuptuar qysh në muajin qershor të vitit 2010 dhe dyshon se ka lidhje me shkrimet e Hedlit mbi rolin e gjeneralit Bariq në Luftën atdhetare (rasti i *Fshatrave të Pozheshkit*) dhe mbi statusin e mundshëm të invalidit të luftës.⁴³³

427 Srgjan Puhalo, Nebojsa Petroviq, Neda Perishiq, *Gatishmëria për pajtim në Bosnjë e Hercegovinë* (Fridrich Ebert Stiftung, Sarajevë, 2010).

428 *Po aty*, f. 130.

429 *Po aty*, f. 131.

430 Intervistë me gazetaren e Jutarnji list, Slavica Lukiq dhe gazetaren Radio televizionit kroat Sasha Kosanoviq, muaji dhjetor i vitit 2011.

431 Slavica Lukiq ka shkruar mbi krimet e Merçepit vetëm kur është arrestuar ai dhe kur prapë është ngritur aktakuzë kundër tij. Mbi krimet në Sisak po ashtu ka shkruar vetëm kur është ngritur aktakuza, kurse për përgjegjësinë eventuale të Vladimir Sheksit pas raporteve të publikuara nga ana e Amnesty International.

432 Intervistë me Slavica Lukiqin; kësaj gezatारेje i janë dërguar një varg letrash me tituj „Çetnikja Slavica Lukiq” ose „SERBOMADHJA Slavica Lukiq”.

433 “Hedl: Gjeneral Slavko Bariqi më ka kërcënuar se do të më likuido! Bariqi: Do t’i padis shpifësit”, 12 korrik i vitit 2011, faqja e internetit të *Novi List*, <http://www.novilist.hr/Vijesti/Crna-kronika/Hedl-General-Slavko-Baric-prijetio-je-da-ce-me-likvidirati!-Baric-Tuzit-cu-klevetnike>.

Nënkryetari i parlamentit kroat, Vladimir Sheksi, në muajin janar të vitit 2011 në një intervistë për gazetën kroate, gazetarët dhe redaktorët i ka quajtur „nëntokë politike“, prej të cilëve „një pjesë e tyre nuk kanë shprehur (...) duke bërë vërejtje, në thelb, qëndrime kundërkroate“, dhe se disa „bashkëpunojnë“ me Amnesty International dhe me Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut, me Sava Shtrbcin dhe Veritasin, dhe gazetarët i ka quajtur „vrasës medial dhe pirana“.⁴³⁴ Sheksi, po ashtu, në gusht të vitit 2011 ua ka dërguar redaktorëve të mediave një letër në të cilën thotë se në Kroaci shkelen të drejtat themelore mbi raportimin objektiv dhe të paanshëm, dhe se botohen artikuj të cilët kanë „dykuptimësi ideologjike“, dhe se „gazetarët dhe redaktorët – trilluesit vazhdojnë punën e tyre të ndyrë“. Në letër i drejtohet shoqatës së gazetarëve kroat që të reagojë dhe e ka akuzuar atë se nuk po e përmbush detyrën e vet të rëndësishme që hapësirën e mediave, sa të jetë e mundur më shumë, ta ruajnë nga kontaminimi me gënjeshtër, shpifje, politikanizëm dhe gazetari „joprofesionale“.⁴³⁵

Disa gazetarë e kanë përgatitur dhe e kanë botuar publikimin „Libri i bardhë - Kronika e kërcënimeve dhe e sulmeve ndaj gazetarëve në vitet 1990 – 2011.“, që përfaqëson një pasqyrë të veçantë të 70 rasteve të kërcënimit me vdekje, të frikësimit sistematik dhe të sulmeve fizike në gazetarët, fotoreporterët dhe kinematografët kroat gjatë periudhës së cekur.⁴³⁶ Nga ky numër, 12 janë raste të sulmeve ose të trysnive mbi gazetarët dhe redaktorët të cilët kanë shkruar ose kanë raportuar mbi problematikën e krimeve të luftës dhe drejtësinë tranzicionale.⁴³⁷ Në këtë libër janë të dokumentuar sulmet në Drago Hedlin, të cilat kanë zgjatur prej vitit 1992 deri në vitin 2009. Sulmet kanë qenë të lidhura me raportimin e tij mbi *rastin Gllavash* dhe krimet në zonën e Osijekut me rrethinë. Kështu, nga Branimir Gllavashi, qysh nga viti 1992, përmes deputetit parlamentar Ivan Vrkića, ka marrë kërcënime me vdekje. Gllavashi e ka porositur Hedlin se do ta shndërron në „pluhur e hi“ nëse nuk pushon së shkruari mbi krimet e cekura. Sipas mendimit të shumë gazetarëve, pothuajse nuk ekziston mundësia për lustracion të këtyre gazetarëve të cilët kanë përhapur një propagandë të luftës të llojit të vet dhe gjuhën e urrejtjes në Kroaci gjatë viteve nëntëdhjetë. Përndryshe, mbizotëron konsensusi përgjithësisht i pranuar se ata gazetarë dhe raportues kanë punuar shumë mirë dhe se roli i tyre ka qenë moralisht i arsyetuar.⁴³⁸

Aktgjykimi për gjeneralët kroat Gotovina, Markaçi dhe Çermaku, i shqiptuar në datën 15 prill të vitit 2011, e ka marrë një pjesë të mirë të hapësirës së mediave të atyre ditëve.⁴³⁹ Mediat kryesisht kanë raportuar mbi aktgjykimin në mënyrë jo objektive, duke e bindur opinionin sesi aktgjykimi i këtyre do të thotë kriminalizim i gjithmbarshëm i pjesëmarrjes së trupave kroate në luftën e viteve 1991 – 1995. Shembull i qartë i kësaj janë titujt e gazetës *Večernji list* të datës 15 dhe 16 prill ku në të parën është botuar portreti i stilizuar i Gotovinės para trengjyreshit kroat me mbishkrimin „Hero“, kurse në të dytën në krye të faqes është shkruar „Dje e kemi shpallur se si Ante Gotovina është hero. Edhe sot mendojmë ashtu“.

434 Kjo intervistë dhe aksionet, të cilat kanë pasuar, kanë rezultuar si përgjigje e autoriteteve kroate nga ndaj Amnesty International dhe Nismës së të Rinjëve për të drejtat e njeriut, në lidhje me procesimin e Vladimir Sheksit për shkak të përgjegjësisë së tij potenciale për krime të caktuara të luftës. Pos që gazetarët e kanë publikuar këtë lajm, ata, pastaj, edhe kanë shkruar edhe tekste të cilat kanë shtruar pyetje lidhur me përgjegjësinë eventuale të Vladimir Sheksit.

435 Hulumtuesi nga Kroacia i ka hedhur një vështrim korrespondencave të Vladimir Sheksit me redaksitë e mediave kroate. Letra i është dërguar mediave në muajin gusht të vitit 2011.

436 Redaktorja e „Librit të bardhë“ Renata Ivanović ka cekur se „nga 70 rastet e cekura, janë paraqitur 50, kurse janë zgjidhur 11, por jo edhe të gjitha në mënyrë pozitive për gazetarët. Gjashtë prej tyre janë në procedurë, kurse në 28 raste nuk janë zbuluar kryerësit. Raste, në tërësi, në të vërtetë ka edhe më shumë, 105, por nja tridhjetë prej tyre nuk janë përpunuar, sepse disa kolegë e kanë lënë gazetarin, kurse disa të tjerë nuk kanë dashur të bashkëpunojnë, ngaqë konsiderojnë se sulmet në ta janë pjesë përbërëse e profesionit të tyre“. „Libri i bardhë - Kronika e kërcënimeve dhe e sulmeve në gazetarët në vitet 1990. – 2011.“, Zagreb, 2011.

437 Që e përbënë përafërsisht 17 % nga numri i përgjithshëm i sulmeve dhe i trysnive.

438 Intervistë me gazetaren e gazetës *Jutarnji list*, Slavica Lukić dhe gazetarin e Radio televizionit kroat, Sasha Kosanovićin në muajin dhjetor të vitit 2011.

439 Sipas hulumtimeve lidhur me raportimin e televizionit publik mbi aktgjykimin e GJNPJ në lëndën Gotovina dhe të tjerët, që i ka bërë Documenta, ditari i parë qendror i RTK-së pas aktgjykimin, në datën 15 prill të vitit 2011, ka zgjatur 41,07 minuta dhe plotësisht i është kushtuar temës së aktgjykimin të gjeneralëve. Hulumtimi mbi përmbajtjen e emisionit qendror informativ publik – „Ditari“ pas aktgjykimin për gjeneralët Gotovina, Markaçi dhe Çermaku i datës 15 prill deri në datën 30 prill të vitit 2011, faqja e internetit e Documenta, http://www.documenta.hr/documenta/attachments/460_istravanje%20sadrzaja%20Dnevnika%20javne%20televizije%2015%2004%20-%2030%2004%202011.pdf.

Në raportimin e Radiotelevizionit kroat (RTK) ka mbizotëruar reagimi i qytetarëve, i veteranëve të luftës, bashkëluftëtarëve, anëtarëve të ekipeve të mbrojtësve të akuzuarve, të anëtarëve të familjeve dhe të miqve personal të akuzuarve, politikanëve dhe personave publik të cilët plotësisht e kanë shprehur qëndrimin e protestës, tërbimit dhe të vuajtjes ndaj aktgjykimit të këtyllë. Pothuajse në tërësi kanë munguar deklaratat e viktimave dhe të atyre që do të përfaqësonin qëndrimet e tyre. Aktgjykimi disa herë është quajtur drakonik dhe i padrejtë nga gazetarët dhe raportuesit. Shumica dërmuese e tyre ka konstatuar se ai është aktgjykim për luftën çlirimtare dhe Republikën e Kroacisë si të tillë. Reporterët kanë thënë të pavërteta të qarta dhe kanë qenë posaçërisht të anshëm.⁴⁴⁰ Janë botuar një numër i madh artikujsh nga e gjithë Kroacia mbi qytetarët e tmerruar nga aktgjykimi. Në një deklaratë, një qytetar i anketuar në u Pakoshtani ka deklaruar: „Për çka kemi luftuar, për ta (një zë nga anash: “të gjithë duhet të dëbohen, edhe më shumë “), kurse ata janë të mbrojtur si arinjtë e Likës. Ne nuk guxojmë ta themi një fjalë, kurse shiheni ju se çfarë po bëjnë me njerëzit tanë”.⁴⁴¹

Organizata Documenta ka analizuar përmbajtjen e 16 Ditarëve qendrorë të RTK nga data 15 deri në datën 30 prill të vitit 2011 dhe ka konstatuar se Ditari qendror i mbrëmjes në ditën e shqiptimit të aktgjykimit plotësisht i është kushtuar aktgjykimit të gjeneralëve kroat, derisa të nesërmen në atë temë janë shpenzuar 72 për qind e kohës e emisioneve më të rëndësishme informative në vend. Në ditarin e parë të përgatitur të datë 15 prill, vetëm tre persona (që të tretë në Beograd) e kanë shprehur qëndrimin të kundërt me të tjerët, përkatësisht nuk janë pështritur nga aktgjykimi. Në të gjithë Ditarët e përgatitur, nga gjithsejtë 184 bartës të porosive, vetëm tre kanë qenë pjesëtarë të viktimave dhe të shoqatave të viktimave.

5.3. Serbia

SHPGS, në datën 8 korrik të vitit 2009 ka ngritur aktakuzë kundër NN personave (personave përgjegjës dhe gazetarëve në Radio-televizionin e Beogradit, Radio-televizionin e Novi Sadit, gazetave ditore Politika, Večernje novosti dhe të tjera) për shkak të veprës penale të organizimit dhe të nxitjes për kryerje të gjenocidit dhe të krimeve të luftës nga neni 145 i Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë. Në arsyetim të aktakuzës thuhet se në media, me gjuhën e urrejtjes dhe të përhapjes së informatave të rrejshme janë bërë përgatitjet politiko-propagandistike me qëllim të krijimit të besimit mbi arsyeshmërinë e konfliktit të armatosur dhe, në kuadër të tij, të shkeljes së vrazhdë të normave të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilat kanë pasur efekt të fuqishëm dhe ndikim në opinionin e gjerë, posaçërisht në pjesëtarët e formacioneve paramilitare të cilat janë sjellë në mënyrë hakmarrëse në konflikte. Manipulimet e tilla të vetëdijshme të mediave “edhe subjektivisht e edhe objektivisht paraqesin veprime të thirrjes dhe të nxitjes për krime të luftës, me çka është kryer veprë penale e organizimit dhe e nxitjes së kryerjes së gjenocidit dhe të krimeve të luftës nga neni 145 i LP RFJ-së”.⁴⁴²

Në muajin dhjetor të vitit 2011, Prokuroria për Krime të Luftës e Serbisë e ka promovuar publikimin “Fjalët dhe të veprat e këqija: thirrja ose nxitja për krime të luftës në mediat në Serbi në vitet 1991-1992”, në të cilin është sjellë materiali i mbledhur në fazën paraprake të procedurës në lëndën *Mediat*. Prokuroria këtë e ka arsyetuar me nevojën që opinionin profesional dhe ai i ekspertëve të përfshihet në kërkimin e përgjigjeve në dilemat e shumta të cilat i ka gjyqësori serb në lidhje me përgjegjësinë penale të mediave.⁴⁴³ Përfaqësuesit e Prokurorisë për krime të luftës kanë theksuar se përgjegjësia e mediave për krime të luftës duhet të hulumtohet deri në fund, megjithëse Prokuroria për këtë ende nuk ka qëndrim të përkufizuar, por edhe se nuk do të paralajmëroj asnjë procedurë gjyqësore.⁴⁴⁴

440 Hulumtimi mbi përmbajtjen e emisionit qendror informativ të televizionit publik – „Ditarit“ pas aktgjykimit ndaj gjeneralëve Gotovina, Markaçi dhe Çermaku prej datës 15 prill deri në datën 30 prill të vitit 2011, faqja internetit e Documenta, http://www.documenta.hr/attachments/460_Istrazivanje%20sadrzaja%20Dnevnik%20javne%20televizije%2015%2004%20-%2030%2004%202011.pdf.

441 *Po aty*, f. 8.

442 Padia penale e SHPGS është publikuar në “Fjalët dhe veprat e këqija: thirrje ose nxitje për krimet e luftës në media në Serbi 1991-1992”, Qendra për procese tranzicionale, Beograd, 2011, f. 384.

443 *Po aty*, f. 13.

444 “Roli i mediave në krimet e luftës duhet të hulumtohet”, *Politika*, 3.12.2012.

Një nga mediat, roli i të cilave është përmendur në kallëzimin penal të SHPGS, Radio-televizioni i Serbisë, iu ka kërkuar falje në datën 18 prill të vitit 2011 “atyre qytetarëve të Serbisë dhe atyre qytetarëve të vendeve fqinje që kanë qenë subjekt i fyerjeve, shpifjeve dhe përmbytjeve të cilat do t’i përgjigjeshin përcaktimit të sotëm juridik të gjuhës së urrejtjes, e të cilat janë të transmetuara në programet e Radio-televizionit të Beogradit dhe RTS gjatë viteve nëntëdhjetë”.⁴⁴⁵

5.4. Kosova

Human Rights Watch ka dokumentuar kërcënimet ndaj Vehbi Kajtazit, gazetarit të gazetës së përditshme Koha Ditore, të cilat në muajin shkurt të vitit 2010 ia ka drejtuar Sabit Geci, ish anëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kërcënimet ndaj Kajtazit kanë pasuar pas tekstit në të cilin ai kritikon amnistinë e një grupi të burgosurish, midis të cilëve ka qenë edhe djali i Gecit, Albani. Anëtarët e policisë kosovare e kanë dekurajuar Kajtazin kur ka provuar për të ngritur ankesë ndaj Gecit.⁴⁴⁶ Sipas fjalëve të Kajtazit, raportimi nga gjykimi për krime të luftës nuk është problem, por hulumtimi i krime të luftës është jashtëzakonisht i vështirësuar, kurse të gjithë gazetarët, „të cilët shkruajnë mbi krimet luftës që i ka kryer UÇK –ja rrezikojnë që të shpallen për tradhtarë”.⁴⁴⁷

5.5. Mali i Zi

Qendra për Edukim Qytetar (QEQ) nga Podgorica ka thirrur në datën 2 qershor të vitit 2009 prokurorinë supreme shtetërore që t’i përkushtohet çështjes së „përgjegjësisë së gazetarëve të cilët gjatë të nëntëdhjetave të luftës me zell e kanë promovuar gjuhën e urrejtjes e cila ka pasur ndikim të rëndësishëm në formën dhe angazhimin e Malit të Zi në ngjarjet e luftës në atë periudhë të ish RSFJ-së”.⁴⁴⁸ Kryetarja e Gjykatës Supreme të Malit të Zi, Vesna Medenica menjëherë ka deklaruar se edhe gazetarët duhet të përgjigjen nëse i kanë nxitur ngjarjet e luftës në hapësirën e ish Jugosllavisë.⁴⁴⁹ Deri në fund të vitit 2011 Prokuroria Supreme Shtetërore ende nuk ka ngritur hetime lidhur me përgjegjësinë e gazetarëve.⁴⁵⁰

5.6. Maqedonia

Në Maqedoni nuk ekziston ndonjë rast i cili gazetarët i vë në lidhje me nxitjen e urrejtjes mbi baza etnike dhe/ose në lidhje me mohimin e krimeve të luftës.⁴⁵¹ Tekstet në lidhje me krimet e luftës dhe konfliktin në Maqedoni janë shumë të rralla, kurse kur ka raportime lidhur me këtë temë, mediat gjithmonë i vendosin në kontekst të interesave politike.⁴⁵² Vërehet një rritje e lehtë e interesimit të mediave për krimet e luftës në gjysmën e dytë të vitit 2011, në lidhje me interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë, me të cilin janë ndërprerë të gjitha veprimet gjyqësore dhe hetimore të lidhura me krimet e luftës.

5.7. Sllovenia

Megjithëse mediat e kanë hapur çështjen lidhur me disa ngjarje nga konflikti i armatosur në Slloveni në vitin 1991, ato deri më sot nuk janë hulumtuar e as nuk janë procesuar. Në atë kategori hyjnë incidenti në kalimin

445 Deklarata Programore e Bordit Drejtues RTS, 23 maj i vitit 2011, faqja e internetit e Radio televizionit të Serbisë, <http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2011/05/23/1379756/Programska%20izjava%20UO%20RTS.pdf>.

446 Human Rights Watch World Report 2011, Country Report Kosovo, faqja e internetit e Human Rights Watch, <http://www.hrw.org/en/world-report-2011/serbia#kosovo>.

447 Komunikim me email me Vehbi Kajtazin, gazetarin e gazetës *Koha Ditore*, i datës 1 shkurt të vitit 2012.

448 „Të formohet komisioni për hulumtimin e rolit të gazetarëve”, komunikatë e Qendrës për arsimim qytetar, faqja e internetit të QAQ, 12 qershor i vitit 2009. <http://cgo-cce.org/saopstenja/CGO%20Oformiti%20komisiju%20za%20ispitivanje%20uloge%20novinara%2012062009.pdf>.

449 „Medenica: Janë zgjidhur 70 për qind e të gjitha lëndëve”, faqja e internetit *Pobjeda*, 15 korrik i vitit 2009; <http://www.pobjeda.me/arkhiva/?datum=2009-07-15&id=167652>.

450 Përgjigje me email e Mirela Rebronjës, koordinatores së programit të QAQ, 10 janar i vitit 2011.

451 Intervistë me Katerina Neshkovin, gazetaren e Nova Makedonija, e datës 13 dhjetor të vitit 2011.

452 Intervistë me Katerina Neshkovin, gazetaren e Nova Makedonija, e datës 20 shkurt të vitit 2012.

kufitar Holmec dhe *rasti Shkofije*, mbi të cilat mediat kanë shkruar si për shkelje të mundshme të së drejtës humanitare.⁴⁵³

IV. Vërtetimi i fakteve dhe tregimi i së vërtetës

1. Rezyme

Gjatë viteve 2010-2011, në rajon nuk është paraqitur asnjë nismë zyrtare e rëndësishme për formimin e komisionit shtetëror (kombëtar) të së vërtetës.

Në BdheH në këtë periudhë, Grupi i ekspertëve për përpilimin e strategjisë së drejtësisë tranzicionale në BdheH e ka zhvilluar procesin konsultativ, ku është debatuar mbi modelin dhe propozimet për krijimin e një trupi jashtëgjyqësor për vërtetimin e fakteve dhe tregimin e së vërtetës në nivelin nacional. Përkundër aktgjykimeve gjyqësore të shumta, një pjesë e qytetarëve të BdheH edhe më tutje konsideron se faktet relevante mbi konfliktin e armatosur ende nuk janë vërtetuar. Pas Marrëveshje së Paqes të Dejtonit, në BdheH është realizuar një numër i madh i nismave në fushën e vërtetimit të fakteve dhe të tregimit të së vërtetës, kryesisht brenda shoqërisë civile, por këto nisma kryesisht kanë qenë ndërmjet vete të pa bashkërenditura dhe të fokusuara para së gjithash në qendrat urbane.

Pas procesit shumëvjeçar intensiv konsultativ në kuadër të procesit KOMRA, në muajin mars të vitit 2011, është miratuar Propozim Statuti i KOMRA-s, që së bashku me më shumë se gjysmë milioni nënshkrime të qytetarëve të mbledhura anë e kënd rajonit i është dhënë kryetarëve të shteteve të krijuara në territorin e ish-Jugosllavisë. Gjatë vitit 2011, procesi KOMRA ka hyrë në fazën e institucionalizimit, përkatësisht të bartjes nga niveli civil në nivelin politik.

Qendra shtetërore kroate memoriale-dokumentuese e luftës Atdhetare ka vazhduar me mbledhjen e fakteve mbi ngjarjet nga konfliktet e armatosura në Kroaci, duke e zgjeruar veprimtarinë e saj edhe në konfliktin e armatosur në BdheH. Në Kosovë, në vitin 2011, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është themeluar Instituti shtetëror për Hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë me qëllim të koordinimit, të përcjelljes dhe hulumtimit të krimeve të luftës. Në Serbi, në Kroaci dhe në Kosovë, organizatat për të drejtat e njeriut, që punojnë në dokumentimin e krimeve të luftës (Fondi për të Drejtën Humanitare, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe Documenta) kanë vazhduar të punojnë në vërtetimin e regjistrimit gjithëpërfshirës të humbjeve njerëzore në konfliktet e armatosura të viteve nëntëdhjetë. Në Slloveni, me hulumtimin dhe vërtetimin e fakteve mbi “personat e fshirë” është marrë Instituti për Paqe në Lubjanë.

Koordinimi rajonal i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur në hapësirën e ish-Jugosllavisë ka filluar në vitin 2011 nën patronatin e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), me qëllim të ndërlihdjes së shoqatave dhe të fuqizimit të trytnisë në qeveritë e rajonit e me qëllim të zgjidhjes më efikase të fatit të personave të zhdukur në konfliktet e armatosura. Deri në fund të vitit 2011, sipas të dhënave të KNPZH-së, fati i rreth 13.500 njerëzve, të cilët janë zhdukur gjatë konflikteve të armatosura nga viti 1991 deri në vitin 2001 në hapësirën e ish Jugosllavisë ende nuk është zgjidhur. Aktivitetet në gjetjen dhe në identifikimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur i kanë kryer komisionet shtetërore për personat e zhdukur në Kroaci, Serbi dhe Mal të Zi, përkatësisht Instituti për personat e zhdukur në BdheH. Në Kosovë, me zgjidhjen re fatit të personave të zhdukur merren Komisioni qeveritar për Personat e Zhdukur, Zyra për Mjekësi Ligjore brenda Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës dhe Departamenti për mjekësinë forenzike i EULEX-it.

453 Për shkak të artikullit mbi Holmecin dhe gjoja të shtënat në ushtarët e APJ-së gjatë dorëzimit të tyre, gazetarin Bojan Bugjën e ka dënuar Gjykata e Nderit e Shoqërisë së Gazetarëve të Sllovenisë - për shkak të shkeljes së kodit të nderit. Në *Mladina* majft është shkruar mbi ngjarjet në Shkofje, kur, gjoja, pas ndërprerje së zjarrit, policët slloven në datën 29 qershor të vitit 1991 i kanë vrarë pjesëtarët e APJ-së, të cilat janë hedhur në kamion. “Ali smo nedolžni? Neraziskane temne strani herojske osamosvojitve”, *Mladina*, 14 maj 2006, shih faqen e internetit: <http://www.mladina.si/92583/ali-smo-nedolzni/>.

Në përmbajtjen e numrit më të madh të teksteve shkollore, të shfrytëzuara në vitin shkollor 2010-2011 në shkollat fillore dhe të mesme në BdeH, Kroaci, Serbi, Kosovë, Mal të Zi dhe Slloveni hetohet anshmëria etnike. Përgjegjësia dhe faji për krimet e luftës ose shpërbërjen e Jugosllavisë kryesisht i përshkruhen palës tjetër, derisa heshtet roli i palës vetanake në krime. Asnjë tekst shkollor, i cili shfrytëzohet në shkollat fillore dhe në të mesmen Maqedoni nuk ka përmbajtje të përfaqësuar të cilat flasin mbi konfliktin e vitit 2001.

2. Komisioni për të vërtetën

2.1. Bosnja dhe Hercegovina

Në fillim të vitit 2010, pas themelimit të Grupit Punues të Ekspertëve(GPE) për përpilimin e Strategjisë së drejtësisë tranzicionale në BdeH, anëtarët e GPE-së janë ndarë në tri nëngrupe tematike, prej të cilave njëri ka qenë nëngrupi për vërtetimin e fakteve dhe tregimin e së vërtetës. Anëtarët e këtij nëngrupi kanë qenë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe, posaçërisht në nëngrupe, përfaqësuesit e shoqatave të viktimave. Ata kanë organizuar, kanë marrë pjesë dhe kanë raportuar në konsultimet tematike. Siç është cekur edhe në rezyme të këtij Raporti, deri në fund të vitit 2011, Strategjia e drejtësisë tranzicionale në BeH është gjendur në fazën përfundimtare të përpunimit.

2.2. Sllovenia

Sllovenia, që nga shpallja e pavarësisë, ka ndërmarrë masa për të zgjidhur çështjet e së kaluarës me fqinjin e saj perëndimor, Italinë.

Me nismën e Italisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë dhe të Sllovenisë, kanë themeluar në vitin 1993 komisionin historik dhe kulturor slloveno-italian me detyrën për të vërtetuar faktet historike në marrëdhëniet e dy popujve midis viteve 1880 dhe 1956.⁴⁵⁴ I përbërë prej shtatë historianëve slloven dhe italian, komisioni ka publikuar raportin e përbashkët në vitin 2000. Në raport janë analizuar dhe qartësuar çështjet e kontestueshme historike slloveno-italiane, duke filluar nga përgjegjësia për fillimin e luftës, nëpër përgjegjësinë për vrasjen e civilëve slloven nga ana e okupatorit italian dhe vrasja e italianëve nga forcat partizane në “fojbat” i Istrës, deri te eksodusi i pasluftës i mijëra italianëve (optanëve) nga Istra dhe Dalmacia.

Në Slloveni nuk ka pasur kurrfarë nismash për themelimin e komisionit zyrtar për të vërtetën, i cili do të merrej me konfliktet e armatosura, të cilat e kanë përcjellë shpërbërjen e Jugosllavisë.

2.3. Niveli rajonal

2.3.1. Procesi KOMRA

Koalicioni rajonal i organizatave joqeveritare dhe i shoqatave të viktimave për themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës të viteve nëntëdhjetë (KOMRA),⁴⁵⁵ ka hyrë në vitin 2010 në fazën finale të procesit konsultativ mbi mandatin, qëllimet dhe detyrat e Komisionit Rajonal. Gjatë vitit 2010, Koalicioni është përforcuar me bashkimin e organizatave joqeveritare dhe shoqatat e viktimave nga Maqedonia dhe Sllovenia.⁴⁵⁶

454 Poročilo slovensko - talijanske zgodovinsko - kulturne komisije, faqja e internetit e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë: http://www.mzz.gov.si/fileadmin/pageuploads/Zakonodaja_in_dokumenti/dokumenti/Porocilo_SIZKK.pdf.

455 Koalicioni për KOMRA në muajin dhjetor të vitit 2011 ka numëruar 1820 anëtarë: 348 organizata joqeveritare, 59 shoqata të viktimave dhe të anëtarëve të familjeve të viktimave, 12 shoqata të veteranëve, 24 media, 8 organizata fetare, 11 organizata siç janë partitë politike, degët dhe këshillat e partive politike, organizata të vetëqeverisjes lokale dhe 1358 individë nga radhët e viktimave, bashkësive fetare, artistëve, shkrimtarëve, regjisorëve dhe të tjerë. Koalicioni në BdeH deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2011 ka përfshirë 360 anëtarë, në Mal të Zi 156, në Kroaci 174, në Kosovë 402, në Maqedoni 37, në Slloveni 22 dhe Serbi 669 anëtarë. Procesi KOMRA: Raport maj 2006 – tetor 2011. http://zarekom.org/documents/Izvestaj-o-Procesu-REKOM-za-period-od-maja-2006-do-avgusta-2011_.sr.html.

456 Nga gjysma e vitit 2010 në procesin konsultativ janë inkuadruar organizatat joqeveritare, shoqatat e viktimave dhe të veteranëve nga Maqedonia, kurse në muajin shtator të të njëjtit vit edhe organizatat joqeveritare dhe shoqatat e personave të fshirë nga Sllovenia. *Po aty*.

Në takimet konsultative dhe në forumet rajonale për drejtësinë tranzicionale, nga muaji maj i vitit 2010 e deri në muajin mars të vitit 2011, objekt i debatit ka qenë Projekt Statuti i KOMRA-s, qëllimet, detyrat, lënda e punës, përbërja e komisioneve dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre, autorizimet e komisionit dhe të tjera.⁴⁵⁷

Nga fillimi i vitit 2010, Koalicioni për KOMRA-n ka formuar Grupin Punues të Ekspertëve, me detyrën për të analizuar propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve të të gjitha konsultimeve gjatë katër viteve të gjata të procesit konsultativ.⁴⁵⁸ Më së shumti debate kanë shkaktuar dispozitat mbi autorizimet e KOMRA-s dhe mundësitë që komisioni mund të bëjë kualifikimin juridik të krimeve të luftës. Megjithëkëtë, qëndrimi i përbashkët se vetëm me themelimin e organit, i cili do ta ndërpriste praktikën e interpretimit selektiv të fakteve mbi të kaluarën dhe manipulimin me numrat e viktimave, ka kontribuar që Koalicioni për KOMRA-n ta miratojë Propozim Statutin e KOMRA-s në Kuvendin e mbajtur në muajin maj të vitit 2011.

Gjatë muajit maj dhe qershor të vitit 2011, Koalicioni për KOMRA ka mbledhur 543.870 nënshkrime të përkrahjes së qytetarëve anë e kënd rajonit për themelimin e KOMRA-s.⁴⁵⁹ Koalicioni për KOMRA, në fund të muajit qershor të vitit 2011, peticionin për themelimin e komisionit dhe Propozim Statutin ia ka dorëzuar kryetarëve të Kroacisë, Malit të Zi, dhe Sllovenisë si dhe anëtarit të Presidencës së BdheH, Zheljko Komshiqit.

Në këtë periudhë, nismës për themelimin e KOMRA-s i është dhënë përkrahja deklarative e përfaqësuesve më të lartë të pushtetit dhe elitave politike të vendeve post-jugosllave, midis të tjerash edhe e kryetarit të Kroacisë, Ivo Josipoviçit dhe ish kryetarit Serbisë, Boris Tadiçit, kryetarit të Sllovenisë, Danilo Türk, kryeministrit të qeverisë së Kosovës, Hashim Thaçit.⁴⁶⁰ Një numër i madh i kryetarëve të partive politike, deputetë të parlamentit, ministra, artistë, shkrimtarë dhe të tjerë me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur themelimi e KOMRA-s.⁴⁶¹

457 Në atë periudhë gjithsejtë janë mbajtur 55 takime konsultative (50 konsultime në të gjitha nivelet në vitin 2010 dhe atë: 16 lokale, 17 nacionale dhe 15 konsultime rajonale. Në vitin 2011 ka pasur pesë konsultime dhe atë: tri konsultime kombëtare dhe dy rajonale) me kategori të ndryshme të pjesëmarrësve dhe dy Forume Rajonale për drejtësinë tranzicionale, në Novi Sad në muajin mars të vitit 2010, në Zagreb në muajin tetor të vitit 2010 dhe një takim ndërkombëtar në Sarajevë në muajin qershor të vitit 2011.

458 Krahas propozimeve dhe sugjerimeve të pjesëmarrësve të procesit konsultativ, janë analizuar edhe statutet e komisioneve të tjera, legjislacioni i vendeve post-jugosllave, burimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës penale ndërkombëtare si dhe dokumentet ligjore ndërkombëtare. Procesi KOMRA: Raport maj 2006 – tetor 2011. Në dispozicion në http://zarekom.org/documents/Izvestaj-o-Procesu-REKOM-za-period-od-maja-2006-do-avgusta-2011_sr.html.

459 Në Bosnjë e Hercegovinë janë mbledhur 122.540 nënshkrime të përkrahjes, në Kroaci 19.674, në Mal të Zi 31.060, në Serbi 254.625, në Kosovë 100.566, në Slloveni 5346, dhe në Maqedoni 10.059 nënshkrime, faqja e internetit e Koalicionit për KOMRA, http://zarekom.org/documents/Kampanja-prikupljanja-potpisa-izvestaj-april-jun-2011_sr.html.

460 “Kryetari Josipoviç e ka përkrahur Nismën për KOMRA “ Komunikatë e Koalicionit për KOMRA-n, 30.08 2010, <http://zarekom.org/vesti/Predsednik-Josipovic-podrzao-Inicijativu-za-REKOM.sr.html>. „Kryetari Tadiç e ka përkrahur Nismën për KOMRA-n, 30.08 2010, <http://zarekom.org/vesti/Predsednik-Tadic-podrzao-Inicijativu-za-REKOM.sr.html>. Raport “1.000.000 nënshkrime për KOMRA-n”, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi dhe Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci, http://www.zarekom.org/uploads/documents/2011/07/i_1534/f_2/f_2091_sr.pdf.

461 Në BdeH me nënshkrime të tyre e kanë përkrahur themelimin e KOMRA-s: nënkryetari i Federatës së BdeH Mirsad Kebo, kryetari i PAD Sulejman Tihqi, kryebashkiaku i Sarajevës Alia Behmen, ministri i kulturës Salmir Kaplan, kryetari dhe nënkryetari i Federatës së BdeH Zhivko Budimir dhe Svetozar Pudariç, ministri i Sigurisë i BdeH, Sadik Ahmetoviç, kryesuesi i Këshillit komunal Qendra e Sarajevës Slaven Kovaçević, shkrimtari Ivan Lovrenoviç, regjisori Dino Mustafiç dhe Danis Tanoviç, poetja dhe shkrimtarja Ferida Durakoviç, aktori Ermin Bravo, regjisori Haris Pashoviç, dhe të tjerë. Nga Kroacia, themelimin e KOMRA-s, midis të tjerëve, e kanë përkrahur kryebashkiaku i Vukovarit dhe anëtar i PDS Zheljko Sabo, kryebashkiakët e Poreçit dhe Karlovca, Edi Shtifaniç dhe Damir Jeliç, ish kryetari i Republikës së Kroacisë Stjepan Mesiç, shkrimtari Slobodan Shnajder, etj. Në Serbi, me nënshkrimet e tyre, themelimin e KOMRA-s e kanë përkrahur kryetari i Kuvendit të Vojvodinës Shandor Egereshi, nënkryetari i Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë Judita Popoviç, kryebashkiaku i Bujanocit Shaip Kamberi, pastaj kryetari i partisë liberal-demokrate Çedomir Jovanoviç, kryetari i Lidhjes së Socialdemokratëve të Vojvodinës Nenad Çanak, kryetari i Partisë për Veprim Demokratik, Riza Halimi, kryetari i Rajoneve të bashkuara të Serbisë Mlagjan Dinkiç, nënkryetari i DS Jelena Trivan, komisionari për informim për çështje publike Rodoljub Shabiç dhe të tjerë. Në Kosovë, me nënshkrimet e veta përkrahje i kanë dhënë ministri i shëndetësisë në përbërjen e përparme të Qeverisë së Kosovës, Ferid Agani, deputetja në Kuvendin e Kosovës Rada Trajkoviç, kryetari i partisë më të madhe opozitare, Lidhjes demokratike të Kosovës (LDK) Isa Mustafa, nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) Ardian Gjini, kurse në Mal të Zi klubet e deputetëve të partisë Socialdemokrate, të Partisë Boshnjake, Partisë Socialiste Popullore, Demokracisë së Re Serbe, Partisë Demokratike të Socialistëve dhe të partive shqiptare. Në Maqedoni, përkrahje themelimit të KOMRA-s i ka dhënë deputeti i VMRO DPMNE në Parlament, Vlatko Gojceç, kurse në Slloveni kryetari i Kuvendit Shtetëror Pavel Gantar, ombudsmanpersoni, zonja Zdenka Čebashek Travnik, si dhe deputetët në Parlamentin Evropian Jelko Kacin dhe Tanja Fajon. *Po aty*.

Përkrahje të madhe themelimit të KOMRA-s i kanë ofruar edhe 146 artistë, intelektualë dhe profesor universitar nga shtetet post-jugosllave, të cilët publikisht i kanë bërë ftesë kryetarëve të BdheH, të Malit të Zi, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Serbisë që ta themelojnë KOMRA-n.⁴⁶²

Themelimin e KOMRA-s e kanë përkrahur edhe institucionet e Bashkimit Evropian. Nënkomisioni për të drejtat e Njeriut i Parlamentit Evropian, në takimin e datës 30.09.2010 ia ka dhënë përkrahjen e plotë themelimit të KOMRA-s, derisa Parlamenti Evropian, në Rezolutën e miratuar në muajin janar të vitit 2011, i ka ftuar qeverinë e Serbisë dhe të vendeve të tjera që, po ashtu, të ofrojnë përkrahjen për themelimin e komisionit rajonal.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në fillim të vitit 2011 e ka miratuar Raportin e raportuesit të Komitetit për Politikë të Jashtme të Këshillit të Evropës, i cili i thërret “të gjitha vendet në rajonin e ish-Jugosllavisë që të marrin pjesë në themelimin e KOMRA-s, pavarësisht nga statuti i tyre, në mënyrë që ky komision ta realizojë funksionin e pajtimit të plotë dhe të pranimit të viktimave”, e pastaj është miratuar edhe Rezoluta 1786 (2011), me të cilën i ofrohet përkrahje e plotë kësaj nisme civile.⁴⁶³ Krahas kësaj, Komisioni Evropian në muajin tetor të vitit 2011 e ka inkuadruar KOMRA-n në Strategjinë e tij të zgjerimit dhe të raportimit për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe e ka përshëndetur përkrahjen e tyre ndaj KOMRA-s si një element i rëndësishëm për përparimin në integrimet evropiane të kandidatëve për anëtarësim në BE.⁴⁶⁴

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, procesi KOMRA ka hyrë në fazën e kalimit gradual nga fusha e shoqërisë civile në nivelin politik.⁴⁶⁵ Është formuar ekipi rajonal i avokuesve publik, që në muajin dhjetor të vitit 2011 është takuar me kryetarin e Malit të Zi, Filip Vujanoviçin.⁴⁶⁶ Pas atij takimi, kryetari Vujanoviç ua ka drejtuar një thirrje personale kryetarëve të shteteve të rajonit që përkrahjen e tyre të përgjithshme për themelimin e KOMRA-s ta konkretizojnë në atë mënyrë që do të fillojnë me procedurat për hulumtimin e mundësive juridike për themelimin e KOMRA-s.

2.3.2. Gjykata e grave

Veprimtaret paqësore nga Serbia, Bosnja e Hercegovine, Mali i Zi, Kroacia dhe Kosova e kanë filluar nga fundi vitit 2010 nismën për themelimin Gjykatës së Grave për hapësirën e ish-Jugosllavisë, në kuadër të së cilës gratë nga i tërë rajoni do të dëshmonin mbi përvojat tragjike gjatë luftës së fundit. Qëllim është krijimi i një “gjykate alternative”, e cila me anë të dëgjimit të dëshmimeve të viktimave dhe të dëshmitarëve do t’i kontribuonte një drejtësie më gjithëpërfshirëse për gratë-viktima të konfliktit se sa ajo e cila, sipas mendimit të nismëtares, fiton brenda sistemeve gjyqësore tradicionale, të cilat fokusohen në kryerësit dhe nuk lënë mjaft hapësirë që të dëgjohet zëri i viktimave.⁴⁶⁷ Në mesin e organizatave, të cilat e kanë filluar këtë nismë, janë, midis të tjerash, edhe Grate në të zeza nga Serbia dhe Qendra për studime femërore nga Mali i Zi.

462 Letër e përkrahjes e intelektualëve dhe e shkrimtarëve për themelimin e KOMRA-s, <http://www.zarekom.org/documents/Pismo-podrske-intelektualaca-i-umetnika-osnivanju-REKOM-a.sr.html>.

463 Resolution 1786 (2011): Reconciliation and political dialogue between the countries of the former Yugoslavia, faqja e internetit e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta11/ERES1786.htm>.

464 “Nisma për KOMRA-n e inkuadruar në Strategjinë e zgjerimit dhe të raportimeve të Komisionit Evropian”, Komunikatë e Koalicionit për KOMRA, 20.10.2011, <http://zarekom.org/vesti/Inicijativa-za-REKOM-ukljucena-u-Strategiju-prosirenja-i-izvestaje-Evropske-komisije.sr.html>.

465 Nga fjala e Natasha Kandiqit me rastin e vizitës kryetarit të Malit të Zi, Filip Vujanoviçit !Zëri i Nismës KOMRA, nr 2/2011, f. 20, <http://zarekom.org/Glas-Inicijative-za-REKOM/Glas-Inicijative-za-REKOM-2/2011.sr.html>.

466 Në Ekipin Rajonal të avokuesve janë profesor i Universitetit në Sarajevë Zdravko Grebo dhe regjisor i Dino Mustafiq nga Sarajeva, profesor i Universitetit në Zagreb Zharko Puhovski, drejtoresha ekzekutive e FDH-së në Beograd Natasha Kandiq dhe gazetari Dinka Gruhonjiq nga Novi Sadi, gazetarët, Dragoljub Dushko Vukoviç nga Podgorica dhe Igor Mekina nga Lubjana dhe profesoresha e Universitetit në Shkup, Biljana Vankovska.

467 “Gratë janë viktimat më të mëdha të luftërave të fundit”, faqja e internetit Deutsche Welle, 6 nëntor 2011, http://www.dw.de/dw/article/0,,15513968,00.html?maca=ser-serbian_all-2277-rdf.

3. Qendra shtetërore hulumtuese-dokumentuese

3.1. Kroacia

Qendra kroate memoriale-dokumentuese e Luftës Atdhetare (QKMDLA) në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2011 ka vazhduar me punën e saj në sistematizimin, në mbledhjen, në arkivimin dhe publikimin e materialit historik mbi konfliktin e armatosur në Republikën e Kroacisë. Në kuadër të kësaj, ka vazhduar puna në rregullimin e materialit të „Krajinës së Republika Srpska“ (KRS), në seleksionimin dhe përgatitjen e dokumenteve për botimin e publikimit nga seria: Republika e Kroacisë dhe Lufta Atdhetare 1990-1995 – dokumente, dhe në krijimin e materialit të memoareve përmes zhvillimit të intervistave me komandantët dhe pjesëtarët e trupave të luftës, dhe pjesëmarrësve në ngjarje individuale.⁴⁶⁸

Një nga aktivitetet e rëndësishme të Qendrës, që ka vazhduar nga periudha e mëhershme, është puna në mbledhjen e dokumenteve për mbrojtjen e gjeneralëve kroat A. Gotovina, I. Çermak dhe M. Markaça si dhe gjeneralit S. Praljka para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë. Krahas kësaj, projekti “Humbjet e drejtpërdrejta demografike të Republikës së Kroacisë në luftën atdhetare” ka vazhduar gjatë viteve 2010-2011, dhe deri në fund të vitit të kaluar në bazën e të dhënave janë futur të dhëna për 5.182 persona të vrarë dhe 1.202 persona të vdekur nga vdekja natyrale në luftën Atdhetare në hapësirën e okupuar të RK (hapësira e „RSK“, kryesisht persona të kombësisë serbe).⁴⁶⁹

Qendra, po ashtu, ka vazhduar me veprimtarinë e saj botuese, të cilën e ka intensifikuar nga viti 2010 kur ka filluar me botimin e librave mbi konfliktin e armatosur në Kroaci në gjuhën angleze.⁴⁷⁰ Krahas mbledhjes dhe sistemimit të të dhënave nga pala kroate dhe serbe gjatë luftës në Kroaci, Qendra, në vitin 2011 ka zgjeruar aktivitetin e saj edhe në mbledhjen e të dhënave mbi luftën në BdeH, me botimin e përmbledhjes së punimeve “Kontribut për historinë e Rames në Luftën atdhetare 1990-1995 (kontribute mbi luftën e kroatëve në BdeH për ekzistencën e tyre në tokën e stërgjyshore)”. Siç thuhet në raportin e Qendrës për vitin 2011, me këtë ka filluar ngaqë “një pjesë e propagandës boshnjako-muslimanen ngjarjet në Prozor në muajin tetor të vitit 1992 synon t'i paraqes si fillim „të agresionit të Republikës së Kroacisë në BdeH“, gjë që nuk është e vërtetë”.⁴⁷¹

3.2. Kosova

Me vendimin e qeverisë së Kosovës, në muajin prill të vitit 2011 është themeluar Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim të koordinimit, të përcjelljes dhe të hulumtimit të krimeve të luftës, krimeve kundër paqes, krimeve të gjenocidit dhe shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare.⁴⁷² Misioni i Institutit është mbledhja, përpunimi, klasifikimi dhe arkivimi i lëndëve mbi krimet e luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare dhe i ngjarjeve të tjera të Republikës nga viti 1990 e deri në vitin 1999. Krahas kësaj, Instituti do të merret edhe me analizën e krimeve të kryera dhe ngjarjeve të tjera relevante, me përpunimin re tyre, verifikimin dhe sajimin e bazës së të dhënave, me përpilimin e shënimeve dhe të lëndëve të tjera për ndjekje penale dhe me përgatitjen e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera mbi rezultatet e hulumtimit, të cilat i kanë kryer ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.⁴⁷³

468 Raportim mbi punën e Qendrës kroate memoriale dokumentuese të Luftës Atdhetare për vitin 2010, gusht 2011, f.5, faqja e internetit QKMDLA (HMDCDR), http://www.centardomovinskograta.hr/pdf/Izvjescje_rad_Centra_2010.pdf.

469 Raportim mbi punën e Qendrës kroate memoriale dokumentuese të Luftës Atdhetare për vitin 2010, prill 2012, f.5, faqja e internetit QKMDLA, http://www.centardomovinskograta.hr/pdf/Izvjescje_rad_Centra_2011_opsirna_verzija_konacno%20.pdf.

470 Raportim mbi punën e Qendrës kroate memoriale dokumentuese të Luftës Atdhetare për vitin 2010, gusht 2011, f.8, faqja e internetit QKMDLA, http://www.centardomovinskograta.hr/pdf/Izvjescje_rad_Centra_2010.pdf.

471 Raportim mbi punën e Qendrës kroate memoriale dokumentuese të Luftës Atdhetare për vitin 2010, gusht 2011, f.11, faqja e internetit QKMDLA http://www.centardomovinskograta.hr/pdf/Izvjescje_rad_Centra_2010.pdf.

472 Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë, faqja e internetit të Qeverisë së Republikës së Serbisë, <http://www.mfa-ks.net/?page=3,108,716&offset=5>.

473 Zejnullah Gruda, Drejtor i Institutit për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë; intervistë në revistën „Made in KS“, numri 7, muaji tetor i vitit 2011.

Instituti, në punën e tij do të shfrytëzoj bazën e të dhënave të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, të bashkësisë islame dhe të organizatave të tjera të cilat i kanë dokumentuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe krimet, kurse do të kërkohet edhe nga organizatat joqeveritare që Institutit t’ia dorëzojnë gjithë dokumentacionin e tyre, në mënyrë që të konsolidohen në një vend.⁴⁷⁴

3.3. Mali i Zi

Edhe pse Kuvendi i Malit të Zi qysh në vitin 2007 ka miratuar Rezolutën mbi përmbushjen e detyrimeve të Malit të Zi në kuadër të Marrëveshjes mbi stabilizim asociimin, në të cilën e thërret Qeverinë, „që përmes formës së qendrës së veçantë hulumtuese-dokumentuese të krijojë premisat formalo-juridike si dhe të tjerat të domosdoshme për vërtetimin e së vërtetës mbi ngjarjet me elemente të mundshme të krimeve nga periudha e viteve 1991–2001, e që janë në çfarëdo mënyre të lidhura drejtpërdrejtë me Malin e Zi”⁴⁷⁵, deri në fund të vitit 2011 nuk është themeluar qendra e këtillë.

4. Vërtetimi dhe dokumentimi i fakteve nga organizatat e shoqërisë civile

4.1. Bosnja dhe Hercegovina

Qendra hulumtuese-dokumentuese nga Sarajeva gjatë viteve 2010-2011 ka vazhduar punën në digjitalizimin e materialeve dëshmuere në kuadër të projektit të saj “Humbjet njerëzore në Bosnjë e Hercegovinë 1991-1995”. Krahas kësaj, në muajin shtator të vitit 2010, është publikuar libri “Sinjalet zemrës”, me çka ka përfunduar puna në projektin „Historia gojore – rrëfime pozitive“. Qëllimi i projektit ka qenë që me dokumentimin e rrëfimeve të këtilla dhe me ruajtjen e tyre të kontribuohet drejt rindërtimit të besimit midis qytetarëve të BdheH dhe fuqizimit të krijimit të serishëm të lidhjeve të rrënuara nga konfliktet e armatosura.⁴⁷⁶

Nisma më e rëndësishme joqeveritare gjatë viteve 2010-2011 ka qenë krijimi i “hartës së gjenocidit”, në kuadër të projektit me emrin “Srebrenica – krijimi i hartës së gjenocidit” të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut të BdheH. Harta e Srebrenicës është hartë interaktive në formë të animacionit dokumentar, që përbëhet prej 17 hartave të animuara të dokumentuara të cilat janë punuar me metodologjinë e fakteve nga dokumentet e institucioneve relevante dhe rekonstruktimi i tyre sipas fazave të zhvillimit të gjenocidit në Srebrenicë. Secila nga hartat përmban dokumente, në të cilat ndodhen provat tekstore dhe figurative si dhe video shënime. Qëllimi i projektit është që të mundësoj modelin universal të interpretimit dhe të të kuptuarit të mekanizmave të gjenocidit, i cili mund të zbatohet për qëllime arsimore, posaçërisht në mesin e njerëzve të ri në programet e shkollave të mesme, por edhe në programet e tjera.⁴⁷⁷

Krijimi i bazës së të dhënave on-line të Lidhjes së Kampistëve të Bosnjës e Hercegovinës, është financuar gjatë dy viteve, deri në gjysmën e vitit 2010 nga ana e UNDP-së, deri atëherë kur janë futur rreth 10 për qind e të dhënave, të cilat i posedon Lidhja. Për shkak të mungesës së interesimit të institucioneve të BdheH që financiarisht ta përkrahin këtë nismë, baza nuk është zhvilluar më tutje.⁴⁷⁸

4.2. Kroacia

Organizata joqeveritare *Documenta* ka vazhduar me dokumentimin e fatit të personave të vrarë dhe të zhdukur

474 *Po aty*.

475 Rezolutë mbi përmbushjen e obligimeve të Malit të Zi në kuadër të marrëveshjes së stabilizim asociimit, 27 dhjetor i vitit 2007, *Gazeta zyrtare e Malit të Zi*, nr. 02/08.

476 Në libër janë publikuar 42 rrëfime private në bazë të intervistave të cilat janë zhvilluar me 69 persona. Faqja e internetit e QHD, http://www.idc.org.ba/index.php?option=com_content&view=article&id=269%3Akrijiga-signali-srca&catid=1%3Alatest-news&Itemid=50&lang=bs.

477 Intervistë me Alma Mashiqin, drejtoreshë e Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut, BdheH, 27 dhjetor i vitit 2011.

478 Faqja e internetit e Lidhjes së të burgosurve nëpër kampe të Bosnjës dhe Hercegovinës, <http://logorasibih.ba>.

në konfliktin e armatosur në Kroaci nga viti 1991 deri në vitin 1995 në kuadër të projektit „Humbjet njerëzore në Kroaci 1991-1995“, i filluar në vitin 2008.⁴⁷⁹ Nga fillimi i punës (dhjetor 2008) e deri sot, *Documenta* e ka përpiluar regjistrin emër për emër të rreth 6.800 viktimave dhe ka mbledhur fakte mbi rrethanat e vdekjes së tyre. Ekipi hulumtues ka zhvilluar mbi 2.600 intervista me anëtarët e familjeve të viktimave, dëshmitarëve, të shoqatave të viktimave dhe organizatave partnere në mbi 130 qytete, fshatra dhe fshatra të vogla në zonën e Qarkut mosllavakut-Sisakut dhe Sllavonisë Perëndimore, që kanë sjellë deri te informacionet mbi rreth 3.100 viktimave. Në periudhën nga muaji maj deri në muajin dhjetor të vitit 2011, janë evidencuar 2.000 viktima.⁴⁸⁰

Shoqata joqeveritare *Gratë në luftën atdhetare* në vitin 2011 ka filluar nismën për procesimin e personave përgjegjës për dhunimet e kryera në luftë në Kroaci në vitet 1991-1995. Në bashkëpunim me „Shoqërinë e kampistëve të kampeve serbe të përqendrimit“, në kuadër të projektit të njëjtë është botuar libri i Marija Sliskoviçit *Sunçica*, që përmban 14 dëshmi të grave dhe një mashkulli (me prejardhje kroate), të cilat i kanë dhunuar pjesëtarët e APJ-së dhe të Ushtrisë Serbe të Krajines (USK). Libri është paraqitur në muajin shtator të vitit 2011 dhe me atë rast dy gra, të cilat e kanë përjetuar dhunimin në Vukovar, kanë dëshmuar publikisht për këtë.⁴⁸¹

4.3. Serbia

Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, në muajin shtator të vitit 2011 kanë botuar vëllimin e parë të *Librit të kujtimit të Kosovës*, që përmban emrat e 2046 njerëzve dhe rrëfimin për jetën e tyre si dhe vrasjen në Kosovë gjatë vitit 1998.⁴⁸² Promovimi i librit është organizuar në datën 8 shtator të vitit 2011 në Beograd në prani të anëtarëve të familjeve të viktimave dhe të personave të zhdukur, gazetarëve dhe ambasadorit të Norvegjisë në Serbi.

Regjistri emër për emër i viktimave është bazuar në deklaratat e anëtarëve të familjeve dhe dëshmitarëve, në dokumentacionin e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë dhe të gjykatave vendore (në Serbi e në Kosovë), në raportimet e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, në raportet zyrtare dhe listat, në raportime nga mediat, në fotografitë dhe në burimet e tjera relevante. Përmbajtja e *Librit të kujtimit të Kosovës* është në dispozicion të publikut edhe në Internet, në formë të listës dhe të ueb faqes së veçantë.⁴⁸³

Në fund të vitit 2011, është vërtetuar se në Kosovë, nga muaji janar i vitit 1988 e deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2000 gjithsejtë janë vrarë, kanë pësuar dhe janë zhdukur 13.196 persona. Në mesin e tyre, 80 për qind janë shqiptarë dhe 20 për qind serb dhe joshqiptar të tjerë.

Nga viti 2009, FDH punon në krijimin e regjistrit të emrave të shtetasve të Serbisë dhe të Malit të Zi, të cilët kanë rënë, janë vrarë ose zhdukur gjatë konfliktit të armatosur në territorin e Sllovenisë, Kroacisë, dhe Bosnjës dhe Hercegovinës.⁴⁸⁴ Në fund të vitit 2011, është vërtetuar se gjithsejtë janë vrarë 1.945 shtetas të Serbisë dhe të Malit të Zi, pjesëtarë të formacioneve të armatosura të rregullta dhe paramilitare.

4.4. Kosova

Pjesa e parë *Librit të Kujtimit të Kosovës*, projektit të përbashkët shumëvjeçar të FDH Kosovë dhe FDH, është

479 Më shumë për projektin shih në faqen e internetit: www.ljudskigubici.info.

480 Komunikim me email me Igor Roginekin, 1 gusht i vitit 2012.

481 Gratë viktima të egërsisë seksuale në luftë – libër i prezantuar nga Sunçica: Dhunimi në vorbullën e poshtërit, 16 shtator i vitit 2011, faqja e internetit, http://hrsvijet.net/index.php?option=com_content&view=article&id=16872:ene-rtve-seksualnih-ivljavanja-u-ratu-predstavljena-knjiga-sunica-silovane-u-vrtlogu-poniavanja-videofoto&catid=28:povijesni-identitet&Itemid=112.

482 Më shumë për projektin shih në faqen e internetit: <http://www.kosovskaknjigapamcenja.org>.

483 Lista e të vrarëve, e të rënëve dhe e personave të zhdukur në Kosovë, faqja e internetit e *Librit të kujtimit të Kosovës*, <http://www.hlc-rdc.org/db/kkp/index.html>.

484 Regjistri emër për emër i qytetarëve të Serbisë dhe Malit të Zi, faqja e internetit e Fondit për të Drejtën Humanitare: <http://www.hlc-rdc.org/?cat=279>.

botuar në muajin qershor të vitit 2011. Në Prishtinë, në datën 7 shtator të vitit 2011, është organizuar promovimi i parë i librit, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 250 anëtarë të familjeve të viktimave dhe të personave të zhdukur, të organizatave joqeveritare, gazetarë dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore të Kosovës.⁴⁸⁵

4.5. Mali i Zi

Fondi për të Drejtën Humanitare në datën 12 prill të vitit 2011 e ka paraqitur në Podgoricë Raportin mbi humbjet njerëzore të Malit të Zi nga viti 1991 deri në vitin 1995. Gjatë konflikteve të armatosura në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë gjithsejtë janë vrarë 302 shtetas të Malit të Zi, kurse 62 persona konsiderohen si të zhdukur. Në takim nuk kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e institucioneve, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në fillim të viteve nëntëdhjetë, siç është Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi.

4.6. Sllovenia

Instituti për paqe në Slloveni në bashkëpunim me Amnesty International Slloveni, Qendrën Informative – Juridike për OJQ dhe Asociacionin Forenzik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga Italia, nga viti 2007 deri në vitin 2009 e ka zbatuar projektin me emrin “Personat e fshirë në Slloveni – sfidë e shtetit tonë” me qëllim që të ndërlihd punën e organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë marrë me temën e qytetarëve të fshirë të Sllovenisë në vitin 1992 dhe që të zhvillojnë një qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e këtij problemi. Në kuadër të projektit janë zhvilluar disa aktivitete – ndihma juridike për viktimat, avokimi publik në institucionet shtetërore mbi të drejtat e personave të fshirë, ngritja e vetëdijes në publik përmes organizimit të debateve publike dhe hulumtimit mbi personat e fshirë. Në kuadër të projektit janë zhvilluar intervista me personat e fshirë në Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi.⁴⁸⁶ Në atë periudhë, janë dokumentuar 80 rrëfime jetësore të personave të fshirë me qëllim që të dokumentohen shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të pengohet harrimi nëpërmjet të vërtetimit të fakteve mbi fshirjen dhe pasojat e fshirjes mbi viktimat.

5. Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur

5.1. Niveli rajonal

Bashkëpunimi i deritashëm midis shteteve në rajon është bazuar në Marrëveshjen e Naumit, të nënshkruar në datën 18 qershor të vitit 2004 midis Bosnjës e Hercegovinës, Republikës së Kroacisë dhe Serbisë, me të cilën është zyrtarizuar bashkëpunimi në nivel operativ.⁴⁸⁷ Serbia dhe BdheH nuk e kanë nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare mbi bashkëpunimin në fushën e kërkimit të personave të gjetur. Në Sarajevë, në datën 13 tetor të vitit 2011, është mbajtur takimi rajonal i shërbimit të kërkimit nga BdheH, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia dhe Shqipëria. Qëllim i takimit ka qenë arritja e marrëveshjes së përbashkët në frymën e përcjelljes së të dhënave mbi personat e zhdukur nga kompetencat e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në kompetenca të shërbimit të kërkimit.⁴⁸⁸

Në fund të vitit 2011, mbi zgjidhjen e rasteve të mbetura kanë biseduar përfaqësuesit Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), të Institutit për Persona të Zhdukur (IPZH) BdheH, Komisionit për të Burgosurit dhe Personat e Zhdukur të Qeverisë së Kroacisë dhe Komisionit për Persona të Zhdukur të Qeverisë së Republikës së Serbisë. Në takim, midis të tjerash, është arritur ujdja e dyanshme e përcjelljes së mbetjeve mortore, të cilat janë të identifikuar përmes projektit të përbashkët të identifikimit me Komisionin Ndërkombëtar për

485 Intervistë me drejtorin ekzekutiv të FDH Kosovë, Bekim Blakajn, 06.12.2011.

486 Neža Kogovšek et al, *The Scars of the Erasure: a contribution to the crucial understanding of the erasure of people from the register of permanent residents of the Republic of Slovenia*, Ljubljana: Peace institute, 2010, f.13.

487 Përgjigje me email e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për Personat e Zhdukur, 20 janar i vitit 2012.

488 Takim rajonal i shërbimeve të kërkimit, faqja e internetit Shoqëria e Kryqit të Kuq, BdheH, 13 tetor i vitit 2011, <http://www.rcsbh.org/index.php/galerije?start=5>.

Personat e Zhdukur (ICMP).⁴⁸⁹ Krahas kësaj, është arritur marrëveshja mbi vëzhgimin e përbashkët të terrenit, këmbimin e informatave mbi lokacionet, monitorimin e zhvarrosjeve dhe identifikimin si dhe mbi çështje të tjera të cilat kanë të bëjnë me personat e zhdukur në të tria shtetet.⁴⁹⁰

5.1.1. Koordinimi rajonal i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga hapësira e ish Jugosllavisë

Kjo nismë rajonale ka filluar në muajin qershor të vitit 2011, nën patronatin e Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), me idenë që të formohet trupi rajonal i cili do të angazhohet për zgjidhjen efikase të rasteve të personave të zhdukur në konfliktet e armatosura të viteve nëntëdhjetë.⁴⁹¹ Qëllim i kësaj nisme është krijimi i mekanizmave me ndihmën e të cilëve do të ushtrij trysni mbi shtetet e rajonit që „në kuadër të kompetencave të veta urgjentisht të ndërmarrin hapa konkret në krijimin e kushteve adekuate politike dhe të tjera për përshejtimin e procesit të kërkimit të personave të zhdukur“, por edhe të përshejtojnë edhe kënaqjen e drejtësisë, realizimin e të drejtave të viktimave dhe të anëtarëve të mbijetuar të familjeve të tyre.⁴⁹² Koordinimi rajonal i shoqatave tubon rreth 30 shoqata dhe asociacione nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që merren me problematikën e personave të zhdukur.

5.2 Bosnja dhe Hercegovina

Nga përafërsisht 30.000 persona të zhdukur gjatë konfliktit të armatosur në B dhe H, deri sot janë gjetur rreth dy të tretat e personave të zhdukur.⁴⁹³ Sipas të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) në B dhe H, deri në fund të vitit 2011, kanë qenë edhe 9.309 raste të hapura të personave të zhdukur. Në vitin 2010, në gjithë B dhe H janë zgjidhur 759 raste, kurse në vitin 2011 janë zgjidhur 853 raste të personave të zhdukur.⁴⁹⁴

Evidenca qendrore e personave të zhdukur të Institutit për personat e zhdukur deri në fund të vitit 2011 nuk është krijuar në tërësi, gjë që e ngadalëson procesin e verifikimit të identitetit të personave të zhdukur, pas të cilës do të fitoheshin të dhëna plotësisht të sakta mbi numrin e personave të zhdukur.⁴⁹⁵ Evidenca qendrore duhet të verifikojë të dhënat për 34.965 persona dhe vetëm atëherë do të fitohet numri i plotë i saktë i personave të zhdukur në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në atë proces, Instituti për personat e zhdukur bashkëpunon me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në B dhe H (KNKK), Shoqërinë e Kryqit të Kuq të B dhe H, Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Agjencinë për Identifikimi e Dokumenteve (IDEA), kurse

489 ICMP: Janë gjetur dy të tretat e personave të zhdukur, faqja e internetit e ICMP, <http://www.ic-mp.org/BA/press-releases/two-thirds-of-the-missing-accounted-forpronadeno-dvije-trecine-nestalih/#more-1476>.

490 Janë gjetur dy të tretat e personave të zhdukur, faqja e internetit e ICMP, <http://www.ic-mp.org/BA/press-releases/two-thirds-of-the-missing-accounted-forpronadeno-dvije-trecine-nestalih/#more-1476>.

491 Koordinimi rajonal i shoqatave tubon rreth 30 shoqata dhe federata nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat merren me problematikën e personave të zhdukur. “Përfaqësuesit e familjeve të personave të zhdukur nga Ballkani Perëndimor janë tubuar në Sarajevë”, komunikatë e ICMP, 22 korrik i vitit 2011, faqja e internetit e ICMP, <http://www.ic-mp.org/BA/press-releases/representatives-of-families-of-the-missing-from-the-western-balkans-gather-in-sarajevo-predstavnici-porodica-nestalih-iz-zapadnog-balkana-okupili-su-se-u-sarajevu/>.

492 Komunikatë e Koordinimit Rajonal e datës 1 dhjetor të vitit 2011, dërguar me anë të emailit.

493 Përgjigje me anë të emailit e Samira Krehiqit e menaxheres së programit të ICMP-së në pyetjen e FDH-së dhe të RCTP, e datës 21 dhjetor të vitit 2011.

494 Letër e Dragan Kojiqit, drejtoreshës rajonale të MKCK, e datës 24 janar të vitit 2012.

495 Procesi i verifikimit të personave të zhdukur në Evidencën qendrore të të zhdukure nënkupton vërtetimin e statusit dhe të identitetit të secilit person, i cili është i paraqitur si person i zhdukur në ndonjërin prej bazave duke filluar nga data 30 prill e vitit 1991 e deri më sot. Përndryshe, në Institutin për personat e zhdukur në Bosnjë dhe Hercegovinë ndodhen bazat e të gjitha institucioneve dhe të komisioneve, të cilat janë marrë me evidentimin e personave të zhdukur, siç janë, para së gjithash, komisioni Shtetëror për këmbimin e të burgosurve të luftës dhe evidencën e personave të zhdukur, Komisioni shtetëror për personat e zhdukur, ish komisionet/zyrat e entiteteve – Komisioni Federal për kërkimin e personave të zhdukur dhe Zyra për kërkimin e personave të zhdukur në RS, pastaj baza e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në B dhe H (KNKK) dhe Komisioni Ndërkombëtar për personat e Zhdukur (ICMP). Pas kryerjes së verifikimit, secili person i zhdukur do ta ketë dosjen e vet në formë të shtypur, e cila do të përmbajë dokumentet themelore mbi identitetin dhe rrethanat e zhdukjes së atij personi, para së gjithash fletëparaqitjen mbi zhdukjen, raportin e ADN-së dhe procesverbalin mbi identifikimin.

gasjen ndaj bazave të tyre e ka mbi mbështetjen në nenin 6 të Ligjit mbi Personat e Zhdukur.⁴⁹⁶ Deri në fund të vitit 2011, në evidencën qendrore të personave të zhdukur, në Institutin për Personat e Zhdukur janë verifikuar rreth 10.000 lëndë, kurse gjithsejtë janë identifikuar mbi 19.000 persona të zhdukur.⁴⁹⁷

Sipas vlerësimeve të Institutit për personat e zhdukur, përqindja e deritashme e identifikimeve të gabuara të konstatuara deri sot është rreth 0,4 për qind, dhe brenda Institutit është formuar grupi i punës për zgjidhjen e problemit të mbetjeve mortore të paignifikuara në morgje dhe në mauzole (përmendoret e eshtrave), detyrë themelore e të cilit është revidimi i trupave të zhvarrosur të paignifikuar të vendosur në ato objekte.

Sipas të dhënave të Institutit për personat e Zhdukur gjatë vitit 2010 janë lokalizuar 263 varreza potenciale masive dhe individuale, kurse janë kryer gjithsejtë 203 zhvarrosje. Janë zhvarrosur 818 mbetje mortore të viktimave nga lufta e kaluar, kurse janë identifikuar 926 persona të zhdukur. Në vitin 2011, sipas raporteve preliminare janë zhvarrosur rreth 400 persona të zhdukur, kurse janë identifikuar 872 persona të zhdukur.⁴⁹⁸ Në të njëjtin vit, janë lokalizuar 230 varreza potenciale dhe janë kryer 195 zhvarrosje në territorin e Bosnjës e Hercegovinës.⁴⁹⁹

Nga data 1 janar e vitit 2011, Prokuroria e BdeH ka marrë mbikëqyrjen mbi të gjitha zhvarrosjet në BdeH. Para kësaj, mbikëqyrjen mbi zhvarrosjet e kanë ushtruar prokuroritë në entitete. Kështu, prokurorët e RS i kanë ndër-marrë veprimet lidhur me zhvarrosjen e mbetjeve mortore të personave të zhdukur të përkatësisë etnike serbe, kurse prokurorët nga FBeH në zhvarrosjet e mbetjeve mortore të personave të zhdukur të përkatësisë etnike boshnjake dhe kroate, pa marrë parasysh nëse vendi i zhvarrosjes është lokalizuar në RS ose FBdeH. Në muajin qershor të vitit 2010, megjithëkëtë, Kolegji i Prokurorisë së FBdeH e ka marrë qëndrimin se veprimi i tillë është i paligjshëm. Pas kësaj, është arritur marrëveshja që Prokuroria e BdeH të marrë mbikëqyrjen mbi zhvarrosjet.⁵⁰⁰

Procesi i zhvarrosjes, i identifikimit, i ruajtjes dhe i varrosjes së mbetjeve mortore të personave të zhdukur plotësisht financohet nga buxheti i Bosnjës dhe Hercegovinës të paraparë me një shumë prej një milion markash konvertibile në vit. Sipas vlerësimeve të Institutit për personat e zhdukur, buxheti i paraparë është i mjaftueshëm për zbatimin efikas të këtyre aktiviteteve.⁵⁰¹ Megjithëkëtë, Prokuroria në BdeH në muajin tetor të vitit 2011 ka njoftuar se deri në fillim të muajit tetor të vitit 2011 nuk janë paguar paratë e parapara për kryerjen e zhvarrosjeve dhe se ky institucion ka borxhe ndaj atyre të cilët marrin pjesë në procesin e zhvarrosjes.⁵⁰² Sipas pohimeve të Institutit për persona të zhdukur, krahas problemeve financiare, ekzistojnë edhe probleme të natyrës administrative, të cilat e ngadalësojnë bashkëpunimin midis Prokurorisë (që jep urdhrin për hapjen e varrit) dhe Gjykatës së BdeH (që sjellë vendimin mbi hapjen e varrit), si dhe vet procesit të zhvarrosjes. Siç e ka cekur edhe Marko Jurishiq nga Instituti për personat e zhdukur, nga viti 2009 e deri në muajin shtator të vitit 2011, Instituti ia ka drejtuar Prokurorisë 185 kërkesa për zhvarrosje, në të cilat nuk ka marrë kurrfarë përgjigje.⁵⁰³

Disa vërejtje të caktuara janë drejtuar edhe nga Republika Srpska lidhur me punën e Institutit për personat e zhdukur në Bosnjë e Hercegovinë. Qeveria e Republika Srpska në vitin 2010 e ka përgatitur „Raportin mbi kërkimin e personave të zhdukur dhe hulumtimin e procesimin e krimeve të luftës“, i cili është plotësuar edhe në vitin 2011. Mbi raportet kanë debatuar deputetët e Kuvendit Popullor të Republika Srpska në vitin 2010 dhe 2011.

496 Përgjigje me anë të emailit e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për personat e zhdukur, e datës 20 janar të vitit 2012.

497 Përgjigje me anë të emailit e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për personat e zhdukur, e datës 16 janar të vitit 2012.

498 Përgjigje me anë të emailit e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për personat e zhdukur, e datës 16 janar të vitit 2012.

499 Përgjigje me anë të emailit e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për personat e zhdukur, e datës 16 janar të vitit 2012.

500 Arritja e drejtësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë: procesimi i lëndëve të krimeve të luftës prej vitit 2005 deri në vitin 2010, OSBE BdeH, 2011, f.36.

501 Përgjigje me anë të emailit e Lejla Çengiqit, zëdhënëses së Institutit për personat e zhdukur, e datës 16 janar të vitit 2012.

502 Mungesa e mjeteve e ngadalëson kërkimin e personave të zhdukur, faqja e internetit e BIRN, 12 tetor i vitit 2011, <http://www.bim.ba/bh/291/10/33552/>.

503 Sipas pohimeve të Marko Jurishiqit, anëtarit të KD IPZH, Instituti nga viti 2009 ia ka drejtuar Prokurorisë së BdeH 185 kërkesa, për të cilat deri në muajin shtator të vitit 2011 nuk ka marrë kurrfarë përgjigjesh. Kujt i përgjigjet që të mos gjenden personat e zhdukur, faqja e internetit *Radio Slobodna Evropa*, BdeH, 01 shtator i vitit 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/bih_nestali_identifikacija_grobnice_icmp/24315114.html.

Në kritika është cekur ngadalësia e punës së Institutit për personat e zhdukuri dhe numri i vogël i personave të identifikuar të kombësisë serbe.⁵⁰⁴ Siç e pohon Ekipi Operativ i Republika Srpska për kërkimin e personave të zhdukur, në RS, deri në formimin e Institutit të BdheH (01 janar i vitit 2008), janë gjetur dhe identifikuar 3.454 persona të zhdukur, kurse prej vitit 2008 deri në vitin 2010 janë identifikuar 3.075 trupa, prej të cilëve, siç pohon Goran Krçmari, udhëheqës i Ekipit Operativ të RS, janë identifikuar vetëm 75 persona të kombësisë serbe.⁵⁰⁵ Republika Srpska në përfundim të muajit dhjetor të vitit 2011 ka pasur 1.710 persona të zhdukur prej të cilëve 625 trupa gjenden në urna në Sarajevën Lindore, Nevesinje dhe Banja Llukë.⁵⁰⁶

5.3. Kroacia

Në përfundim të vitit 2011, Republika e Kroacisë edhe më tutje i kërkon 1.776 shtetas të zhdukur gjatë konflikteve të armatosura në periudhën kohore 1991-1995 në Kroaci.⁵⁰⁷ Nga ai numër, nga periudha e viteve 1991-1992 konsiderohen të zhdukur 991 persona, kurse nga periudha e vitit 1995 të zhdukur konsiderohen 785 persona.⁵⁰⁸

Gjatë viteve 2010 dhe 2011, Drejtoria për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur (DPNZH) e ka vazhduar punën në procesin e zhvarrosjeve dhe të identifikimit të personave të zhdukur me ritëm të ngjashëm si në vitin 2009. Në vitin 2010 janë identifikuar gjithsejtë 72 persona, kurse në vitin 2011 janë identifikuar 90 persona.⁵⁰⁹ DPNZH nuk mban statistika të të zhvarrosurve dhe të personave të identifikuar sipas kriterit të etnicitetit, si Bosnja dhe Hercegovina, derisa Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale ua pamundëson që të zbulojnë etnicitetin e personave të gjetur për nevojat e këtij raporti.

Personat e zhdukur si rezultat i konflikteve të armatosura edhe më tutje përfshihen në dy programe: programi me personat e zhdukur gjatë viteve 1991-1992, dhe programi me persona të zhdukur gjatë vitit 1995. Sipas DPNZH, në programin e viteve 1991-1992, 87 për qind e viktimave janë të kombësisë kroate, derisa brenda programit të vitit 1995, 90-95 për qind e viktimave janë të kombësisë serbe. DPNZH gjatë vitit 2010 ka marrë mbetjet mortore të 10 personave nga Republika e Kroacisë. Mbetjet mortore të gjashtë personave janë marrë nga Republika e Serbisë, kurse mbetjet mortore të katër personave janë marrë nga Bosnja e Hercegovina.⁵¹⁰ Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur marrje të mbetjeve mortore. Gjatë viteve 2010 dhe 2011 nuk ka pasur shpërndarje të mbetjeve mortore në shtetet e tjera (përndryshe, nuk është vërtetuar identiteti i personave nga hapësira e shteteve të tjera për periudhën e cekur). Në fund të vitit 2011, është vërtetuar identiteti i katër personave nga hapësira e Bosnjës dhe Hercegovinës të zhvarrosura në hapësirën e Republikës së Kroacisë, kurse aktivitetet në lidhje me shpërndarjen e mbetjeve të tyre mortore janë në vazhdim e sipër.⁵¹¹

Në Kroaci është shprehur problemi i zhvarrosjeve dhe i identifikimit të viktimave të kombësisë serbe, kryesisht të të rënëve/vrarëve gjatë dhe menjëherë pas aksioneve ushtarako-policore (AUP) „Vetëtima“ dhe „Stuhia“. Lokacionet ku janë varrosur trupat e të vrarëve janë shënjuar dhe dokumentuar qysh në vitin 1995, por shumë prej tyre deri sot nuk janë zhvarrosur. Ekzistojnë regjistra me numër të viktimave dhe me vendet e sakta të varrosjes së tyre, duke qenë se ato të ashtuquajturat varreza të përbashkëta i ka bërë (më së shpeshti brenda varrezave ekzistuese civile) ushtria kroate, gjatë pastrimit të terrenit pas operacioneve të cekura ushtarake. Në Kroaci ekzistojnë edhe 43 varreza të përbashkëta/masive të tilla me një numër të supozuar prej 393 trupash në to, të cilat

504 Seanca e 37-të e Kuvendit Popullor të Republika Srpska të mbajtur në datën 31 maj të vitit 2010 dhe seanca e 14-të e Kuvendit Popullor të Republika Srpska, që ka filluar të punojë në datën 13 dhjetor të vitit 2011.

505 Intervistë me Goran Krçmarin, udhëheqësin e Ekipit Operativ të RS, 27 dhjetor i vitit 2011.

506 *Po aty.*

507 Përgjigje e Drejtorisë për personat e ndaluar dhe të zhdukur ndaj kërkesës së Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut, e datës 9 janar të vitit 2012.

508 *Po aty.*

509 *Po aty.*

510 *Po aty.*

511 *Po aty.*

pas zhvarrosjes pastaj edhe duhet të identifikohen.⁵¹² Zhvarrosjet në varrezat e tilla janë bërë deri tash vetëm në 10 lokacione, kurse as ato nuk janë të zhvarrosura plotësisht dhe kjo e ngadalëson procesin e zhvarrosjes dhe të identifikimit në rajonet ku ato ndodhen.

Sipas Drejtorisë për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur problemi i procesit të ngadalshëm të zhvarrosjeve së këtyre varrezave përbënë mungesë të hapësirës në morgje, në të cilat varrosen trupat nga momenti i zhvarrosjes e deri në kohën sa zgjat procesi i identifikimit. Krahas kësaj, Drejtoria për të burgosurit dhe personat e zhdukur, zhvarrosjet e, pastaj, edhe identifikimet, i bënë sipas një rendi të caktuar, përkatësisht nga rajoni në rajon. Pas përfundimit të punës në një rajon, kalon në tjetrin në vijim, përkatësisht atje ku ekzistojnë supozime ose varreza të shënuara.⁵¹³ Sipas pohimeve të Drejtorisë për persona të ndaluar dhe të zhdukur (DPNZH), ende mbesin 57 zhvarrosje të mbetjeve mortore të personave të rënë/vrarë menjëherë pas AUP „Vetëtima“, si dhe zhvarrosja e 235 mbetjeve mortore të personave të rënë/vrarë gjatë dhe menjëherë pas AUP „Stuhia“.⁵¹⁴

Të dhënat e Drejtorisë për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur dhe të Komisionit për Personat e Zhdukur të Qeverisë së Republikës së Serbisë lidhur me numrin e personave të zhdukur të kombësisë serbe nga periudha gjatë dhe menjëherë pas AUP „Vetëtima“ dhe „Stuhia“ edhe më tutje dallojnë.

Drejtorja për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur disponon me të dhëna se në varrezat e përbashkëta në zonën e Banovinës, Kordunit, Likës, Dalmacisë Veriore dhe Sllavonisë Perëndimore janë gjetur gjithsejtë 957 mbetje mortore të personave të kombësisë serbe. Nga ai numër, deri tash gjithsejtë janë zhvarrosur 826 mbetje mortore dhe atë vetëm në nëntë lokacione.⁵¹⁵ Megjithëkëtë, deri tash pothuajse në të gjitha varrezat e përbashkëta janë zhvarrosur më shumë trupa se sa që është supozuar se janë të varrosura në to. Pos varrezës së përbashkët në Vrbovljan (e cila ende nuk është zhvarrosur deri në fund), në varrezat e tjera të cekura janë zhvarrosur gjithsejtë 206 persona më shumë se sa ka supozuar se ndodhen brenda tyre Drejtoria për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur.⁵¹⁶ Duke pasur parasysh se pason zhvarrosja edhe e 292 trupave, për të cilat Drejtoria supozon se gjenden në varreza të përbashkëta në 43 lokacione, mund të supozohet se numri i trupave brenda tyre është më i madh.⁵¹⁷

Komisioni për Persona të Zhdukur i Republikës së Serbisë disponon me të dhënën se brenda të gjitha varrezave të përbashkëta të cekura gjenden gjithsejtë 1.216 persona të kombësisë serbe, përkatësisht 259 më shumë se sa supozon DPNZH.⁵¹⁸ Po ashtu, në disa varreza të përbashkëta janë të zhvarrosur më shumë persona se sa supozon KPZH, si p.sh., në lokacionin në Knin, ku janë zhvarrosur 301 persona, megjithëse në regjistër të KPZH kanë qenë 258. Pos varrezës së përbashkët në lokacionin në Knin, posaçërisht problematike janë lokacionet në Petrinje, ku ekziston dallimi prej 32 personash, për të cilët supozohet se janë brenda varrezave, në Dvor te Una, ku ekziston dallimi në 64 persona, si dhe në Gornje Selishte, ku ekziston dallimi në 73 persona.⁵¹⁹ Të dhënat mbi personat e zhdukur dallojnë jo vetëm në evidencat e institucioneve të të dy shteteve, por edhe nga Qendra Dokumentuese-informative „Veritas“, e cila cek se deri tash janë zhvarrosur gjithsejtë 1.049 persona të kombësisë serbe, kurse prej tyre pozitivisht janë identifikuar 656 persona. Sipas regjistrit të tyre, në Kroaci ende janë 2.015 persona të zhdukur të kombësisë serbe, kryesisht të zhdukur gjatë AUP „Vetëtima“ dhe „Stuhia“⁵²⁰.

512 Të dhëna të marra nga Komisioni për Personat e Zhdukur i Qeverisë së Republikës së Serbisë, muaji nëntor i vitit 2011. I ka vërtetuar Drejtoria për personat e ndaluar dhe të zhdukur, krahas faktit se ekziston mospajtimi i dy organeve të shteteve lidhur me numrin e njerëzve të cilët janë të varrosur në varreza.

513 Intervistë me Vishnja Biliqin, zëvendëshefin e Drejtorisë për personat e ndaluar dhe të zhdukur, 23 dhjetor i vitit 2011.

514 Përgjigje e Drejtorisë për personat e ndaluar dhe të zhdukur ndaj kërkesës së Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut, 9 janar i vitit 2012.

515 Të dhënat mbi zhvarrosjet janë të muajit qershor të vitit 2011. Lokacionet në të cilat janë kryer zhvarrosjet: Knin, Zhitnik, Vrbovljan, Okučan, Petrinja, Dvor mbi Une, Medari, Gračac dhe Korenica.

516 Drejtoria për personat e ndaluar dhe të zhdukur ka supozuar se brenda varrezave të cekura të përbashkëta ndodhen 624 persona.

517 Intervistë me Vishnja Biliqin, zëvendëshefin e Drejtorisë për personat e ndaluar dhe të zhdukur, e datës 23 dhjetor të vitit 2011.

518 Informacion i marrë nga Komisioni për personat e zhdukur i Serbisë, nëntor i vitit 2011.

519 Kjo varrezë masive ende nuk është zhvarrosur.

520 „Viktimat serbe të luftës dhe të pasluftës në hapësirën e Kroacisë dhe të ish RSK në periudhën e viteve 1990. - 1998“, faqja e internetit e Veritas, <http://www.veritas.org.rs/srpski/spiskovi1.htm>.

Drejtoria për Personat e Ndaluar dhe të Zhdukur, në fund të muajit dhjetor të vitit 2011 ka pasur 2.188 kërkesa aktuale për kërkim të personave të zhdukur.

5.4. Serbia

Në Serbi, nga fillimi i konfliktit në ish-Jugosllavi e deri më sot janë gjetur 1.298 trupa, prej të cilëve 848 nga konflikti në Kosovë, dhe 450 trupa nga konfliktet e tjera. Nga numri i tërësishëm, 425 trupa kanë ardhur me rrugë lumore në periudhën 1991-1995, kurse 727 trupa janë zhvarrosur. Janë identifikuar 1.077 persona - 818 shqiptarë të Kosovës (të gjetur në varrezat masive në Batajnicë dhe Petrovo selo), 96 kroat, 125 persona nga Federata e BdheH dhe 26 nga Republika Srpska, 15 persona nga Serbia dhe një person nga Mali i Zi.⁵²¹ Të gjithë personat e tjerë të paidentifikuar janë me prejardhje nga Kosova dhe i janë dorëzuar autoriteteve kosovare.

Komisioni për Personat e Zhdukur i Qeverisë së Republikës së Serbisë, i autorizuar për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur, i kërkon personat e zhdukur në konfliktet e armatosura në Kroaci, BdheH dhe Kosovë, e të cilët janë shtetas të Serbisë, dhe/ose familjet e të cilëve pas konflikteve janë vendosur me banim në Serbi, dhe e kanë parashtruar kërkesën për kërkimin e personit të zhdukur para shërbimeve kompetente në Serbi. Sa ka të bëjë me personat, që Serbia i kërkon nga shtetet e tjera, nuk ka ndryshime të mëdha as në numrin e personave të gjetur e as në numrin e personave të identifikuar, që janë zhvarrosur në vendet e tjera. Në Kroaci, Serbia i kërkon 403 shtetas të Serbisë si dhe 1.200 persona të afërmit e të cilëve jetojnë në Serbi. Nga Kosova 1.803 persona konsiderohen të zhdukur, sipas burimeve serbe, derisa numri i personave, zhdukjen e të cilëve e kanë paraqitur familjet, në Serbi është 521.⁵²² Në dy vitet e fundit është publikuar pranim-dorëzimi i 30 trupave nga lista serbe e kërkimit, të cilat janë marrë në Merdare nga institucionet kompetente në Kosovë. Të gjithë trupat janë identifikuar dhe tashmë i kanë marrë familjet e tyre.

106 | Qeveria serbe gjatë viteve 2010 dhe 2011 disa herë i ka kontrolluar lokacionet në rrethinën e Rashkës dhe lokacionin e Sijarinës në Medvegje, në lidhje me kërkesat e institucioneve të Kosovës që këto zona të kërkohen për shkak të ekzistimit eventual të varrezave masive. Kërkimet e fundit janë kryer në muajin tetor të vitit 2011 në lokacionin në afërsi të Rashkës, në praninë e institucioneve ndërkombëtare dhe kosovare, por as atëherë nuk është vërtetuar ekzistimi i varrezës masive në lokacionin i cili është hetuar.

Qeveria serbe i ka katër kërkesa të hapura, të cilat i janë dërguar institucioneve kompetente në Kosovë, ndaj të cilave, për shumicën, është vepruar, por pala serbe i konsideron të pazgjidhura. Këto janë Bellaçevci, lokacion, kërkimi i të cilit nuk është kryer deri në fund, por kërkimet janë pezulluar; Koshare, ku supozohet se ka së paku gjashtë trupa të ushtarëve deri tek të cilët, deri tash, nuk ka qenë e mundur të depërtohet për shkak të minave; Livačko Jezero, që më herët është kërkuar me ndihmën e zhytësve, por për shkak të kushteve natyrore në liqë kërkohet zbatimi i metodave të tjera; dhe një lokacion në afërsi të Suha Rekës, në të cilin, me rastin e kërkimeve, nuk është gjetur asgjë.

Serbia i ka kryer të gjitha obligimet e saj dhe në këtë moment nuk ka kërkime nga shtetet e tjera.⁵²³ Krahas kësaj, me rastin e vizitës së kryetarit të Serbisë, Boris Tadiq Vukovarit në datën 4 nëntor të vitit 2010, delegacioni serb i ka dorëzuar autoriteteve kroate dokumentacionin e kërkuar një kohë të gjatë të Ushtrisë së Serbisë mbi personat, të cilët janë zhdukur në spitalet e Vukovarit në muajin nëntor të vitit 1991 dhe personat të cilët kanë kaluar nëpër kampet në territorin e Serbisë në vitet 1991-1992.⁵²⁴

521 Intervistë me Veljko Odaloviqin, kryetaren e Komisionit për personat e zhdukur në Republikën e Serbisë, e zhvilluar në muajin gusht të vitit 2011 dhe në datën 4 nëntor të vitit 2011.

522 Intervistë me Veljko Odaloviqin, kryetaren e Komisionit për personat e zhdukur në Republikën e Serbisë, e zhvilluar në muajin gusht të vitit 2011 dhe në datën 4 nëntor të vitit 2011.

523 *Po aty.*

524 Dokumentacioni i Ushtrisë së Serbisë e cek numrin prej 1.276 personash në spitalin e Vukovarit, dhe 2.876 persona të cilët kanë qëndruar në kampet Begejci dhe Stajiqevo. Ekziston mospajtimi prej 50 emrash midis evidencave të këtyre dy shteteve. *Po aty.*

Gjatë viteve 2010 dhe 2011, familjet e personave të zhdukur kanë vazhduar për të kërkuar miratimin e ligjit mbi personat e zhdukure e, megjithëkëtë, deri në fund të vitit 2011 nuk ka pasur njoftime nga institucionet se kjo do të ndodh. Një nga problemet e ligjit unik do të jetë përfshirja e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me personat e zhdukur, sepse është fjala për disa konflikte të armatosura, në të cilat këta persona janë zhdukur.⁵²⁵ Problem shtesë paraqet ekzistimi i një numri të madh të kategorive plotësuese në lidhje me personat e zhdukur, siç janë, për shembull, rastet e familjeve të cilat kanë marrë shtetësinë e një vendi tjetër nga ai të cilin i afërmi i tyre e ka pasur në momentin e zhdukjes dhe, së këndejmi, edhe konsiderohet si person i zhdukur i shtetit tjetër.⁵²⁶

Për nevojat e remontit të Hidroelektranës „Bajina Bashta“ gjatë verës së vitit 2010, është ndaluar qarkullimi i ujit në liqenin artificial Peruqac, me çka niveli i ujit ka rënë në 18 metra. Instituti për Personat e Zhdukur në BdheH ia ka paraqitur kërkesën Komisionit për Persona të Zhdukur nga Serbia që të mundësohet hulumtimi i fundit të liqenit në kërkim të trupave të personave të zhdukur gjatë konfliktit të armatosur në BdheH. Proceset e shumta gjyqësore për krime të luftës në rajon kanë vënë në spikamë se një numër i madh i trupave të të vrarëve janë hedhur në lumin Drin, arsye kjo për të cilën në mënyrë të bazuar supozohet se lumi shumicën e tyre e ka sjellë deri tek liqeni i Peruqacit. Krahas kësaj, në liqenin Peruqac në vitin 2001 janë gjetur trupat e shqiptarëve të Kosovës, të zhdukur në vitin 1999.

Kërkimi ka qenë i përqendruar në pjesën e poshtme të rrjedhës së lumit Drin, në të cilën ndodhet liqeni akumulues Peruqac. Në kërkimin e fundit të liqenit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e komisionit serb dhe boshnjak, me praninë e komisionit kosovar dhe me ndihmën e përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare. Në pjesën e bregut serb të liqenit janë gjetur 14 trupa, midis të cilëve shpejt janë identifikuar edhe Rasim Qoriqi nga Prijepolja dhe Jusuf Rastoder nga Berane, udhëtarë të rrëmbyer nga treni në Shterpce në muajin shkurt të vitit 1993.⁵²⁷ Është gjetur edhe shasija e ftohësit që në vitin 2001 kishte “notuar” nga liqeni dhe në të cilin janë gjetur trupat e shqiptarëve të vrarë në Kosovë, por, përkundër të pritmeve, nuk janë gjetur trupat e shqiptarëve për të cilat ende kërkohet. Instituti për personat e zhdukur i BdheH nga ana boshnjake ka gjetur mbetje komplete dhe jokomplete të 396 rasteve. Siç ka deklaruar Amor Mashoviqi, nga Instituti boshnjak, vlerësimet e mjekoligjorëve janë se në ato 396 raste minimalisht janë 97 persona.⁵²⁸

5.5. Kosova

Në përfundim të vitit 2011, në Kosovë bëhen kërkime për 1.797 persona të zhdukur gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Gjatë vitit 2010, janë gjetur dhe janë identifikuar 57 persona, kurse familjeve iu janë dorëzuar mbetjet mortore të 103 personave, të cilët sërish janë varrosur. Në vitin 2011, familjeve iu janë dhënë mbetjet mortore të 72 personave të identifikuar. Deri tash Kosovës i janë dorëzuar mbetjet mortore të rreth 840 personave, që në pjesën më të madhe kanë qenë të zhvarrosur nga varrezat në territorin e Serbisë. Nga viti 2006, Serbia nuk i ka dorëzuar trupa Kosovës, sepse as nuk ka pasur zbulime as të varrezave të reja e as të trupave, edhe pse ka pasur shumë kërkime të terrenit të Rashkës dhe Medvegjes. Pranim-dorëzimi i trupave në kufirin Serbi dhe Kosovë zhvillohet edhe sot e gjithë ditën, por ka të bëjë me trupat e serbëve të identifikuar dhe të joshqiptarëve të tjerë në Kosovë, të cilat i pranon Komisioni për Persona të Zhdukur i Serbisë dhe familjet e tyre.⁵²⁹

Kuvendi i Kosovës, në datën 31 gusht të vitit 2011 e ka miratuar Ligjin mbi personat e Zhdukur, me të cilin rregullohen të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjet e tyre në Kosovë, vërtetohen autorizimet dhe përgjegjësitë e Komisionit qeveritar për Personat e Zhdukur dhe e formon Regjistrin Qendror të personave

525 *Po aty.*

526 *Po aty.*

527 „Midis mbetjeve mortore në Peruqe, trupat e dy udhëtarëve të rrëmbyer në Shterpce”, faqja e internetit *Blic*, 26 shkurt i vitit 2011, <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/237973/Medju-posmrtnim-ostacima-u-Peruccu-tela-dva-putnika-oteta-u-Strpcima>.

528 Intervistë telefonike me Amor Mashoviqin, drejtorin e Institutit për personat e zhdukur BdheH, e datës 18 janar të vitit 2012.

529 Përgjigje me email e Suzana Novobërdaliut, kryetare e Komisionit për të drejta të njeriut, barazi gjinore, për persona të zhdukur dhe peticione, Kuvendi i Kosovës, e datës 23 dhjetor të vitit 2011.

të zhdukur, me të cilin udhëheq Komisioni dhe në të cilin gjenden të dhënat e centralizuara mbi personat e zhdukur, të cilat janë të marra nga të gjitha burimet në dispozicion, në mënyrë që të ndihmohet gjatë zbulimit të identitetit të të zhdukurve si dhe vendit dhe rrethanave të zhdukjes së tyre.⁵³⁰ Personi i zhdukur përkufizohet si „person, vendi i gjetjes së të cilit është i panjohur për familjen e tij apo të saj e për të cilin në bazë të informacionit të besueshëm dihet se është zhdukur nga data 1 janar e vitit 1998 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në periudhën prej vitit 1998 deri në vitin 1999“.⁵³¹ Një nga aspektet më të rëndësishme të Ligjit nga pikëpamja e familjeve të personave të zhdukur është rregullimi i të drejtave të tyre mbi të qenët në dispozicion të pronës së personave të zhdukur, pa kushtin që anëtarin e zhdukur të familjes së tyre ta shpallin të vdekur.⁵³² Statusi i këtillë juridik, çfarë e ofron Ligji, në mënyrë të dukshme do t'i kontribuojë pozitivisht më të mirë të familjeve të personave të zhdukur.⁵³³ Pos kësaj, autoritetet vendore, tash, me një legjislaturë adekuate, mund të merren me zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur në mënyrë të plotë, duke iu qasur si një problemi shoqëror, me ndryshim nga organizata ndërkombëtare, mandati i së cilit është ekskluzivisht i natyrës teknike.⁵³⁴

Puna e Grupit Punues për Personat e Zhdukur nga konfliktet e armatosura në Kosovë, të cilin e koordinon Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) ka vazhduar edhe gjatë viteve 2010-2011. Në grupin punues gjenden përfaqësuesit e familjeve të personave të zhdukur nga Kosova dhe Serbia si dhe përfaqësuesit e qeverisë dhe të KNKK, kurse është formuar me qëllim që „të përfaqësojë mekanizëm formal, mbi të cilin autoritetet qeveritare, të cilat kanë pasur kontrollin mbi zonat në të cilat kanë ndodhur zhdukjet, të këmbëjnë informacione dhe të planifikojnë aktivitetet e mëtejme të drejtuara nga kërkimi i të zhdukurve dhe të kënaqin drejtësinë dhe nevojat e familjeve të tyre“.⁵³⁵

Familjet e personave të zhdukur nga Kosova, nga fillimi i muajit dhjetor të vitit 2011 i janë drejtuar autoriteteve qeveritare me kërkesë që në negociatat mbi statutin me Serbinë të futet edhe zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur, por kjo kërkesë është refuzuar nga ana e përfaqësuesve të BE-së. Përfaqësuesit e BE-së e kanë refuzuar këtë me arsyetimin se ekziston dhe funksionon Grupi Punues për Personat e Zhdukur.⁵³⁶

Me hulumtimin e lokacioneve, në të cilat do të mund të ishin mbetjet e personave të zhdukur, si dhe me zhvarrosjen e trupave të tyre merret edhe Departamenti i EULEX-it për mjekësinë ligjore (EULEX, *Department of Forensic Medicines* - DFM [angl.]), dhe kjo është posaçërisht e rëndësishme për shkak të kërkimit të personave të zhdukur në shtetet e tjera. Ky departament i EULEX-it ka njoftuar lidhur me hulumtimin e rreth 35 lokacioneve, të cilat janë identifikuar si varreza potenciale gjatë vitit 2012.⁵³⁷

Me qëllim të zgjidhjes së çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, EULEX-i ka vendosur bashkëpunimin me Serbinë dhe me Malin e Zi. Në kuadër të bashkëpunimit me Serbinë deri tash janë organizuar më shumë kërkime të terrenit sipas njoftimeve, në vitet e fundit në Medvegje dhe në Rashkë, deri sa në bashkëpunim me Malin e Zi në muajin korrik të vitit 2010 është kryer kërkimi i lokacionit në komunën e Andrijeviçës.⁵³⁸ Deri tash, EULEX-i

530 Ligji nr. 04/L-23 mbi personat e zhdukur, 31 gusht i vitit 2011, neni 13.

531 *Po aty*, neni 2, paragrafi 1.

532 *Po aty*, neni 6, paragrafi 3.

533 Të drejtat në reparacione administrative materiale e familjeve të personave të zhdukur kohët e fundit janë të rregulluara në Kosovë, por Ligji mbi statusin dhe të drejtat e luftëtarëve të rënë, invalidëve, veteranëve, dhe pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre Ligji nr. 04/L-054 mbi statusin dhe të drejtat e luftëtarëve të rënë, invalidëve, veteranëve, dhe pjesëtarëve të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre është miratuar në datën 8 dhjetor të vitit 2011.

534 Raport: Situata në Kosovë: hyrje në gjendjen, faqja e internetit ICMP, i datës 14 shtator të vitit 2010, Sarajevë, f.8, <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2007/11/icmp-dg-264-4-bos-doc-general.pdf>.

535 Informatë e marrë nga Dragana Kojiq, drejtoreshë e Delegacionit rajonal të KNKK, e datës 26 dhjetor të vitit 2011.

536 Familjet ngulin këmbë që në Bruksel të diskutohet edhe mbi personat e zhdukur, faqja e internetit e gazetës *Koha ditore*, 8 dhjetor i vitit 2011, http://www.koha.net/index.php/force_download/repository/caricatures/repository/docs/ProgramiFestivKTV.pdf?page=1,13,79983.

537 Përgjigje me email e Suzana Novobërdaliut, kryetare e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, personat e zhdukur dhe peticione të Kuvendit të Kosovës, e datës 23 dhjetor të vitit.

538 Raport i Departamentit për mjekësinë ligjore i EULEX-it mbi aktivitetet në lidhje me personat e zhdukur, i vitit 2010, faqja e internetit e EULEX-it, http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/ompf/DFM%202011%20MP%20REPORT1_SERB.PDF.

nuk ka pasur kurrë farë suksesi në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Maqedoninë në lidhje me kërkesën për kërkim të terrenit në territorin e tyre.⁵³⁹

Mbi 70 për qind të zhvarrosjeve, të cilat i ka kryer Departamenti për Mjekësi Ligjore i EULEX-it gjatë tri viteve të fundit në Kosovë, janë kryer në varrezat kosovare, ku edhe është gjetur pjesa më e madhe e të gjithë personave të zhdukur të identifikuar.⁵⁴⁰

Komisioni Ndërkombëtar mbi Personat e Zhdukur (International Commission on Missing Persons - ICMP [angl.]), në raportin e tij mbi problemet e zgjidhjes së çështjes së personave të zhdukur në Kosovë në vitin 2010, e cek se ka ardhur deri te një bllokim në zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur nga Kosova nga viti 2005.⁵⁴¹ Siç e cek edhe ICMP, pas zhvarrosjeve në Serbi në vitin 2001 dhe 2002, nuk janë gjetur mbetje të reja mortore të viktimave nga Kosova në Serbi, derisa në Kosovë, shumica e mbetjeve mortore është gjetur në vet fillimin e procesit nga ana e ekipeve të GJNPJ, e më vonë të UNMIK-ut (midis viteve 1999 dhe 2003). Pas vitit 2005, ICMP ka vërejtur një rënie në zbulimin e varrezave të reja, por edhe më tutje bëhen kërkime për rreth 2.000 persona të zhdukur.⁵⁴²

Problem tjetër është numri i identifikimeve të gabuara të trupave, që janë bërë me metodën tradicionale të njohjes para shfrytëzimit të analizës së ADN-së, në periudhën midis viteve 1999 dhe 2003.⁵⁴³ Ky problem është karakteristik për tërë rajonin, por në një përqindje posaçërisht të madhe është i pranishëm në Kosovë.⁵⁴⁴

Në morgjet kosovare gjenden 414 mbetje mortore të personave të cilët deri tash nuk janë të identifikuar, edhe pse disa trupa atje gjenden edhe nga dhjetë vite.⁵⁴⁵ ICMP, në vitin 2010 e ka shprehur vlerësimin se do të jenë të domosdoshme zhvarrosjet e përsëritura me qëllim të shmangies së gabimeve të bëra në procesin e identifikimit dhe mbledhja e përsëritur e mostrave referente nga familjet të cilat i kanë marrë trupat e identifikuar me metodën klasike.⁵⁴⁶

Megjithëkëtë, si shenjë e përparimit mund të vlerësohet nënshkrimi i marrëveshjes së përbashkët të departamenteve kompetente të EULEX-it dhe ICMP-së në datën 10-11 nëntor të vitit 2011 në Sarajevë mbi bashkëpunimin për hulumtimin e themeltë të këtyre rasteve.⁵⁴⁷

5.6. Mali i Zi

Qeveria e Malit të Zi, në datën 2 qershor të vitit 2011 e ka zgjedhur kryetarin e ri të Komisionit për Personat e Zhdukur të Malit të Zi. Për kryetar të Komisionit është zgjedhur Dragan Gjukanoviq, përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe i Kujdesit Social. Me atë rast janë zgjedhur edhe gjashtë anëtarë të Komisionit, të cilët janë të punësuar në organet e tjera shtetërore

539 Intervistë me Anne Blanks, zëdhënëse e policisë së EULEX-it, e datës 12 janar të vitit 2012.

540 Raport vjetor mbi aktivitetet e Departamentit për mjekësinë ligjore i EULEX-it, dhjetor 2010-dhjetor 2011, f.10-11, faqja e internetit EULEX-it, http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/ompf/ANNUAL%20REPORT%20DFM%202011_Serb.pdf.

541 Raport: Situata në Kosovë: hyrje në gjendjen, faqja e internetit ICMP, 14 shtator i vitit 2010, Sarajevë, <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2007/11/icmp-dg-264-4-bos-doc-general.pdf>.

542 *Po aty*, f. 4.

543 *Po aty*, f. 4-5.

544 Më shumë intervista me ekspertët e ICMP-së janë zhvilluar në periudhën nga muaji gusht i vitit 2011 deri në muajin janar të vitit 2012.

545 Informacion i marrë nga Dragana Kojiq, drejtoreshë e delegacionit rajonal të KNKK, i datës 26 dhjetor të vitit 2011. Sipas të dhënave të ICMP-së, në Morgun e Prishtinës gjenden mbetjet mortore të së paku 413 personave. Raport: Situata në Kosovë: hyrje në gjendjen, faqja e internetit ICMP, i datës 14 shtator të vitit 2010, Sarajevë, f. 6, <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2007/11/icmp-dg-264-4-bos-doc-general.pdf>.

546 Raport: Situata në Kosovë: hyrje në gjendjen, faqja e internetit ICMP, i datës 14 shtator të vitit 2010, Sarajevë, f.5-16, <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2007/11/icmp-dg-264-4-bos-doc-general.pdf>.

547 Më shumë intervista me ekspertët e ICMP-së janë zhvilluar në periudhën nga muaji gusht i vitit 2011 deri në muajin janar të vitit 2012.

Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur gjetje dhe identifikim të 66 personave, të cilët ndodhen në regjistrin, të cilin Kryqi i Kuq i Malit të Zi në muajin nëntor të vitit 2008 e ka marrë nga misioni rajonal i Kryqit të Kuq në Beograd. Në vitin 2011 janë identifikuar tre persona.⁵⁴⁸ Komisioni për persona të zhdukur, në muajin shkurt të vitit 2011 ka marrë informacionin nga Komisioni për personat e Zhdukur se në liqenin Peruqac është gjetur një pjesë e mbetjeve mortore të Jusuf Rastoderit (1939), i cili është vrarë pasi që është rrëmbyer nga treni në stacionin e Shtrpces në datën 27 shkurt të vitit 1993. Identifikimi i mbetjeve të tij mortore është kryer në Institutin për mjekësi ligjore në Beograd, kurse pranim-dorëzimi është kryer në datën 23 mars të vitit 2011 në Bijelo Polje.⁵⁴⁹ Në shtator të vitit 2011 në Beograd janë identifikuar mbetjet mortore të dy qytetarëve të Serbisë, të cilët në vitin 1999 janë rrëmbyer dhe vrarë në Kosovë.⁵⁵⁰ Në muajin maj të vitit 2010 është kryer pranim-dorëzimi i një pjesë të mbetjeve mortore të tre pjesëtarëve të grupit të rezervistëve të grupit „nikshiqas-shavnikaq” të armatës popullore të ish-Jugosllavisë.⁵⁵¹ Ende janë duke u bërë kërkime për një pjesëtarë të këtij grupi.⁵⁵²

Gjatë viteve 2010 dhe 2011 në territorin e Malit të Zi nuk janë gjetur trupat e shtetasve të huaj, të cilët janë zhdukur në konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi.⁵⁵³ Në fund të muajit korrik të vitit 2010 hetuesit kosovar dhe malazias, së bashku me mjekoligjorët e misionit të EULEX-it e kanë hulumtuar lokacionin e kantierit të sharrës në Andrijevicë, për të cilin është dyshuar se aty ndodhet një varrezë masive e shqiptarëve të Kosovës, por hetimet nuk ka dhënë rezultate.⁵⁵⁴

Protokolli mbi bashkëpunimin me komisionet për personat e zhdukur të vendeve të tjera ende është nënshkruar, por prej Komisionit për Personat e Zhdukur të Malit të Zi njoftojnë se në periudhën e ardhshme theksi do të vendoset në arritjen e marrëveshjeve dhe të protokolleve bilaterale mbi bashkëpunimin.⁵⁵⁵

5.7. Maqedonia

Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur në Maqedoni zyrtarisht nuk shënon kurrfarë ndryshimesh në lidhje me gjendjen e përshkruar në Raportin e FDH-së, Documente dhe BIRN-it për vitin 2009: *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave*.

Fati i pasigurt i personave të zhdukur në Maqedoni është në lidhje të ngushtë me amnistinë e të dyshuarve dhe të të dënuarve, deri te e cila ka rezultuar me interpretimin autentik të Ligjit mbi amnistinë në mesin e vitit 2011. Në MPB pohojnë se, përkundër asaj se personat e amnistuar kanë të drejtë që të mos deklarohen mbi krimet me të cilat janë të ndërlidhur, kërkimi i personave të zhdukur nuk ka përfunduar.⁵⁵⁶

Nga gjithsejtë 22 persona të zhdukur në lidhje me konfliktin e vitit 2001, sipas të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), edhe 14 persona konsiderohen të zhdukur.⁵⁵⁷ Evidenca e MPB-së tregon se

548 Përgjigje me email e kryetarit të Komisionit për personat e zhdukur të Malit të Zi, Dragan Gjukanoviqit, e datës 15 dhjetor të vitit 2011.

549 *Po aty*.

550 *Po aty*. Është fjala për Bogdan Radeviqin nga Peja dhe Rexhë Shalën nga Gjakova, familjet e të cilëve banojnë në Mal të Zi.

551 *Po aty*.

552 Informacion mbi grupin nikshiqas-shavnikaq, autor Radan Nikoliq, faqja e internetit të Shoqatës së luftëtarëve të luftërave të viteve 1990, Mali i Zi, <http://www.ubr.co.me/projekti>.

553 Përgjigje me email e kryetarit të Komisionit për personat e zhdukur të Malit të Zi, Dragan Gjukanoviqit, e datës 15 dhjetor të vitit 2011.

554 „Nuk ka varrezë masive të shqiptarëve në Andrijevicë”, *Portal Analitika*, 27 korrik i vitit 2010; <http://www.portalanalitika.me/drustvo/vijesti/8766-nema-masovne-grobnice-albanaca-u-andrijevici-.html>.

555 Përgjigje me email e kryetarit të Komisionit për personat e zhdukur të Malit të Zi, Dragan Gjukanoviqit, e datës 15 dhjetor të vitit 2011.

556 Informacion i marrë nga Ministria e punëve të brendshme, i datës 23 janar të vitit 2012.

557 Të dhëna të botuara në ICRC ANNUAL REPORT 2009; nuk ka informacione të reja në ICRC ANNUAL REPORT 2010, kurse raporti i ICRC për vitin 2011 nuk është botuar.

edhe 16 persona konsiderohen të zhdukur.⁵⁵⁸ Deri sot, në Maqedoni janë identifikuar mbetjet mortore të katër maqedonasve,⁵⁵⁹ tre shqiptarëve⁵⁶⁰ dhe një shtetasi bullgar⁵⁶¹.

Komisioni për vërtetimin e fatit të personave të zhdukur dhe të kidnapuar të vitit 2001, është themeluar në vitin 2003 dhe edhe më tutje formalisht ekziston, por zyrtarët nuk kanë dëshiruar as ta vërtetojnë e as ta demantojnë këtë informatë.⁵⁶²

5.8. Sllovenia

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Sllovenisë, organet shtetërore për momentin i kërkojnë 260 persona të zhdukur.⁵⁶³ Policia nuk ka të dhëna mbi personat e zhdukur gjatë konflikteve në hapësirën e ish RSFJ-së, kurse në konfliktet në Slloveni në vitin 1991 janë identifikuar të gjitha viktimat kështu që zyrtarisht nuk ka persona të zhdukur. Megjithatë, disa qytetarë të Sllovenisë janë zhdukur gjatë konfliktit të armatosur në BdeH.⁵⁶⁴

6. Sistemi i arsimit dhe ngjarjet e periudhës së luftës

6.1. Bosnja dhe Hercegovina

Përmbajtja e teksteve shkollore, të cilat shfrytëzohen në shkollat fillore dhe të mesme në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk ka ndryshuar dukshëm në dy vitet e fundit. Tekstet e historisë ende mbajnë shenja të anshmërisë etnike.⁵⁶⁵

Edhe pse revidimi i teksteve të historisë është bërë në vitin 2007 me nismën e Këshillit të Evropës me qëllim që nga tekstet e historisë në gjithë vendin të largohen leksionet të cilat merren me luftën e viteve 1992-1995, deri te kjo nuk ka rezultuar në rastin e teksteve të historisë për klasën e nëntë të shkollës fillore, të cilat shfrytëzohen në Republika Srpska. Në këtë tekst janë ruajtur interpretimet e njëanshme të shpërbërjes së RSFJ-së dhe të konflikteve të armatosura në Kroaci, dhe në Kosovë edhe gjatë bombardimeve të Republikës Federative të Jugosllavisë.⁵⁶⁶ Tekstet shkollore, që janë në shfrytëzim në kantonet e Federatës së BdeH për fëmijët boshnjak edhe më tutje i përmbahen moratoriumit të leksioneve mbi periudhën 1992-1995, ashtu siç tekstet për fëmijët kroat dhe serb kanë mbajtur interpretimet e njëanshme të së kaluarës së afërt.

Në Federatën e BdeH ekziston mundësia e zgjedhjes midis teksteve të ndryshme të historisë, derisa në Republika Srpska shfrytëzohet vetëm një tekst i historisë për klasën e caktuar të shkollës fillore ose të mesme. Në Republika Srpska, në të gjitha shkollat e mesme mësohet sipas programeve të njëjta. Në shkollat fillore, nxënësit mund të

558 Informacion i marrë nga Ministria e punëve të brendshme, i datës 23 janar të vitit 2012.

559 Janë identifikuar Krsto Gogovski dhe Vasko Mihajlovski nga fshati Neproshteno, dhe Simeon Jakimovski dhe Dimitrije Dimovski nga Tetova, të zvarrosur në zonën e Tetovës, viti 2001.

560 Në humnerë në bjeshkën Bistra, në vitin 2004 janë zvarrosur dhe identifikuar shqiptarët Islam Veliu, Hajredin Halimi dhe Ibrahim Veliu.

561 Trupi i qytetarit të Bullgarisë, Radoslav Ginovit është zvarrosur në humnerën në bjeshkën Bistra në vitin 2004.

562 Собраниската комисија ќе ја утврдува судбината на киднапираните, Утрински весник 28.06.2003, <http://star.utrinski.com.mk/?pBroj=1205&stID=5499&pR=2>, pristupljeno 09.01.2012.

563 Aty numërohen të gjithë personat e zhdukur. Informacion i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Sllovenisë, i datës 23 janar të vitit 2012.

564 Mbetjet mortore të Dragomir Petronjiqit, me prejardhje serb nga Prijedor, qytetarit të Celjes, janë gjetur në varrezën masive në BdeH dhe janë identifikuar në vitin 2007. Policia sllovene, pas fshirjes nga regjistri, e ka deportuar në BdeH në vitin 1992, ku është vvarë. "Fati i Petronjiqit i bashkon "personat e fshirë", faqja e internetit *Politika*, 9 tetor i vitit 2007, <http://www.politika.rs/rubrike/Svet/t43553.lt.html>. Sipas informacioneve jozyrtare, Alojz Krivograd, fotograf nga Sllovenia, është zhdukur pasi që në verën e vitit 1992 në BdeH e kanë burgosur forcat serbe dhe sipas deklaratave të dëshmitarëve e kanë dërguar për këmbim, kur edhe i humbet çdo gjurmë. Mbetjet e tij mortore janë gjetur në varrezën masive në Foqë në vitin 2001. „Alojz Krivograd – Futy“, faqja e internetit *Mladina*, 18 qershor i vitit 2001, <http://www.mladina.si/93691/alozj-krivograd-futy/>.

565 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f.48-49.

566 *Po aty*, f. 48.

përcaktohen për vijim të mësimin të grupit kombëtar të lëndëve sipas plan programeve të njërit prej kantoneve nga FBdheH, kurse ekziston edhe mundësia e formimit të klasave të veçanta për shkak të organizimit më të thjeshtë të mësimin. Për grupin kombëtar të lëndëve sipas planeve dhe programeve të FBdheH në RS janë përcaktuar 2.804 nxënës, dhe atë në numrin më të madh të rasteve në kantonin e Tuzllës.⁵⁶⁷

Në Bosnjë e Hercegovinë, në kuadër të edukimit qytetar zhvillohen lëndët obligative *Bazat e demokracisë* në shkollat fillore, dhe *Demokracia dhe të drejtat e njeriut* në shkolla të mesme.⁵⁶⁸ Të dyja lëndët i ka zhvilluar rrjeti arsimor CIVITAS në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, që edhe e zbaton procesin e zhvillimit të materialit mësimor dhe programin e certifikimit për arsimtarët dhe profesorët në territorin e tërë BdeH. Lënda *Demokracia dhe të drejtat e njeriut* merret me aspektin e gjerë të të drejtave të njeriut, por ka të bëjë edhe me drejtësinë tranzicionale dhe atë në përmbajtjet që lidhen me nocionin e drejtësisë dhe qasjes drejtësisë si dhe në leksionin mbi rolin e organizatave joqeveritare dhe humanitare.⁵⁶⁹ Në kuadër të programit të CIVITAS-it, në pjesë të ndryshme të BdeH zbatohet edhe një pjesë e planit mësimor *Hulumtimi i të drejtës humanitare*, të cilin e ka krijuar KNKK. Është fjala për një program, të cilin e kanë krijuar *Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq* (KNKK) dhe *Education Development Center* (EDC) pas përfundimit të konflikteve të armatosura. I dedikohet adoleshentëve nga mosha 13 deri në moshën 18 vjeçare, me qëllim që t'iu ofrojë parimet themelore dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe që të nxisë drejt zgjidhjes së padhunshme të konflikteve dhe për veprim humanitar në bashkësitë e veta.⁵⁷⁰ HDH është e integruar në tërë Bosnjën e Hercegovinë: në Federatën e BdeH, RS dhe në Distriktin e Brçkos.⁵⁷¹

Në Distriktin e Brçkos, HDH është përfaqësuar nga viti 2000 dhe është integruar në *Orën e Klasës së Komunitetit* (*Čas odjeljske zajednice*). Në FBdheH, HDH ligjërohet nga viti 2006. Nëntë orë të HDH në vit studiohen në kuadër të lëndës *Demokracia dhe të drejtat e njeriut* në shkollat për fëmijët boshnjak. Në shkollat, në të cilat vijohet plani dhe programi mësimor kroat, HDH me 10 njësitë e saj mësimore është e integruar në programin *Politika dhe ekonomia*. Në Republika Srpska zbatohet i njëjti model i studimit si edhe në Distriktin e Brçkos.⁵⁷²

6.2 Kroacia

Nuk ka ndryshime në raport me periudhën prej vitit 2009 kur është fjala te përfaqësimi i temës së luftës në tekstet shkollore kroate. Edhe më tutje arsimtarët i kanë në dispozicion pesë tekste shkollore për historinë, dy për nxënësit e klasave të teta të shkollave fillore dhe tri për nxënësit e klasave të katërta të shkollave të mesme, të të njëjtëve autor.⁵⁷³ Nëpër të gjitha librar, shpesh, trupat serbe cilësohen me termin „agresor“, mbahet statusi i „Stuhisë“ si i një aksioni të drejtë dhe legjitim me incidente individuale të krijuara për shkak të hakmarrjes dhe lakmisë. Nga tekstet e historisë, të cilat nuk janë analizuar në raportin e mëhershëm mbi procesin e përparimit të drejtësisë tranzicionale në vendet post-jugosllave, nxënësit e klasave të katërta të shkollave të mesme e kanë në dispozicion tekstin e autores Mira Kolar-Dimitrijeviq, Hrvoje Petriqit dhe Jaksha Raguzhës, por as ky tekst nuk dallon për nga interpretimi i ngjarjeve në lidhje me luftën nga tekstet e tjera.⁵⁷⁴ Autorët e cekin se si fitorja në luftë përfaqëson „thyerje të idesë serbomadhe“,⁵⁷⁵ e cila e ka synuar ndërtimin e “Serbisë së madhe”⁵⁷⁶ përmes „amputimit të 70 për qind të territorit të Kroacisë“.⁵⁷⁷ Në disa raste përdoret termi “agresor” për njësitë serbe.⁵⁷⁸

567 Intervistë me Ivana Ixhën, bashkëpunëtoren e lartë profesionale për plane dhe programe mësimore për arsimin fillor në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës të Republika Srpska, Banja Llukë, e datës 11 nëntor të vitit 2011.

568 Lëndët janë të obligueshme prej vitit 2001 në shkollat e mesme, kurse prej vitit 2009 në shkollat fillore, në të tërë territorin e BdeH.

569 *Demokracia dhe të drejtat e njeriut*, tekst shkollor për shkollat e mesme, Civitas, Sarajevë 2009, f. 84-92.

570 Informacion i marrë nga Dragana Kojiq, drejtoreshë e delegacionit rajonal të KNKK, i datës 26 janar të vitit 2012.

571 Pos kantonit të Bosnjës së Mesme, i cili në fund të vitit 2011 ka filluar procesin e integritimit.

572 Përgjigje me anë të emailit e Sanela Bajrambashiqit, zëdhënëse e KNKK, Sarajevë, e datës 25 janar të vitit 2012.

573 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f.49.

574 Mira Kolar-Dimitrijeviq, Hrvoje Petriq dhe Jaksha Raguzh, *Historia 4 (Povijest 4)*(Meridijani, Zagreb, 2004).

575 *Po aty*, f. 230-231, 237.

576 *Po aty*. 233.

577 *Po aty*.

578 *Po aty*. 236.

Në lidhje me çlirimin e territoreve kroate ceket edhe operacioni ushtarak në Medaçki xhep dhe përmendet se si UNPROFOR-i ka penguar marrjen e territorit me dhunë dhe është kërkuar që kjo të bëhet me rrugë paqësore.⁵⁷⁹ Për të dëbuarit pas “Stuhisë” shkruhet se 150.000 njerëz në mënyrë të organizuar e kanë lëshuar Kroacinë, sepse nuk e kanë dashur qeverinë kroate.⁵⁸⁰ Në pjesën „Krimet e luftës në Kroaci “ përmenden vetëm krimet e kryera ndaj kroatëve.⁵⁸¹

Teksti i përmend edhe ngjarjet e konfliktit të armatosur në BdeH dhe posaçërisht ceket qëllimi i serbëve për të kryer gjenocid ndaj boshnjakëve dhe kroatëve.⁵⁸² Krahas kësaj, teksti shkollor e përkufizon konfliktin midis kroatëve dhe boshnjakëve gjatë luftës në BdeH si mosmarrëveshje, e cila është shndërruar në një konflikt të shkurtër.⁵⁸³ Përgjegjësia e Republikës së Kroacisë të lidhur me Herceg Bosnjën për krime kundër boshnjakëve po ashtu zvogëlohet dhe mohohet lidhja e autoriteteve të Herceg Bosnjës me ato të Zagrebit.⁵⁸⁴

Programi arsimor i KNKK *Hulumtimi i të Drejtës Humanitare*, i cili i kushtohet fëmijëve dhe adoleshentëve të moshës prej 13 deri 19 vjeç, është përfshirë në arsimin e mesëm, edhe pse nuk është plotësisht i zbatuar dhe i njohur për publikun e gjerë.

Zyra për lidhje e Gjykatës Ndërkombëtare Penale të ish-Jugosllavisë në Zagreb, në muajin shtator të vitit 2010, në letrën hyrëse ka kërkuar nga Ministria e Shkencës, e Arsimit dhe e Sportit që t’ua paraqesë nxënësve të shkollave të mesme Gjykatën Ndërkombëtare dhe punën e saj. Ministria e ka shqyrtuar këtë program arsimor disa muaj, por Zyra e GJPNJ në fund është informuar se projekti është refuzuar me vendim të kabinetit të ministrit.⁵⁸⁵

6.3. Serbia

Nga viti 2010, në Serbi botohen pesë tekste të reja të historisë dhe dy mjete të reja mësimore, të cilat i ka miratuar Ministria e Arsimit, të gjitha për klasën e tetë të shkollës fillore. Nga tekstet për shkollë të mesme është paraqitur vetëm një tekst i ri dhe atë për klasën e tretë të drejtimit natyror-matematikor të gjimnazit. Historia për klasën e tetë të shollës fillore shkakton dukshëm interesimin më të madh të autorëve dhe botuesve në Serbi, kurse në dy vitet e fundit, me pesë tekste të reja krahas tashmë dy ekzistuesve të cilat edhe më tutje shfrytëzohen, është vënë rekordi në tërë rajonin.⁵⁸⁶ Të gjitha tekstet përfshijnë lëndën nga periudha e historisë së Jugosllavisë, shpërbërjen e saj dhe konfliktet e armatosura si dhe rrethanat e krijimit të shteteve të reja.

Tekstet e entit për tekste shkollore janë më të shpeshtat në përdorim në shkollat në Serbi.⁵⁸⁷ Teksti shkollor këtij i botuesi e përshkruan shpërbërjen e Jugosllavisë si pasojë të nacionalizmave të promovuara nga kreu i strukturës partiake dhe shtetërore.⁵⁸⁸ Krahas kësaj, kur paraqiten shembuj të “nacionalizmave”, ekskluzivisht flitet mbi nacionalizmin shqiptar dhe kroat, kurse për udhëheqjen serbe thuhet “më së gjati i është kundërvënë” demokratizimit dhe sistemit shumëpartiak dhe se skena politike serbe në krye me Millosheviqin ka qenë e karakterizuar si “regjim i represionit, mungesë e plotë e demokracisë dhe e tolerancës politike, ndjekje dhe burgosje e kundërshtarëve politik.”⁵⁸⁹

579 *Po aty*. 241.

580 *Po aty*. 242.

581 *Po aty*. 242-243.

582 *Po aty*. 240.

583 *Po aty*.

584 Për shembull, krahas fotografisë së Urës së Mostarit të rrënuar ceket se ura është e rrënuar në luftë, por nuk ceket se cilat forca janë përgjegjëse për rrënimin e saj. *Po aty*.

585 Informacion i marrë nga Zyra për lidhje e GJNKJ.

586 Lista e të gjitha teksteve të miratuara, të cilat shfrytëzohen në institucionet shkollore në Serbi, është në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, <http://www.mpn.gov.rs/prosveta/page.php?page=80>.

587 Arsimitarët e lëndëve kanë mundësi që vet të zgjedhin se prej cilit tekst do t’i mësojnë nxënësit, kurse në shkollë të caktuara për zgjedhjen e teksteve vendosin drejtorët e shkollave. Nxënësit dhe prindërit nuk kanë ndikim në këto vendime. Informacione të marra me anë të gjashtë intervistave me arsimtarët e lëndëve të historisë të shkollave fillore dhe të mesme të Beogradit, Nishit dhe Leskovcit, gjatë muajit shkurt të vitit 2012.

588 Gjorgje Gjuriq dhe Momqillo Pavloviq, *Historia 8 (Istorija 8)* (Enti për tekste, Beograd, 2010.), f. 184.

589 *Po aty*, f. 184.

Lufta në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë është prezantuar si një tërësi, si “luftë qytetare”, e cila “ka filluar si luftë lokale, e kufizuar” në Kroaci, pastaj “ka vazhduar në Bosnjë, pas pranimit të saj si shtet i pavarur në datën 6 prill të vitit 1992.” Në pjesën mbi luftën në Kroaci, në asnjë vend nuk përmendet roli dhe përgjegjësia e APJ-së.⁵⁹⁰ Megjithëkëtë, thuhet se lufta ka përfunduar me “aksionet e ushtrisë kroate kundër popullatës serbe”, të cilat kanë rezultuar me dëbimin e 99 për qind të popullatës serbe nga Republika Serbe e Krajines dhe me djegien e 80 për qind të shtëpive serbe, ku autorët thirren në të dhëna të Komitetit Kroat të Helsinkit.⁵⁹¹ Në asnjë vend nuk cekën pësimet e kroatëve gjatë konfliktit të armatosur. Në tekste është cekur “masakra në Srebrenicë”, për të cilën thuhet se është “krim i luftës dhe krim kundër njerëzimit, të cilin e ka kryer ushtria e Republika Srpska me ndihmën e formacione ve paramilitare, ndaj ushtarëve dhe civilëve boshnjak”.⁵⁹² Thuhet edhe se janë “të kundërshtueshme të dhënat mbi numri i tërësishëm të viktimave, sipas njëres palë 8.000 njerëz, sipas të tjerëve këta numri vlerësohen si teprim”.⁵⁹³ Autorët e teksteve po ashtu e cekin se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, në datën 26 shkurt të vitit 2007, në aktgjykimin sipas padisë së BeH kundër RFJ-së “këtë krim e ka kualifikuar si gjenocid, por Serbinë nuk e ka ndërlidhur me këtë ngjarje”.⁵⁹⁴ Një pjesë e madhe e këtij kapitulli i është kushtuar Kosovës, në lidhje me të cilën nuk flitet mbi konfliktin e armatosur, por për konfliktin e organizatës terroriste shqiptare dhe “forcave të rendit”, si dhe mbi “agresionin e NATO-s”. Askund nuk përmenden viktimat civile shqiptare. Është paraqitur një tabelë, në të cilën tregohen “pësimet e civilëve nga NATO-ja”, ceket se nga Kosova janë shpërngulur “220.000 serb dhe popullatë tjetër joshqiptare”, thuhet se “gjatë agresionit kanë rënë midis 1.500-2.500 civilë”.⁵⁹⁵ Përfundimisht, edhe pse cekën shumë emra të të akuzuarve serb para GJPNJ, nuk ceket se përse kanë qenë të akuzuar. Në pjesët, në të cilat përmenden pësimet e viktimave serbe, emërohen përgjegjësit, kurse në pjesë shumë të përgjithësuar, në të cilat flitet mbi “të gjitha viktimat” –pos në rastin e Srebrenicës – nuk cekën viktimat e popujve të tjerë dhe as kombësia e kryerësve, si dhe as forcat përgjegjëse për vrasjet.⁵⁹⁶

Në tekstin e Radosha Ljushiqit dhe Ljubodrag Dimiqit, për luftën në Kroaci thuhet se „ka pasur karakteristika të konfliktit nacional dhe fetar“, kurse për forcat ushtarake të këtij shteti përdoret termi „njësi paramilitare“, edhe pse autori diku më herët e cek faktin se Kroacia e kishte shpallur pavarësinë dhe që, si të tillë, e kanë pranuar edhe shtete të tjera.⁵⁹⁷ Mbi aksionet „Vetëtima“ dhe „Stuhia“ flitet për zbatimin e “spastrimit etnik të serbëve paraprakisht të planifikuar”.⁵⁹⁸ Në lidhje me luftën në BdheH, thuhet se „aksionet ushtarake të të gjitha palëve të luftës janë përcjellë nga krimi masiv, midis të cilëve veçohet krimi në Srebrenicë“, por nuk thuhet se çfarë ka ndodhur në Srebrenicë dhe as se kush janë viktimat.⁵⁹⁹

Një pjesë e teksteve, të cilat merren me ngjarjet në Kosovë, nuk i përmban përshkrimet e pësimeve të shqiptarëve, ashtu siç edhe në pjesët e mëhershme të tekstit, në të cilat përshkruhet situata shoqërore-politike në ish Jugosllavi pas Luftës së Dytë botërore, nuk flitet mbi shkaqet e kryengritjes së shqiptarëve në Kosovë dhe arsyet e vërteta të rezistencës së tyre ndaj bashkimit me Serbinë. “Krizat” në Kosovë, siç e cekin autorët, ka filluar me “provokimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, të cilën “bashkësia ndërkombëtare” (në tekst termi është në thonjëza) e ka përkrahur.⁶⁰⁰ Ceket e dhëna se në “agresionin e paktit të NATO-s” kanë pësuar “2.000 civilë dhe 462 ushtarë dhe policë”, si edhe se ardhjen e trupave të NATO-s në Kosovë pas përfundimit të intervenimit “e kanë përcjellë krime të shumta ndaj popullatës civile”, dhe se nga Kosova janë shpërngulur mbi 200.000 serb dhe popullatë tjetër joshqiptare.

590 APJ shihet në një fotografi, e cila është e nënshkruar me “Nacionalistët kroat në rrugët e Splitit i nxjerrin nga tanket ushtarët e APJ-së”.
Po aty, f. 184.

591 Po aty, f. 186.

592 Po aty, f. 185.

593 Po aty, f. 185.

594 Po aty, f. 185-186.

595 Po aty, f. 187.

596 Po aty, f. 184-188.

597 Radosh Ljushiq dhe Ljubodrag Dimiq, *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore (Istorija za osmi razred osnovne škole)*, (Freska, Beograd, 2010.), f. 238-239.

598 Po aty.

599 Po aty, f. 240.

600 Po aty.

Në lidhje me regjimin e Slobodan Millosheviqit, autori thotë se “ka përjetuar një numër të madh të sfidave” gjatë viteve nëntëdhjetë të shekullit 20-të, “midis të cilave duhet përmendur edhe demonstratat e opozitës, grindjet me udhëheqësit e Republika Srpska dhe Republikës së Krajines Serbe, sanksionet e bashkësisë ndërkombëtare, inflacionin e lartë, bombardimin nga pakti i NATO-s”, si dhe faktin se e gjithë kjo “ka ndikuar në rënien e popullaritetit të regjimit”, për çka edhe ai ka humbur në zgjedhje.⁶⁰¹ Autori arrin në përfundimin se “trashëgimia e Slobodan Millosheviqit (mungesa e shtetit ligjor, institucionet e rrënuara, shoqëria e kriminalizuar) ka përcaktuar fatin e Zoran Gjingjiqit”.⁶⁰²

Ministria e Arsimit ka dhënë rekomandimet e veta për përfshirjen e Hulumtimit të së Drejtës Humanitare të GJPNJ në lëndën e *Edukatës Qytetare* për shkollat e mesme, por realizimi i këtij rekomandimi ka ngecur për shkak të reformës së shkollave të mesme dhe planeve e programeve të tyre, të cilat priten në periudhën në vijim. Programi është akredituar në Ministrinë e Arsimit për zhvillim profesional të arsimtarëve dhe nëpër këtë trajnim kanë kaluar rreth 350 profesorë të shkollave të mesme.⁶⁰³

6.4. Kosova

Nuk ka ndryshime në politikën arsimore të Kosovës ndaj ngjarjeve të periudhës së konfliktit, por edhe më tutje janë në shfrytëzim tekste shkollorë të cilat kanë qenë në përdorim gjatë viteve të fundit. Në tekstet, të cilat janë në shfrytëzim, nuk ka ndryshime të përmbajtjes dhe ngjarjet e kontestueshme janë paraqitur nga perspektiva e shqiptarëve dhe, së këndejmi, nuk përmenden krimet kundër serbëve dhe joshqiptarëve të tjerë në periudhën prej vitit 1998 deri në vitin 2000.⁶⁰⁴

Po ashtu, edhe më tutje të gjitha shkollat e shfrytëzojnë programin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës, pos shkollat të cilat i vijnë shumica e serbëve dhe e goranëve. Në ato shkolla, në ambientet me shumicë të popullatës serbe dhe në Gorë (në Dragash dhe në fshatrat e përreth), fëmijët e vijnë mësimin sipas programeve shkollorë të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë dhe në gjuhën serbe. Për shkak të gjuhës serbe të cilin e përdorin goranët, shumica e goranëve në Dragash më me dëshirë i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollat të cilat i shfrytëzojnë programet e Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Kjo vlen për arsimin fillor dhe të mesëm në komunën e Dragashit. Goranët në sistemin e arsimit kosovar më së shumti janë të integruar në komunat e Pejës dhe të Prishtinës, gjë që shpjegohet me numrin e vogël të goranëve në këto rajone.⁶⁰⁵

6.5. Mali i Zi

Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Mal të Zi edhe gjatë viteve 2010 dhe 2011 kanë mundur ekskluzivisht të përdorin vetëm tekstet e Entit për Tekste dhe Mjete Mësimore të Podgoricës.

Materien për shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftërat të cilat e kanë përcjellë atë, nxënësit e klasës së nëntë (të fundit) të shkollës fillore edhe më tutje e kanë mësuar nga teksti, autor të të cilit janë Sllavko Burzanoviq dhe Jasmina Gjorgjeviq.⁶⁰⁶ Nxënësit e klasës së katërt të gjimnazit edhe më tutje kanë mësuar nga dy tekste: të parit, të vitit 2003, autor të të cilit janë Sherbo Rastoder, Radoje Pajoviq dhe Zvezdan Foliq, dhe të dytit, të vitit 2009, autor të të cilit janë Sherbo Rastoder, Dragutin Papoviq dhe Sait Shabotiq.⁶⁰⁷

Në të vetmin leksion të tekstit për klasën e nëntë të shkollës fillore, që i kushtohet luftës në ish Jugosllavi, edhe

601 *Po aty*, f. 241.

602 *Po aty*, f. 241.

603 Informacion i marrë nga Dragana Kojiq, drejtoreshë e delegacionit rajonal të KNKK, i datës 25 janar të vitit 2012.

604 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 53.

605 Informacion i marrë nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë.

606 Intervistë me telefon me Biljana Miranoviqin, redaktoren e tekstit të historisë në Entin për tekste dhe Mjete mësimore, e datës 8 dhjetor të vitit 2011.

607 Intervistë me telefon me Radovan Popoviqin, mbikëqyrësin për histori të Entit për shkolla, 8 dhjetor 2011.

më tutje nuk ceken krimet të cilat kanë ndodhur në Mal të Zi (Kalugjerski Laz, Bukovica, Morinj, deportimi i refugjatëve bosanas).⁶⁰⁸ Përmbajtja e këtij leksioni është e ngjashme me përmbajtjen e leksionit të tekstit të vitit të katërt të gjimnazit të Rastoderit, Pajoviqit dhe Foliqit.⁶⁰⁹

Që nga viti shkollor 2009–2010, nxënësit e gjimnazit në Mal të Zi shfrytëzojnë botimin e ri të tekstit të historisë për klasën e katërt, të autorëve Rastoder, Papoviq dhe Shabotiq.⁶¹⁰ Për shkak të qëndrimit posaçërisht të shprehur kritik lidhur me rolin e qeverisë së asaj kohe gjatë sulmit në Dubrovnik, rolit të mitropolitit Amfilohije, APJ-së dhe vullnetarëve, cekjes së krimeve në fshatrat Bukovica te Plevanja, kampi në Morinj, teksti ka hasur në kritika të shumta të palëve, të shoqatave dhe të individëve.⁶¹¹

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka kërkuar që Këshilli mbi arsimin e përgjithshëm të rishikojë disa përmbajtje të caktuara të tekstit, kurse në mbledhjen e Këshillit, të mbajtur në datën 26 janar të vitit 2010, është sjellë vendimi që deri në fund të vitit nxënësit të mësojnë edhe nga tekstet e vjetra.⁶¹² Është rekomanduar formimi i komisionit recensues për tekstin kontraverz të historisë.⁶¹³ Enti për tekste dhe për mjete mësimore ka njoftuar publikimin e konkursit për tekstin e ri, por ai nuk është shpallur deri në fund të vitit 2011.⁶¹⁴

Nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë të shkollave fillore në Mal të Zi për lëndë obligative zgjedhore e kanë *Hulumtimin e të Drejtës Humanitare*, sipas programit të GJNPJ të vitit 2006. Këshilli për arsimin e përgjithshëm ka miratuar vendimin që HDH të futet si lëndë zgjedhore. Në vitin shkollor 2009/2010, orët e Hulumtimit të së Drejtës Ndërkombëtare i kanë vijuar 813 nxënës.⁶¹⁵

6.6. Maqedonia

Në të gjitha tekstet shkollore në shkollat fillore dhe të mesme deri në përfundim të vitit 2011 nuk ka përmbajtje të përfaqësuar të cilat flasin për konfliktin e vitit 2001.⁶¹⁶ Arsye të kësaj janë qëndrimet ende të ndara brenda shoqërisë maqedonase rreth asaj se çka në të vërtetë ka ndodhur në atë konflikt.⁶¹⁷

6.7. Sllovenia

Në tekstet të cilat janë në shfrytëzim në shkollat fillore dhe të mesme si dhe në ato profesionale në Slloveni, shumica e ngjarjeve nga periudha e pavarësimit të Sllovenisë janë përshkruar në mënyrë korrekte, por hetohet një sasi e konsiderueshme e njëanshmërisë në interpretimin e temave të lidhura me shpërbërjen e RSF të Jugosllavisë dhe konfliktet e armatosura të fundit.

608 Slavko Burzanoviq dhe Jasmina Gjorgjeviq, *Historia për klasën e nëntë të shkollës fillore (Istorija za deveti razred osnovne kole)* (Enti për tekste dhe mjete mësimore, Podgoricë, 2009); Analiza e hollësishme mund të shihet në: Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 54- 55.

609 Sherbo Rastoder, Radoje Pajoviq dhe Zvezdan Foliq, *Historia e klasës së katërtë të gjimnazit (Istorija za četvrti razred gimnazije)*, Enti për tekste dhe mjete mësimore, Podgoricë, 2003).

610 Sherbo Rastoder, Radoje Pajoviq dhe Zvezdan Foliq, *Historia e klasës së katërtë të gjimnazit (Istorija za četvrti razred gimnazije)*, Enti për tekste dhe për mjete mësimore, Podgoricë, 2009.); Analiza e hollësishme mund të shihet në: Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 55- 56.

611 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 56.

612 „Debat mbi tekstin e historisë“, *Puna arsimore* 1-2, 11 shkurt i vitit 2009, faqja e internetit http://www.prosvjetnirad.co.me/broj17-18_09g/10.htm.

613 „Me dy “histori” deri në fund të vitit shkollor”, faqja e internetit e *Portal Analitika*, 26 janar i vitit 2010; <http://www.portalanalitika.me/politika/vijesti/1664-sa-dvije-istorije-do-kraja-kolske-godine.html>.

614 Intervistë me telefon me Nagja Durkoviqin, kryeredaktoren dhe redaktoren e Entit për tekste dhe mjete mësimore, e datës 9 dhjetor të vitit 2011.

615 „Zbatimi i Hulumtimit të së Drejtës Humanitare në sistemin arsimor“; faqja e internetit e Entit për shkollat e Malit të Zi, http://www.zzs.gov.me/rubrike/projekti/projekti/humanitarno_pravo/.

616 Intervistë me Ljupço Spasovskin, udhëheqësin e shërbimit pedagogjik në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, 18 janar i vitit 2012.

617 *Po aty*.

Tekstet shkollorë për klasën e nëntë të shkollës fillore e shqyrtojnë krizën në vitet tetëdhjetë në RSFJ, pavarësimin e Sllovenisë dhe fundin e socializmit. Në tekstin shkollor „Shekujt tonë“ thuhet se kryeministri i fundit jugosllav Ante Marković „nuk ka pasur shumë fuqi politike dhe gjatë gjithë kohës ka bërë lëshime, para së gjithash ndaj Serbisë dhe APJ-së“, gjë që është treguar edhe kur në muajin janar të vitit 1991 „Serbia, me ndihmën e njerëzve të vet në Bankën Popullore të Jugosllavisë ka marrë rreth 1,4 miliard dollarë për pensionet dhe humbjet në bankat e veta“. Për demonstratat në Kosovë të vitit 1991 shkruhet se kanë qenë „nacionale dhe sociale“ dhe se popullsia shumicë shqiptare ka kërkuar „që Kosova të bëhet republikë me të drejtën për vetëvendosje dhe bashkim të mundshëm me Shqipërinë“, dhe se autoritetet jugosllave demonstratat „i kanë shtypur me ushtri dhe polici“. Luftërave në Kroaci dhe B dhe H në këtë tekst i është kushtuar një faqe.⁶¹⁸ Teksti e cek se në B dhe H „Janë përlëshur tre popuj, myslimanët, serbët dhe kroatët“ të cilët përpara kanë „jetuar në bashkëjetesë“, kurse pasojë e luftës dhe të spastrimit etnik kanë qenë „masat e refugjatëve, numri i të cilave ka kaluar shifrën prej 2,5 milionëve, që është më shumë se gjysma e popullatës së asaj republike“, derisa „shtetet evropiane vakët i janë përgjigjur luftës“. Në tekstin „Shekulli 20-të“, autorët e cekin se kryetari serb Slobodan Milosheviq dhe politikanët besnik të tij, të cilët kanë qenë kundër propozimit të konfederalizimit të Jugosllavisë, „me ndihmën e ushtrisë jugosllave kanë filluar t’i armatosin serbët jashtë Serbisë dhe ta shkaktojnë konfliktin e armatosur“ dhe me këtë „kanë sjellë deri te luftërat shumëvjeçare, të cilave Sllovenia ia ka dalë t’iu shmanget“.⁶¹⁹

Në tekstet për klasën e nëntë të shkollës fillore „E hulumtoj të kaluarën“, në mënyrë të hollësishme është paraqitur interpretimi i konflikteve midis Sllovenisë dhe Serbisë.⁶²⁰ Autorët, duke ua atribuar qëndrimet e udhëheqjeve politike të gjithë pjesëtarëve të popujve të veçantë (në RSFJ) e cekin se „tensionet midis sllovenëve dhe serbëve kanë zgjatur qysh nga mesi i viteve tetëdhjetë, kur është bërë e qartë se në Slloveni dhe Serbi zbatohen dy drejtime të kundërta ekonomike dhe politike; sllovenët e kanë përkrahur demokratizimin dhe bashkëpunimin me Evropën, derisa serbët janë përcaktuar për një Jugosllavi të mbyllur dhe i kanë bërë thirrje të kaluarës së tyre të lavdishme“.

Tekstet për klasën e katërt të gjimnazit në mënyrë precize e përshkruajnë procesin e pavarësimit të Sllovenisë dhe shpërbërjen e RSFJ-së.⁶²¹ Në fillim të kapitullit mbi shpërbërjen e Jugosllavisë shkruan se gjatë kërkimit të rrugëdaljeve nga kriza janë formuar dy koncepte - „ai serb dhe slloven“, me ç’rast udhëheqësi i komunistëve serb „ka marrë konceptin serbomadh“, të cilin, si program nacional, e ka formësuar ASSHA dhe ka kërkuar „ndryshimin e parimeve (kon)federale të kushtetutës jugosllave të vitit 1974, viktima më e madhe e të cilit është populli serb, i cili jeton në disa republika“.⁶²² Qëndrimi i këtyllë është mbajtur edhe në botimet e mëvonshme të teksteve për klasën e katërt të gjimnazit, të cilat i kanë përgatitur autorët e tjerë.⁶²³ Më tutje, aty shkruan se politikën e tillë e ka përkrahur edhe APJ, në të cilën „mbi mesataren kanë qenë të përfaqësuar serbët dhe malazezët“. Në tekst thuhet se Serbia me „sloganin – të gjithë serbët në një shtet“ ka hapur „çështjen e kufijve ekzistues midis republikave“, derisa për dominim të popullit më të madh më së shumti ka qenë e etur politika serbe, e cila ka „dashur të sigurojë me grumbullimin masiv të masave të ndezura qëllimin e përkrahjes për Slobodan Milosheviqin. “Për këtë arsye, “ndryshe nga Evropa Lindore, ku sistemi komunist është shembur, politika serbe e ka mbrojtur atë sistem dhe ka filluar për ta shfrytëzuar për arritjen e qëllimeve të veta në Jugosllavi“. Në kapitullin, në të cilin përshkruhet pavarësimi i Sllovenisë, shkruan se „automjetet e blinduara të ushtrisë jugosllave në pyllin krakovian kanë qenë pre e lehtë e territorialistëve slloven, kur edhe ushtria jugosllave ka qenë „e detyruar të tërhiqet“ nga Sllovenia.⁶²⁴ Lufta në pjesën tjetër të ish shtetit të përbashkët fare nuk është përshkruar, nëse përjashtohet një fjali nën fotografinë e refugjatëve, ku shkruan se në pjesët e tjera të Jugosllavisë „është ndezur një nga luftërat më të përgjakshme të kohës bashkëkohore“. Në tekstin e historisë për shkollat teknike dhe profesionale „Historia 2“ në lidhje me luftën në Slloveni shkruan se menjëherë pas shpalljes së pavarësisë „ka filluar intervenimi i ushtrisë jugosllave“, por nuk është përshkruar qëllimi i këtij intervenimi dhe as që janë dhënë informacione më të hol-

618 Ana Nushaa Kern, Dushan Neqak, Bozho Repe, *Shekulli ynë (Naše stoletje)*, Modrijan, Lubjanë, 2005.), f. 211-226.

619 Ervin Dolenc, Alesh Gabriç, Marjan Rode, *Shekulli 20. (20. Stoletje)*, DZS, Lubjanë, 2008.), f. 164.

620 Jelka Razpotnik, Damjan Snoj, *Raziskujem pretoklost 9*, (Rokus, Lubjanë, 2005.), f. 169.

621 Ervin Dolenc, Alesh Gabriç, *Zgodovina 4*, (DZS, Lubjanë, 2002.), f. 242-247.

622 *Po aty*.

623 Alesh Gabriç, Mateja Rezhak, *Zgodovina 4*, (DZS, Lubjanë, 2011.), f. 208.

624 Ervin Dolenc, Alesh Gabriç, *Zgodovina 4* (DZS, Lubjanë, 2002.), f. 246.

lësishme. Nuk përmendet as fakti se APJ ka intervenuar pas vendimit të qeverisë federative. MT Sllovene, sipas vlerësimit të autorit të tekstit, „e ka paaftësuar ushtrinë“, në mënyrë që konflikti me APJ-në të jetë i përfunduar pas ndërmjetësimit të Bashkësisë Evropiane, përkatësisht takimit në Brione, ku kanë “vazhduar negociatat midis Sllovenisë, Kroacisë dhe Serbisë”.⁶²⁵

Në tekstet e përmendura shkollore nuk përmenden „personat e fshirë“ në Slloveni dhe as edhe faktet lidhur me këto ngjarje.

V. Reparacionet

1. Rezume

Ligjet që rregullojnë statusin dhe të drejtat e viktimave civile të luftës, në shumicën e shteteve post-jugosllave kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me periudhën e mëparshme, dhe ende janë evidente mangësi të shumta në fushën e drejtësisë tranzicionale. Në shumicën e shteteve, të drejtën për reparacione administrative ende e kanë vetëm civilët dhe ushtarët që kanë pësuar lëndim trupor, kurse pasojat e keqtrajtimit duhet t’i dëshmojnë me prova për t’i fituar këto të drejta. Viktimat që nuk i plotësojnë këto kërkesa, ose që nuk kanë dëmtime fizike si pasojë e keqtrajtimit gjatë konflikteve të armatosura, në shumicën e shteteve post-jugosllave nuk kanë statusin e viktimave civile të luftës. Përjashtim është BeH, ku ligji parashikon që viktimat e dhunimit dhe të keqtrajtimit seksual kanë të drejtë për kompensim, pa kushtin e dëshmimit me prova të dëmtimit trupor.

Në periudhën e kaluar, personat të cilët kanë qenë të burgosur në kampe, gjithashtu në shumicën e shteteve është dashur të provojnë lëndimin trupor, dhe me përjashtim të Kroacisë, vetë qëndrimi në kamp nuk ka qenë i mjaftueshëm për të fituar të drejtën për kompensim. Sa i përket personave që kanë qenë të ndaluar në kampe, mund të pritet përparim në Kosovë, ku nga fundi i vitit 2011 është miratuar Ligji që rregullon statusin, të drejtat dhe përfitimet e viktimave civile dhe ushtarake të luftës. Me këtë ligj është parashikuar që për njohjen e statusit të të burgosurit civil dhe luftarak mjafton qëndrimi në kamp.

Kosova ka bërë përparim përkitazi me masat e reparacionit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut jashtë konflikteve të armatosura, por në lidhje me to. Atje në vitin 2010 është nxjerrë Ligji i cili rregullon statusin ligjor, të drejtat dhe përfitimet e kësaj kategorie, numerikisht të madhe, të viktimave.

Në të gjitha shtetet post-jugosllave edhe më tej janë në fuqi dispozitat diskriminuese të cilat rregullojnë statusin, të drejtat dhe përfitimet e viktimave të luftës, porse të cilat janë të pavolitshme për civilët në krahasim me luftëtarët përkitazi me kushtet për njohjen e statusit të invalidit të luftës, me lartësinë e kompensimeve dhe me vëllimin e përfitimeve.

Pavarësisht nga numri i madh i kërkesë padive për kompensimin e dëmit që janë ngritur në gjykatat e të gjithë rajonit, edhe më tej, një numër fare i vogël i viktimave arrin që në rrugë gjyqësore të realizojë kompensimin e dëmit, i cili u është shkaktuar gjatë konflikteve të armatosura. Në këtë ndikon, si kohëzgjatja e madhe e procedurës, interpretimi i dispozitave ligjore që rregullojnë parashkrimin e kërkesave të tyre në dëm të viktimave, aplikimi i një standardi jashtëzakonisht të lartë të dëshmimit, trajtimi joadekuat i viktimave dhe shpallja e gjykatave jokompetente. Prandaj, viktimat gjithnjë e më shumë kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre para institucioneve ndërkombëtare. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vitin 2010, ka nxjerrë një aktgjykim të shkallës së parë lidhur me rastin e dhjetë qytetarëve “të fshirë” të Sllovenisë, ku është konstatuar se Sllovenia në këtë rast ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mundësuar kështu krijimin e hapësirës për të rregulluar në të ardhmen statusin e këtyre personave në Slloveni.

Ashtu si në periudhën e mëparshme, në pothuajse të gjitha vendet post-jugosllave po ngrihen memoriale ekskluzivisht për të përkujtuar viktimat-pjesëtarë të kombit shumicë. Vetëm në Mal të Zi është ngritur një

625 Stane Berzelak, *Zgodovina 2*, (Modrijan, Lubjanë, 2003.), f. 186-203.

monument përkujtimor kushtuar të gjithë viktimave civile që kanë pësuar në konfliktet e armatosura gjatë viteve 1991-2001. Një numër i vogël i këtyre monumenteve të ngritura në rajon është rezultat i iniciativave private ose i përpjekjeve nga ana e vetë familjeve të viktimave, pa ndonjë pjesëmarrje të qeverisë dhe shpesh herë edhe pa leje të domosdoshme. Në disa raste, autoritetet kanë ndaluar apo larguar përmendoret e këtilla.

2. Reparacionet materiale

2.1. Bosnja e Hercegovina

2.1.1. Reparacionet materiale administrative

Iniciativa për nxjerrjen e ligjit shtetëror për të drejtat e viktimave civile të luftës dhe të viktimave të torturës, e ngritur qysh në vitin 2006, deri në fund të vitit 2011 nuk ka dhënë rezultate konkrete. Edhe pse grupi i punës i Ministrisë për të Drejtat e Njeriut ka hartuar këtë projekt ligj, ky nuk ka marrë pëlqimin e qeverive të entiteteve deri në fund të vitit 2011.⁶²⁶ Miratimi i këtij ligji me të cilin do të rregullohet statusi i viktimave civile të luftës në nivel të tërë shtetit dhe do të përmirësohet definitivisht statusi i viktimave të torturës, që e kanë përjetuar në kampet e burgosjes, parashikohet jo më vonë se deri në vitin e ardhshëm.⁶²⁷

Me përjashtim të familjeve të personave të zhdukur, përfitimet financiare për të gjitha kategoritë e viktimave në Bosnje dhe Hercegovinë nuk janë të rregulluar në nivel shteti, por në nivel entiteti, dhe kjo në masë të madhe ndikon në dallimin në të ardhura të kategorive të caktuara të viktimave civile, varësisht nga ajo se në cilin entitet e kanë vendbanimin.⁶²⁸

Në Bosnje dhe Hercegovinë, Ligji për personat e zhdukur edhe më tej është i vetmi ligj i cili rregullon reparacionet materiale administrative për kategorinë specifike të viktimave të luftës, e i cili implementohet në nivel shtetëror.⁶²⁹ Mbështetja financiare mujore për familjet e personave të zhdukur kap shumën 25 për qind të pagës mesatare të paguar në Bosnje e Hercegovinë për tremujorin paraprak, që përlllogaritet veç e veç për çdo shfrytëzues. Paga mesatare në BdheH, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Bosnjës e Hercegovinës në vitin 2010 ka qenë 798 MK (afërsisht rreth 400 euro),⁶³⁰ në bazë të së cilës baza e pagesës mujore për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur ka qenë rreth 200 MK (afërsisht 102 euro).

Ligji për personat e zhdukur në BdheH është aprovuar qysh në vitin 2004, por ende nuk është krijuar Fond për mbështetjen e familjeve të personave të zhdukur të Bosnjës dhe Hercegovinës, gjë që edhe më tepër e rëndon statusin e familjeve të personave të zhdukur.

2.1.1.1. Federata e BdheH

E drejta për të marrë një shumë mujore në para në Federatën e BdheH edhe më tej caktohet sipas shkallës së invaliditetit që ka pësuar një person i mbijetuar dhe e cila gjë duhet të provohet, si në rastin e viktimave civile të luftës, ashtu të luftëtarëve. Sikurse edhe në vitet e mëparshme, janë evidente dallime të mëdha në lartësinë e pensionit invalidor për viktimat ushtarake dhe civile të luftës.⁶³¹ Përveç kësaj, një problem shtesë për viktimat civile të luftës paraqet edhe mundësia e humbjes së të drejtës për pension invalidor pas rehabilitimit nga lëndimet e marra si pasojë e operacioneve luftarake.

626 Komunikim me email me Ruzmira Gaçoo, bashkëpunëtoresh profesionale në Ministrinë për të Drejta të Njeriut dhe Refugjatë e BdheH, i datës 18 janar të vitit 2012.

627 „Moskujdesi i shtetit të BdheH: në luftë - viktimat të torturës, sot –viktimat të politikës“, faqja e internetit e *Radio Evropa e Lirë*, më 20 maj 2012, <http://www.slobodnaevropa.org/content/u-ratu-zrtve-torture-danas-zrtve-politike/24586988.html>.

628 Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumente & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: raport për vitin 2009*, f. 58.

629 Ligji për personat e zhdukur, *Gazeta zyrtare e BdheH*, Nr. 50/04.

630 Agjencia Statistikore e Bosnjës dhe Hercegovinës, faqja e internetit, http://www.bhas.ba/saopstenja/NPL_2000_2010_bh.pdf.

631 Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumente & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: raport për vitin 2009*, f. 57.

Statusi dhe të drejtat e viktimave të dhunimeve në luftë dhe të dhunës seksuale edhe më tej janë të rregulluara me Ligjin për bazat e mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së viktimave civile të luftës dhe të mbrojtjes së familjeve me fëmijë, si kategori e posaçme e viktimave civile të luftës.⁶³² Kompensimi mujor për viktimat e dhunimit në Federatë kap shumë afërsisht prej 280 euro,⁶³³ mirëpo këta persona edhe më tej duhet të provojnë statusin e vet të viktimës civile duke paraqitur prova se i janë drejtuar ndonjë organizate apo institucioni për ndihmë psiko-sociale, por pa dokumentacion mjekësor.

Zgjidhjet ligjore problematike mbeten në fuqi deri sa të mos nxirret ligji i ri shtetëror lidhur me statusin e personave që i kanë mbijetuar torturës dhe trajtimit çnjerëzor në kampe gjatë luftës. Ata mund të realizojnë të drejtën për kompensim mujor dhe të drejtat e tjera nga buxhetet e kantoneve, të komunave ose të entiteteve vetëm nëse shëndeti i tyre është dëmtuar të paktën 60 për qind.⁶³⁴ Të tjerët, të drejtat e veta mund t'i kërkojnë vetëm në rrugë gjyqësore.⁶³⁵

Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, gjatë vitit 2010, 5.157 persona kanë realizuar të drejtat mbi bazën e invaliditetit sipas statusit të viktimës civile të luftës, ndërsa ky numër në vitin 2011 ka qenë 5.143 persona. Dhënit në para për viktimat civile të luftës në vitet 2010 dhe 2011 nuk kanë ndryshuar krahasuar me vitin 2009. Ato sigurohen me participim, përkatësisht 70 për qind nga buxheti i Federatës së B dhe H, kurse 30 për qind nga buxheti i Kantonit. Kanë kapur shumë prej 101,51 MK deri në 563,95 MK. Sa për krahasim, paga mujore në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, sipas të dhënave të Entit Federal të Statistikave, në tetor të vitit 2011 ka qenë 817,67 MK (419 euro).⁶³⁶ Si anëtarë të familjeve të civilëve të vrarë në Federatën e B dhe H, gjatë vitit 2010, të drejtën për kompensim në para e kanë realizuar 5.746 persona, kurse gjatë viti 2011- 5.581 persona.⁶³⁷

2.1.1.2. Republika Srpska

Në Republika Srpska pensionet invalidore për invalidët ushtarakë të luftës ndahen në bazë të Ligjit për të drejtat e luftëtarëve, të invalidëve ushtarakë dhe të familjeve të luftëtarëve të rënë në Luftën për mbrojtjen e atdheut të Republika Srpskës.⁶³⁸ Statusi i invalidëve ushtarakë të luftës dhe i familjeve të luftëtarëve edhe më tej është më i mirë se statusi i viktimave civile të luftës, në radhë të parë përkitazi me shumën e përfitimeve mujore në para dhe me përqindjen e dëmtimit në bazë të së cilës vlerësohet invaliditeti. Shuma e kompensimit të cilën e kanë marrë invalidët civilë të luftës ka lëvizur nga 112 MK deri në 1.125 MK (nga 57 deri në 575 euro). Invalidët ushtarakë të luftës kanë marrë shuma duke filluar nga 25 MK deri në 1.825 MK (nga 13 deri në 933 euro). Mjetet sigurohen nga Buxheti i Republika Srpskës, nga Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes së Luftëtarëve-të Invalidëve.⁶³⁹ Ligji për mbrojtjen e viktimave civile të luftës rregullon të drejtat dhe përfitimet e viktimave civile të luftës dhe të anëtarëve të familjeve të viktimave civile të luftës, të vrara, të rëna, të vdekura ose të zhdukura.⁶⁴⁰ Sipas Ligjit për mbrojtjen e viktimave civile të luftës, viktimë civile e luftës mund të shpallet personi, organizmi i të cilit është dëmtuar të paktën 60% për shkak të plagës, lëndimit ose të dëmtimit, ndërsa për invalidët ushtarakë të luftës është i domosdoshëm dëmtimi prej të paktën 20%.⁶⁴¹

632 (Gazeta zyrtare e Federatës së B dhe H (36/99; 54/04; 39/06; 14/09).

633 Shkresë e Ministrisë Federale të Punës dhe të Politikës Sociale të BeH, e datës 10 janar të vitit 2012.

634 Me ndryshimet e Ligjit për bazat e mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së viktimave civile të luftës dhe të mbrojtjes së familjeve me fëmijë të vitit 2006, dëmtimi i organizmit ka mundur të jetë edhe i natyrës mendore dhe jo vetëm i asaj trupore (fizike).

635 "Viktimat e luftës në B dhe H edhe më tej kërkojnë kompensim", faqja e internetit e Qendra për Drejtësi dhe Pajtim, <http://cjr.ba/bs/page.php?id=74>.

636 Faqja e internetit e Entit Federal të Statistikave, Federata e B dhe H, www.fzs.ba.

637 Informacion i marrë nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale e Federatës së B dhe H, i datës 10 janar të vitit 2012.

638 Gazeta zyrtare e Republika Srpska Nr. 134/11.

639 Përgjigje me postë elektronike e Maja Radetiçiqit, Shërbimi për komunikim me publikun, Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes Invalidore-të Luftëtarëve e Republika Srpska, më 25. janar 2012

640 Ligji për mbrojtjen e viktimave civile të luftës, neni 2, Gazeta zyrtare e Republika Srpska Nr. 24/10.

641 Ligji për mbrojtjen e viktimave civile të luftës, neni 2, Gazeta zyrtare e Republika Srpska Nr. 24/10.10; Ligji për të Drejtat e luftëtarëve, e invalidëve ushtarakë dhe të familjeve të luftëtarëve të rënë në Luftën për Mbrojtjen e Atdheut të Republika Srpska, neni 5, Gazeta zyrtare e Republika Srpska, Nr. 134/11.

Në vitin 2010, kanë qenë 1.725 përfitues të kompensimit mujor për invalidë civil të luftës, kurse në vitin 2011, 1.654 përfitues.⁶⁴² Numri i invalidëve ushtarak të luftës është më i madh dhe ky numër në vitin 2010 është 36.452 përfitues, kurse në vitin 2011- 35.629 përfitues.⁶⁴³ Pension invalidor familjar për anëtarët e familjeve të civilëve të vrarë në Republika Srpska, nga fundi i viti 2010 kanë marrë 2.051 përfitues. Në dhjetor të vitit 2011 ky numër ka qenë 2.005 përfitues. Pension invalidor familjar për anëtarët e familjeve të personave të vrarë me status ushtari në Republika Srpska, në vitin u 2010 kanë marrë 30.717 përfitues, kurse në vitin 2011, gjithsej 29.224 përfitues.⁶⁴⁴ Pensioni invalidor familjar përfshin edhe pensionet invalidore familjare të personave të zhdukur.

Statusi i viktimave të dhunimit në Republika Srpska edhe më tej është më i keq se në Federatën e B dhe H. Shuma e kompensimit mujor është ende dukshëm më e ulët (në krahasim me rreth 280 euro në Federatë, në Republika Srpska viktimat e dhunimit marrin mesatarisht në muaj prej 50-150 euro). Përveç kësaj, viktimat e dhunimit në Republika Srpska edhe më tej janë të detyruara të paraqesin dokumentacionin mjekësor për dëmtimin e organizimit prej të paktën 60% në mënyrë që të provojnë statusin e viktimave civile të luftës.⁶⁴⁵

2.1.2. Reparacionet materiale na bazë të vendimeve gjyqësore

Deri në fund të vitit 2011, në B dhe H janë nxjerrë gjithsej rreth 20 aktgjykime lidhur me këto lëndë, mirëpo paratë kurrë nuk janë paguar.⁶⁴⁶ Përfaqësuesit e gjykatave dhe shoqatat e viktimave theksojnë se në disa raste kompensimet janë caktuar në shumë prej 20 MK, kurse në disa raste prej 200, e madje edhe prej 500 MK në ditë ta kaluar në kamp.⁶⁴⁷

Më së shumti padi kundër Federatës së B dhe H, nëpërmjet shoqatave të veta, kanë ngritur personat të cilat i kanë mbijetuar trajtimit çnjerëzor dhe torturës në kampe anekënd Bosnjës dhe Hercegovinës.⁶⁴⁸ Anëtarët e Shoqatës së të Burgosurve në Kampe të Bosnjës e Hercegovinës deri tani kanë ngritur mbi 15.000 padi në gjykatat lokale, kurse shumica e tyre, afërsisht 12.000 padi janë ngritur kundër Republika Srpskës.⁶⁴⁹ Gjatë viteve 2010 dhe 2011, paditë e ngritura kundër Republika Srpskës janë tërhequr dhe këto janë paraqitur në gjykatat e Federatës së B dhe H.⁶⁵⁰ Një pjesë e madhe e padive sërish u janë dërguar nga ana e gjykatave të Federatës gjykatave në Republika Srpska. Sipas deklaratave të Prokurorit të Republika Srpskës, deri në fund të vitit 2011 janë pranuar rreth 4.000 padi nga Federata e B dhe H.⁶⁵¹ Anëtarët e Shoqatës së të Burgosurve në Kampe të B dhe H, nuk kanë ngritur

642 Përgjigje me postë elektronike e Ivanica Shpanjiq – Rakiqit, Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes invalidore-të luftëtarëve e Republika Srpska, e datës 11 janar të vitit 2012.

643 *Po aty*.

644 Përgjigje me postë elektronike e Ivanica Shpanjiq – Rakiqit, Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes invalidore- të luftëtarëve e Republika Srpska, e datës 11 janar të vitit 2012.

645 Ligji për mbrojtjen e viktimave civile të luftës, *Gazeta zyrtare e Republika Srpska*, Nr. 25/93, ndryshimet dhe plotësimet e fundit 10/24, neni 2.

646 „Viktimat e luftës në B dhe H edhe më tej kërkojnë kompensim“, faqja e internetit *IWPR*, <http://iwpr.net/sr/report-news/%C5%Bertve-rata-u-bih-i-dalje-tra%C5%BEE-kompenzaciju>.

647 „Ish-të burgosurit e kampeve kanë ngritur 56 padi kundër Federatës së B dhe H“, faqja e internetit *Press-online Republika Srpska*, më 22 Shkurt 2012 http://pressrs.ba/sr/vesti/vesti_dana/story/10465/Biv%C5%A1i+logora%C5%A1i+podneli+56+tu%C5%BEBi+protiv+Federacije+BiH.html.

648 Në përputhje me dispozitat e Ligjit për bazat e mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së viktimave civile të luftës dhe të mbrojtjes së familjeve me fëmijë, vetëm ata persona që kanë përjetuar torturë dhe trajtim çnjerëzor në kampe gjatë luftës, dhe që dëmtimi i shëndetit të tyre të jetë 60 për qind, mund të realizojnë të drejtën për kompensim mujor nga buxhetet e kantoneve, të komunave dhe të entiteteve, si dhe kategoritë e tjera të viktimave civile të luftës. Të tjerët, të drejtat e veta në Federatën e Bosnjës e Hercegovinës, mund t'i kërkojnë vetëm në rrugë gjyqësore. Ligji për bazat e mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së viktimave civile të luftës dhe të mbrojtjes së familjeve me fëmijë, (*Gazeta zyrtare e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës* 36/99; 54/04; 39/ 06; 14/ 09, neni 54.

649 „Viktimat e luftës në B dhe H edhe më tej kërkojnë kompensim“, faqja e internetit *Qendra për Paqe dhe Pajtim*, më 9 gusht 2011, <http://cjr.ba/bs/page.php?id=74>.

650 Sipas Murat Tahiroviqit, Kryetar i Shoqatës së të Burgosurve në Kampe të Bosnjës e Hercegovinës, kjo ka ndodhur ngase gjykatat në Republika Srpska u kanë bërë obstrukcion padive. “Të burgosurit e kampeve nga B dhe H kanë humbur kontestet kundër Serbisë”, faqja e internetit e gazetës *Politika*, më 5 nëntor 2011, <http://www.politika.rs/rubrike/region/Logorasi-iz-BiH-izgubili-spor-protiv-Srbije.lt.html>.

651 “RS: BeH po manipulon me tregimin për zhdëmtimet e luftës”, faqja e internetit e *Večernje novosti*, më 26 janar 2012, <http://www.novosti.rs/vesti/planeta.300.html:363546-RS-BiH-manipulise-pricom-o-ratnoj-odsteti>.

padi vetëm kundër Republika Srpskës, por rreth 4.000 padi janë ngritur edhe kundër FBdheH, kurse janë ngritur padi edhe kundër Serbisë. Anëtarët e Shoqatës së të burgosurve kroatë në kampe të luftës së atdhetare kanë filluar në vitin 2009 të ngrisin padi kryesisht kundër Federatës së BdheH dhe kanë ngritur rreth 4.000 padi deri në fund të vitit 2011. Anëtarët e Shoqatës së të Burgosurve në kampe të RS, nga viti 2008, kundër Federatës së BdheH kanë ngritur 536 padi për çdo kamp në të cilin, sipas të dhënave të tyre kanë qenë të burgosur serbët. Nga fundi i vitit 2011 janë ngritur 56 padi nga ana e boshnjakëve për kohën që e kanë kaluar në kampet e KKM-së gjatë viteve 1993 dhe 1994 në Gjykatën Kantonale të Livnos.⁶⁵²

Gjatë vitit 2011 janë nxjerrë disa nga aktgjykimet e para lidhur me këto raste. Gjykata Themelore në Trebinje, në tetor të vitit 2011 ka nxjerrë Aktgjykimin e parë jo të plotfuqishëm, sipas të cilit Federata e BdheH është e obliguar që ish të burgosurës në Kampin Dretel afër Çaplina t' i paguajë 100.000 MK për torturat dhe mundimet që i janë shkaktuar gjatë kohës së burgosjes, në bazë të padisë të cilën e ka ngritur Shoqata e të Burgosurve në Kampe e Republika Srpskës në emër të Shoqatës së të Burgosurve në Kampe të rajonit të Trebinjes.⁶⁵³ Ky është aktgjykimi i parë i nxjerrë në favor të Shoqatës së të Burgosurve në Kampe të Republika Srpskës dhe edhe pesë të tjera ekzistojnë në Gjykatën Themelore të Trebinjes. Shumë shpejtë janë nxjerrë edhe tri aktgjykime kundër Federatës së BdheH, mbi të njëjtën bazë.⁶⁵⁴ Nga fundi i vitit 2011, Gjykata Kantonale në Travnik, më 29 Nëntor të vitit 2011 ka nxjerrë aktgjykimin e parë të plotfuqishëm në bazë të padisë individuale kundër Federatës së B dhe H për torturën e ushtruar sipas të cilit ish të burgosurit e kampit nga Zenica, i cili ka qenë në Kampin *Kaonik* (nën mbikëqyrjen e KKM-së), i është ndarë dëmshpërblimi prej 200 markash konvertibile në ditë sa ka qëndruar në kamp.⁶⁵⁵

Në Prokurorinë e Republika Srpskës, në vitin 2010 janë evidentuar gjithsej 25.086 lëndë lidhur me reparacionet e luftës në një vlerë më të madhe se 845 milionë markash konvertibile. Në 4272 lëndë është arritur paqësimi kurse në 3.186 lëndë është pezulluar procedura, porse të dëmtuarit në 349 lëndë kanë paraqitur kundërshtime.⁶⁵⁶

Kur në vitin 2005 është nxjerrë Ligji për realizimin e të drejtës për kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar gjatë periudhës së operacioneve luftarake nga 20.05.1992 deri 19.06.1996, për paqësime kompetente ka qenë Prokuroria e Republika Srpskës, prandaj gjykatat janë shpallur jokompetente dhe lëndët e pranuar në mënyrë masive ia kanë dërguar Prokurorisë së Republika Srpskës.⁶⁵⁷ Mirëpo, një numër i madh lëndësh shumë shpejtë ka arritur në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, ku janë paraqitur ankesa ndaj vendimeve të prokurorisë të Republika Srpskës. Bëhet fjalë për ankesat e parashtruesve ndaj vendimeve masive të Prokurorisë së Republika Srpskes lidhur me llogaritjet në mënyrë paushalle të shumave të dëmshpërblimit të cilat shpesh herë kanë qenë më të ulëta në krahasim me ato të cilat në disa raste të tjera i ka caktuar gjykata. Parashtruesit e tyre janë ankuar se në këtë mënyrë iu është shkelur e drejta e pronës dhe e drejta për gjykim të drejtë. Gjykata Kushtetuese e BdheH ka konstatuar se ekziston shkelja e të drejtave të pronës, shkelja e të drejtave për qasje ndaj gjykatave dhe shkelja e të drejtave për pavarësinë e gjykatës.⁶⁵⁸ Kuvendi Popullor i Republika Srpskes, në datën 15 dhjetor të vitit 2008 ka miratuar Ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për kompensimin e dëmit material dhe jo material me të cilin është rregulluar që personat fizik, për shkak të zhdukjes së personit të afërm

652 „Ish-të burgosurit e kampeve kanë ngritur 56 padi kundër Federatës së BdheH”, faqja e internetit e Press-online Republika Srpska, më 22 Shkurt 2012, http://pressrs.ba/sr/vesti/vesti_dana/story/10465/Biv%C5%A1i+logora%C5%A1i+podneli+56+tu%C5%BEBi+protiv+Federacije+BiH.html.

653 “Drejtesia lokale – Trebinje: Aktgjykimi për shkak të torturës në kampe”, faqja e internetit *BIRN*, më 7 tetor 2011, <http://www.bim.ba/bh/290/10/33518/>.

654 “Trebinje: aktgjykime për burgosurit e kampeve, faqja e internetit *BIRN*, më 7 tetor 2011 <http://www.bim.ba/bh/303/10/34182/>; “Drejtesia lokale – Trebinje: Aktgjykim i ri për mbajtje në kamp”, faqja e internetit *BIRN*, 9 janar 2012, <http://www.bim.ba/bh/303/10/34183/>.

655 “Konfirmohet aktgjykimi i parë në bazë të padisë individuale nga një ish i burgosur i kampit”, faqja e internetit *TVI*, <http://www.tv1.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/dogadjaji/4274-video-potvrđena-prva-presuda-po-pojedinačnoj-tuzbi-jednog-bivseg-logorasa.html>.

656 Raport i punës së Prokurorisë së Republika Srpska në vitin 2010, f. 12.

657 Ligji për realizimin e të drejtës për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të shkaktuara gjatë periudhës së operacioneve luftarake nga data 20.05.1992. deri në datën 19.06.1996, *Gazeta zyrtare e RS*, Nr. 103/05, 1/09 dhe 49/09, neni 4.

658 Raport i punës së Prokurorisë së Republika Srpska në vitin 2010, f.13.

në periudhën e luftës, mund të realizojnë të drejtat për kompensimin e dëmit jo material duke lidhur paqësim në Prokurorinë e Republika Srpskes. Gjykata Kushtetuese e Republika Srpskes, në tetor të vitit 2009 ka nxjerrë edhe një vendim, ku thuhet se disa nene të këtij ligji nuk janë në përputhje me Kushtetutën kështu që në këtë mënyrë edhe ky ligj është shpallur jo kushtetues, sepse me „Akt të pushtetit legjislativ nuk mund të shtyhen për më vonë ekzekutimet e vendimeve të plotfuqishme dhe ekzekutuese të gjykatave dhe nuk mund të përcaktohen shumat fikse të dëmeve edhe atë dukshëm më të vogla nga shumat mbi të njëjtat baza, të caktuara në procedurat gjyqësore.⁶⁵⁹ Kuvendi Popullor i Republika Srpskes në datën 23 Dhjetor të vitit 2009 ka aprovuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për realizimin e të drejtave për kompensimin e dëmit material dhe jo material gjatë periudhës së operacioneve luftarake. Me këtë ligj, prioritet në prokurori kanë lëndët të cilat ekzistojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BdheH, me afate precize, e që kapin numrin prej 26.000.⁶⁶⁰

Në nëntor të vitit 2011, Kuvendi Popullor i Republika Srpskes ka aprovuar Ligjin për borxhin e brendshëm të Republika Srpskes me të cilin njihet e drejta për kompensim të dëmit material dhe jo material të shkaktuar gjatë periudhës së operacioneve luftarake duke filluar nga 20 Maji i vitit 1992 deri më 19 Qershor të vitit 1996, përkatësisht personave juridikë dhe personave fizikë të cilëve me vendime të plotfuqishme gjyqësore ose me paqësime jashtëgjyqësore u është njohur e drejta e dëmshpërblimit e gjithashtu edhe personave të përfshirë me Ligjin për realizimin e të drejtave për kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar gjatë periudhës së operacioneve luftarake duke filluar nga 20 Maji i vitit 1992 deri më 19 Qershor të vitit 1996.⁶⁶¹ Ligji njeh të drejtën e kompensimit të dëmit ku debitor është Republika Srpska, si dhe organet e vetëqeverisjes lokale. Është parashikuar që dëmshpërblimi të paguhet në fletobligacione të Republika Srpskes, të cilat me rastin e kompensimit të dëmit të shkaktuar gjatë periudhës së operacioneve luftarake rrjedhin për pagesë për 13 vjet.⁶⁶² Një motiv për nxjerrjen e këtij ligjit është frika që për shkak të „pranimit për çdo ditë të numrit të madh të padive të qytetarëve, ekziston rreziku i çrregullimit të stabilitetit makroekonomik dhe të qëndrueshmërisë fiskale“. Nga ana tjetër, shoqatat e viktimave konsiderojnë se ky ligj është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.⁶⁶³

Anëtarët e Shoqatës së Unionit të Viktimave Civile të Luftës të Kantonit të Sarajevës, në vitin 2010 kanë ngritur 4.200 padi kundër Republika Srpskes në Gjykatën Themelore të Sarajevës në emër të 4.200 personave të rasteve individuale për kompensimin e dëmit jo material të shkaktuar gjatë granatimit të Sarajevës.⁶⁶⁴ Prokuroria e Republika Srpskes konteston paditë për shkak të parashkrimit të tyre si dhe për faktin se kërkesat e paraqitura deri më tash kapërcejnë shumën prej 600 milionë MK. Prokurori i RS, Slobodan Rakulj konsideron se kërkesat në të vërtetë janë çështje e reparacioneve të luftës dhe konteston kompetencat e Gjykatës Themelore në Sarajevë.⁶⁶⁵ Gjykata Kantonale në Sarajevë, në muajin shtator të vitit 2011 ka nxjerrë aktvendimin kundër Republika Srpskes në favor të R. SH., për kompensimin e dëmit jo material në shumë prej 35.000 MK. Dëmi ka të bëjë me përjetimin e dhembjes shpirtërore për shkak të vrasjes së prindërve të R.Sh., të cilët janë zhdukur në Gerbavicë e të cilët Gjykata Komunale në Sarajevë i ka shpallur për të vdekur në ditën e zhdukjes së tyre (në korrik të vitit 1992).⁶⁶⁶

659 Vendim i Gjykatës Kushtetuese së RS, i datës 14 tetor të vitit 2009, faqja e internetit e Gjykatës Kushtetuese të Republika Srpska, <http://www.ustavnisud.org/Odluke.aspx?cat=13&subcat=39&lang=hrv&odluka=186&odldet=503>.

660 Raport i punës së Prokurorisë së Republika Srpska në vitin 2010, f. f.15.

661 Ligji për borxhin e brendshëm të Republika Srpska, *Gazeta zyrtare e Republika Srpska* Nr. 115/11, neni 11, paragrafi 1.

662 Një Ligj, pothuajse identik, për borxhin e brendshëm të Republika Srpska, është miratuar në vitin 2009, mirëpo Gjykata Kushtetuese e RS (GJKRS) disa dispozita të tij i ka shpallur jokushtetuese. Në Ligjin e ri janë bërë ndryshime në përputhje me rekomandimet e GJKRS: afati i rrjedhjes për pagesë të disa fletobligacioneve të përgjithshme është shkurtuar nga 15 në 14 vjet, kurse afati i rrjedhjes për pagesë të fletobligacioneve të emetuara mbi bazën e dëmeve materiale dhe jomateriale të shkaktuara gjatë periudhës së operacioneve luftarake, është shkurtuar nga 14 në 13 vjet; Arsyetimi i Ligjit për borxhin e brendshëm, (*Gazeta zyrtare e Republika Srpska*), Nr. 115/11.

663 “Viktimat e luftës: krimi nuk mund të paguhet me fletobligacione”, faqja e internetit e *Radio Evropa e Lirë*, më 13 dhjetor 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/zrtve_rata_zlocin_se_ne_moze_platiti_obveznicama/24420914.html.

664 Paditë, fillimisht janë paraqitur në Gjykatën Themelore të Banja Llukës në vitin 2007, ku kanë qëndruar dy vjet pa lëvizur fare. Pastaj, aktakuzat janë tërhequr dhe janë paraqitur në Gjykatën e Sarajevës, duke iu referuar kompetencës së gjykatës përkitazi me vendin ku ka ndodhur ngjarja. Intervistë me Muzafer Teskerexhiqin, sekretar i Unionit të Viktimave Civile të Luftës i Kantonit të Sarajevës, më 10 janar 2012.

665 “Fillojnë seancat gjyqësore lidhur me paditë e viktimave të luftës nga Sarajeva”, faqja e internetit *Radio Evropa e Lirë*, Maja Bjelajac, më 3 maj 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/sarajevske_civilne_zrtve_rocista/16798625.html.

666 Edina Kamenica, „Zhdëmtim për prindërit“, „Oslobodenje“, më 17 tetor 2011, f. 4.

2.2. Kroacia

2.2.1. Reparacionet materiale administrative

Për shkak të invaliditetit civil të shkaktuar gjatë luftës së viteve 1991-1995, 2.459 persona kanë marrë kompensime në vitin 2010.⁶⁶⁷ Sipas të dhënave nga muaji janar i vitit 2012, kanë qenë 58.099 luftëtarë – përfitues të pensionit invalidor.⁶⁶⁸

Kroacia edhe më tej dallon nga shtetet e tjera në territorin e ish Jugosllavisë përkitazi me kushtet për njohjen e statusit të invalidit civil të luftës. Invalid civil i luftës në Kroaci është ai person, organizmi i të cilit është dëmtuar të paktën 20% për shkak të plagëve ose lëndimeve që i ka pësuar.⁶⁶⁹ Mirëpo, në kornizën ligjore të Kroacisë nuk i gëzojnë të gjithë invalidët të njëjtat të drejta. Kështu, kategoria e invalidëve me organizëm të dëmtuar nën 80 % nuk kanë të drejtë shtese për kurim dhe ndihmë nga personi tjetër.⁶⁷⁰ Gjithashtu, edhe më tej përdoret definicioni i invalidit civil, me të cilin nuk veçohen kategoritë e posaçme duke marrë parasysh burimin e invaliditetit, përkatësisht llojin e keqtrajtimit, të cilit i është nënshtruar personi.⁶⁷¹ Për këtë arsye, p.sh., viktimat e dhunimit edhe më tej duhet t'i provojnë dëmtimet trupore ose psikike, të cilën gjë *Amnesty International* e vlerëson si kërkesë e cila është e pamundur ta plotësojnë viktimat.⁶⁷² Luftëtarët e forcave kroate të cilët kanë kaluar të paktën 3 ditë në kampin e armikut ose në burg, automatikisht konsiderohen 20% invalid, ndërsa e njëjta rregull nuk vlen për civilët të cilët kanë qenë të burgosur në kampe dhe të cilët duhet të provojnë dëmtimin e organizmit me anë të vërtetimit për shkakun dhe rrethanat nën të cilat ka ndodhur dëmtimi.⁶⁷³ Për shkak të një rregullimi të tillë diskriminues, numri më i madh i civilëve nuk ka realizuar të drejtat për pension invalidor personal.

Neni 9 i Ligjit për mbrojtjen e invalidëve civilë dhe ushtarakë të luftës në mënyrë eksplicite konteston të drejtat të cilat ky ligj i rregullon, për personat të cilët janë lënduar si „pjesëtarë, ndihmës ose bashkëpunëtorë të formacioneve ushtarake dhe paramilitare të armikut“.⁶⁷⁴

124

Të drejtat, të cilat parashikohen me këtë ligj, përveç kompensimeve në para, përfshijnë edhe rehabilitimin profesional, pastaj mjekimin, përkatësisht ndihmën për shpenzimet e mjekimit.⁶⁷⁵ Anëtarët e familjeve të personave të vrarë, të vdekur ose të zhdukur nën rrethanat e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e invalidëve civilë dhe ushtarakë të luftës mund të realizojnë të drejtën e kompensimit në formë të pensionit invalidor.

Pensionin invalidor personal për invalidët civilë, për grupin më të lartë (të parë) ka qenë 3.326 kuna (rreth 450 euro),⁶⁷⁶ kurse për luftëtarët shuma e pensionit invalidor mesatar në vitin 2010 ka qenë 5.285 kuna (rreth 715

667 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Kroacisë - Drejtoria për Mbrojtjen e Viktimave dhe të Pjesëmarrësve të Luftës, *Pasqyrë vjetore e numrit të shfrytëzuesve nga Sistemi i mbrojtjes së invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës*, më 31 dhjetor të vitit 2010, faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, http://www.mzss.hr/zdravstvo_i_socijalna_skrb/socijalna_skrb/uprava_za_zastitu_zrtava_i_sudionika_rata_.

668 Pasqyrë e numrit të shfrytëzuesve të pensioneve sipas llojeve dhe shumave mesatare të pensioneve, faqja e internetit e Entit të Sigurimeve Pensionale të Kroacisë, <http://www.mirovinsko.hr/UserDocsImages/korisnici%20mirovine%202012/km1za12.pdf>.

669 Ligji për mbrojtje e invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr.33/92 i 103/03, neni 8.

670 *Po aty*, neni.17.

671 *Po aty*, neni.8.

672 Amnesty International, *Briefing to the European Commission on the ongoing concerns over impunity for war crimes in Croatia*, tetor 2011, faqja e internetit e Amnesty International, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/EUR64/011/2011/en/fe82e4d9-3272-48f7-aaad-467e61fe65f3/eur640112011en.pdf>.

673 Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumentë & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave*: Raport për vitin 2009, f. 62.

674 Ligji për mbrojtjen e invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr. 33/92 dhe 103/03, neni 9.

675 *Po aty*, neni 14.

676 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Kroacisë - Drejtoria për Mbrojtjen e Viktimave dhe të Pjesëmarrësve të Luftës, *Pasqyrë vjetore e numrit të shfrytëzuesve nga Sistemi i mbrojtjes së invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës*, më 31 dhjetor 2010, faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, http://www.mzss.hr/zdravstvo_i_socijalna_skrb/socijalna_skrb/uprava_za_zastitu_zrtava_i_sudionika_rata_.

euro)⁶⁷⁷. Kur është fjala për anëtarët e familjeve të civilëve të vrarë dhe të invalidëve të vdekur civil të luftës, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale të Republikës së Kroacisë, prej datës 31 dhjetor të vitit 2010, 349 persona kanë qenë përfytyrës të pensioneve invalide familjare.⁶⁷⁸ Shumica e pjesëtarëve të vrarë dhe të zhdukur të forcave kroate gjatë luftës kanë statusin e mbrojtësve të vrarë dhe të zhdukur kështu që shteti, në janar të vitit 2012 ua ka paguar 11.954 pensione familjeve të këtyre personave.⁶⁷⁹ Pensioni mesatar për familjen e luftëtarit, në janar të vitit 2012 ka qenë 6.977 kuna (922 euro).⁶⁸⁰ Gjithashtu, shteti këtyre kategorive iu ka siguruar edhe një numër më të madh të drejtash, nga të cilat disa prej tyre janë të konsiderueshme, si për shembull furnizimi (ndihma sociale), e cila në muajin dhjetor të vitit 2010 ka qenë 1.098 kuna (149 euro).⁶⁸¹

2.2.2. Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore

Në vitin 2011 nuk është shënuar kurrfarë përparimi me raportin e shtetit ndaj viktimave civile të luftës, dhe nuk ka as ndryshime në praktikën gjyqësore.⁶⁸² Çështja e kompensimit të dëmit në Kroaci në mënyrë ligjore është rregulluar me anë të dy akteve ligjore: me Ligjin për Përgjegjësinë të Republikës së Kroacisë për dëmin e shkaktuar nga ana e pjesëtarëve të Forcave të Armatosura dhe ato Policore të Kroacisë gjatë Luftës Atdhetare⁶⁸³ dhe me Ligjin për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga aktet terroriste dhe nga demonstratat publike⁶⁸⁴.

Të dëmtuarit, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe institucionet ndërkombëtare tashmë vite me radhë paralajmërojnë për praktikën e cila familjarëve të afërm të personave të vrarë nuk iu mundëson realizimin e të drejtësisë me përcaktimin e përgjegjësisë penale të kryerësit (shumë krime nuk janë procesuar) dhe as nuk u ofron mundësinë e realizimit të kompensimit për shkak të personit të afërt.⁶⁸⁵

Sikurse edhe në rastet e krimeve të luftës, në statistikat e procedurave gjyqësore për kompensimin e dëmit të shkaktuar në luftë nuk ka qasje të lehtë në Kroaci. Organizatat Qendra për Paqe, Jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut në Osijek, Dokumente – Qendra për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut kanë grumbulluar për vitin 2010 105 lëndë për kompensimin e dëmit jo material për shkak të vdekjes së personit të afërm. Proceset zhvillohen në gjykata të ndryshme në Kroaci dhe ndodhen në faza të ndryshme.

Në shumicën e rasteve të dokumentuara, kërkesat e paditësve/të dëmtuarve janë refuzuar. Gjykatat i janë referuar afatit të përgjithshëm të parashkrimit (pesëvjeçar), duke llogaritur nga kryerja e ngjarjes së dëmshme, kurse shkaku – vrasja e civilëve, duke kryer vepër penale, nuk ka qenë e vlefshëm për shkak të mosekzistimit të aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor.⁶⁸⁶ Mirëpo, është shënuar një numër i vogël rastesh kur gjykata i është referuar

677 Paga mesatare neto, në dhjetor të vitit 2009 ka qenë 5.362 kuna (rreth 735 euro).

678 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Kroacisë - Drejtoria për Mbrojtjen e Viktimave dhe të Pjesëmarrësve të Luftës, *Pasqyrë vjetore e numrit të shfrytëzuesve nga Sistemi i mbrojtjes së invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës*, më 31 dhjetor 2010, faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, http://www.mzss.hr/zdravstvo_i_socijalna_skrb/socijalna_skrb/uprava_zastitu_zrtava_i_sudionika_rata.

679 Pasqyrë e numrit të shfrytëzuesve të pensioneve sipas llojeve dhe shumëve mesatare të pensioneve, faqja e internetit e Entit të Sigurimeve Pensionale të Kroacisë, <http://www.mirovinsko.hr/UserDocsImages/korisnici%20mirovine%202012/km1za12.pdf>.

680 Pasqyrë e numrit të shfrytëzuesve të pensioneve sipas llojeve dhe shumëve mesatare të pensioneve, faqja e internetit e Entit të Sigurimeve Pensionale të Kroacisë, <http://www.mirovinsko.hr/UserDocsImages/korisnici%20mirovine%202012/km1za12.pdf>.

681 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Kroacisë - Drejtoria për Mbrojtjen e Viktimave dhe të Pjesëmarrësve të Luftës, *Pasqyrë vjetore e numrit të shfrytëzuesve nga Sistemi i mbrojtjes së invalidëve ushtarakë dhe civilë të luftës*, më 31 dhjetor 2010, faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, http://www.mzss.hr/zdravstvo_i_socijalna_skrb/socijalna_skrb/uprava_zastitu_zrtava_i_sudionika_rata.

682 Qendra për Paqe, jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut-Osijek, Dokumente – Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën, Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjyqësorisë për krime të luftës: Raport për vitin 2011*, Zagreb, viti 2012.

683 Ligji për përgjegjësinë e Republikës së Kroacisë për dëmin e shkaktuar nga ana e pjesëtarëve të forcave të armatosura dhe të forcave policore gjatë Luftës Atdhetare, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr.117/03.

684 Ligji për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga aktet terroriste dhe nga demonstratat publike, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr.117/03.

685 Qendra për Paqe, jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut-Osijek, Dokumente – Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën, Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjyqësorisë për krime të luftës: Raport për vitin 2010*, Zagreb, viti 2011 f. 36.

686 *Po aty*, f. 35.

Ligjit për marrëdhëniet detyrimore të Republikës së Kroacisë. Me këtë ligj është parashikuar një afat më i gjatë i parashkrimit në rastin kur dëmi është shkaktuar me vepër penale. Edhe pse ky afat më i gjatë i parashkrimit mund të aplikohet vetëm në rastet në të cilat me aktgjykim është konstatuar se dëmi rrjedh nga vepra penale, me ligj është i parashikuar përjashtimi sipas të cilit gjykata civile ka të drejtë të konstatojë nëse dëmi është shkaktuar me vepër penale, po që se nuk ekziston aktgjykim kundër personit përgjegjës. Në disa raste, gjykatat civile janë përcaktuar të shqyrtojnë nëse dëmi, për shkak të të cilit zhvillohet procedura kontestimore, është kryer me veprime të cilat përmbajnë elemente të veprës penale. Në këtë mënyrë, pasi që është konstatuar se ka pasur raste të këtilla, u janë caktuar nëpërmjet gjykimit disa kompensime të dëmtuarve/paditësve.⁶⁸⁷

Nga rastet, të cilat janë përfunduar, në 74% të lëndëve kërkesë paditë janë refuzuar për shkak të parashkrimit të ngritjes së procedurës kontestimore, për shkak të kundërshtimit të miratuar të dëmit të luftës, të mungesës së provave që dëmin (duke kryer vepra penale të vrasjes ose të krimit të luftës) e kanë shkaktuar pjesëtarët e KKM-së ose të forcave kroate policore ose për shkak të mosekzistimit të përgjegjësive së Republikës së Kroacisë në territorin i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë nën kontrollin e pushtetit të Republikës së Kroacisë. Vetëm në 12% të lëndëve, gjykatat kanë miratuar kërkesë paditë, duke përcaktuar përgjegjësinë e Republikës së Kroacisë dhe kështu kanë caktuar kompensimin e dëmit jo material për paditësit.⁶⁸⁸ Organizatat Qendra për Paqe, Jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut në Osijek, Dokumente – Qendra për Ballafaqim me të kaluarën dhe Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, të cilët përcjellin gjykimet për krimet e luftës në Kroaci, nuk kanë vërejtur kurrfarë përparimi gjatë vitit 2011 lidhur me çështjen e shlyerjes së shpenzimeve të procedurës kontestimore për paditësit të cilët kanë humbur kontestin e ngritur kundër Republikës së Kroacisë për kompensimin e dëmit për shkak të vdekjes së personit të afërm, si dhe për shkak të pasurisë së asgjësuar nga ana e subjekteve për të cilat është përgjegjëse Republika e Kroacisë.⁶⁸⁹ Si shkak për këtë theksohet fakti se në shumicën e lëndëve paraprakisht nuk është konstatuar përgjegjësia penale e kryerësit të veprës penale, e cila për pasojë ka pasur vdekjen e personit të afërm ose asgjësimin e pasurisë së paditësit.⁶⁹⁰

126

Një problem shtesë paraqet fakti se në numrin më të madh të rasteve (madje 61,4%), paditësve të refuzuar iu është caktuar të kompensojnë shpenzimet gjyqësore, gjë që paraqet ngarkesë të madhe për të dëmtuarit. Organizatat e shoqërisë civile i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kroacisë që në mënyrë urgjente të marrë vendimin me të cilin Republika e Kroacisë heqë dorë nga arkëtimi i shpenzimeve nga të gjithë paditësit, të cilët nuk kanë pasur sukses me kërkesë paditë e veta për kompensimin e dëmit për shkak të vdekjes së personit të afërm dhe urgjentisht të përgatisë zgjidhje ligjore me të cilat qytetarëve të Kroacisë do t'iu mundësohej qasje adekuate në të drejtat për reparacion, në përputhje me parimet e të drejtës humanitare ndërkombëtare.⁶⁹¹

Një praktikë e këtyllë e Kroacisë në proceset për kompensimin e dëmit jo material, është gjykuar në dy aktgjykime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut „Julariq kundër Republikës së Kroacisë“⁶⁹² dhe Skenxhiq dhe Kërnariq kundër Republikës së Kroacisë⁶⁹³, me të cilat Kroacisë i është urdhëruar të paguajë kompensimin e drejtë për të paditurit për shkak të moszhvillimit të hetimeve efektive dhe të përshtatshme lidhur me krimet e kryera.

2.3. Serbia

2.3.1. Reparacionet materiale administrative

Statusi dhe të drejtat e viktimave civile të luftës dhe të familjeve të viktimave në periudhën prej fillimit të vitit

687 *Po aty*, 36.

688 *Po aty*, 35.

689 Qendra për Paqe, jo dhunë dhe të Drejta të Njeriut-Osijek, Dokumente – Qendra për Ballafaqim me të Kaluarën, Këshilli Qytetar për të Drejtat e Njeriut, *Përcjellja e gjykimeve për krime të luftës: Raport për vitin 2010*, Zagreb viti 2011, f. 10.

690 *Po aty*, f. 10.

691 *Po aty*, f. 11.

692 Lënda *Julariq kundër Kroacisë* (Parashtresa Nr. 20106/06), aktgjykimi, e datës 20 janar të vitit 2011.

693 Lënda *Skenxhiq dhe Kërnariq kundër Kroacisë* (Parashtresa Nr.16212/08), aktgjykimi, e datës 20 janar të vitit 2011.

2010 deri në fund të vitit 2011, në Serbi kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me periudhën paraprake. Reparacionet administrative janë parashikuar me Ligjin për të drejtat e invalidëve civilë të luftës, me të cilin janë definuar të drejtat dhe procedurat e invalidëve civilë të luftës, anëtarëve të familjeve të invalidëve të vdekur civil të luftës (në rast se me të kanë jetuar para vdekjes në të njëjtën bashkësi familjare), dhe të anëtarëve të familjeve të viktimave civile të luftës.⁶⁹⁴

Sipas këtij ligji, personat të cilëve iu janë shkelur seriozisht të drejtat gjatë kohës së pushtetit të Slobodan Millosheviqit, por që nuk kanë pësuar dëmtime serioze trupore dhe personat të cilët kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme trupore për shkak të operimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Serbisë, edhe më tej e kanë të pamundur të hyjnë në rrethin e shfrytëzuesve të ndihmave materiale dhe të formave të tjera të ndihmave të cilat i garanton shteti.

Sikurse gjithkund në rajon, edhe në Serbi statusi i invalidëve ushtarakë të luftës ka mbetur më i mirë në krahasim me statusin e viktimave civile të luftës.⁶⁹⁵ Anëtarët e familjeve të luftëtarëve të rënë të cilët janë vrarë në konfliktin e armatosur ose kanë vdekur nga pasojat e plagosjes/lëndimit edhe më tutje marrin të ardhura mujore në para pavarësisht nga gjendja materiale e familjes, ndërsa anëtarët e familjeve të civilëve të vrarë këtë të drejtë mund ta realizojnë vetëm nëse të ardhurat e tyre mujore janë nën cenzusin ligjor. Anëtarët e familjeve të luftëtarëve dhe civilëve të zhdukur në Serbi edhe më tutje nuk mund të realizojnë të drejtat nga sistemi i mbrojtjes sociale, nëse të zhdukurit e vet nuk i shpallin për të vdekur. Statusi i invalidit civil të luftës, përkatësisht i viktimës civile të luftës përcaktohet me anë të provave me shkrim, dhe kjo nga koha kur rasti i theksuar ka ndodhur.

Mjetet për realizimin e këtyre të drejtave sigurohen nga buxheti i Serbisë dhe nga fundi i vitit 2011 ka pasur 1972 përfitues aktiv.⁶⁹⁶ Përveç pensionit invalidor personal, i cili caktohet varësisht nga shkalla e dëmtimit, këta përfitues mund të realizojnë edhe të drejtën e shtesës për kurim dhe të këtyre janë 336 përfitues. Pastaj, të drejtën për shtesë ortopedike e realizojnë 800 përfitues, kurse të drejtën për të ardhura mujore në para e realizojnë 455 anëtarë të familjeve të viktimave civile të luftës.⁶⁹⁷ Në numrat e theksuar më sipër të përfituesve janë përfshirë të gjithë invalidët civilë të luftës, përkatësisht anëtarët e familjeve të viktimave civile të luftës, nga këto lufta: Lufta e Dytë Botërore, nga luftërat e viteve 1990, nga intervenimi i NATO-s në vitin 1999 dhe viktimat nga periudha paqësore.

Të ardhurat mujore për invalidët civilë të luftës dhe për invalidët ushtarakë nuk dallojnë, dhe këto kapin shumat prej 10.270 RSD deri 78.997 RSD (prej 89 deri 684 euro), prej grupit VII deri në grupin I të invaliditetit. Që të dy kategoritë e përfituesve kanë mundësi identike edhe kur është fjala për të drejtën për ndihmën materiale dhe për të drejtën për mjete ndihmëse ortopedike. Megjithatë, invalidët ushtarakë kanë disa kategori të invaliditetit (edhe për më pak se 60% të dëmtimit trupor) dhe më tepër mundësi për të ardhura shtesë (për invalidët e papunësuar e të ngjashme). Një shpërpjesëtim i njëjtë në mundësitë për ndihmë shtesë (përveç pensionit të rregullt invalidor mujor) ka të bëjë edhe me familjet e viktimave civile të luftës/të invalidëve ushtarakë si dhe me kategorinë e përfituesve nga familjet e invalidëve civilë të luftës/të familjeve të invalidëve ushtarakë të vdekur/të luftëtarëve të vdekur. Pensioni invalidor familjar mund të jetë prej 23.699 RSD deri 90.846 RSD (prej 205 deri 787 euro).⁶⁹⁸

694 Ligji për të drejtat e invalidëve civilë të luftës, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, Nr. 52/96.

695 Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumente & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 64.

696 Ekspozë i Lubisha Veličkoviçit, kryeshef i Departamentit për procedurë administrative në Sektorin për Çështje të Luftëtarëve dhe të Invalidëve, Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Serbisë, në Konferencën e Fondit për të Drejtën Humanitare me temë *E drejta e viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë viteve të 90-ta për reparacione materiale në Serbi*, transkripti, faqja e internetit FHP, <http://www.hlc-rdc.org/?cat=248>.

697 *Po aty*.

698 Të gjitha shumat e përmendura janë për muajin janar të vitit 2012. Informacion i marrë nga Sektori për Çështje të Luftëtarëve dhe të Invalidëve, Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Serbisë, më 21 shkurt 2012.

2.3.2. Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore

Viktimat e luftës në Serbi rrallë herë përcaktohen që në mënyrë të pavarur të realizojnë të drejtat për reparacione nëpërmjet procedurave gjyqësore dhe kjo për shkak të frikës dhe mosbesimit ndaj organeve të drejtësisë të Republikës së Serbisë, për shkak të shpenzimeve materiale për nevojat e avokatëve, si dhe për shkak të shpenzimeve potencialisht të mëdha gjyqësore që do të llogariteshin në ngarkesë të tyre në rast të humbjes së procesit. Sikurse edhe deri më tani, paditë në emër të viktimave i ngritin organizatat për të drejtat e njeriut.⁶⁹⁹

Nga fillimi i vitit 2010, të gjitha gjykimet për reparacione materiale zhvillohen në Gjykatën e Parë Themelore në Beograd, përkatësisht në Gjykatën e Lartë në Beograd.

Fondi për të Drejtën Humanitare, në raportin e vet *Reparacionet materiale për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën: Praktika e gjykatave në Republikën e Serbisë* ka analizuar praktikën e deritashme të gjykatave në Serbi në realizimin e reparacioneve materiale. Viktimat dhe përfaqësuesit e tyre shpesh herë ballafaqohen me trajtim përçmues nga ana e përfaqësuesit të Prokurorisë Publike Republikane, por edhe me veprime të pahijshme dhe me ofendim nga ana e gjykatësve të veçantë.⁷⁰⁰ Në disa raste, gjykatësit thënie të viktimave i kanë komentuar në mënyrë jo adekuate, duke relativizuar vuajtjet e tyre,⁷⁰¹ i kanë nxitur të shpejtojnë me rastin e dhënies së dëshmimeve dhe kanë bërë gabime evidente në shqiptimin e emrave të viktimave, përkatësisht në procedurat në të cilat viktimat janë të nacionalitetit shqiptar.⁷⁰² Nga viktimat është kërkuar që të bashkëngjisin aktgjykime penale të plotfuqishme me të cilat është përcaktuar përgjegjësia e pjesëtarëve të caktuar të MPB-së, të APJ-së ose të UJ-së, certifikatat mjekësore për lëndimet nga koha kur kanë përjetuar dhunën ose provat e tjera me të cilat do t'i vërtetonin pohimet për lëndimet.⁷⁰³ Në disa raste, krimet që janë kryer nuk janë vlerësuar si „të drejtuara kundër rregullimit kushtetues të shtetit“.⁷⁰⁴ Në rastin e refugjatëve të mobilizuar në mënyrë të dhunshme nga Kroacia, përfaqësuesit e Prokurorisë Publike Republikane kanë shfaqur dyshimin për mundësinë që krimi fare të ketë ndodhur.⁷⁰⁵ Sipas të dhënave të FDH-së, shumat e dëmshpërblimit të cilat i kanë marrë viktimat e krimeve të luftës dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut deri më tani në gjykatat e Serbisë, janë të ulëta në mënyrë të pashembullt dhe në shpërpjesëtim me vuajtjet dhe lëndimet që i kanë pësuar viktimat.⁷⁰⁶ Krahas të gjitha këtyre problemeve, një vështirësi shtesë paraqet kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Sipas të dhënave të FDH-së, rastet mesatarisht zgjasin rreth pesë vite, kurse ka raste të cilat zgjasin edhe nga 13 vite, për ç'arsye disa viktima nuk e kanë përjetuar fundin e procedurës.⁷⁰⁷ Kësaj duhet shtuar edhe faktin se për shkak të reformës së pakryer të forcave të sigurisë, para së gjithash të policisë, shumë viktima, para së gjithash në Sanxhak, nuk marrin guximin për të ngritur procedura gjyqësore sepse shumë kryerës ende janë aktiv në shërbimin policor në qytetin e tyre.⁷⁰⁸ Përveç sa u theksua, një nga problemet më të mëdha paraqitet edhe çështja e afateve të parashkrimit për realizimin e reparacioneve materiale, sepse gjykatat në Serbi edhe më tutje i referohen Opinioni Ligjor të Gjykatës Supreme të Serbisë (GJSS), sipas të cilit afati për rivendikimin e dëmit kufizohet në tri vite.⁷⁰⁹

699 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Reparacionet materiale për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën: Praktika gjyqësore në Republikën e Serbisë*, Beograd, viti 201, f. 3.

700 *Po aty*, f. 8-10.

701 Në proceset të cilat i përfaqëson FDH në rastin e të burgosurve të kampeve nga Shlivovica dhe nga Mitrova Pola, gjykatësit kanë pohuar se dëshmitarët nuk po e thonë të vërtetën, dhe se „edhe situata në Serbi ka qenë tejet e keqe“. *Po aty*, f. 8.

702 *Po aty*.

703 *Po aty*.

704 Kështu e ka vlerësuar Prokuroria Publike Republikane krimin në Podujevë, me ç'rast pjesëtarët e Shkorpionëve kanë vvarë 14 gra dhe fëmijë dhe i kanë plagosur dhe u kanë shkakuar lëndime të përhershme pesë fëmijëve të mitur shqiptarë. *Po aty*, f. 9.

705 Prokuroria Publike Republikane në përgjigjen dërguar FDH-së ka theksuar se shpreh dyshimin që refugjatëve nga Kroacia, të mobilizuar dhunshëm, e të cilët u janë dorëzuar organeve serbe dhe formacioneve paramilitare, ka mundur t'ju ndodhë ndonjë gjë e keqe. *Po aty*, f. 9.

706 *Po aty*, f. 10.

707 Viktimat e torturës policore Hazbija Smajoviq nga Tutini dhe Sabit Bibiq nga Sjenica kanë vdekur derisa ka zgjatur procedura. *Po aty*, f. 10, fusnota 18.

708 *Po aty*, f. 11.

709 Opinioni ligjor i Dhomës civile i Gjykatës Supreme të Serbisë, i dhënë në seancën e 10 shkurtit të vitit 2004.

Fondi për të Drejtën Humanitare në vitin 2010 ka ngritur 14 padi në emër të 46 shqiptarëve të cilët në mënyrë të paligjshme janë paraburgosur nga ana e forcave serbe të sigurimit në periudhën para dhe gjatë bombardimeve të NATO-së.⁷¹⁰ Deri në fund të vitit 2011, për një numër të lëndëve është urdhëruar ekspertiza mjekësore.⁷¹¹ Në vitin 2011 janë nxjerrë nëntë aktgjykime.⁷¹²

2.4. Kosova

2.4.1 Reparacionet materiale administrative

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, në Kosovë, deri në fund të vitit 2011 kanë qenë gjithsejtë të regjistruar 13.109 përfitues të të ardhurave të cilat i marrin në bazë të pësimeve gjatë konflikteve të armatosura të viteve 1998-1999.⁷¹³

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, gjatë vitit 2010, nga gjithsejtë 12.994 përfitues të të ardhurave, të cilat qytetarët i marrin në bazë pësimeve gjatë konflikteve të armatosura në vitet 1998-1999, numrin më të madh e kanë përbërë familjet e viktimave –7.666. Në mesin e kategorive të caktuara, dukshëm më i madh është numri i familjeve të viktimave civile të luftës, 5.188. Pagesat mujore dhe beneficionet e veçanta në bazë të invaliditetit gjatë vitit 2010 i kanë marrë 3.132 ushtarë dhe 2.084 invalid civil të luftës.⁷¹⁴

Nga 13.109 përfitues të pensionit në bazë të pësimit gjatë kohës së luftës në Kosovë të regjistruar gjatë vitit 2011, 5.494 persona kanë marrë pagesa në bazë të invaliditetit, derisa 7.501 persona kanë marrë kompensime në bazë të vdekjes, përkatësisht zhdukjes së anëtarit të familjes.⁷¹⁵

Midis vitit 2006 dhe 2012, statusi dhe të drejtat e luftëtarëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), viktimave civile dhe familjeve të tyre është i rregulluar me Ligjin e miratuar në vitin 2006.⁷¹⁶ Në periudhën e mëparshme është përgatitur një ligj i ri, i cili është miratuar në vitin 2011 dhe ka hyrë në fuqi në datën 1 janar të vitit 2012. Ligji e përkufizon statusin juridik dhe i rregullon të drejtat dhe beneficionet e të gjitha kategorive të cekura në përkufizimin e ligjit si dhe të të burgosurve të luftës dhe familjeve të civilëve të zhdukur dhe të luftëtarëve të zhdukur të UÇK-së.⁷¹⁷

Qëllim i Ligjit është “përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensionit dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me flijimin dhe me kontributin e tyre kanë qenë faktor vendimtar për lirinë dhe çlirimin e vendit.”⁷¹⁸ Ligji rregullon dhënien e statusit të luftëtarëve të rënë të kombit të UÇK-së, pjesëtarëve zhdukur të UÇK-së, veteranëve të UÇK-së, invalidëve të luftës, të burgosurve të luftës dhe anëtarëve të familjeve të ngushta të këtyre kategorive. Ligji i përfshin kategoritë e mëposhtme të viktimave civile: personat e zhdukur dhe anëtarët e familjeve të tyre, invalidët civil të luftës tek të cilët është shkaktuar dëmtim i organizmit prej së paku 40 për qind (e me këtë janë përfshirë edhe personat që kanë pësuar nga minat dhe pajimet e tjera eksplozive, të mbetura nga konfliktet e armatosura), viktimat civile të luftës, përkatësisht personat të cilët janë vrarë ose plagosur nga forcat e armikut në periudhën prej datës 27 shkurt të vitit 1998 deri në datën 20 qershor

710 Informacion i marrë nga Fondi për të Drejtën Humanitare në vitin 2012.

711 *Po aty*.

712 Komunikatë e FDH-së lidhur me rastet konkrete, gjatë kohës së gjyqimit dhe me rastin e aktgjykimeve, faqja e internetit e FDH, <http://www.hlc-rdc.org/?cat=242>.

713 Informacion i dërguar Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, i marrë nga Ministria e Punës dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Kosovës, i datës 4 korrik të vitit 2012.

714 *Po aty*.

715 104 persona kanë marrë kompensime në bazë të përkujdesjes ndaj invalidëve civil, përkatësisht invalidëve ushtarak të luftës. *Po aty*.

716 Ligji 02/L-2 mbi statusin dhe të drejtat e anëtarëve familjeve të luftëtarëve të rënë, invalidëve, veteranëve dhe pjesëmarrësve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, i datës 23 shkurt i vitit 2006.

717 Ligji nr. 04/L-054 mbi statusin dhe të drejtat e luftëtarëve të rënë, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, i datës 1 janar të vitit 2012.

718 *Po aty*, neni 1.

të vitit 1999 dhe civilët e burgosur nëpër kampe si dhe anëtarët e familjeve të ngushta të kategorive të cekura të luftës.⁷¹⁹

“Invalid civil i luftës”, në kuptimin e këtij Ligji, është personi “organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40 për qind si pasojë e plagosjes nga arma, sëmundja e shkaktuar nga burgosja ose kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë nga data 27.02.1998 deri në datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40 për qind si pasojë e mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës.”⁷²⁰ Nga ana tjetër, për invalidët e luftës të UÇK-së është e nevojshme të dëshmohet dëmtimi i organizmit prej së paku 20% të plagës, lëndimit ose sëmundjes, të cilat kanë rezultuar si pasojë e luftës, e internimit (burgosjes) në burgje ose në kampe të armikut.⁷²¹

Personat, të cilët nuk e përmbushin kushtin e dëmtimit trupor, por iu është dëmtuar shëndeti mendor, nuk e plotësojnë kushtin e pranimit të invaliditetit. Viktimat e dhunës seksuale, së këndejmi, nuk do të jenë në mesin e pranuesve të kompensimit, pos nëse edhe tek ata ka rezultuar deri te invaliditeti trupor prej së paku 40 për qind. Familjet e ngushta të personave civil të zhdukur e realizojnë të drejtën në ndihmë financiare nëse anëtarët e familjeve të tyre janë zhdukur prej datës 1 janar të vitit 1998 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, me faktin se zhdukja e personit ka rezultuar si pasojë e luftës në Kosovë në periudhën e viteve 1998–1999.⁷²²

Në përkufizimin e invalidit të luftës të UÇK-së, viktimës civile të luftës (të vrarë, të plagosur e të vdekur si rezultat i plagosjes ose që ka pësuar nga minat) dhe të burgosurit civil të luftës, ligjvënësi e përdor termin “kampet e armikut” ose “forcat e armikut”, me çka nga ligji përjashtohen viktimat civile të cilat kanë qenë të burgosura në kampet e UÇK-së e nuk kanë përjetuar dëmtim trupor, si dhe civilët të cilët janë vrarë ose plagosur e pastaj kanë vdekur.⁷²³ Edhe një pikë kontestuese e ligjit është qasja ndaj disa benificioneve, siç është e drejta në reabilitim mjekësor dhe fizikal⁷²⁴, qasja ndaj shërbimeve primare, sekondare dhe terciare shëndetësore⁷²⁵, përparësi në punësim⁷²⁶ e drejta për lirim nga dogana gjatë futjes së automjeteve speciale dhe zvogëlimi i shpenzimeve të rrymës elektrike⁷²⁷, përparësia dhe e drejta në arsimim të pa pagesë⁷²⁸ që nuk i përfshin anëtarët e familjeve të civilëve të vrarë (pos familjeve të personave të zhdukur).⁷²⁹

Për kategoritë, të cilat janë të përfshira me Ligjin e ri, përfitimet të cilat janë të parapara për grupet e viktimave civile janë shumë më të pakta se sa ato që janë të parapara për luftëtarët e UÇK-së⁷³⁰ dhe anëtarët e familjeve të tyre. Invalidët civil të luftës marrin pensione në lartësi prej midis 96 dhe 122 eurosh mujore, derisa familjet e viktimave civile marrin kompensimin mujor në lartësi prej 135 eurosh, aq sa marrin edhe familjet e civilëve të zhdukur.⁷³¹ Nga ana tjetër, familjet e luftëtarëve të rënë dhe të zhdukur të UÇK-së marrin për muaj midis 239 dhe 356 euro, në varësi nga fakti se sa anëtarë të familjeve kanë rënë ose janë zhdukur.⁷³² Pagesa më të larta në krahasim me civilët marrin edhe invalidët ushtarak të luftës – midis 120 dhe 239 euro.⁷³³ Me Vendim të Qeverisë së Kosovës nr.02/152 të muajit janar të vitit 2011, është paraparë rritja prej 50% në lartësinë e të gjitha kategorive

719 *Po aty*, neni 3.

720 *Po aty*, neni 3.

721 *Po aty*, 3, paragrafi 1.7.

722 *Po aty*, neni 3, paragrafi 1.14.

723 *Po aty*, neni 3, paragrafi 1.8, 1.10, 1.12.

724 *Po aty*, neni 6, paragrafi 1.2,

725 *Po aty*, neni 6.1.3.

726 *Po aty*, neni 6, 1.8

727 *Po aty*, neni 6, paragrafi 2 dhe 3.

728 *Po aty*, neni 6, paragrafi 7 dhe 8.

729 *Po aty*,

730 Për qindja e dëmtimit invalidor po ashtu i favorizon luftëtarët e UÇK-së në raport me civilët. Për luftëtarët, shkalla minimale e dëmtimit në bazë të të cilit mund të realizohet e drejta në pension dhe benificione të tjera është 20-30 për qind.

731 Informacion i dërguar Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës, i datës 4 korrik të vitit 2012.

732 *Po aty*.

733 *Po aty*.

të viktimave ushtarake (të invalidëve të ushtrisë, të personave që kujdesen për ta, familjeve të invalidëve ushtarak pas vdekjes, familjeve të luftëtarëve të rënë dhe familjeve të luftëtarëve të zhdukur), por jo edhe për kategoritë e viktimave civile.⁷³⁴ Pagesat maksimale familjare sipas këtij vendimi do të mbesin pensionet familjare - 534 euro për më shumë se katër të rënë ushtarë të UÇK-së nga një familje.⁷³⁵ Sipas njohurive të Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, ky Vendim i Qeverisë nuk është zbatuar ende deri në fund të vitit 2011.⁷³⁶

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në datën 28 tetor të vitit 2010 e ka miratuar Ligjin mbi të drejtat e ish të burgosurve dhe të përndjekurve politik.⁷³⁷ Ligji e përkufizon statusin ligjor dhe i rregullon të drejtat dhe definicionet e ish të dënuarve politik, ish të burgosurve politik dhe ish të përndjekurve politik.⁷³⁸ Sipas këtij ligji, ish i dënuari politik është qytetari i Kosovës i cili është i dënuar nga gjykatat ushtarake ose gjykatat me kompetenca të përgjithshme për vepra të inkriminuara politiko-ideologjike dhe patriotike gjatë regjimeve totalitare në ish Jugosllavin.⁷³⁹ Ish i burgosur politik, me këtë ligj konsiderohet personi i cili është privuar nga liria, është ndaluar në një vend të caktuar në izolim dhe është burgosur për motive, qëllime dhe interesa politike më shumë se shtatëdhjetë e dy (72) orë në objektet e organeve të ndjekjes, përkatësisht organeve kompetente të institucioneve zyrtare të sigurimit (policisë, ushtrisë dhe shërbimit të fshehtë).⁷⁴⁰ Ligji përkufizon edhe statusin e ish të ndjekurve politik – qytetarit të Kosovës kundër të cilit, me akt ligjor të organit kompetent, janë marrë masa politiko – ligjore dhe veprime të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kanë ndikuar në masën e pezullimit ose në ndërprerjen e marrëdhënies së punës, shkollimin, marrjen e lejes, përkatësisht në ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë me mjete të pronës personale, për shkak të bindjes, përcaktimit ose lidhjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta me personat të cilët kanë qenë të dënuar dhe të ndjekur në bazë të dyshimit të supozuar politik ose inkriminimit.⁷⁴¹ Korniza kohore e përfshirë me këtë Ligj fillon nga data 1 mars e vitit 1913 e deri në datën 1 qershor të vitit 1999, me të cilën mbulohet periudha e vendosjes së “regjimeve totalitare”,⁷⁴² përkatësisht prej kur Mbretëria e Serbisë e ka pushtuar Kosovën në Luftën e Dytë Ballkanike. Ligji parasheh të drejtën në kompensimin material gradual për dy kategori të përfshira me këtë ligj, ish të burgosurit politik dhe ish të përndjekurit politik.⁷⁴³ Të drejtën në sigurim pensional dhe invalidor e kanë të gjitha kategoritë e personave të përfshirë me këtë Ligj,⁷⁴⁴ derisa të drejtën në rehabilitim, sigurim shëndetësor dhe social e kanë të gjithë personat me pasoja të përhershme psikike dhe fizike të krijuara si rezultat i burgosjes.⁷⁴⁵ Po ashtu, të gjithë personat e përfshirë me këtë Ligj e kanë të drejtën e përparësisë me rastin e punësimit, marrjen e bursave, strehimit, kompensimin për varrosje dhe beneficione të ngjashme, nëse ndodhen në gjendje të rëndë ekonomike dhe shëndetësore.⁷⁴⁶

Me Ligj është paraparë edhe themelimi i Komisionit për realizimin e të drejtave të ish të burgosurve dhe të përndjekurve politik i Qeverisë së Kosovës.⁷⁴⁷ Krahas kësaj, me qëllim të shqyrtimit, hulumtimit dhe shpalljes së të vërtetës për ish të dënuarit, për të burgosurit dhe të përndjekurit politik si dhe me qëllim të integritetit të tyre në shoqëri, është paraparë themelimi i Institutit për integritet të ish të burgosurve dhe të përndjekurve politik.⁷⁴⁸

734 Aktivitetet e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2011, Zyra për informim publik, faqja e internetit e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të Republikës së Kosovës, http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/Broshura_sr_2011.pdf.

735 *Po aty*.

736 Korrespondencë me email me Bekim Blakajn, drejtor i Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, 03 korrik i vitit 2012.

737 Ligji nr. 03/L-95 për të drejtat e ish të burgosurve dhe të të ndjekurve politik, i miratuar në datën 28 tetor të vitit 2010.

738 *Po aty*, neni 1.

739 *Po aty*, neni 3, paragrafi 2.

740 *Po aty*, neni 3, paragrafi 3.

741 *Po aty*, neni 3, paragrafi 4.

742 *Po aty*, neni 4.

743 *Po aty*, neni 7, paragrafi 1.

744 *Po aty*, neni 9.

745 *Po aty*, neni 8.

746 *Po aty*, neni 12, paragrafi 1.

747 *Po aty*, neni 19.

748 *Po aty*, neni 20.

2.4.2. Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore

Edhe më tutje nuk ka përparim në fushën e reparacioneve materiale në bazë të vendimeve gjyqësore në Kosovë.

Një numër i madh i padive për kompensim të dëmit, të cilat i kanë ngritur shqiptarët e Kosovës edhe më tutje gjenden para gjykatave kosovare. Po ashtu, nga viti 1999, serbët e Kosovës dhe joshqiptarët e tjerë kanë ngritur një numër të madh të padive për shkak të shkatërrimit të pronës menjëherë pas përfundimit të luftës së vitit 1999, para gjykatave komunale, të cilat në shumicën e rasteve janë shpallur jokompetente. Sipas pohimeve, të cilat Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë i ka marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjykatat në Kosovë deri në fund të vitit 2011 nuk kanë sjellë asnjë aktgjykim në dobi të viktimave civile të luftës në Kosovë.⁷⁴⁹

2.5. Mali i Zi

2.5.1. Reparacionet materiale administrative

Sipas evidencës së Ministrisë së Punës dhe të Përkujdesjes Sociale, në Mal të Zi, në fund të vitit 2010 ka pasur 250 invalidë të luftës, katër invalidë civil të luftës dhe 185 familje të luftëtarëve të vrarë gjatë konflikteve të luftës.⁷⁵⁰ Në vitin 2011 janë regjistruar 245 invalidë ushtarakë të luftës, katër invalidë civil të luftës dhe 180 familje të luftëtarëve të rënë, në lidhje me konfliktet e viteve nëntëdhjetë.⁷⁵¹

Deri në fund të vitit 2011 nuk ka pasur ndryshime të Ligjit mbi mbrojtjen e luftëtarëve dhe të invalidëve⁷⁵², ndryshimet e fundit të të cilit janë të aprovuara në vitin 2008⁷⁵³. Me këtë ligj, për t'u njohur statusi i invalidit ushtarak ka qenë e nevojshme që organizmi të jetë i dëmtuar të paktën 20 përqind, kurse për invalidin civil të luftës - 50 përqind.

Të ardhurat mujore në para harmonizohen sipas gjashtë mujorit me lëvizjen e kostos së jetesës dhe të mesatares së të ardhurave në Mal të Zi.⁷⁵⁴ Në periudhën prej 1 korrikut të vitit 2010 deri në datën 1 janar të vitit 2011, invalidët ushtarakë kanë marrë mesatarisht prej 32,71 euro deri në 545,14 euro në muaj, ndërsa pensioni i invalidëve civil të luftës ka lëvizur prej 70 euro deri në 545,14 euro.⁷⁵⁵ Ndarjet për të dy kategoritë kanë mbetur të njëjta, porse invalidët civil të luftës nuk mund të realizojnë të drejtën për tri kategoritë e fundit (për më pak se 50 përqind invaliditet).⁷⁵⁶

Të drejtën e shtesës për përkujdesje dhe ndihmë nga personi tjetër e kanë pasur invalidët ushtarakë dhe civil të kategorisë së parë me 100 për qind invaliditet, si dhe invalidët ushtarakë dhe civilë të luftës "me dëmtim të përgjithshëm të organizmit i cili për nga invaliditeti është i barabartë me dëmtimin e organizmit të invalidit ushtarak të grupit të parë, përkatësisht të invalidit civil të luftës të grupit të parë".⁷⁵⁷ Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë nga personi tjetër në vitin 2010 ka qenë 272,57 euro. Që të dy kategoritë kanë të njëjtat të drejta përkitazi me mjetet e ndihmës ortopedike. Gjithashtu, të drejtat e tyre janë në raport të njëjtë sa i përket të ardhurave për anëtarët e familjeve të tyre. Pensioni invalidor i shtuar në fund të vitit 2010 ka qenë 190,80 euro.⁷⁵⁸

749 Korrespondencë me email me Bekim Blakajn, drejtor i Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, 03 korrik 2012.

750 Përgjigje me postë elektronike e Veselinka Gjuretqiut, këshilltare e pavarur për mbrojtjen e luftëtarëve – të invalidëve, Ministria e Përkujdesjes Sociale, më 22 dhjetor 2011.

751 *Po aty*.

752 *Po aty*.

753 Ligji për mbrojtjen e luftëtarëve dhe të invalidëve, *Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi*, nr. 69/03, Nr. 21/08.

754 Përgjigje me postë elektronike e Veselinka Gjuretqiut, këshilltare e pavarur për mbrojtjen e luftëtarëve – të invalidëve, Ministria e Përkujdesjes Sociale, më 22 dhjetor 2011.

755 *Pa aty*.

756 Ligji për mbrojtjen e luftëtarëve dhe të invalidëve, *Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi*, nr. 69/03, neni 22.

757 *Po aty*, neni 29.

758 Përgjigje me postë elektronike e Veselinka Gjuretqiut, këshilltare e pavarur për mbrojtjen e luftëtarëve – të invalidëve, Ministria e Përkujdesjes Sociale, e datës 22 të vitit dhjetor 2011.

Kompensimi në para i sigurimit material, në fund të vitit 2010 ka qenë 109,03 euro, kurse për bashkëpërfituesin ky kompensim është shtuar për 20 për qind. Kompensimin e kanë marrë invalidët pa kurrfarë të hyrash dhe fëmijët e luftëtarit të rënë të cilët janë në shkollim të rregullt dhe ata që nuk kanë kurrfarë të hyrash.⁷⁵⁹

Shuma e pensionit invalidor familjar, e pensionit invalidor familjar të shtuar dhe e kompensimit në para të sigurimit material është e njëjtë si për familjet e të zhdukurve, si për familjet e luftëtarëve të rënë. Për njohjen e të drejtës për pension invalidor familjar mbi bazën e luftëtarit të rënë deri në fund të vitit 2011 edhe më tutje ka qenë e nevojshme të sigurohet certifikata nga libri amëz i të vdekurve ose aktvendimi i organit kompetent për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur. Familjet e civilëve të zhdukur, përfundimisht me vitin 2011, në Mal të Zi nuk kanë fituar të drejtën për ndihmë mujore në para.⁷⁶⁰

Gjatë vitit 2011, në Mal të Zi, ndihma materiale për invaliditet civilë dhe ushtarak të luftës është shtuar jo shumë, përkatësisht më së shumti 20 euro për kategoritë më të rënda të invaliditetit.

25.2. Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore

Në Gjykatën e Podgoricës kundër Malit të Zi, deri në fund të vitit 2011, janë ngritur 12 procese për kompensim të dëmit jo material, të shkaktuar nga ana e organeve shtetërore. Janë paditur ushtria, e cila është identifikuar si autor i krimit, dhe MPB -ja, si një institucion që ka përgjegjësinë për mbrojtjen e njerëzve dhe të pronës.⁷⁶¹ Paditë janë ngritur nga familjet e viktimave të krimeve të luftës, nga viktimat personalisht ose nëpërmjet avokatëve të tyre. Organizata Joqeveritare „Aksioni për të Drejtat e Njeriut“, e cila monitoron këto gjykime, konstaton se të njëjtat karakterizohen nga shqyrtimet, në të cilat shmanget ndërlidhja e vrasjes se viktimave me ushtrinë, por vrasja e tyre reduktohet në ngjarje të jashtëzakonshme, për të cilat përgjegjës është Mali i Zi si trashëgimtar juridik i RFJ-së, duke theksuar se kjo tezë është e dobishme për viktimat, për shkak se palët e dëmtuara nuk kanë nevojë të provojnë faktet e vet ngjarjes, por kjo është edhe joreale, sepse ajo fshih faktin se pjesëtarët e ushtrisë kanë kryer pa arsye vrasjen e qytetarëve të pafajshëm të shtetit, të cilit edhe ata vet i përkasin.⁷⁶²

Aktgjykimi i plotfuqishëm për kompensimin e dëmit material është shqiptuar sipas padisë së Haxhi Ahmetit nga Novo Sella, afër Pejës, i cili e ka paditur Malin e Zi për shkak të dhembjes shpirtërore të cilën e ka përjetuar si viktimë e krimeve të luftës, të kryera në prill të vitit 1999 në fshatin Kalugjerski Laz. Gjykata i ka ndarë atij kompensim prej 12.000 euro nga 45.000 sa ka kërkuar Ahmeti⁷⁶³. Për krime ndaj refugjatëve të tjerë shqiptarë në këtë fshat, përfaqësuesit e autorizuar të viktimave kanë paraqitur rreth 20 padi për kompensim të dëmit në Gjykatën Themelore të Podgoricës. Procedurat e tjera për kompensim të dëmit janë në zhvillim e sipër. Qeveria e Malit të Zi nuk i është përgjigjur deri në fund të vitit 2011 iniciativës së ngritur në mars të vitit 2009 që viktimat e krimit në Kalugjerski Laz të marrin kompensim në të njëjtën mënyrë si viktimat e deportimeve në dhjetor të vitit 2008.⁷⁶⁴

Në lidhje me krimet e kryera në Bukovicë, Fondi për të Drejtën Humanitare ka përfaqësuar disa viktime.

Në rastin e padisë së viktimave të torturës në fshatin bukovicës, Çerjenci, të Shaban Rizvanoviqit dhe Arif Rizvanoviqit, Gjykata Themelore në Podgoricë ka nxjerrë aktgjykimin e shkallës së parë, në datën 7 prill të vitit 2010 sipas të cilit shteti i Malit të Zi është i obliguar t'u paguajë atyre 10.000 € në emër të dëmit. Mirëpo, Gjykata e Lartë ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë për të kthyer çështjen për rigjykim. Ndaj Shaban dhe Arif Rizvanoviqit tortura kanë kryer pjesëtarët e formacionit rezervë të Ushtrisë së Jugosllavisë (UJ) në shkurt të vitit 1993. Fondi për të Drejtën Humanitare ka ngritur një padi në emër të Rizvanoviqve në datën 30 tetor të vitit 2006. Fondi ka njoftuar se, „pavarësisht nga të metat e aktgjykimit“, nuk do të ankohet për shkak se ngritja e procedurës në

759 Po aty.

760 Po aty.

761 Aksioni për të drejtat e njeriut, *Gjykimet për krime të luftës në Mal të Zi*, Podgoricë, viti 2011, f.27.

762 Po aty.

763 Po aty.

764 Përgjigje me postë elektronike e avokatit të familjes së viktimave, Veli Muriqit, e datës 12 dhjetor të vitit 2011.

shkallë të dytë për Shaban dhe Arif Rizvanoviçin, i cili së shpejti do t'i mbushë 90 vjet, do të thotë se drejtësinë të cilën janë duke e pritur për më shumë se 17 vjet, ndoshta nuk do të përjetojnë⁷⁶⁵

Gjykata e Lartë ka anuluar edhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Kolashin të nxjerrë në datën 11 maj të vitit 2010 për një kompensim prej 15.000 € për Zlatija Stovrag nga fshati bukovicës Vukshiq, për shkak të vuajtjeve që i janë shkaktuar dhe dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së burrit të saj Himzo, i cili ka kryer vetëvrasje nga frika prej ndonjë torture tjetër policore. Gjithashtu është anuluar aktgjykimi me të cilin i është ndarë kompensimi për pronën Osman Ramoviçit nga fshati Viti, sipas padisë të cilën e ka ngritur Fondi për të Drejtën Humanitare qysh në vitin 2007⁷⁶⁶. Në Gjykatën Themelore në Podgoricë, në datën 8 prill të vitit 2010, kanë filluar proceset për kompensimin e dëmeve sipas padive të Zlatija, Alema dhe Amella Bungur dhe Sevda Bungur, për shkak të paraburgosje së paligjshme dhe dërgimit në territorin boshnjak të kontrolluar nga serbët e Bosnjës.⁷⁶⁷

Gjykimet për kompensim të dëmit, për viktimat e bombardimeve të NATO-s në fshatin Murino në fund të vitit 2011 kanë qenë para përfundimit. Në disa konteste janë nxjerrë aktgjykime të shkallës së parë, kurse në një rast kërkesë padia është refuzuar.⁷⁶⁸ Në shtator të vitit 2010, Gjykata Themelore në Podgoricë ka vendosur që familjes së Monojlo Komatinës se vrasë, t'i paguhen 69.000 € në emër të dëmit, për çfarë ka pasuar një ankesë e shtetit.⁷⁶⁹ Në nëntor të vitit 2010, Gjykata ka nxjerrë aktgjykim me të cilin Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Administratës Publike dhe Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht Ushtria e Malit të Zi, janë të obliguara që bashkërisht t'i paguajnë 82.000 € familjes së Vukiq Vuletiqit, i cili, pasi ishte plagosur, kishte vdekur në spitalin e Beranit.⁷⁷⁰

Në dhjetor të vitit 2008, përfaqësuesit e viktimave kanë arritur një paqësim gjyqësor me qeverinë e Malit të Zi në 42 konteste gjyqësore, në të cilat kanë përfaqësuar familjet e viktimave të deportuara nga Mali i Zi, dhe që janë vrasë më vonë në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Familjet e viktimave kanë marrë kompensim në vlerë prej 4.100.000 €. Fëmijët e të vrasëve kanë marrë nga 30.000 € në emër të dëmit, prindërit dhe bashkëshortet nga 25.000 €, vëllezërit dhe motrat - anëtarët e familjeve të të burgosurve në kampe nga 10.000 € kurse të mbijetuarit nga 7000 €, për një muaj qëndrimi në kamp.⁷⁷¹

2.6. Maqedonia

Ende nuk ka në dispozicion të dhëna për përkujdesjen ndaj viktimave civile të luftës në Maqedoni, dhe as që ekzistojnë zgjidhje ligjore të cilat rregullojnë këtë fushë. Numri i viktimave dhe i të plagosurve rëndë (i invalidëve) në anën e forcave maqedonase të sigurisë në konfliktin e vitit 2001 është: 43 pjesëtarë të vrasë të ushtrisë maqedonase dhe 119 pjesëtarë të plagosur të Armatës së Republikës së Maqedonisë (ARM). Gjithashtu, janë vrasë 15 pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kurse janë plagosur 150.⁷⁷²

Procesi i pagimit të kompensimit për pjesëtarët e plagosur të ARM-së dhe për familjet e atyre pjesëtarëve të cilët kanë humbur jetën gjatë viteve 2010-2011 ka hyrë në fazën përfundimtare.

Sipas Ligjit për të drejtat e posaçme të pjesëtarëve të forcave të sigurisë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, i cili

765 Komunikatë e Fondit për të Drejtën Humanitare, e datës 12 qershor të vitit 2010, faqja e internetit FHP, <http://www.hlc-rdc.org/index.php/sr/informisanje/saoptenja/262-obeteenje-zbog-torture-nad-abanom-i-arifom-rizvanovi-1993-godine-u-bukovici>.

766 Aksioni për të drejtat e njeriut, *Gjykimet për krime të luftës në Mal të Zi*, Podgoricë, viti 2011, f.15.

767 „Bukovikasit kërkojnë kompensim dëmi për shkak të dhembjeve shpirtërore”, faqja e internetit *Pobjeda*, më 9 prill 2010, <http://www.pobjeda.me/arhiva/?datum=2010-04-09&id=182897>.

768 Përgjigje me postë elektronike e avokatit të familjes së viktimave, Veli Muriqit, e datës 12 dhjetor të vitit 2011.

769 „Ofendon ankesa e shtetit”, faqja e internetit *Večernje novosti*, më 17 shtator 2010, <http://www.novosti.rs/vesti/planeta.70.html:300463-Vredja-zalba-drzave>.

770 „MPB dhe Ushtria t'i paguajnë 82.000”, faqja e internetit *Montenews*, më 25 nëntor 2010, <http://www.montenews.me/vijesti/drustvo/92412.html>.

771 „Deportimi i refugjatëve 1992”, faqja e internetit Zyra e Avokaturës Preleviq, http://www.prelevic.com/human_rights_deportacija.htm

772 Ministria e Punëve të Brendshme, *Libri i Bardhë (Bela Knjiga)*, Shkup, f.137-146.

ka hyrë në fuqi në vitin 2002, të gjithë këta kanë të drejta nga fusha sociale, shëndetësore dhe arsimore.⁷⁷³

Pjesëtarët e ARM-së, të cilët kanë qenë të plagosur, kanë marrë kompensim varësisht nga përqindja e invaliditetit,⁷⁷⁴ kurse familjet e të vrarëve janë kompensuar me nga 250.000 denarë (rreth 4.000 €) për anëtar të familjes së ngushtë. Unioni i Avokatëve të Maqedonisë ka kritikuar procedurën e kompensimit të familjeve të të vrarëve, sepse kontratat ndërmjet familjeve dhe ARM-së për kompensimin e dëmit janë nënshkruar menjëherë pas vrasjes së pjesëtarëve të armatës.⁷⁷⁵

Për shkak të mënyrës së këtillë të kompensimit, disa familje kanë tentuar që këto vendime t'i rishqyrtojnë nëpërmjet gjykatës, por nuk ka pasur rezultate. Një pjesë e tyre i ka fituar kontestet gjyqësore, por nuk kanë përfunduar të gjitha proceset në favor të paditësve. Një numër i caktuar i pjesëtarëve të plagosur të ARM-së kurrë nuk ka kërkuar kompensim nga shteti.⁷⁷⁶

Procesi i kompensimit për pjesëtarët e policisë nuk ka qenë i organizuar në mënyrë sistematike sikurse ka qenë lidhur me pjesëtarët e ARM-së. Pjesëtarët e policisë që kanë qenë të plagosur, si dhe familjet e të vrarëve, kanë qenë të detyruar të kërkojnë kompensimin me rrugë gjyqësore.⁷⁷⁷ Ende ekzistojnë kërkesa të pazgjidhura ose kontestuese për kompensimin e pjesëtarëve të policisë, përkatësisht lidhur me 9 policë të vrarë dhe 46 të plagosur.⁷⁷⁸

Një nga çështjet e hapura për të cilat nuk ka të dhëna të sakta është numri i viktimave nga radhët e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare - UÇK, i viktimave civile dhe i dëmeve materiale ndaj qytetarëve të nacionalitetit shqiptar, ndërsa veteranët e UÇK-së edhe më tutje përpiqen të marrin pension shtetëror dhe benificione të tjera sociale. Tash për tash, problemi i tyre zgjidhet me mekanizmat e politikës sociale, por jo nëpërmjet sistemit pensional.

2.7. Sllovenia

2.7.1. Reparacionet materiale administrative

Çështja e reparacioneve materiale administrative është e rregulluar me Ligjin për mbrojtje dhe siguri,⁷⁷⁹ me Ligjin për kompensimin e pjesshëm të dëmit të shkaktuar nga agresioni ushtarak ndaj Sllovenisë,⁷⁸⁰ me Ligjin për mbrojtjen e viktimave të agresionit ushtarak ndaj Republikës së Sllovenisë në vitin 1991,⁷⁸¹ dhe me Ligjin për të drejtat e posaçme të viktimave në luftën në Slloveni 1991.⁷⁸²

Në përputhje me Ligjin për kompensimin e pjesshëm të dëmit, personat juridik dhe personat fizik kanë mundur të kërkojnë kompensimin e dëmit të shkaktuar nga konflikti i armatosur në Republikën e Sllovenisë në vitin 1991. Përveç kësaj, të dëmtuarit kanë mundur të kërkojnë kompensimin edhe në bazë të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore dhe në bazë të dispozitave të përgjithshme. Në bazë të këtyre dispozitave, Prokuroria Publike Shtetërore, në rastet e plagosjes ose të vdekjes së pjesëtarëve të Mbrojtjes Territoriale Sllovene (MTS) ose të policisë ka lidhur paqësime jashtë gjyqësore.⁷⁸³

773 Ligji për të drejtat e posaçme të pjesëtarëve të forcave të sigurisë dhe të anëtarëve të familjeve të tyre *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.2/2002 dhe Nr.17/2003.

774 Shumat e kompensimit kanë lëvizur prej 1.500.000 denarësh (rreth 24.000 euro).

775 Intervistë me Aco Stojanovskin, Kryetar i "Unionit të Mbrojtësve të Maqedonisë", e datës 20 janar të vitit 2012.

776 *Po aty*.

777 *Po aty*. Gjithashtu shih: Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumente & BIRN, *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 80-81.

778 Ministria e Punëve të Brendshme, Libri i Bardhë, Shkup, f. 137-146.

779 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 15/1991.

780 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 11/1991.

781 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 12/1991.

782 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 49/1997.

783 Shkresë e Prokurorisë Publike Shtetërore e Republikës së Sllovenisë dërguar hulumtuesit Igor Mekina, më 30 janar 2012.

Ligji për viktimat e dhunës së luftës, i miratuar në vitin 1995, iu kushtohet problemeve të viktimave të Luftës së Dytë Botërore dhe vetëm në një pjesë të vogël merret me viktimat e konflikteve të tjera. Viktimat e konfliktit të viti 1991 kanë marrë kompensim në bazë të ligjeve në fuqi (i fundit është Ligji për invalidët e luftës i Sllovenisë), i cili cakton kompensimin për invaliditet. Ligji për invalidët e luftës i Sllovenisë⁷⁸⁴ rregullon të drejtat të cilat më parë i rregullonte Ligji për mbrojtjen e viktimave të agresionit ushtarak ndaj Republikës së Sllovenisë në vitin⁷⁸⁵, krahas ligjeve për të drejtat themelore të invalidëve ushtarakë dhe të familjeve të luftëtarëve të rënë, si dhe të invalidëve civil të luftës të cilët të drejtat e veta i kanë realizuar në bazë të Ligjit për invalidët civil të luftës.⁷⁸⁶ Invalidët e luftës me organizëm të dëmtuar prej 10 deri në 100 % gëzojnë të drejtën e pensionit invalidor. Baza për përllogaritjen e invaliditetit (prej 30% deri në 100 %) është 35 % e të ardhurave mesatare neto në Slloveni, kurse shuma maksimale është 414 euro.

Personave, të cilët si pjesëtarë të MT të Sllovenisë ose të organeve të Punëve të Brendshme të Sllovenisë janë bërë invalidë si dhe anëtarëve të familjeve të tyre iu është siguruar statusi i invalidit të luftës me Ligjin për të drejtat e posaçme të viktimave të luftës në Slloveni në vitin 1991.⁷⁸⁷ Përkundër kësaj, viktimat edhe sot e kësaj dite nuk mund të realizojnë të gjitha të drejtat, p.sh., pagesën e reparacionit të luftës, sepse Parlamenti Slloven nuk ka aprovuar ndonjë ligj të posaçëm i cili do të caktonte pagesën e reparacionit të luftës.

Sllovenia, dëmin në infrastrukturë, të shkaktuar gjatë vitit 1991, e ka sanuar vetë dhe nuk ka kërkuar reparacion të luftës nga shtetet e tjera trashëgimtare të RSFJ-së. Kështu, Prokuroria Publike Shtetërore e Republikës së Sllovenisë nuk ka të dhëna për lartësinë e dëmit në infrastrukturë e po ashtu nuk ka të dhëna se Sllovenia ka kërkuar nga shtetet e tjera t'i kompensohet dëmi.⁷⁸⁸

Sllovenia pas gati 20 vjetësh ka filluar të zgjidhë problemin e “personave të fshirë”, që ka të bëjë me rregullimin e statusit të 25.671 personave të cilët organet shtetërore sllovene pas pavarësimit në datën 26 shkurt të vitit 1992 me një akt administrativ i kanë shlyer nga regjistri i vendbanimit të përhershëm.⁷⁸⁹

136 | Gjykata Kushtetuese, dy herë, në një afat prej katër vjetësh (1999-2003), ka nxjerrë aktgjykim se me rastin e „fshirjes“ së njerëzve është kryer veprim i kundërligjshëm nga ana e shtetit të Sllovenisë.

Në Slloveni, që nga viti 1999 është në fuqi Ligji për rregullimin e statusit të shtetasve të shteteve të tjera trashëgimtare të RSFJ-së në Republikën e Sllovenisë, që i kushtohet pozitës së veçantë “të personave të fshirë”.⁷⁹⁰ Ligji është miratuar në vitin 1999 pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë në të cilin konstatohet se fshirja nga regjistri i banorëve të përhershëm ka qenë e kundërligjshme, dhe se Ligji për të huajt është në kundërshtim me Kushtetutën duke qenë se nuk e ka rregulluar statusin juridik të personave të cilët më vonë janë fshirë.

Me ligj është caktuar afati prej tre muajve për paraqitjen e lutjes për vendqëndrim të përhershëm, mirëpo paraqitësit e lutjeve është dashur të plotësojnë kushtin se kanë jetuar në Slloveni pas fshirjes nga regjistri i banorëve të përhershëm. Me një Rregullore të këtillë është pamundësuar rregullimi i statusit për të gjithë ata persona të fshirë të cilët janë dëbuar me forcë nga Sllovenia ose e kanë lëshuar Slloveninë përkohësisht, kështu që për shkak të kufijve të mbyllur dhe të kushteve të luftës nuk kanë mundur më të kthehen ose nuk kanë qenë të pranishëm

784 Ligji për invalidët ushtarakë, *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 63/1995.

785 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr 12/1991.

786 Ligji për invalidët civilë të luftës, *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 56/1992.

787 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, Nr.49/1997.

788 Shkresë e Prokurorisë Publike Shtetërore e Republikës së Sllovenisë dërguar hetuesit Igor Mekina, më 30 janar 2012.

789 Informacionin për numrin e ripërcaktuar të “personave të fshirë”, e ka kumtuar në datën 27 janar të vitit 2009 në televizionin shtetëror slloven sekretari shtetëror i atëhershëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Goran Klemenčiq. Për këtë ka raportuar edhe Agjencia Shtetërore e Lajmeve STA. “Klemenčiq: V Sloveniji je bilo izbrisanih 25.671 oseb (krajše)”, internet stranica *Slovenska tiskovna agencija*, 27 janar 2009, <http://www.sta.si/vest.php?s=s&t=0&id=1358382>.

790 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr.61/1999.

për shkaqe të tjera. Dispozita për afatin tremujor për paraqitjen e lutjes është anuluar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në vitin 2003, me të cilin Parlamentit i është caktuar të miratojë ndryshimet përkatëse të ligjit.

Ligji për plotësimet dhe ndryshimet e ligjit për rregullimin e statusit të shtetasve të shteteve të tjera trashëgimtare të RSFJ-së në Republikën e Sllovenisë është miratuar vetëm në vitin 2010.⁷⁹¹ Është zgjeruar kushti për parashtruesit e lutjeve kështu që me këto ndryshime janë përfshirë edhe ata të persona të fshirë, të cilët për shkaqe të arsyeshme e kanë lëshuar Slloveninë. Afati për paraqitjen e lutjeve për vendqëndrim të përhershëm është zgjatuar nga 3 muaj në 4 vjet.

Për shkak të problemeve të personave të fshirë, Sllovenia është marrë në pyetje në muajin shkurt të vitit 2010 në Këshillin për të Drejtat e Njeriut të KB në Gjenevë. Pas kësaj, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (korrik 2010), pas padisë nga ana e vetë banorëve, të fshirë, të Sllovenisë ka nxjerrë aktgjykim ku theksohet se shteti ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁷⁹² Sllovenia ka parashtruar ankesë dhe procesi nuk ka përfunduar deri në fund të periudhës, e cila përpunohet në raport, përkatësisht deri në fund të vitit 2011.⁷⁹³

Në gusht të vitit 2011, Komisioni për eliminimin e diskriminimit racor i Sllovenisë iu ka rekomanduar autoriteteve të pushtetit në Lubjanë të sigurojnë zhdëmtimin e plotë, satisfaksionin, kompensimin dhe garantimin për mospërsëritjen e shkëljes së të drejtave ndaj të gjithë personave, të cilët janë goditur nga heqja e statusit të vendqëndrimit të përhershëm.⁷⁹⁴ Sllovenia deri në fund të vitit 2012 nuk ka vepruar në përputhje me këto rekomandime; pagesa e kompensimit zyrtarisht është refuzuar kurse „personat e fshirë“ janë këshilluar që t'i drejtohen gjykatave të rregullta (të cilat paditë e tyre i hedhin poshtë në mënyrë rutinore). Kanë munguar kërkim faljet nga ana e Kryetarit të shtetit dhe Kryetarit të Qeverisë edhe pse „personat e fshirë“ i kanë pritur dhe kërkuar këto. Një përparim paraqesin kërkim faljet e ish Kryetarit të Parlamentit Pavle Gantar dhe të ministres së Punëve të Brendshme, Katarina Kresal.⁷⁹⁵

2.7.2. Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore

137

Qytetarët „e fshirë“ në Slloveni, as në vitin 2010 e as në vitin 2011 nuk kanë marrë reparacione materiale në bazë të vendimeve gjyqësore edhe pse janë në zhvillim e sipër shumë procedura. Pamundësia që paditësit të kompensojnë dëmin me rrugë dytësore vjen nga shumë faktorë, në radhë të parë për shkak të shpenzimeve të larta të proceseve gjyqësore, por edhe për shkak të barrës së rëndë të të provuarit, të parashkrimit dhe të kohëzgjatjes së madhe të procedurave. Një nga rastet e rralla, ku ndonjë pjesëtarë të qytetarëve „të fshirë“ i është ndarë reparacioni, është rasti i Aleksandar Todoroviqit, i cili me vendim të gjykatës në Ptuj ka marrë reparacion prej 17.000 eurosh, por jo në emër të zhdëmtimit për fshirje nga regjistri i vendbanimit të përhershëm, por për shkak të lejes së punës e cila i është marrë në mënyrë jo ligjore.⁷⁹⁶

Në vitin 2010, në Prokurorinë Shtetërore të Sllovenisë janë paraqitur 27 kërkesa për reparacion, në të cilat të

791 *Gazeta zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, Nr.50/2010.

792 Në fillim ka pasur 11 paditës, por një prej tyre ka vdekur para përfundimit të procedurës. Lënda *Kuriq dhe të tjerët kundër Sllovenisë* (parashtrës Nr. 26828/06), aktgjykimi i datës 13 korrik të vitit 2010.

793 Procesi ka përfunduar nga mesi i vitit 2012, kur me aktgjykimin e Kolegjit të madh të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se Republika e Sllovenisë ka shkelur të drejtat „e personave të fshirë“, përkatësisht nenin 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) dhe nenin 13 (e drejta për mjet efektiv juridik) të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Me këtë, gjykata ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe krahas kësaj është konstatuar shkelja e nenit 14 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut (ndalimi i diskriminimit), ngase të shlyerit, si shtetas të dikurshëm të RSFJ-së janë trajtuar më keq se personat që kanë pasur statusin e të huajve.

794 Faqja e internetit e Amnesty International, <http://arhiv.amnesty.si/sl/node/3062>.

795 "Prvo opravičilo izbrisanim in zmaga človekovih pravic" (Kërkim falja e parë ndaj personave të fshirë dhe fitorja e të drejtave të njeriut, *Večer*, 16 qershor 2010.

796 "Fitorja e parë „e „personave të fshirë“ në Slloveni", faqja e internetit e gazetës *Politika*, më 21 shkurt 2009 <http://www.politika.rs/rubrike/Svet/Prva-pobeda-izbrisanih-u-Sloveniji.lt.html>.

dëmtuarit kanë kërkuar zhdëmtim për shkak të procedurave kundërligjore të organeve të Republikës së Sllovenisë lidhur me fshirjen nga regjistri i popullsisë së përhershme.⁷⁹⁷ Nga ky numër, 18 raste janë zgjidhur me anë të paqësimit jashtëgjyqësor, ndërsa në nëntë raste është ngritur padi kundër Republikës së Sllovenisë.⁷⁹⁸ Nga periudha paraprake, në vitin 2010 janë bartur 48 kërkesa prej të cilave nëntë raste janë zgjidhur me paqësim jashtëgjyqësor kurse në 38 raste janë ngritur padi.⁷⁹⁹

Gjatë vitit 2010 janë zgjidhur 35 raste, 16 në gjykatë dhe 19 me paqësim jashtëgjyqësorë, kurse asnjë nga këto 16 aktgjykime nuk ka qenë në favor të paditësit. Tri padi janë tërhequr, ndërsa 13 të tjera kanë përfunduar në favor të shtetit. Në rastet e paqësimit jashtëgjyqësor, 18 kërkesa janë hedhur poshtë nga ana e Prokurorisë Shtetërore Sllovene, ndërsa një rast është zgjidhur në mënyrë tjetër.⁸⁰⁰ Nga fundi i vitit 2010, të pazgjidhura kanë mbetur edhe 41 kërkesa për zhdëmtim – prej tyre 31 raste janë zhvilluar në gjykatë, ndërsa 10 raste janë zgjidhur me paqësim jashtëgjyqësor. Shumica e padive janë hedhur poshtë për shkak të parashkrimit.

Në Prokurorinë Shtetërore, gjatë vitit 2011 janë paraqitur katër kërkesa për zhdëmtim të cilat janë dërguar në paqësim jashtëgjyqësor, ndërsa në gjashtë raste të dëmtuarit kanë ngritur padi kundër shtetit. Në vitin 2011, Prokuroria Shtetërore ka përfunduar 22 raste. Pesë kërkesa janë zgjidhur në favor të Sllovenisë, kurse në tri raste paditë janë tërhequr. Me paqësim jashtëgjyqësor kanë përfunduar 14 raste dhe të gjitha kërkesat për zhdëmtim janë hedhur poshtë si të pabazuara. Deri në fund të vitit 2011 në gjykata ka pasur 29 padi për kompensim të dëmit.⁸⁰¹ Prokuroria publike në këto raste kryesisht i referohet afatit objektiv pesëvjeçar të parashkrimit. Me fjalë të tjera, vendimi i gjykatës kushtetuese me të cilin është konstatuar jokushtetutshmëria e dispozitave të ligjit kontestues të Sllovenisë për të huajt nga viti 1991⁸⁰², është nxjerrë në vitin 1999, andaj për arsye se paditë janë paraqitur pas skadimit të afatit prej 5 vjetësh, të njëjtat janë hedhur poshtë si të parashkruara.

Në gjykatat sllovene janë zhvilluar edhe disa procedura për kompensimin e dëmit të shkaktuar gjatë „luftës dhjetëditore“ në qershor të vitit 1991.⁸⁰³ Në një rast Sllovenia është shpallur përgjegjëse për dëmin që iu ka shkaktuar shtetasve të huaj, automjetet e të cilëve, pjesëtarët e mbrojtjes territoriale sllovene i kanë shfrytëzuar për krijimin e barrikadave kundër forcave të APJ-së dhe me atë rast kanë humbur jetën gjashtë shoferë, 12 janë lënduar dhe janë shkatërruar 20 kamionë. Në procesin e parë gjyqësor në vitin 1999, gjykata Slloveninë e ka shpallur përgjegjëse për plagosjen e qytetarit të Bosnjës dhe Hercegovinës, për 80% të dëmit të përgjithshëm që është shkaktuar dhe ka caktuar pagimin e dëmit në shumë prej 11 milionë Tollarësh (rreth 46.000 euro).⁸⁰⁴

Sipas të dhënave të Prokurorisë Shtetërore të RS, gjykatat në Slloveni, lidhur me konfliktin e armatosur në Slloveni kanë nxjerrë aktgjykime për dëmshpërblim edhe në disa raste, në të cilat gjithashtu është konstatuar përgjegjësia e Republikës së Sllovenisë.⁸⁰⁵

797 Prokuroria Shtetërore e Republikës së Sllovenisë, *Raport vjetor i Prokurorisë Shtetërore për vitin 2010*.

798 Fjala është për detyrimin ligjor që padia kundër shtetit së pari t'i paraqitet Prokurorisë shtetërore për vendosje. Neni 14 i Ligjit për Prokurorinë Shtetërore *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr. 94/2007 dhe 77/2009) përcakton që ai person që dëshiron të ngreh kontest kundër subjekti të cilin e përfaqëson prokuroria publike, para saj duhet këtij t'i propozojë që çështjen kontestuese ta zgjidh me paqësim jashtëgjyqësor. Prokuroria publike ka afat prej jo më shumë se 30 ditë për t'u përgjigjur dhe për vendimin e vet ta njoftoj propozuesin për mundësinë e paqësimit jashtëgjyqësor. Prokuroria Shtetërore e Republikës së Sllovenisë, *Raport vjetor i Prokurorisë Shtetërore për vitin 2010*. f. 44.

799 *Po aty*, f.44.

800 *Po aty*, f.45.

801 Shkresë e Prokurorisë Shtetërore të Republikës së Sllovenisë për hulumtuesin Igor Mekina, e datës 25 janar të vitit 2012.

802 *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, nr.14/1999.

803 Peter Petroviq, „Sllovenia është përgjegjëse“ faqja e internetit e *Mladina*, 13 korrik 2006, <http://www.mladina.si/94992/slovenija-je-odgovorna/>.

804 Prokuroria shtetërore e Republikës së Sllovenisë, *Raport vjetor i Prokurorisë Shtetërore për vitin 2004*.

805 Shkresë e Prokurorisë Shtetërore të Republikës së Sllovenisë për hulumtuesin Igor Mekina, 30 Janar 2012.

3. Kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur dhe kthimi i pronës

3.1. Bosnja dhe Hercegovina

Nga fundi i luftës e deri në fund të vitit 2010 janë evidentuar mbi një milionë persona të kthyer në Bosnjë e Hercegovinë nga të cilët pothuajse gjysma janë të ashtuquajturit të kthyer nga minoritetet (pjesëtarët e komunitetit të caktuar etnik, i cili është pakicë në mjedisin në të cilin kthehet). Nga gjithsejtë 1.048.498 persona të kthyer të evidentuar, rreth 600.000 ose 67% ka të bëjë me kthimin e personave të zhvendosur, kurse 43% të tjerë (rreth 450.000), me kthimin e refugjatëve. Në Federatën e B dhe H janë evidentuar rreth 750.000 të kthyer, gjë që paraqet 71,5% të kthimit të përgjithshëm në B dhe H, ndërsa në territorin e Republika Srpska janë evidentuar rreth 275.000 ose rreth 26,2%. Prej 2,3% të tjerë (rreth 22.600) nga numri i përgjithshëm i të kthyerve është realizuar në rajonin e Distriktit të Bërçkos. Sipas strukturës nacionale, janë kthyer rreth 650.000 boshnjakë, 135.000 kroat, 256.000 serb dhe rreth 8.000 të nacionaliteteve të tjera.

Shkalla e të kthyerve „minoritar“, llogaritur sipas vlerësimit të Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë në bazë të numrit të supozuar të personave që i kanë braktisur vendbanimet e tyre të paraluftës, krahasuar me numrin e të kthyerve – në Federatën e B dhe H është 32% (personat e kthyer të nacionalitetit serb), kurse në Republika Srpska është 30%, ndërsa nga kjo shkalla e kthimit të boshnjakëve është 36,6%, kurse e kroatëve 9,6%. Sipas të dhënave të fundit të ministrive kompetente të entiteteve dhe të qeverisë së Distriktit Brčko, nga fundi i vitit 2011, me statusin e të zhvendosurve në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës ka pasur 38.654 familje, përkatësisht 117.561 persona të zhvendosur.⁸⁰⁶

Sipas të dhënave të Entit të Statistikave të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, numri i përgjithshëm i refugjatëve të kthyer dhe i personave të zhvendosur në FB dhe H në fillim të vitit 2011 ka qenë 739.639, e prej këtij numri 388.058 të kthyer nga bota e jashtme dhe 351.581 të kthyer nga personat e zhvendosur. Numri përgjithshëm i refugjatëve të kthyer dhe i personave të zhvendosur pjesëtarë të minoriteteve në vendet e origjinës në FB dhe H është 275.247, kurse nga ky numër në vitin 2010 janë kthyer 128 persona. Në fillim të të njëjtit vit, në territorin e FB dhe H ka pasur gjithsej 156 refugjatë, nga të cilët nga Serbia (duke përfshirë edhe Kosovën) kanë qenë 139, prej të cilëve 29 persona në strehim kolektiv. Nga shtetet e tjera gjithsej 17 refugjatë, nga të cilët 6 në strehim kolektiv. Numri i përgjithshëm i personave të zhvendosur ka qenë 48.637.⁸⁰⁷

139

Tabela 1. Kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur në B dhe H deri më 31.12.2010.⁸⁰⁸

Federata e B dhe H			Republika Srpska		
Refugjatë	Të zhvendosur	Gjithsej	Refugjatë	Të zhvendosur	Gjithsej
388.442	361.146	749.588	58.441	216.208	274.649

Distrikti Bërçko dhe B dhe H			Bosnja dhe Hercegovina		
Refugjatë	Të zhvendosur	Gjithsej	Refugjatë	Të zhvendosur	Gjithsej
2.306	21.955	24.261	449.189	599.309	1.048.498

806 Ministria për Refugjatë dhe të Drejtat e Njeriut, Kthimi në vitin 2011, dhjetor 2011, f.3.

807 Faqja e internetit e Entit Federal të Statistikave, www.fzs.ba.

808 Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë, informatë për kthim, faqja e internetit e ministrisë <http://www.mhrr.gov.ba/PDF/Izbjeglice/INFORMACIJA%20%20POVRATKU%20DO%202010.pdf>.

Një numër i madh i komunave nuk ka në dispozicion të dhëna për kthimin real të realizuar dhe nuk mbajnë statistika të këtilla, kurse një numër i madh i kthimeve të regjistruara rezulton me shitjen e pronës dhe me braktisjen e përhershme të vendbanimit të paraluftës. Andaj, rezultatet reale të kthimit do të mund të analizoheshin vetëm kur të jetë bërë regjistrimi i popullsisë.⁸⁰⁹ Ministria për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur në Republika Srpska, me status të personave të zhvendosur ka edhe 19.536 familje (61.776 persona), dhe 2.856 familje refugjatësh (9.002 persona).⁸¹⁰

Kuvendi Parlamentar i BdheH, në qershor të vitit 2010 ka miratuar Strategjinë e korrigjuar për zbatimin e Aneksit VII të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit, e cila merret me identifikimin e mundësive të zgjidhjeve afatgjata për refugjatë dhe për persona të zhdukur.⁸¹¹ Kjo strategji parashikon rimëkëmbjen dhe rekonstruktimin e pronës së paraluftës dhe me zgjidhjen e çështjeve të banimit në vendin e tanishëm të banimit si dhe me kompensimin („kompensimin e drejtë“) e pronës, e cila nuk mund të kthehet.

Strategjia e korrigjuar, si prioritet të padyshimtë përcakton mbylljen e qendrave kolektive. Disa nga masat të cilat, sipas Strategjisë së korrigjuar, do të zbatohen me prioritet, kanë për qëllim shterimin e plotë të kësaj forme të banimit në përputhje me nevojat reale të shfrytëzuesve aktual të kësaj forme të strehimit. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet kategorive të lëndueshme.⁸¹² Planifikohet edhe miratimi i zgjidhjeve të reja ligjore të cilat do të duhej të parandalonin shkeljen eventuale të të drejtave të personave në këtë proces, duke përfshirë parandalimin e pasojave të dëbimit me forcë.⁸¹³ Pritet që ky proces të përfundojë në vitin 2014.⁸¹⁴

3.1.1. *Kthimi i pronës*

Sipas statistikave të fundit, të cilat i kanë publikuar agjencitë PZLP, në BdeH gjithsej janë parashtruar 211.791 kërkesa për kthimin e pronës dhe të të drejtave të banimit.⁸¹⁵ Janë nxjerrë gjithsej 197.815 vendime pozitive dhe 12.642 vendime negative. Numri i rasteve të përfunduara është 197.688, gjë që është mbi 99% të të gjitha rasteve, dhe kjo punë ndodhet në fazën finale të realizimit në BdeH. Për shkak të rezultateve që janë arritur në planin e kthimit të pronës dhe të të drejtave të banimit, Bosnja dhe Hercegovina trajtohet si shembull i mirë në rajon, por edhe më gjerë. Pasi që me përfundim thelbësor nënkuptohet se pronarët/shfrytëzuesit e para luftës janë sjellë në posedim të pronave të veta/të të drejtave të banimit, në rastet e tjera për shkak të statusit kontestues faktik dhe juridik ende janë duke u zhvilluar procedura administrative, konteste ose janë ngritur procedura kontestimore në gjykatat kompetente.⁸¹⁶

Edhe më tej problem paraqesin njësitë e shkatërruara banesore, gjetja e zgjidhjeve për personat të cilët si pasojë e kësaj janë strehuar në qendrat kolektive, pastaj krijimi i mundësive për kthim të qëndrueshëm. Në BdeH ende

809 Informatë për kthimin, faqja e internetit e Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë, <http://www.mhrr.gov.ba/PDF/Izbjeglice/INFORMACIJA%20O%20POVRATKU%20DO%202010.pdf>.

810 Informacione të marra nga Ministria për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur e Republika Srpska në datën 11 janar të vitit 2012.

811 *Strategjia e Bosnjës dhe Hercegovinës për zbatimin e Aneksit VII të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit*, e cila është hartuar nga fundi i vitit 2002 ka qenë dokumenti i parë dhe i përbashkët kornizë në nivel të Bosnjës dhe Hercegovinës me të cilin përkufizohen qëllimet dhe planifikohen aksionet dhe reformat e nevojshme në drejtim të realizimit final të dispozitave të Aneksit VII të marrëveshjes së përgjithshme kornizë për paqe në BdeH, të të ashtuquajturës Marrëveshjes së Dejtonit, me të cilën definohet kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur. Ky dokument ka rëndësi të posaçme për arsye se e kanë pranuar edhe institucionet dikasteriale shtetërore dhe të entiteteve si dhe strukturat e bashkësisë ndërkombëtare në BdeH. Strategjia e korrigjuar për zbatimin e Aneksit VII të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit, prill 2010.

812 Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë, *Raporti i dytë periodik i Bosnjës dhe Hercegovinës për implementimin e traktatit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, viti 2010*.

813 Strategjia e reviduar për zbatimin e Aneksit VII të marrëveshjes paqësore të Dejtonit, viti 2011

814 Informacione të marra nga Ministria për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur e Republika Srpska, të datës 11 janar të vitit 2012.

815 Në vitin 2000, bashkësia ndërkombëtare në BdeH ka themeluar të ashtuquajturin PLIP (Planin e zbatimit të ligjeve pronësore) themelor për përcjelljen dhe aplikimin e dispozitave relevante që ka qenë e përbërë nga katër organizata udhëheqëse të bashkësisë ndërkombëtare në BdeH: OHR, OSCE, UNHCR dhe CRPC. Përfaqësuesit e PLIP-it publikojnë tregues mujor statistikor prej nivelit komunal deri në nivelin e BdeH, duke analizuar dhe krahasuar këta tregues.

816 Strategjia e reviduar e zbatimit të Aneksit VII të marrëveshjes paqësore të Dejtonit, viti 2011, faqe 27.

ekzistojnë rreth 160 qendra të refugjatëve, në të cilat jetojnë 2.865 familje, përkatësisht 7.490 persona. Në kontekst të zbatimit të strategjisë së korigjuar, të zbatimit të Aneksit VII me të cilën gjetja e zgjidhjeve afatgjata për strehimin e këtyre personave është caktuar në krye të prioritetëve të BdheH, BeH në vitin 2011 ka filluar negociatat me Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB) për sigurimin e mjeteve të nevojshme. Është parashikuar rindërtimi i objekteve ekzistuese banesore të shfrytëzuesve të qendrave të refugjatëve, ndërtimi i objekteve të reja si dhe ndërtimi i objekteve të reja të përbashkëta për këto kategori të qytetarëve (të tipit gerijatrik ose të ngjashëm).⁸¹⁷ Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët e BdheH ka një bazë të të dhënave për rreth 45.000 familje, përkatësisht për rreth 150.000 persona të cilëve iu nevojitet ndihmë për rindërtimin e njërive banesore me qëllim të kthimit vullnetar në BdheH.⁸¹⁸

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, në maj të vitit 2010 ka nxjerrë aktgjykimin lidhur me rastin „*Gjokiq kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*“ me të cilin është caktuar pagesa prej 60.000 euro në emër të dëmit material dhe 5.000 euro në emër të dëmit jo material lidhur me shkeljen e Protokollit të parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht lidhur me kthimin e pronës. Fjala është për përpjekjet e pasuksesshme të aplikantit pavarësisht nga kontrata e vlefshme ligjore për shitblerje, për të kthyer në posedim banesën e vet të paraluftës dhe për ta regjistruar në emër të vet.⁸¹⁹ Pasi që Qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës e ka paguar këtë shumë, kundër Federatës së BdheH, në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë ngritur 14 padi të tjera të cilat gjithashtu kanë të bëjnë me kërkimin e dëmshpërblimit për banesat ushtarake të ish- pjesëtarëve të APJ-së.⁸²⁰

3.2. Kroacia

Intensiteti i kthimit të refugjatëve në Kroaci, nga viti në vit është më i dobët duke marrë parasysh se nga përfundimi i luftës kanë kaluar më tepër se 16 vite. Statistikën e kthimit në RK e mbanë Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe e Fondeve të Unionit të Bashkimit Evropian, sepse ajo është trashëgimtar juridik i Zyrës për refugjatë, persona të kthyer, dhe të dëbuar. Statistika e kthimit është mbajtur prej vitit 1995, të cilën institucionet e konsiderojnë si fillim të kthimit, edhe pse një numër i vogël i refugjatëve është kthyer edhe në periudhën e mëhershme.

Sipas të dhënave të tyre, deri në fillim të vitit 2010 janë regjistruar gjithsej 347.405 të kthyer. Gjatë viteve 2010 dhe 2011, gjithashtu sipas të dhënave të ministrisë janë evidentuar 6.844 të kthyer. Në këtë periudhë, numrin e përgjithshëm të të kthyerve e përbëjnë 248 të dëbuar⁸²¹ dhe 6.596 refugjatë nga Bosnja dhe Hercegovina, Mali i zi dhe nga Serbia. Statistikën e kthimit e mbanë Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (United Nations High Commissioner for Refugees – UNHCR (angl.)). Të dhënat e UNHCR-së dhe të ministrisë kompetente dallojnë në një mënyrë. Kështu, të dhënat e UNHCR-së tregojnë se si në Kroaci gjatë viteve 2010 dhe 2011 janë kthyer 843 refugjatë nga Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia (prej të cilëve 538 persona në vitin 2010 dhe 305 persona në vitin 2011), dhe 4.187 persona të zhvendosur (prej të cilëve 2.128 persona në vitin 2010 dhe 2.059 persona në vitin 2011).⁸²²

Realizimi i të drejtave të të kthyerve në nivel lokal dhe integrimi i të kthyerve ndryshon shumë, nga komuniteti në komunitet. Integrimi ka përparuar më mirë në vendet ku përqindje më të lartë të popullsisë përbëjnë pjesëtarët e pakicave kombëtare ose të kthyerit.⁸²³

817 Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatë, raporti i dytë periodik i Bosnjës dhe Hercegovinës për zbatimin e traktatit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, viti 2010.

818 Ministria për Refugjatë dhe të Drejtat e Njeriut: Kthimi në vitin 2011. Dhjetor, 2011, f.4.

819 Lënda „*Gjokiq kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*“, (parashtrës nr. 6518/04), 27 maj 2010.

820 “Kundër Federatës së BdheH janë ngritur 14 padi të tjera“, faqja e internetit e portalit *Bitno* <http://www.bitno.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/protiv-federacije-pokrenuto-14-tuzbi>.

821 Kroacia me termin „të dëbuar“ kupton personat e zhvendosur sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare.

822 Shih faqen e internetit të UNHCR-it në Kroaci: http://unhcr.hr/images/stories/news/stats/docs/2_2012/unhcr_statistical_report_december_2011.pdf.

823 Në këtë aspekt është i dukshëm një përparim më i madh në integrimin në vendet ku personat e kthyer janë nga grupet e ndryshme etnike, por që ndajnë fatin e ngjashëm të kthimit ose të vendosjes nga zonat e përfshira me luftë (p.sh., Vojniq)

Studimi i ri i UNHCR-së i hartuar në Kroaci, bazuar në hulumtimin e kryer në mostrën prej 1.400 të kthyerve të regjistruar, tregon se mbi 33% të të kthyerve ka vendbanim të përhershëm në Kroaci, që është më pak se sa në vitin 2007 (38.3%). Gjithashtu, anketa ka treguar se shfrytëzuesit e programit të qeverisë për sigurimin e banimit mbeten dhe jetojnë në Kroaci në një numër tri herë më të madh se të personat e tjerë të kthyer. Në këtë studim përmendet se 43% të shtëpive “të cilat duken të zbrazëta rregullisht mirëmbahen” në bazë të të cilave konkludohet se ekzistojnë “strategjitë individuale transnacionale të kthimit mbi bazën e të cilave personat të cilët formalisht kanë realizuar kthimin në Kroaci kërkojnë zgjidhje brenda rajonit ose diku tjetër dhe presin zgjidhje më të mira dhe më të qëndrueshme për veten dhe për familjet e veta”.⁸²⁴

3.2.1. Kthimi dhe rimëkëmbja e pronës

Procesi i kthimit të pronës është pothuajse në fund. Pronarëve gjithsej iu janë kthyer 19.267 shtëpi kryesisht deri në vitin 2005, kurse aktualisht janë në zhvillim e sipër edhe 13 procedura për kthimin e pronës, të cilat zhvillohen me rrugë gjyqësore për shkak të zhvendosjes së shfrytëzuesve të përkohshëm. Nga këto 13 procedura, tri procedura janë duke u zhvilluar edhe për shkak të investimeve të paautorizuara.⁸²⁵

Problem kryesor, në aspektin e kthimit të pronës ka paraqitur zgjidhja e çështjeve të banimit të të ashtuquajturve ish-titullarëve të të drejtës banesore.⁸²⁶ Kthimi i pronës të ashtuquajturve ish-titullarëve të të drejtave banesore është rregulluar me Ligjin për zonat e mbrojtjes së posaçme shtetërore dhe me vendimet e Qeverisë së RK.⁸²⁷ Qeveria cakton afatin brenda të cilit personat e kthyer mund t’iu parashtrojnë kërkesë autoriteteve kompetente të administratës shtetërore për kthimin e pronës, kurse ky afat tashmë e shumë vite po zgjatet. Përveç zgjidhjeve ligjore dhe rregulloreve të qeverisë aplikohet edhe Ligji për të huajt në rastet që kanë të bëjnë me parashtruesit e kërkesave të cilët nuk janë shtetas të Kroacisë, por këtë status e kanë humbur pas braktisjes së pronës si pasojë e ngjarjeve të luftës. Në shumicën e rasteve fjala është për serbët etnik të cilët qysh nga viti 1991 e kanë braktisur Kroacinë e të cilët nuk kanë paraqitur kërkesa për certifikatë të shtetësisë kroate, andaj edhe më tutje janë evidencuar si të huaj (në momentin e parashtrimit të kërkesës) edhe pse kanë pasur dëshmi personale kroate. Sipas të dhënave të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe të Fondeve të Bashkimit Evropian, gjatë viteve 2010 dhe 2011, në mënyrë të përshtetshme është zbatuar procesi i strehimit të ish-titullarëve të të drejtës banesore në dhe jashtë zonës së mbrojtjes së posaçme shtetërore (ZMPSH), kështu që në këtë periudhë janë strehuar 1.891 familje.⁸²⁸

Një nga problemet me të cilat ballafaqohen disa grupe të të kthyerve paraqesin dispozitat me të cilat urdhërohet diferenca në qasjen ndaj të drejtave për personat sipas rajoneve nga të cilat kthehen në RK. Për shembull, personat e kthyer kroat nga Bosnja dhe Hercegovina kanë të drejtën e faljes së banesave, ndërsa këtë të drejtë nuk e kanë personat e kthyer nga rajonet e tjera (për shembull nga Serbia).⁸²⁹

Sa i përket rimëkëmbjes së pronës, numri i kërkesave për rimëkëmbje është zvogëluar në mënyrë drastike nëpërmjet procesit të mbylljes së negociatave për aderim në Bashkimin Evropian. Në realizimin e të drejtave për rimëkëmbje prioritet u është dhënë mbrojtësve kroat dhe kroatëve etnik. Kjo përparësi është rregulluar me ligj

824 „Kthimi i minoriteteve në Kroaci – Studimi i procesit të hapur“, faqja e internetit e Udruge Mi, 29. shkurt 2009, <http://www.udrugami.hr/item/165-manjinski-povratak-u-hrvatsku-studija-otvorenog-procesa.html>. Studimi nuk ka pasur qasje në internet në kohën e përgatitjes së raportit.

825 Informacion i marrë nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe e Fondeve të Bashkimit Evropian, i datës 6 shkurt të vitit 2012.

826 Fondi për të Drejtën Humanitare, Documente & BIRN, *E drejta tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2009*, f. 68-69.

827 Ligji për zonat e mbrojtjes së posaçme shtetërore, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr. 86/08 dhe nr.57/11; Vendim për zgjidhjen e çështjes së banimit të të kthyerve – ish titullarëve të të drejtës banesore në fushat jashtë fushës së mbrojtjes së posaçme shtetërore, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* nr. 29/11 dhe 139/11), Vendim për zbatimin e kujdesit për strehimin e të personave të kthyer – të ish titullarëve të të drejtave banesore për banesat jashtë PPDS, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë*, nr.63/08), Konkluzion për mënyrën e përkujdesit të strehimit ndaj personave të kthyer që nuk janë pronarë të shtëpisë ose banesës e që kanë jetuar në banesat në pronësi shoqërore, në viset e RK, që janë jashtë ZMPSH.

828 Nga kjo 1.391 në fushat e mbrojtjes së posaçme shtetërore dhe 500 jashtë kësaj fushe.

829 Për shkak të dispozitave diskriminuese të lartpërmendura në realizimin e të drejtave për kthimin e pronës, Forumi demokratik serb është duke përgatitur padi kushtetuese.

edhe për rimëkëmbjen dhe për zgjidhjen e çështjes së banimit.⁸³⁰ Këto ligje ofrojnë sistemin e poentimit, sipas të cilit caktohen rastet prioritare për rimëkëmbje. Meqenëse numri më i madh i kërkesave është zgjidhur, problem themelor paraqet dispozita e theksuar në nenin 5 paragrafi 12 i Ligjit për fushat e mbrojtjes së posaçme shtetërore në bazë të së cilës “shfrytëzuesi i të drejtës për rimëkëmbje, i cili këtë të drejtë e ka realizuar në bazë të Ligjit për rimëkëmbje, është i obliguar që në shtëpinë e rimëkëmbur familjare të vendoset brenda 30 ditëve nga dita e kontrollit të kryer teknik dhe në te të qëndrojë të paktën 10 vite dhe brenda këtij afati nuk guxon të njëjtën ta shesë, ta falë ose në çfarëdo mënyre tjetër ta tjetërsojë, pa pëlqimin e ministrisë”. Gjatë viteve 2010 dhe 2011, organizatat që ofrojnë ndihmë juridike për shfrytëzuesit e këtyre të drejtave, në shumicën e rasteve, të serbëve etnik, kanë evidentuar disa raste në të cilat ministria kompetente nga MPB ka kërkuar të kryejë verifikimet operative dhe nëse ka konstatuar se pronarët e shtëpive nuk qëndrojnë në to, kanë ngritur procedura gjyqësore për kthimin e mjeteve të investuara.⁸³¹

3.3. Serbia

UNHCR, në vitin 2008 e ka futur Republikën e Serbisë në listën e pesë vendeve me krizë afatgjatë të refugjatëve në botë, si dhe si vendin me numrin më të madh të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në Evropë, dhe ky status deri më sot është i pandryshuar.

Në Republikën e Serbisë, në vitin 2010 janë strehuar 86.000 persona me status të refugjatit, kurse gjatë vitit 2011 ky numër është zvogëluar në 74.487 persona. Numri i personave të zhvendosur në brendi ka mbretur i pandryshuar në raport me vitin 2010 dhe ai është 210.148 persona.⁸³² Në mesin e personave refugjatë, pothuajse gjysma e tyre është më e vjetër se sa mosha 50 vjeçare, derisa në mesin e personave të zhvendosur numri më i madh (prej mbi 26 për qind) është i moshës prej 15 dhe 29 vjeç.

Në fund të vitit 2010 në Serbi kanë ekzistuar 54 qendra kolektive, në të cilat kanë banuar 4.256 persona (898 refugjatë dhe 3.358 persona të zhvendosur në brendi). Në vitin 2011 janë mbyllur 13 qendra kolektive me sigurimin e zgjidhjeve afatgjatë për 753 përfitues, të cilët i kanë lëshuar. Për momentin ekzistojnë edhe 41 qendra kolektive, prej të cilave 13 gjenden në territorin e Kosovës. Në qendrat kolektive strehohen gjithsejtë 3.503 persona (667 refugjatë dhe 2.836 persona të zhvendosur në brendi).

Në vitin 2010, në mënyrë të qëndrueshme janë integruar (ofrimi i mbështetjes për zgjidhjen e çështjes banesore) 1.705 familje të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në brendi dhe edhe 1.469 familje në vitin 2011. Gjatë këtyre dy viteve, ekonomikisht janë fuqizuar 2.754 familje.⁸³³

3.3.1. Kthimi i pronës

Çështja e kthimit të pronës dhe e sigurimit të kushteve për shfrytëzim të papenguar të asaj prone krahas qasjes ndaj të gjitha të drejtave të tjera të nevojshme për zhvillimin e jetës normale, janë obligime të vendeve të origjinës. Duke qenë se Serbia ka më së shumti persona me çështje të statusit të hapur nga të gjitha vendet e rajonit, çështja e kthimit të pronës është pjesë e obligimeve të tyre, por përmes avokimit të qasjes ndaj të drejtave me rrugë të marrëveshjeve ndërshtetërore për personat të cilët banojnë në Serbi si barrë të buxhetit (personat me statusin e refugjatëve dhe të të zhvendosurve). Kur procesi i qasjes rajonale të zgjidhjes së çështjeve të refugjatëve dhe të të

830 Shih: Ligji për Zonat e mbrojtjes së posaçme shtetërore, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* nr. 86/08 dhe nr. 57/11 dhe Ligji për rimëkëmbje, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* nr.24/96, nr.54/96, nr.87/96, nr. 57/00, nr. 38/09, nr. 45/11.

831 Disa biseda me përfaqësuesit e Këshillit Popullor Serb dhe të Forumit Demokratik Serb. Intervistë me Tatjana Vukobratović Spasojević, këshilltare juridike në KPS, shkurt 2012.

832 Nga ky numër, 157.437 janë persona të kombësisë serbe, kurse 22.823 të kombësisë rome. Informacione të marra nga Komisioni për Refugjatë të Republikës së Serbisë, 30 dhjetor i vitit 2011.

833 Mjetet, një pjesë e tyre, janë siguruar nga buxheti i Republikës së Serbisë, kurse në pjesën më të madhe me projektet shumëvjeçare të donatorëve të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, UNHCR-së, Bashkimit Evropian, INTERSOS, The Bureau of Population, Refugees, and Migration (BPRM), dhe të tjerëve.

zhvendosurve është përtëritur, gjatë vitit 2010 dhe 2011 janë mbajtur nëntë takime bilaterale të përfaqësuesve të Kroacisë dhe të Serbisë dhe, paralelisht me këtë, mbi çështjen e kthimit të pronës për refugjatët nga Kroacia, të cilët gjenden në Serbi, është biseduar gjatë takimeve të kryetarëve të Kroacisë dhe Serbisë.⁸³⁴ Rezultat i takimeve të tilla të negociatave të llojit të vet është ndryshimi i politikës ndaj refugjatëve, që ka rezultuar me përkujdesjen edhe për personat e tjerë në nevojë për zgjidhjen e çështjes banesore (duke përfshirë edhe ata të cilët nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre pronësore dhe banesore).⁸³⁵ Këto masa janë mbështetur me Përfundimin e qeverisë së Serbisë mbi pranimin e Propozimit të masave për zgjidhjen e problemeve të refugjatëve në Republikën e Serbisë, të cilin e ka përkufizuar Komisioni për Refugjatët i Republikës së Serbisë.⁸³⁶ Me këtë është vendosur që Serbia të fokusohet në programe të integritit afatgjatë të ish refugjatëve dhe të refugjatëve të tashëm, të cilët me vullnetin e tyre janë përcaktuar për integrim në Serbi.

3.4. Kosova

Sipas të dhënave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, numri i tërësishëm i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur, të cilët janë kthyer në Kosovë nga viti 2000 deri në vitin 2011 është 9.766 serb, 3.241 romë, 6.193 egjiptian dhe ashkali, 1.691 boshnjak, 1.321 goran, dy pjesëtarë të pakicës turke, një kroat dhe 11 malazet. Nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2010, janë kthyer vullnetarisht gjithsejtë 2.214 pjesëtarë të pakicave në Kosovë dhe ky është kthimi më i madh i pakicave në gjashtë vitet e fundit.⁸³⁷ Në mesin e personave të kthyer janë 898 serb, 371 romë, 711 egjiptian dhe ashkali, 49 boshnjak, 182 goran, një turk, një kroat dhe dy malazet. Në vitin 2011 janë kthyer 1.004 pjesëtarë të pakicave, 419 serb, 110 romë, 311 egjiptian dhe ashkali, 50 boshnjak, 104 goran, një turk dhe nëntë malazet.⁸³⁸

Buxheti i qeverisë për mbështetje të kthimit dukshëm është zvogëluar dhe në vitet e fundit është në rënie të përhershme.⁸³⁹ Qeveritë komunale ballafaqohen me vështirësi në sigurimin e banesave sociale për personat e kthyer pa pronë, dhe ato ende nuk janë në gjendje të përgjigjen ndaj nevojave të tashme dhe afatgjata të personave të zhvendosur në brendi dhe të personave të kthyer, për shkak të mungesës së mjeteve për atë destinim.⁸⁴⁰ Së këndejmi, ende nuk mund të flitet mbi strategjitë afatgjata për integrimin e personave të kthyer, edhe pse ka përpjekje në atë drejtim. Strategjia e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është miratuar në datën 12 shkurt të vitit 2010. Me Strategji janë të parapara punësimet e përhershme nëpër komuna për zyrtarët e autorizuar për organizimin e kthimit. Po ashtu është caktuar toka e cila tash iu jepet personave të kthyer për shfrytëzim afatgjatë (99 vite) me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së procesit të kthimit.⁸⁴¹

3.4.1. Kthim i pronës

Agjencioni Kosovar i Pronës (KPA – Kosovo Property Agency [angl.]), merret me zgjidhjen e kërkesave në lidhje me luftën në Kosovë, që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. Ajo e ka trashëguar edhe një pjesë të mandatit të Komisionit për kërkesat banesore dhe pronësore (Housing and Property Claims Commission - HPCC) dhe Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore (Housing and Property Directorate - HPD) të cilat në ndërkohë janë mbyllur (pas themelimit të KPA-së). Ajo pjesë e mandatit, të cilin e ka marrë KPA-ja ka të bëjë me vendimet mbi marrëdhëniet pronësore-juridike të cilat kanë

834 "Josipoviqi në vizitë Serbisë", *Koha* nr. 1020, 22 korrik i vitit 2010.

835 Informacion i marrë nga Komisioni për Refugjatët i Republikës së Serbisë, 30 dhjetor i vitit 2011.

836 Përfundim i Qeverisë së Serbisë 05. Nr: 019-9265/2010, 9 dhjetor i vitit 2010.

837 Të dhënat në Raportin e Komisionit Evropian mbi përparimin e Kosovës për vitin 2010 janë paksa të ndryshme. Sipas atij Raporti, nga muaji janar deri në muajin nëntor të vitit 2010 në Kosovë janë kthyer rreth 1.600 persona; f. 19. European Commission Kosovo* 2010 Progress Report, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf.

838 Informacion i marrë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, muaji dhjetor i vitit 2011.

839 Buxheti i kësaj Ministrie për vitin 2008 ka qenë 9.118.553 euro, në vitin 2010 – 8.743.889 euro, kurse në vitin 2011 ka qenë 7.160.317 euro; Ministria për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Buxhet dhe Financa, faqja e internetit Ministrisë. <http://www.mkk-ks.org/?page=3,93>.

840 European Commission Kosovo* 2010 Progress Report, f. 19-20.

841 *Po aty*, faqe 21.

pritur për përmbartim, si dhe me udhëheqjen e pronës, e cila i është lënë nën drejtorinë e HPD-së. KPA-ja ka edhe mandat ekzekutiv që në bashkëpunim me Policinë e Kosovës për të siguruar dëbimet dhe vendosjen e pronarëve të ligjshëm.⁸⁴² Deri tash, nga themelimi (2006) KPA-ja ka pranuar gjithsejtë 41.471 kërkesa për zgjidhjen e kontesteve pronësore. I ka zgjidhur edhe 23.908 kërkesa, të cilat kanë qenë në kompetenca të HPCC. Zgjidhja e të gjitha kërkesave të tjera të mbetura, numri i të cilave nuk është i njohur, është planifikuar deri në fund të vitit 2012.⁸⁴³

Në këtë kuptim, duke qenë se një numër i madh i këtyre kërkesave janë në lidhje me të drejtat e pakicave në kuadër të bashkësisë shumicë, ekzistojnë probleme të mëdha në realizimin e kërkesave. Së këndejmi, nënshkrimi i memorandumit mbi bashkëpunimin midis KPA-së dhe KP (2009.) është me një peshë të veçantë, sepse i ka shpejtuar dhe i ka thjeshtuar procedurat e dëbimit të personave në mënyrë të paligjshme të vendosur. Deri tash, bashkëpunimi në bazë të këtij memorandumit është i kënaqshëm, me përjashtim të implementimit në pjesën veriore të Kosovës.⁸⁴⁴

3.5. Mali i Zi

Personat me prejardhje nga Bosnja dhe Hercegovina në Mal të Zi kanë status të refugjatëve, derisa personat nga Kosova kanë statusin e personave të zhvendosur në brendi. Me përkujdesjen e tyre merret Enti për përkujdesje të refugjatëve (EPPR), trashëgimtar juridik i Komisarariatit për refugjatët, i cili ka ekzistuar nga viti 2006.⁸⁴⁵ EPPR kujdeset për udhëheqjen e bazës së të dhënave të personave të zhvendosur nga Kosova, kurse në kompetenca të MPB-së është udhëheqja e bazës së të dhënave të personave të zhvendosur nga Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Refugjatët dhe personat e zhvendosur në Mal të Zi ballafaqohen me një varg problemesh, para së gjithash në lidhje me marrjen e shtetësisë. Me nenin 4 të Ligjit mbi Shtetësinë të Malit të Zi është e paraparë që shtetësia malaziasë arrihet me lindje në territorin e Malit të Zi. Fëmijët e të zhvendosurve dhe të personave të zhvendosur në brendi në komunat e Tivarit, Cetinjes, Rozhajës dhe Bijelo Poljes automatikisht regjistrohen në librin e shtetasve në bazë të faktit se kanë lindur në Mal të Zi.⁸⁴⁶ Megjithatë, pas kalimit të regjistrave amë nga kompetenca e komunës në kompetenca të MPB-së nga data 1 janar e vitit 2010, këta fëmijë janë çregjistruar nga libri i shtetasve.⁸⁴⁷

Shoqata e personave të zhvendosur, e refugjatëve dhe e personave të dëbuar konsideron se me këtë veprim në disa baza është bërë diskriminim i gati 18.000 personave të zhvendosur dhe të zhvendosur në brendi, të cilët dëshirojnë të fitojnë shtetësinë malaziasë.

Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi e ka refuzuar në muajin dhjetor të vitit 2011 kërkesën e Shoqatës së personave të zhvendosur, të refugjatëve dhe të personave të dëbuar që ta rishqyrtojë vendimin e Malit të Zi të vitit 2008, i cili e pamundëson marrjen e shtetësisë për ata persona të cilët, për shkak të ngjarjeve të luftës, kanë ardhur në Mal të Zi.⁸⁴⁸ Zgjidhjet aktuale ligjore ua mundësojnë personave të zhvendosur nga Kosova, Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina statusin e të huajve me qëndrim të përhershëm, si „zgjidhje kalimtare“ deri te statusi i shtetasit të Malit të Zi. Me zgjidhjet e reja ligjore (nga muaji nëntor i vitit 2011) është e mundur që të parashtrohet kërkesa për status të të huajit me qëndrim të përhershëm deri në datën 31 dhjetor të vitit 2012.⁸⁴⁹

842 Agjencioni Kosovar i Pronës, mbi mandatin, <http://www.kpaonline.org/sr/about.asp>.

843 Komunikim me email me Arian Krasniqin, zëdhënësin e AKP-së, i datës 9 dhjetor të 2011.

844 Komunikim me email me Arian Krasniqin, zëdhënësin e AKP-së, i datës 7 dhjetor të 2011.

845 Faqja e internetit e Entit për përkujdesje për refugjatët, www.zzzi.co.me.

846 Strategjia për zgjidhjen afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe personave të zhvendosur në brendi me vështrim të veçantë në fushën Konik, Podgoricë, 2011, f.14.

847 *Po aty*, f. 15.

848 Pasqyrë e punës së Gjykatës Kushtetuese në vitin 2011, faqja e internetit e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, <http://www.ustavnisudcg.co.me/Pregled%20rada%20Ustavnog%20suda%20za%202011.godinu.pdf>.

849 Faqja e internetit e Entit për përkujdesje për refugjatët, www.zzzi.co.me.

Deri në mesin e muajit korrik të vitit 2011, MBP e Malit të Zi ka lëshuar 2.180 leje për qëndrim të përhershëm prej gjithsejtë 4.190 aplikacioneve, që është 30 për qind nga numri i tërësishëm i personave të zhvendosur dhe i atyre të zhvendosur në breni, të cilët në datën 7 nëntor të vitit 2011 kanë pasur afat për t'u paraqitur për status të të huajit.⁸⁵⁰

Të zhvendosurit dhe personat e zhvendosur në brendi, të cilët e kanë fituar statusin e të huajit me banim të përhershëm në Mal të Zi, kanë të drejtë në qasje ndaj shtetësisë malaziasë pas dhjetë vitesh të qëndrimit të ligjshëm si persona me banim të përhershëm, ose nëse janë në martesë me shtetasin malaziasë ose shtetasen malaziasë së paku tri vite dhe në mënyrë të ligjshme dhe pa ndërprerje banojnë në Mal të Zi së paku pesë vite, para parashtrimit të kërkesës për praninë në shtetësinë malaziasë.⁸⁵¹ Nga muaji maj i vitit 2008 deri në muajin korrik të vitit 2011, rreth 600 persona të zhvendosur nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia e kanë fituar shtetësinë e Malit të Zi, kryesisht për shkak të lidhjes së martesave me shtetas malaziasë. Të gjithë personat, të cilët kanë parashtruar kërkesë për shtetësi malaziasë, pos personave bashkëshortët martesor të të cilëve janë shtetas malaziasë, kanë qenë të detyruar për të ofruar dëshmi mbi heqjen dorë nga shtetësia e mëhershme.⁸⁵² Megjithëkëtë, me ndryshimet e Ligjit mbi shtetësinë të muajit shtator të vitit 2011, shtetasit e vendeve të ish Jugosllavisë me banim të përhershëm në Mal të Zi, prej së paku pesë vite para referendumit, kanë mundur për të parashtruar kërkesë për marrjen e shtetësisë malaziasë deri në datën 31 janar të vitit 2012 dhe ta marrin shtetësinë me anë të premisë, pa lëshim të shtetësisë së përparshme.⁸⁵³

Në muajin dhjetor të vitit 2011 në evidencën e EPPR kanë qenë 9.300 persona të zhvendosur në brendi nga Kosova (pararegjistrimi është kryer në periudhën prej datës 14 shtator të vitit 2009 deri në datën 14 shkurt të vitit 2010), kurse në evidencat e MPB-së kanë qenë 3.800 persona të zhvendosur nga Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Nga viti 2005, në Mal të Zi zbatohet programi i kthimit vullnetar të personave të zhvendosur në brendi në Kosovë. Gjithsejtë janë kthyer 2.692 persona. Gjatë vitit 2011, sipas të dhënave të EPPR, në Kosovë janë kthyer 19 persona.⁸⁵⁴

Sipas të dhënave nga muaji korrik i vitit 2011, vetëm 7,7 për qind e personave të zhvendosur në brendi jetojnë në banesa me qira, prej tyre 11,1 për qind jetojnë në strehim kolektiv, kurse shumica - 61,2 për qind jetojnë në strehime vetjake pa pronësi ligjore. Vetëm 19,4 për qind prej tyre pohojnë se kanë strehimin me pronësi të rregulluar ligjore.⁸⁵⁵

Qeveria e Malit të Zi ka miratuar në muajin prill të vitit 2005 Strategjinë Nacionale për zgjidhjen e përhershme të problemit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në brendi në Mal të Zi. Megjithëkëtë, qëllimet e saj nuk janë përmbushur, sepse nuk është zgjidhur çështja statusore e personave të zhvendosur dhe të atyre të zhvendosur në brendi, kurse problem ka qenë edhe mungesa e mjeteve materiale.⁸⁵⁶ Qeveria e Malit të Zi në bashkëpunim me UNHCR-në dhe Delegacionin e BE në Mal të Zi gjatë vitit 2009 ka miratuar Planin e Veprimit për zgjidhjen e përhershme të statusit të personave të zhvendosur nga ish republikat jugosllave dhe personat e zhvendosur në brendi nga Kosova, të cilët banojnë në Mal të Zi, kurse në muajin korrik të vitit 2011 Ministria e Punës dhe e Kujdesit Social e ka miratuar Strategjinë për zgjidhje afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe të zhvendosur në brendi me përqendrim të veçantë në fushën e Konikut, me çka Plani i Veprimit i vitit 2009 ka

850 Strategjia për zgjidhjen afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe personave të zhvendosur në brendi me vështrim të veçantë në fushën Konik, Podgoricë, 2011, f.17.

851 Ligji mbi shtetësinë malaziasë, neni 8 dhe 11, *Gazeta zyrtare e Malit të Zi*, nr. 13/2008.

852 Strategjia për zgjidhjen afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe personave të zhvendosur në brendi me vështrim të veçantë në fushën Konik, Podgoricë, 2011, f. 23.

853 „Ndryshimet e ligjit sjellin një numër të rëndësishëm të shtetasve të ri”, faqja e internetit *Radio Slobodna Evropa*, 8 shtator i vitit 2011, http://www.slobodnaevropa.org/content/crna_gora_drzavljanstvo/24322365.html.

854 http://www.zzzi.co.me/index_files/Statistika.htm, qasje e datës 20.1.2012.

855 Strategjia për zgjidhjen afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe personave të zhvendosur në brendi me vështrim të veçantë në fushën Konik, Podgoricë, 2011, f. 25.

856 Përgjigje me anë të postës elektronike e Veljko Tomiqit, e këshilltarit të lartë në Entin për përkujdesje për refugjatët, e datës 20 janar 2012.

pushuar të ekzistojë.⁸⁵⁷ Me Strategjinë e re janë përkufizuar dy zgjidhje të mundshme të problemit të të zhvendosurve dhe personave të zhvendosur në brendi – integrimi lokal dhe kthimi vullnetar.⁸⁵⁸ Me te është paraparë që EPPR, MPB-ja dhe UNHCR-ja të formojnë komisionin, i cili do të shqyrtonte rastet e personave, kërkesat e të cilëve janë refuzuar gjatë pararegjistrimit të personave të zhvendosur në brendi prej muajit shtator të vitit 2009 deri në muajin shkurt të vitit 2010.⁸⁵⁹

Qeveria e Malit të Zi ka sjellë në datën 22 shtator të vitit 2011 vendimin për të formuar Komisionin Koordinues për përcjelljen e implementimit të Strategjisë për zgjidhjen afatgjate të çështjeve të personave të zhvendosur dhe të personave të zhvendosur në brendi me përqendrim të veçantë në fushën e Konikut. Për kryetar të këtij Komisioni është zgjedhur zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, Dushko Markoviq.

3.5.1. Kthimi i pronës

Komisioni për rindërtimin e Bukovicës i Qeverisë së Malit të Zi, i themeluar në vitin 2007 ka vazhduar me punën në ndërtimin e shtëpive, infrastrukturës rrugore dhe të rrjetit të tensionit të ulët me qëllim të sigurimit të kthimit të qytetarëve të Malit të Zi, të cilët kanë qenë të detyruar për ta braktisur këtë vend për shkak të rrezikimit të jetës dhe sulmit ndaj pronës së tyre nga ana e policisë dhe e ushtrisë.⁸⁶⁰ Në muajin nëntor të vitit 2010, banorëve të Bukovicës iu janë dorëzuar çelësat për 32 objekte banesore. Shuma e tërësishme e mjeteve të investuara në rindërtimin e Bukovicës për vitin 2010 ka qenë rreth dy milion euro.⁸⁶¹ Drejtoria e punëve publike e Qeverisë së Malit të Zi ka kumtuar në muajin nëntor të vitit 2011 se në periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 2010 janë kryer punimet në ndërtimin dhe rindërtimin e 33 objekteve banesore dhe 27 objekteve ndihmëse në Bukovicë.

Sipas të dhënave të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Mal të Zi deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2011 gjithsejtë janë ndërtuar 33 shtëpi dhe deri në fund të vitit 2011 do të ndërtohen edhe dhjetë shtëpi të tjera.⁸⁶² Deri në fund të vitit 2011, 13 familje janë kthyer në Bukovicë, derisa ka përfunduar ndërtimi i 43 objekteve të banimit me rrugë anësore, objekte ndihmëse dhe rrjet elektrik.⁸⁶³ Sipas pohimeve të Shoqatës „Bukovica” dinamika e kryerjes së punimeve në rindërtimin e Bukovicës nuk ka qenë e kënaqshme në periudhën e viteve 2010 –2011 dhe në Bukovicë janë kthyer vetëm dy familje, me anëtarë të moshës së shtyrë, kurse 30 shtëpi dhe më tutje janë pa persona të kthyer. Sipas fjalëve të tyre, me rastin e krijimit të projektit të rindërtimit të shtëpive fare nuk janë këshilluar përfaqësuesit e Shoqatës, dhe as pronarët e objektit dhe ka ndodhur që dikujt t’i ndërtohet shtëpia në tokën e huaj.⁸⁶⁴

3.6. Maqedonia

Gjatë vitit 1999, në Maqedoni kanë ikur rreth 360.000 njerëz nga Kosova. Me Vendim të Qeverisë së Kroacisë në muajin mars të vitit 1999, këtyre njerëzve iu është ofruar mbrojtja e përkohshme humanitare. Rreth 65 për qind e personave kanë qenë të strehuar tek familjet, derisa rreth 35 për qind prej tyre janë strehuar në tetë qendra kolektive, të ndërtuara për këtë qëllim.⁸⁶⁵ Deri në fund të vitit 1999, në Maqedoni kanë mbetur edhe rreth 8.103

857 Strategjia për zgjidhjen afatgjatë të çështjes së personave të zhvendosur dhe personave të zhvendosur në brendi me vështrim të veçantë në fushën Konik, Podgoricë, 2011, f. 5.

858 *Po aty*.

859 *Po aty*, f.9.

860 Komisioni për rindërtimin e Bukovicës, kryeson kryetari i Malit të Zi Filip Vujanoviq. Buxheti i planifikuar për rindërtimin e Bukovicës është 4,5 milionë euro.

861 Buletin i Ministrisë së Punës dhe të Përkujdesjes Sociale, Podgoricë, dhjetor i vitit 2010, f. 16, <http://www.minradiss.gov.me/vodici/info/102635/BILTAN-MINISTARSTVA-RADA-I-SOCIJALNOG-STARANJA-1.html>.

862 Raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut për tremujorin e tretë të vitit 2011, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Mali i Zi,, <http://gamn.org/files/YIHR%20-%20treci%20kvartalni%20izvjestaj%202011.pdf>.

863 „U Bukovicu se u 43 nove kuće vratilo 13 porodica”, *internet stranica* PVPortal – Portali informativ i Pljevlës, <http://pvportal.me/2011/12/u-bukovicu-se-u-43-nove-kuce-vratilo-13-porodica/>.

864 Përgjigje me anë të postës elektronike e kryetarit të Shoqatës „Bukovica” Jakub Durgutit, 20 dhjetor të vitit 2011.

865 Profili i migrimit 2008, Qeveria e Maqedonisë, viti 2009, f.34.

persona nga Kosova (kryesisht romë), në mënyrë që ky numër deri në fund të vitit 2002 të zvogëlohet në 2.750 persona.

Qeveria, në vitin 2003 e ka hequr ndihmën e përkohshme humanitare për refugjatët, kurse në muajin korrik të të njëjtit vit, parlamenti maqedonas e ka miratuar Ligjin mbi azilin dhe mbrojtjen e përkohshme.⁸⁶⁶ Me ligj pranohen të drejtat përkatëse në pajtim me dispozitat e Konventës mbi Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit përkatës: strehimi, ndihma në të holla, mbrojtja shëndetësore, sigurimi pensional-invalidor, por edhe bartja e pronës, e kapitalit të investuar dhe e përfitimit. Për periudhën e viteve 2008-2015, është miratuar në vitin 2008 edhe “Strategjia për integrimin e refugjatëve dhe të të huajve në Maqedoni”. Qëllim i Strategjisë është ndihma dhe përkrahja për integrimin shoqëror të këtyre kategorive të njerëzve përmes ofrimit të azilit dhe të ndihmës me rastin e kthimit në vendin e origjinës. Të dhënat e fundit të UNHCR-së flasin se Maqedonia në vitin 2011 ka pasur 1.398 refugjatë.⁸⁶⁷

Maqedonia ka edhe persona të zhvendosur në brendi dhe atë 473 persona (135 familje).⁸⁶⁸ Një numër i caktuar i këtyre personave është i strehuar në qendra kolektive, kurse për një numër prej tyre Qeveria ka siguruar financat për marrjen me qira të hapësirës për banim.⁸⁶⁹ Shumica e personave të zhvendosur nuk dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës për arsye të sigurisë, edhe pse kanë kaluar dhjetë vite nga përfundimi i konfliktit.⁸⁷⁰

3.7. Sllovenia

Sllovenia e refuzon pagesën e pensioneve për një grup të vogël të oficerëve të pensionuar të APJ-së, të cilët me familje jetojnë në Slloveni. Në mesin e tyre ka edhe slloven, por edhe njerëz nga hapësira të ndryshme të ish RSFJ-së.⁸⁷¹ Disa prej tyre kanë kaluar një kohë të gjatë – midis 7 dhe 10 vite pa pension dhe sigurim shëndetësor. Ata, në muajin shkurt të vitit 2009 i janë drejtuar kryetarit të Sllovenisë, Danilo Türkut, kryeministrit Borut Pahor, kryetarit të parlamentit Pavel Gantarit, kryetarit të Gjykatës Supreme të Sllovenisë Franc Testenit dhe ombudspersonit, zonjës Zdenka Čebashek-Travnikut, por pa sukses. Pensionet për këtë grup të ish oficerëve të APJ-së është dashur të paguhen në përputhje me Marrëveshjen për Trashëgiminë të vitit 2001. Organet shtetërore sllovene i kanë refuzuar këto kërkesa, duke iu referuar nevojës se, para pagesës së pensionit, të lidhin një marrëveshje të veçantë me shtetet e tjera trashëgimtare të RSFJ-së.⁸⁷²

4. Memorialet

4.1. Bosnja dhe Hercegovina

Në Bosnjë e Hercegovinë, shumica e përmendoreve, të cilat janë ngritur, kanë të bëjnë me pjesëtarët e njërit prej popujve përbërës të BdeH. Për këtë arsye, memorialet, jo rrallë, përmbajnë porosi të cilat në mesin e grupeve të

866 *Po aty.*

867 Faqja e internetit e UNHCR, <http://www.unhcr.org/pages/49e48d8f6.html>.

868 Informacioni i marrë nga Ministria e punës dhe e politikës sociale, i datës 30 janar të vitit 2012.

869 *Po aty.*

870 “Раселени доживотно”, Faqja e internetit e *Vecer* 9 qershor i vitit 2010, <http://www.vecer.com.mk/?ItemID=6312BB8579E5F14FA3C69367636D63B5>.

871 Igor Mekina, »Kaj so sploh hoteli častniki JLA?«, Mladina, 5 shkurt i vitit 2009, në dispozicion përmes: <http://www.mladina.si/46147/kaj-so-splloh-hoteli-castniki-jla/>.

872 Sipas dispozitave të Marrëveshjes mbi Trashëgiminë (neni 2 i Aneksit E), shtetet kanë marrë përgjegjësinë që rregullisht të paguajnë pensionet të cilat ua kanë borxh qytetarëve të vet, të cilët kanë qenë shërbyes civil ose ushtarak të RSFJ-së pa marrë parasysh se ku e kanë banimin ose vendbanimin e përhershëm, nëse ato pensione kanë qenë të financuara nga buxheti federativ ose mjetet e tjera federative të RSFJ-së. Megjithatë, neni 3 i Aneksit E, të Marrëveshjes mbi Trashëgiminë parasheh edhe mundësinë që shtetet në rast nevojë mund të lidhin marrëveshje bilaterale për sigurimin e pagesës së pensioneve dhe arrijten e aranzhmaneve të veçanta me qëllim të sigurimit të pagesave të pensioneve në pajtim me nenin 2 të Ligjit mbi vërtetimin e Marrëveshjes mbi çështjet e trashëgimisë, *Gazeta zyrtare e RFJ-së*, 06/02.

ndryshme shkaktojë tensione.⁸⁷³ Ekspertët posaçërisht e theksojnë se shumë përmendore, si pjesë të tyre të pandashme, përcillen nga simbolet fetare dhe, së këndejmi, nga porosi të cilat i kontribuojnë ndezjes së urrejtjes.⁸⁷⁴ Shënjimi i vendit, ku janë ndodhur varrezat masive dhe individuale në nivel shtetëror është i rregulluar me rregulloren mbi shënimin e vendit të zhvarrosjes dhe të varrosjes të personave të zhdukur, të cilën e ka propozuar Grupi punues për implementimin e ligjit për personat e zhdukur, në harmoni me komisionin këshillëdhënës të përbërë prej përfaqësuesve të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur.⁸⁷⁵ Këshilli i Ministrave e ka miratuar rregulloren në muajin tetor të vitit 2006 dhe ajo deri sot nuk ka ndryshuar. Me të përcaktohen pamja e memorialit ose e pllakës përkujtimore, financimi dhe procedurat e tjera të varrimit të personave të zhdukur dhe të gjetur. Është paraparë që për varreza individuale në pllakën e përkujtimit të vendoset mbishkrimi me një pamje unike me të dhënat personale, kohën e zhdukjes dhe kohën e zhvarrosjes së varrezës. Për shënjimin e vendit të zhvarrosjes, sipas rregullores, zgjidhjen ideore e sjellë Komisioni për zgjedhjen e zgjidhjeve ideore. Teksti i mbishkrimit përmban të dhënat zyrtare të Institutit për personat e zhdukur mbi datën e zhvarrosjes, numrin e gjetur të mbetjeve mortore, përkatësinë kombëtare dhe rrethanat e zhdukjes. Po ashtu është e përcaktuar që teksti i shkruar në pllakë në asnjë mënyrë nuk guxon të shpreh as ndjenjat kombëtare e as ato fetare të popujve të tjerë dhe të pakicave që jetojnë në BdheH. Problemi procedural lidhur me zbatimin e vet rregullores qëndron në faktin se ka të bëjë me përmendoret, të cilat, sipas Ligjit mbi personat e zhdukur të vitit 2004, financohen nga Fondi për ndihmë familjeve të personave të zhdukur (Fondi), i cili asnjëherë nuk është themeluar. Sipas Rregullores, Fondi do të kishte të drejtë që të urdhërojë heqjen dhe ndryshimin e përmendoreve ekzistuese me përmbajtje fyese pas pranimit të kërkesës.

Për shkak të moszbatimit të mekanizmit të krijuar për mbajtjen dhe shënjimin e këtyre vendeve, si dhe mekanizmave për të cilët kryerësit do të ishin të dënuar, jo rrallë ndodh vandalizmi i vendeve të krimeve masive. Një nga shembujt është varreza masive Bunarevi në Republika Srpska, nga e cila janë zhvarrosur 27 trupa të boshnjakëve nga kampet e afërta, në të cilat ish të burgosurit e kampit Manjača gjatë vizitës së këtij vendi në fund të vitit 2011 i kanë gjetur kufomat e hedhura të deleve të ngordhura të infektuara, arsye kjo për të cilën i kanë thirrur institucionet për të mbrojtur vendet e krimeve masive.⁸⁷⁶

Një numër i madh i vendeve, në të cilat janë kryer krime të rënda nuk kanë shenja karakteristika, sepse iniciatorët e memorializimit kanë hasur në rezistencën e autoriteteve, që më herët ka qenë posaçërisht e shprehur në Republika Srpska, por edhe disa iniciativa të reja në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës për të vendosur shenja të përkujtimit për pjesëtarët e vrarë të kombësisë serbe kanë hasur në pengesa të ngjashme. Në Sarajevë, për herë të parë në datën 3 maj të vitit 2010, me një marsh të qetë është shënuar vrasja e ushtarëve të APJ-së në Rrugën e Vullnetarëve në organizim të Këshillit të Qeverisë së Republika Srpska për kultivim të traditave të luftërave çlirimtare. Kryetari i bashkisë së Sarajevës Alia Behmen dhe Asambleja Komunale e Qytetit të Sarajevës kanë kërkuar ndalimin e shënimin të vrasjes së pjesëtarëve të APJ-së në Sarajevë.⁸⁷⁷ Megjithëkëtë, shënimi i përvjetorit ka kaluar pa kurrfarë incidentesh si në vitin 2010 ashtu edhe në vitin 2011, megjithëse është përjetuar si një provokim i llojit të vet nga ana e autoriteteve të Republika Srpska. Organizatat e luftës nga Republika Srpska (RS), e kanë filluar nismën që, nëse iu jepet leja, në Rrugën e Vullnetarëve (tash Rruga e Hamdi Kreshevljakoviçit) të vendosin pllakën përkujtimore të APJ-së për të rënë në përlëshje me Mbrojtjen Territoriale të BdheH.

Nënkryetari i Federatës së BdheH Svetozar Pudariq, në muajin tetor të vitit 2011 ka iniciuar ngritjen e përmendores për viktimat e krimeve të luftës të cilat i kanë kryer Armata e Bosnjës dhe e Hercegovinës ndaj pjesëtarëve të kombësisë serbe gjatë rrethimit të Sarajevës në Kazani të Trebeviçi. Për këto krime askush nuk është dënuar

873 ICMP, Raport nga konferenca: Promovimi i qasjes së tërësishtme të çështjes së memorialëve dhe kujtimit, Sarajevë, 8-10 dhjetor i vitit 2010.

874 "Manipulimi me vendet e kujtimit", faqja e internetit e BIRN, <http://www.bim.ba/bh/230/10/29819/?tpl=30>.

875 Rregullore mbi shënimin e vendeve të zhvarrosjeve dhe varrosjeve të personave të zhdukur, *Gazeta zyrtare e BdheH*, nr. 83/06.

876 „Lidhja e të burgosurve në kampe në BdheH: Të mbrohen vendet e krimeve masive“, faqja e internetit *Moje vijesti*, 14 nëntor i vitit 2011, <http://www.mojevijesti.ba/novost/104179/Zastititi-mjesta-masovnih-zlocina>.

877 „Sarajevë: Nesër shënimi i vrasjeve të ushtarëve të APJ-së në Rrugën e Vullnetarëve“, faqja e internetit *Depo*, 2 maj 2010, <http://www.depo.ba/vijest/6108>.

para gjykatave në BdeH, dhe as që është vërtetuar zyrtarisht numri i viktimave.⁸⁷⁸

Me rastin e miratimit të Ligjit mbi Përmendoret dhe memorialet e luftërave çlirimtare në RS,⁸⁷⁹ klubet e deputetëve të popullit boshnjak dhe kroat kanë parashtruar kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë para Gjykatës Supreme të RS.⁸⁸⁰ Për shkak të shumë dispozitave kontestuese në ligjin jo fort moti të miratuar, ata edhe e kanë iniciuar çështjen e mbrojtjes së interesave vitale kombëtare, krahas vërejtjes themelore që në ligj të mos lihet mundësia që të ngrihen, të mbahen dhe ligjërisht të normohen memorialet, para së gjithash të viktimave civile të luftës, si dhe të pjesëtarëve të Armatës së RdeH dhe të Këshillit kroat të Mbrojtjes (KKM).⁸⁸¹ Për shkak të vetos së delegatëve boshnjak dhe kroat në Këshill të Kombeve të Republika Srpska, qëndron edhe nisma mbi formimin e regjistrit të të gjitha përmendoreve dhe memorialëve të Republika Srpska.

Përmendorja me emrat e 1.226 qytetarëve të vrarë të Kozarcit, gurthemeli i së cilës është vënë në vitin 2009, ka përfunduar në muajin korrik të vitit 2010. Përmendorja ka formën e një kupole të madhe të hirtë të gurtë, në brendësinë e së cilës janë të shkruar emrat e 1,226 boshnjakëve nga Kozarci, të vrarë në kohën e luftës. Jashtësia e kupolës është e mbuluar me qirin elektrik – nga një për secilën viktimë – të cilët ndriçojnë gjatë natës.

Në vitin 2011 janë mbajtur një numër i madh i ngjarjeve, qëllim i të cilave ka qenë shënimi i përkujtimit të viktimave të konflikteve të armatosura. Ngjarje me karakter ndërkombëtar, me numrin më të madh të pjesëmarrësve edhe në vitet paraprake, është “Marshi i paqes” i cili këtë vit ka zgjatur nga data 07 deri në datën 10 korrik të vitit 2011. Kjo vizitë memoriale mbahet nga viti 2005 në kuadër të shënimit të përvjetorit nga gjenocidi i kryer ndaj boshnjakëve në Srebrenicë nga Ushtria e Republika Srpska. Gjatë manifestimit, i cili zgjat tri ditë, në lokacione të caktuara mbahen promovime të librave, shfaqje të filmave dokumentar dhe orë të historisë, në të cilat mund të dëgjohen edhe dëshmi të srebrenicasve, të pjesëmarrësve të „Marshit të vdekjes” të vitit 1995.⁸⁸²

Shoqata e të burgosurve të kampit *Prijedor 92* tashmë pas një numri të gjatë të viteve, në bashkëpunim me shoqatat e tjera, midis të cilave është edhe shoqatat e të burgosurve të kampit *Kozarac*, shoqata *Urat e miqësisë* nga Rizvanoviqi i Prijedorit dhe Shoqata *Me zemër deri te paqja* nga Kozarci, organizojnë shumë manifestime gjatë vitit në fushat e vrasjes dhe në ish kampet e vrasjeve të boshnjakëve dhe kroatëve në komunën e Prijedorit gjatë luftës në BdeH.⁸⁸³ Organizohet edhe tribuna në shenjë të përkujtimit të doktorit të vrarë Esad Sadikoviqit, që mbahet në datën 5 gusht në teatrin e Prijedorit. Në kuadër të këtyre manifestimeve organizohen edhe ekspozita, performanca artistike dhe ngjashëm. Përfaqësuesit e Shoqatës së të burgosurve të kampit *Prijedor 92* e theksojnë se ekziston një problem i madh me vendosjen e pllakave përkujtimore në vendet e vrasjes dhe të burgosjes. Shumica e këtyre vendeve tash është pronë private dhe pronarët e ri nuk e lejojnë shënjimin e vendit të rënies e shpesh as edhe vizitat me qëllim të nderimit të viktimave.⁸⁸⁴

Edhe pse Ligji mbi përmendoret dhe simbolet i Distriktit të Brçkos është i miratuar qysh në vitin 2003, për shkak të mospajtimeve lidhur me zbatimin e tij, mbikëqyrësi i përfaqësuesit të lartë për Brçkon në vitin 2007 përkohë-

878 „Sarajeva pa shpirt dhe pa moral”, faqja e internetit e *Radio Sarajevo*, 22 dhjetor i vitit 2011, <http://www.radiosarajevo.ba/novost/70195/sarajevo-bez-duse-i-morala>.

879 Ligji mbi përmendoret dhe memorialët e luftërave çlirimtare është miratuar në Kuvendin Popullor të Republika Srpska, në datën 3 nëntor të vitit 2011.

880 Vendim mbi iniciimin e procedurës së mbrojtjes së interesit vital nacional të popullit boshnjak, i datës 14 nëntor të vitit 2011, Këshilli i Kombeve, http://vijecenarodars.net/index.php?option=com_content&view=article&id=164%3A2011-12-08-10-24-28&catid=1%3A2011-02-24-07-34-05&.

881 “Gjykata Kushtetuese e RS vendos mbi ligjin e kontestuar mbi përmendoret”, faqja e internetit e *Vijesti*, 21 dhjetor i vitit 2011, <http://www.mojevijesti.ba/novost/108238/Ustavni-sud-RS-odlucuje-o-spornom-Zakonu-o-spomenicima>.

882 Marshi i vdekjes është një kalim nga territori i RS drejt territorit nën kontrollin e Armatës së BdeH i dhjetëra mijëra srebrenicasve në vitin 1995, gjatë të cilit një numër i madh i tyre janë burgosur nga ana e URS e pastaj janë vrarë.

883 Në kuadër të shënimit të krimit në territorin e komunës së Prijedorit shënohet sulmi në Kozarac, pësimet në bregun e Majtë të Sanës, krimet në kampet Keraterm, Omarska dhe Manjača, krimi në Hrastova Glavica, krimi në Shkëmbinj të e Koriqanit në bjeshkën Vlasiq.

884 Përgjigje me anë të postës elektronike nga Edina Ramuliqi, Shoqata e Burimit Prijedoras, e datës 23 nëntor të vitit 2011.

sisht e ka ndaluar ndërtimin e përmendoreve në distrikt.⁸⁸⁵ Megjithëkëtë, dy vite e gjysmë më vonë, partitë politike, shoqatat e luftëtarëve dhe shoqatat e viktimave e kanë arritur marrëveshjen dhe mbikëqyrësi për Brçkon, Raffi Gregorian, në datën 21 dhjetor të vitit 2009 e ka dhënë Urdhrin mbi përmendoret, me të cilin njoftohet për lejimin e ngritjes së memorialëve për viktimat civile në luftërat e viteve 1992-1995 dhe 1939-1945.⁸⁸⁶ Ndërtimi i memorialeve deri në fund të vitit 2011 nuk ka arritur të përfundojë.

Në rrethin e ndërmarrjes publike “Luka Brçko”, në organizim të Shoqatës së të burgosurve të kampit të distriktit, në datën 7 maj të vitit 2011 është hapur dhoma-përkujtimore në të cilën janë ekspozuar një pjesë e fotografive, në të cilat janë të paraqitura pamjet e vrasjes së civilëve në këtë qytet.⁸⁸⁷ Me atë rast është theksuar se me hapjen e kësaj dhome përkujtimore për herë të parë në BdheH në një mënyrë të tillë shënohet dita e vrasjes së civilëve në kampe. Sipas fjalëve të kryetarit të Federatës së të burgosurve nëpër kampe të BdheH, Murat Tahiroviqit, “hapja e dhomës përkujtimore do të tregoj, në një mënyrë, edhe numrin e njerëzve të cilët këtu kanë rënë dhe faktin se këtu njëmend ka pasur kamp, në të cilin janë vrarë njerëzit”.⁸⁸⁸

4.2. Kroacia

Me rastin e vizitës së parlamentit të Bosnjës e Hercegovinës, kryetari i Kroacisë Ivo Josipoviç ka shprehur ndjesën për krimet dhe pësimet e njerëzve të pafajshëm, që i ka shkaktuar politika e Kroacisë e viteve 1990-të në Bosnjë e Hercegovinë. Pas kësaj, Josipoviç ka vizituar edhe fshatin Ahmiq në të cilin pjesëtarët e Këshillit Kroat të Mbrotjtjes (KKM) i kanë vrarë 116 civilë kroat, duke i përfshirë këtu edhe gratë dhe fëmijët.⁸⁸⁹

Gjatë vitit 2011 i është kushtuar paksa më shumë vëmendje komemoracionit të viktimave të vitit 1991, duke qenë se shënohet 20 vjetori i tyre. Në Kroaci, vend qendror ka zënë shënimi i 20 vjetorit nga pësimet e Vukovarit. Më shumë se 30.000 qytetarë nga e gjithë Kroacia, në mesin tyre edhe kryetari dr. Ivo Josipoviç dhe ish kryeministrja Jadranka Kosor, kanë marrë pjesë në kolonën e përkujtimit, e cila i ka vizituar vendet e pësimit në Vukovar, në datën 18 nëntor të vitit 2011. Po ashtu, qytetarët në sheshe dhe në rrugë të tjera në anë e kënd qyteteve të tjera në Kroaci, i kanë lënë me mijëra qirinjtë të ndezur për viktimat e Vukovarit.

Në prag të shënimit të AUL *Stuhia*, në muajin gusht të vitit 2011, në Knin është zbuluar përmendorja e fitores. Përmendorja e zë një pjesë të madhe të Sheshit dr. Franjo Tugiman në Knin, kurse është punuar në formë të shkronjës „V“, që simbolizon fitoren (angl. victory). Në përmendore janë inkorporuar kishëza, kryqi, harku triumfal. Megjithëkëtë, shënimi i 16 vjetorit të AUL *Stuhia* ka kaluar në hije të aktgjykimit jo të plotfuqishëm të GJPNJ për gjeneralët kroat për krime të kryera në operacionin ushtarak. Me rastin e mbajtjes së fjalimit në Knin, ish kryeministrja Jadranka Kosor ka përshëndetur „të gjithë veteranët kroat, të gjithë gjeneralët, e posaçërisht gjeneralët kroat Ante Gotovinën dhe Mlladen Markaçin“.

Gjatë viteve 2010 dhe 2011, ka pasur disa përpjekje të vendosjes së memorialëve për serbët e rënë gjatë luftës në Kroaci nga ana e shoqatave të familjeve të të rënëve ose shoqatat joqeveritare, prej të cilave shumica kanë qenë të pasuksesshme.

Në 15 vjetorin e AUL *Stuhia*, aktivistët e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (Nisma) në Knin kanë

885 *Ligji mbi përmendoret dhe simbolet*, Gazeta zyrtare e Distriktit të Brçkos së BdheH, nr.22/03.

886 Zyra e Përfaqësuesit të Lartë, Urdhër i supervizorit mbi përmendoret, 21 dhjetor i vitit 2009, faqja e internetit e OHR, http://www.ohr.int/print/?content_id=44319.

887 “Dhoma e hapur përkujtimore”, faqja e internetit *eBrçko*, 7 maj i datës 2011, http://ebrcko.net/index.php?option=com_content&view=article&id=2838:otvorena-spomen-soba&catid=16:vijesti1&Itemid=180.

888 „Tahiroviq: Brçko jeton në një gjendje të pazgjidhur“, faqja e internetit *Nezavisni BiH informativni portal Otisak*, 7 maj i vitit 2012, http://www.otisak.ba/index.php?option=com_content&view=article&id=11049:tahirovi-brko-ivi-u-nerijeenom-stanju-foto&catid=23:brko-distrikt&Itemid=138.

889 Amnesty International, *Behind the wall of silence: Prosecution of war crimes in Croatia*, f. 59, faqja e internetit Amnesty International, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/EUR64/003/2010/en/81544213-9880-4a5e-acea-d5269d0bc8ad/eur640032010en.pdf>.

vendosur pllakën përkujtimore me mbishkrimin –“5.8.1995.–5.8.2010., Në 15 vjetorin e aksionit Stuhia të UK, përmes kësaj rruge, nëpër të cilën kanë kaluar me mijëra refugjatë, pllakën e vendosin qytetarët e RK, të cilët iu ofrojnë viktimave ndjesën në mungesë të ndjesës së njerëzve të përgjegjshëm“. Edhe pse Nisma ka kërkuar lejen për vendosjen e kësaj pllake përkujtimore, kurrë nuk ka marrë përgjigje nga drejtorja e qytetit të Kninit, apo e njëjta është hequr në pak se 24 orë pas vendosjes me vendim të kryetares së bashkisë së Kninit Josipa Rimac, dhe kurrë nuk është kthyer.

Në tetor të vitit 2010 në Varivode është zbuluar përmendorja kushtuar nëntë civilëve të kombësisë serbe, të cilët në vitin 1995 janë vrarë nga forcat kroate. Në këtë përmendore janë emrat e nëntë civilëve të vrarë të shkruara me alfabetin latin dhe cirilik. Gjatë zbulimit të përmendores, krahas përfaqësuesve të Këshillit popullor Serb dhe të komunës Kistanje, kanë qenë të pranishëm edhe kryetari Josipoviç, si dhe përfaqësuesit e qeverisë, Radovan Fuchs dhe Slobodan Uzelac. Josipoviç me këtë rast ka theksuar se është fjala për viktima civile dhe ka vlerësuar se si është fjala për një nga krimet që përfaqësojnë turp për Kroacinë.

Në muajin tetor të vitit 2011, një grup i banorëve të Golubiqit afër Kninit (kryesisht persona të kthyer) ua kanë ngritur përmendoren anëtarëve të familjeve të tyre të rënë në luftë në vitet 1991 – 1995 godine.⁸⁹⁰ Në përmendore fillimisht kanë qenë emrat e 34 personave të kombësisë serbe, prej të cilëve shumica kanë rënë në vitin 1995, kurse një numër dukshëm më i vogël në vitin 1991. Kjo përmendore, megjithëkëtë, nuk është zbuluar aso kohe, duke qenë se ministri i punëve të brendshme i asaj kohe Tomislav Karamarko, e ka ndaluar zbulimin e saj duke e cekur si arsye frikën nga shqetësimi i qytetarëve dhe nga shkelja e rendit dhe e qetësisë publike.⁸⁹¹ Familjeve të viktimave iu është ndaluar edhe përkujtimi i mirëmbajtjes. Ky vendim i ministrit është sjellë pas protestës së shoqatave të veteranëve nga i gjithë rajoni i Zarës dhe i Kninit, të cilat kanë pohuar se si në mesin e emrave të shkruar në përmendore gjendet edhe “një numër i madh i individëve, të cilët kanë mbajtur uniforma çetnike dhe janë vrarë në luftë me pjesëtarët e UK”.⁸⁹² Në mënyrë plotësuese, inspekcioni i Ministrisë së mbrojtjes së ambientit, rregullimit hapësiror dhe i ndërtimit ka ardhur në përfundim se si përmendorja është ndërtuar pa lejet përkatëse dhe në tokën e cila kryesisht është në pronësi të shtetit. Në fund, kjo përmendore është zbuluar në formën e saj të ndryshuar në muajin nëntor të vitit 2011. Në të nuk janë cekur më emrat individual të të rënëve, por në të është shkruar vetëm mbishkrimi „Në kujtim të Golubiçansve të rënë në luftëra“.⁸⁹³

4.3. Serbia

Pllaka përkujtimore e viktimave serbe të rëna në luftërat e hapësirave të ish Jugosllavisë nga viti 1991 deri në vitin 2000 është zbuluar në parkun e Tashmajdanit me rastin e shënimit të Ditës së Personave të Zhdukur, në datën 30 gusht të vitit 2010. Ngritjen e pllakës përkujtimore e ka iniciuar koordinimi i shoqatave serbe të familjeve të personave të zhdukur nga hapësira e ish Jugosllavisë, kurse e ka miratuar Kuvendi i qytetit të Beogradit, që edhe e ka ndihmuar financiarisht këtë aksion. Në solemnitetin e zbulimit të pllakës ka qenë i pranishëm edhe nënkryetari i kuvendit të qytetit të Beogradit, Zoran Alimpiç.⁸⁹⁴

Në qendër të Pançevës, në muajin nëntor të vitit 2010, është zbuluar pllaka përkujtimore për Srgjan Aleksiçin, në

890 Përmendorja është vendosur në varrezën e kishës ortodokse Shën Stefani në Golubiq.

891 “Karamarko ka ndaluar zbulimin e përmendores për viktimat serbe në Golubiq”, faqja e internetit *Slobodna Dalmacija*, 1 tetor i vitit 2011, <http://www.slobodnadalmacija.hr/Hrvatska/tabid/66/articleType/ArticleView/articleId/150702/Default.aspx>.

892 “Karamarko ka ndaluar zbulimin e përmendores për viktimat serbe në Golubiq për shkak të rrezikut nga incidentet”, faqja e internetit e *Jutarnji list*, 1 tetor i vitit 2011, <http://www.jutarnji.hr/template/article/article-print.jsp?id=977984>.

893 “Prapë stuhishëm në Golubiq: Përkundër ndalesës, serbët e ndërrojnë përmendoren – tash bëhen nderime për “të rënë në luftëra”, faqja e internetit e *Slobodna Dalmacija*, 8 nëntor i vitit 2011, <http://slobodnadalmacija.hr/Hrvatska/tabid/66/articleType/ArticleView/articleId/154387/Default.aspx>.

894 “Zbulohet pllaka përkujtimore për viktimat serbe”, faqja e internetit e *Vesti online*, 30 gusht i vitit 2010, <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/78323/Otkrivena-spomen-ploca-srpskim-zrtvama>.

kalimin i cili tash bart emrin e tij.⁸⁹⁵ Me rastin e vendosjes së pllakës të pranishëm kanë qenë edhe babai i Srgjanit, Rade Aleksiç, kryetarja e bashkisë së Pançevës Vesna Martinović, ambasadori i BdeH në Serbi, Borisha Arnaut, si dhe përfaqësuesit e Kuvendit Komunal dhe të sektorit civil të rajonit. Nismën për vendosjen e pllakës përkujtimore dhe emërimin e kalimit e ka miratuar Kuvendi komunal i Pançevës me nismën e organizatës joqeveritare Aksioni qytetar, e cila e ka propozuar në emër të koalicionit të organizatave joqeveritare të Vojvodinës Qytetare.

Pllakën përkujtimore për pjesëtarët e Njësisë Speciale Antiterroriste (NjSA) “për të rënë gjatë kryerjes së detyrave në mbrojtje të vendit” e kanë zbuluar me rastin e shënimit të ditës së themelimit të njësisë, në muajin dhjetor të vitit 2010 kryetari i Serbisë Boris Tadiq dhe ministri i punëve të brendshme të Serbisë Ivica Daçiç, kurse në përshpirtje ndihmësi i patriarkut KOS-it Atanasije Rakita.⁸⁹⁶ Ministri Daçiç me atë rast ka deklaruar: “gjashtëmbëdhjetë pjesëtar të Njësisë kanë rënë duke i kryer detyrat e tyre në luftë, por edhe në paqe, gjë që duhet të na përkujtojë se sa punë e rrezikshme, e rëndë dhe e komplikuar është kjo. Është obligim i yni që të mos zbehet kujtimi për ta. Dëshirojmë që në pllakën përkujtimore të mos jetë i shtuar më asnjë emër.”⁸⁹⁷ Agjencia Informative dhe e Sigurimit(AIS) ka zbuluar një pllakë të re në muzeun e saj kushtuar “të akuzuarve të Hagës”. Vendosja përmban objekte të cilat iu kanë takuar të akuzuarve, të cilët më vonë janë konfiskuar, kurse në pllakë janë ekspozuar edhe objekte të cilat janë gjetur të arratisurit me rastin e burgosjes së tyre, midis të tjerash dy revole të cilat janë gjetur tek Ratko Mlladiqi në momentin kur është burgosur dhe letërnjoftimi i tij, i cila nuk e ka numrin dhe nuk është i lëshuar në bazë të shenjave të gishtërinjve.⁸⁹⁸

Nisma e disa organizatave joqeveritare nga Beogradi që 11 korriku të shpallet Ditë e Përkujtimit të Viktimave të gjenocidit në Srebrenicë ka nisur në fillim të vitit 2009, kur Parlamenti Evropian e ka miratuar Rezolutën me të cilën i thërret shtetet e Bashkimit Evropian e posaçërisht shtetet e Ballkanit Perëndimor, që në këtë mënyrë të shënojnë kujtimin ndaj gjenocidit në Srebrenicë.⁸⁹⁹ Në kuadër të nismës i është drejtuar letër ish kryetarit të Serbisë, Boris Tadiqit për të mbështetur kërkesën që 11 korriku të shpallet dhe të shënohet si Ditë e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë. Është organizuar aksioni i leximit publik të letrës në çdo të 11-tin e muajit para ndërtesës së Presidencës së Serbisë, që ka zgjatur deri në qershor të vitit 2011.⁹⁰⁰

Krahas kësaj, *Gratë në të zeza* së bashku me një grup artistësh, Qendrën për dekontaminim kulturor, Teatrin Fryma, grupin Hedhurinat nga Beogradi dhe Art klinikën nga Novi Sadi, në vitin 2010, në dhjetëvjetorin e shënimit të gjenocidit në Srebrenicë e kanë filluar fushatën për ngritjen e përmendores për viktimat e gjenocidit në Beograd.⁹⁰¹ Fushata “Një palë këpucë – një jetë” ka filluar me aksionin simbolik të mbledhjes së 8.372 palë këpucëve dhe mesazheve të viktimave të Srebrenicës, të cilat i kanë dhuruar qytetarët e Beogradit. Në muajin nëntor të vitit 2010, një grup i organizatave dhe i artistëve i është drejtuar Komisionit për Përmendoret dhe Emërtim të rrugëve të shesheve të Kuvendit të qytetit të Beogradit me kërkesën që në Beograd të ndahet hapësira për ekspozimin e këpucëve dhe mesazheve të grumbulluara, që do të ishte edhe hapësirë për diskutimet publike mbi krimet.⁹⁰² Kërkesa është përsëritur në muajin mars të vitit 2011, por Komisioni i Kuvendit të qytetit pa kurrfarë debati publik e ka refuzuar. Përndryshe, Komisioni, si argument kundër e ka cekur atë se “është fjala për një

895 „Pançevë: Pllakë përkujtimore për Srgjan Aleksiçin”, faqja e internetit e *Vesti online*, 8 nëntor i vitit 2010. <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/95392/Pancevo-Spomen-ploca-Srdanu-Aleksicu>.

896 “Pllakë përkujtimore për SAJ-asit e rënë”, faqja e internetit e *Vesti online*, 20 dhjetor i vitit 2010, <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/105265/Spomenploca-poginulim-SAJevcima>.

897 “Kreu shtetëror i Serbisë, Kusta dhe Pizhoni në ceremoninë e SAJ-asit në Batajnicë!”, faqja e internetit e *Press online*, 21 dhjetor i vitit 2010, <http://www.pressonline.rs/sr/vesti/hronika/story/144855/Dr%C5%BEavni+vrh+Srbije%2C+Kusta+i+Pi%C5%BEon+na+proslavi+SAJ-a+u+Batajnici%21.html>.

898 “Nga revolja e Mladiqit deri te seanca e Dabiqit”, *Danas*, 21 nëntor i vitit 2011, f. 1, 4 dhe 5.

899 Iniciatorë kanë qenë Fondi për të Drejtën Humanitare, *Gratë në të zeza*, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Qendra për përparimin e studimeve juridike, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut dhe Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut.

900 Përgjigje me anë të postës elektronike nga Milosh Urosheviqi dhe Natasha Lambiq, *Gratë në Zeza*, 12 korrik i vitit 2012.

901 Ana Vilenica, performuese, Biljana Rakočević, fotografe artistike, Branimir Stojanović, psikanalitik, Milica Tomiq, artiste, dhe Sasha Stojanović, artist figurativ.

902 Kopjet e kërkesës së organizatës *Gratë në të zeza* të drejtuara Kuvendit të qytetit të Beogradit të siguruar me anë të postës elektronike nga *Gratë në të zeza* në datën 12 korrik të vitit 2012.

ngjarje, e cila gjithsesi se e meriton të jetë e shënuar me përmendore, por në vendin e ngjarjes, ashtu siç, përndryshe, është edhe praktikë” e që nuk është shfrytëzuar si kriter me rastin e vendosjes mbi ngritjen e përmendoreve për të gjithë të rënë në luftërat e të nëntëdhjetave.⁹⁰³

Fondi për të Drejtën Humanitare, duke hulumtuar dhe duke grumbulluar materialin për projektin *Humbjet njerëzore*, i cili përfshin Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, ka evidentuar dhe ka dokumentuar edhe 70 përmendore dhe pllaka përkujtimore që kanë të bëjnë me viktimat e luftërave prej vitit 1991 deri në vitin 2000. Numri më i madh i memorialëve, i cili ka të bëjë me qytetarët e Serbisë të rënë në konfliktet e armatosura gjendet në Serbi (64), kurse dukshëm më pak ka në Mal të Zi (4) dhe në Kosovë (2). Nga numri i tërësishëm, në qytete ndodhen 40 përmendore dhe pllaka përkujtimore, në ambientet rurale 26, derisa katër memorialë gjenden në vendet ku kanë ndodhur incidentet. Janë shënuar vendet e incidenteve në të gjitha rastet e lokacioneve, në të cilat civilët e kanë humbur jetën gjatë bombardimeve të NATO-s.

Rolin më të rëndësishëm në ngritjen e memorialëve e kanë pasur shoqatat e luftëtarëve të luftërave, të cilat dikur kanë vepruar në mënyrë të pavarur, kurse një kohë në bashkëpunim me administratat lokale dhe përfaqësuesit e policisë dhe të ushtrisë. Përfaqësuesit e qeverisë lokale, të policisë dhe të ushtrisë po ashtu edhe në mënyrë të pavarur kanë ngritur përmendore, si dhe familjet e viktimave. Një pllakë përkujtimore e ka vendosur Partia Radikale Serbe, kurse dy përmendore i kanë financuar ndërmarrjet. Në vendosjen e një memoriali specifik në formë të dy altarëve, së bashku me familjet, ka marrë pjesë edhe Kisha Ortodokse Serbe. Një memorial është edhe i sheshit në Kraljevë.⁹⁰⁴ Në shumicën e përmendoreve dhe të pllakave përkujtimore nuk është shënuar data e vendosjes.⁹⁰⁵ Numri më i madh i përmendoreve dhe i pllakave përkujtimore, tetë, janë ndërtuar dhe vendosur në vitin 2000, pra, menjëherë pas përfundimit të konflikteve të luftërave në hapësirat e ish RSFJ-së.⁹⁰⁶

4.4. Kosova

Kosova nuk ka procedurë të përkufizuar me ligj për ngritjen e përmendoreve/memorialëve dhe procedura për ngritjen e përmendoreve ndryshon nga komuna në komunë. Nismat për ngritjen e përmendoreve më së shpeshti ua kanë parastruar komunave familjet e luftëtarëve të rënë, shoqatat e veteranëve të luftës dhe asambltet komunale.⁹⁰⁷ Me përfundim të kompleksit *Adem Jashari*, nuk ka përmendore të tjera ose qendra memoriale, të cilat janë të mbrojtura me ligj.

Ligji mbi shpalljen e kompleksit memorial *Adem Jashari* në Prekaz si zonë e një rëndësie të veçantë (Ligji nr. 2004/39), është miratuar në vitin 2004 dhe paraqet ligjin e parë që ka të bëjë me memorializimin e kujtesës kolektive të shqiptarëve të Kosovës ndaj konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.⁹⁰⁸

Anë e kënd Kosovës janë ngritur përmendore të ndryshme pas përfundimit të konfliktit të armatosur dhe kryesisht të gjithë iu janë kushtuar luftëtarëve të rënë të UÇK-së.⁹⁰⁹ Përmendoret kushtuar luftëtarëve të rënë të UÇK-së janë të mëdha, mbizotërojnë me ambientin dhe më së shpeshti janë të vendosura anash rrugëve. Më së shpeshti i lavdërojnë dhe i promovojnë simbolet kombëtare (flamurin shqiptar, uniformën e UÇK-së etj), kurse shpesh janë të pranishme edhe mbishkrimet “viktimat e rëna” [martir] dhe “luftëtarë të rënë” [dëshmor], përkatësisht “martir i kombit” [dëshmori i kombit].⁹¹⁰ Në zonat fshatare përmendoret shpesh janë të ngritura pa leje, gjë

903 *Po aty*.

904 Hulumtuesit e FDH-së gjatë hulumtimeve në terren kanë hetuar disa raste të dhënies së emrave rrugëve sipas pjesëtarëve të UJ-së dhe MPB-së, të cilët kanë rënë gjatë konflikteve të armatosura në ish RSFJ. Rrugët, të cilat tash i bartin emrat e tyre, kryesisht janë rrugë në të cilat jetojnë familjet e tyre.

905 Nga 25 prej tyre, në të cilat kjo e dhënë ka qenë e dukshme, nga një janë vënë në vitet: 1995, 1998, 2001, 2002, 2003 dhe 2005. Nga dy janë zbuluar në vitet: 1996, 1999, 2006 dhe 2010, kurse tri në vitin 2009.

906 Të gjitha të dhënat janë marrë nga hulumtuesit e humbjeve njerëzore të Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës në Fondin për të Drejtën Humanitare.

907 Elife Krasniqi, “Përmendoret në Kosovë sot”, *Made in KS*, nr. 6, maj i vitit 2011, f. 5.

908 Ligji nr.2004/39 mbi shpalljen e kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekazë për zonë me rëndësi të veçantë kombëtare.

909 *Po aty*, f. 4-6.

910 *Po aty*, f. 6.

që komunitat e kanë toleruar pa intervenime, kurse në qytete në këto vitet e fundit është e domosdoshme leja nga Drejtorati për urbanizëm.⁹¹¹

Në muzeun kombëtar në Prishtinë është e hapur ekspozita e përhershme kushtuar luftës së UÇK-së, e cila përmban artefakte nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999.⁹¹²

Në Kosovë mbahet edhe një numër i madh i komemoracioneve, të cilat i organizon secila komunë e pakta njëherë në vit, shpesh nën patronatin e kryetarit të komunës. Tubimi i më i rëndësishëm përkujtimor është “Epopëja e UÇK-së” - [Epopëja, Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës], komemoracion që i kushtohet luftës së UÇK-së dhe Adem Jasharit, që zgjat tri ditë në muajin mars dhe e cila nuk është e rregulluar me ligj si festë kombëtare, por përkrahet nga organet shtetërore dhe në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Qeverisë së Kosovës si dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare.

Nga viti 2003, në Kosovë, data e 27 prillit shënohet si Dita e Personave të Zhdukur.⁹¹³ Kuvendi i Kosovës në datën 8 shkurt të vitit 2007 ka miratuar vendimin me të cilin prej atëherë kjo datë zyrtarisht shënohet si Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur.⁹¹⁴

Bashkësia serbe në Kosovë ka ngritur në vitin 2009 përmendoren e cila i kushtohet serbëve të rrëmbyer dhe të vrarë gjatë viteve 1998 -2000 në Hoçë të Madhe, komuna e Rahovecit, por pa lejen e autoriteteve komunale. Në trupin e përmendores është mozaiku me fytyrën e Shën Gjonit si dhe pllakat me emrat e gdhendur të personave të rrëmbyer dhe të vrarë. Ndërtimin e përmendores e ka organizuar Kisha Ortodokse Serbe dhe banorët e Hoçës së Madhe. Me rastin e zbulimit të përmendores në datën 11 shtator të vitit 2009 kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e MKCA-së, kryetari i Komisionit për personat e Zhdukur të Serbisë Veljko Odalović dhe anëtarët e familjeve të personave të zhdukur nga Rahoveci.⁹¹⁵

Bashkësia serbe në Kosovë e shënon edhe ditën e veçantë të personave të zhdukur në datën 22 qershor.⁹¹⁶ Familjet e të zhdukurve çdo vit e shënojnë këtë ditë me anë të manifestimeve në shumë vende të Kosovës, kurse në pjesën veriore të Mitrovicës i vendosin kurorat me lule në monumentin “E vërteta”.⁹¹⁷

4.5. Mali i Zi

Edhe pse qysh në vitin 2009 Kuvendi Komunal i Podgoricës ka miratuar Programin për ngritjen e përmendoreve-memorialëve për viktimat civile të luftës në parkun përkujtimor Pobrezhje në Podgoricë, ky vendim është realizuar vetëm në datën 11 korrik të vitit 2011, kur kryeministri Igor Lukshiq solemnisht e ka zbuluar memorialin pikërisht në Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë. Në pllakën përkujtimore shkruan: „Viktimave civile të luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë 1991–2001 – Të mos përsëritet“.⁹¹⁸

911 Informacion i marrë nga FDH Kosovë.

912 Intervistë me Helena Zdravković-Zonta, hulumtuesen e pavarur akademike, e datës 24 nëntor të vitit 2011.

913 Atë ditë, në vitin 1999, pjesëtarët e forcave të armatosura serbe kanë vrarë ose kanë kidnapuar 400 shqiptarë të Kosovës nga fshati Meje në komunën e Gjakovës. Trupat e tyre janë gjetur dhe janë zhvarrosur në varrezat masive në terrenin për stërvitje të Njësisë Speciale Antiterroriste (NJS) të MPB-së së Serbisë, në Batajnicë afër Beogradit, 2001-2002.

914 Pillar III (OSCE) Report 01/2007 On the Monitoring of the Assembly of Kosovo, 1 January 2007 – 28 February 2007, faqja e internetit e OSBE-së, <http://www.osce.org/kosovo/26234>.

915 “Zbulohet përmendorja për personat e zhdukur në Hoçë të Madhe”, faqja e internetit *Studio B*, 11 shtator i vitit 2009, <http://www.studiob.rs/info/vest.php?id=42164>.

916 Atë ditë në vitin 1998 janë kidnapuar dhe deri tash llogariten si të zhdukur rreth njëqind serb në Rahovec, Hoçë të Madhe, Zoçishtë. Optrushë dhe Retimlje.

917 „Shënohet dita e personave të zhdukur në Kosovë“, faqja e internetit e *B92*, 22 qershor të vitit 2011, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=06&dd=22&nav_category=640&nav_id=520495.

918 „Kryetari i Qeverisë Igor Lukshiqi e ka zbuluar Parkun Përkujtimor që i kushtohet të gjitha viktimave civile që llogariten në hapësirat e ish Jugosllavisë në periudhën e viteve 1991 - 2001 “, faqja e internetit e Qeverisë së Malit të Zi, 11 korrik i vitit 2011, <http://www.gov.me/vijesti/107350/Otvoren-Spomen-park-posvecen-svim-civilnim-zrtvama-ratova-vodenih-na-prostorima-bivse-Jugoslavije-u-periodu-od-1991-2001-godine.html>.

Në zbulimin e memorialit në Pobrezhje, kryeministri Lukshiq posaçërisht i ka përkujtuar viktimat e krimit të deportimit, pësimet e udhëtarëve në trenin në Shtpce, viktimat e rëna në Kalugjerski Laz, rënien e viktimave në luftimet dubrovnikase, dëbimin e bukovicasve dhe viktimat civile në Mal të Zi gjatë intervenimit të NATO-s në vitin 1999.⁹¹⁹

Forumi i boshnjakëve/myslimanëve të Malit të Zi, i cili e ka filluar nismën për vënien e këtij memoriali përkujtimor, në të njëjtën ditë në Podgoricë e ka organizuar takimin me rastin e zbulimit të përmendores. Kryetari i Këshillit Drejtues të Forumit Mirsad Rastoderi ka thënë se shpreson „që kjo të jetë vetëm fillimi për punimin e hollësishtëm të kompleksit memorial, në të cilin do të jenë të hetueshme karakteristikat e viktimave, për të cilat përgjegjësit ose bashkëpërgjegjësit janë në Mal të Zi“.⁹²⁰ Përkundër kësaj, kryetari i Shoqatave të Luftëtarëve të luftërave të vitit 1990, Radan Nikoliqi ka deklaruar se përmendorja në Pobrezhje është akt politik dhe se me të theksohen viktimat boshnjake,⁹²¹ derisa për Partinë Popullore ngritja e kësaj përmendoreje ka paraqitur simbolin e kryerjes së seleksionimit midis viktimave.⁹²²

Organizatrat joqeveritare, Qendra për Arsimim Qytetar dhe Aksioni për të Drejtat e Njeriut, së bashku me hulumtuesin e pavarur të shkëlqes së të drejtave të njeriut, Aleksandar Zekoviqin, kanë parashtruar nismën në datën 26 maj të vitit 2011 për ngritjen e memorialit përkujtimor për të deportuarit në Herceg Novi,⁹²³ kurse një ditë më vonë ia kanë parashtruar nismën Kuvendit të Malit të Zi që data 27 maj të shpallet Dita e përkujtimit të Viktimave të Deportimit.⁹²⁴ Nisma është përkrahur nga Kryetari i Kuvendit të Malit të Zi, Ranko Krivokapiq.⁹²⁵

Deri në fund të vitit 2011 nuk është realizuar vendimi i Komisionit për ndërtimin e përmendoreve dhe e Kuvendit komunal të Bijelo Poljes mbi ndërtimin e përmendores për pesë qytetarë të Bijelo Poljes të rrëmbyer nga treni në stacionin e Shtpces në datën 27 shkurt të vitit 1993, për të cilën është dhënë njoftimi në fillim të vitit 2010.⁹²⁶

4.6. Maqedonia

Edhe më tutje nuk ekziston një memorial i përbashkët i kushtuar viktimave maqedonase dhe shqiptare ose luftëtarëve të vrarë dhe të rënë në vitin 2001. Memorialët, të cilat i ka ndërtuar bashkësia shqiptare në Maqedoni (shumica prej tyre të ngritura pa miratimi e organeve kompetente) dukshëm janë në numër më të shumtë se sa memorialët që i kushtohen luftëtarëve të strukturave të sigurimit.⁹²⁷ Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi numrin e gjithmbarshëm të memorialëve të tilla në Maqedoni.

Duke e shënuar një dhjetëvjetësh nga konflikti i vitit 2001, janë ndërtuar disa përmendore për nder të veteranëve të rënë maqedonas. Midis të tjerash, iu është ngritur edhe përmendorja të gjithë veteranëve të rënë të vitit 2001 në pjesën qendrore të Shkupit në muajin tetor të vitit 2011, përmendorja në Manastir e quajtur *Engjëlli*, që i është kushtuar shtatë veteranëve të rënë dhe e zbuluar në vitin 2011, si dhe përmendorja *Karpalak* në Prilep, që i është kushtuar dhjetë veteranëve të rënë të atij qyteti në fund të muajt maj të vitit 2011. Janë të shpeshta rastet e dëmtimit të përmendoreve / memorialëve. Pllaka përkujtimore kushtuar luftëtarëve të ushtrisë maqedonase në vendin

919 *Po aty*.

920 „Të mos përsëritet“, faqja e internetit e *Forumit të boshnjakëve /myslimanëve të Malit të Zi*, 12 shtator i vitit 2011, http://www.forumbosnjaka.com/index.php?subaction=showfull&id=1315841407&archive=&start_from=&ucat=1&

921 „Qeveria e ka harruar Murinën dhe Lorën“, faqja e internetit e *Dan*, 7 korrik i vitit 2011, <http://www.dan.co.me/?nivo=3&rubrika=Drustvo&datum=2011-07-07&clanak=287530>

922 *Po aty*.

923 „Nisma për ngritjen e pllakës përkujtimore për viktimat e deportimit refugjatë të vitit 1992 në Herceg-Novi“, Podgoricë, 26 maj i vitit 2011, <http://cgo-cce.org/saopstenja/Inicijativa%20za%20spomenik%2026052011.pdf>.

924 „Nisma për përcaktimin e Ditës së përkujtimit të viktimave të deportimit të refugjatëve në vitin 1992“, Podgoricë, 27 maj i vitit 2011, <http://cgo-cce.org/saopstenja/Inicijativa%20za%20dan%20sjecanja%2027052011.pdf>.

925 „Përkrahje e plotë për nismën për ndërtimin e përmendores“, faqja e internetit e *Portal Analitika*, 28 maj i vitit 2011, <http://www.portalanalitika.me/drustvo/vijesti/27939-puna-podrka-inicijativi-za-izgradnju-spomenika-.html>.

926 Intervistë me kryetarin e Këshillit Drejtues të boshnjakëve/myslimanëve të Malit të Zi, Mirsad Rastoderin, 23 shkurt i vitit 2012.

927 Intervistë me Vasiliki Neofotistos, profesorëshen e antropologjisë në Universitetin Buffalo në Njujork, 17 janar i vitit 2012.

Karpalak, në rrugën Shkup-Tetovë, ku ka ndodhur incidenti, disa herë është dëmtuar dhe prapë është vendosur.⁹²⁸

Muzeu i lirisë, më i njohur si *Muzeu ONA*, punon që nga muaji nëntor i vitit 2008 në Shkup, por deri më sot nuk është i regjistruar dhe as që është në listën zyrtare të muzeve në Maqedoni.⁹²⁹ Muzeu përbëhet nga dy pjesë, njëra që i kushtohet vitit 1878 (Lidhjes së Prizrenit), dhe tjetri që i kushtohet Ushtrisë Çlirimtare të Kombit dhe ngjarjeve të vitit 2001.

4.7. Sllovenia

Në Slloveni, çështja e memorialëve më së shpeshti është e lidhur me rënien e pjesëtarëve të forcave të mbrojtjes së Sllovenisë. Pas vitit 1991, në shumë vende ku janë zhvilluar konfliktet midis MT-së dhe APJ-së janë vendosur të ashtuquajturat “tetraedër” ose „gjemborët“ në mënyrë që të përkujtohen pengesat kundërtankiste, me të cilat janë ndalur kolonat e APJ-së. Një nga karakteristikat e tilla jo fort moti është vendosur edhe në aeroportin Brnik në shenjë të përkujtimit të vdekjes së dy gazetarëve austriak. Përmendorja dhe pllaka përkujtimore janë vendosur në aeroport me rastin e shënimit të 20 vjetorit të pavarësisë së Sllovenisë dhe në Ditën e Policisë në datën 30 qershor të vitit 2011. Në përmendore janë shkruar edhe emrat e tre të vararëve.⁹³⁰

Shënjime solemne (pllaka përkujtimore) gjenden edhe në shtëpitë në të cilat ka pasur depo të fshehta të armëve para konfliktit në Slloveni, në kalimin në Holmec, kurse në disa vende qëndrojnë edhe shembuj të teknikës së konfiskuar luftarake të APJ-së, për shembull para Muzeut Ushtarak në Lubjanë ose në pjerrësinë Medvedjek.

Në Slloveni nuk ka pllaka përkujtimore, të cilat do ta kujtonin vrasjen e ushtarëve të APJ-së. Nuk ekziston as edhe një përmendore –memorial që i kushtohet të gjitha viktimave të konfliktit në Slloveni në vitin 1991.

Në muajin korrik të vitit 2011, me rastin e tubimit të fundit rreth memorialit të tyre të braktisur „tetraedrit“, ish pjesëtarët e MT sllovene kanë përshëndetur me një minutë heshtjeje edhe ish armiqtë e tyre, të cilët kanë rënë në atë vend.⁹³¹

928 “Нова плоча кај Карпалак”, faqja e internetit e *Nova Makedonija*, 4 shkurt i vitit 2011, <http://novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=2411839358&id=9&prilog=0&setIzdanie=22198>.

929 Intervistë me Skender Asanin, kryetarin e Shoqatës së historianëve të shqiptarëve në Maqedoni, një nga nismëtarët për formimin e “Muzeut të Lirisë”, e datës dhjetor të vitit 2012.

930 „Na Brniku odkrili spomenik ob 20. obletnici samostojnosti“, faqja e internetit e *Delo*, 30 qershor i vitit 2011, faqja e internetit, <http://www.times.si/slovenija/na-brniku-odkrili-spomenik-ob-20-obletnici-samostojnosti--b45a410321-8600cc20c3.html>.

931 „Po 20 letih z grenkim priokusom namesto za orožje prijeli za metle“, faqja e internetit e portalit *Lokalno* www.lokalno.si, 9 korrik i vitit 2011, http://lokalnoaktualno.ext.tmedia.si/2011/07/09/64757/zgodba/Po_20_letih_namesto_za_orozje_z_grenkim_priokusom_prijeli_za_metle.

Përmbajtja

I. Rezyme.....	3
Gjykimet për krimet luftës.....	3
Reformat institucionale.....	7
Vërtetimi i fakteve dhe tregimi i së vërtetës.....	9
Reparacionet.....	9
II. Gjykimet për krimet luftës para gjykatave vendore.....	10
1. Rezyme.....	10
2. Bosnja e Hercegovina.....	15
2.1 Kapacitetet.....	16
2.2 Bartja e përgjegjësive në gjykata të nivelit më të ulët	17
2.3 Federata e BdheH.....	18
2.4 Republika Srpska BdheH.....	18
2.5 Distrikti i Brçkos i BdheH.....	19
2.5.1 Statistika.....	19
2.6 Performanca e Gjykatës së BdheH.....	20
2.7 Ekstradimet nga BdheH dhe në BdheH.....	22
2.8 Gjykimet për dhunën seksuale në luftë.....	22
2.9 Gjykimet për krime në kampin Silos, në shkollën fillore dhe kazermën Krupa.....	22
2.10 Gjykimi i pjesëtarëve të Detashmentit të Dhjetë Diversant të Ushtrisë së RS.....	23
2.11 Rasti i Vullnetares.....	25
3. Kroacia.....	25
3.1 Kapaciteti.....	26
3.2 Qasja ndaj të dhënave mbi procesimin e krimeve të luftës.....	27
3.3 Statistika.....	28
3.4 Gjykimet në mungesë.....	29
3.5 Kohëzgjatja e gjatë e procedurave.....	29
3.6 Anshmëria e gjykatave.....	30
3.7 (Mos)Procesimi i krimeve të forcave kroate.....	30
3.8 Mosprocesimi i komandantëve ushtarak dhe civil të profilit të lartë.....	31
3.9 Viktimat e dhunës seksuale.....	32
3.10 Lirimi me kusht nga vuajtja e dënimit me burgosje.....	32
3.11 Aktgjykimi i plotfuqishëm ndaj Branimir Gllavashit.....	32
3.12 Procedura të reja penale.....	33
3.12.1 Aktakuza kundër Tomisllav Merçepit.....	33
3.12.2 Aktakuza kundër Brodarcit, Millankoviçit dhe Boshnjakut.....	33
3.12.3 Aktakuza kundër Aleksandar Vasileviçit dhe Miroslav Zhivanoviçit.....	34
3.13 Aktgjykimi i shkallës së parë i Hagës ndaj gjeneralëve Gotovina dhe Markaç.....	34
4. Serbia.....	34
4.1 Kapaciteti.....	35
4.2 Statistika.....	36
4.3 Dënimet e ulëta.....	37

4.4.	Gjykimet në proces për krime të luftës.....	37
4.4.1.	Rasti Lovas.....	37
4.4.2.	Rasti Skoçiq.....	38
4.4.3.	Rasti i Qyshkut.....	39
4.5.	Përgjegjësia komanduese.....	40
5.	Kosova.....	41
5.1.	Kapacitetet.....	41
5.2.	Statistika.....	42
5.3.	Gjykimet për krime të luftës në vazhdim.....	43
5.3.1.	Rasti Sabit Geçi.....	43
5.3.2.	Rasti Kleçka.....	44
5.4.	Procesimi i rrëmbimit të serbëve, romëve dhe pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnik.....	44
5.5.	Hetimet e akuzave mbi tregtimin me organe njerëzore (raport i Dick Martit).....	45
6.	Mali i Zi.....	45
6.1.	Kapacitetet.....	46
6.2.	Gjykimet për krimet e luftës.....	46
6.2.1.	Rasti Bukovica.....	46
6.2.2.	Rasti i deportimit të refugjatëve	47
6.2.3.	Rasti Kalugjerski Laz.....	49
6.2.4.	Rasti i Morinjit.....	50
7.	Maqedonia	51
7.1.	Kapacitetet.....	51
7.2.	Statistika.....	51
7.3.	Amnistia për krime të luftës.....	53
8.	Slovenia.....	53
8.1.	Kapacitetet.....	53
8.2.	Statistika.....	54
8.3.	Gjykimet në proces për krime të luftës.....	54
8.3.1.	Lënda Radovanoviq.....	54
8.3.2.	Lënda Grujoviq.....	55
8.4.	Hetimet e papërfunduara.....	55
8.5.	Lëndët e përfunduara në formë të plotfuqishme.....	56
8.5.1.	Lënda Arsimi dhe të tjerët.....	56
8.5.2.	Lënda Koder.....	56
8.5.3.	Lënda Veliqi.....	56
8.5.4.	Lënda Shtrihovec I.....	57
9.	Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët.....	57
9.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	57
9.1.1.	Mbrojtja e dëshmitarëve.....	57
9.1.2.	Mbështetja për dëshmitarët dhe viktimat.....	59
9.2.	Kroacia.....	60
9.2.1.	Mbrojtja e dëshmitarëve.....	60
9.2.2.	Mbështetja për dëshmitarët.....	60
9.3.	Serbia.....	61
9.3.1.	Mbrojtja e dëshmitarëve.....	61

9.3.2.	Përkrahja për dëshmitarët.....	63
9.4.	Kosova.....	63
9.4.1.	Mbrojtja e dëshmitarëve.....	63
9.5.	Mali i Zi.....	65
9.5.1.	Mbrojtja e dëshmitarëve.....	65
9.5.2.	Mbështetja për dëshmitarët	65
9.6.	Maqedonia.....	66
10.	Bashkëpunimi rajonal në procesimin e krimeve të luftës	66
III.	Reformat institucionale.....	69
1.	Rezume.....	69
2.	Lustracioni.....	70
2.1.	Bosnja e Hercegovina.....	70
2.2.	Serbia.....	73
2.3.	Kosova.....	73
2.4.	Mali i Zi.....	73
2.5.	Maqedonia.....	74
2.6.	Sllovenia.....	75
3.	Mbështetja për të dënuarit dhe për të dyshuarit për krime të luftës.....	75
3.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	75
3.2.	Kroacia.....	77
4.	Debatet parlamentare.....	77
4.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	77
4.1.1.	Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.....	79
4.1.2.	Kuvendi Popullor i Republika Srpska.....	80
4.2.	Kroacia.....	81
4.3.	Serbia.....	83
4.4.	Kosova.....	85
4.5.	Mali i Zi.....	86
4.6.	Maqedonia.....	88
4.7.	Sllovenia.....	89
5.	Mediat dhe raportimi mbi krimet e luftës.....	89
5.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	89
5.2.	Kroacia.....	90
5.3.	Serbia.....	92
5.4.	Kosova.....	93
5.5.	Mali i Zi.....	93
5.6.	Maqedonia.....	93
5.7.	Sllovenia.....	93
IV.	Vërtetimi i fakteve dhe tregimi i së vërtetës.....	94
1.	Rezume.....	94

2.	Komisioni për të vërtetën.....	95
2.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	95
2.2.	Sllovenia.....	95
2.3.	Niveli rajonal.....	95
2.3.1.	Procesi KOMRA.....	95
2.3.2.	Gjykata e grave.....	97
3.	Qendra shtetërore hulumtuese-dokumentuese.....	98
3.1.	Kroacia.....	98
3.2.	Kosova.....	98
3.3.	Mali i Zi	99
4.	Vërtetimi dhe dokumentimi i fakteve nga organizatat e shoqërisë civile.....	99
4.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	99
4.2.	Kroacia.....	99
4.3.	Serbia.....	100
4.4.	Kosova.....	100
4.5.	Mali i Zi.....	101
4.6.	Sllovenia.....	101
5.	Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur.....	101
5.1.	Niveli rajonal.....	101
5.1.1.	Koordinimi rajonal i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga hapësira e ish Jugosllavisë.....	102
5.2.	Bosnja dhe Hercegovina.....	102
5.3.	Kroacia.....	104
5.4.	Serbia.....	106
5.5.	Kosova.....	107
5.6.	Mali i Zi.....	109
5.7.	Maqedonia.....	110
5.8.	Sllovenia.....	111
6.	Sistemi i arsimit dhe ngjarjet e periudhës së luftës.....	111
6.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	111
6.2.	Kroacia.....	112
6.3.	Serbia.....	113
6.4.	Kosova.....	115
6.5.	Mali i Zi.....	115
6.6.	Maqedonia.....	116
6.7.	Sllovenia.....	116
V.	Reparacionet.....	118
1.	Rezyme.....	118
2.	Reparacionet materiale.....	119
2.1.	Bosnja e Hercegovina.....	119
2.1.1.	Reparacionet materiale administrative.....	119
2.1.1.1.	Federata e BdheH.....	119
2.1.1.2.	Republika Srpska.....	120
2.1.2.	Reparacionet materiale na bazë të vendimeve gjyqësore.....	121

2.2.	Kroacia.....	124
2.2.1.	Reparacionet materiale administrative.....	124
2.2.2.	Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore.....	125
2.3.	Serbia.....	126
2.3.1.	Reparacionet materiale administrative.....	126
2.3.2.	Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore.....	128
2.4.	Kosova.....	129
2.4.1.	Reparacionet materiale administrative	129
2.4.2.	Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore.....	132
2.5.	Mali i Zi.....	132
2.5.1.	Reparacionet materiale administrative.....	132
2.5.2.	Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore.....	133
2.6.	Maqedonia.....	134
2.7.	Sllovenia.....	135
2.7.1.	Reparacionet materiale administrative.....	135
2.7.2.	Reparacionet materiale në bazë të vendimeve gjyqësore.....	137
3.	Kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur dhe kthimi i pronës.....	139
3.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	139
3.1.1.	Kthimi i pronës.....	140
3.2.	Kroacia.....	141
3.2.1.	Kthimi dhe rimëkëmbja e pronës.....	142
3.3.	Serbia.....	143
3.3.1.	Kthimi i pronës.....	143
3.4.	Kosova.....	144
3.4.1.	Kthim i pronës.....	144
3.5.	Mali i Zi.....	145
3.5.1.	Kthimi i pronës.....	147
3.6.	Maqedonia.....	147
3.7.	Sllovenia.....	148
4.	Memorialet.....	148
4.1.	Bosnja dhe Hercegovina.....	148
4.2.	Kroacia.....	151
4.3.	Serbia.....	152
4.4.	Kosova.....	154
4.5.	Mali i Zi.....	155
4.6.	Maqedonia.....	156
4.7.	Sllovenia.....	157

Botuesi:

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Për botuesin:

Bekim Blakaj

Tirazhi:

200

Prishtinë, 2013

Copyright © 2013

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

342(497.1)(047.3)

Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave : Raport për vitin 2010-2011 / Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë. - Prishtinë : Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, 2013. - 164 f. ; 27 cm.

ISBN 978-9951-8855-2-2

ISBN 978-9951-8855-2-2



9 789951 885522